UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE NË FUSHËN E PËRKTHIMIT TË LETËRSISË PËR FËMIJË

PUNIM PËR GRADËN DOKTOR I SHKENCAVE

NË GJUHËSI

Komisioni:

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

Përgatiti: Udhëheqës shkencor:

MA. ERIOLA QAFZEZI (BONJA) Prof. Dr. VIKTOR RISTANI

Tiranë, 2014

FALENDERIME

Fillimisht do të doja të shprehja falenderim dhe mirënjohje të sinqertë për udhëheqësin shkencor prof.dr. *Viktor Ristanin* për gjithë ndihmën, inkurajimin dhe mbështetjen në të gjitha fazat e përgatitjes së këtij punimi. Ndihma e tij ka qenë e padiskutueshme në çdo moment, duke filluar që nga përcaktimi i fushës së studimit, e, më gjerë, në gjetjen e shtigjeve më me interes për t'u shqyrtuar në këtë punim.

Falenderoj gjithashtu gjithë stafin akademik të Universitetit të Tiranës, koha e studimeve pranë këtij universiteti ka qenë vërtet e vlefshme dhe frytdhënëse dhe pedagogë të ndryshëm, me studimet e tyre prezantuar orëve të studimit pranë këtij universiteti, kanë ndikuar në një mënyrë apo në një tjetër në këtë punim.

Gjej rastin gjithashtu t'iu drejtohem gjithë kolegëve të mi në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës duke iu shprehur mirënjohje për mirëkuptimin gjatë kohës së nevojshme që i jam përkushtuar këtij studimi.

Nuk mund të mos përmend këtu ndihmën e pakursyer të prindërve dhe motrës sime që janë gjendur gjithmonë pranë meje në mënyra të ndryshme duke më dhënë mbështjetje dhe inkurajim të vazhdueshëm për të ecur përpara. Ata kanë qenë një mënyrë për të na dhënë qetësinë e nevojshme mua dhe fëmijëve të mi, sa herë që unë nuk u jam gjendur dot pranë atyre.

Falenderoj gjithashtu bashkëshortin tim që më ka ndenjur pranë dhe më ka mirëkuptuar në çdo hap të këtij studimi dhe iu ka dhënë fëmijëve ngrohtësinë e duhur që të mos e ndienin mungesën time.

Një kërkesë për falje fëmijëve të mi, Lukës dhe Simonit, për kohën tonë të humbur. Çdo fjalë e shkruar në këtë punim ka qenë një kohë e munguar për ta, që kanë bërë çmos të më tërheqin vëmendjen si gjatë orëve të studimit ditën, ashtu edhe gjatë orëve të vona natën duke kërkuar vazhdimisht praninë time. Megjithatë, shpërqëndrimet e tyre kanë qenë vërtet të nevojshme dhe më kanë dhënë edhe më shumë forcë për të ecur me punimin.

TABELA E PËRMBAJTJES

Falenderime i
Tabela e përmbajtjes ii
Shkurtime vii
Listë figurash viii
Listë tabelash ix
Listë grafikësh xii
Hyrje xiii
KREU I Zhvillimi i përkthimit të letërsisë për fëmijë si një degë e veçantë brenda studimeve përkthimore 1
I.1 Kuadër teorik rreth studimeve përkthimore 2
I.1.1 Pikpamje të ndryshme mbi përkthimin 2
a. Çështja e ekuivalencës 4
b. Pozicionimi i përkthyesit 5
I.1.2 Pikpamje funksionaliste mbi përkthimin 6
I.1.3 Huajëzimi dhe amëtarizimi 9
I.2 Nocioni i diskutueshëm "letërsi për fëmijë" 11
I.3 Struktura e tekstit dhe funksionimi i tij brenda sistemit 15
I.4 Përkthimi për fëmijë kundrejt përkthimit për të rritur 18
I.5 Letërsia për fëmijë nën ndikimin e faktorëve ndërkulturorë dhe ideologjikë 21
1.6 Diskutim përmbledhës rreth pikpamjeve teorike në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë 23

KREU II Përshkrimi i korpusit të përzgjedhur 24
II.1 Arsyet për përzgjedhjen e korpusit 24
II.2 Përshkrimi i elementëve të rëndësishëm si kopertina dhe ilustrimet, parathënia e pasthënia, faqosja, ndarja në kapituj, tabela e përmbajtjes, shënimet, etj. 25
II.2.1 *Alice's Adventures in Wonderland (1865)* 25
II.2.1.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Alice's Adventures in Wonderland* 25
II.2.1.2 Veçanësia e përkthimit në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland* 27
II.2.1.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland* 29

II.2.2 *Harry Potter and the Philosopher's Stone (1997)* 38
II.2.2.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Harry Potter and the Philosopher's Stone* 38
II.2.2.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe 40
II.2.2.3 Të dhëna rreth variantit në gjuhën shqipe 41

II.2.3 *Robinson Crusoe (1719)* 42
II.2.3.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Robinson Crusoe* 42
II.2.3.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe 44
II.2.3.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe 45

II.2.4 *Gulliver's Travels (1726)*.....47
II.2.4.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Gulliver's Travels* 47
II.2.4.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe 48

II.2.4.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe 49

II. 3 Roli i parathënies në korpusin nën shqyrtim 51
II.3.1 Qëndrime të ndryshme mbi rolin e parathënies 52
II.3.2 Funksionet e parathënies në korpusin nën shqyrtim 53

KREU III Qëndrimi i përkthyesit të letërsisë për fëmijë 55
III.1 Marrëdhënia e pabarabartë "i rritur-fëmijë" 55
III.2 (Sh)Përdorimi i pushtetit të të rriturve gjatë përkthimit 56
III.3 Modelet e përkthimit të letërsisë për fëmijë 60
III.4 Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit 63
III.4.1 Sfond teorik mbi amëtarizimin dhe huajëzimin 64
III.4.2 Shfaqje konkrete të prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit 66
Rast Studimor 1 "Gulliver's Travels"
Rast Studimor 2 "Alice's Adventures in Wonderland"
Rast Studimor 3 "Robinson Crusoe"
a) Huazimi 68
b) Përkufizimi 68
c) Përkthimi fjalë për fjalë 69
ç) Zëvendësimi 69
d) Krijim leksikor 70
dh) Mospërfshirja 71
e) Shtimi 72
III.4.3 Shprehja e rezultateve të studimit krahasimor nëpërmjet tabelave dhe grafikëve 72

KREU IV Vështirësitë në identifikimin dhe mbartjen e elementëve ndërtekstualë 79
IV.1 Përshkrim teorik i dukurisë së ndërtekstualitetit 79
IV.2 Ndërtekstualiteti dhe aludimet 81
IV.3 Shfaqje konkrete të aludimeve në korpusin në shqyrtim 85
IV.3.1 *Përkthimi i lojërave të fjalëve* 86
Rast Studimor: Alice's Adventures in Wonderland
IV.3.1.1 Përkufizimi i "lojë fjalësh" 86
IV.3.1.2 Tipologjia e lojërave të fjalëve 87
A. Kriteri formal 87
a. Lojë fjalësh *vertikale* 87
b. Lojë fjalësh *horizontale* 88
B. Kriteri gjuhësor 88
a. Kategoria fonologjike 88
a.1 Homofonia 88
a.2 Homonimia 89
a.3 Homografia 89
a.4 Paronimia 89
b. Kategoria polisemantike 89
c. Kategoria idiomatike 90
ç) Kategoria morfologjike 90
d) Kategoria sintaksore 91

IV.3.1.3 Identifikimi i lojërave të fjalëve në origjinal 91

IV.3.1.4 Strategjitë për përkthimin e lojërave të fjalëve: krahasim mes varianteve në gjuhën shqipe 96
IV.3.1.5 Analizë sasiore dhe interpretime cilësore 105

IV.3.2 Loja e fjalëve "tale-tail" – Marrëdhënia formë-përmbajtje 111
Rast Studimor: Alice's Adventures in Wonderland
IV.3.2.1 Pikpamje të ndryshme rreth diskutimit formë-përmbajtje në përkthim 111
IV.3.2.2 Loja e fjalëve tale-tail dhe variantet e saj në gjuhën shqipe.....112
IV.3.3 Problematika e përkthimit të emrave të përveçëm 121
Rast Studimor 1 - Harry Potter and the Philospher's Stone
Rast Studimor 2 - Alice's Adventures in Wonderland
IV.3.3.1 Pikpamje teorike mbi përkthimin e emrave të përveçëm 123
1) Brixhit Shtolt (1978) 127
2) Suzan Basnet (1980) 127
3) Gëte Klingberg (1986) 128
4) Pitër Njumark (1988) 128
5) Teo Hermans (1988) 128
6) Brixhit Shulze (1991) 129
7) Ritva Lepihalme (1994) 129
8) Ivonë Bertils (2003) 130
IV.3.3.2 Konkretizimi i përkthimit të emrave të përveçëm në brendësi të korpusit.....133
Rast Studimor 1 - Harry Potter and the Philospher's Stone
1. Analiza e emrave të studentëve në Hoguorts 133
a. Personazhi kryesor *Harri Poter* 133
b. Hermionë Granxher dhe Ron Uezli 134
c. Studentë të tjerë nga Grifarti, Baldoskuqi dhe Korbziu 135
d. *Drako Mallfoi* dhe studentë të tjerë nga Gjarpërblerti 136
2. Analizë e emrave të profesorëve dhe stafit në Hoguorts 139
a. Albus Urtimori dhe Minerva MekGur 139
b. Severus Pitoni 141
c. Stafi përbërës në Hoguorts 142
3. Analizë e emrave të magjistarëve të tjerë 144
a. *Fluronvdekja* dhe mbështetës të tij 144
b. Personazhet jo kryesorë 145
c. Emrat e autorëve të librave të studimit 146
4. Analizë e emrave të tjerë 146
a. Emrat e familjarëve 146
b. Adresa ekzistuese dhe të shpikura 147
5. Përfundime në lidhje me strategjitë e përdorura në rastin studimor 1 147
Rast Studimor 2 - Alice's Adventures in Wonderland
1. Emërtimet e personazheve 149
a. Emra marrë nga bota reale 149
b. Emra personazhesh të trilluar 157
2. Emërtimet e lëndëve që zhvillohen në shkollë 159
3. Përfundime në lidhje me strategjitë e përdorura në rastin studimor 2 164

KREU V Pasqyrim konkret i standardeve në përkthimin e letërsisë për fëmijë 166
V.1 Shkallë të ndryshme të përshtatjes si një nga standardet e përkthimit të letërsisë për

Fëmijë.....168
V.1.1 Përshtatja kulturore kontekstuale 169
a. Shpjegimet shtesë 170
b. Rifjalësimi 171
c. Përkthimi shpjegues 172
ç. Shpjegimi jashtë tekstit 172
d. Zëvendësimi me një ekuivalent në kulturën e gjuhës së përkthimit....174
dh. Zëvendësimi me një ekuivalent të përafërt në kulturën e gjuhës së përkthimit 175
e. Thjeshtësimi 177
f. Fshirja 179
g. Lokalizimi 180
1.2 Aspekte gjuhësore 181
V.1.3 Modernizimi 186
V.1.4 Purifikimi 187
V.1.5 Shkurtimi 188
V.1.6 Përshkrimi i vendodhjes gjeografike.....191
V.1.7 Keqpërkthime serioze 192
V.2 Ndryshime në nivelin sintaksor 197
V.2.1 Përputhshmëri ose ngjashmëri në llojin dhe strukturën e fjalisë së përbërë 200
V.2.2 Copëzim i fjalive të përbëra të origjinalit në tekstin e përkthyer 201
V.2.3 Mungesë përputhshmërie në llojin e fjalisë dhe strukturës 202
V.2.3.1 Fjali e thjeshtë në gjuhën origjinale – Fjali e përbërë në gjuhën e përkthimit 202
V.2.3.2 Strukturë e thjeshtësuar e fjalisë në gjuhën e përkthimit 203
V.2.3.3 Fjali e përbërë në origjinal – Fjali e thjeshtë në gjuhën e përkthimit.....204
V.2.3.4 Ndryshim i llojit të pjesës së nënrenditur nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit 204
V.2.3.5 Strukturë më e ndërlikuar në tekstin e përkthyer 204
V.2.4 Përdorimi i lidhëzave.....205
V.2.4.1 Fjali asindetike në origjinal – fjali sindetike në gjuhën shqipe...205
V.2.4.2 Fjali sindetike në origjinal – Fjali asindetike në tekstin e përkthyer 206
V.3 Përfundime në lidhje me ndryshimet në nivel sintaksor 206
V.4 Anë problematike të vërejtura gjatë studimit krahasimor 207
V.4.1 Mungesa e koherencës 208
V.4.2 Gabime drejtshkrimore 210
V.4.3 Shtrembërimi i strukturave morfosintaksore të shqipes 211
V.4.4 Përdorimi i fjalëve e shprehjeve të huazuara kundrejt atyre karakteristike shqiptare 213

PËRFUNDIME 216

BIBLIOGRAFI 223

SHTOJCA 233

Shtojca 1 ***Lojërat e fjalëve në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe***

(1944-2008).....233

Shtojca 2
Tabela përmbledhëse me shembuj krahasues ilustrues nga

përkthimi i HPaPS 245

Shtojca 3

Intervistë me përkthyesit *Taulant dhe Eri Tafa* (varianti IV i AAiW) 253

SHKURTIME

AAiW – Alice's Adventures in Wonderland

GT – Gulliver's Travels

RC – Robinson Crusoe

HPaPS – Harry Potter and the Philosopher's Stone

LBÇ – Liza në Botën e Çudirave

UG – Udhëtimet e Guliverit

RK – Robinson Kruzo

HP – Harri Poter dhe Guri Filozofal

LISTË FIGURASH

Figura 1 ***Tregimi i Miut në origjinal*** 116

Figura 2 ***Tregimi i Miut në V.I*** 117

Figura 3 ***Tregimi i Miut në V.II*** 117

Figura 4 ***Tregimi i Miut në V.III*** 118

Figura 5 ***Tregimi i Miut në V.IV*** 119

Figura 6 ***Tregimi i Miut në V.V*** 120

LISTË TABELASH

Tabela 1
Përkthimi i titujve të kapitujve në variantet në gjuhën shqipe të AAiW 36
Tabela 2
Përkthimi i titujve të kapitujve në variantin në gjuhën shqipe të HPaPS 41
Tabela nr. 3
Korpusi nën shqyrtim - Veprat origjinale dhe variantet në gjuhën shqipe 51
Tabela nr. 4
Strategji për përkthimin e njësive kulturore specifike 72
Tabela nr. 5
Procedurat e përkthimit të njësive specifike kulturore në variantin
në gjuhën shqipe të GT 73
Tabela nr. 6
Prirjet e përkthimit në v. I të AAiW 74
Tabela nr. 7
Prirjet e përkthimit në v. II të AAiW 74
Tabela nr. 8
Prirjet e përkthimit në v. III të AAiW 74
Tabela nr. 9
Prirjet e përkthimit në v. IV të AAiW 75
Tabela nr. 10
Prirjet e përkthimit në v. V të AAiW 75
Tabela nr. 11
Procedurat e përkthimit të njësive specifike kulturore në variantin në gjuhën shqipe
të RC 76
Tabela nr. 12
Lojërat e fjalëve në origjinal: llojet dhe shpjegimi i tyre 92
Tabela nr. 13
Lojërat e fjalëve në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe (1944-2008) 98
Tabela nr.14
Shpërndarja e strategjive të përdorura në përkthimin e lojërave të fjalëve 106
Tabela nr. 15
Përkthimi i lojës së fjalëve "tale-tail" në pesë variantet në gjuhën shqipe 113
Tabela nr. 16
Përkthimi i emrave të përveçëm – personazhe reale 150
Tabela nr.17
Përkthimi i emrave të përveçëm – referenca historike 151
Tabela nr.18
Përkthimi i emrave të përveçëm – referenca gjeografike 152
Tabela nr.19
Përkthimi i emrave të përveçëm – aludime 155
Tabela nr.20
Përkthimi i emrave të përveçëm – trillime 158
Tabela nr. 21
Emrat e lëndëve dhe çfarë përfaqësojnë ato 159
Tabela nr. 22
Emërtimi i lëndëve në variantet e përkthyera 160
Tabela nr. 23
Dukuritë gjuhësore të vërejtura në përkthimin e fjalive të përbëra 198

Tabela nr. 24
Emrat e përveçëm – Studentët në Hogwarts 245
Tabela nr. 25
Emrat e përveçëm – Stafi dhe profesorët në Hogwarts 246
Tabela nr. 26
Emrat e përveçëm – Magjistarë të tjerë 247
Tabela nr. 27
Tituj librash, lëndë në shkollë, shurupe dhe namatisje 248
Tabela nr. 28
Emrat e përveçëm – familjarët 250
Tabela nr. 29
Emrat e rrugëve, adresa, (ekzistuese dhe të shpikura) 251

LISTË GRAFIKËSH

Grafiku nr. 1
Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe të GT ..73

Grafiku nr.2
Përmbledhje e prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit në secilin prej 5 varianteve të AAiW 75

Grafiku nr. 3
Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe të RC ..77

Grafiku nr. 4
Strategjitë e përdorura në V.I për përkthimin e lojërave të fjalëve.....107

Grafiku nr. 5
Strategjitë e përdorura në V.II për përkthimin e lojërave të fjalëve 108

Grafiku nr. 6
Strategjitë e përdorura në V. III për përkthimin e lojërave të fjalëve 108

Grafiku nr. 7
Strategjitë e përdorura në V. IV për përkthimin e lojërave të fjalëve 108

Grafiku nr. 8
Strategjitë e përdorura në V.V për përkthimin e lojërave të fjalëve 109

Grafiku nr. 9
Strategjitë e përdorura në gjithë korpusin për përkthimin e lojërave të fjalëve 109

Grafiku nr. 10
Ruajtja e shkronjës së madhe në emërtimin e lëndëve në variantet në gjuhën shqipe ...163

Grafiku nr. 11
Rikrijimi i aludimeve në emërtimin e lëndëve në variantet në gjuhën shqipe 163

Grafiku nr. 12
Dukuritë gjuhësore të vërejtura në përkthimin e fjalive të përbëra 199

Grafiku nr. 13
Mungesë përputhshmërish ….....200

HYRJE

Përligjia e temës

Në qendër të këtij studimi është vendosur përkthimi i letërsisë për fëmijë, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Në mbarë botën studimet mbi përkthimin e letërsisë për fëmijë kanë fituar një shtrirje të gjerë këto tridhjetë-dyzetë vitet e fundit, duke e kthyer përkthimin e letërsisë për fëmijë në një nga fushat me interes më të lartë studimi brenda studimeve përkthimore. Në hapësirën shqiptare, megjithatë, vërehet lehtësisht se studime të tilla mungojnë, madje, pak rëndësi i kushtohet në përgjithësi përkthimit të librave për fëmijë, duke e lënë në hije një gjini të tillë, aq të rëndësishme për formimin dhe argëtimin e brezave të rinj.

Përzgjedhja e temës së studimit në fjalë nuk ka qenë e rastësishme. Në studimet e mia gjatë specializimit për të fituar titullin Master i Shkencave, kam paraqitur pranë Universitetit të Tiranës punimin me titull *Udhëtimet e Lizës në Botën e Çudirave të Gjuhës Shqipe*, një studim krahasues i veprës origjinale në gjuhën angleze *Alice's Adventures in Wonderland* dhe katër varianteve të saj të ndryshme në gjuhën shqipe. Ka qenë një studim që më ka përfshirë thellësisht në punë krahasimore dhe nëpërmjet të cilit jam ndeshur me shumë shtigje të pashkelura më parë. Por, në fazën në të cilën po punoja kisha si synim kryesor krahasimin shumëplanësh të veprës në fjalë, dhe, duke qenë e kufizuar të punoja vetëm me një vepër, mjaftohesha duke mbajtur shënime rreth gjithë problemeve të cilat nuk i gjeja të trajtuara në literaturën studimore shqiptare, duke gjetur kështu gjithnjë e më shumë mundësi për ta shtrirë studimin në të ardhmen dhe duke i premtuar vetes se çdo pikpyetje e lënë në dyshimet e momentit do të kthehej në një fushë interesante studimi për vitet e ardhshme. Pikërisht në këtë mënyrë filloi të marrë jetë ky studim: shënimet e hollësishme dhe pyetjet që i kam bërë shpesh vetes më kanë shtyrë të bëj gjithmonë e më tepër kërkime në aspektin teorik, të cilat janë shprehur në mënyrë të përmbledhur gjatë këtij punimi. Megjithatë, një punim i tillë që rendit kontributet teorike të dhëna nga studiues të ndryshëm nuk do të kishte qenë i plotë pa u mbështetur në shembuj konkretë, të cilët i japin frymën e vërtetë një studimi krahasues. Për këtë arsye, jam përpjekur që çdo problematikë apo dukuri të përshkruar nga ana teorike të jetë e mbështetur nga shembuj dhe analiza konkrete që bëjnë të mundur nxjerrjen më në pah të problematikës apo dukurisë në fjalë. Një gjë e tillë është mundësuar edhe nëpërmjet zgjerimit të korpusit studimor me qëllim që edhe analizat e bëra të jenë më domethënëse.

Ashtu siç u përmend, në këtë studim renditen një sërë aspektesh teorike dhe praktike të përkthimit të letërsisë për fëmijë, me qëllim zgjimin e interesit të lexuesve dhe studiuesve për këtë fushë kaq interesante, që paraqet edhe më shumë interes gjatë kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën. Gjithashtu, duke qenë një punim i cili hap shtigje të reja diskutimi dhe studimi, duhet përmendur mungesa e natyrës gjithëpërfshirëse dhe shteruese të tij. Ajo çka shpresojmë të arrijmë nëpërmjet këtij studimi, mes të tjerash, është informimi dhe rritja e interesit rreth përkthimit të letërsisë për fëmijë si dhe çelja e shtigjeve të reja të studimit në të ardhmen, duke dashur të rrisim kontributet në një fushë sa tërheqëse aq edhe delikate, sa të thjeshtë në dukje, por po aq të fshehtë në thellësi, sa të përhapur, por, njëkohësisht, shumë pak të studiuar – përkthimin e letërsisë për fëmijë.

Objekti i studimit dhe hipotezat e tij

Objekti kryesor i këtij studimi është të hedhë dritë e të sjellë informacion sa më të dobishëm në lidhje me përkthimin e letërsisë për fëmijë të shpalosur në dy plane: plani teorik dhe plani praktik. Pjesa teorike ze një vend të konsiderueshëm të studimit, fillimisht duke ndërtuar një kuadër teorik rreth vetë studimeve përkthimore dhe më tej duke përshkruar karakteristika kryesore të letërsisë për fëmijë dhe përkthimit të saj, të cilat e dallojnë atë nga përkthimi i letërsisë për të rritur. Aspekte të tjera teorike të përshkruara në studimin tonë mbështeten nëpërmjet shembujve konkretë, gjë që na fton drejt një të kuptuari edhe më konkret të aspekteve të përshkruara në secilin prej kapitujve që janë pjesë përbërëse e këtij punimi. Dukuritë e përshkruara teorikisht pasurohen edhe bëhen më konkrete nëpërmjet rasteve studimorë. Nëpërmjet këtij punimi synojmë gjithashtu të nxjerrim në pah mënyra të ndryshme se si të rriturit mund të ushtrojnë pushtetin e tyre mbi fëmijët, duke analizuar rolin e përkthyesit dhe faktorëve të tjerë në këtë drejtim. Gjithashtu, dy ndër prirjet kryesore të vërejtura në analizën e përkthimeve në ditët e sotme – huajëzimi dhe amëtarizimi – janë përshkruar në këtë punim në aspektin teorik si dhe në atë praktik nëpërmjet shembujve konkretë të korpusit tonë, duke synuar kështu analizimin e shfaqjes së këtyre dy prirjeve në letërsinë për fëmijë. Objekt i këtij studimi ka qenë gjithashtu përshkrimi i dukurisë së ndërtekstualitetit si një nga dukuritë e studiuara më gjerësisht në studimet përkthimore në ditët e sotme. Në këtë studim, jemi përqëndruar në veçanti në dy shfaqje të ndërtekstualitetit që ia vlejnë t'iu kushtojmë vëmendje të posaçme në përkthimin e letërsisë për fëmijë – lojërat e fjalëve dhe emrat e përveçëm. Kështu, ne synojmë të hedhim dritë mbi analizën e lojërave të fjalëve, llojeve të tyre si dhe strategjitë e ndryshme që janë përdorur për t'i sjellë ato në gjuhën shqipe. Gjithashtu, synojmë t'iu vijmë në ndihmë studiuesve dhe përkthyesve të ndryshëm, duke sjellë një sërë pikpamjesh teorike mbi përkthimin e emrave të përveçëm dhe duke analizuar mënyrat e ndryshme të përkthimit të tyre në korpusin nën shqyrtim. Një ndër synimet më të rëndësishme të këtij studimi është edhe pasqyrimi konkret i standardeve në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke u përqëndruar në përshtatjen në nivele të ndryshme dhe duke u përqendruar në shfaqjen e përshtatjes në forma të ndryshme në nivelin kulturor si dhe në ndryshimet e vërejtura në nivelin sintaksor. Shembuj të ndryshëm vjelë nga i gjithë korpusi na kanë ndihmuar që ta përmbushim këtë synim në mënyrë sa më të plotë dhe praktike. Gjithashtu, nuk mund të lemë pa përmendur edhe një sërë dukurish problematike që kemi vërejtur gjatë krahasimeve që kemi bërë me origjinalin, të cilat i sjellim konkretisht të pasqyruara në këtë punim me qëllim që të hedhim dritë edhe mbi shfaqje të tilla, të cilat nuk duhet të ndodhin gjatë përkthimit.

Meqenëse ky punim është ndër hapat e para që hidhen në fushën e studimit të përkthimit të letërsisë për fëmijë, gjatë hartimit të studimit dhe analizimit të dukurive dhe nxjerrjes së përfundimeve në bazë të analizave përkatëse, pavarësisht fazës sonë të punimit, gjithmonë kemi pasur parasysh zgjimin e interesit të gjerë në lidhje me një fushë pak të studiuar në hapësirën shqiptare. Gjithashtu, paralelisht, kemi synuar t'iu vijmë në ndihmë përkthyesve të letërsisë për fëmijë duke i njohur ata më konkretisht dhe më thellësisht me dukuritë dhe problemet me të cilat mund të përballen në punën e tyre si dhe prezantimin e strategjive të mundshme për t'u përdorur si dhe me mënyrat për të shmangur disa anë problematike që shpesh mund të kalojnë pa u vënë re. Njëkohësisht, duke qenë se pjesë e studimit tonë krahasues janë vepra të përkthyera në një hark kohor që mbulon shtatëdhjetë vitet e fundit, dhe duke vërejtur gjendjen e përkthimeve në ditët e sotme, dëshirojmë që, nëpërmjet këtij punimi, të tërheqim vëmendjen e përkthyesve, redaktorëve, shtëpive botuese, ilustruesve dhe pjesmarrësve të tjerë në përkthimin dhe botimin e letërsisë për fëmijë, duke nxjerrë më në pah faktin se përkthimi i letërsisë për

fëmijë nuk duhet të shikohet si një punë më pak e rëndësishme dhe me më pak përgjegjësi se përkthimi i letërsisë për të rritur.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Ky studim është ndërtuar mbi bazën e hulumtimit të kujdesshëm të materialeve të ndryshme të cilat përqëndrohen në disiplinën e studimeve përkthimore në përgjithësi, dhe përkthimit të letërsisë për fëmijë në veçanti. Kemi shfletuar një sërë librash të botuara, studimesh dhe disertacionesh, si dhe artikuj me natyrë krahasimore të botuar në organe ndërkombëtare. Të gjitha këto materiale na kanë ndihmuar për të hartuar në mënyrë përshkruese pjesën teorike të punimit tonë si dhe për të organizuar pjesën praktike, të cilën e kemi pasuruar me shembuj konkretë nga korpusi që kemi përzgjedhur për t'u shqyrtuar në këtë punim. Për të përmbushur qëllimet e pjesës praktike, jemi përfshirë në një proces të vazhdueshëm krahasimi dhe analizimi të kujdesshëm të veprave origjinale me variantet në gjuhën shqipe si dhe, në rastet e pranisë së më shumë se një varianti të së njëjtës vepër origjinale, krahasimi edhe të varianteve me njëri-tjetrin. Analiza e çdo dukurie të përshkruar teorikisht dhe të mbështetur me shembuj përfaqësues ka qenë pika fillestare që na ka ndihmuar për hartimin e një sërë tabelave dhe grafikëve, të dhënat e të cilëve përmbledhin në mënyrë të sintetizuar gjetjet e studimit tonë. Edhe pse në punim jepen vetëm shembuj përfaqësues, të dhënat përmbledhëse të shprehura në tabela e grafikë i referohen gjithë shembujve të analizuar. Kështu, edhe përfundimet që jepen në lidhje me dukuritë e vërejtura janë më domethënëse e gjithëpërfshirëse.

Studimi është organizuar në pesë kapituj kryesorë të cilët shpalosin aspekte teorike dhe praktike të përkthimit të letërsisë për fëmijë. Meqenëse kemi të bëjmë me një studim i cili synon të hedhë dritë në një fushë studimi relativisht të re në studimet përkthimore në Shqipëri, kemi synuar të sjellim në mënyrë të ekuilibruar aspekte teorike që na janë dukur me interes t'i bëjmë të njohura duke mbështetur dukuritë e përshkruara teorikisht me raste konkretë studimorë nga korpusi ynë. Në kapitullin e parë prezantohet fillimisht një kuadër teorik i studimeve përkthimore, duke u ndalur në disa pikpamje të ndryshme mbi përkthimin, diskutime të ndryshme mbi ekuivalencën dhe pozicionimin e përkthyesit. Brenda këtij kuadri teorik përshkruhen edhe disa pikpamje funksionaliste mbi përkthimin si dhe nocionet e huajëzimit dhe amëtarizimit që rimerren edhe në mënyë praktike në vazhdim të punimit. Duke u përqëndruar në argumentimin e faktit se sot mund të flasim me të drejtë për përkthimin e letërsisë për fëmijë si një degë të veçantë brenda studimeve përkthimore, ky kapitull vazhdon me shpjegimin e nocionit "letërsi për fëmijë", mënyrën e funksionimit të tekstit në brendësi të sistemit si dhe parashtrimin e disa prej faktorëve që e dallojnë përkthimin e letërsisë për të rritur nga përkthimi i letërsisë për fëmijë, e cila është gjithmonë nën ndikimin e faktorëve ideologjikë dhe ndërkulturorë.

Në kapitullin e dytë pasqyrohen në mënyrë të hollësishme veprat origjinale dhe variantet e tyre të përkthyera në gjuhën shqipe, që përbëjnë edhe korpusin e këtij studimi. Për secilën prej veprave të përzgjedhura për këtë studim janë sjellë të dhëna rreth origjinalit si dhe variantit apo varianteve të gjetura në gjuhën shqipe për elementë të tillë si kopertina, ndarja në kapituj, ilustrimet në brendësi të veprës, shënimet e përkthyesit, etj. Gjithashtu, janë zbërthyer edhe arsyet se pse secila vepër paraqitet interesante nga këndvështrimi i përkthimit. Kapitulli mbyllet duke sjellë disa të dhëna me interes në lidhje me rolin dhe funksionin e parathënies në përgjithësi, dhe, në veçanti, në korpusin nën shqyrtim.

Kapitulli i tretë ka për qëllim të shtjellojë qëndrimin e përkthyesit të letërsisë për fëmijë, duke pasqyruar fillimisht arsyet e pabarazisë në marrëdhënien "i rritur-fëmijë" si

dhe një sërë shembujsh se si mund të shpërdorohet pushteti nga ana e të rriturve gjatë përthimit. Me interes është edhe prezantimi i disa modeleve të përkthimit të letërsisë për fëmijë, që mund t'iu hyjë në ndihmë përkthyesve në ditët e sotme. Pjesë e këtij kapitulli është edhe pasqyrimi më i hollësishëm edhe më konkret i prirjeve të huajëzimit dhe amëtarizimit nëpërmjet një sërë shembujsh nga veprat e përzgjedhura si pjesë e korpusit tonë studimor. Rezulatet e nxjerra nga krahasimi paraqiten nëpërmjet tabelave dhe grafikëve, analiza e të cilëve na ndihmon në nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me prirjet e sipërpërmendura.

Me mjaft interes në këtë punim është kapitulli i katërt ku përshkruhet një nga dukuritë që paraqet më shumë domethënie dhe vështirësi gjatë përkthimit në përgjithësi si dhe gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë në veçanti. Fillimisht ndërtekstualiteti përshkruhet teorikisht dhe më pas prezantohen një sërë shembujsh të shfaqjes konkrete të dukurisë së ndërtekstualitetit, duke u ndalur në lojërat e fjalëve dhe përkthimi i emrave të përveçëm. Në lidhje me lojërat e fjalëve bëhet një përshkrim i hollësishëm i tipologjisë së tyre sipas kriterit formal dhe gjuhësor, ndjekur nga strategjitë e vërejtura në përkthimin e tyre. Sërish gjetjet e studimit tonë paraqiten nëpërmjet tabelave dhe grafikëve, që i japin një natyrë më sintetike kësaj pjese të studimit si dhe e bëjnë më të lehtë procesin e interpretimit të të dhënave dhe nxjerrjen e përfundimeve. Në vazhdim të këtij kapitulli prezantohet një çështje mjaft e mprehtë në përkthim që ka të bëjë me përkthimin e emrave të përveçëm. Sërish janë paraqitur një sërë pikpamjesh teorike rreth përkthimit të emrave të përveçëm, duke e shtrirë më pas studimin në planin praktik me një gamë të gjerë shembujsh. Gjatë analizës së shembujve janë studiuar jo vetëm mënyrat e sjelljes në gjuhën shqipe të emrave të përveçëm, por, njëkohësisht, i është kushtuar vëmendje faktit nëse nënkuptimet e fshehura pas emrave të përveçëm të origjinalit arrijnë të përcillen si të tilla në gjuhën shqipe. Ky kapitull mbyllet me parashtrimin e disa përfundimeve në lidhje me strategjitë e përdorura në përkthimin e emrave të përveçëm në korpusin tonë, që shpresojmë të jenë të dobishme për përkthyesit letrarë në përgjithësi, si dhe për përkthyesit e letërsisë për fëmijë në veçanti.

Si pjesë e fundit e këtij studimi shërben kapitulli i pestë, një studim i zgjeruar në lidhje me pasqyrimin e standardeve të përkthimit të letërsisë për fëmijë. Fillimisht përshkruhen teorikisht një sërë shkallësh të përshtatjes kulturore kontekstuale si një nga standardet e përkthimit të letërsisë për fëmijë. Gjithë kuadri teorik pasurohet me shembuj të vjelë nga korpusi ynë, që e bën edhe më interesante pjesën praktike të këtij studimi krahasimor. Në pjesën e dytë të këtij kapitulli kemi përshkruar një sërë ndryshimesh të vërejtura në nivelin sintaksor, të cilat tregojnë se thjeshtësimi i strukturës së fjalisë është një tjetër standard i zbatuar gjerësisht në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Sërish, nëpërmjet shembujve kemi arritur të përpilojmë të dhënat në formën e tabelave dhe grafikëve që i bëjnë më të dukshme rezulatatet e studimit tonë. Ky kapitull mbyllet me një sërë shembujsh të cilët pasqyrojnë edhe disa anë problematike të vërejtura gjatë krahasimit të veprave origjinale me variantet e tyre në gjuhën shqipe, si, për shembull, mungesa e koherencës, gabimet drejtshkrimore, shtrembërimi i strukturave morfosintaksore të gjuhës shqipe si dhe përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve të huazuara kundrejt atyre karakteristike të gjuhës sonë shqipe. Nxjerrja në pah e dukurive të tilla problematike duhet t'i bëjë përkthyesit dhe shtëpitë botuese më të rrisin kujdesin në punën e tyre për të shmangur përcjelljen e kuptimeve të tjetërsuara si dhe për të përcjellë te fëmijët një gjuhë sa më të pasur dhe të pastër, larg ndikimeve të gjuhëve të huaja. Ajo çka është edhe më e rëndësishme për t'u theksuar, vetë përkthyesit duhet të kuptojnë se përkthimi i letërsisë për fëmijë nuk kërkon më pak përkushtim, vëmendje dhe përgjegjësi se përkthimi i letërisisë për të rritur.

Studimi ynë mbyllet duke parashtruar një sërë përfundimesh në formë të përmbledhur në lidhje me aspektet teorike të shtjelluara gjatë gjithë punimit si dhe në lidhje me shembujt e analizuar të cilët përfaqësojnë shfaqje konkrete të aspekteve teorike. Shpresojmë që përfundimet t'iu vijnë në ndihmë studiuesve dhe përkthyesve të përkthimit të letërsisë për fëmijë në veçanti dhe studiuesve dhe përkthyesve letrarë në përgjithësi. Gjithashtu në fund të këtij punimi jepen edhe shtojcat, ku mund të gjeni tabelën e plotë mbi përkthimin e lojërave të fjalëve, disa tabela në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm të llojeve të ndryshme në veprën *Harry Potter and the Philosopher's Stone* si dhe një intervistë zhvilluar me përkthyesit e variantit të tretë të *Alice's Adventures in Wonderland*.

Kreu I Zhvillimi i përkthimit të letërsisë për fëmijë si një degë e veçantë brenda studimeve përkthimore

Interesi kritik në rang botëror për përkthimin e letërsisë për fëmijë është zhvilluar me hapa të shpejtë gjatë tridhjetë viteve të fundit. Kështu shprehet *Xhillian Lejdhi (Gillian Lathey)* në hyrje të veprës së saj me përmbledhje të shkrimeve mbi përkthimin e letërsisë për fëmijë.[1] Një kthesë në këtë drejtim shënoi simpoziumi i tretë i Shoqërisë Ndërkombëtare Studimore për Letërsinë për Fëmijë [*International Research Society for Children's Literature* (*IRSCL*)] në vitin 1976: ishte konferenca e parë për letërsinë për fëmijë (dhe për shumë vjet e vetmja) që i kushtohej tërësisht përkthimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të librave për fëmijë.[2] Në një kohë kur studimi i letërsisë për fëmijë – në rang kombëtar ose ndërkombëtar – sa po fillonte të fitonte besueshmëri akademike, studiuesi austriak Riçard Bamberger (Richard Bamberger) u shpreh në simpozium se "*roli i përkthimit thuajse nuk ishte prekur, pavarësisht faktit se përkthimet janë të një rëndësie edhe më të madhe në letërsinë për fëmijë sesa në letërsinë për të rritur*".[3] Bambergeri e mbështet këtë koment mbi rëndësinë parësore të përkthimeve për fëmijë duke iu referuar universalitetit të dukshëm të "klasikëve" të tillë si përrallat e *vëllezërve Grim, librat e Pinokut, Pipi Çorapegjata dhe Liza në Botën e Çudirave*. Për më tepër, sipas tij, fëmijët nuk interesohen për një libër sepse është një përkthim, siç mund të ndodhë me të rriturit, por për fuqinë e rrëfimit si një histori aventure, fantazie, etj. sikur librat të ishin shkruar fillimisht në gjuhën e tyre. Problematika që ngre Bambergeri në lidhje me dallimet mes mënyrës së pritshmërisë së përkthimeve nga të rriturit dhe fëmijët hapi rrugën për kërkime të mëtejshme në këtë fushë.

U desh një kohë e gjatë që studiuesit në fushën e Studimeve Përkthimore të shqyrtonin sfidat e veçanta të përkthimit të letërsisë për fëmijë. Mendimet prej vitit 1976 deri në ditët e sotme kanë qenë të ndryshme: ka pasur edhe nga ata që mendonin se në punimet teorike në këtë fushë (përkthimi) zor se mund të gjendej diçka që kishte të bënte me vetë temën,[4] ndërkohë që vitet e fundit ekziston mendimi se fusha e përkthimit të letërsisë për fëmijë mbetet ende e patrajtuar nga teoricienët, botuesit dhe institucionet akademike.[5] Megjithatë, duhet të përmendim se shenjat e para të një interesi rreth çështjeve më të përgjithshme të ndikimeve ndërkulturore dhe shpërndarjes ndërkombëtare të letërsisë për fëmijë ishin shfaqur që më parë, që brenda disiplinës së Letërsisë Krahasuese – një degë studimi letrar të përkufizuar nga Suzan Basneti (Susan Bassnett) si një degë që merret me llojet e lidhjeve në letërsitë përtej kufijve kohorë dhë hapësinorë.[6] Nga ana tjetër, komparativisti Pol Hazard (Paul Hazard) botoi që në vitin 1932 dorëshkrimin e tij për një republikë botërore të letërsisë për fëmijë, duke propozuar një këndvështrim romantik për zhvillimin e një të kuptuari ndërkombëtar dhe për shkëmbimin e vlerësimit estetik nëpërmjet librave për fëmijë. Fjalimi i Bambergerit në simpoziumin e lartpërmendur përfaqëson qëndrimin e Hazardit duke pohuar se "*tani mund të flasim me të drejtë për një letërsi botërore për fëmijë që mund të bëjë më shumë për të arritur një kuptim në rang ndërkombëtar. Tani fëmijë në mbarë botën po rriten*

[1] G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters Ltd. fq.1.
[2] Po aty, fq. 1.
[3] R. Bamberger (1978) *The influence of translation on the development of national children's literature* në *Children's Books in Translation.* (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell, fq. 19.
[4] B. Stolt (1978) *How Emil becomes Michel: On the translation of children's books* në *Children's Books in Translation*. (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell, fq. 133.
[5] E. O'Connell (1999) *Translating for children* në *Word, Text, Translation.* (ed.s G. Anderman and M. Rogers) Clevedon: Multilingual Matters, fq. 208.
[6] S. Bassnett (1993) *Comparative Literature: A Critical Introduction*. Oxford: Blackwell, fq. 1.

duke shijuar të njëjtat kënaqësi në të lexuar, dhe duke ndarë të njëjtat ide, qëllime dhe shpresa".[7]

Meqenëse studiuesit dhe kritikët kanë filluar ta vlerësojnë letërsinë për fëmijë si një mjet dinamik nga ana estetike dhe ideologjike, studimet mbi përkthimin e kësaj letërsie kanë fituar më shumë terren. Kështu, duke e parë transmetimin e tekstit për fëmijë nga një gjuhë ose kulturë në një gjuhë ose kulturë tjetër nëpërmjet këndvështrimit të përkthimit, mund të vërejmë pritshmëri dhe interpretime të ndryshme për fëmijërinë.[8] Cilado qoftë pika fillestare nga e cila nisen, studiuesit sfidojnë perceptimin që akoma qëndron i pranuar nga të gjithë se *ndërkombëtarizimi i letërsisë për fëmijë nuk është problematik, dhe se personazhet si Pinoku, Liza dhe Babar i kanë kapërxyer me lehtësi kufijtë kombëtarë dhe gjuhësorë*.[9] Ata i paralajmërojnë lexuesit për pengesat dhe pabarazitë gjatë udhëtimeve të teksteve për fëmijë nëpërmjet përkthimit sipas pikpamjeve të ndryshme mbi fëmijërinë në vende dhe histori të ndryshme dhe sipas faktorëve që ndikojnë në zhvillim.

Përpara se të fillojmë të diskutojmë më në hollësi në lidhje me përkthimin e letërsisë për fëmijë, do të përqëndrohemi së pari në disa pikpamje të ndryshme rreth vetë përkthimit dhe të përkthyerit, gjë që do të na ndihmojë për të kuptuar edhe më mirë arsyet se pse kur flasim për përkthimin e letërsisë për fëmijë duhet të kemi parasysh jo vetëm pikpamje të përgjithshme mbi procesin e të përkthyerit, por duhet të reflektojmë më thellë rreth një sërë faktorësh që luajnë rol të vecantë në këtë gjini, të cilët do të shpërfaqen gjatë këtij kreu.

I.1 Kuadër teorik rreth studimeve përkthimore

Në këtë çështje të punimin tonë do të prezantojmë në mënyrë të përmbledhur qëndrimet e studiuesve të ndryshëm në lidhje me përkthimin dhe veprimtarinë përkthimore. Theksojmë që në fillim se synimi ynë ka qenë parashtrimi i atyre pikpamjeve që paraqesin interes për studimin tonë, pra, nuk kemi si synim të sjellim në mënyrë kronologjike dhe gjerësisht studime që kanë formësuar ndërdisiplinën e studimeve përkthimore, por ato pikpamje që ne i shohim si të dobishme për këtë studim krahasimor. Do të fillojmë duke parashtruar disa qëndrime teorike rreth përkthimit dhe përkthyesit, dhe, më pas, do të paraqesim disa pikpamje funksionaliste si dhe prirjet e huajëzimit dhe amëtarizimit, të cilat marrin një rëndësi të veçantë në përkthimin e letërsisë për fëmijë.

I.1.1 Pikpamje të ndryshme mbi përkthimin

Përkthimi dhe të përkthyerit janë koncepte për të cilat ekzistojnë një sërë përkufizimesh në varësi të këndvështrimit përkatës. Një njeri i zakonshëm mund të mendojë se përkthimi ka të bëjë thjesht me ndryshimin e një teksti nga një gjuhë në një tjetër. Për gjuhëtarët përkthimi duhet parë si një shkencë, ndërsa studiues të ndryshëm e shikojnë përkthimin si një art me natyrë krijuese.[10] Për shembull, sipas studiuesit Roxher Belli (Roger Bell), përkthimi nënkupton transformimin e një teksti që ka ekzistuar në një gjuhë

[7] R. Bamberger (1978) *The Influence of Translation on the Development of national Children's Literature* në veprën *Children's Books in Translation.(ed.s Klingberg* and *Ørvig)*, Stockholm: Almqvist and Wiksell, fq. 21.
[8] G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters Ltd., fq. 2.
[9] Po aty, fq. 4.
[10] Shikoni për shembull S. Bassnett (2002) *Translation Studies*. London: Routledge, fq. 4,6; R. T. Bell (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London:Longman, fq. 4.

në një tekst ekuivalent (të njëvlershëm) në një gjuhë tjetër, duke ruajtur, sa më shumë të jetë e mundur, përmbajtjen e mesazhit si dhe karakteristikat formale dhe rolet funksionale të origjinalit.[11] Gjithashtu, përkthimi mund të konsiderohet edhe si një akt rileximi dhe rishkrimi,[12] që mbush boshllëqet mes gjuhëve,[13] ose si një veprimtari që ndërton ura lidhëse në hapësirën mes origjinalit dhe përkthimit.[14] Një larmi e tillë përkufizimesh na bën të mendojmë se edhe vetë veprimtaria përkthimore nuk është aq e drejtpërdrejtë dhe e thjeshtë sa mund të mendohet.

Disiplina e studimeve përkthimore, mes të tjerash, ka për qëllim zhvillimin e një teorie apo disa teorive të përkthimit të cilat përkufizojnë dhe shpjegojnë praktikat e përkthimit. Sipas Basnetit, qëllimi i teorisë së përkthimit është arritja e të kuptuarit të proceseve që marrin pjesë gjatë veprimtarisë përkthimore.[15] Ndërsa Pitër Njumarku (Peter Newmark) beson se teoria e përkthimit nuk mund të konsiderohet as si teori dhe as si shkencë, por si një trup njohurish rreth procesit të të përkthyerit. Ja se si shprehet ai:

> *Qëllimi kryesor i teorisë së përkthimit është të përcaktojë metoda të përshtatshme për shkallën më të gjerë të mundshme të teksteve apo të kategorive të teksteve. Për më tepër, ajo siguron një kuadër parimesh, rregullash dhe ndihmesash për përkthimin e teksteve si dhe për realizimin e kritikës së përkthimeve, një sfond për zgjidhjen e problemeve.*[16]

Siç mund të vihet re, nuk ekziston një bashkëmarrëveshje në lidhje me qëllimin përfundimtar të studimeve përkthimore: mund të mbahet një qëndrim normativ ("metoda të përshtatshme", "kuadër parimesh") në përqasje me një qëndrim më përshkrues ("të kuptuarit e asaj çka ndodh në të vërtetë gjatë përkthimit).[17] Në ditët e sotme, nuk ka një qëndrim teorik të vetëm në lidhje me përkthimin që të jetë pranuar gjerësisht dhe që të zbatohet në të gjitha veprimtaritë përkthimore dhe nga të gjithë studiuesit e kësaj disipline. Madje, edhe qëllimi i studimeve përkthimore ka ardhur duke u zgjeruar, nga diskutimet e lashta "përkthim fjalë-për-fjalë kundrejt përkthim i lirë", duke përfshirë më gjerë pikpamjet post-koloniale dhe feministe mbi përkthimin, së bashku me çështjet e fuqisë, etikës dhe pabarazisë në përkthim. Kështu, kur flasim për përkthimin nuk kemi parasysh thjesht dhe vetëm ndryshimin e fjalëve të origjinalit dhe zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera në tekstin e përkthyer, por, në ditët e sotme, përkthimi konsiderohet të jetë një proces negociimi ndërmjet teksteve dhe kulturave, një proces gjatë së cilit ndodhin një sërë shkëmbimesh të ndërmjetësuara nga përkthyesi.[18] Përkthimi, pra, nuk paraqet vetëm interes gjuhësor, por përfshin gjithashtu një ndërthurje mes kulturave të ndryshme. Më poshtë do të përmendim vetëm disa nga çështjet qëndrore të studimeve përkthimore.

a. Çështja e ekuivalencës

Një nga çështjet më thelbësore të trajtuara teorikisht brenda studimeve përkthimore ka të bëjë me konceptin e ekuivalencës. Sipas Dagllas Robinsonit (Douglas Robinson), shumica e studimeve përkthimore perëndimore e kanë trajtuar ekuivalencën si qëllimin

[11] R. T. Bell (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London:Longman, fq. xv.
[12] R. Oittinen (1995). *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press.
[13] P. Newmark (1991) *About Translation*. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 25.
[14] S. Bassnett (2002) *Translation Studies*. London: Routledge, fq. 10.
[15] Po aty, fq. 43.
[16] P. Newmark (1981) *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon , fq. 19.
[17] Për të pasur një këndvështrim më të plotë në lidhje me historikun e zhvillimit të studimeve përkthimore, mund t'i referoheni Bassnett (2002) *Translation Studies*. London: Routledge.
[18] S. Bassnett (2002) *Translation Studies*. London: Routledge, fq. 6.

kryesor të përkthimit në përgjithësi.[19] Tradicionalisht, ekuivalenca është nënkuptuar si ekzistenca e njëvlershmërisë mes tekstit origjinal dhe përkthimit. Megjithatë, sipas Otinenit vetë termi "ekuivalencë" është i paqartë, ashtu si dhe përkufizimet që jepen rreth tij.[20] Teoricienë të ndryshëm sjellin pikpamje të ndryshme se çfarë lloj ekuivalence kërkohet – e plotë apo e pjesshme, në nivelin e fjalës apo të kuptimit, e kështu me radhë.

Pikpamja tradicionale shpreh qëndrimin se gjatë përkthimit përkthyesi duhet të përzgjedhë mes kërkimit për ekuivalentë formalë (duke u përqëndruar në aspektin semantik të tekstit dhe duke bërë një përkthim literal apo fjalë-për-fjalë) apo për ekuivalentë funksionalë (duke pasur si qëllim të ruajë mesazhin e origjinalit, pra, duke bërë një përkthim të lirë, sipas kuptimit).[21] Megjithatë, ne i përmbahemi qëndrimit të Njumarkut, i cili shprehet si më poshtë vijon:

> *Ekziston një bashkëmarrëveshje e përgjithshme por jo gjithëpërfshirëse se qëllimi kryesor i përkthyesit është të prodhojë për lexuesit e tij një efekt mundësisht sa më të afërt me efektin e prodhuar për lexuesit e origjinalit. Ky parim njihet kryesisht si parimi i reagimit apo efektit të ngjashëm ose të njëvlershëm, ose, ndryshe, si ekuivalencë funksionale apo dinamike. Një parim i tillë i shmang dhe i kapërxen gjithë polemikat e shekullit të nëntëmbëdhjetë në lidhje me faktin nëse përkthimi duhet të priret drejt gjuhës së origjinalit apo të përkthimit, si dhe gjithë diskutimet që venë ballë për ballë besnikërinë ndaj bukurisë, përkthimin fjalë-për-fjalë ndaj përkthimit të lirë, formën ndaj përmbajtjes.*[22]

Edhe këto pak shembuj rreth çështjes së ekuivalencës na bëjnë të kuptojmë se përkufizimet dhe termat mund të jenë të paqarta dhe të mbivendosen. Për më tepër, Roxher Belli shprehet:

> *... ideali i një ekuivalence të plotë është një iluzion mendor, pjellë e imagjinatës... Kalimi nga njëra gjuhë në tjetrën, me përkufizim, nënkupton ndryshimin e formës. Gjithashtu, ballafaqimi i formave nxjerr në pah kuptime që asnjëherë nuk mund të përputhen plotësisht; nuk ka sinonimi absolute ndërmjet fjalëve të së njëjtës gjuhë.*[23]

Nëse përqëndrohemi thjesht në gjetjen apo në krijimin e ekuivalencës së plotë, kur dihet se një gjë e tillë nuk mund të arrihet, do të anashkalojmë çështje të rëndësishme të veprimtarisë përkthimore. Përkthimi nuk është thjesht një shkëmbim fjalësh nga gjuha në gjuhë, por është një proces komunikativ që ndodh brenda një konteksti shoqëror.[24] Gjithashtu, siç venë në dukje studiuesit Hatim dhe Mason, pjesë e këtij procesi është edhe vendimarrja (çfarë dhe si do të përkthehet). Vendimet e përkthyesit në lidhje me përzgjedhjen e fjalëve dhe shprehjeve të përshtatshme sipas kontekstit dhe sipas interpretimit të tyre në rolin e një lexuesi bëjnë që çdo tekst i përkthyer të jetë unik në vetvetë dhe të dallohet nga përkthimet e tjera, duke e lënë kështu në hije kërkimin e

---

[19] D. Robinson (1991) *The Translator's Turn*. The John Hopkins University Press, fq. 259, cituar në Oittinen (1995), fq. 34.
[20] R. Oittinen (1995) *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press, fq. 35.
[21] R. T. Bell (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London:Longman, fq. 7.
[22] P. Newmark (1981) *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon , fq. 10.
[23] R. T. Bell (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London:Longman, fq. 6.
[24] B. Hatim dhe I. Mason (1990). *Discourse and the translator*. London: Longman, fq. 3.

ekuivalencës dhe duke u përfshirë në kërkimin e strategjive të përkthimit, një çështje më praktike dhe më e frytshme në veprimtarinë përkthimore.[25]

b. Pozicionimi i përkthyesit

Edhe qëndrimet mbi pozicionin e përkthyesit dhe qëndrimit të tij ndaj veprës origjinale janë të ndryshme. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, për shembull, ekzistonin dy pikpamje të ndryshme: ose përkthyesi konsiderohej si dikush që do t'i nënshtrohej shkrimtarit origjinal, sepse origjinali kishte një status më të lartë se përkthimi, gjë që kërkonte një përkthim besnik; ose përkthyesi ishte ai që do të përmirësonte origjinalin, që konsiderohej si më inferior, duke lënë kështu vend për një përkthim më të lirë.[26] Në kohët e sotme, sërish ekzistojnë prirje të tilla që, nga njëra anë, e shohin përkthyesin si dikë që e çliron tekstin nga zinxhirët e gjuhës origjinale, duke i dhënë një identitet të ri në gjuhën e përkthimit, dhe, nga ana tjetër, si një tradhtar, që shformon synimet origjinale të shkrimtarit, duke i lejuar vetes shumë liri gjatë përkthimit të tekstit.[27] Për këtë arsye, ekziston edhe një perceptim i tillë sipas së cilit përkthyesi "i mirë" është ai që i qëndron "besnik" tekstit origjinal, por një qëndrim i tillë është shumë subjektivist, sepse bazohet thjesht në shije dhe interpretime personale dhe jo në kritere objektive dhe të frytshme.

Edhe në lidhje me çështjen e besnikërisë nuk ekziston një marrëveshje e përgjithshme. Përcaktimi i shkallës së besnikërisë, në fakt, nënkupton që përkthyesi duhet të ketë një kriter matës sipas së cilit të vlerësohet edhe cilësia e përkthimit, gjithmonë në krahasim të vazhdueshëm me origjinalin. Duhet të mbahen parasysh gjëra të tilla si besnikëria ndaj shkrimtarit origjinal, synimeve të tij, përcjelljes me besnikëri të nënkuptimeve dhe mesazheve të fshehura, stilit të shkrimtarit, portretizimit të personazheve, etj. me synimin për të rikrijuar efekt përafërsisht të njëjtë te lexuesit e tekstit të përkthyer. Sipas Roxher Bellit, duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi qëllimit të përkthimit,[28] ndërsa Rita Otinen (Rita Oittinen) mendon se përkthyesi duhet të përpiqet të krijojë një tërësi të besueshme, të rikrijojë idenë e librit origjinal.[29] Një këndvështrim i tillë mbi përkthyesin, pra, si një riprodhues, duhet të na bëjë të reflektojmë edhe më shumë mbi qëndrimin e përkthyesit ndaj origjinalit dhe ndikimit të tij në tekstin e përkthyer dhe "kufijtë" e lirisë së tij.

Gjatë punimit tonë do t'i përmbahemi perceptimit të përkthyesit si një lexues i tekstit origjinal. Çdo lexues bën interpretime personale, nisur nga një sërë faktorësh si formimi dhe pritshmëritë kulturore dhe letrare, madje dhe gjendja emocionale. Sipas Hatimit dhe Masonit, të cilët citojnë studiuesin Xhorxh Shteiner (George Steiner), çdo lexim i tekstit është në vetvete një veprim përkthimor, d.m.th. një interpretim. Ne përpiqemi të zbulojmë se çfarë nënkuptohet në një tekst nisur nga një sërë kuptimesh të mundshme, me fjalë të tjera, nga potenciali i kuptimit.[30] Kështu, pra, përkthyesi, si një nga shumë lexues të mundshëm të tekstit origjinal, e lexon dhe e interpreton tekstin, së bashku me synimet e shkrimtarit origjinal. Ky proces leximi përbën fazën fillestare të procesit të përkthimit të cilit do t'i nënshtrohet vepra origjinale. Pra, ajo çka përkthehet

[25] Gjatë këtij punimi përdorim termin "strategji" bazuar në përkufizimin "***Një strategji përkthimi është një procedurë që shërben për të zgjidhur një problem me të cilin përballemi gjatë përkthimit të një teksti apo një pjese të tij.***" **[**M. Baker (2005) *Routledge Encyclopedia of Translation Studies.* London: Routledge, fq. 188.]

[26] S. Bassnett (2002) *Translation Studies*. London: Routledge, fq. 13.

[27] R. T. Bell (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London:Longman, fq. 6.

[28] Po aty, fq. 7.

[29] R. Oittinen (2004) *Translating for children – theory.* Në P. Hunt (ed.), *International Companion Encyclopedia of Children's Literature*. London: Routledge, fq. 901.

[30] B. Hatim dhe I. Mason (1990). *Discourse and the translator*. London: Longman, fq. 10.

nuk është synimi i shkrimtarit origjinal, por interpretimi që i ka bërë përkthyesi synimeve të shkrimtarit.[31] Ky proces interpretimi le vend për të shkaktuar pasiguri në lidhje me autorësinë e tekstit.[32]

Të tjera pikpamje në lidhje me rolin e përkthyesit i referohen faktit nëse prania e përkthyesit duhet të njihet dhe të jetë e dallueshme në tekstin e përkthyer, apo, nëse, në të kundërt, përkthyesi duhet të mbetet i padukshëm, thjesht duke komunikuar mesazhin e shkrimtarit origjinal në gjuhën e përkthimit. Sipas studiuesve Hatim dhe Mason, çfarëdo përkthimi, deri në një farë mase, do të pasqyrojë botkuptimin e përgjithshëm mendor dhe kulturor të vetë përkthyesit, pavarësisht përpjekjeve për të qenë sa më të paanshëm.[33] Rëndësia e të qenurit të paanshëm theksohet edhe më shumë nëse lexojmë me kujdes fjalët e Otinen: "*përkthyesit nuk janë faktorë asnjëanës në proces*", meqenëse ata kanë përvojat dhe botkuptimin e tyre personal dhe kulturor, të cilat ndikojnë në punën e tyre.

I.1.2 Pikpamje funksionaliste mbi përkthimin

Pikpamjet e përfshira nën qëndrimin funksionalist kanë të bëjnë me funksionin ose funksionet e teksteve dhe përkthimeve.[34] Ky qëndrim u zhvillua në Gjermani në vitet '80 dhe, si një metodë me orientim praktik, përfshin vlerësimin e përkthimeve në lidhje me funksionalitetin e tyre në një situatë të dhënë në një kulturë të caktuar,[35] një element normativ që teori të tjera të përkthimit shpesh e kanë shmangur. Edhe pse termi "funksionalizëm" përfshin në vetvete teori dhe qëndrime të ndryshme, ne, brenda qëllimeve të punimit tonë, do të përqëndrohemi në skoposteorinë prezantuar nga Hans Vermier (Hans Vermeer), të zhvilluar më tej në bashkëpunim me Katharina Rajs (Katharina Reiss).[36]

Fjala greke "skopos" (qëllim) i referohet nocionit se detyra kryesore e përkthyesit është që të identifikojë qëllimin e synuar të përkthimit.[37] Me fjalë të tjera, në vend që të kërkohet arritja e ekuivalencës të çfarëdolloji, qëllimi kryesor është përcaktimi i mënyrës së funksionimit të përkthimit në një kontekst të ri tekstual dhe gjuhësor. Kjo nënkupton marrjen në konsideratë të publikut marrës në gjuhën e përkthimit, dhe, veçanërisht, njohuritë e tij rreth botës, njohuritë specifike kulturore, pritshmëritë dhe nevojat komunikative.[38] Gjithashtu skoposteoria njihet ndryshe edhe si një qëndrim me orientim kulturor mbi përkthimin. Kështu, meqenëse përkthimi nuk është thjesht një transferim gjuhësor, por, mbi të gjitha, një transferim kulturor, përkthyesi duhet të jetë një njohës i mirë i të dyja kulturave: i asaj të shprehur nëpërmjet gjuhës origjinale dhe i asaj të përkthimit, si dhe normave, zakoneve dhe vlerave të përfaqësuara në secilën prej tyre. [39]

---

[31] C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explained*. Manchester: St. Jerome, fq. 85.

[32] Në lidhje me leksime dhe interpretime të ndryshme gjatë procesit të përkthimit, mund të lexoni më në hollësi R. Oittinen (1995) *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press, fq. 53.

[33] B. Hatim dhe I. Mason (1990) *Discourse and the Translator*. London: Longman, fq. 11.

[34] C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explained.* Manchester: St. Jerome, fq.1.

[35] Po aty, fq. 2.

[36] Reiss & Vermeer, 1984.

[37] M. Ruokonen (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: Tommola, J. (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto, fq. 69.

[38] C. Nord (2006) , *Functional and Skopos Oriented Approaches to Translation*. Në Keith Brown (ed.), *Encyclopedia of Language & Linguistics*. Elsevier: Oxford, fq.663.

[39] K. Reiss dhe H. J. Vermeer (1984) *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Tübingen: Niemeyer, fq. 4, 13, 26.

Duke e mbështetur pikpamjen e tij në teorinë e veprimit njerëzor, Vermieri e konsideron përkthimin si një sjellje me qëllime të caktuara që ndodh në një situatë të veçantë. Përkthimi, si një veprim i qëllimshëm, është në varësi të kontekstit dhe nuk mund të konceptohet thjesht si një transferim nga një gjuhë në një tjetër,[40] ndryshe nga pikpamja disi e ngurtë e Xhon Katfordit (John C. Catford) si "zëvendësimi i materialit tekstual në një gjuhë nëpërmjet materialit ekuivalent tekstual në një gjuhë tjetër.[41] Në të kundërt, sipas skoposteorisë, të përkthyerit nënkupton prodhimin e një teksti në një kontekst marrës për një qëllim marrës dhe një publik marrës në rrethana të gjuhës së përkthimit".[42] Gjithashtu, teksti origjinal nuk është qëllimi kryesor nga i cili nisemi për të përkufizuar procesin dhe metodat e përkthimit, por një ofertë të dhënash, që, pjesërisht ose tërësisht, kthehet në një ofertë të dhënash për publikun e tekstit të përkthyer.[43] Këtë ofertë të dhënash, çdo lexues (dhe çdo përkthyes në rolin e lexuesit) do ta interpretojë në mënyrën e vet. Gjatë procesit të përkthimit, ato aspekte të tekstit origjinal që përkthyesi i konsideron me interes ose me rëndësi për qëllimin e tekstit të përkthyer, do të transferohen në kulturën e përkthimit duke përdorur atë mënyrë prezantimi që përkthyesi mendon se është e përshtatshme për qëllimin e dhënë.[44] Kështu, teksti i përkthyer bëhet një ofertë e re të dhënash në kulturën e përkthimit në lidhje me të dhënat e ofruara në gjuhën dhe kulturën origjinale.[45] Megjithatë, edhe ne jemi të të njëjtit mendim me Nordin, e cila shprehet '*përkthyesi nuk mund të ofrojë të njëjtën sasi dhe të njëjtin lloj të dhënash ashtu si edhe prodhuesi i tekstit origjinal. Përkthyesi, në fakt, ofron një tjetër lloj të dhënash në një formë tjetër*.[46] Kjo ndodh për arsye se pritshmëritë dhe njohuritë e publikut të tekstit të përkthyer nuk janë të njëjta me ato të publikut marrës të tekstit origjinal.

Për funksionalistin, ekuivalenca në nivelin tekstual apo gjuhësor nuk është as e dëshirueshme dhe as e arritshme, kjo sepse konteksti i gjuhës origjinale ndryshon nga ai i gjuhës së përkthimit dhe qëndrimi besnik ndaj origjinalit nuk është kaq i rëndësishëm sa të qëndruarit besnik ndaj publikut marrës së tekstit të përkthyer. Për këtë arsye mund të themi se skoposteoria është më shumë e orientuar ndaj tekstit të përkthyer sepse qëllimet parësore konsiderohen pikërisht cilësitë e këtij teksti dhe jo të tekstit origjinal: ky i fundit është thjesht një nga burimet e ndryshme që përdor përkthyesi për të nxjerrë të dhëna të nevojshme për procesin e përkthimit.[47] Duke pasur si qëllim parësor prodhimin e një teksti funksionalisht të përshtatshëm në gjuhën e përkthimit, funksionalistët udhëhiqen nga parimi se qëllimi justifikon mjetin.[48] Qëllimi kryesor nuk është prodhimi i një teksti ekuivalent nga ana gjuhësore apo stilistike por prodhimi i një teksti që përmbush qëllimin apo funksionin për marrësit e këtij teksti, publikun e synuar, dhe është ky i fundit që

---

[40] C. Nord (2006) , *Functional and Skopos Oriented Approaches to Translation*. Në Keith Brown (ed.), *Encyclopedia of Language & Linguistics*. Elsevier: Oxford, fq. 662.

[41] J. C. Catford (1965) *A Linguistic Theory of Translation: An Essay in Applied Linguistics.* Oxford: Oxford University Press, fq. 20.

[42] H. Vermeer, cituar në Nord (2006) *Functional and Skopos Oriented Approaches to Translation*. Në Keith Brown (ed.), *Encyclopedia of Language & Linguistics*. Elsevier: Oxford, fq. 663.

[43] C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explained*. Manchester: St. Jerome, fq. 12.

[44] Po aty, fq. 25-26.

[45] K. Reiss dhe H. J. Vermeer (1984) *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Tübingen: Niemeyer, fq. 76; cituar në C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explain*ed. Manchester: St. Jerome, fq. 25-26.

[46] C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explain*ed. Manchester: St. Jerome, fq. 35.

[47] Po aty, fq. 25.

[48] K. Reiss dhe H. J. Vermeer (1984) *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Tübingen: Niemeyer, fq. 101.

përcakton skoposin, pra, qëllimin e përkthimit. Është kjo arsyeja që Rajsi dhe Vermieri theksojnë se të gjitha vendimet në lidhje me përkthimin janë specifike në varësi të kulturës, gjuhës dhe situatës, është publiku marrës i tekstit të përkthyer së bashku me aspektet e tij kulturore që e ndihmojnë përkthyesin të përcaktojë metodat e përshtatshme për secilin rast në veçanti.

Funksionalizmi është përballur me kritika të ndryshme për vetë faktin se një qëndrim i tillë që i kushton shumë rëndësi publikut marrës të tekstit të përkthyer dhe largohet disi nga studimi i hollësishëm i tekstit origjinal, madje, deri diku, e lejon përkthyesin që të përshtatë tekstin sipas nevojave dhe nivelit të njohurive të publikut, gjë që mund të çojë deri në manipulim (të qëllimshëm) të tekstit origjinal dhe, njëkohësisht, justifikim të gjithë ndryshimeve të gjykuara si të "domosdoshme" për të arritur qëllimin e synuar. Megjithatë, gjithçka është në varësi të pikpamjes që ndjekim në lidhje me vetë përkufizimin e përkthimit. Studiuesja Otinen shprehet se nëse ne e konsiderojmë përkthimin si kërkim për ekuivalencë, atëherë përshtatja është diçka e ndryshme nga origjinali, por, nëse, nga ana tjetër, përkthimi konsiderohet si veprim njerëzor në kontekste të ndryshme, ashtu siç shprehen Vermier dhe Rajs, përcaktimi i kufijve mes përkthimit dhe përshtatjes do të ishte diçka e vështirë, dhe, në fund të fundit, e pamundur.[49]

Megjithëse pikpamjet funksionaliste nuk janë aq të përhapura sa qëndrimet e orientuara drejt ekuivalencës, ne po iu referohemi atyre në këtë punim studimor meqenëse edhe një sërë studiuesish në këtë fushë e konsiderojnë përkthimin e letërsisë për fëmijë brenda këtij kuadri teorik. Për shembull, studiuesja Otinen shprehet se përqëndrimi në publikun marrës së tekstit të përkthyer duhet të marrë më shumë përparësi se sa përpjekjet për të krijuar njëjtësi mes tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer.[50] Ja se si shprehet ajo:

> *Përkthimi është një proces dialogjik, bashkëpunues që ndodh në kontekste individuale. Kjo do të thotë se asnjë përkthim nuk prodhon njëjtësi; përkthimi krijon tekste për qëllime të ndryshme, situata të ndryshme dhe publik të ndryshëm.*[51]

Gjithashtu, duke iu përmbajtur idesë së Andre Lefever (André Lefevere), studiuesja Otinen shprehet se përkthimi është një rishkrim për lexues të rinj në kulturën e përkthimit.[52] Megjithatë, edhe pse jemi të të njëjtit mendim se gjithmonë duhet marrë parasysh publiku dhe kërkesat e pritshmëritë e tij në një kulturë të re, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një publik të përbërë nga fëmijë dhe të rinj, besojmë se përkthyesi nuk duhet të anashkalojë qëllimet dhe stilin e shkrimtarit origjinal.

Në mënyrë të përmbledhur, theksojmë se skoposteoria i kushton vëmendje orientimit të përkthimit në varësi të qëllimit të tij, që përcaktohet nga publiku marrës i veprës që do të përkthehet, nevojat e të cilit shërbejnë si fillesë për të përcaktuar edhe strategjitë e përkthimit. Megjithatë, orientimi i përkthimit ndaj publikut marrës mund të shprehet edhe në mënyra të tjera, për shembull, në pozicionimin e përkthimit ndaj prirjeve të huajëzimit dhe amëtarizimit.

---

[49] R. Oittinen (1995) *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press, fq. 30.

[50] R. Oittinen (2004) *Translating for children – theory.* Në P. Hunt (ed.), *International Companion Encyclopedia of Children's Literature*. London: Routledge, fq. 902.

[51] Po aty, fq. 901.

[52] R. Oittinen (2006) *No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children*. Në J. Van Coillie, and W.P. Verschueren (eds.), *Children's Literature in Translation. Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 39.

I.1.3 Huajëzimi dhe amëtarizimi

Parë me këndvështrimin e një studimi krahasimor, përkthimet mund të shqyrtohen në dritën e dy prirjeve të tjera që janë ndjekur prej përkthyesit: huajëzimi dhe amëtarizimi. Përcaktimi i orientimit të përkthimit ndaj një prej këtyre dy prirjeve ka të bëjë me faktin nëse përkthimi priret ndaj gjuhës së përkthimit dhe kulturës e normave të saj si dhe publikut të ri marrës, apo, në kahun tjetër, ndaj ruajtjes së karakteristikave të gjuhës dhe kulturës origjinale, edhe në rast se këto mund të jenë të panjohura për lexuesit e huaj dhe mund të çojnë në keqkuptime, apo mospranime të tekstit të përkthyer.

Nëse përkthyesit ndjekin rrugën e amëtarizimit, ata e asimilojnë tekstin në varësi të vlerave të kulturës së gjuhës së përkthimit, si nga ana gjuhësore, ashtu edhe nga ana kulturore.[53] Ky lloj përkthimi mund të quhet përkthim i "padukshëm", meqenëse veçanësitë e tekstit origjinal zëvendësohen me cilësi që janë të njohura për lexuesin e huaj. Nga ana tjetër, rruga e huajëzimit prodhon një përkthim të "dukshëm", që ruan elementët e huaj, duke qëndruar sa më pranë tekstti origjinal. Nëse përkthyesit ndjekin këtë qëndrim, ata ruajnë karakteristika të konsiderueshme të origjinalit, duke e sjellë *tekstin e huaj sa më afër lexuesit*.[54] Në të kundërt, duke ndjekur rrugën e amëtarizimit, përkthyesi afron *lexuesin me tekstin e huaj*, duke e përshtatur atë që të përputhet sa më shumë me vlerat kulturore të gjuhës së përkthimit.

Çështja e huajëzimit dhe amëtarizimit ka qenë në qendër të vëmendjes për studiues të ndryshëm për vite me radhë. Filozofi dhe romantiku gjerman, Fridrih Shlajermaher (Friedrich Scleiermacher), ishte i pari që në shekullin e tetëmbëdhjetë përkufizoi se ç'nënkuptojnë në të vërtetë huajëzimi dhe amëtarizimi. Gjithashtu ai mendonte se përkthyesi duhet të përqëndrohet jo vetëm në përmbajtjen tekstuale, por edhe në transmetimin e shpritit të gjuhës së huaj dhe të shkrimtarit.[55] Deri në atë kohë, përkthimi përqëndrohej në transferimin e kuptimit, duke qenë kështu një praktikë më shumë amëtarizuese, e cila në qëndrimin më ekstremist kërkonte që teksti i përkthyer të ishte ashtu sikur shkrimtari origjinal ta kishte shkruar në gjuhën e përkthimit, ndërkohë që pikpamja e Shlajermaherit mund të kalonte në ekstremin e kundërt, duke ruajtur kulturën origjinale dhe shprehjet karakteristike të huaja deri në atë masë sa të shkaktojnë edhe pamundësi për t'u lexuar apo për t'u kuptuar.

Një pikpamje më bashkëkohore vjen nga Antuan Berman (Antoine Berman) sipas së cilit ruajtja e elementëve të huaj në përkthim është diçka thelbësore për krijimin e një dialogu mes kulturës origjinale dhe asaj në gjuhën e përkthimit. Ashtu si edhe Shlajermaher, ai thekson nevojën për të pasur elementë të huaj që janë aq të panjohur në atë masë sa ta "shqetësojnë" lexuesin, nëse teksti i përkthyer i ruan elementë të tillë të tekstit origjinal të cilët njihen në kulturën e përkthimit, atëherë efekti i përkthimit ka humbur.[56] Një studiues tjetër që shprehet në mbështetje të një përkthimi huajëzues është Lorens Venuti (Lawrence Venuti), i cili i kritikon praktikat amëtarizuese, kryesisht për

---

[53] R. Oittinen (2004) *Translating for children – theory.* Në P. Hunt (ed.), *International Companion Encyclopedia of Children's Literature*. London: Routledge, fq . 905.

[54] R. Oittinen (2006) *No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children*. Në J. Van Coillie, and W.P. Verschueren (eds.), *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 42.

[55] F. Schleirmacher (1838) *Hermeneutik und Kritik.* fq. 62, cituar në M. Ruokonen (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: J. Tommola (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto, fq. 66.

[56] M. Ruokonen (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: Tommola, J. (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto, fq. 70-71.

shkak të etnocentrizmit të tyre. Sipas Venutit, origjina e dallimeve gjuhësore dhe kulturore të tekstit të huaj duhet të jetë e pranishme dhe të njihet në tekstin e përkthyer.[57] Meqenëse përkthimi është një proces që ndodh nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, Venuti i përmbahet mendimit se huajëzimi është një qëndrim më etik dhe më i drejtë sepse, në këtë mënyrë, lexuesit mund të shohin dhe të njohin ata faktorë që kanë ndikuar në përkthim, ndryshe nga qëndrimi i kundërt që i bën lexuesit të besojnë se përkthimi dhe origjinali janë pothuajse i njëjti tekst, por të shprehur në gjuhë të ndryshme. Megjithatë, huajëzimi dhe amëtarizimi nuk janë strategji absolute, por relative sipas vlerave të kulturës së përkthimit si dhe në varësi të kontekstit, pra, e njëjta strategji përkthimi, në varësi të situatave të ndryshme, mund të bëhet shkas si për qëndrim huajëzues ashtu edhe qëndrim amëtarizues.[58]

Parapëlqimi i një qëndrimi kundrejt qëndrimit tjetër nga ana e përkthyesit nuk është gjithmonë në varësi të dëshirës së tij, por varet nga një kombinim faktorësh. Ka një sërë arsyesh për t'u prirur drejt amëtarizimit: Otinen përmend disa prej tyre, si, për shembull, çështjet politike ose morale.[59] Gjithashtu, një rol i rëndësishëm luhet edhe nga vlerat kulturore si edhe ideologjia e gjuhës së përkthimit. Për më tepër, ka edhe një sërë ndryshimesh mes gjuhëve dhe kulturave në lidhje me normat e pranuara gjerësisht. Në lidhje me letërsinë për fëmijë, prirjet janë të ndryshme: përkthyesi mund të ruajë elementët e huaj ose mund t'i asimilojë ato sipas gjuhës dhe kulturës së përkthimit. Ndër elementët e huaj që mund t'i nënshtrohen njërës prirje ose tjetrës përmendim emrat e personazheve, njësitë matëse të hapësirave, peshave, njësitë monetare, referencat kulturore, etj. Prirja e përkthyesit ndaj huajëzimit i vendos lexuesit para një përgjegjësie më të madhe gjatë procesit të leximit, ata përballen me më shumë sfida gjatë interpretimit sepse teksti i përkthyer përmban një sërë elementësh të huaj, ashtu siç ata shfaqen në tekstin origjinal, pjesë e kulturës përfaqësuar nga gjuha origjinale. Kështu, lexuesi bëhet edhe më aktiv gjatë leximit, në kërkim të gjetjes së kuptimit të këtyre elementëve të huaj, të ndryshëm, të panjohur. Kjo mënyrë leximi dhe interpretimi çon në zbulime, mënyra të reja të të menduarit dhe të kuptuarit, por, megjithatë, ekziston rreziku që, nëse këta elementë të huaj e tejkalojnë aftësinë e lexuesit, teksti mund të bëhet i pakuptueshëm.[60] Kjo ndodh veçanërisht nëse lexuesit në gjuhën e përkthimit janë fëmijë dhe kjo është njëkohësisht edhe arsyeja se pse shumica e librave të përkthyer për fëmijë janë amëtarizuar në gjuhën e përkthimit, pra, elementët e huaj janë asimiluar sipas kulturës së gjuhës së përkthimit.

Përzgjedhja e njërit qëndrim apo tjetrit do të ndikojë patjetër në përvojën e leximit, interpretimit dhe mënyrës së pranimit të tekstit. Duhet pasur gjithmonë parasysh se duke eleminuar elementët e huaj në një tekst të amëtarizuar nuk iu krijohet mundësi lexuesve të përcaktojnë vetë mënyrën e reagimit ndaj këtyre elementëve: nëse është vetë përkthyesi që e bën këtë zgjedhje në vend të lexuesve, ata i përfshijnë lexuesit në një proces leximi më pasiv gjatë së cilit ata thjesht mund të njohin apo të pranojnë atë çka iu

---

[57] L.Venuti (1995) *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge, fq. 311, cituar në R. Oittinen (2006) *No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children*. Në J. Van Coillie, and W.P. Verschueren (eds.), *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 43.

[58] M. Ruokonen (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: J. Tommola (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto, fq. 72, 74.

[59] R. Oittinen (2004) *Translating for children – theory.* Në P. Hunt (ed.), *International Companion Encyclopedia of Children's Literature*. London: Routledge, fq. 905.

[60] M. Ruokonen (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: J. Tommola (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto, fq. 78.

ofrohet rreth kulturës tjetër. Prirjet e shfaqura nga përkthyesit ndaj amëtarizimit, kritikohen gjithashtu sepse mendohet të krijojnë te lexuesit një imazh jo të qartë të kulturës origjinale dhe nuk iu krijojnë atyre mundësi për të kuptuar larmishmërinë e botës. Megjithatë, sipas studiueses Nord, veçanërisht në rastet kur librat për fëmijë janë me përmbajtje pedagogjike, amëtarizimi i elementëve të huaj mund të ketë më shumë përparësi sesa identifikimi i tyre në një atmosferë të huaj, sepse një atmosferë e huaj mund të bëjë që lexuesi t'i distancohet tekstit. Nga ana tjetër, një tekst me elementë të huaj mbetet i panjohur për lexuesit. Në kreun e tretë ne do të studiojmë pikërisht këto prirje të huajëzimit dhe amëtarizimit në korpusin tonë për të parë më konkretisht se çfarë ndodh me elementët e huaj kulturorë dhe se çfarë ndikimi mund të ketë qëndrimi i përkthyesit në procesin e interpretimit dhe të kuptuarit të tekstit nga ana e lexuesve.

Kemi përmendur deri tani studime të ndryshme mbi vetë procesin e përkthimit, duke e konsideruar përkthimin herë si një shkëmbim materiali gjuhësor dhe kulturor, herë si një veprimtari të qëllimshme nisur nga publiku marrës në gjuhën e përkthimit, dhe herë duke argumentuar prirjet e përkthyesit ndaj elementëve të huaj të pranishëm në tekstin origjinal. Do të ndalemi tani në mënyrë të hollësishme në gjininë e letërsisë për fëmijë, duke hedhur dritë mbi nocionin e diskutueshëm "letërsi për fëmijë" dhe duke diskutuar më në thellësi rreth përkthimit për fëmijë në dallim nga përkthimi për të rritur. Do ta mbyllim këtë kapitull duke renditur një sërë faktorësh kulturorë dhe ideologjikë që ushtrojnë ndikimin e tyre në përkthimin e letërsisë për fëmijë.

I.2 Nocioni i diskutueshëm "letërsi për fëmijë"

Që në fillim duhet të parashtrojmë se nuk ka një përkufizim të vetëm dhe përfundimtar të letërsisë për fëmijë. Kjo vjen si pasojë e faktit se karakteristikat e një letërsie të tillë janë të shumëfishta, kështu që edhe përkufizimet e dhëna për të janë po të tilla, duke përfshirë edhe vështirësinë e përkufizimit të "fëmijëve" apo "fëmijërisë" në një mënyrë të vetme dhe të shterueshme. Rrjedhimisht, një pyetje më me vend do të ishte: Cilat janë disa cilësi të letërsisë për fëmijë?

Një nga vështirësitë kryesore në përkufizimin e "letërsisë për fëmijë" është shkalla e përfshirjes dhe natyra e paqartë e fushave semantike që mbulohen nga koncepte të cilave iu referohet përdorimi i fjalëve "letërsi" dhe "fëmijë". Siç shprehet *Astrit Bishqemi* në konceptin "*letërsi për fëmijë*" kombinohen kërkesat pedagogjike me ato edukative, duke përfshirë edhe veprat e përshtatura ose të shkruara për të rritur, por që janë të kuptueshme ose mund të shërbejnë për të vegjlit.[61] Studiuesit Nouls dhe Malmkjaer (*Knowles dhe Malmkjaer)* japin një përkufizim shumë të gjerë dhe pragmatik që duket se shmang çështjet shumë të vështira: Sipas tyre *letërsia për fëmijë është çfarëdo rrëfimi që shkruhet ose botohet për fëmijë dhe këtu përfshihen edhe romanet për adoleshentë që iu drejtohen lexuesve të ashtëquajtur "të rritur të rinj" ose "adoleshentëve të vonë*".[62] Vështirësia që përfaqësohet nga përdorimi i këtyre termave prezantohet edhe nga Otinen*:*

> *Thuajse nuk ka një bashkëmarrëveshje mbi përkufizimin e fëmijës, fëmijërisë dhe letërsisë për fëmijë. Përkufizimi ... është gjithmonë një çështje pikpamjesh dhe situatash: fëmijëria mund të konsiderohet një çështje shoqërore ose kulturore; mund të shikohet nga këndvështrimi i fëmijës ose i të rriturit ... Unë e shikoj*

[61] A. Bishqemi (2006) *Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë.* Sejko, Tiranë, fq. 9.
[62] K. Malmkjaer (1996) *Language and Control in Children's Literature* , London: Routledge, fq. 2.

> *letërsinë për fëmijë si një letërsi që lexohet pa zë nga fëmijët dhe që iu lexohet me zë të lartë fëmijëve.*[63]

Meqenëse shprehja "letërsi për fëmijë" nuk karakterizohet në mënyrë specifike, shumë nga shkrimet kritike në lidhje me librat për fëmijë kufizohen në një mënyrë reference të ngjashme me atë që përmendëm më lart. Klingberg jep këtë përkufizim më praktik:

> *Letërsia për fëmijë dhe të rinj (që tashmë e tutje i referohemi thjesht si letërsi për fëmijë) përkufizohet si e tillë duke përfshirë jo ato libra që ata lexojnë (fëmijët dhe të rinjtë lexojnë dhe gjithmonë kanë lexuar një masë të gjerë letërsie), por atë letërsi që është botuar për – ose kryesisht për – fëmijët dhe të rinjtë.*[64]

Duke pasur parasysh përkufizimet e parashtruara, mund të identifikojmë më tej karakteristikat më kryesore të letërsisë për fëmijë si një gjini më vete.

- *Së pari*, libra të kësaj natyre (ndërkohë që kategorizohen nga publiku parësor i synuar, d.m.th. lexuesit e rinj) në fakt iu drejtohen dy lloje publiku: fëmijëve, që dëshirojnë të zbaviten dhe mundësisht të informohen, dhe të rriturve, që kanë shije dhe pritshmëri letrare të ndryshme. Grupi i dytë, që përfshin fillimisht redaktorët dhe botuesit, dhe, rrjedhimisht, edhe prindërit, edukatorët, studiuesit dhe kritikët, sigurisht, ka më shumë ndikim se sa grupi i parë.[65] Janë të rriturit ata që kanë pushtetin e fuqisë dhe ndikimit duke qënë se ata vendosin çfarë shkruhet, dhe, çka është me rëndësi për këtë diskutim, çfarë botohet, vlerësohet dhe blihet.
- *Së dyti*, ndërkohë që është e vërtetë se disa vepra të letërisë për fëmijë pëlqehen vetëm nga publiku i grupit të parë, shumë prej tyre i përkasin teksteve me natyrë ambivalente siç është edhe rasti i *Alice's Adventures in Wonderland,* vepër e cila mund të lexohet nga një fëmijë në nivelin tradicional letrar ose të interpretohet gjithashtu nga një i rritur në një nivel më të sofistikuar ose në një nivel satirik.
- *Së treti*, letërsia për fëmijë shkruhet nga njerëz që nuk i përkasin grupit të cilit i drejtohen. Librat për fëmijë shkruhen për një grup të veçantë lexuesish, por zakonisht nuk shkruhen nga pjestarë të këtij grupi; edhe shkrimi edhe blerja e tyre kryhet nga të rritur që nuk janë pjestarë duke iu drejtuar fëmijëve që bëjnë pjesë në ky grup.[66] Një pasojë e papëlqyeshme mund të jetë që shkrimtarët e letërsisë për fëmijë mund të mos jenë shumë të bindshëm, të mos njohin mjaftueshëm publikun origjinal dhe të shkruajnë për të përmbushur kënaqësinë e publikut marrës të përbërë, përveç lexuesve të rinj, edhe nga kritikë, prindër dhe mësues.
- *Së fundi*, siç shprehet *Puurtinen* kjo gjini nuk është e zakonshme për shkak të funksioneve të shumta që ajo përmbush si dhe kufizimeve të ndryshme kulturore brenda të cilave ajo vepron.[67] Letërsia për fëmijë i përket njëkohësisht sistemit letrar dhe sistemit shoqëror-edukativ, d.m.th. nuk lexohet vetëm për kënaqësi, çlodhje dhe përvojë letrare, por, përdoret edhe si një mjet edukimi dhe shoqërizimi. Ky karakter i dyfishtë ndikon jo vetëm në mënyrën e të shkruarit por

---

[63] R. Oittinen (1993) *On the Dialogics of Translating for Children*, në C. Picken (ed.) *Translation: The Vital Link. XIII FIT World Congress.* London, Institute of Linguistics, fq. 11.

[64] G. Klingberg, cituar në K. Reis (1982) *Zur Übersetzung von Kinder-und Jugendbüchern.* Lebende Sprachen, fq. 7 (përkthimi është bërë prej meje nga varianti në anglisht).

[65] T. Puurtinen (1995) *Linguistic Acceptability in Translated Children's Literature* . Joensuu: University of Joensuu, fq. 19.

[66] J. Briggs (1989) *Reading Children's Books. Essays in Criticism XXVIX (1),* fq. 4.

[67] T. Puurtinen (1995) *Linguistic Acceptability in Translated Children's Literature* . Joensuu: University of Joensuu, fq. 17.

edhe në mënyrën e të përkthyerit të letërsisë për fëmijë, marrëdhëniet e së cilës me normat letrare, shoqërore dhe edukative bëjnë që kjo gjini të kthehet në një fushë kërkimi interesante dhe të frytshme.

Megjithatë, nuk mund të lemë jashtë vëmendjes sonë edhe faktin se letërsia për fëmijë shpeshherë është konsideruar si inferiore, kryesisht për faktin se në sistemin letar tradicional kjo gjini ze një pozicion periferik, dhe, gjithashtu, sepse librat për fëmijë shmangen nga normat tradicionale letrare dhe paraqesin probleme në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin tradicional.[68] Edhe kritikët, nga ana tjetër, shpesh iu shmangen shkrimeve për fëmijë duke menduar se pak nga shkrimet për fëmijë shkojnë përtej formulave ose stereotipeve.[69] Me fjalë të tjera, ngjashmëritë e herëpashershme në lidhje me strukturën, personazhet dhe gjuhën që gjenden në shumë vepra të letërsisë për fëmijë duket sikur kontribuojnë në vlerësimin e këtij zhanri si "inferior", dukuri kjo që do të ndikojë edhe në qëndrimin e përkthyesit ndaj librit që do të përkthejë. Duke reflektuar me kujdes, kuptojmë se fakti që këto vepra paraqesin probleme për ata që do të zbatonin mjetet e kritikës letrare tradicionale për këtë gjini nuk nënkupton se është vetë gjinia që është problematike, por do të thotë se mjetet e interpretimit nuk janë të duhurat. Sipas Peri Nodelmanit (Perry Nodelman), deri sa ne të zhvillojmë një qëndrim të ri, nuk do të arrijmë të kuptojmë se si një vepër për fëmijë mund të jetë unike edhe pse personazhet, historia, gjuha "e thjeshtë" si dhe vetë thelbi qendror i modeleve dhe ideve të saj nuk janë të tilla.[70]

Sipas Pitër Hant (Peter Hunt) përkufizimi që jepet për letërsinë për fëmijë si *libra që lexohen dhe janë të përshtatshëm për fëmijë*, nuk është një përkufizim praktik sepse do të përfshinte çfarëdo lloj teksti që lexohet nga fëmijët.[71] Megjithatë, në përgjithësi librat për fëmijë janë vetëm ata libra bashkëkohorë të konsideruar si të tillë (libra për fëmijë). Edhe Gëte Klingberg (Göte Klingberg) bashkohet me mendimin se nuk ka një marrëveshje të përbashkët në lidhje me konceptin e letërsisë për fëmijë. Ai nxjerr në pah nevojën për standardizimin e terminologjisë sepse koncepte të njëjta shprehen nëpërmjet termave të ndryshme në gjuhë të ndryshme, shumë terma përkufizohen në mënyra të ndryshme, dhe sepse studiuesit e fushave të ndryshme, në lidhje me letërsinë për fëmijë, përdorin terma të ndryshme për të përfaqësuar të njëjtin koncept.[72] Rita Otinen shkon deri aty sa të hedhë për diskutim vetë faktin nëse është e nevojshme të përkufizohet letërsia për fëmijë. Ajo vëren se *veprat letrare dhe gjithë zhanret letrare marrin kuptime të ndryshme dhe ripërkufizohen gjithmonë nga e para. Pra, mund të ndodhë që ajo që sot është letërsi për të rritur nesër të kthehet në letërsi për fëmijë.*[73] Kjo në fakt është më se e mundur. Libra të tillë si *Gulliver's Travels* janë shkruar fillimisht për një publik të rritur dhe u kthyen më vonë në libra për fëmijë, dhe, njëkohësisht, mund të ndodhë e kundërta, libra të shkruar për fëmijë kthehen në libra interesantë kur "zbulohen" nga të rriturit si në rastin e të famshmit *Harry Potter* etj.

---

[68] Ia vlen të përmendim këtu një metaforë të përpunuar nga *P. Hunt* (1992) në veprën *Literature for Children: Contemporary Criticism.* London, Routlege, sipas së cilës sistemi letrar tradicional pasqyron vlerat e nëntëshme edhe në sistemin tradicional brenda hierarkisë familjare, që priret të nënvlerësojë shkrimet nga gratë, ndërsa shkrimet për fëmijë kanë një status edhe më të ulët dhe vështrohen kryesisht si terreni i grave: nënave ose mësueseve.

[69] P. Nodelman (1985) *Interpretation and apparent sameness of children's novels. Studies in the Literary Imagination 18.* fq. 20

[70] Po aty fq. 5.

[71] P. Hunt (1991) *Criticism, Theory and Children's Literature.* Oxford: Blackwell, fq. 61.

[72] G. Klingberg (1978) *Children's Books in Translation.* Stockholm: Almqvist and Wiksell, fq. 35-36.

[73] R. Oittinen (1993) *On the Dialogics of Translating for Children*, në C. Picken (ed.) *Translation: The Vital Link. XIII FIT World Congress.* London, Institute of Linguistics, fq. 42-43.

Sipas Torben Vajnrajhut (Torben Weinreich) letërsia për fëmijë është *një lloj letërsie që ka karakteristika të qarta komunikative…sepse lexuesit, me fjalë të tjera fëmijët, në një shkallë shumë më të lartë se në cfarëdolloj letërsie tjetër, përfshihen së bashku me autorin në vetë procesin e krijimit*.[74] Fëmija në rolin e lexuesit është një kërkesë e letërsisë për fëmijë. Pra, një nga cilësitë e letërsisë për fëmijë është *lexuesi-fëmijë*, i përfshirë në një *proces komunikimi* me shkrimtarin (një proces komunikimi që i ka fillesat që prej procesit të krijimit të tekstit). Një cilësi e tillë merr kuptim të veçantë për përkthyesin e letërsisë për fëmijë dhe përgjegjësitë dhe vështirësitë në punën e tij. Megjithatë, Vajnrajhu shprehet me keqardhje se janë pikërisht cilësitë komunikative që bëjnë që letërsia për fëmijë (ose një pjesë e konsiderueshme e saj) të mos konsiderohet si artistike dhe termi më i përshtatshëm për të përshkruar cilësitë komunikative do të ishte "pedagogjike". Rrjedhimisht, nëse aspektet pedagogjike ose edukative të letërsisë për fëmijë konsiderohen si pjesë e dëshirës komunikative të shkrimtarit për të informuar lexuesit ose për të ushtruar ndikim tek ta, nuk duhet të flasim domosdoshmërisht për letërsinë për fëmijë të cilësuar si pedagogji ose (në mënyrë përjashtimore) art. Ajo mund t'i ketë (njëkohësisht) *të dyja këto cilësi.*[75]

Gjithashtu, duke ndjekur studimet e filozofit rus Mikail Bakhtin (Mikhail Baktin) si dhe të teoricienit Homi Baba (Homi Bhabha), studiuesi Dejvid Rud (David Rudd) (1992, 1999b, 2000, 2004a, 2004b), duke përdorur konceptin e hibriditetit, thekson se letërsia për fëmijë përmban edhe qëllime edukimi edhe nënshtrimi, dhe nocionet e fëmijërisë dhe të të rriturve nuk konsiderohen si dukuri statike, por janë në një proces të vazhdueshëm negociimi. Më tej, Rudi shprehet se teksti nuk mund të shihet si i izoluar, por, ai, në të njëjtën kohë, përfshin edhe *kontekstin edhe lexuesin.*[76]

Letërsia për fëmijë, pra, nuk mund të përkufizohet asnjëherë në mënyrë thelbësore, por vetëm në mënyrë pragmatike, si një zonë ku sfida është e vazhdueshme, për arsyen e thjeshtë se letërsia për fëmijë ka të bëjë pikërisht me këtë: ndërtimin e një hapësire dhe luftën e vazhdueshme mbi këtë hapësirë, brenda së cilës do të luajnë gjithmonë edhe të rriturit edhe fëmijët.[77]

Një nga karakterstikat e letërsisë për fëmijë, siç është lartpërmendur, është se ajo iu drejtohet njëkohësisht lexuesve të grupmoshave të ndryshme. "Klasikët" e letërsisë për fëmijë nuk mund të klasifikohen në mënyrë të ndarë si letërsi për të rritur dhe letërsi për fëmijë.[78] Tekstet dërgojnë mesazhe edhe për fëmijët edhe për të rriturit-lexues: fëmijët arrijnë të kuptojnë atë që është e drejtpërdrejtë dhe e dukshme, ndërsa të rriturit do të zbulojnë nivelin e *fshehur* brenda të njëjtit tekst. Kjo dukuri njihet me termin *adresim i dyfishtë ose i shumëfishtë* dhe si shembuj mund të sjellim libra të tillë si *Winnie the Pooh, The Little Prince, Pinocchio, Alice's Adventures in Wonderland.* Në raste të tilla lexuesi zyrtar është fëmija, ndërsa lexuesi jozyrtar është i rrituri; krijohet në këtë mënyrë një *pseudoletërsi për fëmijë,* një letërsi që lexohet gjerësisht nga të rriturit edhe pse parësorisht iu drejtohet fëmijëve. Gjatë përzgjedhjes së korpusit të këtij punimi si dhe gjatë vjeljes së shembujve dhe analizave sasiore dhe cilësore, ne do t'i përmbahemi

---

[74] T. Weinreich (2000) *Children's literature: Art or Pedagogy?* Roskilde University Press, fq. 123.

[75] M. Lassén-Seger (2006) *Adventures into Otherness: Child Metamorphs in Late Twentieth-Century Children's Literature.* Åbo : Åbo Akademi University Press, fq. 15.

[76] D. Rudd (2000) *Enid Blyton and the Mystery of Children's Literature*. Wiltshire: Macmillan, fq. 11.

[77] D. Rudd (1999) *Defining the Indefinable: Children's Literature's Problematic Status*. Punim i pabotuar nga konferenca e nëntë BALCL, Bolton Institute, cituar në M. Lassén-Seger (2006): *Adventures into Othernes: Child Metamorphs in late twentieth-century children's literature. Åbo : Åbo Akademi University Press,* fq.19.

[78] H. H. Ewers (1994) *Kinderliteratur im interkulturellen Prozess: Studien zur Allgemeinen und Vergleichenden Kinderliteratur-Wissenschaft* (Eds. Hans-Heino Ewers, Gertrud Lehnert, and Emer O'Sullivan) J. B. Metzler fq. 18.

pikërisht një qëndrimi të tillë, që, edhe pse përfshin brenda hapësirës së letërsisë për fëmijë gjithë cilësitë e lartpërmendura, na orienton drejt një publiku marrës të përbërë nga fëmijë dhe të rritur njëkohësisht. Qëndrimi ynë do të përligjet edhe më shumë nëpërmjet arsyetimeve gjatë këtij kreu dhe atij pasardhës, veçanërisht në kreun e dytë, ku renditen arsyet mbi përzgjedhjen e korpusit studimor.

I.3 Struktura e tekstit dhe funksionimi i tij brenda sistemit

Nuk ekziston spontaniteti i pastër, sepse
thyerja e kufijve varet nga ekzistenca e kufijve.[79]

Siç e përmendëm edhe në çështjen e mësipërme, letërsia për fëmijë nuk është konsideruar gjithmonë si një gjini letrare më vete brenda Studimeve Përkthimore, madje kjo fushë ka qenë e mënjanuar dhe e lënë në hije nga teoricienët, botuesit dhe institucionet akademike.[80] Vetëm gjatë viteve 1960 dhe 1970 vëmendja e kritikëve u drejtua nga ndikimet ndërkulturore në letërsinë për fëmijë, duke lënë mënjanë mendimet e vjetëruara se përkthimi i letërsisë për fëmijë duhet të ketë të bëjë thjesht me transmetimin sa më të afërt të origjinalit, dhe duke u orientuar drejt një qëndrimi që i kushtonte vëmendje kalimit të një teksti për fëmijë nga një gjuhë dhe kulturë në një një gjuhë dhe kulturë tjetër, gjë që do të pasqyrojë edhe pritshmëri dhe interpretime të ndryshme mbi fëmijërinë.[81] Gjatë kësaj periudhe filloi t'i kushtohej vëmendje në rritje studimit të përkthimit të kësaj letërsie, shoqëruar edhe me vlerësimin më të madh të kësaj gjinie. Në ditët e sotme pranohet gjerësisht fakti se përkthimi i letërsisë për fëmijë është një fushë e re studimi brenda Studimeve Përkthimore, megjithatë, janë dashur një sërë punimesh dhe studimesh për të arritur deri në këtë fazë të zhvillimit.

Imazhi i sistemit të fëmijëve vendos një sërë kufizimesh mbi tekstin,[82] si për shembull nevoja e njëkohësishme (dhe shpesh kontradiktore) për t'iu pëlqyer edhe të rriturve edhe fëmijëve si dhe prirja për vazhdimësi, shkalla e pranueshmërisë së modeleve të reja në sistemin ekzistues.[83] Edhe pse shumë shkrimtarë për fëmijë shkruajnë brenda kufijve të këtyre kufizimeve, një pjesë e tyre përpiqen t'i kapërxjenë këto kufij nëprmjet dy zgjidhjeve ekstreme: ose duke shkruar një tekst që nuk iu drejtohet fare të

---

[79] M. Bakhtin (1986) *Speech Genres and Other Late Essays.* University of Texas Press, fq. xix.

[79] G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters Ltd., fq. 2-3.

[80] Shikoni për më tepër të dhëna në këtë drejtim E. O'Connell (2005) *Translating for Children*. Në G. Lathey (ed.) *The Translation of Children's Literature: A Reader*, Toronto: Multilingual Matters, fq. 14-25; P. Pinsent (ed.) (2006) *No Child is an Island: The Case for Children's Literature in Translation*, Pied piper publishing.; G. Thomson-Wolgemuth (1998) *Children's Literature and its Translation: An Overview*. MA Thesis, Department of Linguistics Language and Culture, University of Surrey, (2006) *The Role of Afterwords in East German Translated Literature for Children and Adolescents*. Në P. Pinsent (ed.), *No Child is an Island: The Case for Children's Literature in Translation*, Pied piper publishing, fq. 227-238, (2009) *Translation under State Control. Books for Young People in the German Democratic Republic*, New York and London: Routledge; G. Lathey (2006) G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters Ltd., (2010) *The Role of Translators in Children's Literature: Invisible Storytellers*, New York and London: Routledge.

[82] Të shkruarit brenda kufijve nuk është tipike vetëm për letërsinë për fëmijë, çfarëdo teksti i shkruar është deri në një farë mase rezultati i kufizimeve të një modeli të caktuar. Megjithatë, në sisteme të tjera mund të lejohet edhe më shumë fleksibilitet.

[83] Gatishmëria e një sistemi inferior për të pranuar vetëm modelet e stabilizuara nuk është karakteristikë vetëm e sistemeve të tjera në polisistemin letrar, por edhe e sistemeve semiotike, veçanërisht e sistemeve shoqërore [*Even-Zohar* (1978) *Papers in Historical Poetics.* Tel Aviv: Porter Institute for Poetics and Semiotics.]

rriturve (kjo është tipike për sistemin jo-kanonik); ose duke iu drejtuar kryesisht të rriturve, duke e përdorur fëmijën si një mjet dhe jo si një marrës të vërtetë për të cilin shkruhet teksti (tipike për sistemin kanonik).[84] Këto zgjedhje, që prodhojnë tekste ambivalente, kanë struktura tipike, iu nënshtrohen normave të veçanta dhe përfshijnë në manipulim edhe lexuesit e nënkuptuar.

Pasi një tekst prodhohet (shkruhet, botohet dhe shpërndahet) në një periudhë të caktuar kohore, ai do të përfshihet brenda një pozicioni të caktuar në polisistemin letrar, të përcaktuar edhe nga kufizimet e ndryshme të polisistemit letrar dhe jetës letrare.[85] Teksti fiton kështu një status të veçantë që mund të ndryshojë me kohë sipas ndryshimeve dinamike të sistemit letrar.[86] Por në një kohë të veçantë, një tekst ka një status të mirëpërcaktuar në një opozicion binar: ose teksti është për fëmijë ose për të rritur, ose është kanonik ose jo-kanonik. Shumica e teksteve letrare ruajnë një status të mirëpërcaktuar; megjithatë, disa tekste karakterizohen nga një status që nuk mund të përshkruhet si i mirëpërcaktuar, por si i papërcaktuar përfundimisht. Dukuria e një statusi të tillë të papërcaktuar, të mirënjohur në siteme të tjera semiotike, si për shembull sistemet shoqërore, nënkupton se një shenjë e caktuar (në rastin konkret një tekst letrar) vendos më shumë se një marrëdhënie opozicioni statusi brenda të njëjtit sistem. Tekstet që kanë një status të papërcaktuar qartë nuk mund të studioheshin gjatë kohës që në teorinë letrare mbizotëronte një nocion statik për letërsinë; ky nocion statik bëri që tekstet të klasifikoheshin sipas kategorive të përcaktuara, homogjene dhe të mbyllura, meqënëse nocioni i strukturës identifikohej gabimisht me nocionin e homogjenitetit.

Në ditët e sotme pranohet koncepti dinamik për sistemet letrare, duke qenë të vetëdijshëm se sistemi letrar nuk është statik, por është "*një sistem i shumëfishtë, një sistem i përbërë nga sisteme të ndryshme që ndërthuren me njëri-tjetrin dhe edhe mbivendosen pjesërisht, por duke funksionuar njëkohësisht si një tërësi, anëtarët e së cilës janë në marrëdhënie ndërvarësie*".[87] Studiuesit kanë vështirësi të studiojnë dhe të klasifikojnë tekste që lexohen nga të rriturit dhe njëkohësisht konsiderohen klasikë në letërsinë për fëmijë – që do të thotë, tekste që formalisht i përkasin një sistemi (sistemit të fëmijëve) dhe që njëkohësisht lexohen nga publiku i një sistemi tjetër (sistemi i të rriturve), megjithatë përkatësia e tyre në sistem bazohet në kriterin e moshës së publikut marrës (fëmijë kundrejt të rriturve). Kështu, Zohar Shavit (Zohar Shavit) propozon një reduktim të qëllimit dhe nocionit të ambivalencës për ta zbatuar atë vetëm për një rast të veçantë: tekste që sinkronikisht (megjithatë në mënyrë dinamike dhe jo statike) ruajnë një status ambivalent në polisistemin letrar.[88] Tekste të tilla i përkasin njëkohësisht më shumë se një sistemi dhe rrjedhimisht lexohen në mënyra të ndryshme (edhe pse njëkohësisht), nga të paktën dy grupe lexuesish. Këta grupe lexuesish kanë pritshmëri të ndryshme në lidhje me normat dhe zakonet e të lexuarit, për rrjedhojë edhe të lexuarit e të njëjtit tekst do të jetë i ndryshëm për lexues të ndryshëm.

Me mjaft rëndësi në këtë drejtim është edhe shkrirja e studimeve kulturore me studimet përkthimore, shfaqur nëpërmjet *kthesës kulturore* në vitet '70, dukuri që solli lindjen e teorisë së polisistemit. Teoria e polisistemit u zhvillua nga Itamar Ivën Zohari, një teoricien izraelit që studioi mënyrën e funksionimit të letërsisë dhe përkthimit brenda

[84] Tekstet '*kanonike'* janë ato tekste që konsiderohen si pjesë e trashëgimisë letrare. [G.Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 40]

[85] I. Even-Zohar (1978) *Papers in Historical Poetics*. Tel Aviv: Porter Institute for Poetics and Semiotics.; Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*. Athens: University of Georgia Press.

[86] Nocioni dinamik i sistemit letrar u zhvillua nga semiotikanët në Rusi (*Tynjanov* 1971, *Jakobson*, 1960, 1971) dhe pasardhësit e tyre (*Even-Zohar* 1979, *Lotman* 1976). Gjithashtu, nocioni i *Lotman* mbi ambivalencën (1977) ka shumë rëndësi për këtë diskutim, edhe pse është një nocion shumë i gjerë.

[87] I. Even-Zohar (1979) *Polysystems Theory. Poetics Today 1*. fq. 290

[88] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*, Athens: University of Georgia Press, fq. 58.

konteksteve ose sistemeve të veçanta. Sipas tij (1978), një polisistem është një rrjet i tërë i përbërë nga rrjete të ndërlidhura – letrare ose jashtëletrare – dhe mbulon gjithë sistemet letrare madhore ose minore brenda një shoqërie. Çdo polisistem letrar përbëhet nga një numër nënsistemesh të cilët janë të organizuar në mënyrë hierarkike, modele parësore (inovative) dhe dytësore (konservative), lloje letërsish të kanonizuara dhe jo të kanonizuara. Sa më afër qendrës së periferisë të jetë një nënsistem, aq më i ulët do të jetë statusi i tij kulturor brenda sistemit në tërësi. Polisistemet letrare nuk janë sisteme të izoluara por lidhen me sisteme të tjera kulturore që mund të takohen nëpërmjet strukturave ideologjike dhe socioekonomike të një shoqërie.

Letërsia e përkthyer si një nënsistem mund të ketë çfarëdo pozicioni brenda sistemit. Mund të gjendet ose në qendër, duke përfaqësuar një pjesë domethënëse të letersisë vendase, ose në periferi, duke përfaqësuar një pjesë me më pak ndikim. Letërsia për fëmijë është një nga pjesët e sistemit letrar dhe zakonisht ka një pozicion periferik në polisistemin letrar si dhe një prestigj kulturor të ulët. Në mënyrë të ngjashme mund të shprehemi edhe për letërsinë për fëmijë të përkthyer, e cila zë një pozicion anësor brenda sistemit letrar, duke qëndruar edhe më në periferi dhe duke pasur një ndikim të ulët. Ajo do të mbështetet në norma të përcaktuara nga një lloj mbizotërues brenda një gjinie të përcaktuar, dhe do t'iu nënshtrohet normave të paravendosura dhe modeleve ekzistuese në gjuhën e përkthimit. Është kjo arsyeja, sipas Ivën-Zoharit, që brenda letërsisë për fëmijë të përkthyer shpesh ndodhin injorime dhe manipulime dhe përkthyesi i letërsisë për fëmijë nënvlerësohet. Duke e kthyer vëmendjen nga çështjet ideologjike, Ivën-Zohari thekson rëndësinë e normave të përkthyesve dhe ndikimin e tyre në rolin dhe statusin e përkthyesve. Për më tepër, edhe strategjia e përdorur gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë është në varësi të statusit që ka letërsia e përkthyer për fëmijë. Në vazhdim të diskutimit të mësipërm mund të themi se letërsia e përkthyer për fëmijë mund të ndikohet nga si dhe të ushtrojë ndikim në gjuhën dhe kulturën e përkthimit si dhe në lexuesit, gjë që bën që teksti origjinal t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh për të pasqyruar atë që konsiderohet të jetë e përshtatshme për fëmijët që do të lexojnë librin e përkthyer, në një nivel të pranueshëm vështirësie.

Vermier dhe Rajs janë dy studiues të tjerë që dhanë kontribut të rëndësishëm në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke qenë të parët që zhvilluan teorinë e llojeve të teksteve dhe e zbatuan atë në përkthimin e letërsisë për fëmijë.[89] Skoposteoria u zhvillua nga funksionalistë të tillë si Vermier, Hënig (Hönig), Kusmaul (Kussmaul), Holx Menteri (Holtz-Mänttary), Nord dhe Rajs. Ky grup teoricienësh, duke pasur "skoposin" (qëllimin) si kriterin më të rëndësishëm në çfarëdo përkthimi që varet nga nevojat dhe pritshmëritë e lexuesve të tekstit të përkthyer, e ndryshuan pikën e referencës nga teksti origjinal, të cilit shpesh i referoheshin si "origjinali i shenjtë",[90] drejt lexuesit të përkthimit, duke vendosur në një pozicion qëndror pikërisht lexuesit fëmjë. Gjithashtu skopoteoria i përcaktoi një rol të ri edhe përkthyesit si një "ekspert", që kishte më shumë liri në veprim duke mos qenë i detyruar që të riprodhojë tekstin origjinal.[91] Brenda këtij konteksti, përkthimi konsiderohet një produkt kulturor dhe vetë procesi i përkthimit si një procedurë me

[89] K. Reiss (1971) *Mőglichkeiten und Grenzen der Übersetzungskritik.* München: Max Heuber; (1982) *Zur Übersetzung von Kinder- und Jugendbüchern.* Lebende Sprachen 1, 7-13; A. Chesterman (1989) *Readings in Translation Theory.* Helsinki, Finn Lectura.

[90] H. G. Hönig (1998) *Positions, Power and Practice: Functionalist Approaches and Translation Quality Assessment* në Ch. Schäffner (ed.) (1998). *Translation and Quality*. Clevedon etc: Multilingual Matters, fq. 9.

[91] G. Thomson-Wohlgemuth (1998) *Children's literature and its translation: An overview*. Temë dizertacioni. University of Surrey, fq. 105.

ndjeshmëri kulturore,[92] gjë që bën edhe lidhjen ndërmjet teorisë së polisistemit dhe "kthesës kulturore". Mund të themi, pra, se përkthimi nuk është një çështje thjesht gjuhësore, por një veprimtari që ndodh nën ndikimin e faktorëve shoqërorë, kulturorë, ekonomikë dhe politikë, gjë që merr edhe më shumë kuptim në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Në përmbledhje të këtij diskutimi, e gjejmë me vend të shkëputim një citim nga studiuesja Otinen*: Meqë përkthimi (zakonisht) nuk mund të jetë një riprodhim "besnik" dhe fjalë për fjalë në një gjuhë tjetër, kur teksti duhet të rishkruhet për një publik dhe situatë të re, atëherë nuk ka gjëra absolute; asgjë nuk mund thjesht të shmanget ose të këshillohet. Gjithçka varet nga kush, çfarë, kur dhe ku.*[93]

I.4 Përkthimi për fëmijë kundrejt përkthimit për të rritur

A janë të njëjta problemet që shfaqen në përkthimin e letërsisë për fëmijë në krahasim me përkthimin e letërsisë për të rritur? Në pamje të parë mund të krijohet përshtypja se problemet janë të të njëjtit lloj, në fund të fundit, mund të përdorim të njëjtat koncepte gjatë përshkrimit të tyre, dhe mund të bëjmë klasifikime të ngjashme.[94] Megjithatë, ka disa cilësi të përbashkëta të letërsisë për fëmijë që diskutohen në studime të ndryshme si natyra komunikative e letërsisë për fëmijë, niveli i përshtatjes sipas kulturave të ndryshme, kërkesat e grupeve të ndërmjetme, statusi i përkthyesit të letërsisë për fëmijë, etj. Këto cilësi nxjerrin më tepër në pah faktin se përkthimet e letërsisë për fëmijë ndryshojnë në mënyrë cilësore, në varësi të cilësive të vecanta të publikut. Faktorë të tjerë që shfaqin ndryshime në fushën e letërsisë për fëmijë parë në këndvështrim krahasues me letërsinë për të rritur kanë të bëjnë edhe me nivelin e njohurive dhe përvojës, fazën e zhvillimit emocional dhe disa të dhëna pedagogjike. Turgej Kurultaji (Turgay Kurultay) duke theksuar rolin komunikativ shprehet se vetëm nëpërmjet një roli të tillë përkthimi do të jetë i efektshëm në kulturën e përkthimit dhe do të shërbejë qëllimin e vet.[95] Përshtatja do të duhet të jetë më e shumtë në rastin e letërsisë për fëmijë në krahasim me letërsinë për të rritur dhe ai nxjerr në pah nevojën për kritere të teorisë së përkthimit që të mund të përshkruajnë këtë përshtatje të mëtejshme.

Letërsia për fëmijë ndryshon nga letërsia për të rritur sepse shkrimtarët e librave për fëmijë dhe lexuesit e tyre kanë nivel të ndryshëm njohurish dhe përvoje. Janë të rriturit ata që përzgjedhin temat dhe që vendosin në lidhje me ata që do të publikojnë, shesin, vlerësojnë dhe blejnë librat për fëmijë dhe vetë fëmijët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në këtë proces, kështu që një ndër faktorët vendimtarë është nocioni që kanë të rriturit në lidhje me nevojat dhe dëshirat e fëmijëve.

Shkrimtarët për fëmijë, pavarësisht motivimit, në përgjithësi vendosin të shkruajnë për të rinjtë, ndërsa përkthyesit mund të mbajnë një qëndrim tjetër drejt

---

[92] H. Vermeer (1994) *Translation Today: Old and New Problems* në M. Snell-Hornby (1994) *Translation Studies. An Interdiscipline.* Amsterdam, John Benjamins, fq. 10.

[92] R. Oittinen (1995) *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press, fq. 23–30.

[94] Për shembull studimet: K. Reiβ (1982) *Zur Übersetzung von Kinder- und Jugendbüchern.* Lebende Schprahen 1, fq.7; W. Haranth (1984) *Übersetzungen und Bearbeitungen.* në L. Binder (ed.) *Illustrieren, Bearbeiten, Übersetzen. Arbeit an und mit Texten.*Wien: Internationales Institut für Jugendliteratur und Leseforschung, fq. 87; V. Rutschmann (1996) *Kinderliterarisches Übersetzen und Interkultureller Austausch* në *Zum Übersetzung von Kinder- und Jugendliteratur* CTL Lausanne No 27/1996, fq. 6; D. von Stockar (1996) *Kinderliterarische Übersetzungsprobleme* në *Zum Übersetzung von Kinder- und Jugendliteratur* CTL Lausanne No 27/1996, fq. 24; C. Bravo-Villasante (1978) *Translation Problems in my Experience as a Translator* në *Children's Books in Translation.* (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell International, fq. 46.

[95] T. Kurultay (1994) *Probleme und Strategien bei der Kinderliterarischen Übersetzung im Rahmen der Interkulturellen Kommunikation.* Në H. Ewers, E. O'Sullivan (ed.s) *Kinderlitertatur im Interkulturellen Proseβ* Stuttgart, Weimar: Metzler fq. 200.

"asimetrisë" në marëdhënien "i rritur-fëmijë". Përkthimi i letërsisë për fëmijë e thekson edhe më tepër këtë marrëdhënie asimetrie. Të rriturit – qofshin këta përkthyes, redaktorë apo botues në vendin ku flitet gjuha në të cilën do të përkthehet libri për fëmijë – janë ata që vendosin se çfarë do të jetë e përshtatshme për lexuesit-fëmijë në kulturën e përkthimit, se çfarë do të jenë të aftë të kuptojnë fëmijët dhe se si duhet të përkthehet teksti. Kjo marrëdhënie asimetrie nënkupton se do të përdoret një mënyrë tjetër të shkruari për fëmijët në krahasim me të rriturit.

Përkthyesit e letërsisë për fëmijë variojnë që nga përkthyesi profesional që mund të marë rastësisht një porosi për të përkthyer një libër për fëmijë, deri në një shkrimtar me përvojë për fëmijë i cili kthehet drejt përkthimit. Për rrjedhojë, është e pashmangshme ekzistenca e një ndryshueshmërie në lidhje me të kuptuarit e lexuesve fëmijë nga ana e përkthyesve. Puna e atyre përkthyesve që nuk janë as shkrimtarë për fëmijë dhe as të përfshirë në ndonjë mënyrë në botën e fëmijëve mund të paraqesë vështirësi të dukshme në procesin e përkthimit.

Gjithashtu, ndryshe nga letërsia për të rritur, letërsia për fëmijë duhet që të marrë vazhdimisht në konsideratë faktin se sa do të jenë të aftë lexuesit për të kuptuar elementët e kulturave të huaja dhe veçanësitë e tyre. Zhvillohet kështu një "kundërvënie" midis vlerësimit për origjinalin nga njëra anë, dhe shqetësimit për lexuesit e synuar nga ana tjetër, gjë që theksohet edhe më tepër në rastin e përkthyesve të letërsisë për fëmijë. Brixhit Shtolt (Brigit Stolt) shprehet se besnikëria nuk është më një problem me rëndësi në letërsinë për fëmijë, duke cituar shkrimtaren dhe përkthyesen e mirënjohur Astrid Lindgrenën (Astrid Lindgren) e cila ankohej se përkthyesve të librave për fëmijë shpesh iu drejtoheshin me fjalët: *nuk duhet ta thuash këtë; nuk është mirë të shprehesh në atë mënyrë!*[96]

Studiuesja Puurtinen shkon edhe më larg duke menduar se përkthyesve të letërsisë për fëmijë, ndryshe nga përkthyesit e letërsisë për të rritur, iu lejohet, madje, nganjëherë, edhe iu kërkohet që të manipulojnë tekstin origjinal në mënyrë të tillë që të përshtatet me kerkesat letrare të vendit ku do të lexohet libri i përkthyer.[97] Pra, do të ishte "detyrimi" ose, së paku, do të ishte pjesë e punës së përkthyesit, që të prodhonte përkthime të *pranueshme* për fëmijët të cilët nuk mund të kuptojnë aq sa të rriturit. Megjithatë, deri në çfarë mase do të ishte e lejueshme të ndryshohej origjinali? A është e këshillueshme të ndryshohet origjinali për të krijuar një tekst lehtësisht më të kuptueshëm? Çfarë lloj ndryshimesh *mund* të bëhen dhe çfarë ndryshimesh *duhen* shmangur?

Në teorinë e përkthimit gjejmë dy lloj metodash përshtatjeje: *përshtatja globale* si një ndryshim tërësor i funksionit të tekstit origjinal, dhe *përshtatja lokale* e përdorur edhe në rastin e letërsisë për fëmijë për t'u përballur me dallime specifike ndërmjet gjuhës ose kulturës së tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer.[98] Sipas Shtoltit, origjinali nuk duhet të ndryshohet në asnjë lloj rrethane sepse ai shërben për të plotësuar vlerat edukative për të vegjlit. Ndryshimet e vetme që mund të lejohen janë ato fetare ose politike.[99] Gjithashtu përshtatja do të mund të "justifikohej" edhe në lidhje me monedhat, njësitë matëse, zakone kombëtare, mënyrën e të veshurit, zakone jo të mira të sjelljes së fëmijëve si dhe thjeshtëzimin e tekstit.

---

[96] B. Stolt. (1978) *How Emil Becomes Michel – On the Translations of Children's Books.* në G. Klingberg, M. Ørvig, S. Amor (ed.s) *Children's Books in Translation. The Situation and Problems*. Stockholm: Almqvist&Wiksell International, fq. 132.

[97] T. Puurtinen (1994) *Dynamic Style as a Parameter of Acceptability in Translated Children's Books*. në M. Snell-Hornby (1994) *Translation Studies: An Interdiscipline*. Amsterdam*:* John Benjamins, fq. 84.

[98] G. Bastin (1997) *Encyclopaedia of Translation Studies.* London: Routledge, fq. 7.

[99] B. Stolt (2006) *How Emil Becomes Michel – On the Translation of Children's Books.* Në G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters, fq.70-71.

Nga ana tjetër, Shaviti dhe Klingbergu mendojnë se letërsia për fëmijë nuk duhet të ndryshojë. Për shembull, Shaviti nuk i pranon ato lloj ndryshimesh të tekstit origjinal të cilat kanë për qëllim që ta kthejnë tekstin në një mjet ideologjik, duke e transformuar atë ndonjëherë edhe krejtësisht.[100] Një çështje shqetësuese për përkthyesin e teksteve për fëmijë është kufizimi i pashmangshëm i botës së njohurive të të vegjëlve. Nuk mund të mendohet se lexuesit e rinj kanë fituar aftësinë për të kuptuar në thellësi të dhënat kulturore, gjuhësore dhe gjeografike që merren si të mirëqena për lexuesit e rritur. Meqenëse shpjegimet në fund të faqes nuk janë gjithmonë një zgjidhje e kënaqshme për këtë problem, një taktikë që, pavarësisht diskutimeve që shkakton, përdoret shpesh në përkthimin e teksteve për fëmijë është neutralizimi i gjithë dallimeve kulturore, ekonomike dhe politike duke sjellë dhunshëm elementët e huaj dhe të panjohur të tjetërsuar sipas gjuhës së përkthimit.[101] Diskutimi është shumë i thellë, në fakt, dhe qëndron në qëndër të shkrimeve të sotme mbi statusin e veprës së përkthyer kundrejt origjinalit, por, për qëllimet e këtij punimi ne do të kufizohemi në vërejtjen e shkallës së përcjelljes së vlerave kulturore të origjinalit dhe nivelit të pranisë së tyre në tekstin e përkthyer.[102]

I.5 Letërsia për fëmijë nën ndikimin e faktorëve ndërkulturorë dhe ideologjikë

Kemi përmendur deri tani një sërë cilësish të letërsisë për fëmijë dhe kemi dhënë një sërë faktorësh që e dallojnë përkthimin për fëmijë kundrejt përkthimit për të rritur. Në vazhdimësi të këtij diskutimi, do të parashtrojmë edhe një sërë elementësh kulturorë dhe ideologjikë që ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Kështu, për shembull, studiuesja Dona Norton shprehet se letërsia për fëmijë duhet të hartohet në mënyrë të tillë që t'i hapë dyert zbulimit dhe aventurës për fëmijët.[103] Një gjë e tillë mund të realizohet duke iu ofruar atyre kënaqësi, transmetim të trashëgimisë letrare, duke nxitur kuptueshmërinë dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore, si dhe duke i përfshirë ata në një proces shkëmbimi përvoje. Letërsia për fëmijë duhet të transmetojë njohuri, të ushqejë dhe të zhvillojë imagjiantën, si dhe të nxisë zhvillimin.

Lejdhi shprehet se transferimi i letërsisë nga një gjuhë në tjetrën ose nga një kulturë në tjetrën prezanton imazhe të ndryshme të fëmijërisë në vende të ndryshme të botës.[104] Duke ndjekur këtë arsyetim, një përmbajtje e përshtatshme bën që të nxiten vlera dhe sjellje të dëshirueshme në fëmijët. Fëmijët eksplorojnë botën nëpërmjet rrëfimeve dhe librave që ata lexojnë, dhe, përkrah pikpamjes së përgjithshme se vlera parësore e letërsisë është të kultivojë ndjenja estetike dhe kënaqësie, ashtu siç shprehet edhe Zhan Karli (Jean Karl), letërsia ndihmon zhvillimin e fëmijëve sepse i ndihmon ata të fitojnë përvojë duke i shpënë ata në shtete të tjera, shoqëri të tjera, vende dhe histori të ndryshme.[105] Gjithashtu, në lidhje me zhvillimin shoqëror, fëmijët, nëpërmjet leximit,

---

[100] Z. Shavit (1981) *Translation of Children's Literature as a Function of its Position in the Literary Polysystem* në *Poetics Today* 1981/Vol.2/Part 4, fq. 174.

[101] R. Ellis & L. Oakley-Brown (ed.) (2001) *Translation and Nation: Towards a Cultural Politics of Englishness*, Multilingual Matters, Clevedon, fq. 153.

[102] Për të mësuar më tepër rreth shkallës së pranisë së elementëve të huaj kulturorë në tekstin e përkthyer, mund të lexoni më në hollësi çështjen *Prirjet e asimilimit dhe huajëzimit* dhe ilustrimin me shembuj konkretë në kreun e tretë.

[103] D. E. Norton (1987) *Through the Eyes of a Child: An Introduction to Children's Literature.* Colombus: Merrill Publishing Company, fq. 35.

[104] G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 11.

[105] J. Karl (1970) *From Childhood to Childhood: Children's Books and Their Creators*. New York: The John Day Company, fq. 18.

mund të fitojnë sjellje, besime, standarde dhe motive që vlerësohen nga familjet e tyre dhe nga grupet kulturore ku ata bëjnë pjesë.[106] Për këtë arsye mund të themi se librat për fëmijë i ndihmojnë ata të kuptojnë dhe të bëhen pjesë e normave dhe sjelljeve të shoqërisë përkatëse, si dhe të përjetojnë, nëpërmjet procesit të të lexuarit, përvoja të reja. Në këtë drejtim, studiuesja Purtinen i përmbahet mendimit se letërsia për fëmijë luan një rol domethënës si një mjet edukativ, shoqëror dhe ideologjik. Sipas saj, didaktizmi është pothuajse gjithmonë i pranishëm, në mënyrë të dukshme ose të fshehtë në librat e fëmijëve. Ky parim didaktizimi, dobishmërie për fëmijën, vendoset në plan plotësues ose ndonjëherë kundërvënës me kërkesën e kuptueshmërisë: edhe gjuha edhe përmbajtja e librave për fëmijë përshtaten me aftësitë e lexuesve për të kuptuar dhe lexuar.

Sërish duke iu referuar letërsisë për fëmijë, Sharlot Hak (Charlotte S. Huck) përmend rolin e kësaj letërsie për të nxitur kuptimin e njerëzve të kulturave dhe ideologjive të ndryshme në nivel ndërkombëtar, duke bërë që fëmijët të njohin ide dhe tradita me të cilat nuk kanë pasur asnjë kontakt të mëparshëm, duke i çuar ata në vende dhe kohë të ndryshme, pra, duke fuqizuar marrëdhëniet e tyre me njerëzit dhe mjedisin rreth tyre.[107] Letërsia e paramenduar për fëmijë, shton ajo, gjithmonë pasqyron sjelljet e ndryshueshme të shoqërisë ndaj fëmijërisë dhe familjes, dhe konsiderohet si një dokumentim i shoqërisë dhe zakoneve që të rriturit do t'iu transferonin fëmijëve të tyre.[108] Në fakt, ashtu siç ve në pah edhe Pitër Hant, letërsia për fëmijë është një gjini që përkufizohet nga vetë publiku, dhe cilësia universale që e karakterizon atë ka të bëjë me rolin edukativ dhe kulturor, meqenëse fëmijët kanë shumë të përbashkëta, kështu që, letërsia për fëmijë na ofron një mjet për të kuptuar dallimet kulturore.[109] Sipas këtij këndvështrimi, përkthimi i letërsisë për fëmijë ka gjithashtu aspektin e vet kuturor, sepse shtrin edhe më tej kufijtë kulturorë të fëmijëve dhe mundëson shkëmbimet kuturore. Është e rëndësishme të identifikojmë shkallën e përfshirjes së elementëve të huaj kulturorë dhe ideologjikë në tekstin e përkthyer kundrejt përshtatjes së tyre sipas kontekstit të ri kulturor dhe ideologjik.

Sipas Zohar Shavitit përkthimi është një *proces transferimi jo vetëm nga një kulturë në tjetrën, por edhe nga një sistem në tjetrin, nga sistemi i të rriturve në sistemin e fëmijëve.*[110] Kështu, ajo identifikon transferimin e veprave letrare për të rritur në sistemin e librave për fëmijë. Që të ndodhë një dukuri e tillë, duhet që vepra të jetë e dobishme dhe e përshtatshme për fëmijë si dhe të kuptohet lehtësisht prej tyre. Kritere të tilla e ndihmojnë përkthyesin që të përzgjedhin veprat që do të përkthejnë si dhe të vendosin shkallën e ndryshimeve që iu lejohet të bëjnë.[111] Marrim si shembull një nga librat, që, pasi iu është nënshtruar shumë përkthimeve, sot njihet gjerësisht si libër për fëmijë: *Robinson Kruzo.* Kjo vepër mund të mendohet se shërben si një mjet edukimi dhe shoqërizimi sepse përmbush funksione të ndryshme brenda kufizimeve kulturore. Për shembull, iu mëson fëmijëve se si të përballen me vështirësitë, dhe iu mundëson lexuesve që të njihen me një jetë shoqërore të ndryshme nga jeta e tyre, duke marrë më shumë të dhëna rreth kuturës angleze (emrat e njerëzve dhe vendeve, traditat dhe mënyra e jetesës së tyre). Njëkohësisht një sërë diskutimesh rreth borgjezisë apo diskriminimet raciale nuk përfshihen ose modifikohen gjatë përkthimit.

---

[106] D. E. Norton (1987) *Through the Eyes of a Child: An Introduction to Children's Literature.* Colombus: Merrill Publishing Company., fq. 24.
[107] C. S. Huck (1987) *Children's Literature in the Elementary School*. Orlando: Saunders College Publishing, fq. 7.
[108] Po aty, fq. 96.
[109] P. Hunt (1992 *Literature for Children: Contemporary Criticism*. London, Routlege, fq. 6, 110.
[110] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*, Athens: University of Georgia Press, fq. 111.
[111] Po aty, fq. 113.

Sipas Eva Maria Metkalfit (Eva-Maria Metcalf), "*gjithnjë e më shumë libra për fëmijë po i drejtohen një publiku të dyfishtë të përbërë nga fëmijë dhe të rritur, gjë që paraqet një sfidë të dyfishtë për përkthyesin, i cili duhet t'i drejtohet një publiku të dyfishtë nëpërmjet letërsisë së përkthyer*". Një gjë e tillë i shtohet vështirësive të procesit të përkthimit.[112] Edhe studiuesi Kliford Landers (Clifford Landers) komenton rreth çështjeve ideologjike në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke u shprehur se përkthyesi duhet të jetë i lirë që të përshtasë elementët e huaj kulturorë dhe traditat ndaj të cilave fëmijët që lexojnë tekstin e përkthyer nuk shfaqin interes.[113] Sipas tij, çështje të tilla si racizmi, paragjykimet gjinore, divorci, vdekja dhe tabutë nuk duhet të përfshihen në përkthimin e letërsisë për fëmijë dhe përkthyesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm në lidhje me problemet që vijnë për pasojë. Gjithashtu, Aithne O'Konëll (Eithne O'Connell) nxjerr në pah disa aspekte të tjera në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke u shprehur se përkthimi i kësaj letërsie ka pasur probleme në lidhje me statusin e ulët të origjinalit, meqenëse materiali origjinal konsiderohet të ketë një interes dytësor nga ana e shkrimtarëve, pavarësisht faktit se përkthimi i kësaj letërsie luan një rol të rëndësishëm ideologjik, etik, fetar, etj. Këto norma përcaktojnë se çfarë përkthehet si dhe kur dhe ku, dhe janë gjithmonë në ndryshim e sipër, nga gjuha në gjuhë, kultura në kulturë dhe brezi në brez.[114] Në vazhdim të këtij qëndrimi, sipas studiueses Emer O'Sullivan, përkthyesi ka më shumë mundësi të ketë një prani të dukshme në përkthimin e letërsisë për fëmijë dhe të ndryshojë tekstin duke mbajtur parasysh interesat dhe aftësitë e përcaktuara në mënyrë kulturore që kanë fëmijët në një stad të caktuar zhvillimi.[115] Të gjitha argumentat dhe arsyetimet e sipërpërmendura na bëjnë të kuptojmë dhe të reflektojmë me kujdes për shkallën e ndikimit të faktorëve ideologjikë dhe kulturorë në letërsinë për fëmijë, dhe, për më tepër, në përkthimin e kësaj gjinie.

1.6 Diskutim përmbledhës rreth pikpamjeve teorike në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë

Shenjat e para të një interesi rreth çështjeve më të përgjithshme të ndikimeve ndërkulturore dhe shpërndarjes ndërkombëtare të letërsisë për fëmijë janë shfaqur fillimisht brenda disiplinës së Letërsisë Krahasuese. Në ditët e sotme mund të pohojmë me bindje përkthimi i letërsisë për fëmijë përfaqëson një fushë e re studimi brenda Studimeve Përkthimore. Kërkime më të thella në këtë fushë studimi merren me dallimet mes mënyrës së pritshmërisë së përkthimeve nga të rriturit dhe fëmijët. Pavarësisht vështirësive të përkufizimit të letërsisë për fëmijë, mund të përmendim disa nga cilësitë e saj të cilat duhen patur parasysh gjatë përkthimit të kësaj gjinie në dallim nga gjinitë e tjera. Librat për fëmijë iu drejtohen edhe fëmijëve edhe të rriturve, mund të interpretohen në nivele të ndryshme për shkak të natyrës ambivalente, dhe gjithashtu kanë karakter të dyfishtë dhe veprojnë brenda kufizimeve kulturore. Shpeshherë kjo lloj gjinie është lënë në hije për shkak të pozicionit periferik që ajo ze brenda sistemit letrar tradicional, akoma më në periferi është e pozicionuar letërsia për fëmijë e përkthyer. Megjithatë, zhvillime të tjera në kuadër të studimeve përkthimore, si kthesa kulturore dhe teoria e polisistemit

[112] E-M. Metcalf (2003) *Exploring Cultural Difference through Translating Children"s Literature*. Në *Meta*, xviii, 1-2: 322-27; fq. 323.
[113] C. E. Landers (2001) *Literary Translation: A Practical Guide. Great Britain*. Cromwell Press Ltd, fq. 106.
[114] E. O'Connell, (2006) *Translating for children*. Në G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 19-21.
[115] E. O'Sullivan (2006) *Narratology meets translation studies, or The voice of the translator in Children's Literature*. Në G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader*. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 98-100).

kanë hedhur më shumë dritë në përkthimin e lëtërsisë për fëmijë, duke na bërë të kuptojmë se përkthimi i letërsisë për fëmijë është vazhdimisht nën ndikimin e faktorëve kulturorë, shoqërorë, ekonomikë e politikë dhe nuk është asnjëherë një çështje thjesht gjuhësore, por një proces i vazhdueshëm negociimi.

Kreu II Përshkrimi i korpusit të përzgjedhur

Do ta fillojmë këtë kre duke përshkruar në mënyrë të hollësishme veprat që kemi përzgjedhur të jenë pjesë e studimit tonë si dhe duke parashtruar arsyet e kësaj përzgjedhjeje. Do të japim të dhëna rreth veprave origjinale si dhe varianteve të përkthyera në gjuhën shqipe. Do të shqyrtojmë në hollësi secilin prej varianteve për të identifikuar dhe shpjeguar praninë ose mungesën e elementëve të tillë si parathënia, pasthënia, ilustrimet, tabela e përmbajtjes, ndarja në kapituj, titujt e kapitujve, shpjegime dhënë nga ana e përkthyesit, etj. Duke qenë të ndërgjegjshëm se asnjëherë nuk mund të zgjedhim një korpus gjithëpërfshirës në një fushë studimi relativisht të re (përkthimi i letërsisë për fëmijë), po e fillojmë këtë kre duke përligjur arsyet e përzgjedhjes së korpusit studimor, dhe, më tej, do të japim më shumë hollësi për secilën vepër, gjë që do të na ndihmojë gjatë punës krahasimore në pjesën praktike të studimit.

II.1 Arsyet për përzgjedhjen e korpusit

Kemi menduar dhe rimenduar për një kohë të gjatë se cili do të ishte korpusi më i përshtatshëm për një studim të përmasave të tilla si studimi ynë, i cili merr përsipër të shqyrtojë aspektet teorike dhe praktike të përkthimit të letërsisë për fëmijë. Nuk mund të lemë pa përmendur se jemi përballur me vështirësi të shumta në procesin e përzgjedhjes. Si fillim, duhet thënë se letërsia për fëmijë në vetvete përfshin një numër shumë të gjerë veprash dhe një larmi shkrimtarësh sa që ishte një sipërmarrje vërtet sfiduese përzgjedhja e disa veprave thjesht për qëllime studimi. Në këtë këndvështrim theksojmë se kemi përzgjedhur vepra të tilla që të jenë jo vetëm përfaqësuese të letërsisë për fëmijë, por, njëkohësisht, t'i japin dorë qartësimit të qëllimeve të studimit tonë, pra, të nxjerrin në pah çështje të ndryshme domethënëse të përkthimit të letërsisë për fëmijë, parë me syrin e dukurive që bien në sy më tepër gjatë procesit të transferimit nga një gjuhë në tjetrën. Për këtë arsye kemi përfshirë në studimin tonë një vepër klasike të letërsisë për fëmijë ndër vite *Alice's Adventures in Wonderland*, të lexuar gjerësisht nga fëmijët dhe të rriturit për breza me radhë. Gjithashtu, duke iu referuar librave për fëmijë më të shitur e të lexuar, por njëkohësisht, edhe më të studiuar në ditët e sotme në mbarë botën, zgjodhëm të përfshijmë në studim edhe një libër që ka njohur sukses nga miliona e miliona lexues, të vegjël e të rritur njëkohësisht, *Harry Potter and the Philosopher's Stone.* Nga ana tjetër, siç diskutuam edhe në kreun e parë, përkufizimi i letërsisë për fëmijë si një gjini më vete është disi i diskutueshëm dhe mundëson që të përfshihen në letërsinë për fëmijë edhe vepra të shkruara fillimisht për të rritur por që lexohen gjerësisht nga fëmijët në një nivel më të thjeshtë vështirësie ose ideologjie. Ky lloj adresimi i dyfishtë ka qenë një ndër motivimet që na ka shoqëruar për përzgjedhjen e dy veprave të tjera që e plotësojnë korpusin tonë. Përkthimi i letërsisë për fëmijë shpesh përshkruhet si një komunikim ndërkulturor që përfshin në mënyrë të ngjashme kulturën e fëmijëve dhe të të rriturve. Kjo ndodh sepse të rriturit komunikojnë me fëmijët nëpërmjet letërsisë.[116] Duke pasur parasysh këtë lloj konceptimi, kemi përzgjedhur *Robinson Crusoe* si një vepër tjetër që do të na ndihmojë në studimin tonë, një vepër e cila ka shënuar shumë risi duke i dhënë zë vetë fëmijërisë së romanit në gjuhë angleze, edhe pse pati ndikim të gjerë edhe në letërsinë për të rrritur. Së fundi, brenda kufizimeve të këtij studimi, e plotësojmë përzgjedhjen tonë me *Gulliver's Travels,* një vepër që i përket kanonit të letërsisë perëndimore, por që sot njihet gjerësisht si një vepër për fëmijë e që lexohet nga fëmijët në mbarë botën. Theksojmë edhe një herë se ne jemi udhëhequr nga parimi i Zohar

[116] R. Oittinen (2000) *Translating for Children.* New York: Garland, fq. 6.

Shavitit në lidhje me mënyrën e konsiderimit të përkthimit si një proces transferimi jo vetëm nga një kulturë në një tjetër, por edhe nga një sistem në një tjetër, dhe, ajo çka ne e gjejmë me shumë vend në dritën e këtij studimi, nga sistemi i të rriturve në sistemin e fëmijëve.[117] Një konceptim i tillë përligj përzgjedhjen e një satire të tillë si *Gulliver's Travels* të shndërruar sot, nëpërmjet procesit të përkthimit, në një vepër të lexuar gjerësisht nga fëmijë dhe të rritur. Për ne do të jetë me shumë interes të vërejmë ndryshimet që pëson një vepër e tillë gjatë përkthimit, nisur edhe nga publiku të cilit do t'i drejtohet vepra e përkthyer. Pasi kemi përmendur veprat që do të na shoqërojnë në studimin tonë, është e nevojshme që të hyjmë më në hollësi për secilën nga veprat e përmendura dhe variantet që kemi gjetur në gjuhën shqipe, me të cilat ne kemi punuar për të përmbushur qëllimet tona në pjesë të ndryshme të këtij punimi. Edhe një here theksojmë se kemi qenë të tunduar për të bërë pjesë të këtij punimi edhe shumë vepra të tjera, përfaqësuese të letërsisë për fëmijë ndër vite, por, qëllimi ynë kryesor ka qenë jo vetëm përfshirja në korpus studimi e veprave përfaqësuese të letërsisë për fëmijë, por e atyre veprave të kësaj gjinie, që shfaqin dukuri me interes në kuadër të këtij studimi krahasimor, të cilat do t'i përshkruajmë më hollësisht më poshtë.

II.2 Përshkrimi i elementëve të rëndësishëm si kopertina dhe ilustrimet, parathënia e pasthënia, faqosja, ndarja në kapituj, tabela e përmbajtjes, shënimet, etj.

Në këtë çështje do të parashtrojmë disa të dhëna për të njohur më tepër veprat origjinale nën shqyrtim si dhe variantet perkatëse që kemi gjetur të përkthyera në gjuhën shqipe si dhe do të argumentojmë se cilat prej varianteve do të përfshijmë në këtë studim, duke përmendur arsyet pse një pjesë të varianteve të gjetura në gjuhën shqipe i kemi lënë jashtë këtij studimi. Gjatë shqyrtimit të hollësishëm të varianteve në gjuhën shqipe do të përmendim praninë e elementëve përbërës të tillë si parathënia e pasthënia, shoqërimin e varianteve me ilustrime apo mungesën e tyre, mënyrën e renditjes së kapitujve në krahasim me origjinalin, shënimet që shoqërojnë secilin prej varianteve, etj. Të gjithë këta elementë janë të rëndësishëm për analizën dhe interpretimin e dukurive të vërejtura dhe të përshkruara në pjesët vijuese të këtij punimi.

II.2.1 *Alice's Adventures in Wonderland (1865)*

II.2.1.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Alice's Adventures in Wonderland*

Në fillim po sjellim disa të dhëna për librin origjinal *Alice's Adventures in Wonderland* shkruar nga Çarls Lutuixh Doxhson (Charles Lutwidge Dogdson) nën pseudonimin Ljuis Kerrël (Lewis Carroll). Duke iu referuar të dhënave të krijimtarisë së Ljuis Kerrël rikujtojmë se ai shkroi tre versione të ndryshme të së njëjtës histori, duke i përcakuar nga një status të ndryshëm secilit. Versioni i parë *Alice's Adventures under Ground* iu dhurua Elisës dhe, vetëm në mars të vitit 1886, pasi versioni i dytë i Kerrëllit u bë shumë i suksesshëm, dorëshkrimi u botua. Versioni i parë u botua fillimisht si një dokument historik dhe jo si një libër për fëmijë, ndoshta sepse vetë shkrimtari synonte drejt një libri me status të papërcaktuar. Teksti aq i mirënjohur, *Alice's Adventures in Wonderland,* ishte versioni i dytë, shkruar nga Kerrël pasi miqtë e tij e nxitën që të botonte në formën e

[117] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*, Athens: University of Georgia Press, fq. 111.

një libri atë dorëshkrim që ata kishin pasur mundësi ta lexonin.[118] Megjithatë, Kerrël nuk dëshironte ta botonte versionin e parë ashtu siç ishte dhe e ndryshoi pjesën më të madhe të tij. Ky version fitoi shumë popullaritet, dhe, në një kohë të shkurtër u shndërrua në një vepër klasike për fëmijë, duke e bërë Kerrëlin shumë të famshëm. Lensilin Roxher Grini (Lancelyn Roger Green) shprehet se *të dy librat u shndërruan në klasikë të pranuar gjerësisht mes moshave të reja dhe të vjetra që përpara fundit të shekullit dhe mund të citoheshin pa ndonjë referencë në veçanti apo jusifikim duke qenë të sigurtë se të gjithë lexuesit do ta kuptonin menjëherë se përse bëhej fjalë.*[119] Versioni i fundit i *Alice's Adventures in Wonderland* që u përgatit nga Kerrël mban titullin *The Nursery Alice* dhe u botua në vitin 1889. Në këtë version shkrimtari ka ndryshuar krejtësisht mënyrën e të shprehurit dhe tonin që mbizotëronte në versionet e mëparshme dhe vetëm ilustrimet origjinale të Xhon Tenielit (John Tenniel) ruajnë lidhje me versionet e mëparshme.

Ekzistenca e tre versioneve të ndryshme bën të mundur që nga pikpamja metodologjike të jetë më e lehtë që të eksplorohet natyra e tekstit për shkak të vetë dallimeve mes tyre. Kur Kerrël mori vendimin të botonte *Alice's Adventures in Wonderland* ai vendosi të ndryshonte versionin e parë, ndoshta duke menduar se ai version ishte shumë i sofistikuar për t'u përfshirë në sistemin e fëmijëve, por edhe jo aq shumë i sofistikuar sa të pranohej nga të rriturit. Ka një dallim thelbësor mes versionit të parë dhe të dytë: karakteristika të nënkuptuara të versionit të parë, bëhen mbizotëruese në versionin e dytë: pra, dallimi mes tyre nuk ka të bëjë vetëm me praninë ose mungesën e disa elementëve, por në mënyrën e organizimit të tyre, dhe, rrjedhimisht, hierarkinë brenda vetë tekstit. Gjatë punimit të versionit të dytë, Kerrëli ishte i qartë në drejtimin e tij; ai dëshironte të zgjeronte ato elementë që i japin tekstit natyrën nën diskutim. Më pas, gjatë shkrimit të versionit *The Nursery Alice*, ai shmangu dhe fshiu gjithë ata elementë që ai kishte zhvilluar në versionin e dytë. Në këtë version të tretë, Kerrëli u përpoq ta çlironte tekstin nga statusi i papërcaktuar dhe e transformoi atë qëllimisht që t'iu drejtohej vetëm fëmijëve, duke e ndryshuar statusin e tekstit dhe duke e kthyer atë në një tekst me status njëvlerësh dhe të mirëpërcaktuar.

Për qëllimet e studimit tonë nuk është e nevojshme të hyjmë në një analizë të hollësishme të dallimeve mes tre versioneve përkatëse, por është e mjaftueshme të përmendim faktin se edhe vetë autori dhe përpunimet që ai i bëri veprës në fjalë bëjnë që *Alice's Adventures in Wonderland* të fitojë një status të papërcaktuar në mënyrë përfundimtare. Kështu, shkrimtari kombinoi dy modele mbizotëruese të letërsisë për fëmijë – atë të historisë me aventura dhe atë të historisë me fantazi – dhe ua shtoi ato modelit të gjinisë nonsens brenda letërsisë.[120] Modeli i parë ishte mbizotërues në letërsinë për fëmijë gjatë pesëdhjetë viteve të mëparshme, ndërsa dy të tjerët ishin duke u bërë të njohur. Vetë shkrimtari duhet të ketë qenë i ndërgjegjshëm për cilësitë risiprurëse të tekstit të tij (për shkak të ndryshimit që sillte krahasuar me modelin tradicional).[121]

---

[118] Megjithatë, siç ve në dukje L.R. Green [(1960) *Lewis Carroll*. London: Bodley Head, fq. 35], *Kerrëll* u bind për botimin e dorëshkrimit vetëm pasi *George MacDonald* ua lexoi atë fëmijëve të tij dhe ata u kënaqën shumë.

[119] L. R. Green (1969) *The Golden Age of Children's Books*. Egoff et al., fq. 57.

[118] L. R. Green [(1960), *Lewis Carroll*. London: Bodley Head, fq. 51) na ve në dijeni të faktit se në një letër drejtuar një miku të tij *Kerrël* shprehet '*Mund të garantoj se librat nuk përmbajnë asnjë lloj mësimi letrar në brendinë e tyre – në fakt, ato nuk japin asnjë lloj mësimi'*. Kjo ishte një deklaratë provokuese për kohën dhe sigurisht që tregonte një koncept të ri mbi letërsinë për fëmijë.

[119] Siç përmend edhe M. Gardner (2000) (në *The Annotated Alice – the definitive edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA) shumica e poezive që shfaqen në të dy librat e Kerrëlit janë parodi të poezive ose këngëve që ishin shumë të njohura për lexuesit bashkëkohorë të Kerrël. Gjithashtu, siç shprehet *Tynjanov* [(1971) Tynjanov, Jurij, and Roman Jakobson. [1929] 1971. *Problems in the Study of Literature and Language.* Matejka and Pomorska.] parodia është karakteristike kur normat ndryshojnë në sistemin

Kerrëli e braktisi nivelin moral, që konsiderohej si detyrues në letërsinë për fëmijë (edhe pse jo më si i tillë në letërsinë për të rritur). Në këtë drejtim, ai shkeli një nga rregullat thuajse të shenjta të letërsisë për fëmijë aktuale kanonike; megjithatë, kjo shkelje u mundësua si pasojë e pranimit të librit edhe nga publiku i rritur.

Nëse do të analizonim marrëdhëniet e pështjelluara ndërmjet fantazisë dhe realitetit në dy pika kyçe të tekstit – fillimi dhe fundi – do të vërejmë se, në të dyja rastet, është e pamundur të emërtohet me siguri secili prej episodeve si një ëndërr apo një ngjarje e vërtetë. Është vetë Kerrëli që i ngatërron qëllimisht të dyja botët, shpesh duke i ndërtuar ato në bashkëekzistencë me njëra-tjetrën. Për më tepër, Kerrëli nuk e përfundon historinë me zgjimin e Lizës, por e le të hapur pyetjen nëse kemi të bëjmë me një ëndërr, madje edhe motra e Lizës fillon të ëndërrojë, dhe i gjithë teksti përfundon me "ëndrrën e një ëndrre" – "*...ndoshta edhe me andrrën e dikurshme të Botës së Çudivet ... tue kujtue fëminin e vet dhe ditët e kandshme verore".*[122] Kjo teknikë e ndërlikuar i përzien edhe më shumë kufijtë mes dy botëve: motra e Lizës ëndërron për aventurat e Lizës (sikur ato të ishin të vërteta), ekzistenca e të cilave barazohet me botën reale. Kështu Kerrëli vë në diskutim kufijtë mes dy dimensioneve. Nëse mund të ëndërrohet për një ëndërr, sikur ajo të ishte e vërtetë, në mënyrë të anasjelltë, realiteti mund të përshkruhet si pjesë e një ëndrre. Kjo lloj marrëdhënieje mund të shpjegohet vetëm në përputhje me normat e një historie në dukje të pakuptimtë, ku lejohen motivime të llojeve të ndryshme, përveç atyre logjike. Kështu, kalimi nga realiteti në fantazi dhe anasjelltas nuk mund të shpjegohet në mënyrë logjike (përveç rastit kur pranohet "logjika" e brendshme e historisë). Liza është brenda botës së saj në një ëndërr-zhgjëndërr, dhe ndërkohë qëndron e ulur në të njëjtin vend: ajo krijon hapësirë brenda hapësirës meqenëse të gjitha transformimet janë në ëndërr dhe jo në jetën e saj të vërtetë.

Dallimet ndërmjet versioneve (toni i ndryshëm, mungesa e parodisë dhe satirës në variantin për fëmijë, qëndrimet e ndryshme ndaj marrëdhënies mes hapësirës dhe kohës, fantazisë dhe realitetit) tregojnë se sa shumë i ndërgjegjshëm ishte Kerrëli për publikun të cilit i drejtohej në çdo rast, gjë që duhet pasur parasysh edhe nga përkthyesit e veprës për t'u ndërgjegjësuar në lidhje me publikun marrës, një faktor shumë i rëndësishëm që do të ndikojë në strategjitë e përkthimit.

II.2.1.2 Veçanësia e përkthimit në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland*

Kur bie në gropën e lepurit, Liza përballet me një botë në të cilën kuptimi shpesh pëson shndërime të anasjellta. Detyra kryesore e përkthyesit, pa dyshim, është të përcjellë kuptimin e origjinalit, por si do të përballet përkthyesi me këtë detyrë në një vepër si *Alice's Adventures in Wonderland*, ndërkohë që vetë kuptimi i origjinalit përcillet në mënyrë të fshehtë dhe shpesh të anasjelltë?

Në Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë lexojmë "*shumë gjëra nga novacionet që solli kjo vepër nuk na habitin më për arsyen e thjeshtë se në këtë formë janë shkruar me dhjetëra novela e romane ... 'zbulimi' i asaj bote fantastike nga heroina dhe mrekullitë që i ndodhin qenë një gjë krejt e re dhe e freskët. Ajo mënyrë parashtrimi, pra zbulimi i një bote të jashtëzakonshme nga vetë fëmijët, përbën edhe sot bazën e shumë*

---

letrar dhe është treguese e një periudhe letrare që është në përfundim. Në një parodi, shkrimtari e bazon modelin e ri në rimodelimin e një modeli ekzistues, duke prezantuar modelin e qëndrueshëm (dhe duke abuzuar me të njëkohësisht).

[122] L. Carroll (1944) *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë, fq. 136.

veprave letrare. Ja pra ndihmesa e çmuar që solli 'Liza ...' në letërsinë për fëmijë".[123] Nisur nga këto të dhëna, kjo vepër nuk do të paraqitej shumë problematike për përkthim, si për variantet e hershme të përkthimit, dhe aq më tepër në ditët e sotme që shumë novela e romane, duke iu përmbajtur citimit të mësipërm, i janë bashkuar kësaj forme të shkruari. Në fillim të kësaj çështjeje të punimit tonë do të shikojmë se pse, fillimisht, të kuptuarit e kësaj vepre, dhe më pas, përkthimi i saj, paraqet një problematikë unike ashtu si dhe vetë vepra. Duke diskutuar mbi variantet nën shqyrtim, do të udhëhiqemi nga parimi përfundimtar që përpiqet të na tregojë se si përkujdesja për kuptimin e shprehur në sipërfaqe pa i kushtuar vëmendjen e duhur nënkuptimeve dhe aludimeve që gjallojnë nën sipërfaqen e tekstit mund të çojë në një përkthim jo të efektshëm. Duke iu përmbajtur këtij argumenti, le të hyjmë në Botën e Çudirave ku normat e përkthimit dhe kuptimit shndërrohen sipas statusit të vetë veprës.

Që kur *Alice's Adventures in Wonderland* është bërë pjesë e kanonit letrar të botës perëndimore vepra është veshur me një farë pushteti fetar, gjë që për përkthyesin do të thotë edhe më shumë vështirësi në punën e tij. Fillimisht, përkthyesi ka frikë se mos "e tradhëtojë" tekstin: ai duhet ta përkthejë pa e transformuar atë. Përkthyesit gjithashtu kanë frikë se mos "tradhëtojnë" lexuesin. Shumë lexues presin që përkthimi i veprave letrare klasike të përcjellë saktësisht ato që ishin shkruar në origjinal, dhe kjo ide mbi saktësinë sërish ngjall në mendje idetë për ngjashmëri mes fjalëve dhe kuptimeve leksikore më shumë sesa për kuptimet e ligjërimit apo efektit të përcjellë në tërësi. Të gjitha këto ndjenja mund ta kufizojnë lirinë e përkthyesit letrar që të përcjellë thjesht sintaksën dhe semantikën sipërfaqësore të një teksti në vend që të përcjellë efektin e fjalëve dhe domethënien nëntekstuale në vend. Megjithatë, zhvillimet bashkëkohore të teorisë së përkthimit dhe teknikave të rrëfimit priren që të sugjerojnë përparësinë e niveleve më të larta të ligjërimit ndaj njësive leksikore dhe sintaksore, duke u udhëhequr nga parimi i krijimit të *efektit sa më të ngjashëm e të përafërt* për lexuesit e tekstit të përkthyer kundrejt efektit të përjetuar nga lexuesit e tekstit origjinal.[124] Nga ana tjetër, vetë përkthyesit duhet të ndërgjegjësohen se përkthimi, si një akt komunikimi, është i lidhur pazgjidhshmërisht me lexuesit, të cilët, pasi teksti është përkthyer mund të jenë të ndryshëm nga marrësit të cilëve u drejtohet teksti origjinal. Nuk është e lehtë që nga një botë çudirash, ku gjithçka ndryshon, ku asgjë nuk është siç duket, dhe mungesa e kuptimit është krejt relative, të rikrijohet një botë tjetër çudirash me kuptime, kundërkuptime dhe nënkuptime që të pasqyrojnë njëkohësisht edhe botën origjinale.

Veçanësia e veprës shtrihet në shformimet e gjuhës dhe zakoneve dhe referimet dhe lidhjet që realizon ky tekst me tekste të tjerë dhe situata ose personazhe realë apo të trilluar. Çështja më problematike për përkthyesin do të jetë pikërisht kjo: a do të arrijë ai të ngrejë pak a shumë të njëjtat ura komunikimi, të përcjellë pak a shumë të njëjtin efekt, të vendosë ura lidhëse sa më shumë të qëndrueshme ndërmjet botës rrëfyese ekzistuese brenda një kulture dhe lexuesve që i kanë rrënjët e tyre në një kulturë tjetër? Problematika vazhdon të endet edhe më shumë rreth vetes kur mendojmë se *Alice's Adventures in Wonderland* është vlerësuar si libri për fëmijë më i parapëlqyer nga të rriturit. Aludimet nuk mund të identifikohen lehtësisht nga lexuesit fëmijë as në veprën origjinale në anglisht, dhe, kështu ngrihet edhe një kurth tjetër për përkthyesin. Së pari, kujt do t'i drejtohet vepra e përkthyer (a do të jetë edhe vepra e përkthyer me të njëjtin status apo në përkthim publiku të cilit i drejtohet vepra do të jetë i mirëidentifikuar, a do t'i drejtohet vepra një publiku bashkëkohor shqiptar apo do të riprodhohet një imitim i një shkrimi që ngërthen në vetvete edhe shumë aludime historike dhe a duhen përcjellë këto

[123] A. Bishqemi (2006) *Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë*. Sejko. Tiranë, fq. 111.
[124] V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 207-208.

të fundit në përkthim), dhe së dyti, a do të jetë edhe vepra e përkthyer një ndërthurje kuptimesh e nënkuptimesh me kufij të papërcaktuar qartë, ashtu si edhe në origjinal, apo përkthyesi do të afrohet më tepër me lexuesin (duke e thjeshtëzuar dhe duke i zhveshur petkun e aludimeve tekstit) duke u larguar nga shkrimtari dhe vepra origjinale? Natyrisht që përgjigja e pyetjes së dytë është e lidhur ngushtë me përgjigjen e pyetjes së parë, dhe, sigurisht që nuk është aspak e lehtë që t'i përgjigjemi përfundimisht pyetjeve të ngritura nëse e vendosim veten në rolin e përkthyesit.

Në mënyrë të përmbledhur, theksojmë edhe një herë se arsyet pse kemi zgjedhur një vepër të tillë si *Alice's Adventures in Wonderland* si pjesë të veprave që do të përfshihen në studimin tonë krahasimor janë të shumëfishta. Së pari, në veprën origjinale shprehen një sërë aludimesh dhe nënkuptimesh nëpërmjet lojërave të fjalëve dhe emrave të përveçëm, që do të studiohen në mënyrë të hollësishme në pjesë të ndryshme të këtij punimi. Gjithashtu, qëndrimi që kanë mbajtur përkthyes të ndryshëm ndaj njësive kulturore të pranishme në vëprën origjinale përbën një tjetër çështje me interes që do të jetë pjesë e studimit tonë në një plan krahasues mes varianteve të ndryshme sjellë në gjuhën shqipe ndër vite. Gjatë këtij punimi do të shqyrtojmë pesë variante në gjuhën shqipe dhe në secilin rast do të shohim qëndrimin e mbajtur nga secili përkthyes, duke pasur gjithmonë parasysh kënaqësinë që na jep leximi (po aq sa edhe kuptimi) i veprës në anglisht, por, njëkohësisht, duke mos harruar asnjëherë vështirësitë që paraqet gjatë përkthimit një vepër e tillë që na vjen nga një botë çudirash dhe që duhet të transmetohet në një botë tjetër çudirash. Sa të ngjashme do të jenë këto dy botë? Le të udhëtojmë së bashku me Lizën përtej kufijve kohorë dhe hapësinorë për të eksploruar magjitë dhe çudirat e vetë gjuhës.

II.2.1.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland*

Në këtë çështje do të paraqesim disa karakteristika të korpusit që kemi përzgjedhur për këtë punim. Me korpus do të nënkuptojmë një grup tekstesh të shkruara (ose materialesh gojore) të përdorura për studimin krahasues. Në fushën e përkthimit korpusi mund të jetë njëgjuhësor, dygjuhësor dhe shumëgjuhësor,[125] në rastin tonë korpusi do të jetë dygjuhësor: anglisht (teksti origjinal) dhe shqip (pesë variantet e përkthyera në gjuhën shqipe).

Kemi diskutuar tashmë për veprën *Alice's Adventures in Wonderland* dhe kemi pranuar faktin se ky libër u drejtohet njëkohësisht edhe të rriturve edhe fëmijëve, madje vitet e fundit vazhdon të ribotohet edhe si pjesë e letërsisë botërore klasike përkrah librave më të rëndësishëm për të rritur.[126] Ky ndryshim i publikut marrës të librit sigurisht që do të ndikojë në vendimet dhe zgjedhjet e përkthyesit, për këtë arsye është e nevojshme që të identifikojmë disa të dhëna që mund të gjejmë në kopertinë, parathënie e pasthënie, figurat (nëse këto janë pjesë e varianteve të përkthyera në shqip), shënimet e

[125] S. Laviosa (2002) *Corpus-based Translation Studies: Theory, Findings, Applications*. Rodopi B. V., Amsterdam, New York, fq. 33.

[126] R. Weissbrod (1996) në *Curiouser and Curiouser: Hebrew Translations of Wordplay in 'Alice's Adventures in Wonderland'. Wordplay and Translation.* St.Jerome Publishing: Manchester, fq. 223-224) shprehet se në kohën që u botua, ky ishte libri që gëzonte më shumë famë nga librat për fëmijë, kryesisht sepse nuk kishte qëllime moralizuese, gjë që e dallonte nga gjithë librat për fëmijë të kohës dhe për këtë arsye i tërhiqte shumë fëmijët. Ndërkohë, në ditët e sotme, të rriturit e lexojnë këtë libër më shumë se fëmijët sepse këta të fundit janë shumë të rrethuar nga materiale pamore lehtësisht të kapshme, gjë që e largon vëmëndjen e tyre nga të lexuarit e përqendruar. Kjo ka bërë që libri sot të lexohet gjerësisht nga të rinjtë dhe të rriturit, pra, që vepra të funksionojë brenda sistemit të letërsisë për të rritur.

përkthyesve dhe t'i krahasojmë me origjinalin dhe ndërmjet tyre sepse të gjitha këto na tregojnë pjesërisht qëndrimin e përkthyesit ndaj veprës si dhe na japin mundësi të hamendësojmë nëse vepra u drejtohet fëmijëve apo të rriturve si dhe shkallën e "besnikërisë" që shfaqin përkthyesit ndaj origjinalit dhe publikut marrës (duke qënë të vetëdijshëm për konceptin e diskutueshëm të besnikërisë në përkthim). Kemi kërkuar dhe kemi gjetur pesë variante në gjuhën shqipe, cilësitë e së cilave po i përshkruajmë më poshtë.

Varianti i parë është botuar në Tiranë në vitin 1944 nga shtëpia botuese *Tirana* me *botonjës Ismail Mal' Osmani*. Në kopertinë shënohet emri i autorit siç shkruhet në anglisht *Lewis Carroll,* titulli i librit *Liza në Botën e Çudinavet* si dhe shënimi *Përkthyer prej origjinalit nga Hysejn Çela dhe Beqir Çela* (shënim ky që përsëritet edhe në pjesën e brendshme të librit së bashku më shënimin tjetër *Të drejtën e ri-botimit e ruejnë përkthyesat*). Më pas jepet përmbajtja me *XII Kaptina* dhe numrin përkatës të faqeve. Përmbajtja jepet në fillim dhe jo në fund të librit, gjë që dëshmon për afërsinë e variantit të përkthyer me origjinalin, madje edhe mënyra grafike e përfaqësimit të ndarjes në kapituj është krejtësisht si në origjinal: numri i kapitullit me gërma romake, titulli i kapitullit dhe numri i faqes. Titujt e dhënë në këtë pasqyrë përputhen me titujt në fillim të çdo kapitulli. Në fund të përmbajtjes jepet në kllapa shënimi i përkthyesve *Në faqen mbrapa kësajë do të gjeni* ***spjegimet e fjalëve me dy kuptime***, gjë që është shumë e rëndësishme jo vetëm për këtë variant të përkthyer, por edhe në krahasimin me variantet e tjera, sepse ky është varianti i vetëm që përmban një tabelë që sqaron nënkuptimet e emërtimeve.[127] Në faqen nr.7 dhe 8 gjejmë një *Parathânje* mjaft të vlefshme të shkruar nga vetë përkthyesit, ku ata, pasi njohin faktin se vepra është një kryevepër në *letërsinë fëminore* anglo-saksone, shkëputin një pjesë të parathënies së një botimi amerikan të shkrimtares *Anna Eleonor Roosevelt - "si përrallëz,* ***fëmijët*** *e çdo gjenerate kanë gjetë në Lizën të vërteta dhe marrina të blueme e të gërshetueme aq bukur, sa me mbetë përherë të kënaqun prej tyne; por kur fillojmë* ***të rritemi*** *dhe të lexojmë në tê disa nga kuptimet mâ të holla, që përmban mbi politikën dhe jetën përgjithësisht, e shijojmë ndoshta edhe mâ tepër..."*.[128] Për këto arsye, shprehen përkthyesit, "*prej shumë kohësh e kishim quejtë nji punë të dobishme përkthimin e Lizën në gjuhën t'onë, kështu-që edhe fëmijët Shqiptarë të mund të kishin në dorë nji libër të kandshëm dhe të përshtatun nga çdo pikëpamje për moshën dhe kërkesat e mendjeve të tyre në formim e sipër"*.[129] Përkthyesit përmendin faktin se punën për përkthim e patën nisur para shumë vjetësh por u desh të kalonte shumë peripeci të ngjashme më vetë Lizën derisa u botua.[130] Është me rëndësi të përmendim se përkthyesit japin më poshtë edhe një *justifikim të nevojshëm*, faktin se origjinali është shkruar në një gjuhë fëminore angleze dhe kjo përbën një vështirësi *për me e përkthye në nji* ***gjuhë fëminore Shqipe***. Para botimit të variantit përfundimtar, përkthyesit kanë bërë shumë *prova* duke lexuar pjesë të përkthyera në klasa të ndryshme të shkollave fillore të vendit, megjithatë shfajësohen për vështirësi ose mungesë

[127] Këto të dhëna do t'i riprodhojmë në çështjen mbi përkthimin e lojërave të fjalëve.

[128] L. Carroll (1944) *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë, fq. 7.

[129] Po aty, fq. 8.

[130] Ja si shprehen përkthyesit *"Nji herë priti për disa vjet, në Ministrin' Arsimit të Morandit, radhën e shqyrtimit, derisa mâ në fund i qe dhânë Zotit Prof. Kostaq Cipo, i cili – e kemi për detyrë t'a themi – jo vetëm nuk e vonoi, por, mbassi e gjeti të përshtatshëm, pat rekomandue që të botohej shpejt. Vijoi, pastaj, nji tjetër periudhë pritjeje, pse shpërblimi që na ofrohej ishte krejt qesharak në krahasim me mundin e përkthimit, e na vetë nuk ishim në gjendje me përballue shpenzimet e shtypit. Por desh Zoti e mâ në fund, mbassi pat dhânë edhe Ministrija e Kulturës Popullore pëlqimin e sajë, ramë n'ujdi me Shtëpinë Botuese 'Ismail Mal'Osmani' të Kryeqytetit, e cila kujtojmë se âsht përpjekë të nxjerri nji botim me çmim të lirë dhe të shtypun pastër e me kujdes".* (Po aty, fq. 8)

rrjedhshmërie që mund të gjenden në gjuhën e tekstit. Në fjalët e fundit ata përmendin krenarinë e tyre për faktin se kanë sjellë në duart e lexuesve *të **vegjël*** një dhuratë të rallë siç është *Liza në Botën e Çudinavet,* meqenëse *letërsia fëminore në Shqipní âsht dhimbsunisht aq e vorfën , sa me e meritue të përfillet si e paqênë. Prandej, punëtorët e ksajë lâme kujtojmë se meritojnë njifarë **miradije**, ose, të paktën nji gjykim të zbutun mbi vlerën e punës së tyre.*[131]

Bazuar në këtë parathënie mund të parakuptojmë një sërë gjërash edhe pa nisur të lexojmë më tej përkthimin: vepra në origjinal u drejtohet si fëmijëve edhe të rriturve, ndërsa përkthyesit e përmendin disa herë se *Liza* u drejtohet lexuesve të vegjël, libri është përshtatur për formimin mendor të fëmijëve, janë bërë përpjekje për të përdorur një gjuhë fëminore shqipe, etj. Me rëndësi është të vemë në pah edhe faktin se përkthyesit kërkojnë të ndërgjegjësojnë lexuesit për vështirësitë në punën e tyre (si praktike ashtu edhe materiale) si dhe të fitojnë mirënjohje për përkthimin e bërë. Gjithashtu, theksohen edhe kontributi që sjell vepra e përkthyer në letërsinë për fëmijë në Shqipëri si dhe disa nga vështirësitë me të cilat janë përballur përkthyesit gjatë sjelljes së veprës në gjuhën shqipe.

Vepra në brendësi përmban 20 figura – të gjitha janë ilustrime origjinale të Tenielit – kundrejt 41 figurave në veprën origjinale. Theksojmë se të gjitha figurat e pranishme në libër janë ilustrime origjinale (përfshirë edhe figurën e kopertinës). Gjithashtu libri ndahet në dymbëdhjetë kapituj, ashtu si dhe në origjinal.[132] Vjersha që ndodhet në origjinal (që shërben si parathënie e gjithë ngjarjeve që do të rrëfehen në libër) nuk është përkthyer në këtë variant. Ndarja në paragrafe brenda kapitujve ruhet kryesisht si në origjinal.

Në faqen e parë të **variantit të dytë** kemi këto të dhëna: emrin e shkrimtarit *Levis Karoll,* titullin të shkruar me gërma të mëdha *LIZA NE BOTEN E ÇUDIRAVE*, shënimin *Përkthyer prej origjinalit nga Maqo Afezolli* si dhe *Tiranë, 1961* (në faqen prapa ballinës shohim se është botuar nga shtypshkronja *Mihal Duri* në 5000 kopje). Më tej vjen parathënia (në faqet 3-4) e shkruar jo nga vetë përkthyesi i veprës, por nga *Bedri Dedja.* Që në titullin e parathënies lexojmë *Një libër i dashur **për fëmijë*** ku libri prezantohet si një *dhuratë e bukur* që iu bëhet fëmijëve nga ndërmarrja shtetërore e botimeve "Naim Frashëri". Bedri Dedja rrëfen fillimisht historinë se si është krijuar kjo *vepër e dashur **për fëmijë*** nga ***Levis Karoll .***[133] *Bedri Dedja* shkruan më tej se *në këtë përrallë fantastike bëhet për ëndrrën e bukur të çupës së vogël Liza, e cila bën një udhëtim interesant në botën e çudirave ... nga gjithë ky udhëtim interesant Liza mëson shumë gjëra dhe bëhet në fund të fundit një çupë e zgjuar. Në fund të udhëtimit ajo bindet, se në këtë jetë nuk ka gjë më të bukur se bota jonë e vërtetë, se shkolla dhe familja, se puna dhe mësimi... Këto pra, janë mësimet që na jep libri i bukur i Levis Karollit "Liza në botën e çudirave", i cili edhe sot e kësaj dite ka mbetur si një nga veprat e letërsisë klasike për fëmijë.* Kështu mbyllet parathënia, duke na lënë të kuptojmë se përkthimi u drejtohet fëmijëve, dhe duke

[131] Po aty, fq. 8.

[132] Për titujt dhe përkthimin e tyre do të diskutojmë në fund të kësaj nënçështjeje dhe të dhënat do t'I paraqesim në mënyrë krahasimore për të pesë vriantet nëpërmjet tablelës *Përkthimi i titujve të kapitujve.*

[133] Duhet të themi se historia që rrëfehet këtu, në fakt, nuk është tërësisht e vërtetë. Bedri Dedja na thotë se Kerrël e pati takuar Lizën në rrugë një ditë, Liza i pati kërkuar një përrallë dhe pas disa ditësh ai i dha Lizës një fletore më një shkrim të qartë e të këndshëm që titullohej "Liza në Botën e Cudirave" (?!). E kemi përmendur se fillimisht historinë Kerrël ia pati rrëfyer Lizës gjatë një shëtitjeje me varkë dhe pastaj ia dha me shkrim dore si një dhuratë për Krishtlindje. Për më tepër, shkrimi i tij nuk ishte as i bukur dhe as i qartë. Në parathënie përmendet gjithashtu se Kerrël vdiq dhe nuk mësoi gjë për fatin e veprës dhe kjo u dha për botim nga vetë Liza në moshë të kaluar. Duhet të themi se kjo është krejtësisht e gabuar. Libri u botua që në gjallje të Kerrël, madje ai ishte vazhdimisht i shqetësuar edhe për faktin se libri ishte shumë i shtrenjtë dhe fëmijët nuk kishin mundësi ta blinin e ta lexonin.

në dhënë një mesazh moralizues krejtësisht të panevojshëm (parë me syrin e sotëm) e që nuk përmbahet kurrsesi në veprën origjinale, përkundrazi, e kemi thënë tashmë që *Alice's Adventures in Wonderland* ishte një vepër që doli kundër gjithë qëndrimeve didaktike e moralizuese të kohës dhe për këtë arsye fëmijët e pëlqyen së tepërmi (qëndrimet didaktike dhe moralizuese duken më së miri në paroditë e pranishme në vepër). Nuk përmendet në parathënie asgjë mbi statusin e papërcaktuar të veprës, duke theksuar edhe një herë mendimin se ky përkthim iu drejtohet fëmijëve. Nuk gjejmë asnjë koment në parathënie lidhur me vështirësitë apo humbjet gjatë përkthimit të veprës, apo të dhëna për vetë përkthyesin. Përmbajtja e veprës jepet në faqen e fundit, ku shikojmë se vepra e përkthyer përmban shtatëmbëdhjetë kapituj, kundrejt dymbëdhjetë kapitujve të origjinalit. Një lexim i kujdesshëm tregon se nuk është respektuar fillimi dhe mbarimi i kapitujve si në origjinal, si dhe janë ndërfutur disa kapituj nga *Through the Looking Glass* (vazhdimi i *Alice's Adventures in Wonderland*), gjë që nuk duhet të kishte ndodhur pasi numri 12 është i rëndësishëm për Kerrëlin (të dy librat kanë nga 12 kapituj secili), ose, të paktën, të ishte përmendur një dukuri e tillë në parathënie. Nga ana grafike është ruajtur, ashtu si edhe në variantin e parë, paraqitja e kapitujve si në origjinal: numër romak, titulli, numri i faqes. Duhet të përmendim gjithashtu se ka disa ndryshime nga paraqitja e titujve në pasqyrën e lëndës dhe, nga ana tjetër, titujt e kapitujve në brendësi të veprës, të cilat do t'i rendisim më poshtë, në vazhdimësi të tabelës nr.1, së bashku me mospërputhjet e vërejtura për variantet e tjera. Në brendësi të librit gjejmë 45 figura kundrejt 41 në origjinal: duhet thënë se figurat nuk riprodhohen gjithmonë në atë pjesë të tekstit ku shfaqen në tekstin origjinal, 16 nga 45 figura i përkasin *Through the Looking Glass* (këto herë vendosen në pjesë të *Alice's Adventures in Wonderland* dhe herë në kapitujt që i përkasin *Through the Looking Glass* – kapitujt e ndërfutur) dhe 29 nga 45 figura janë të tekstit origjinal. Gjithashtu, figurat duket të jenë rikrijuar sipas figurave që shfaqen në origjinal sepse nuk kanë nënshkrimin e Tenielit dhe nuk janë të punuara në imtësi.

Varianti i tretë paraqet në kopertinë një pamje të një vajze të vogël (nuk është aspak e ngjashme me ilustrimet origjinale të *Tenniel*) duke parë në një qiell të errët të rrethuar nga yje. Në krye jepet emri *Ljuis Kerël* dhe më poshtë titulli me gërma të mëdha *LIZA NË BOTEN E ÇUDIRAVE,* si dhe *Shtëpia Botuese Mesonjetorja.* Në ballinë shkruhet përsëri shkrimtari, titulli *Liza në botën e çudirave* si dhe, poshtë titullit, *Përktheu: Maqo Afezolli*, e, më poshtë *Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja", Tiranë, 1998.* Parathënia *E fshehta e botës së çudirave* është shkruar nga *Naum Prifti* në faqet 3-9. Që në fillim Prifti përmend se vepra u bë dalëngadalë një nga më të përhapurat në letërsinë angleze **për fëmijë**, dhe, *si çdo vepër e mirë e letërsisë për fëmijë, ajo filloi të tërhiqte vëmendjen e* ***të rriturve*** *dhe të lexohej me dëshirë dhe prej tyre.* Prifti përmend gjithashtu se letërsia e shek. XIX u shkëput nga *kërkesat didaktike e moralizimet e drejtpërdrejta* dhe se merita e veprës në letërsinë për fëmijë ka të bëjë me *zbulimin e një bote të jashtëzakonshme e të zakonshme nga vetë fëmijët.* Më pas jepen të dhëna në lidhje me Kerrëlin, aftësitë e tij krijuese, dëshirës për të qëndruar me fëmijë e për t'i fotografuar ata. Pasi na informon saktë edhe në lidhje me historinë e krijimit të veprës origjinale gjatë një shëtitjeje me varkë të autorit me të tria vajzat Lidëll, Prifti zhbiron arsyet e suksesit të veprës, zbulon disa parodi (krijimet poetike të kohës) dhe satira (skena e gjyqit), kundërsense e ilogjizma, kalimet nga bota e vërtetë në botë fantastike si dhe gërshetimin e fantazisë me humorin. Edhe Prifti duket se ngatërrohet në kundërthëniet e Lizës dhe e keqkupton qëndrimin e autorit duke qenë se edhe ai nuk i shpëton qëndrimit moralizues kur shprehet se *Lizën, siç e tërheq kureshtja për të zbuluar çdo cep të botës së çudirave, po aq shumë e bren edhe meraku për detyrat që duhet të zgjidhë, e merr malli për njerëzit e afërm...,* ndërkohë që duhet të kuptojmë se gjithë qëndrimi i Lizës ndaj shkollës apo ngjarjeve fantastike është thjesht ironi e sarkazëm. Në fund të parathënies lexojmë *Është*

e kuptueshme se përkthimi i veprave humoristike pëson humbje, po megjithatë, edhe kështu na jepet mundësia të shijojmë humorin dhe talentin e njërit prej autorëve të shquar të letërsisë botërore për fëmijë.[134] Naum Prifti që në fillim të parathënies na njeh me faktin se vepra lexohet si nga fëmijë edhe të rritur, megjithatë nënkuptohet se ky përkthim u drejtohet kryesisht fëmijëve. Vetëm rrjeshtat e fundit të parathënies na lenë të kuptojmë se vepra përmban humor dhe si e tillë do të pësojë humbje, por qëllimi është të njohim dhe shijojmë talentin e autorit origjinal, kështu që një farë humbjeje do të duhet të tolerohet. Kështu, ndër qëllimet e kësaj parathënieje, ndonëse të shkruar jo nga vetë përkthyesi, përmendim informimin e lexuesve, vështirësitë në përkthimin e disa llojeve të veçanta zhanresh si dhe humbjet e pashmangshme gjatë përkthimit. Përmbajtja jepet në fund të veprës, ku kuptojmë se ka gjithsej 12 kapituj ashtu si edhe në origjinal (pra, janë hequr pjesët e shkëputura nga *Through the Looking-Glass* të përfshira në variantin e dytë). Titujt e dhënë në përmbajtje përputhen me titujt në fillim të çdo kapitulli. Rikujtojmë se varianti i dytë dhe i tretë është punuar nga i njëjti përkthyes, kështu që ngjashmëritë janë të shumta mes dy varianteve, megjithëse, një shqyrtim më i hollësishëm tregon se në këtë variant përkthyesi nuk pasqyron rreptësisht ndarjen e paragrafëve ashtu si në origjinal ose në variantin e vitit 1961. Ky variant nuk ka asnjë figurë, gjë që e largon edhe më shumë nga origjinali.

Varianti i katërt jep në kopertinë emrin e shkrimtarit *Ljuis Kerël*, titullin *Liza në botën e çudirave* dhe shtëpinë botuese *Botimet Vëllezërit Tafa.* Ilustrimi në kopertinë nuk të sjell ndërmend asgjë nga vepra origjinale, është një ilustrim shumëngjyrësh, që paraqet një pamje me disa shtëpi natën, yje ngado, dhe dy krijesa shumë të çuditshme (për dikë që e ka lexuar veprën origjinale dhe i njeh mirë personazhet). Paraqitet një lepur që nuk ka asgjë të përbashkët me pamjen aristokratike të Lepurit të Bardhë (që është edhe arsyeja kryesore pse Liza çuditet kur e shikon Lepurin për herë të parë), dhe një vajzë të vogël me një kostum gati qesharak nëse kemi parasysh Lizën në ilustrimet e Tenielit (fustanin me dantella dhe këpucët elegante – veshje tipike viktoriane) dhe me një paruke që më shumë të sjell ndërmend Kokëkashtën. Mund të themi se kjo figurë na shpie në një botë çudirash por jo në Botën e Çudirave të Kerrël, aq më tepër që në brendësi të veprës nuk ka asnjë figurë tjetër, që do të thotë se imazhet e krijuara nga kopertina do të ngelen në mendjen e lexuesve dhe do të identifikojnë dy prej personazheve më të rëndësishëm. Që këtu mund ta kuptojmë se do të ketë një mungesë koherence mes ngjarjeve të rrëfyera në brendësi të veprës që pasqyrojnë një kontekst britanik, largësi në kohë dhe në hapësirë me tekstin origjinal dhe mesazhit që na përcillet nga kopertina – kontakti i parë me veprën. Në ballinë ndodhet shënimi *Kolana Kryeveprat e letërsisë botërore* ***për fëmijë –*** pra, ky përkthim iu drejtohet lexuesve të vegjël (gjë që kuptohej edhe nga kopertina). Në faqen tjetër lexojmë ***Përkthyer*** *nga Taulant dhe Eri Tafa, Diplomuar në Universitetin e Bolonjës, © Të drejtat janë të rezervuara ....* dhe po në të njëjtën faqe *Letërsi e sotme për fëmijë ...* ***Shqipëruar*** *nga Taulant dhe Eri Tafa ....* ***përkth.*** *Taulant dhe Eri Tafa,* dhe në faqen tjetër *Ljuis Kerël, Liza në botën e çudirave,* ***Përkthyer*** *nga Taulant dhe Eri Tafa, Diplomuar në Universitetin e Bolonjës.* Mund të shikojmë se si kalohet nga *përkthej* në *shqipëroj* pa i dhënë rëndësi dallimit mes këtyre termave. As në fillim dhe as në fund nuk ka një përmbajtje të veprës me titujt e kapitujve dhe me numrin e faqeve, gjë që dëshmon për një largësi me veprën origjinale, megjithatë është ruajtur numri i kapitujve – gjithsej dymbëdhjetë. Pothuajse në mbarim të çdo kapitulli dhe para fillimit të kapitullit pasardhës, lihet një faqe bosh dhe shkruhet *Botimet Vëllezërit Tafa – Ne sjellim vetëm vlera...,* gjë që sërish dëshmon për një largësi të përkthimit nga origjinali. Parathënie nuk

[134] L. Kerël (1998) *Liza në Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Shtëpia Botuese 'Mësonjëtorja': Tiranë, fq. 9.

ka, pra, mungojnë komentet që do të mund të na informonin në lidhje me autorin, statusin e veprës origjinale, komentet mbi vështirësitë gjatë përkthimit etj. Disa nga komentet e përkthyesve në lidhje me përkthimin e kësaj vepre dhe orientimin e përkthyesve ndaj përkthimit në përgjithësi mund t'i lexoni në fund të këtij punimi, në pjesën shtojcat, Shtojca nr. 3.

Varianti i pestë titullohet *Liza në botën e çudirave* dhe në kopertinë gjejmë këto të dhëna përveç titullit: emrin e shkrimtarit *Luis Kerol* dhe gjininë *novelë*. Në faqen më tej zbulojmë përkthyesin *Frederik Shuraja,* si dhe shtëpinë botuese dhe vitin e botimit - Redona, Tiranë 2008. Libri ka në kopertinë një ilustrim shumëngjyrësh (jo nga ilustrimet origjinale) që na njeh me tre personazhe: Liza, maçoku dhe lepuri. Nuk jepet as në fillim dhe as në fund përmbajtja e lëndës me titujt e kapitujve, megjithatë, në brendësi të veprës, kuptojmë se, ashtu si edhe origjinali, ky variant përmban 12 kapituj, për titujt e të cilëve do të diskutojmë më poshtë. Nga fq. 3 deri në fq. 7 jepet parathënia. Në fund, fq. 152-165 janë renditur 34 *shënime të përkthyesit.* Në faqet e fundit 166-171 jepen një sërë ushtrimesh që e ftojnë lexuesin në një *studim të thelluar.* Përkthyesi na njeh me faktin se vepra origjinale përmban një sërë lojërash fjalësh gjë që përbën jo vetëm vështirësi gjatë përkthimit, por edhe interes të veçantë. Që në fillim të parathënies, përkthyesi vetështron pyetjen "*Përse edhe një përkthim tjetër i Lizës"*dhe më pas na sjell këtë përgjigje "*Problemi është se përkthyesit e 'Lizës' i janë përmbajtur më tepër variantit të tyre të ritregimit, përshtatjes, rikrijimit. Këto përkthime, megjithëse janë sjellë në gjuhë më të gjallë se origjinali, kanë një problem: Keroli nuk ka shkruar 'këtë Lizë'. Ndaj qëllimi im është të sjell në gjuhën shqipe një* ***përkthim sa më të saktë****, kuptohet aq sa lejojnë ndryshimet e gjuhës angleze me atë shqipe".*[135] Misioni i përkthyesit, pra, është që të na sjellë në duart tona ***një përkthim sa më të saktë*** brenda mundësive që i lejon gjuha shqipe dhe ndryshimet e saj me anglishten. Mbetet për t'u diskutuar fakti se përse përkthyesi iu referohet përkthyesve të mëparshëm duke theksuar se ata kanë sjellë një "Lizë tjetër" në duart e lexuesve dhe gjithashtu, çka është edhe më me rëndësi për diskutimin tonë, çfarë nënkupton ai me "përkthim sa më të saktë". Më tej ai shprehet "*Natyrisht, vështirësia më e madhe qëndron te përkthimi i lojës së fjalëve...Në përkthimet e tjera, përkthyesit kanë synuar të mos i përkthejnë lojërat e fjalëve, por të japin variantin e tyre, që nuk ka asgjë të përbashkët me origjinalin. Kam synuar, si rregull, të ruaj variantin e autorit, qoftë edhe pjesërisht."*[136] Nuk është shumë e qartë se pse përkthyesi mendon se mospërkthimi i lojërave të fjalëve përbën një shmangie nga *përkthimi* ***i saktë***, në fund të fundit, edhe vetë përkthyesi në fjalë tregohet kontradiktor kur thotë se synon të ruajë variantin e origjinalit, por një gjë e tillë nuk është gjithmonë e mundur. Vështirësi të tjera që përkthyesi ka hasur përmenden prej tij në vazhdim të parathënies, si, për shembull, përkthimi i vargjeve (parodive) të cilat përkthehen saktë, ndërsa vargjet e parodizuara jepen me shënime. Përkthyesi na shpjegon se në disa raste *ka qenë i detyruar të shmanget nga përkthimi i saktë i tekstit të Kerolit,* raste që kanë të bëjnë me përkatësinë gjinore si dhe përdorimin e përemrit "ju" në raste politese. Përkthyesi, pra, nëpërmjet parathënies, na njeh që në fillim me arsyen e përkthimit të tekstit origjinal (sjellja në gjuhën shqipe e një përkthimi sa më të saktë) dhe, njëkohësisht, na bën të ditur problemet gjatë procesit të përkthimit të veprës origjinale (përkthimi i lojërave të fjalëve, parodive, etj.) duke theksuar vazhdimisht *përkthimin e saktë* dhe rastet kur i është dashur t'i shmanget një përkthimi të tillë. Pavarësisht faktit se nuk janë të qarta kriteret për përcaktimin e një përkthimi të saktë apo vetë cilësimit *përkthim i saktë* që le vend për diskutim, nuk përmendet publiku të cilit i drejtohet ky përkthim – fëmijët apo të rriturit. Mendojmë se përkthimi u drejtohet

[135] L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 3.
[136] Po aty, fq. 8.

njëkohësisht të rriturve dhe fëmijëve. Kjo për arsye se në fund të librit jepen një sërë shpjegimesh për lojërat e fjalëve dhe paroditë, gjë që do të ishte krejt e panevojshme për lexuesit-fëmijë dhe kërkon vëmendjen dhe përqëndrimin e të rriturve. Megjithatë, pas këtyre shënimeve, në faqet që vijojnë në përmbyllje të përkthimit, jepet rubrika *Studim i thelluar* që rendit një sërë ushtrimesh reflektuese mbi tekstin, punësh të pavarura, teknika të tilla si klaster, breinstorming, diagrami Ven, etj., gjë që, pikësëpari, e largon shumë përkthimin nga qëllimet e origjinalit (Kerol nuk ka shkruar këtë "Lizë" didaktizuese), dhe, së dyti, e kanalizon librin si një vepër për fëmijë, deri diku, me qëllime didaktike.

Le të hedhim edhe një vështrim krahasues mbi ndarjen e varianteve në gjuhën shqipe në kapituj dhe titujt përkatës, duke i krahasuar ato me origjinalin. Theksojmë se asnjëherë nuk është e udhës të nënvlerësohet titulli i tekstit, duke e quajtur atë si gjë të dorës së dytë; *titulli është kartëvizita e çdo teksti dhe pjesë përbërëse e tij*.[137] Titujt janë shumë domethënës për Kerrëlin, shpesh herë përfaqësojnë një sintezë të ngjarjeve, e herë të tjera lojëra fjalësh. Në tabelën nr. 1 do të pasqyrojmë titujt e kapitujve dhe do të bëjmë krahasime mes pesë varianteve.

[137] Gj. Shkurtaj (2008) *Si të Shkruajmë Shqip.* Botimet Toena: Tiranë, fq. 85.

Tabela 1
Përkthimi i titujve të kapitujve në variantet në gjuhën shqipe të *AAiW*

Varianti / Titulli i kap.	*V.I*	*V.II*[138]	*V.III*	*V.IV*	*V.V*
Down the rabbit-hole	Përmes gropës së Lepurit	Përmes gropës së lepurit	Përmes gropës së lepurit	STROFKA E LEPURIT	Poshtë strofkës së lepurit
The pool of tears	Pellgu i lotëvet	Pellgu i lotëve	Pellgu i lotëve	LIQENI I LOTËVE	Pellgu me lot
A caucus-race and a long tale	Nji ndeshje vrapimi dhe nji histori e gjatë	Një ndeshje vrapimi	Gara e vrapimit Kokus dhe një histori e gjatë	VRAPIMI LËMSH DHE TREGIMI PA FUND	Vrapimi në rreth dhe historia e gjatë
The rabbit sends in a little bill	Lepuri urdhnon!	Në shtëpinë e lepurit	Në shtëpinë e Lepurit	NJË DETYRË PËR LEPURUSHIN	Billi i vogël fluturon në oxhak
Advice from a caterpillar	Këshilla nga Krymbi	Këshilla e krimbit	Këshilla e Vemjes	KËSHILLAT E VEMJES	Këshilla nga një vemje
Pig and pepper	Thí e spec	Derri, piperi dhe macja "Qeshir"	Derri, piperi dhe macja Qeshire	DERRKUCI DHE PIPERI	Derrkuci dhe piperi
A mad tea-party	Nji gosti e çmendun	Një gosti të çmëndurish	Një gosti të marrësh	ÇAJI I TË ÇMENDURVE	Një pirje çaji e marrë
The queen's croquet-ground	Sheshi i Doçevet	Sheshi i lojës së mbretëreshës	Sheshi i lojës së Mbretëreshës	MBRETËRESHA LUAN HOKEJ	Loja kroket e Mbretëreshës
The mock turtle's story	Historija e Breshkës së Ndrrueme	Historia e breshkës së ndryshuar	Historia e Breshkës së Rreme	HISTORIA E BRESHKËS SË GËNJESHTËRT	Tregimi i Breshkës së Rreme
The lobster-quadrille	Vallja e gaforrevet	Vallja e gaforreve	Vallja e Gaforreve	VALLJA E ARAGOSTAVE	Vallja e detit
Who stole the tarts	Kush i vodhi biskotat?	Kush i vodhi biskotat?	Kush i vodhi biskotat?	KUSH I VODHI TORTAT	Kush i vodhi byrekët
Alice's evidence	Dishmija e Lizës	Dëshmia e Lizës	Dëshmia e Lizës	DËSHMIA E LIZËS	Liza jep dëshminë

[138] Po paraqesim vetëm titujt e kapitujve që përputhen me ndarjen në kapituj të origjinalit, edhe pse, siç e kemi vënë në dukje, ky variant përmban gjithsej shtatëmbëdhjetë kapituj.

Në lidhje me **variantin e parë,** kemi vërejtur këto raste ku ka mospërputhje mes titullit të dhënë në përmbajtje (dhënë në tabelën nr. 1) dhe titullit në krye të çdo kapitulli: Lepuri urdhnon (pa pikëçuditëse), Sheshi i Doçeve (pa "t" në fund) dhe Kush i **v**odhi Biskotat? ("vodhi" shkruar me shkronjë të vogël). Ndër mospërputhjet e vërejtura në **variantin e dytë** përmendim titujt: "NË SHTËPINË E LEPURIT **V**" ku, meqenëse është shkruar me shkronja të mëdha dhe nuk ka pikë pas shkronjës, krijohet ideja sikur i referohemi lepurit të pestë (V), "**DERRI PIPERI** DHE MACJA QESHIRE", ku nuk është vendosur presja pas "DERRI" dhe duket sikur "DERRI PIPERI" është emri dhe mbiemri i derrit sepse i përmbahet logjikës së emërtimit të personazheve në Botën e Çudirave, "NJË GOSTI TË ÇM**E**NDURISH" (në përmbajtje shkruhet "çmëndurish"), HISTORIA E BRESHKËS S**E** NDRYSHUAR (s**ë**) dhe VALLJA E GAFO**R**EVE (gafo**rr**eve). Në fillim të çdo kapitulli të **variantit të tretë** jepet numri në gërma romake dhe titulli me shkronja të mëdha. Ne jemi mbështetur në përmbajtjen e lëndës (fq. 153) për të dalluar përdorimin e shkronjës së madhe. Nuk vemë re mospërputhje nga ana grafike në këtë variant. ***Varianti i katërt*** në kopertinë dhe në ballinë ka të shkruar "Liza në botën e çudirave", 12 ndarjet i emërton "kapituj" dhe titujt janë shkruar me shkronja të mëdha. As në fillim dhe as në fund nuk ka përmbajtje, kështu që nuk mund të vërejmë mospërputhje. Po kështu, edhe në variantin e pestë nuk ka përmbajtje, prandaj nuk mund të flasim për mospërputhje, pasi titujt jepen vetëm në fillim të çdo kapitulli.

Siç mund ta vini re, në tabelën nr. 1 kemi hijëzuar titullin *The Rabbit Sends In A Little Bill* dhe përkthimet e tij në gjuhën shipe. Titulli në vetvete ngërthen një lojë fjalësh që nuk duhet nënvleftësuar nga përkthyesit dhe nga lexuesit. *Send in a bill* është një idiomë e gjuhës angleze që do të thotë "të urdhërosh dikë për të përmbushur një porosi"; njëkohësisht *Bill* është emri i zhapikut, pra, titulli mund të interpretohet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe figurativisht. Nëse do të përkthehej fjalë për fjalë, nuk do të ruhej dykuptimësia, gjë që duket se e kanë kuptuar përkthyesit në fjalë, sepse në variantin e parë ky kapitull titullohet *Lepuri urdhnon*, gjë që është në koherencë edhe me tekstin në brendësi kur Liza shprehet *Sa çudí më duket me u-urdhnue andej-këtej prej nji lepuri!*[139] Në variantin e dytë dhe të tretë këtë kapitull e gjejmë të titulluar *Në shtëpinë e Lepurit* gjë që është në koherencë me zhvillimin e ngjarjeve në brendësi të kapitullit (Liza ndodhet brenda shtëpisë së lepurit), por nuk arrihet të rikrijohet dykuptimësia e shprehur në origjinal. Në variantin e katërt vërejmë një mospërputhje mes titullit *Një detyrë për lepurushin* dhe zhvillimit të ngjarjeve për dy arsye: së pari, personazhi duhet të emërtohet *Lepur* që të identifikohet me *Lepurin e Bardhë* që shfaqet që në fillim të veprës, dhe, së dyti, sepse është Lepuri ai që urdhëron Lizën që duhet të kryejë detyrat që ai i jep, gjë që duket edhe në fjalët e Lizës *Është qesharake të bëhesh kamariere e një lepurushi!*[140] Edhe në variantin e pestë bëhet e mundur që, përmes titullit, të arrijmë të parakuptojmë zhvillimin e ngjarjeve në brendësi të kapitullit, por, sërish, humbet dykuptimësia e pranishme shprehur në titullin origjinal.

Një tjetër mospërputhje mes titullit dhe përmbajtjes e vërejmë në titullin e kapitullit të dytë në variantin e katërt *Liqeni i lotëve.* Liza tani është e dëshpëruar sepse ka rënë në *ujin e kripur,*[141] i duket sikur është *në det* [142] dhe pjesa çuditërisht titullohet *liqeni* i lotëve. Në kapitullin e tretë përmendet *Caucus-Race* në origjinal, ku termi *Caucus* nënkupton një takim të udhëheqësve të një grupi për të vendosur për një kandidat ose një

[139] L. Carroll (1944) *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë, fq. 38.
[140] L. Kerël (2008) *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë, fq. 42.
[141] Po aty, fq. 22.
[142] Po aty, fq. 23.

politikë të caktuar.[143] Edhe vetë gara simbolizon faktin se pjestarët e një komisioni vrapojnë shumë por nuk shkojnë askund. Pavarësisht aludimit që nuk është përcjellë as në brendësi të varianteve (garës personazhet i referohen si një *ndeshje vrapimi*, apo si një vrapim *Kokus*, a një vrapim *lëmsh* gjë që shfaqet edhe në titull), pjesa tjetër e këtij titulli i referohet lojës së fjalëve *tale-tail* për të cilën do të diskutojmë më gjatë në kreun e katërt, ku shembujt do të na shërbejnë për të reflektuar më thellë rreth marrëdhënies "formë-përmbajtje" – këtu po përmendim vetëm faktin se në variantin e katërt në titullin *Vrapimi lëmsh dhe tregimi pa fund* përmendet *tregimi pa fund* që në brendësi e gjejmë të emërtuar *histori pa fillim dhe pa mbarim.*[144] Ndërsa në variantin e pestë ekziston koherencë mes titullit dhe ngjarjeve në brendësi të kapitullit, meqenëse bëhet fjalë për një *vrapim në rreth* dhe *një histori të gjatë* (*ai vizatoi formën e rrethit… e vendosi gjithë skuadrën rrotull rrethit … të gjithë u mblodhën rrotull tij … të gjithë përsëri u mblodhën rrotull … na tregoni historinë tuaj).*[145] Mendojmë gjithashtu që ka një mospërputhje mes titullit në variantin e katërt *Çaji i të çmendurve* dhe mënyrës se si shprehet Liza *Është çaji **më i pështirë** që kam provuar ndonjëherë në jetën time*[146] kundrejt origjinalit *It's **the stupidest** tea-party I ever was at all in my life* [*the stupidiest* – më i, e marrë].[147] Në po këtë variant vemë re një mospërputhje mes titullit *Kush i vodhi **tortat*** dhe episodit që e përshkruan këtë veprim kur lexojmë *Mbretëresha e zemrave përgatiti **feta buke të thekura me gjalpë** në një ditë vere; por Kopuku i zemrave, i vodhi **bukët e thekura me gjalpë** dhe tashmë i ka ngrënë,*[148] gjë që nuk ka lidhje as me titullin dhe as me pjesët e tjera të rrefyera brenda sallës së gjyqit ku ndodhen personazhet. Mendojmë gjithashtu se ka një shmangie ndaj vlerave kulturore të origjialit në përkthimin e këtij titulli *Who stole the **tarts*** edhe në variantin e pestë, të përkthyer *Kush i vodhi **byrekët**.*

Pas këtij krahasimi të sipërfaqshëm mund të themi se, në mënyrë kronologjike, ashtu siç shfaqen njëri pas tjetrit edhe variantet e përkthyera, largësia me origjinalin fillon e theksohet gjithnjë e më shumë nga varianti i parë (me ndarje kapitujsh, përmbajtje, kopertinë dhe figura si në origjinal) deri në variantin e katërt (pa përmbajtje, kopertinë të ndryshme dhe pa asnjë figurë) dhe të pestë (shoqëruar me ushtrime që e ftojnë lexuesin në një studim të thelluar). Hamendësojmë se të pesë variantet në gjuhën shqipe, nisur nga të dhënat e mësipërme, iu drejtohen fëmijëve, pra nuk kemi (për veprat e përkthyera në gjuhën shqipe) status të papërcaktuar. Këto të dhëna janë të rëndësishme të kuptohen dhe të mbahen parasysh edhe gjatë analizave më të hollësishme që do të parashtrojmë në vazhdim të këtij punimi.

II.2.2 *Harry Potter and the Philosopher's Stone*

II.2.2.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Harry Potter and the Philosopher's Stone* (1997)

Përzgjedhja e kësaj vepre në kuadër të studimit tonë është shumë domethënëse. *Harry Potter and the Philosopher's Stone* është i pari ndër shtatë romane shkruar nga britanikja

[143] M. Gardener (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA, fq. 31.
[144] L. Kerël (2008) *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë, fq. 37.
[145] L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 33-35.
[146] L. Kerël (2008) *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë, fq. 95.
[147] M. Gardner (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA, fq. 78.
[148] Po aty, fq. 141.

Rouling (J. K. Rowling), e cila rrëfen lirshëm historitë dhe aventurat e një djali magjistar dhe miqve të tij në shkollën e magjistarëve.[149] Me miliona e miliona kopje janë shitur nga seria e librave Poter, jo vetëm në gjuhën angleze por në qindra gjuhë të botës në të cilat veprat janë përkthyer, një numër i lartë fansash ndjekin filmat e frymëzuar nga këto romane, duke përfshirë të vegjël e të mëdhenj në botën e mrekullueshme të magjisë.

Xhoanë Kethlin Rouling [Joanne K. (Kathleen) Rowling] lindi në 31 korrik 1965 në një familje angelze. Pasi mbaroi shkollën në vitin 1983, ajo shkoi në universitet dhe u diplomua në frëngjisht dhe letërsi klasike në 1986. Rouling filloi të shkruante rreth Heri Poterit - një djaloshi magjistar - në vitin 1990, dhe, siç shprehet vetë ajo, të gjitha hollësitë thjesht i erdhën ndërmend gjatë një udhëtimi me tren nga Mançesteri për në Londër. Pas disa vitesh ajo u largua për në Portugali ku do të jepte mësime në gjuhën angleze, duke punuar njëkohësisht edhe mbi dorëshkrimin e saj. Ajo u kthye sërish në Angli në vitin 1993, dhe u vendos në Edinburg me vajzën e saj të vogël, ndoshta kjo është edhe arsyeja pse ndonjëherë atë e njohin edhe si shkrimtare skoceze.

Rouling e mbaroi dorëshkrimin në vitin 1995, dhe pasi ai iu refuzua për botim nga disa shtëpi botuese, *Harry Potter and the Philosopher's Stone* u hodh në treg në vitin 1997 nën emrin *J. K. Rowling* në vend të *Joanne Rowling*, shkronja *K.* i përket gjyshes së Rouling me emrin Kethlin (Kathleen). Përdorimi i inicialeve bëri që të krijohej pak mister në lidhje me faktin nëse shkrimtarja ishte femër apo mashkull, meqenëse agjenti letrar i Rouling i druhej faktit nëse djemtë do t'i lexonin librat e një shkrimtareje femër.[150] Vepra u vlerësua nga kritikët dhe fitoi një sërë çmimesh letrare, si për shembull Çmimi Britanik i Librit për Librin për Fëmijë të Vitit [*British Book Awards' Children's Book of the Year (Bloomsbury 2009)*]. Pasi *Harry Potter and the Philosopher's Stone* u botua edhe në Amerikë në 1998, nën titullin *Harry Potter and the Sorcerer's Stone*, Rouling u shndërrua në një shkrimtare e cila po përmbushte synimet e saj. Nuk është e lehtë që të shpërfaqim gjithë arsyet e famës së *Harry Potter and the Philosopher's Stone.* Profesoresha Uendi Doniger (Wendy Doniger) e ka përshkruar Rouling si "një magjistare" e cila arrin të krijojë histori të reja nga pjesë të ricikluara të historive të vjetra.[151] Suksesi buron në një përzierje të veçantë brenda kësaj shkrimtareje, një përzierje e asaj që mund të parashikohet dhe asaj që nuk mund të pritet.

Fillimi i historisë është klasik: Harri Poter është një djalosh jetim dhe pa miq, që nuk e duan dhe e tallin në familjen që e ka adoptuar. Megjithatë, jeta e tij merr një kthesë krejtësisht të re kur ai zbulon që është magjistar dhe fillon studimet në shkollën e magjistarëve për të mësuar magjitë. Ai zbulon gjithashtu se prindërit e tij nuk e kanë humbur jetën në një aksident me makinë, por ishin vrarë nga magjistari të cilit i druhen të gjithë, Fluronvdekja. Sipas një profecie të mistershme, Fluronvdekja është përpjekur të mallkojë Harrin por nuk ia ka dalë dot dhe ka humbur fuqitë e veta. Meqenëse vetëm Harri i ka mbijetuar mallkimit, ai është i famshëm mes magjistarëve, por jo të gjithë e duan, sidomos mbështetësit e Voldemortit. Në veprën që ne kemi përzgjedhur, ndërtohen të dhënat bazë për historinë, prezantohet Harri dhe personazhet e tjerë, përshkruhen rregullat kryesore të botës së magjistarëve, lëndët që zhvillohen në shkollë, rregullat e lojërave sportive, etj. Harri dhe miqtë e tij, Roni dhe Hermiona, mësojnë rreth magjive dhe përfshihen në rreziqe kur përpiqen të zgjidhin misterin e gurit filozofal. Mendojmë se

---

[149] Shtatë romanet fillojnë me *Harry Potter and the Philosopher's Stone* (1997) dhe, brenda një dhjetëvjeçari plotësohen me botimin e veprave të tjera: *Harry Potter and the Chamber of Secrets* (1998), *Harry Potter and the Prisoner of Azkaban* (1999), *Harry Potter and the Goblet of Fire* (2000), *Harry Potter and the Order of the Phoenix* (2003), *Harry Potter and the Half-Blood Prince* (2005) dhe *Harry Potter and the Deathly Hallows* (2007).

[150] G . Beahm (2007) *Jästit ja taikuus: Harry Potterin ja J. K. Rowlingin tarina*. Helsinki: readme.fi.

[151] P. Hunt (2001) *Children's Literature*. Malden, Mass.: Blackwell Publishers, fq. 123.

këto të dhëna janë të mjaftueshme për studimin tonë, dhe po vazhdojmë më poshtë duke renditur ato aspekte të veprës që e bëjnë atë interesante nga pikpamja e përkthimit.

II.2.2.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe

Të gjithë librat e serisë Poter janë magjepsës: ata përmbajnë histori të ndryshme në lidhje me miqësinë e besnikërinë, por edhe aventura emocionuese dhe keqbërës të rrezikshëm. Librat, sipas Kolin Menlov (Colin Manlove), na tërheqin të gjithëve sepse përmbajnë humor, risi dhe magji.[152] Nuk mund të lemë pa përmendur edhe aftësitë e veçanta rrëfimtare të shkrimtares si dhe risitë gjuhësore që sjell ajo: krijimi i një sërë fjalëve të shpikura nga vetë ajo për të përshkruar sende dhe dukuri që ndodhin vetëm në botën magjike të krijuar prej shkrimtares. E, megjithatë, shkrimtarja Rouling, nuk ndalet me kaq: personazhet prezantohen në mënyrë krejt domethënëse njëri pas tjetrit me emra të veçantë e krejtësisht shprehës, duke nënkuptuar edhe rolin e tyre në ngjarjet në vepër si dhe interpretimin e tekstit në mënyrë të fshehtë. Kjo cilësi ka qenë arsyeja kryesore se pse ne kemi përfshirë romanin e parë të serisë Poter në korpusin tonë studimor. Gjatë leximit të veprës origjinale na ka tërhequr mënyra e emërtimit të personazheve, që iu lejon lexuesve të formojnë lehtësisht imazhe pamore në imagjinatën e tyre për identifikimin e personazheve dhe dallimin e tyre nga njëri-tjetri thjesht nëpërmjet emrit të tyre. Është me mjaft interest ë krahasojmë emrat në gjuhën angleze me ato në gjuhën shqipe për të përmbushur qëllime të ndryshme të studimit tonë. Së pari, të shikojmë nëse emrat janë përkthyer apo modifikuar në gjuhën shqipe, dhe, nëse thjesht janë transkriptuar, të hamendësojmë mbi arsyet e një vendimi të tillë nga ana e përkthyesit. Së dyti, për ato emra që janë përkthyer në gjuhën shqipe, të zbulojmë nëpërmjet cilave strategji janë sjellë në gjuhën shqipe emra domethënës të veprës origjinale dhe se deri në ç'masë është bërë e mundur të udhëtojë në faqet e librit në gjuhën shqipe ngarkesa semantike e emrit të personazhit në gjuhën angleze. Gjithashtu, duke e konsideruar përkthyesin si një lexues të tekstit origjinal, mund të themi se gjatë procesit të lexim-interpretimit, përkthyesit e lexojnë dhe interpretojnë tekstin origjinal duke synuar të zbulojnë mesazhet e fshehura të shkrimtarit origjinal. Në këtë drejtim, Xhorxh Shtajner shprehet se çdo lexim i një teksti është një veprim përkthimi, d.m.th. një interpretim. Ne përpiqemi të nxjerrim kuptimin e tekstit nga një sërë kuptimesh të mundshme, me fjalë të tjera, nga potenciali i kuptimit.[153] Studiuesja Kristianë Nord, në vazhdim të kësaj logjike, shprehet se ajo çka përkthehet në të vërtetë nuk është synimi i dërguesit (shkrimtari i veprës origjinale), por interpretimi që i bën përkthyesi synimit të dërguesit.[154] Ne na intereson të shohim nëse synimet e nënkuptuara të shkrimtares në emrat e personazheve arrijnë të jenë sërish të tilla për lexuesit e variantit në gjuhën shqipe.

Theksojmë se të shtatë romanet janë shumë të pasur në emra të shpikur prej shkrimtaresh dhe se studimi i të gjithave syresh do të ishte me shumë interes. Megjithatë, ne, në mënyrë përfaqësuese, e kemi kufizuar studimin tonë vetëm në romanin e parë të serisë, dhe, njëkohësisht, vetëm në identifikimin dhe, më pas, krahasimin e emrave të përveçëm të personazheve me emrat përkatës në gjuhën shqipe, duke diskutuar në mënyrë të veçantë për strategjitë e përcjelljes në gjuhën shqipe të emrave me ngarkesë semantike. Këto çështje do të gjejnë vend në brendësi të kreut të katërt, ku do të

[152] C. Manlove (2003) *From Alice to Harry Potter: Children's Fantasy in England*. Christchurch, N.Z.: Cybereditions, fq. 187.
[153] B. Hatim, I. Mason (1990) *Discourse and the translator*. London: Longman, fq. 10.
[155] C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explained.* Manchester: St. Jerome, fq. 85, 15)

diskutojmë rreth dukurisë së ndërtekstualitetit, më hollësisht, rreth përkthimit të nënkuptimeve shprehur nëpërmjet mënyrës së emërtimit të personazheve.

II.2.2.3 Të dhëna rreth variantit në gjuhën shqipe

Në kopertinën e variantit në gjuhën shqipe shohim të shkruar fillimisht emrin e shkrimtares – J. K. Rowling – si dhe titullin – Harry Potter dhe Guri Filozofal – ndjekur nga shtëpia botuese Dituria. Këto janë të dhënat që marrim nga kopertina dhe që riprodhohen edhe në faqen pas saj. Më në brendësi mësojmë emrin e përkthyesit, Amik Kasoruho si dhe titullin e veprës në origjinal, pra, nga e cila është bërë përkthimi në gjuhën shqipe (*Harry Potter and the Philosopher's Stone*). Jepet edhe emri i redaktores dhe realizues së paraqitjes grafike, përkatësisht Mariana Ymeri dhe Gerta Kambo. Njihemi gjithashtu me faktin se botimi i parë është bërë në janar 2002 dhe botimi i dytë në mars 2002. Tabela e përmbajtjes shfaqet në fund të veprës, ku shikojmë se, ashtu si edhe në veprën origjinale në anglisht, libri ka si pjesë përbërëse 17 kapituj, titujt e të cilëve mund t'i shohim në mënyrë përqasore në tablën nr. 2.

Tabela 2
Përkthimi i titujve të kapitujve në variantin në gjuhën shqipe të *Harry Potter*

Titulli origjinal	***Titulli në gjuhën shqipe***
The boy who lived	Fëmija që i shpëtoi vdekjes
The Vanishing Glass	Xhamat që zhduken
Letters From No One	Letra nga askush
The Keeper of the Keys	Roja i çelësave
Diagon Alley	Diagon Alli
The Journey From Platform Nine and Three-Quarters	Udhëtim nga binari 9 e ¾
The Sorting Hat	Kapela që flet
The Potions Master	Mësuesi i shurupeve
The Midnight Duel	Dyluftimi në mesnatë
Halloween	Hallouini
Quidditch	Kuidiçi
The Mirror of Erised	Pasqyra e dëshirave
Nicholas Flamel	Nikolas Flameli
Norbert the Norwegian Ridgeback	Norberti, dragoi kurrizrrudhosur i Norvegjisë
The Forbidden Forest	Pylli i ndaluar
Through the Trapdoor	Kapanxha
The Man With Two Faces	Njeriu me dy fytyra

Siç mund ta shikojmë edhe nga tabela, titujt qëndrojnë shumë afër mënyrës së shprehjes së tyre në origjinal. Njëkohësisht, një lexim dhe krahasim më i hollësishëm me origjinalin, tregon se titujt janë një sintezë e ngjarjeve brenda kapitujve, ashtu si edhe në origjinal. Varianti në gjuhën shqipe nuk përmban parathënie, pasthënie dhe as shënime nga ana e përkthyesit (as shënime në fund të faqes dhe as shënime sqaruese në fund të veprës së përkthyer).

II.2.3 *Robinson Crusoe (1719)*

II.2.3.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Robinson Crusoe*

Daniel Defo (Daniel Defoe) lindi në Londër në vitin 1660. Ai ishte djali i Xhejms Fo dhe Elis Fo, të cilët u detyruan të ndërronin fe dhe të ktheheshin në presbiterianë në 1662. Danieli u bë një tregtar, u martua me Meri Taflei (Mary Tuffley) dhe patën së bashku shtatë fëmijë. Ai bëri shumë udhëtime në Angli dhe në Evropë. Në vititn 1695, ai e ndryshoi mbiemrin dhe filloi ta quante veten De Fo (De Foe). Shkroi një sërë traktatesh politike dhe u arrestua shpesh si pasojë e shkrimeve të tij. Gjithashtu, për shkak të borxheve, falimentoi disa herë si dhe u fut në burg. Ka shërbyer gjatë jetës së tij në poste të tilla si gazetar politik, këshilltar dhe agjent sekret.[155] Vdiq në Londër në vitin 1731. Majkëll Shinagel (Michael Shinagel) shprehet për të se Defo ishte një nga shkrimtarët anglezë më prodhimtarë dhe lëvrues të gjinive të ndryshme, botimet e të cilit në prozë dhe poezi variojnë me tema nga më të ndryshmet si ekonomi, politikë, fe, arsim, udhëtim dhe letërsi. Si një gazetar, ai ishte i përfshirë në më shumë se dymbëdhjetë organe periodike.[156] Edhe Xhejms Xhojsi e vlerëson Defonë, duke e quajtur atë shkrimtarin e parë anglez që ka shkruar pa u përpjekur të imitojë ose të përshtatë veprat e huaja, dhe që ka mbushur krijesat e penës së tij me një shpirt të vërtetë kombëtar, një shkrimtar që ka krijuar një formë artistike pa ndjekur shembuj të mëparshëm.[157] Edhe Homer Braun (Homer Brown) shprehet se Defo ka shkruar në çfarëdo kategori të imagjinueshme të ligjërimit.[158] Ai thotë se romanet e Defosë përbëjnë vetëm një grup të vogël të shkrimeve të tij,[159] dhe disa prej tyre janë emërtuar si romane vetëm në fillim të shekullit të njëzetë dhe se ka qenë Sër Uolter Skot që iu parapriu kritikëve të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë që e quajtën Defonë si shpikësin e romancës historike.[160]

Robinson Crusoe është shkruar në gjuhën angleze dhe u botua për herë të parë në prill të vitit 1719 me një titull shumë më të gjatë.[161] Sipas studiuesit Gerard Genet (Gérard Genette), është e logjikshme dhe e pashmangshme që të shkurtohen tituj të tillë të gjatë dhe që bëjnë një përmbledhje të periudhës klasike dhe ndoshta, veçanërisht, të shekullit të tetëmbëdhjetë.[162] Që prej botimit të parë, kjo vepër pati një ndikim të ndjeshëm në letërsinë për fëmijë dhe për të rritur.[163] Siç shprehet studiuesi Seth Lerer (Seth Lerer) në këtë roman ndërthuren dy nga qëndrimet filozofike dhe shoqërore më

---

[155] D. Defoe (1994) *Robinson Crusoe – An Authoritative Text - Contexts – Criticism*. (Ed.) Michael Shinagel. New York: W.W. Norton & Company, fq. 433, 434.

[156] Po aty, fq. 434.

[157] J. Joyce (1994) në Daniel Defoe. *Robinson Crusoe – An Authoritative Text - Contexts - Criticism*. (ed.) M. Shinagel. New York: W.W. Norton & Company, fq. 320, 321.

[158] H. Brown (1996) *The Institution of the English Novel: Defoe's Contribution. NOVEL: A Forum on Fiction*, Vol. 29. No. 3. fq. 301.

[159] Kanoni i plotë i romaneve të Defosë përfshin *Robinson Crusoe*, *Moll Flanders*, *Colonel Jacques*, *Captain Singleton*, *Roxana*, *Memoirs of a Cavalier*, dhe *Journal of the Plague Year* (kjo e fundit akoma nuk është përcaktuar përfundimisht nëse i përket gjinisë së romanit) (H. Brown, vepra e sipërcituar, fq. 301-302).

[160] *Sir Walter Scott* realizoi përmbledhjen e parë të romaneve të Defosë nën titullin *The Novels of Daniel Defoe* në vitet 1809-1810.

[161] Titulli i plotë dhe origjinal i romanit është "*The Life and Strange Surprising Adventures of Robinson Crusoe of York, Mariner: Who lived Eight and Twenty Years, all alone in an un-inhabited Island on the coast of America, near the Mouth of the Great River of Oroonoque; Having been cast on Shore by Shipwreck, wherein all the Men perished but himself. With An Account how he was at last as strangely deliver'd by Pyrates. Written by Himself*". (Defoe, 1994: 2)

[162] G. Genette (1997) *Paratexts – Thresholds of interpretation*. (tr.) Jane E. Lewin. Cambridge: Cambridge University Press, fq. 71.

[163] S. Lerer (2008) *Children's Literature: A Reader's History, from Aesop to Harry Potter*. The University Chicago Press Ltd.: London, fq. 129.

madhore e të hershme të modernizmit: përkushtimi puritan dhe epistemologjia lokiane.[164] Nga njëra anë, theksimi nga vetë Kruzo për vetëkërkim, shqetësimi për listat dhe inventarët, përkushtimi ndaj shpëtimit e lidhin me puritanizmin e shekullit të shtatëmbëdhjetë. Nga ana tjetër, magjepsja nga hollësitë në brendësi të romanit, përvoja dhe aftësitë, njohuritë rreth botës fizike të fituara nëpërjmjet shqisave e vendosin romanin brenda trashëgimisë së Xhon Lokut. Ja se si shprehet vetë studiuesi Seth Lerer duke iu referuar risive të këtij romani:

> *Robinson Kruzo solli diçka të re, njësoj sikur t'i jepte zë fëmijërisë së vetë romanit anglez. Dhe, me të vërtetë, ky është një roman për fëmijë. Robinson fillon duke shpjeguar prejardhjen e vet gjenealogjike. Ai sjell etimologjinë e mbiemrit të tij, dhe, duke e bërë këtë, lidh trashëgiminë e tij me udhëtimin e tij shpirtëror. Fjala "crusoe" është një anglicizëm i emrit në gjermanisht "Kreutznaer" – ai që i afrohet kryqit...Kruzo është një kryqtar, dhe në roman jepet udhëtimi katolik i shpëtimit drejt reformimit dhe vetë-zbulimit. Edhe Robinsoni është djali i tretë (ashtu si edhe Lemuel Gulliver është djalë i tretë), dhe ky kusht bën që ai të gjejë vetë rrugën nëpër botë. Ndryshe nga Piligrim's Progress ku ishte babai ai që u largua në një mision shpirtëror, në këtë roman është djali që largohet në një mision shpritëror dhe ekonomik.*[165]

Por çfarë rrëfehet në këtë roman? Heroi i romanit është një anglez në moshë të re, Robinson Kruzo, i cili ka dëshirë të bëhet detar, dhe kjo dëshirë kthehet në një pasion që do t'ia ndryshojë të gjithë jetën. Ai largohet në një udhëtim, kundër dëshirës së prindërve. Një stuhi me pasoja shkatërrimtare e përmbys anijen dhe disa pjestarë të ekipit mbyten. Fatmirësisht, Kruzo shpëton dhe arrin të kthehet në shtëpi. Edhe kapiteni i anijes e këshillon të mos kthehet më në det. Por, djaloshi i ri ndjehet i turpëruar dhe zgjedh më mirë të vazhdojë udhëtimin se sa të kthehet në shtëpi. Pas një sërë udhëtimesh të susksesshme, ai arrin të nxjerrë një shumë parash, por nuk e prin fati i mbarë dhe piratët e kapin rob anijen dhe skllavërojnë gjithë ekipin, përfshirë dhe Kruzonë. Për rreth dy vjet, ai jeton në Marok dhe punon në shtëpinë e pronarit të tij, derisa largohet fshehurazi në një udhëtim peshkimi me një burrë maur dhe me një djalë të quajtur Xuri. Ai e detyron burrin që të largohet dhe merr me vete vetëm djalin. Ata lundrojnë për ditë me radhë derisa shpëtohen nga një anije portugeze që drejtohet për në Brazil. Kapiteni është një burrë i sjellshëm që i jep para Kruzosë për të blerë çdo gjë që ka, edhe varkën, edhe Xurin. Kruzoja e pranon ofertën, duke i shitur të gjitha, dhe duke blerë një fermë në Brazil. Ai punon aty dhe, brenda katër viteve, përmirësohet nga ana ekonomike, por, i pakënaqur, vendos të nisë një udhëtim drejt Afrikës për të importuar skllevër zezakë në mënyrë të jashtëligjshme. Edhe ky udhëtim përfundon tragjikisht, por Kruzoja ia del të mbijetojë sërish. Tani ai e gjen veten në një ishull të shkretë dhe përpiqet të mbijetojë me mjete dhe armë që i kanë mbetur nga anija e shkatërruar. Ndërton për vete një vend të sigurt për të jetuar dhe arrin të gjejë ushqim në ishull. Ai jo vetëm gjuan kafshë, por edhe zbut dhitë, i mjel dhe nxjerr djathë. Mëson të rrisë oriz, misër e sheqer. Bën udhëtime të shkurtra në ishull dhe afër tij. Kështu, Kruzo jeton për njëzet e gjashtë vjet i vetmuar në ishull, miqtë e tij të vetëm janë kafshët e zbutura, një qen, mace, dhe një papagall. Gjatë jetës në ishull përballet edhe me vështirësi të tilla si një tërmet dhe sëmundje të ndryshme. Prandaj, në mënyrë të shkallëzuar, ai kthehet në një njeri më fetar, dhe fillon të lutet rregullisht. Një ditë ai shikon gjurmë këmbësh në bregdet dhe trembet pa masë.

[164] Po aty, fq. 129.
[165] Po aty, fq. 130.

Zbulon se ka kanibalë dhe ata janë në kërkim të viktimave. Arrin të shpëtojë një prej tyre, i cili është sërish një kanibal e quan atë Premt dhe e bind të bëjë premtimin se nuk do të hajë më mish njeriu. Premti është shumë besnik dhe qëndron pranë Kruzosë gjatë gjithë jetës. Kruzoja i mëson atij rreth krishtërimit, dhe edhe Premti kthehet në një protestant fetar. Ata jetojnë së bashku dhe merren me veprimtari bujqësore. Kanibalët rikthehen një ditë dhe këtë herë Kruzo dhe Premti arrijnë të shpëtojnë dy njerëz – babanë e Premtit dhe një marinar spanjoll. Pasi zbulon se ka marinarë të tjerë spanjollë dhe portugezë në vendin ku jetojnë fiset e Premtit, Kruzo përpiqet të gjejë një mënyrë që t'i tërheqë të gjithë këta njerëz në ishullin e tij, duke menduar se të gjithë së bashku mund të ndërtojnë një varkë dhe të largohen nga ishulli. Prandaj ai dërgon babanë e Premtit dhe marinarin spanjoll në ishullin e këtyre fiseve. Para kthimit të tyre shfaqet një anije tjetër, ku disa rebelë po përpiqen të marrin në kontroll anijen dhe kapitenin, bashkë me dy burra të tjerë. Kruzo dhe Premti arrijnë t'i shpëtojnë këta njerëz nga rebelët, kapiteni e merr anijen e tij dhe rebelët ndëshkohen. Kapiteni e shpërblen Kruzonë me disa dhurata dhe e merr edhe Kruzonë edhe Premtin me vete në Angli. Pas njëzet e tetë vitesh në ishull, Kruzo i rikthehet qytetërimit dhe takohet me të afërmit e tij. Me pas shkon në Lizbonë dhe, nëpërmjet ndihmës së një miku të vjetër, arrin të mbledhë të ardhurat e tij nga ferma në Brazil. Ai bëhet i pasur dhe vendos të kthehet në Angli. Nuk udhëton në rrugë detare, por tokësore. Udhëtimi paraqet një sërë rreziqesh për të dhe Premtin, si të ftohta ekstreme dhe sulme nga ujqërit e uritur. Fatmirësisht, arrijnë të sigurt në Angli. Aty Kruzo martohet dhe bëhet babai i tri fëmijëve. Pas pak kohësh, gruaja ndahet nga jeta dhe një nga nipërit e tij, një marinar i suksesshëm, e bind Kruzonë që të rikthehet në det. Ata vizitojnë ishullin dhe kalojnë njëzet ditë në koloninë e re. Kruzo iu le banorëve disa armë, vegla pune dhe dy punëtorë. Më pas ai shkon në Brazil, ble një anije dhe i dërgon burrat dhe gratë të vendosen në ishull. Historia mbaron duke na lënë të kuptojmë se Kruzo do të vazhdojë aventura dhe vizita të tjera në ishull, që rrëfehen në vëllimin e dytë.[166]

II.2.3.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe

Vepra origjinale, pas çdo leximi, shpërfaq një mënyrë të re interpretimi dhe kjo është me mjaft rëndësi kur mendojmë se në duart e lexuesve shqiptarë do të jetë një përkthim i saj, që do të thotë, një tekst që iu është nënshtruar disa herë proceseve shumëplanëshe të interpretimit nga ana e përkthyesit në rolin e një lexuesi të kujdesshëm. Ne na intereson të shikojmë se si do të transferohet vepra dhe mesazhet e saj në gjuhën shqipe nga ana e përkthyesit dhe cilat do të jenë interpretimet e publikut marrës në gjuhën shqipe.

Ashtu siç e parashtruam më lart, vepra paraqet mjaft interes për t'u analizuar nga pikpamje të ndryshme, por ne do të shpjegojmë arsyet pse ky roman është përfshirë krahas veprave të tjera në këtë studim krahasimor. E kemi përzgjedhur veprën, fillimisht, sepse ajo është konsideruar si romani i parë në gjuhën angleze drejtuar fëmijëve dhe lexuar gjerësisht edhe nga të rriturit. Procesi i interpretimit të veprës, për rrjedhojë, zhvillohet në nivele të ndryshme, në varësi të publikut marrës. Një status të tillë, të papërcaktuar, e kemi diskutuar që në fillim si një nga cilësitë e letërsisë për fëmijë, dhe kjo vepër nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Në mënyrë më të veçantë, e kemi zgjedhur këtë vepër për të qenë pjesë e pjesës së studimit që krahason prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit nga ana e përkthyesit ndaj njësive specifike kulturore të pranishme në origjinal. Gjithashtu, qëndrimi i përkthyesit shprehur nëpërmjet shkurtimit apo shpjegimit

[166] Pas suksesit të vëllimit të parë, Defo shkroi vëllimin e dytë të titulluar *The Farther Adventures of Robinson Crusoe.* Gjithashtu, Defo shkroi edhe një vëllim të tretë të titulluar *The Serious Reflections of Robinson Crusoe.*

të hollësishëm të disa pasazheve të origjinalit, shoqërimi me shënime në fund të faqes etj. do të bëhen sërish pjesë e studimit tonë, në kreun e fundit, ku do të diskutojmë rreth standardeve të përkthimit të letërsisë për fëmijë.

II.2.3.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe

Kemi gjetur tre variante në gjuhën shqipe; varianti i parë përkthyer nga *Halit Selfo dhe Bujar Doko*, botuar nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" në vitin 1982 (ribotim i vitit 1966); varianti i dytë përkthyer nga *Halit Selfo dhe Bujar Doko*, botuar nga shtëpia botuese "OMSCA" në vitin 1998; dhe varianti i tretë sjellë në gjuhën shqipe nga *Astrit Bishqemi dhe Luçiano Boçi*, botuar nga shtëpia botuese "Dy Lindje dhe dy Perëndime" në vitin 2007 (ribotim i vitit 2005). Nga këto tre variante që kemi gjetur, vetëm varianti i parë do të përfshihet në korpusin tonë dhe më poshtë, gjatë përshkrimit të karakteristikave të secilit variant, po shpjegojmë edhe arsyet e përzgjedhjes sonë.

Varianti i parë paraqet në kopertinë një varkë mes dallgëve si dhe emrin e shkrimtarit në krye (Daniel Defo) dhe në fund të faqes me shkronja të mëdha titullin ROBINSON KRUZO. Në brendësi të veprës zbulojmë edhe disa të dhëna të tjera rreth saj, ky variant është përkthyer nga teksti anglisht *The life and adventures of Robinson Crusoe*, Henry Fronde, London, 1910. Kjo është një e dhënë me shumë rëndësi sepse në këtë mënyrë kuptojmë se ky variant është bazuar në veprën e plotë në origjinal, gjë që do të thotë se edhe në gjuhën shqipe lexuesit do të kenë mundësi të jenë sa më afër origjinalit, dhe jo një versioni të shkurtuar të tij. Gjithashtu mësojmë se përkthimi është filluar nga Halit Selfo dhe se pas vdekjes së tij është përfunduar nga Bujar Doko. Mësojmë edhe redaktoren – Margalina Sina. Me tej varianti në gjuhën shqipe na sjell një parathënie në faqet 3-15, shkruar nga Aurel Plasari, të dhëna të hollësishme rreth së cilës mund t'i lexoni në çështjen që vijon rreth rolit të parathënies. Vepra nuk shoqërohet me shënime nga ana e përkthyesit në fund të faqes dhe as me shënime në përfundim të saj. Gjithashtu vepra në gjuhën shqipe nuk ka asnjë ilustrim në brendësi të saj. Ashtu si edhe origjinali, nuk ka një përmbajtje të kapitujve as në fillim dhe as në fund të veprës, as edhe ndarje kapitujsh në brendësi të saj.

Varianti i dytë paraqet në kopertinë një ilustrim të personazhit kryesor, në krye të saj jepet me shkronja të madhe emri i shkrimtarit DANIEL DEFO dhe menjëherë poshtë tij titulli i veprës sërish me shkronja të mëdha ROBINSON KRUZO. Në kopertinë gjithashtu cilësohet edhe gjinia e veprës – roman. Përkthyesit e këtij varianti janë po ata përkthyes që përmendëm në variantin e parë, pra, Halit Selfo dhe Bujar Doko. Përmenden edhe redaktorët Mosi Zaloshnja dhe Bujar Doko. Përmenden gjithashtu edhe korrektorët letrarë e teknikë, përkatësisht Thanas Feka dhe Tatjana Sini, si dhe piktori Safo Marko (që ka pregatitur vetëm kopertinën sepse në brendësi të veprës nuk ka asnjë figurë). Ky variant nuk ka parathënie, as shënime në fund të faqes dhe as shënime në fund të librit nga ana e përkthyesve. Ashtu si edhe varianti i parë, nuk ka një ndarje në kapituj. Një vështrim përqasës me variantin e parë na bën të kuptojmë se të dy variantet janë krejtësisht të njëjtë, duke përjashtuar vetëm ndonjë ndryshim jo domëthënës të realizuar kryesisht gjatë shtypjes së librit në shtypshkronjë. Kjo është arsyeja se përse këtë variant nuk e kemi përfshirë në studimin tonë krahasues.

Ilustrimi në kopertinën e variantit të tretë paraqet personazhin kryesor në një pozicion luftarak në ishullin e tij duke vështruar i shtangur një gjurmë njeriu në rërë. Në krye të kopertinës jepet titulli ROBINSON KRUZO dhe në fund të faqes emri i shkrimtarit DANIEL DEFO. Në brendësi të librit, në faqen e parë pas kopertinës jepet cilësimi *Vargu "Orkidet për fëmijë"*. Kjo është një e dhënë me shumë rëndësi që nuk duhet anashkaluar sepse e cilëson këtë variant si një vëpër drejtuar fëmijëve. Në faqen

tjetër, duke e plotësuar kanalizimin e këtij varianti si një vepër për fëmijë, lexojmë disa të dhëna të tjera: vepra është shqipëruar *shkurtazi* nga Lumo Skëndo dhe është *sjellë në gjuhën shqipe dhe është redaktuar* nga Astrit Bishqemi dhe Luçiano Boçi. Mësojmë gjithashtu se titulli në origjinal është "Robenson" dhe se është korrektuar nga Sefedin Trungu dhe është recensuar nga Milianov Kallupi dhe Ferit Lama. Në brendësi të veprës ka gjithsej njëzet e nëntë ilustrime. Ky variant nuk ka një përmbajtje me ndarje dhe tituj kapitujsh as në fillim dhe as në fund, por, në brendësi, mund të shohim se vepra ndahet me numra romakë në 38 kapituj të shkurtër. Pas një krahasimi që i kemi bërë këtij varianti me origjinalin, kemi vënë re se ai është shkurtuar ndjeshëm, përafërsisht vetëm një e treta e tij është sjellë në gjuhën shqipe, duke lënë jashtë variantit në shqip një pjesë të mirë të nënkuptimeve dhe aludimeve sociale dhe politike të origjinalit. Varianti në gjuhën shqipe, pra, është reduktuar thjesht në paraqitjen e rrjedhës së ngjarjeve dhe aventurave të personazhit kryesor. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme: së pari, ky variant është i kanalizuar në gjininë e letërsisë për fëmijë, pra, është identifikuar që në fillim publiku marrës, dhe, së dyti, vepra është shqipëruar në mënyrë të shkurtuar, pra, është një variant i përmbledhur i origjinalit i përshtatur në gjuhën shqipe për fëmijë. Këto dy arsye janë mjaft domëthënëse për studimin tonë sepse prezantojnë një prirje që ekziston në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë, përshtatja e një vepre për një publik në moshë të vogël, gjë që, në të shumtën e rasteve, nënkupton shkurtimin në një masë të ndjeshme të veprës shkruar në gjuhën origjinale. Gjithashtu, në faqet e fundit të saj vepra shoqërohet nga një pasthënie shkruar nga Astrit Bishqemi si dhe disa shënime në lidhje me këtë pasthënie.[167] Në këtë pasthënie sqarohet se Lumo Skëndo është emri letrar i shkrimtarit Mithat Frashëri si dhe sillen disa të thënsa rreth jetës dhe formimit të tij si njeri erudit. Përmenden një sërë veprash të përkthyera nga Mithati në gjuhën shqipe nga gjuhë të tilla si gjermanishtja, frëngjishtja e anglishtja. Mësojmë edhe se përkthimi i veprës në fjalë është bërë nga frëngjishtja dhe se përkthimi është bërë posaçërisht për fëmijë. Botimi origjinal me përkthyes Lumo Skëndon është bërë në vitin 1910 dhe ai variant, siç na shpjegohet në këtë pasthënie, ka pasur një sërë shpjegimesh me shkronja të vogla në fund të faqes, shpejgime të natyrës gjeografike, shpjegime në lidhje me dijenitë shkencore e historike, sqarim i fjalëve të huaja, etj. Theksohet gjithashtu vëmendja e veçantë e Frashërit për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës shqipe. Pasthënia vijon duke shpjeguar arsyet e shkrutimit të veprës nga ana e përkthyesit Mithat Frashëri: *Ai e ka botuar në një formë më të përtypshme për lexuesin shqiptar të asaj kohe, lexuesin e rritur fillestar e të pashkathtësuar, të pakualifikuar dhe atë fëmijë. Sidomos për kategorinë e dytë, për lexuesin e moshës së njomë. Pra, nuk është thjesht një shkurtim me gërshërë, apo një redaktim, por një përpunim serioz, në formë më të thjeshtuar*.[168] Një argument i tillë mbështetet nga disa krahasime të pasazheve të këtij varianti me variantin e plotë nën përkthimin e Selfo-Dokos (1966). Megjithatë, edhe vetë Astrit Bishqemi thekson se janë hequr e janë shkurtuar përshkrimet e gjata, arsyetimet, etj., të cilat e plogështojnë veprën dhe, kështu, libri është një përpunim i romanit të Defosë, një përshtatje, një rikallëzim apo një ritregim i tij.[169] Këto argumenta, së bashku me një krahasim bërë nga ana jonë e këtij varianti me origjinalin, kanë bërë që ky variant të konsiderohet si i papërshtatshëm për studimin tonë krahasimor, sepse, duke qenë një variant i shkurtuar i origjinalit, në

[167] Dëshirojmë të theksojmë se shënimet janë shkruar për të sqaruar disa pjesë të pasthënies dhe vetëm pesë shënimet e para sqarojnë fjalë të përmendura gjatë veprës, si për shembull, *mësallë, glinë, shinik*, etj. Ndërkohë që në brendësi të vetë veprës nuk ka asnjë shënim në faqet e librit nga ana e përkthyesit për të sqaruar pjesë të variantit sjellë në gjuhën shqipe.

[168] D. Defo (2007) *Robinson Kruzo* (përkth.) A. Bishqemi, L.Skëndo, Dy Lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë, fq. 94.

[169] Po aty, fq. 96-97.

mungesë të një sërë arsyetimesh dhe nënkuptimesh të shkrimtarit Defo, nuk le vend për analiza cilësore dhe sasiore që do të interpretohen nëpërmjet grafikëve në vazhdim të këtij punimi. Të dhënat që do të nxirrnim nga një krahasim i tillë do të ishin të sipërfaqshme dhe nuk do të përputheshin me krahasimin e origjinalit me variantin e parë, i cili është një përkthim i pashkurtuar i origjinalit.

II.2.4 Gulliver's Travels (1726)

II.2.4.1 Të dhëna rreth veprës origjinale *Gulliver's Travels*

Libri *Gulliver's Travels* shkruar nga Xhonatan Suift (Johnathan Swift) i përket sigurisht kanonit të letërsisë perëndimore. Megjithatë, shumica e njerëzve në ditët e sotme e konsiderojnë atë si pjesë të fondit të çmuar të letërsisë për fëmijë, si rrjedhojë e përshtatjeve të ndryshme të cilave i është nënshtruar kjo vepër, kryesisht si pasojë e procesit të përkthimit në gjuhë të ndryshme. Edhe studiuesja Rita Otinen, duke disktuar mbi nevojën dhe vështirësinë e përkufizimit të letërsisë për fëmijë shprehet se *veprat letrare dhe gjini të tëra letrare fitojnë kuptime të ndryshme dhe përkufizohen sërish e sërish. Prandaj mund të ndodhë vërtet që ajo që sot konsiderohet si letërsi për të rritur, nesër të konsiderohet si letërsi për fëmijë.*[170] Pikërisht një gjë e tillë ka ndodhur me *Gulliver's Travels* dhe kjo ka qenë arsyeja se pse ne e kemi bërë këtë vepër pjesë të studimit tonë, si një nga veprat që e ka ndryshuar statusin e saj dhe gjininë përkatëse pikërisht nëpërmjet përkthimit.

Skeleti i rrëfimit i një prej veprave më të famshme me motivin e udhëtimeve detare dhe aventurave të rrezikshme në territore të panjohura është krijuar nga shkrimtari dhe satiristi irlandez Xhonatan Suift (1667-1745). Nga katër pjesët që përbëjnë romanin, kryesisht vetëm dy librat e parë janë përshtatur për fëmijët si një fantazi udhëtimi. Në veprën e plotë përshkruhen përvojat e Lemuel Guliverit, i cili, thuajse padashur, zhvilloi vizita në katër kultura të huaja e të çuditshme. Në librin e parë, Guliveri përshkruan rrugëtimin e tij në tokën e Liliputëve, njerëz të gjatë vetëm pesëmbëdhjetë centimetra. Në pjesën e dytë të librit, Guliveri e gjen veten mes gjigandëve të Brobdingnagit. Pjesa e tretë vazhdon me satirizimin e akademisë britanike dhe njohurive shkencore nëpërmjet përshkrimit ironik të Laputës, Balnibardit, Lugnagut, Glubdubdribit dhe Japonisë. Dhe së fundmi, pjesa e katërt, ngjarjet e së cilës zhvillohen në vendin e Nuihnhnmëve, e çon Guliverin në një shoqëri ideale përbërë nga kuaj fisnikë dhe të mençur. Edhe pse udhëtimet e Guliverit kanë pasur si qëllim parësor të satirizonin shoqërinë britanike të epokës kur jetoi Suifti, pjesa e Liliputëve dhe gjigandëve janë bërë shumë të famshme në të gjithë botën. Fëmijët i tërheq shumë kombinimi i elementëve realistë dhe fantastikë ndërthurur bukur dhe në mënyrë origjinale në historitë e përshkruara gjatë gjithë veprës, së bashku me thyerjen e rregullave të jetës së zakonshme, situatat qesharake (të synuara nga shkrimtari si satirike) si, për shembull, mes të tjerash, diskutimi për thyerjen e vezëve, etj.

Përshtatjet dhe përkthimet e ndryshme të *Gulliver's Travels* kanë ndjekur pak a shumë të njëjtën rrugë ashtu si edhe vepra origjinale *Robinson Crusoe.* Versioni i shkurtuar i *Gulliver's Travels* lexohej nga fëmijët në formën e një libri të përshtatur për fëmijë shumë shpejt pasi u botua për herë të parë në 1726. Ashtu si edhe me romanin tjetër të suksesshëm *Robinson Crusoe,* edhe *Gulliver's Travels* doli shpejt në treg në një version të shkurtuar dhe shumë shpejt botuesit e kuptuan se kjo vepër përbënte një fuqi

[170] R. Oittinen (1992) *Teaching translation of fiction - a dialogic point of view*. Në *Teaching Translation and Interpreting: Training Talent and Experience. Papers from the First Language International Conference, Elsinore, Denmark.* Dollerup, Cay and Anne Loddegaard (eds.), fq. 42-43.

shitëse në treg. Ndërkohë që *Robinson Crusoe* u botua fillimisht në prill të 1719 dhe, menjëherë, në gusht të po atij viti u botua një version i shkurtuar dhe i paautorizuar i këtij romani, i ndjekur nga një sërë botimesh gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë, edhe me *Gulliver's Travels* ndodhi e njëjta dukuri: versioni i parë i shkurtuar dhe i paautorizuar u botua në 1727 dhe përmbante vetëm udhëtimet në Liliput dhe Brobdingnag. Ndërsa nga mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë, ishin botuar një sërë botimesh të shkurtuara që përmbanin vetëm udhëtimin mes liliputëve. Versionet e shkurtuara të të dyja veprave të përmendura vazhduan të shfaqeshin edhe në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kohë në të cilën ata shfaqeshin vetëm si botime për fëmijë dhe të rinj.

Fillimisht ishte mungesa e materialeve të ngjashme ajo që bëri që vepra *Gulliver's Travels* të përshtatej brenda sistemit të letërsisë për fëmijë. Vepra u lexua me një frymë nga fëmijët, duke përmbushur një boshllëk që ekzistonte në polisistemin letrar. Pra, romani lexohej nga fëmijët edhe që më përpara se të ekzistonte sistemi i fëmijëve, që nga ajo kohë vepra ka arritur të mbajë një pozicion të qëndrueshëm brenda sistemit të fëmijëve. Kjo nuk ndodhi thjesht sepse ajo u shndërrua shpejt në një libër "klasik" për fëmijë, por kryesisht për arsye se vepra iu nënshtrua shumë përshtatjeve dhe rishqyrtimeve, me qëllim që ajo t'i përkiste sistemit marrës.[171]

II.2.4.2 Veçanësia e përkthimit të veprës në gjuhën shqipe

Analiza krahasimore në lidhje me tekstet që janë transferuar nga sistemi i letërsisë për të rritur në sistemin e letërsisë për fëmijë është me mjaft interes të zhvillohet për një vepër të tillë si *Gulliver's Travels,* sepse në një vepër të tillë janë përgjithësisht kufizimet e vendosura nga sistemi mbi lexuesit e nënkuptuar ato që nxjerrin në pah nevojën për një proces transferimi. Edhe më të ndjeshme janë pasojat e një transferimi të tillë nëse kemi parasysh se vetë përkthimi përbën një proces transferimi nga një gjuhë në tjetrën, nga një kulturë në një tjetër, nga një grup pritshmërish në një tjetër. Këtij procesi transferimi do t'i shtohet edhe transferimi nga një sistem letërsie në një tjetër si dhe nga sistemi i letërsisë për të rritur në sistemin e letërsisë për fëmijë. Në këtë drejtim, paraqet shumë interes studimi krahasimor i një vepre të shkruar dhe të nënkuptuar fillimisht për të rritur, por që njëkohësisht ekziston brenda polisistemit letrar, brenda sistemit të letërsisë së përkthyer, dhe, njëkohësisht letërsisë për fëmijë. Kemi përmendur se përkthimi i letërsisë për fëmijë realizon edhe lidhjen e tekstit me modelet ekzistuese në sistemin e gjuhës së përkthimit. Një dukuri e tillë, e njohur nga procedurat e përgjithshme të përkthimit, është veçanërisht e dukshme në përkthimin e letërsisë për fëmijë për shkak të prirjes së sistemit për të pranuar vetëm atë që është e mirënjohur dhe që i përket traditës.[172] Në këtë drejtim, pëzgjedhja e një vepre të tillë si pjesë e korpusit tonë do të na ndihmojë të identifikojmë shembuj që nxjerrin në pah përshtatje apo shkurtime që mund t'i jenë bërë veprës origjinale nga ana e përkthyesit për të qenë në përputhje me sistemin e letërsisë në gjuhën shqipe apo me pritshmëritë kulturore të lexuesve. Gjatë pjesës krahasimore të këtij studimi që do të pasurohet me shembuj ne do të përqëndrohemi në pjesë të tilla të veprës si njësitë matëse, njësitë monetare dhe ushqimet. Gjithashtu, gjatë diskutimit mbi

[171] Sa më shumë kthehej libri në një vepër klasike të letërsisë pëe fëmijë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, aq më shumë filloi të humbiste pozicionin e tij në sistemin e të rriturve. Kjo nuk do të thotë që libri u zhduk nga sistemi i të rriturve. Në të kundërt, vepra fitoi statusin e një vepre kanonike, pjesë e trashëgimisë letrare, pra, lexohet sot nga të rriturit për vlerën historike, ndërsa brenda letërsisë për fëmijë është akoma një vepër që "jeton". [Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*. Athens: University of Georgia Press. fq. 116)].

[172] Për më tepër në këtë drejtim, mund të shikoni I. Even-Zohar (1975, 1978d), G. Toury (1977, 1980a, 1980b).

standardet e përdorura gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë, do të shkëpusim shembuj domethënës nga përkthimi në gjuhën shqipe për të parë se çfarë strategji janë përdorur gjatë transferimit të veprës në gjuhën shqipe.

II.2.4.3 Të dhëna rreth varianteve në gjuhën shqipe

Nga variantet e përkthyera në gjuhën shqipe kemi përzgjedhur dy, i pari është botuar në vitin 1974 dhe i dyti në vitin 2007. Vetëm varianti i parë do të bëhet pjesë e studimit tonë krahasues dhe më poshtë po parashtrojmë arsyet e një zgjedhjeje të tillë. Varianti i parë sjell në kopertinë një hartë të udhëtimeve të Guliverit. Në brendësi vepra përmban njëqind e një ilustrime, të përpunuara në vazhdimësi të njëri-tjetrit dhe në koherencë të brendshme. Pasqyra e lëndës jepet në fund të veprës së përkthyer, dhe, ashtu si edhe në origjinal, prezantohet ndarja në katër pjesë e librit, dhe për çdo pjesë, kapitujt përkatës nuk kanë tituj, por sjellin përmbledhtasi ngjarjet kryesore të kapitullit. Përkthimi i qëndron shumë besnik origjinalit, i ndarë në katër pjesë, dy pjesët e para me nga tetë kapituj dhe, pjesa e tretë dhe e katërt, përkatësisht prej njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë kapitujsh. Titujt e katër pjesëve janë *Udhëtimi për Liliput, Udhëtimi për Brobdingnag, Në udhë për Laputa, Balnibarbi, Glubbdubdrib, Luggnag e Japoni, Një udhëtim në vendin e Huihnhmëve* kundrejt titujve të origjinalit, përkatësisht: *A voyage to Lilliput, A voyage to Brobdingnag, a voyage to Laputa, Balnibarbi, Luggnagg, Glubbdubdrib, and Japan* dhe *A voyage to the country of the Houyhnhnms.* Në faqen e parë pas kopertinës lexojmë emrin e shkrimtarit (Xhonatan Suift), titullin e plotë (Udhëtimet e Guliverit ndër vise të largëta të dheut) si dhe emrin e përkthyesit (Halit Selfo) shoqëruar nga shtëpia botuese (Naim Frashëri) si dhe specifikimi se ky është botimi i dytë. Më pas lexojmë një parathënie shkruar nga Spiro Çomora (pra, jo nga vetë përkthyesi). Në këtë parathënie fillimisht jepen një sërë të dhënash biografike për shkrimtarin si dhe epokës historike të Anglisë në shekullin XVIII dhe ndikimet e ngjarjeve të ndryshme në formësimin dhe shprehjen e satirës të Suiftit. Më tej shtjellohen një sërë faktesh interesante rreth veprës origjinale, organizimit të saj, perceptimin e saj nga bashkëkohësit si dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm në qesëndisjen e hapur apo të fshehtë të endur hollësishëm dhe mjeshtërisht prej shkrimtarit. Në paragrafin e fundit të kësaj parathënieje lexojmë se shqipërimi i kësaj vepre i shton bibliotekës shqiptare një kryevepër që do të rrëmbejë zemrën e lexuesit *të çdo moshe.*[173] Një pohim i tillë na bën të kuptojmë se vepra le vend për t'u lexuar nga të rritur e të vegjël njëkohësisht. Në po këtë paragraf gjejmë disa të dhëna në lidhje me përkthimin e veprës dhe vështirësitë e këtij procesi. Vepra cilësohet si e shqipëruar dhe, për më tepër, *puna e shqipëruesit të saj ... s'duhet të ketë qenë e lehtë.* Vështirësia kryesore duhet të ketë qenë sjellja në gjuhën shqipe e një leksiku të pasur në emra, vende, zakone dhe objekte me po aq thjeshtësi sa dhe stili karakterizues i shkrimtarit.[174] Me interes është fakti se në fund të veprës së përkthyer jepen një sërë shpjegimesh për çdo kapitull nga ana e përkthyesit, të cilat qartësojnë për lexuesit nënkuptimet, pjesët satirike si dhe elementët ndërtekstualë që nuk janë të kapshëm për lexuesit shqiptarë, veçanërisht fëmijët të cilët mund ta lexojnë veprën e plotë vetëm nëse kanë në duart e tyre këtë variant. Në këtë drejtim, mund të themi se këto shënime përmbushin pjesërisht qëllimet e parathënies nëse ajo do të ishte shkruar nga vetë përkthyesi.

---

[173] Xh. Suift (1974) *Udhëtimet e Guliverit ndër vise të largëta të dheut.* (përkth.) H. Selfo. Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, fq. 9.
[174] Po aty, fq. 9.

Varianti i dytë nën shqyrtim është botim i vitit 2007. Në kopertinë shohim një ilustrim shumëngjyrësh që paraqet Guliverin në ishullin e liliputëve. Gjithashtu jepet në kopertinë emri i shkrimtarit (Xhonatan Suift) si dhe titulli (Udhëtimet e Guliverit). Në faqen pas kopertinës lexojmë shënimin *Vargu "Orkidet për fëmijë"* si dhë shënimin "*Ky botim i Shtëpisë Botuese "dy Lindje dhe dy Perëndime" është i përfshirë në listën rekomanduese të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për shkollat 9-vjeçare",* të dhëna që, së bashku me shënimin *përshtati për fëmijë Astrit Bishqemi* na bën ta kanalizojmë veprën si një libër për fëmijë. Ky variant nuk shoqërohet as me parathënie dhe as me shënime apo komente në fund të librit, pra, nuk ndjehet prania e përkthyesit nëpërmjet këtyre elementëve. Në fillim të këtij varianti jepet pasqyra e lëndës, ku titullohen vetëm katër pjesët *Guliveri në Liliput, Te Gjigandët, Në Ujdhesën Flututuese "Laputa"* dhe *Në vendin e Huihmëve,* dhe nuk jepen kapitujt përbërës për secilën pjesë. Edhe vetë titujt, parë në krahasim me titujt në origjinal, tregojnë për një thjeshtësim të origjinalit. Në brendësi të veprës së përkthyer mund të shikojmë se ka gjithsej 8 kapituj për pjesën e parë, 5 kapituj për pjesën e dytë, 9 kapituj për pjesën e tretë dhe 8 kapituj për pjesën e katërt. Një studim dhe krahasim më i hollësishëm tregon se ky variant nuk përmban shumë pjesë nga vepra origjinale, duke sjellë kështu në shqip një përmbledhje të origjinalit ku kanë humbur shumë elementë satirikë, gjë që nënkuptohet edhe nga fakti i shprehur qartë se kemi të bëjmë me një përshtatje për fëmijë. Sërish, fakti që ky variant është një shkurtim dhe përshtatje i origjinalit në nivel të ndjeshëm, bën që ai të mos jetë pjesë e korpusit tonë studimor.

Duke iu referuar tani gjithë veprave origjinale dhe varianteve të sipërpërmendura, po e paraqesim në mënyrë të përmbledhur korpusin nën shqyrtim gjatë këtij studimi nëpërmjet tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3
Korpusi nën shqyrtim - Veprat origjinale dhe variantet në gjuhën shqipe

Vepra origjinale	***Variantet në gjuhën shqipe***
Alice's Adventures in Wonderland (1865) Lewis Carrol	Liza në Botën e Çudinavet (1944) Hysejn dhe Beqir Çela
	Liza në Botën e Çudirave (1961) Maqo Afezolli
	Liza në Botën e Çudirave (1998) Maqo Afezolli
	Liza në Botën e Çudirave (2008) Vëllezërit Tafa
	Liza në Botën e Çudirave (2008) Frederik Shuraja
Harry Potter and the Philosopher's Stone (1997) J. K. Rowling	Heri Poter dhe guri filozofal (2002) Amik Kasoruho
Robinson Crusoe (1719) Daniel Defoe	Robinson Kruzo (1982) Halit Selfo, Bujar Doko
Gulliver's Travels (1726) Jonathan Swift	Udhëtimet e Guliverit (1974) Halit Selfo

II. 3 Roli i parathënies në korpusin nën shqyrtim

Pozicioni i përkthyesit në të ardhmen është po kaq i vështirë për t'u përcaktuar sa dhe vetë termi 'përkthim'. Por roli i përkthyesit në të ardhmen është më pak i hapur ndaj diskutimeve. Ai duhet të konsiderohet si një figurë kyçe gjatë nxitjes së nivelit më të lartë të kuptimit mes popujve dhe kombeve. Ai nuk duhet të konsiderohet si anonim…Ai është "i padukshëm" vetëm kur komunikimi është i qartë dhe nuk le asgjë për t'u diskutuar. Në raste të tjera, kur fillojnë dyshimet ose dallimet kulturore, përkthyesi duhet të shkruajë një parathënie më vete, ku të shpjegojë se si e ka kryer punën e tij … një roman i përkthyer që nuk ka parathënien e përkthyesit duhet të jetë diçka që i përket së shkuarës, dhe, rrjedhimisht, si parathënia, ashtu edhe vetë vepra, duhet të tërheqin vëmendjen e kritikut.[175]

Këto fjalë, shkruar më shumë se tridhjetë vjet më parë nga studiuesi dhe përkthyesi Pitër Njumark, vazhdojnë të jenë të vërteta edhe sot. Një pjesë e mirë e veprave të përkthyera në gjuhën shqipe kanë shumë pak gjurmë të dukshme të pranisë së përkthyesit, një ndër elementët e së cilës shprehet pikërisht nëpërmjet parathënies. Akoma më shumë theksohet një dukuri e tillë në letërsinë e përkthyer për fëmijë, duke e anashkaluar parathënien dhe duke e trajtuar atë si një element deri diku të panevojshëm qoftë nga ana e përkthyesit, qoftë nga ana e shtëpisë botuese, kryesisht nisur nga paragjykimi se lexuesit në moshë të re nuk priren të ndalen në shfletimin e faqeve të tepërta që do t'i largojnë ata nga procesi aktual i të lexuarit dhe kuptuarit të veprës. Gjatë këtij punimi, ne do të sjellim një sërë argumentash dhe shembujsh për të mbështetur mendimin se parathënia është një përbërës me mjaft rëndësi që vendos ura komunikimi me veprën

[175] P. Newmark (1983) *The Translation of Metaphor.* L.A.U.T., fq. 17.

origjinale, shkrimtarin origjinal, përkthyesin dhe strategjitë e përdorura prej tij, vështirësitë e hasura gjatë procesit të të përkthyerit, etj., dhe nëpërmjet së cilës, përkrah elementëve të tjerë, ne mund të diskutojmë rreth shkallës së pranisë së përkthyesit dhe mënyrës së perceptimit të veprave të përkthyera.

II.3.1 Qëndrime të ndryshme mbi rolin e parathënies

Në këtë nënçështje do të përmendim në mënyrë të përmbledhur disa qëndrime mbi rolin e parathënies, që do të na ndihmojnë të reflektojmë edhe më shumë rreth nevojës së pranisë së tyre në përkthimet në ditët e sotme.

Ritva Hartama-Hajnonen (Ritva Hartama-Heinonen) në artikullin e saj "*Translators' Prefaces—A Key to the Translation?"* arrin në përfundimin: *Përkthyesi është lidhja mes tekstit origjinal dhe përkthimit, dhe për këdo që është i interesuar mbi përkthimet dhe cilësinë e tyre, parathëniet ofrojnë një pikë fillestare shumë të mirë – ndoshta një mënyrë për të njohur tekstin e përkthyer ose edhe për të hapur një dritare për botën e përkthyesit.*[176]

Nga ana tjetër, Lorens Venuti, një studiues i njohur gjerësisht për studimet e tij të hollësishme në lidhje me shkallën e dukshmërisë së përkthyesit në produktin përfundimtar, shprehet pozitivisht dhe e mbështet dukshmërinë e përkthyesit, duke e konsideruar parathënien si një nga elementët që ndihmon për të nxjerrë më në dukje praninë e tij. Ja se si shprehet vetë Venuti në këtë drejtim:

> *Përkthyesit duhet të bëjnë detyrimisht një përsëritje të kodeve – kulturore, ekonomike, ligjore – që i kufizojnë dhe i shfrytëzojnë ata. Ata mund të punojnë për të përsëritur konceptin indidualist të autorësisë që e ka kufizuar përkthimin në kufijtë e kulturës anglo-amerikane, jo vetëm duke zhvilluar risi të praktikave përkthimore nëpërmjet të cilave puna e tyre bëhet e dukshme për lexuesit, por edhe duke i prezantuar këto praktika nëpërmjet parathënieve, eseve, leksioneve, intervistave.*[177]

> *Padukshmëria e përkthyesit në ditët e sotme ngre një sërë çështjesh kaq shqetësuese në lidhje me ekonominë gjeopolitike të kulturës sa që për t'u përballur me to nevojitet një numër edhe më i madh të dhënash në lidhje me përkthimin. Pikpamja ime nënkupton një besim utopik në fuqinë e përkthimit për të bërë dallimin, jo vetëm për lindjen e formave të reja kulturore, por edhe në lindjen e marrëdhënieve të reja kulturore në botë.*[178]

Pra, sipas Venutit, përkthimi duhet të kontribuojë në arritjen e kuptimit mes popujve dhe kombeve të ndryshme, gjë që bëhet e mundur nëpërmjet rritjes së dukshmërisë së përkthyesit në veprën e përkthyer, ku një element i rëndësishëm për përmbushjen e këtij misioni është pikërisht parathënia.

Pitër Bush (Peter Bush), shkrimtar dhe përkthyes, e mbështet dukshmërine e përkthyesit, duke u shprehur pozitivisht në lidhje me parathënien si dhe shënimet në fund të faqes dhe shfaqjes së emrit të përkthyesit në kopertinë, si një nga mënyrat për ta

---

[176] R. Hartama-Heinonen (1995) "*Translators' Prefaces—A Key to the Translation*?" Në *Folia Translatologica* 4, fq. 41.
[177] L. Venuti (1995) *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge, fq. 311.
[178] Po aty, fq. 213.

dalluar përkthimin si të tillë.[179] Nga ana tjetër, Kerël Majer (Carol Maier) mendon se vetë përkthyesit kanë faj që nuk janë shumë të famshëm. Shënimet e përkthyesve shpesh shkruhen në fund të faqes ose në fund të librit, në hyrje ose në përfundim të veprës, dhe jo si komunikime nga "hapësira e ndërmjetme".[180] Kjo ndodh edhe për arsye se shtëpitë botuese dhe lexuesit presin që përkthyesit të "sjellin rezultatet e përkthimit më shumë se sa të flasin rreth eksplorimeve të tyre". Në të vërtetë, do të ishte me shumë interes për lexuesit dhe studiuesit që kjo "hapësirë e ndërmjetme" të ofronte një diskutim nga ana e vetë përkthyesit nisur nga vetë përvoja e tij gjatë procesit konkret të përkthimit, dhe jo vetëm të dhëna rreth shkrimtarit të veprës origjinale dhe subjektit apo personazheve.

Njumarku shprehet se parathënia është një mënyrë për të nxitur të kuptuarin në nivel ndërkulturor.[181] Ai beson se dukshmëria e përkthyesit duhet të rritet kur boshllëku kulturor ndërmjet tekstit origjinal dhe përkthimit rritet, dhe parathënia e përkthyesit është një mjet që mund ta ndihmojë lexuesin ta kapërxejë këtë boshllëk. Sipas Edvin Gentzlerit, (Edwin Gentzler) shtëpitë botuese po eksperimentojnë me forma të reja për prezantimin e përkthimeve, duke përfshirë përdorimin e materialeve shtesë suplementare, si për shembull, parathëniet, hyrjet, intervistat, shënimet në fund të faqes,[182] gjë që tregon se idetë e Venutit po fitojnë gjerësisht mbështetje. Diçka e tillë do të gjente vend edhe për përkthimet në hapësirën shqiptare, dhe do të ishte shumë domethënëse në përkthimin e letërsisë për fëmijë.

II.3.2 Funksionet e parathënies në korpusin nën shqyrtim

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se funksionet e parathënies, sipas studiuesve të sipërpërmendur, janë rritja e nivelit të dukshmërisë së përkthyesit, dhënia e shpjegimeve mbi aktivitetin e të përkthyerit, eksplorimi ndërkulturor, etj. Nga ana tjetër, duke iu referuar vetë parathënieve që kemi studiuar në korpusin e lartpërmendur, mund të themi se qëllimet e parathënies që shoqërojnë variantet e përkthyera në gjuhën shqipe janë:

- Informimi në shkallë të ndryshme në lidhje me shkrimtarin dhe me veprën origjinale (të dhëna biografike, qëllimet e veprës, mesazhet, subjekti, personazhet),
- Qartësimi i arsyeve përse është marrë përsipër përkthimi ose ripërkthimi i veprës;
- Njohja me përkthimet e mëparëshme (nëse ka);
- Identifikimi i publikut të cilit i drejtohet vepra e përkthyer kundrejt veprës origjinale;
- Parashtrimi i vështirësive me të cilat është përballur përkthyesi gjatë përkthimit të veprës (gjuha fëminore, humori, lojërat e fjalëve);
- Shfajësimi ose justifikimi për pasaktësira të mundshme;
- Pozicionimi i veprës së përkthyer brenda letërsisë shqipe;
- Përcaktimi i veprës si përkthim apo shqipërim;
- Kërkim mirënjohjeje nga ana e publikut për punën e bërë nga përkthyesi.

[179] P. Bush (1997) (përkth.) Juan Goytisolo *Quarantine*. London: Quartet Books, fq. 115.
[180] C. Maier (1995) *Toward a Theoretical Practice for Cross-Cultural Translation*. Në *Between Languages and Cultures: Translation and Cross-Cultural Texts.* (eds). A. Dingwaney dhe C. Maier Pittsburgh and London: University of Pittsburgh Press, fq. 22.
[181] P. Newmark (1983) *The Translation of Metaphor*. L.A.U.T., fq. 17.
[182] E. Gentzler (2001) *Contemporary Translation Theories*. 2nd ed. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 43).

Vërejmë, gjithashtu, se, në një këndvështrim diakronik, parathënia fillon të mos shfaqet në veprat e përkthyera ose nuk shkruhet nga vetë përkthyesi. Duke e mbyllur këtë diskutim theksojmë se parathënia është një element që nuk duhet të mungojë në një vepër të përkthyer dhe do të ishte vërtet me interes, jo vetëm për studime krahasuese por edhe për një të kuptuar më të thellë të veprës dhe ndërgjegjësim të rolit dhe vështirësive të përkthyesit, veçanërisht në rastet kur ajo shkruhet nga vetë përkthyesi.

Kreu III Qëndrimi i përkthyesit të letërsisë për fëmijë

Gjatë këtij kreu do të hulumtojmë fillimisht rreth zbulimit të disa arsyeve se pse të rriturit dhe fëmijët nuk janë në pozicione të barabarta në prodhimin, leximin dhe përkthimin e letërsisë për fëmijë. Do të sjellim një sërë argumentash që shpërfaqin disa mënyra se si të rriturit ushtrojnë pushtet te fëmijët duke shfrytëzuar pozitën e tyre superiore në këtë marrrëdhënie të pabarabartë si dhe do të hamëndësojmë se si ndikon një gjë e tillë në vetë procesin e përkthimit. Është me mjaft interes në këtë drejtim të prezantojmë disa nga modelet e përkthimit të letërsisë për fëmijë që mund t'i lexoni në hollësi në çështjen e tretë të këtij kreu. Më tej, do të përqëndrohemi në dy prirjet e amatarizimit dhe huajëzimit për të cilat kemi bërë një prezantim teorik edhe në kreun e parë. Në çështjen e katërt të këtij kreu, ne do studiojmë konkretisht shfaqje të këtyre dy prirjeve në korpusin tonë si dhe do t'i paraqesim gjetjet tona nëpërmjet tabelave dhe grafikëve. Do ta mbyllim këtë kre duke reflektuar rreth procedurave nëpërmjet të cilave njësitë specifike kulturore janë sjellë në gjuhën shqipe.

III.1 Marrëdhënia e pabarabartë "i rritur-fëmijë"

Një faktor i dukshëm që ka të bëjë me procesin e të shkruarit dhe të përkthyerit për fëmijë është marëdhënia e pabarabartë ndërmjet shkrimtarit apo përkthyesit të rritur dhe një publiku të përbërë nga fëmijë.[183] Janë të rriturit ata që përcaktojnë shkallën dhe kufijtë e fëmijërisë. Gjithashtu, të rriturit diktojnë ato çka lexojnë fëmijët, meqënëse ata (të rriturit) janë shkrimtarë dhe botues, pra drejtojnë fëmijët drejt materialit që do të lexojnë. Megjithatë edhe shkrimtarët e rritur që i afrohen shumë të kuptuarit të dëshirave të fëmijërisë asnjëherë nuk mund t'i përshtaten krejtësisht perspektivës së fëmijëve, dhe ky dallim thelbësor mes fëmijëve dhe të rriturve shprehet më së shumti në dualitetin e mënyrës së drejtimit të rrëfimtarit ndaj fëmijëve lexues. Përkthyesit duhet të marrin në konsideratë një prani të rriturish brenda tekstit në një sërë formash, që nga spektri i pranisë kontrolluese mbi fëmijët dhe deri në një ironi gazmore të nënkuptuar për të rriturin që i lexon me zë të lartë fëmijës.

Rrjedhimisht, gjatë procesit të përkthimit të letërsisë për fëmijë fshihen një sërë rreziqesh sepse jo gjithmonë të rriturit mbajnë parasysh interesat e fëmijëve, duke u nisur (ndonjëherë edhe gabimisht, ndonjëherë edhe qëllimisht) nga perceptimi i tyre mbi fëmijët, fëmijërinë, letërsinë për fëmijë. Në këtë drejtim, është me mjaft interes të paraqesim një model nga Torben Vajnrajhu (Torben Weinreich) i cili pasqyron procesin e përzgjedhjes, duke përkufizuar kategoritë e njerëzve që ndikojnë në përzgjedhjen në emër të fëmijëve si në skemën më poshtë:[184]



[183] Për lehtësi shprehjeje, gjatë punimit përdoret termi përkthyes duke nënkuptuar edhe përkthyese.

[184] T. Weinreich (1978) *International Book Production for Children Related to the Children's Local Experiences and Local Consciousness.* në G. Klingberg, M. Ørvig, S. Amor (ed.s) *Children's Books in Translation. The Situation and The Problems* Stockholm, Almqvist&Wiksell International, fq. 148-149.

Rrethi më i jashtëm përfaqëson tregun ndërkombëtar të librave. Ai iu ofron botuesve dhe këshilluesve të tyre (që përfaqësojnë rrethin e dytë) një sërë librash dhe më tej janë ata që përzgjedhin librat – ose nga vendi i tyre ose nga shtete të tjera – që do të përkthehen. Këto janë libra që konsiderohen si *të përshtatshëm* dhe që ata vendosin se do të kalojnë në proces botimi. Më tej, sasia e librave që i jepen fëmijëve do të tkurret edhe më shumë – është tani radha e organeve publike që të përzgjedhin se cilët janë librat "e mirë" që mund t'iu jepen me siguri bibliotekave dhe mund të përdoren në shkolla. Edhe prindërit do të shqyrtojnë me kujdes se çfarë ofrohet dhe do të përzgjedhin vetëm ato libra që ata mendojnë se janë të përshtatshëm për fëmijën e tyre. Kjo bën që fëmija të mbetet në qendër, por në fund të zinxhirit, me ato libra që mbeten pasi kanë kaluar gjithë proceset përzgjedhëse të sipërpërmendura. Më në fund, fëmijët kanë në dorë librat që duhet të lexojnë.

Siç duket qartë edhe në skemë, librat "filtrohen" shtresë pas shtrese nga të rriturit të vendosur në role të ndryshme të cilët kanë përgjegjësi fillimisht njëri mbi tjetrin (nisur nga rrethi më i jashtëm) për të arritur deri te ndikimi dhe përgjegjësia e tyre mbi fëmijët (rrethi më në brendësi). Krijohet përshtypja se secili merr pjesë ashtu siç i takon gjatë procesit të përzgjedhjes, duke lënë jashtë atë që ndodhet në qendër, të cilit i drejtohet libri – vetë fëmijën. Kjo është edhe arsyeja se përse në duart e fëmijëve arrijnë një numër i pakët librash, pavarësisht se shumë libra shkruhen për fëmijë. Fakti që disa libra për fëmijë gjykohen si "më të përshtatshëm" se të tjerët na bën të kuptojmë edhe disa nga mënyrat e ushtrimit të pushtetit mbi lexuesit-fëmijë dhe format e manipulimit të tyre nga të rriturit, ku një rol të veçantë luajnë edhe përkthyesit. Nisur nga skema mund të reflektojmë edhe mbi faktin se nuk është e lehtë të shkruash dhe aq më tepër të përkthesh për fëmijë, sepse edhe kërkesat që duhet të plotësojë shkrimtari e, më tej, përkthyesi kalojnë në shumë hallka të grupeve ndërmjetëse, kështu që të përkthyerit për fëmijë mund të jetë edhe më e vështirë se të përkthyerit për të rritur.

III.2 (Sh)Përdorimi i pushtetit të të rriturve gjatë përkthimit

Letërsia për fëmijë paraqet një gjini të veçantë studimit të së cilës i kushtohet rëndësi për shkak të marrëdhënieve të pabarabarta ndërmjet shkrimtarit dhe lexuesit. Për sa i përket përkthimit të kësaj letërsie, ekziston një mungesë ekuilibri në ushtrimin e pushtetit të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë, që nga fëmijët që lexojnë librat, të rriturit që i lexojnë librat, ata që shkruajnë, botojnë dhe vlerësojnë librat (ose që janë të përfshirë në një mënyrë apo në një tjetër në shpërndarjen apo gjetjen e librave), e deri në mësuesit, prindërit, shitësit e librave, bibliotekarët, etj.

Le t'i rikthehemi tani diskutimit tonë duke shtruar fillimisht pyetjen; Çfarë nënkupton pushteti? Afësia që ka dikush për të ndikuar vepruar në një mënyrë të caktuar, aftësia për të diktuar apo ndikuar sjelljen e të tjerëve ose rrjedhën e ngjarjeve, fuqia që ushtrohet mbi dikë tjetër.[185] Kontrolli mund të nënkuptojë edhe aftësinë për të marrë vendime, për të nënshtruar të tjerët me qëllim arritjen e synimeve vetjake. Duke u nisur nga arsyet ekonomike, mund të themi se pushteti është në duart e botuesve sepse ata kanë paratë si një mjet për ushtrimin e pushtetit: ata vendosin se cilët shkrimtarë do të përzgjidhen, përkthyesit që do të punësohen dhe mënyrën e përkthimit të librit. Gjithashtu, duke u nisur nga ushtrimi i kontrollit, të rriturit ushtrojnë pushtetin e tyre mbi fëmijët, të cilët janë më të dobët dhe pa përvojë, kështu që ata e shfrytëzojnë këtë varësi për t'iu imponuar fëmijëve normat dhe idetë e tyre. Kështu, pushteti mund të interpretohet si aftësia që kanë më të fuqishmit për të shfrytëzuar të tjerët dhe për të

[185] http://oxforddictionaries.com/definition/english/power.

përforcuar vullnetin e tyre mbi ta. I rikthehemi sërish pyetjes sonë: Në duart e kujt është pushteti në rastin e përkthimit të letërsisë për fëmijë?

- ***Shkrimtari***

Shkrimtarët kanë rol të ngjashëm me përkthyesit, kanë përgjegjësi si ndaj tekstit ashtu edhe ndaj publikut. Dallimi ndërmjet tyre qëndron në faktin se përkthyesit duhet t'i përmbahen tekstit të prodhuar nga shkrimtari, ndërsa shkrimtari është i lirë në përzgjedhjet e tij. Gjithashtu, duke iu përmbajtur skemës së mësipërme,[186] shkrimtari është në "duart" e përkthyesve dhe botuesve. Kështu, edhe shkrimtari nuk është i vetëm në punën e tij. Shkrimtarja Astrid Lindgren përshkruan marrëdhënien e saj me përkthyesit – ata janë të nevojshëm për të si shkrimtare por ajo duhet t'iu besojë që ata do ta bëjnë punën e tyre duke e kënaqur shkrimtaren.[187] Mund të ndodhë edhe që vetë shkrimtarët të jenë në rolin e përkthyesit, duke pasur kështu më shumë liri dhe të drejta se një përkthyes jo-shkrimtar.

- ***Përkthyesi***

Nga pikpamja teleologjike, të përkthyerit është një proces komunikimi: synimi i përkthimit është që të mbartë njohuritë e origjinalit për lexuesit e huaj.[188] Nga pikpamja e punës së përkthyesit (nga këndvështrimi pragmatik) përkthimi është një proces vendimmarrjeje: një sërë situatash të njëpasnjëshme – si lëvizjet në një lojë – situata të cilat e detyrojnë përkthyesin që të zgjedhë mes një sërë alternativash. Loja që merret si shembull është loja e shahut sepse çdo lëvizje pasardhëse ndikohet nga njohuritë e vendimeve të mëparshme dhe situata që është krijuar si pasojë e atyre vendimeve. Procesi i vendimmarrjes në përkthim ka strukturën e një sistemi semiotik, duke përfshirë aspektin semantik dhe atë sintaksor. Si në të gjithë proceset semiotike, përkthimi ka edhe dimensionin e tij pragmatik: përkthyesi orientohet ndaj asaj mundësie zgjedhjeje që premton një efekt maksimal me përpjekje minimale.[189] Më tej, Jiri Levi (Jiří Levý) shprehet se nga kjo strategji e ashtëquajtur minimaks mund të përfitojnë disa lloje letërsish ndër të tjera letërsia për të rinj dhe ngre pyetjen se nëse, duke iu përmbajtur procedurave të kësaj strategjie, duhet të ruajmë mjetet stilistikore në varësi të llojit të tekstit dhe të publikut marrës,[190] gjë që paraqet interes në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë.

Të përkthyerit, pra, përbën një proces vendimmarrjeje nën ndikimin e faktorëve të tillë si: konteksti, lloji i tekstit, publiku marrës. Në këtë proces përkthyesi duhet të ketë parasysh jo vetëm lexuesit-fëmijë, por njëkohësisht edhe grupet ndërmjetëse – kjo e vendos përkthyesin në një pozicion të vështirë sepse duhet që të përbushë njëherazi kërkesat e faktorëve të ndryshëm vetëm nëpërmjet një teksti të përkthyer. Duke pasur gjithmonë parasysh fëmijët, përkthyesit duhet të njohin sa më mirë gjuhën që mund të përdoret për ta dhe, njëkohësisht, gjuhën e fëmijëve. Ata duhet të njohin gjithashtu edhe kulturën origjinale dhe ta përcjellin atë në mënyrë të pranueshme në gjuhën e përkthimit. Sërish, meqenëse përkthyesit janë fillimisht në rolin e marrësit dhe pastaj në rolin e dërguesit, ata nuk mund të jenë asnjëherë krejtësisht objektivë dhe larg interpretimeve dhe përvojave personale, gjë që e vështirëson edhe më shumë punën e tyre. Nuk mund të

---

[186] T. Weinreich (1978) *International Book Production for Children Related to the Children's Local Experiences and Local Consciousness*. në G. Klingberg, M. Ørvig, S. Amor (ed.s) *Children's Books in Translation. The Situation and The Problems*. Stockholm, Almqvist&Wiksell International, fq. 148-149.
[187] A. Lindgren (1969) *Traduire les Livres d'Enfants – est-ce possible?* në Babel, fq. 100.
[188] J. Levý **(**2000) *The Translation Studies Reader. (*ed.*)* L. Venuti. London, Routledge, fq. 148-156.
[189] Po aty, fq. 156.
[190] Po aty, fq. 158.

lemë pa përmendur edhe faktin se përkthyesit e letërsisë për fëmijë nuk paguhen mirë, dhe, shpesh, sasia e librave të përkthyer mbizotëron mbi cilësinë e tyre. Kushtet e prodhimit përcaktojnë cilësinë e përkthimeve duke i kthyer në luks përkthimet "e mira" të cilat përkthyesit nuk mund t'i përballojnë dot finianciarisht.[191]

- ***Shtëpitë Botuese***

Shtëpitë botuese marrin vendime në varësi të kushteve ekonomike. Ato gjenden para dilemës nëse duhet të përkthejnë libra që blihen ***për*** fëmijë apo libra që blihen ***nga*** fëmijët. Në këtë aspekt, një ndikim të madh ka edhe media dhe të gjithë format e saj, që, nëpërmjet popullarizimit të një filmi apo seriali të caktuar, bën që të lindë një shtysë për përkthimin e një libri të veçantë që, në rast mungese të popullarizimit, nuk do të ishte pjesë e kërkesës së tregut. Pra, edhe pse përkthyesit kanë pushtet në përzgjedhjen e materialit që do të përkthehet, në të vërtetë janë botuesit ata që iu përgjigjen kërkesës së tregut dhe kostos.

Shtëpitë botuese, parë me syrin e biznesit, duhet të veprojnë në bazë të përfitimeve, duke pasur si qëllim parësor rritjen e shitjeve që të arrijnë sa më shpejt fondin e shpenzuar prej tyre. Sigurisht që çdo shtëpi botuese ka një buxhet të caktuar, kështu që do të përzgjidhen me kujdes ata libra që do të botohen, së bashku me librat e përkthyer, dhe do të financohen ri-përkthimet dhe nxirren sërish në treg të librave të përkthyer më parë. Botuesit do të bazohen në atë që tregu kërkon, në librat që shiten, në marrëdhënien ofertë-kërkesë. Nga ana tjetër, janë pikërisht shtëpitë botuese që sjellin ofertën në tregun letrar në një vend të caktuar, kjo nënkupton se përgjegjësia e tyre është e shumëfishtë dhe nuk mund dhe nuk duhet të reduktohet thjesht në planin financiar. Shpesh, shtëpia botuese lidhet me përkthyes të veçantë që punojnë për të, në varësi edhe të llojit të librit që do të përkthehet. Aspekti financiar ndikon edhe në kushtet e punës së përkthyesit, pagesën dhe kohën në dispozicion të tij nga shtëpia botuese. Pasi ka përfunduar përkthimi dhe është dorëzuar, është radha e redaktorëve që të bëjnë "ndryshime" sipas vlerave të shoqërisë, por edhe sipas aspektit financiar, duke kufizuar numrin e paragrafeve ose faqeve. Kjo fazë është me rëndësi edhe për qëndrimin që mbahet ndaj ilustrimeve të pranishme në origjinal, një çështje kjo jo pa rëndësi për përkthimin e librave për fëmijë. Nuk mund të mos përmendim edhe faktin se prania e përkthyesit duhet të ndihet që në kopertinë dhe të mos lihet në hije, gjë që do të shtonte edhe përgjegjësinë e përkthyesit ndaj punës së vet dhe ndaj publikut marrës. E gjejmë me vend të theksojmë edhe një herë se, siç shprehet edhe përkthyesi Edmond Tupja, *përkthyesit nuk janë thjesht hije.*[192]

- ***Kritiku***

Ky faktor është shumë i rëndësishëm sepse priret drejt cilësisë së përkthimit. Janë kritikët ata që duhet të analizojnë problemet që dalin gjatë përkthimit. Procesi i vlerësimit kritik të një libri duhet të jetë po aq i rëndësishëm sa vetë procesi i të përkthyerit, sepse edhe faktorët që duhen marrë në konsideratë janë më të shumtë. Në rastin e letërsisë për fëmijë merren parasysh edhe arsye pedagogjike dhe shoqërore, njëkohësisht, edhe mënyra se si ato do të ndikojnë në ofertën letrare të tregut, sepse shkollat, bibliotekat dhe prindërit do të ndikohen prej tyre. Theksojmë se nuk duhet keqkuptuar procesi i vlerësimit kritik dhe

---

[191] J. Becker (1978) *The Internationalism of Children's Books: Translations and their Ideological Deformations in the Federal Republic of Germany*. në G. Klingberg, M Ørvig, S. Amor. *(ed.s) Children's Books in Translation. The Situation and The Problems*. Stockholm, Almqvist&Wiksell International, fq. 40.

[192] E. Tupja (2003) *Pro Translatore – Shënime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin*. Shtëpia e Librit OMBRA GVG: Tiranë, fq.16.

të reduktohet thjesht në një analizë pedantike të vetë përkthimit pa bërë krahasimin e vazhdueshëm me origjinalin.

Shumë nga kritikët e librave të përkthyer nuk e njohin as veprën në origjinal dhe as gjuhën e huaj dhe e vlerësojnë përkthimin nisur nga natyrshmëria, rrjedhshmëria, lexueshmëria dhe mungesa e interferencave, të cilat janë të gjitha standarte artificiale. Vlerësimi bëhet nga krahasimi i origjinalit me përkthimin dhe probleme që shfaqen gjatë krahasimit, ndër të cilat përmendim titullin, strukturën, paragrafët, lidhëzorët, metaforat, fjalët kulturore, emrat e përveçëm, neologjizmat, fjalët e papërkthyeshme, shumëkuptimësinë, nivelin e gjuhës, lojërat e fjalëve, etj.[193]

- ***Ilustruesi***

Çështja e ilustrimeve ka rëndësi të veçantë në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Siç shprehet edhe Rita Otinen ilustrimet janë shumë të rëndësishme në letërsinë për fëmijë, meqenëse të gjithë librat për fëmijë kanë ilustrime.[194] Ato i ndihmojnë fëmijët që të ndërtojnë imazhe pamore të ngjarjeve, personazheve kryesore, ideve kryesore të tekstit. Sipas saj, ilustrimet janë interpretime që mund të modifikojnë përvojën e lexuesit, të ndikojnë publikun dhe që e bëjnë përvojën e të lexuarit më emocionuese sepse iu japin domethënie të veçantë teksteve të caktuara.[195] Edhe prania e ilustrimeve në një tekst të përkthyer konsiderohet të jetë një formë tjetër përkthimi,[196] prandaj ato duhen përzgjedhur me kujdes. Ilustrimet janë të pranishme që në kopertinë dhe na ndihmojnë të krijojmë një imazh dhe pritshmëri të caktuar që pa filluar të lexojmë veprën dhe është ky imazh fillestar që do të na ndjekë në vijim të librit. Për këtë arsye, nevojitet një bashkëpunim i mirë mes përkthyesve, botuesve dhe ilustruesve. Mbi të gjitha është e rëndësishme që të ketë koherencë mes imazheve fillestare ilustruar në kopertinë dhe atyre që janë në brendësi të librit, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, ngjarjeve dhe përshkrimeve të tyre. Për këtë qëllim është e nevojshme që të specifikohet që në fillim nëse janë ruajtur ilustrimet e origjinalit apo janë përdorur ilustrime të tjera. Përdorimi i ilustrimeve si në origjinal (ndonjëherë edhe riprodhimi i së njëjtës kopertinë) bën që edhe lexuesit të jenë më afër shkrimtarit dhe veprës origjinale, ndërsa ilustrime të reja i largojnë lexuesit nga përcjellja e mesazhit të veprës origjinale. Cilado nga këto dy rrugë të ndiqet nga shtëpia botuese, është tejet e rëndësishme që të mos krijohen mospërputhje mes brendisë së veprës dhe mesazheve që përcillen nga ilustrimet, duke ditur se sa rëndësi iu kushtojnë fëmijët imazheve pamore dhe sa shumë nguliten ato në kujtesën e tyre.

Kështu, pra, edhe ilustrimet janë një nga elementët tregues që shërbejnë për të formuar imazhet pamore në lidhje me personazhet, dhe, si të tilla, janë të rëndësishme për lexuesin dhe ushtrojnë një farë pushteti mbi të. Kjo duhet kuptuar nga shtëpitë botuese që edhe ato t'iu kushtojnë rëndësinë dhe kohën e duhur elemëntëve të tillë në përkthimin e librave për fëmijë, në mënyrë që të respektojnë shkrimtarin dhe tekstin origjinal, por, njëkohësisht, edhe fëmijët – lexuesit e tekstit të përkthyer.

- ***Grupet ndërmjetëse***

---

[193] P. Newmark (1988) *A Textbook of Translation*. Prentice Hall Longman ELT, fq. 185-187.

[194] R. Oittinen (2006) *No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children*. Në J. Van Coillie, and W.P. Verschueren (eds.), *Children's Literature in Translation. Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 93-99.

[195] Po aty, fq. 102.

[196] B. Stolt, (2006) *How Emil Becomes Michel: On the Translation of Children Books*. në G. Lathey (ed.) *The Translation of Children's Literature: A Reader*. Clevedon, Buffalo, Toronto: Multilingual Matters, fq. 82.

Librat për fëmijë përgjithësisht blihen nga prindërit, të afërmit, shkollat, bibliotekat, e kështu me rradhë. Elementë të tillë janë në rolin e ndërmjetësve midis shtëpive botuese dhe publikut marrës – vetë fëmijëve. Në procesin e përzgjedhjes dhe blerjes së librave grupet ndërmjetëse mbajnë parasysh zhvillimin e fëmijëve si pjesëtarë të pranueshëm në shoqërinë e të rriturve. Prindërit përdorin pushtetin e tyre mbi fëmijët duke kontrolluar përzgjedhjen e librave që iu ofrojnë fëmijëve për të arritur qëllimet e tyre gjatë rritjes së fëmijëve dhe formimit të personalitetit të tyre. Shkollat dhe bibiliotekat, gjithashtu, ushtrojnë pushtetin e tyre mbi brezat e ardhshëm, duke shpërndarë një ideologji të caktuar. Duke ushtruar pushtetin e tyre mbi fëmijët, grupet ndërmjetëse, në mënyrë të tërthortë, ushtrojnë ndikim edhe mbi letërsinë e përkthyer. Nëpërmjet diktimit të blerjeve, ata ndikojnë edhe në vendimet e shtëpive botuese të cilët paguajnë për përkthimet. Por, në të vërtetë, ç'pjesë të letërsisë së përkthyer përfaqëson një zgjedhje të bërë nga vetë fëmijët?

- ***Fëmijët***

Fëmijët sot kanë më shumë njohuri se fëmijët para dy apo tri dhjetëvjeçarësh. Këto njohuri merren nga bota që i rrethon. Prindërit janë në gjendje më të mirë financiare, fëmijët kanë udhëtuar më shumë, fëmijët lexojnë letërsi ashtu si dhe të rriturit, dinë më shumë fjalë, bota e fantazisë është më e zhvilluar. E, megjithatë, fëmijët janë konsumatorët që vendosen në fund të procesit të përzgjedhjes, edhe si blerës, edhe si lexues të librave për fëmijë. Megjithatë, nuk mund të mohojmë faktin se fëmijët sot janë kthyer në pjesëmarrës aktivë të tregut për shkak të mundësive ekonomike të tyre, duke pasur edhe ata, në këtë drejtim, pushtet në duart e tyre, gjë që nuk duhet nënvleftësuar. Edhe duke pasur parasysh këtë dukuri të kohëve të fundit, përsëri, mungesa e përvojës dhe njohurive – karakteristike për moshën e fëmijërisë – bën që fëmijët të mbeten nën pushtetin e të rriturve të sipërpërmendur. Nga ana tjetër, ka edhe një mënyrë për ta analizuar këtë situatë në të cilën ndodhen fëmijët dhe të rriturit: Nëse të gjithë e përshtatin letërsinë sipas nevojave të fëmijëve, a nuk janë vetë ata – fëmijët – që, në mënyrë të tërthortë, ushtrojnë pushtet?

- ***Shpërndarja e pushtetit***

Pyetja *Në duart e kujt është pushteti?* lidhet me pyetjen *Për kë përkthehet letërsia për fëmijë?* Për shtëpitë botuese (që të kenë përfitime), për prindërit (që kërkojnë të blejnë libra "të përshtatshëm") apo për fëmijët (të cilëve u drejtohen shkrimtarët origjinalë)? Pushteti, në fakt, ekziston në shumë nivele dhe nuk përqëndrohet në një vend të vetëm. Çdokush në një shoqëri moderne ka pjesën e tij të pushtetit, edhe fëmijët të cilët mendohen si të nënshtruar ndaj më të rriturve që janë më të fuqishëm se ata. Ajo që ndryshon, në të vërtetë, është niveli i pushtetit që ka secili, meqenëse jo të gjithë e ushtrojnë pushtetin në masë të njëjtë. Përkthyesit ndonjëherë janë në pozicionin e më dobtëve – të kufizuar nga shtëpitë botuese, grupet ndërmjetëse, madje, edhe nga vetë fëmijët dhe shijet e tyre.

III.3 Modelet e përkthimit të letërsisë për fëmijë

Pse përkthehet letërsia për fëmijë? Po paraqesim shkurtimisht disa nga qëllimet e përkthimit të letërsisë për fëmijë sipas studiuesve të huaj:

Sipas Klingbergut, ka katër qëllime kryesore se pse përkthehet letërsia për fëmijë:

- për të shtrirë këndvështrimin e tyre dhe të kuptuarit në nivel ndërkombëtar, dhe për të njohur përvojën emocionale të vendeve dhe kulturave të huaja,

- për t'iu ofruar më shumë letërsi fëmijëve,
- për të ndihmuar në zhvillimin e vlerave të lexuesve
- për t'iu dhënë lexuesve një tekst që ata mund ta kuptojnë nisur nga niveli i pamjaftueshëm i njohurive.[197]

Dy qëllimet e para i kundërvihen dy qëllimeve të dyta (grupi i parë kërkon që teksti të ndiqet me besnikëri, ndërsa sipas grupit të dytë mund të lindë nevoja që të bëhen ndryshime të tekstit origjinal).

Sipas Kristianë Jungut (Christiane Jung), qëllimi kryesor është njohja dhe respektimi i popujve të tjerë.[198]

Sipas Klaus Fluges (Klaus Flugge), qëllimi i letërsisë për fëmijë është lidhja imagjinative, intelektuale dhe kulturore me njerëzit e kulturave dhe gjuhëve të tjera.[199]

Sipas Marianë Kerës (Marianne Carus), sa më shpejt që fëmijët të njihen me një apo më shumë kultura të huaja, aq më mendjehapur do të bëhen ata.[200]

Sipas Ulf Haranthit (Wolf Harranth), përkthyes i shumë librave për fëmijë nga anglishtja në gjermanisht, përkthyesit e librave për fëmijë nuk paguhen mirë dhe situata e tyre finianciare ndikon edhe në cilësinë e përkthimeve të tyre.[201] Si pasojë e statusit të tyre inferior, përkthimet dhe përkthyesit e letërsisë për fëmijë shpesh nuk shfaqen si të tillë. Librat për fëmijë nuk kalojnë në duart e kritikëve dhe përkthyesit e tyre injorohen. Rrjedhimisht, nuk ndodh rrallë që në përkthime të ketë ndryshime, shtesa, mospërfshirje të tekstit origjinal. Një gjë e tillë pranohet, nisur nga fakti se fëmijët nuk kanë shumë përvojë dhe njohuri.

Zohar Shavit gjatë diskutimit mbi letërsinë për fëmijë në veprën *Poetics of Children's Literature* na sugjeron disa modele të përgjithshme për shkrimin dhe përkthimin e veprave për fëmijë. Ajo bazohet në teorinë e polisistemeve sipas *Even-Zohar* dhe e zbaton atë në gjininë e letërsisë për fëmijë, duke theksuar pozicionin periferik që kjo gjini ze brenda polisistemit letrar, dhe, për rrjedhojë, prestigjin i ulët. Për më tepër, përkthimi i letërsisë për fëmijë ka një pozicion edhe më periferik, përkthyesit e letërsisë për fëmijë mbështeten në norma të paravendosura të themeluara paraprakisht. Një pozicion i tillë i lejon përkthyesit që të manipulojë tekstin për aq kohë sa vrojtohen dy parimet kryesore: roli didaktik i letërsisë për fëmijë (teksti duhet të jetë edukativ dhe "i mirë për fëmijët") dhe përshtatja e subjektit, personazheve dhe gjuhës sipas aftësive të të lexuarit dhe të kuptuarit të fëmijëve. Shaviti përshkruan pesë lloje të ndryshme kufizimesh në lidhje me të kuptuarit që zakonisht diktojnë qëndrimin global të përkthyesit në lidhje me përmbajtjen dhe formulimin verbal të një teksti origjinal që do të përkthehet për fëmijë duke e dalluar nën-sistemin e letërsisë për fëmijë nga nën-sisteme të tjera.

1- *Pozicionimi në modelet ekzistuese:* teksti duhet të përshtatet me një model ekzistues në letërsinë marrëse, për rrjedhojë një satirë, për shembull, e shkruar fillimisht për të rritur, mund të ndryshohet në një histori të thjeshtë fantazie meqënëse modeli i satirës nuk ekziston në letërsinë për fëmijë në gjuhën e përkthimit.

---

[197] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators*. Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq. 10.

[198] C. Jung (1996) *Tea-time oder Kaffee und Kuchen?*në *Bulletin Jugend und Literatur 2,* fq. 13.

[199] K. Flugge (1994) *Crossing the Divide* në *The Bookseller.* fq. 18.

[200] M. Carus (1980) *Translation and Internationalism in Children's Literature*. në *Children's Literature in Education. Vol.11/No.4,* fq. 174.

[201] W. Harranth (1996) *... und nun das Ganze.* Në *TAUSEND und EIN BUCH 1996/No.5* fq. 15, 16; (1997) *Good Morning, how are you?* Në *Forum Schule Heute 1997/Heft 4,* fq. 16, 18.

2- *Tërësia e tekstit:* përkthyesit mund të manipulojnë tërësinë e tekstit origjinal për ta përshtatur me aftësitë për të kuptuar dhe normat morale të fëmijëve. Gjithashtu, është e lejueshme që të fshihen disa pjesë dhe skena që nuk janë në përputhje me vlerat mbizotëruese morale ose ato që, sipas të rriturve, do të mund të kuptohen nga fëmijët.
3- *Niveli i ndërlikueshmërisë së teksteve,* me pak fjalë, thjeshtësimi i tekstit. Nëse teksti përbëhet nga dy ose më shumë nivele (vecanërisht tekstet shumëkuptimëshe) ai do të reduktohet në një nivel të vetëm kuptimi. Elementë të tillë si tematika, karakterizimi dhe strukturat kryesore të tekstit nuk duhet të jenë shumë të ndërlikuara (p.sh. elementët ironikë nuk duhet të përfshihen); kjo normë zakonisht është në paralel me të parën dhe të dytën.
4- *Përshtatja vlerësuese ose ideologjike:* kufizimet bazohen në konceptin e letërsisë për fëmijë si një instrument didaktik dhe transmetues ideologjie: ndonjëherë teksti origjinal mund të ndryshohet krejtësisht për t'u përshtatur me ideologjinë mbizotëruese në kulturën e përkthimit.
5- *Normat stilistike:* në letërsinë për fëmijë kërkohet një stil i pasur letrar veçanërisht për arsye didaktikore – për të pasuruar fjalorin e fëmijëve.[202]

Për më tepër, Shaviti beson se përkthyesi i letërsisë për fëmijë mund të jetë më i lirë në punën e tij për shkak të pozicionit të ulët të letërsisë për fëmijë brenda polisistemit. Ai mund të manipulojë tekstin për aq kohë sa merr në konsideratë dy parimet e mëposhtme në të cilat bazohet letërsia për fëmijë:

- *përshtatja e tekstit në mënyrë të tillë që të jetë i dobishëm për fëmijë, në përputhje me atë që shoqëria mendon se është "mirë për fëmijët",*
- *përshtatja e subjektit, përsonazheve dhe gjuhës me nivelin e të kuptuarit të fëmijës dhe aftësive të tij për të lexuar.*[203]

Nga ana tjetër, përkthyesja finlandeze Otinen paraqet një mendim të ndryshëm në lidhje me besnikërinë. Sipas saj, përkthyesit duhet të marrin parasysh pritshmëritë e lexuesve të ardhshëm. Çdo lloj përkthimi nënkupton një farë përshtatjeje. Bazuar në kritikun letrar amerikan Harold Blum (Harold Bloom), ajo shprehet se edhe origjinali mund të konsiderohet si një përshtatje e vetë jetës, shkrimtarët e origjinalit kanë përshtatur historitë e tyre për fëmijë, kështu që përkthyesit bëjnë përshtatje sipas kulturës dhe gjuhës së tyre.[204] Është një shenjë besnikërie ndaj shkrimtarit të veprës origjinale nëse do të arrihet që teksti i përkthyer të jetojë në gjuhën e përkthimit, të pranohet dhe të pëlqehet në kulturën marrëse. Shembujt e sjellë nga Otineni përfshijnë shkrimtarë të tillë si Ljuis Kerrël, Tov Janson (Tove Jansson) dhe Roald Dal (Roald Dahl) të cilët kanë qenë vetë ata që i kanë shkruar përsëri librat e tyre për një publik të ndryshëm. Një dukuri e tillë i jep të drejtë përkthyesit që të jetë *besnik* ndaj publikut të tij – fëmijëve (duke iu përmbajtur nocionit të besnikërisë përshkruar nga Otinen). Siç mund ta vemë re, është e vështirë që të dallohet qartë se ku mbaron përkthimi dhe fillon përshtatja; në fakt, nuk ka shumë dallim ndërmjet tyre. Kjo është edhe arsyeja se pse shumë shkrimtarë, përkthyes e studiues nuk kanë të njëjtin qëndrim si Otineni, edhe pse të gjithë janë të të njëjtit mendim për faktin se *besnikëria* përbën një problem kompleks në përkthimin e letërsisë për fëmijë. Kompleksiteti i problemit shfaqet, ndër të tjera, në elementë të tillë si

[202] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*. Athens: University of Georgia Press, fq. 112-128.
[203] Z. Shavit (1981) *Translation of Children's Literature and its Position in the Literary Polysystem*. Në *Poetics Today* 1981/Vol.2/Part 4, fq. 171, 172.
[204] R. Oittinen (1993) *On the Dialogics of Translating for Children*, në C. Picken (ed.) *Translation: The Vital Link. XIII FIT World Congress.* London, Institute of Linguistics, fq. 86.

veçanësitë kulturore dhe niveli i përshtatjes së tyre[205] dhe fakti nëse publiku marrës do të pranojë elementë nga norma kulturore të huaja.[206] Në këtë këndvështrim, përmendim edhe nocionin e Klingbergut: "*përshtatja kulturore kontekstuale*" – një term që përfshin një sërë strategjish që shërbejnë për të afruar një tekst origjinal me lexuesit fëmijë në kulturën e përkthimit. Klingbergu duke diskutuar mbi *shkallën e përshtatjes* (niveli deri në të cilin merren parasysh karakteristikat e lexuesve të vegjël) emërton ndryshimin që mund t'i bëhet tekstit si *përshtatje kulturore kontekstuale* - një term që përfshin një sërë strategjish që shërbejnë për të afruar një tekst origjinal me lexuesit fëmijë në kulturën e përkthimit. Përshtatja mbështetet në supozimin që lexuesit e vegjël do ta kenë të vështirë të asimilojnë emrat e huaj, ushqimet, emrat e vendeve, monedhat e huaja dhe se ata mund ta mënjanojnë një tekst që pasqyron një kulturë që nuk është e njohur. Megjithatë, Klingbergu sugjeron që përshtatja të kufizohet në detaje dhe teksti origjinal të manipulohet sa më pak të jetë e mundur. Përshtatja, sipas tij, nuk nënkupton thjesht rregullimin e tekstit sipas vlerave morale të kulturës marrëse, por ka të bëjë me raste të tilla si prania e gjuhëve të huaja në tekstin origjinal, zakone dhe norma, ushqime të caktuara, lojëra, elementë të botës bimore dhe shtazore, emra të përveçëm, monedha dhe njësi matëse, etj.[207] Gjithashtu, një formë e përdorshme e përshtatjes kontekstuale që është vërtet domethënëse për lexuesit fëmijë është ajo e dialektit ose të folmeve ku ekziston prirja që përkthyesit t'iu përshtaten modeleve ekzistuese në kulturën e përkthimit.

Përkthyesja angleze Anthia Bell (Anthea Bell) është për një fleksibilitet më të lartë. Në disa raste, shprehet ajo, një grup emrash të huaj në faqet e para të librit mund t'i largojë lexuesit e vegjël, kështu që përkthyesi duhet të gjejë shkallën e duhur të pranisë së elementëve të huaj, dhe sa e pranueshme është që ata të ruhen meqenëse, pasi fëmijët fitojnë interes në një rrëfim, ata do të mbajnë mend shumë mirë emrat dhe vendet e huaja pavarësisht se mund të mos kenë njohuri për mitet, legjendat dhe trillimet e shkruara as në gjuhën e tyre dhe aq më pak në variantin e përkthyer, për më tepër, fëmijët nuk do të magjepsen dhe të tërhiqen nga gjërat e ndryshme nëse këto nuk iu prezantohen atyre.[208]

III.4 Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit

Një çështje shqetësuese për përkthyesin e teksteve për fëmijë është kufizimi i pashmangshëm i botës së njohurive të të vegjëlve. Nuk mund të mendohet se lexuesit e rinj kanë fituar aftësinë për të kuptuar në thellësi të dhënat kulturore, gjuhësore dhe gjeografike që merren si të mirëqena për lexuesit e rritur. Meqënëse shpjegimet në fund të faqes nuk janë gjithmonë një zgjidhje e kënaqshme për këtë problem, një taktikë që, pavarësisht diskutimeve që shkakton, përdoret shpesh në përkthimin e teksteve për fëmijë është ajo që, duke ndjekur terminologjinë përdorur nga *Venuti*, do ta do ta shprehim në gjuhën shqipe nëpërmjet dy termave *amëtarizim* dhe *huajëzim.* Qëndrimi *amëtarizues* nënkupton asimilimin e tekstit të huaj sipas vlerave mbizotëruese në kulturën marrëse, ndërsa qëndrimi *huajëzues* nënkupton mbarjten e vlerave kulturore dhe gjuhësore

[205] E. O'Sullivan (1993) *The fate of dual addressee in the translation of children's literature*. në *New Comparison 16*, fq. 5.

[206] T. Kurultay (1994) *Probleme und Strategien bei der Kinderliterarischen Übersetzung im Rahmen der Interkulturellen Kommunikation*. në H. Ewers, E. O'Sullivan (ed.s) *Kinderlitertatur im Interkulturellen Proseβ* Stuttgart, Weimar: Metzler fq. 199.

[207] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators*, fq. 12-18. Gjatë studimit të hollësishëm që Klingberg ka bërë në lidhje me librat për fëmijë përkthyer nga gjuha suedeze në atë angleze, ai identifikon nëntë forma të shfaqjes së përshtatjes kulturore kontekstuale të cilat ne do t'i trajtojmë më në hollësi në kreun e pestë të këtij punimi.

[208] A. Bell (1985) *Translator's Notebook: The Naming of Names.* Në *Signal 46/1985*, fq. 7.

origjinale nëpërmjet përkthimit.[209] Sipas *Venutit* elementët e huaj të tekstit origjinal duhen ruajtur gjatë përkthimit, duke përdorur, për shembull, terma arkaike ose rend të përmbysur të fjalëve, me qëllim që të mos "asimilohet" origjinaliteti nëpërmjet gjuhës dhe kulturës së përkthimit (pavarësisht nëse mund të prodhohet efekti i dëshiruar). Ai mendon se rreziku më i madh i amëtarizimit qëndron në faktin se nëpërmjet përkthimit neutralizohen gjithë dallimet kulturore, ekonomike dhe politike duke sjellë dhunshëm elementët e huaj dhe të panjohur të tjetërsuar sipas gjuhës së përkthimit.[210] Diskutimi është shumë i thellë, në fakt, dhe qëndron në qendër të shkrimeve të sotme mbi statusin e veprës së përkthyer kundrejt origjinalit, por, për qëllimet e këtij punimi ne do t'i referohemi terminologjisë së tij për të vërejtur shkallën e përcjelljes së vlerave kulturore të origjinalit dhe nivelin e pranisë së tyre në tekstin e përkthyer.

Gjatë kësaj çështjeje do të shqyrtojmë hollësisht korpusin tonë për të identifikuar prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit si dhe shkallën e pranisë apo dukshmërisë së shkrimtarit origjinal dhe kulturës origjinale në tekstin e përkthyer. Më tej, krahasimi i shembujve me origjinalin do të jetë me rëndësi për të nxjerrë në pah jo vetëm qëndrimin e përkthyesve ndaj origjinalit, por edhe ndaj publikut marrës të përkthimit (kryesisht, por, jo domosdoshmërisht, fëmijë) dhe kulturës së tyre. Shembujt do të krahasohen edhe ndërmjet tyre (në rastin kur ekzizstojnë variante të ndryshme të së njëjtës vepër origjinale) me synimin për të vlerësuar shkallën e qëndrueshmërisë apo nënshtrimit të tekstit dhe kulturës origjinale ndaj asaj të përkthimit. Një krahasim i tillë do të ndihmojë në ndërtimin e një analize diakronike të prirjeve të përmendura si dhe hamendësimeve në lidhje me nivelin e arritjes së efektit të synuar.

III.4.1 Sfond teorik mbi amëtarizimin dhe huajëzimin

Një tekst letrar kontekstualizohet gjithmonë brenda një komuniteti specifik gjuhësor dhe kulturor, dhe, si i tillë, është gjithmonë specifik në lidhje me normat shoqërore, kulturore, historike dhe gjuhësore. Procesi i përkthimit bën që kërkimi për ekuivalencë të plotë mes gjuhëve dhe kulturave të ndryshme të jetë jo vetëm i vështirë, por edhe i panevojshëm. Një nga vendimet më të rëndësishme që duhet të marrin përkthyesit e letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe është nëse do të krijojnë një tekst që do të ruajë elementët kulturorë (anglezë dhe amerikanë) apo do të prodhojnë një tekst që do të pranohet në mjedisin marrrës (shqiptar). Këto dy prirje të ndryshme përfaqësojnë një dilemë që është përshkruar nëpërmjet mënyrave dhe terminologjive të ndryshme nga studiuesit e përkthimit në kohë të ndryshme. Që në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Fridrish Shlajermaher (Friedrich Schleiermacher) e konsideronte atë përkthim që mbartte gjurmët e së huajës si më të përshtatshëm se një përkthim të neutralizuar.[211] Në mënyrë të ngjashme, Antuan Berman e vlerëson Shlajermaherin për kritikën e tij të hershme radikale dhe gjithashtu mbështet praktikën e përkthimeve etnocentrike.[212] Nga ana tjetër,

---

[209] M. Snell-Hornby (2006) *The Turns of Translation Studies: New Paradigms or Shifting Viewpoints.* John Benjamins B. V., Philadelphia, USA, fq. 145; L. Venuti (2004) *The Translator's Invisibility: A History of Translation.* London and New York: Routledge, fq. 81. Terminologjia në gjuhën angleze është përkatësisht *domesticating* dhe *foreignizing* dhe është përshtatur prej meje në gjuhën shqipe si *amëtarizim* dhe *huajëzim.*

[210] R. Ellis & L. Oakley-Brown (ed.) (2001) *Translation and Nation: Towards a Cultural Politics of Englishness*, Clevedon: Multilingual Matters, fq. 153.

[211] F. Schleiermacher në L. Venuti (1991) *Genealogies of Translation Theory: Schleiermacher*. TTR 4:2, fq. 128-131.

[212] A. Berman në L.Venuti (2004) *The Translation Studies Reader*. London and New York: Routledge, fq. 284-297.

[214] L. Venuti (1995) *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge,fq. 240.

Lorens Venuti, studiuesi që ka kontribuar në mënyrë domethënëse në këtë debat, fajëson strategjitë amëtarizuese sepse ato e bëjnë përkthyesin e padukshëm. Sipas tij, strategjitë e përkthimit konsistojnë fillimisht në përzgjedhjen e elementëve të huaj që do të përkthehen dhe, më tej, në zhvillimin e një metode për t'i përkthyer ata.[213] Metodat, nisur nga strategjitë e zgjedhura nga përkthyesit, mund të ndahen në dy grupe kryesore: amëtarizuese dhe huajëzuese.

Studiuesit përdorin terminologji të ndryshme, megjithatë, mund të gjejmë qëndrime të përbashkëta mes tyre. Për shembull, sipas Shlajermaherit, ka dy rrugë ose dy mundësi zgjedhjeje për përkthyesin: *ose përkthyesi do ta lërë të qetë shkrimtarin sa më shumë të jetë e mundur dhe do të afrojë lexuesit me shkrimtarin, ose do të lërë të qetë lexuesin sa më shumë të jetë e mundur dhe do të afrojë shkrimtarin me lexuesin.*[214] Shlajermaheri mbështet qëndrimin e parë dhe i nxit përkthyesit që t'i çojnë lexuesit jashtë kufijve që të mos i mbajnë ata "në shtëpi", pra, në mjedise të njohura për ta. Këto dy rrugë, sipas terminologjisë së Venutit, njhen me termat *huajëzim* dhe *amëtarizim.* Përkthimet që ndjekin rrugën e amëtarizimit krijojnë te lexuesit përshtypjen se teksti nuk është një përkthim dhe se ai është shkruar që në fillim në gjuhën e përkthimit. Venuti e përshkruan mbizotërimin e përkthimeve të veprave të huaja të amëtarizuara në gjuhën angleze si gjuhë të përkthimit si një rrugë që bën që përkthimet të duken si vepra origjinale dhe përkthyesit të jenë sa më shumë të "padukshëm".[215] Gjithashtu, ai na paralajmëron kundër rreziqeve të tilla të amëtarizimit si për shembull: një sjellje superioriteti, madje, edhe kapitalizmi, ndaj atyre kulturave gjuha origjinale e të cilave nuk është anglishtja. Ai mbështet më shumë një *qëndrim huajëzues*, i cili, sipas tij, do ta bënte lexuesin që të arrinte të ndjente dallimet kulturore dhe gjuhësore, dhe, njëkohësisht, do të motivonte procesin e të lexuarit duke ruajtur cilësitë karakteristike të tekstit origjinal si dhe shijen e tij të huaj, d.m.th. duke sjelle në tekstin e përkthyer dallimet gjuhësore dhe kulturore. Duke iu referuar sërish përkthimit të letërsisë për fëmijë, huajëzimi mund të ketë edhe qëllime edukative, meqenëse ruajtja e njësive specifike kulturore i përfshin fëmijët në një proces ndërgjegjësimi më të lartë në lidhje me kultura dhe popuj të tjerë. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se, duke mbajtur një qëndrim huajëzues, edhe pse lexuesit marrin më shumë të dhëna për kulturën e huaj, ekziston gjithmonë rreziku i mungesës së të kuptuarit, meqenëse vështirësia e të kuptuarit të tekstit ngrihet në një nivel më të lartë. Sido që të jetë, duhet të theksojmë se në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë, amëtarizimi dhe huajëzimi prekin çështje delikate sepse përkthimet kanë ndikim shumë të lartë në mënyrën se si fëmijët i konceptojnë kulturat e huaja.

Ka edhe studiues modernë, si për shembull Maria Timocko (Maria Tymoczko), të cilët e mohojnë dikotominë e sipërpërmendur në lidhje me orientimin përjashtimor të përkthyesit ndaj një qëndrimi ose një tjetër. Sipas Timockos, një përkthim mund të jetë "*i orientuar në mënyrë radikale ndaj tekstit original në disa aspekte, por mund të largohet sërish në mënyrë radikale prej tij në disa aspekte të tjera duke u asimiluar kështu brenda një norme në kulturën marrëse.*"[216] Ka ende studiues të ndryshëm që vazhdojnë të japin kontributin e tyre në këtë debat. Përgjithësisht, mund të pohojmë se një qëndrim amëtarizues priret të jetë një përvojë leximi më e njëtrajtshme për lexuesit, ndërsa, një

---

[214] F. Schleiermacher në M. Snell-Hornby (1988) *Translation Studies: An Integrated Approach*. Amsterdam: John Benjamins, fq. 145.

[215] L. Venuti (1995) *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge, fq. 1.

[216] M. Tymoczko (1999) *Translation in a Postcolonial Context: Early Irish Literature in English Translation.* Manchester, UK: St. Jerome Publishing, fq. 55-56.

qëndrim huajëzues kërkon më shumë njohuri dhe përvojë rreth gjuhës origjinale dhe vlerave të saj autentike.

Duke e mbyllur diskutimin tonë, mund të themi se, meqë përkthyesit janë gjithmonë të përfshirë në procese vendimarrjeje, ata duhet të tregojnë vazhdimisht kujdes gjatë përzgjedhjes së strategjisë që do të përdorin. Vendimet e tyre varen nga faktorë të ndryshëm si p.sh. qëllimi i përkthimit, mosha e publikut marrës, etj., por, ajo çka është edhe më e rëndësishme, ata duhet të shfaqin qëndrueshmëri në vendimet e tyre me qëllim që të mos shkaktojnë pështjellim në lexuesit dhe të mos ndërpresin procesin e natyrshëm të të lexuarit dhe të të kuptuarit.

III.4.2 Shfaqje konkrete të prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit

Në këtë pjesë të punimit në do të identifikojmë disa njësi kulturore specifike në korpusin nën shqyrtim dhe do të vërejmë gjithashtu përdorimin e strategjive konkrete nga ana e përkthyesve për t'i sjellë këto njësi në gjuhën shqipe. Prirjet e përkthyesve shqiptarë do të klasifikohen sipas dy qëndrimeve kryesore: *amëtarizimit* dhe *huajëzimit*, klasifikim ky që do të na lejojë të reflektojmë mbi shkallën e dukshmërisë së shkrimtarit dhe kulturës origjinale kundrejt vlerave kulturore shqiptare në tekstet e përkthyer. Gjatë krahasimit do të përpiqemi t'iu përgjigjemi pyetjeve të tilla si: Çfarë njësi specifike kulturore gjenden në tekstet origjinale në gjuhën angleze? Si janë sjellë ato në gjuhën shqipe? Cila është prirja mbizotëruese përdorur nga përkthyesit në gjuhën shqipe në secilin prej varianteve dhe në gjithë korpusin në përgjithësi? A ka raste ku përkthyesi nuk tregohet i qëndrueshën në llojin e qëndrimit të mbajtur brenda të njëjtit variant në gjuhën shqipe? A ndikon një gjë e tillë në nivelin e të kuptuarit të tekstit nga ana e lexuesve?

Për të kryer një studim brenda objektivave të lartpërmendura kemi zgjedhur si tekste origjinalë *Alice's Adventures in Wonderland*, *Gulliver's Travels* dhe *Robinson Crusoe* në krahasim me variantet e tyre në gjuhën shqipe. Kemi marrë në studim variante të ndryshme të së njëjtës vepër për të identifikuar edhe më mirë prirjet e ndryshme të përkthyesve ndaj të njëjtit tekst origjinal, dhe, njëkohësisht, për të diskutuar mbi shkallën e qëndrueshmërisë së të njëjtës prirjeje brenda të njëjtit variant. Gjithashtu, një korpus i gjerë na ndihmon për të siguruar të dhëna në lidhje me përkthimin e njësive specifike kulturore jo vetëm në fushën e përkthimit të letërsisë për fëmijë, por në përgjithësi për përkthimin letrar. Rikujtojmë se përzgjedhja e korpusit nën shqyrtim përligjet nëpërmjet përceptimit të përkthimit si një proces transferimi, jo vetëm nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, por edhe nga sistemi i të rriturve në sistemin e fëmijëve.[217]

Për të nxjerrë në pah prirjen mbizotëruese të vërejtur në variantet në gjuhën shqipe, kemi lexuar paralelisht tekstet origjinale dhe tekstet e përkthyera duke pasur si synim kryesor identifikimin e njësive specifike kulturore të teksteve në gjuhën angleze dhe mënyrën se si ato janë "ndryshuar" nëpërmjet përkthimit. Shembujt që kanë qenë shprehje e së njëjtës prirjeje janë grupuar si shfaqje e së njëjtës sjellje nga ana e përkthyesit apo përkthyesve. Pas procesit të identifikmit dhe krahasimit, kemi analizuar shembujt dhe kemi nxjerrë të dhëna të rëndësishme që kanë shërbyer si një themel i shëndoshë për ndërtimin e tabelave dhe grafikëve, që, nga ana e tyre, na kanë ndihmuar për të nxjerrë gjetjet dhe përfundimet e përmendura në fund të analizës.

Amëtarizimi dhe huajëzimi mund të zbatohen për aspekte të ndryshme të teksteve: ngjarje historike, rite fetare dhe kulturore, emra të përveçëm, etj. Qëllimi ynë është të zbulojmë se si njësitë specifike kulturore angleze sillen në gjuhën shqipe: nëse gjurmë të tyre janë ruajtur në tekstin e përkthyer apo nëse ato janë asimiluar në gjuhën

[217] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature.* Athens: University of Georgia Press, fq.111.

shqipe. Për përkufizimin e kulturës jemi mbështetur në qëndrimin e Njumarkut*: "mënyra e jetës dhe manifestimeve të saj, që janë të veçanta për një komunitet që përdor një gjuhë të veçantë si mjet shprehjeje."* Gjithashtu, sipas tij, "*terma të lidhur me kulturën, qofshin këto leksema me një njësi të vetme apo shprehje dhe grupe fjalësh janë ato që lidhen veçanërisht me mënyrën e jetesës dhe shprehjeve të saj që janë të veçanta për një komunitet që përdor gjuhën si mjet shprehjeje"*.[218] Brenda qëllimeve të kësaj çështjeje ne do të kufizohemi në përkthimin e njësive monetare, njësive matëse si dhe ushqimeve dhe pijeve. Përkthimi i emrave të përveçëm, për shkak të problematikës komplekse që mbulon, edhe pse përfshihet brenda njësive kulturore specifike, do të trajtohet në kreun e katërt, ku do të diskutojmë në mënyrë të hollësishme për qëndrimin e mbajtur nga përkthyesit ndaj dukurisë së ndërtekstualitetit dhe mënyrat e ndryshme të shfaqjes së saj.

Për të mbështetur studimin tonë nga ana teorike po i referohemi gjuhëtarit dhe studiuesit kroat Vladimir Ivir (Vladimir Ivir) dhe taksonomisë "*Procedura dhe strategji për përkthimin e kulturës"* prezantuar prej tij rreth përkthimit të fjalëve kulturore, një taksonomi që ka shërbyer si themel për shumë klasifikime të tjera të mëvonshme.[219] Brenda këtij modeli përfshihen shtatë strategji: *huazimi, përkufizimi, përkthimi fjalë për fjalë, zëvendësimi, krijimi leksikor, mospërfshirja* dhe *shtimi*, që do t'i shpjegojmë dhe ilustrojmë më poshtë me shembujt vjelë nga korpusi nën shqyrtim. Meqenëse prezantimi i të gjithë shembujve do të na merrte shumë hapësirë dhe kohë, mendojmë se është e mjaftueshme të përmendim vetëm shembuj përfaqësues për secilën nga strtategjitë e lartpërmendura. Duhet të kemi parasysh se përfundimet e përmendura në fund të çështjes i referohen të gjithë shembujve të vjelë (edhe pse vetë shembujt nuk përmenden një për një për shkak të hapësirës së konsiderueshme që do të kërkonte një gjë e tillë).

a. Huazimi

Huazimi ka të bëjë me transmetimin e saktë të informacionit kulturor. Sipas studiuesit Vladimir Ivir, kjo strategji përdoret shpesh nga përkthyesit në ato raste kur lexuesi mund ta dallojë termin e huazuar dhe kuptimin e mbartur prej tij. Si një strategji, huazimi mund të kombinohet me përkufizimin ose zëvendësimin. Gjithashtu, sipas tij, huazimi është më e pranueshme si strategji kur "teksti i përkthyer është relativisht i hapur ndaj ndikimeve të huaja".[220]

Shembulli 1

[218] P. Newmark (1988) *A Textbook of Translation.* Prentice-Hall International, fq. 94.

[219] V. Ivir (1987) *Procedures and strategies for the translation of culture*. Cituar në *Translation across Cultures*", G. Toury, Bahri Publications, New Delhi, fq. 39). Për klasifikime të mëvonshme mund t'i referoheni studimeve të tilla si ato realizuar nga: P. Newmark (1988) *A Textbook of Translation.* New York, Prentice Hall, fq. 103*;* S. Hervey and I. Higgins (1992*) Thinking Translation: A Course in Translation Method: French to English.* London and New York: Routledge.: fq. 103; S. Florin (1993) *Realia in Translation. Në* P. Zlateva (ed) *Translation as Social Action. Russian and Bulgarian Perspectives*. London-New York, fq. 125-7), J. P. Mailhac (1996) *The Formulation of Translation Strategies for Cultural References.* Në C. Hoffman (ed) *Language, Culture and Communication in Contemporary Europ*e. Clevedon: Multilingual Matters, fq. 137; J. F. Aixelá (1996) *Culture-specific Items in Translation.* Në *Translation, Power, Subversion.* (ed.) A. Roman and M. Vidal, Carmen-Africa, Multilinugal Matters Ltd. Fq. 62-64); P. Kwieciński (2001) *Disturbing Strangeness. Foreignisation and Domestication in Translation Procedures in the Context of Cultural Assymetry*. Toruń: Wydawnictwo EDYTOR, fq. 157-165); J. Pedersen (2007) *Scandinavian Subtitles: A Comparative Study of Subtitling Norms in Sweden and Denmark with a focus on Extralinguistic Cultural References.* Stockholm: Stockholm University, fq. 127-155), etj.

[220] V. Ivir (1987) *Procedures and strategies for the translation of culture*. Cituar në *Translation across Cultures*", G. Toury, Bahri Publications, New Delhi, fq. 38.

...about two months after my arrival, we set out for the metropolis, situated near the middle of that empire, and **about three thousand miles distance** from our house… (GT, fq. 103)	…gati dy muaj pas ardhjes sime, u nisëm për kryeqytet, që bie pothuaj në zemër të perandorisë, **nja tri mijë milje nga shtëpia jonë.** (UG, fq. 114)
Shembulli 2	
Let me see: that would be **four thousand miles** down, I think - "…(AAiW, fq. 13)	- Prit të shoh, duhet të kem zbritur nja **katër milje**, besoj… (LBÇ - V.III, fq. 12)
Shembulli 3	
I found after I came **about two Miles up**, that the Tide did not flow any higher, and that it was no more than a little Brook of running Water, and very fresh and good; (RC, fq. 84)	Eca **nja dy milje përpjetë** tij dhe pikasa që lumi nuk vinte nga larg dhe që ai kishte si burim një përrua me ujë të ëmbël shumë të mirë. (RK - fq. 97)

Nëpërmjet të tre shembujve mund të vërejmë se si njësia specifike kulturore – ***miles*** – huazohet në të njëjtën formë në gjuhën shqipe.

b. Përkufizimi

Sipas Ivirit, kjo strategji nuk përdoret shumë gjerësisht e izoluar, por si plotësuese e huazimit. Ka mënyra të ndryshme për të prezantuar përkufizimet, si, për shembull, në trupin e tekstit ose nëpërmjet shënimeve në fund të faqes.[221] Ndonjëherë, ashtu siç shprehet me të drejtë edhe studiuesi Ivir, kjo strategji mund të na çojë drejt mbipërkthimit dhe mbitheksimit të disa shprehjeve gjuhësore që, në mungesë të kësaj strategjie, nuk do të theksoheshin në tekstin origjinal. Ai na kështillon kundër përdorimit të kësaj strategjie në ato raste kur termi kulturor përdoret thjesht në sfondin kulturor.

Shembulli 1	
This liquor tasted like a small **cyder**, and was not unpleasant. (GT, fq. 93)	Pija i ngjante në shije **sidrës*** dhe nuk më vinte e keqe. [****Cidre (frëngjisht), cyder (anglisht) = një farë vere, që nxirret nga molla. Mjeda ka përdorur fjalën sider***.] (UG, fq. 103)
Shembulli 2	
"Write than down," the King said to the jury; and the jury eagerly wrote down all three dates on their slates, and the added them up, and reduced the answer to **shillings and pence.** (AAiW, fq. 113)	"Shkruaje këtë! – urdhëroi Mbreti. Anëtarët i shkruan të tria datat në pllakat e tyre, i mblodhën dhe pastaj e kthyen përgjigjen në **shëllings dhe pencë***. (*para të vogla angleze). (LBÇ - V.II, fq. 131)
Shembulli 3	
But first, I was to prepare more Land, for I had now Seed enough to sow **above an Acre** of Ground. (RC, fq. 101)	Por në fillim duhet të lëroja një copë tokë më të gjerë, se kisha aq farë sa mund të mbillja **një akër*** (*masë toke prej 4047 metrash katrore). (RK, fq. 113)

Në shembullin e parë, njësia kulturore shpalos një pije, e cila transmetohet në të njëjtën formë në gjuhën shqipe, ndjekur nga një përkufizim shpjegues dhënë në shënimin në fund të faqes. Shembulli i dytë konkretizon përdorimin e strategjisë së përkufizimit për

[221] Po aty, fq. 39.

përkthimin e njësive monetare, sërish shoqëruar nga një shënim në fund të faqes. Edhe nëpërmjet shembullit të tretë mund të vërejmë se si është përkufizuar njësia kulturore specifike në shënimin e dhënë në fund të faqes nga ana e përkthyesit. Në të treja rastet, përkufizimet shoqërohen nga huazimi i njësisë kulturore nga gjuha origjinale.

c. Përkthimi fjalë për fjalë

Kjo strategji përfshin përkthimin fjalë për fjalë të konceptit që nuk është i njohur për publikun marrës së tekstit të përkthyer. Kjo procedurë, sipas Ivirit, është mënyra më e shpeshtë për transferimin kulturor.

Shembulli 1

I saw a stage erected **about a foot and a half** from the ground …(GT, fq. 17)	…kishin ngritur një palk **ndonjë këmbë e gjysmë** të lartë… (UG, p. 23)

Shembulli 2

She took down a jar from one of the shelves as she passed: it was labeled "**ORANGE MARMALADE,"** but to her great disappointed it was empty. (AAiW, fq.13)	… Liza ndërsa binte poshtë zgjati dorën dhe kapi një kavanoz në etiketën e të cilit shkruhej me shkronja të mëdha: "**MARMALATË PORTOKALLI".** Por u zhgënjye shumë kur vuri re se kavanozi ishte bosh. (LBÇ - V.IV, fq. 7)

Shembulli 3

… very often I would go and carry them **some Ears of Barley, or a handful of Rice**, and feed them out of my Hand; (RC, fq. 125)	U afrohesha dendur me **ca kallëza elbi a me një dorë oriz**, që e hanin në pëllëmbën time. (RK, fq. 135)

Në shembullin e parë, njësia kulturore specifike është një njësi matëse, ndërsa në shembullin e dytë dhe të tretë, njësitë kulturore përfaqësojnë ushqim. Në të tre rastet, njësitë përkthehen fjalë-për-fjalë në gjuhën shqipe.

ç. Zëvendësimi

Në ato raste kur kultura origjinale dhe ajo e gjuhës së përkthimit mbivendosen pjesërisht, përkthyesit mund të përdorin strategjinë e zëvendësimit. Nëpërmjet zëvendësimit, një shprehje që emërton një koncept të ngjashëm në kulturën marrëse mund të përdoret sikur të ishte një ekuivalent i plotë. Megjithatë, ekziston gjithmonë rreziku i asimilimit të termave ose koncepteve kulturorë të huaj në kulturën marrëse.[222]

Shembulli 1

…I wondered how I could forbear when I saw his dishes of **the size of a silver three-pence**, a leg of pork hardly a mouthful, a cup not so big as a nutshel… (GT, fq. 157)	Më dukej si e rreme kur shihja pjatat, që më ngjanin **sa një qindarkë**, kofshën e derrit, që s'ma zinte synë as për kafshatë, ose kupat, që më shëmbëllenin si lëvozhga arre (UG, fq. 176)

Shembulli 2

Who stole the **tarts**? (AAiW, fq. 110)	Kush i vodhi **boskotat?** (LBÇ - V.I, fq. 117)

[222] Duke reflektuar mbi përdorimin e procedurës së zëvendësimit, Iviri shprehet se e meta kryesore e kësaj procedure është se "identifikon koncepte që nuk janë identikë, duke eleminuar elementët e huaj të kulturës së huaj dhe duke i trajtuar konceptet e kulturës së huaj sikur të mos ishin të huaj dhe t'i përkisnin kulturës marrëse" (Po aty, fq. 42).

Shembulli 3

They had left two Men in the Boat, who as I found afterwards, having drank a little too much **Brandy**, fell a-sleep; (RC, fq. 213)

...kishin mbetur dy veta që...kishin pirë një çikë si shumë **raki** e ia kishin marrë me gjumë. (RK, fq. 224)

Shembulli i parë është një njësi monetare e huaj e zëvendësuar me një koncept të njohur për shqiptarët. E njëjta strategji përdoret edhe në rastin e dytë, kur njësia kulturore është një ushqim, jo shumë i njohur për shqiptarët, dhe për këtë arsye përkthyesi e ka transformuar atë në një ëmblësirë më të "pranueshme" shqiptare. Në shembullin e tretë shfaqet një njësi kulturore në formën e një pijeje shumë të njohur për lexuesit e origjinalit, e cila është zëvendësuar me një njësi të ngjashme në gjuhën shqipe, të njohur gjerësisht në kulturën tonë. Strategjia e zëvendësimit, siç mund të duket edhe nga shembujt, nuk arrin të përcjellë faktin se komunikimi origjinal ka ndodhur në një sfond kulturor të huaj dhe se teksti origjinal ka qenë një shprehje e një kulture të ndryshme.

d. Krijimi leksikor

Nëpërmjet krijimit leksikor, përkthyesit mund të përkthejnë njësi që konsiderohen të paleksikalizuara apo që nuk ekzistojnë as si koncepte në gjuhën dhe kulturën e përkthimit. Këto fjalë të reja mund të pranohen e të përdoren më tej në gjuhën e përkthimit, ose mund të mos pranohen dhe të përdoren vetëm një herë, nesë janë të vështira për të kuptuar dhe të krijuara artificialisht në krahasim me përdorime më të natyrshme të gjuhës së përkthimit.

Shembulli 1

When bending my eyes downwards as much as I could, I perceived it to be a human creature **not six inches high,** with a bow and arrow in his hand, and a quiver at his back. (GT, fq. 16)

Kur vështrova sa mund të shikoja nga ajo anë, pashë një njeri të gjallë, që nuk e kishte shtatin **as gjashtë gishtërinj të gjatë***; mbante në duar një hark e një shtizë dhe i varej në sup një kukurë. (****Masa e gishtit është baras me një të dymbëdhjetën e këmbës, ose afro 7 milimetra. Prandaj të gjashtë gishtërinjtë janë pak më shumë se gjashtëmbëdhjetë centimetra***.) (UG, fq. 21)

Shembulli 2

However, this bottle was *not* marked 'poison,' so Alice ventured to taste it, and finding it very nice, (it had, in fact, a sort of mixed flavour of cherry-tart, custard, pineapple, roast turkey, **toffee**, and hot buttered toast,) she very soon finished it off. (AAiW, fq. 17)

Ajo u bind se në etiketën e shishes nuk ishte shkruar "helm", prandaj e ktheu ta provonte dhe e vërteta është se lëngu i saj iu duk shumë i shijshëm. Shija e saj kishte diçka që të kujtonte tortën me qershi, me krem, me ananas, gjelin e pjekur, **kërcitëset** dhe kekun e ngrohtë me gjalp. (LBÇ - V.IV, fq. 13)

Shembulli 3

I had but a small Quantity at last, my whole Crop not amounting to **above half a Peck** of each kind. (RC, fq. 90)

... të korrat e mia nuk kapërxyen **një gjysmë shiniku** për çdo lloj fare. (RK, fq. 103)

Në shembullin e parë, përkthyesi ka zgjedhur të krijojë një term të ri për matjen e distancës, një term që nuk përdoret zakonisht në gjuhën shqipe. Në shembullin e dytë, është krijuar sërish një term i ri, kësaj radhe për të "mbushur" një hapësirë leksikore për

një lloj karameleje që nuk është pjesë e kulturës shqiptare. Shembulli i tretë ka të bëjë me një njësi matëse të njohur për publikun anglez dhe amerikan, por e panjohur brenda kulturës shqiptare, dhe, për këtë arsye, përkthyesi na prezanton një njësi të re matëse, nëpërmjet procedurës së krijimit leksikor.

dh. Mospërfshirja

Mospërfshirja ka të bëjë me fshirjen e njësive kulturore specifike të pranishme në tekstin origjinal, që, pas përdorimit të kësaj procedure, nuk do të përfshihen më në tekstin e përkthyer. Një veprim i tillë mund të justifikohet për shkak të qëllimeve komunikative.[223]

Shembulli 1

She was very good-natured, and **not above forty foot high**, being little for her age. (GT, fq. 99)	---------- (UG, fq. 109)

Shembulli 2

But she went on all the same, shedding **gallons of tears**, until there was a large pool all around her, about four inches deep and reaching half down the hall (AAiW, fq. 21)	Mirëpo përsëri vazhdoi të qante (--------), derisa rreth e përqark saj u formua një pellg i vërtetë, afër 10 centimetra i thellë, që hapej deri në mes të sallës. (LBÇ - V.III, fq. 21)

Shembulli 3

… and as soon as they came to a little rising Ground, **at about half a Mile Distance**, I bad them hollow, as loud as they could, and wait till they found the Seamen heard them. (RC, fq. 222)	...me të ngjitur një të përpjetë të vogël, (--) të thërritnin me të gjithë mushkëritë, gjersa të bindeshin se i kishin dëgjuar detarët.. (RK, fq. 235)

Siç mund të duket nga vetë shembujt, mospërfshirja është përdorur për të shmangur transferimin e njësive specifike kulturore në gjuhën shqipe: në rastin e parë dhe në rastin e tretë të njësive matëse të distancës, ndërsa, në rastin e dytë, njësive matëse të vëllimit të lëngjeve.

e. Shtimi

Gjatë përdorimit të kësaj procedure, përkthyesit qartësojnë në gjuhën e përkthimit ato të dhëna që shprehen në tekstin origjinal, të cilat, ndonëse mund të jenë të kuptueshme për lexuesit e tekstit në origjinal, mund të mos jenë të qarta për lexuesit e përkthimit.

Shembulli 1

i then took some **refreshment**, and went to my rest. (GT, fq. 78)	**Hëngra e piva** dhe rashë të marr një sy gjumë. (UG, fq. 89)

Shembulli 2

She was now only **ten inches high**.... (AAiW, fq. 17)	Ajo qe katandisur **vetëm një pëllëmbë njeri**. (LBÇ - V.II, fq. 8).

Shembulli 3

I boil'd, or stew'd some of the Flesh, and made some **very good Broth**;. (RC, fq.179)	...Zjeva një copë të mirë në një kusi që mbaja për këtë punë dhe bëra **një supë ose jahni të shijshme.**. (RK, fq. 190)

[223] Duhet të kemi parasysh se në taksonominë e përshkruar nga *Ivir* nuk merren në konsideratë mospërfshirjet që bëhen me qëllim shkrutimin e tekstit, gjë që ndodh shpesh në praktikën e përkthimit.

Mund të shohim se si në të tre rastet njësitë specifike kulturore janë qartësuar në gjuhën shqipe, duke shtuar disa të dhëna sqaruese

III.4.3 Shprehja e rezultateve të studimit krahasimor nëpërmjet tabelave dhe grafikëve

I rikthehemi tani terminologjisë së përdorur nga Lorens Venuti sipas dikotomisë së sipërpërmendur, duke u përpjekur të klasifikojmë brenda kësaj dikotomie secilën prej procedurave që sapo përshkruam dhe ilustruam:

Tabela nr. 4
Strategji për përkthimin e njësive kulturore specifike
(duke iu referuar taksonomise së V. Ivir dhe dikotomisë së L. Venuti)

Amëtarizim	***Huajëzim***
Zëvendësim	Huazim
Mospërfshirje	Përkthim fjalë për fjalë
Krijim leksikor	Përkufizim
	Shtim

Pasi kemi identifikuar gjithë njësitë specifike kulturore në tekstet origjinale dhe në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe, do të analizojmë të dhënat me qëllim vlerësimin e shpeshtësisë së përdorimit të procedurave përfshirë në dikotominë e mësipërme, dhe më tej, përcaktimin e faktit nëse, në përgjithësi, njësitë specifike kulturore janë asimiluar në gjuhën shqipe (pra, ndjekin prirjen e amëtarizimit) apo janë ruajtur si elementë të huaj të gjuhës dhe kulturës angleze (pra, shfaqen nën prirjen e huajëzimit). Para se të analizojmë të dhënat, përmendim se shembujt që ne kemi identifikuar janë të shumtë dhe i tejkalojnë hapësirat konkrete të këtij studimi dhe është e pamundur që të bëjmë një renditje të tyre, nga shembulli i parë deri në shembulli i fundit, për secilin prej rasteve studimorë. Ne do të mjaftohemi me shembujt ilustrues që kemi paraqitur më lart për secilën nga procedurat për përkthimin e njësive kulturore, ndërsa në pjesën që vijon më poshtë do të paraqesim tabela dhe grafikë të cilat i kemi përpunuar pikërisht nga shembujt e vjelë, ndonëse shembujt konkretë nuk po i përmendim. Në këtë mënyrë, do të vërejmë për secilën nga veprat e përkthyera në gjuhën shqipe nëse përkthyesit janë të prirur më tepër drejt qëndrimit amëtarizues apo atij huajëzues. Le të lexojmë analizat e mëposhtme, të pasqyruara nëpërmjet tabelave dhe grafikëve.

Rast Studimor 1 "Gulliver's Travels"

E nisim analizën tonë duke u përqendruar në *Gulliver's Travels* dhe variantin në gjuhën shqipe. Kemi identifikuar gjithësej **342 njësi specifike kulturore** në veprën origjinale dhe në tabelën më poshtë do të prezantojmë procedurat e ndryshme nëpërmjet të cilave këto njësi kulturore (si, për shembull, *pound, league, mile, brandy, inch, yard, foot, meat, liquor, gold, silver*, etj.) janë sjellë në gjuhën shqipe për lexuesit shqiptarë.

Tabela nr. 5
Procedurat e përkthimit të njësive specifike kulturore në variantin në gjuhën shqipe të *"Gulliver's Travels"*

Prirja	**Amëtarizim**	**Huajëzim**

Procedura	*Zëvendësim*	*Mospërfshirje*	*Krijim leksikor*	*Huazim*	*Përkthim fjalë për fjalë*	*Përkufizim*	*Shtim*
Nr. i njësive	61	14	23	90	144	3	7
Përqindja	17%	4%	7%	26%	42%	1%	2%
Gjithsej	**29%**		**98**	**71%**		**244**	

Grafiku nr. 1
Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe të Gulliver's Travels

Siç duket edhe nga tabela dhe grafiku i mësipërm, prirja mbizotëruese është *huajëzimi*, gjë që do të thotë se elementët e huaj janë ruajtur dhe janë sjellë në gjuhën shqipe, kryesisht nëpërmjet procedurave të përkthimit fjalë për fjalë (42%) dhe huazimit (26%). Megjithatë, nuk mund të lemë pa përmendur se një sasi domethënëse e njësive specifike kulturore janë amëtarizuar ose përshtatur në kulturën e gjuhës shqipe, nëpërmjet zëvendësimit (17%), krijimit leksikor (7%), ose mospërfshirjes (4%).

Rast Studimor 2 "Alice's Adventures in Wonderland"
Duke iu referuar rastit studimor nr. 2 - *Alice's Adventures in Wonderland* – mund të themi se kemi identifikuar gjithsej **43 njësi specifike kulturore** (si, për shembull, *mile, inch, gallon, foot, shilling, pence, marmelade, tart, toffee, toast, treacle, lobster*, etj.) dhe nëpërmjet tabelave të mëposhtme do të prezantojmë të dhëna që do të na japin më shumë informacion rreth mënyrës se si njësitë kulturore sillen në variantet në gjuhën shqipe.
Tabela nr. 6
Prirjet e përkthimit në variantin I të *"Alice's Adventures in Wonderland"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	*Zëvendësim*	*Mospërfshirje*	*Krijim leksikor*	*Huazim*	*Përkthim fjalë për fjalë*	*Përkufizim*	*Shtim*
Nr. i njësive	17	2	1	2	15	0	6
Përqindja	40%	5%	2%	5%	34%	0%	14%
Gjithsej			**20**			**23**	

	47%	**53%**

Tabela nr. 7
Prirjet e përkthimit në variantin II të *"Alice's Adventures in Wonderland"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	***Zëvendësim***	***Mospërfshirje***	***Krijim leksikor***	***Huazim***	***Përkthim fjalë për fjalë***	***Përkufizim***	***Shtim***
Nr. i njësive / Përqindja	18 / 42%	4 / 9%	0 / 0%	4 / 9%	12 / 28%	0 / 0%	5 / 12%
Gjithsej	**22** / **51%**			**21** / **49%**			

Tabela nr. 8
Prirjet e përkthimit në variantin III të *"Alice's Adventures in Wonderland"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	***Zëvendësim***	***Mospërfshirje***	***Krijim leksikor***	***Huazim***	***Përkthim fjalë për fjalë***	***Përkufizim***	***Shtim***
Nr. i njësive / Përqindja	17 / 40%	3 / 6%	0 / 0%	5 / 12%	13 / 30%	0 / 0%	5 / 12%
Gjithsej	**20** / **46%**			**23** / **54%**			

Tabela nr. 9
Prirjet e përkthimit në variantin IV të *"Alice's Adventures in Wonderland"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	***Zëvendësim***	***Mospërfshirje***	***Krijim leksikor***	***Huazim***	***Përkthim fjalë për fjalë***	***Përkufizim***	***Shtim***
Nr. i njësive / Përqindja	20 / 46%	2 / 5%	2 / 5%	2 / 5%	15 / 34%	0 / 0%	2 / 5%
Gjithsej	**24** / **56%**			**19** / **44%**			

Tabela nr. 10
Prirjet e përkthimit në variantin V të *"Alice's Adventures in Wonderland"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	***Zëvendësim***	***Mospërfshirje***	***Krijim leksikor***	***Huazim***	***Përkthim fjalë për fjalë***	***Përkufizim***	***Shtim***

Nr. i njësive / Përqindja	10	3	5	9	13	1	2
	24%	6%	12%	21%	30%	2%	5%
Gjithsej	**18**			**25**			
	42%			**58%**			

Grafiku nr.2 Përmbledhje e prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit në secilin prej 5 varianteve



Tabelat dhe ilustrimet e rezultateve nëpërmjet grafikëve shfaqin qartë se prirjet shpërndahen në pothuajse të njëjtën përqindje në të gjitha variantet me dallime të lehta. Për shembull, në variantin e parë, të tretë dhe të pestë mbizotëron huajëzimi, në variantin e dytë dhe të katërt amëtarizimi. Shkalla e amëtarizimit është më e lartë në variantin e sjellë në gjuhën shqipe nga vëllezërit *Tafa* (varianti i katërt), gjë që tregon se, me kalimin e viteve, më pak elementë të huaj sillen në gjuhën dhe kulturën shqipe. Megjithatë, duhet thënë se brenda secilit variant, prirjet shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme, pa shfaqur marrëdhënie kontrastive ndaj një prirjeje apo një tjetër, gjë që nganjëherë nënkupton se përkthyesit nuk janë shumë të qëndrueshëm në pëtkthimin e njësive specifike kulturore, për shembull, e njëjta njësi mund të përkthehet nëpërmjet procedurave të ndryshme brenda të njëjtit variant. Kemi gjetur shumë shembuj të cilët nuk na lejonin ta pozicononim veten qartë si lexues: në një mjedis shqiptar që përdor para të huaja, në një kontekst britanik që përdor pare dhe njësi matëse shqiptare, etj. Kalimi nga një prirje në tjetra brenda së njëjtit variant shkakton pështjellim në të kuptuarin e përgjithsshëm të

tekstit nga ana e lexuesve si dhe perceptimin e kulturës së huaj, si dhe, në një shkallë më të gjerë, një cilësi më të ulët përkthimi.

Rast Studimor 3 "Robinson Crusoe"

Pas një kërkimi të kujdesshëm, në veprën origjinale kemi identifikuar gjithsej **505** njësi kulturore specifike, të cilat iu referohen njësive matëse në hapësirë dhe në peshë, ushqimeve, pijeve si dhe njësive monetare, si për shembull, përkthimi i njësive të tilla si *league, yard, mile, pund, foot, bisket, rum, rice, gold, silver, moidores*, etj. Tabela dhe grafiku që vijojnë do të tregojnë më konkretisht prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit në përkthimin e kësaj vepre.

Tabela nr. 11
Procedurat e përkthimit të njësive specifike kulturore në variantin në gjuhën shqipe të *"Robinson Crusoe"*

Prirja	**Amëtarizim**			**Huajëzim**			
Procedura	***Zëvendësim***	***Mospërfshirje***	***Krijim leksikor***	***Huazim***	***Përkthim fjalë për fjalë***	***Përkufizim***	***Shtim***
Nr. i njësive	107	30	30	131	195	4	8
Përqindja	21%	6%	6%	26%	38%	1%	2%
Gjithsej	**33%**		**167**	**67%**		**338**	

Grafiku nr. 3
Prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe të "Robinson Crusoe"

Siç duket edhe nga tabela dhe grafiku i mësipërm, prirja mbizotëruese është *huajëzimi*, përdorur nga ana e përkthyesit në një masë rreth dy herë më shumë se prirja amëtarizuese, gjë që do të thotë se elementët e huaj janë ruajtur dhe janë sjellë në gjuhën shqipe, kryesisht nëpërmjet procedurave të përkthimit fjalë për fjalë (38%) dhe huazimit (26%). Në një numër të ulët rastesh përdoren teknika editoriale dhe sqaruese, si shënimet në fund të faqes. Sërish nuk duhet të lemë jashtë vëmendjes sonë se rreth një e treta e njësive kulturore nën shqyrtim janë amëtarizuar ose përshtatur në kulturën e gjuhës shqipe, kryesisht nëpërmjet zëvendësimit me njësi të ngjashme (21%), si dhe janë krijuar

leksikalisht njësi të reja në gjuhën shqipe (6%) dhe disa prej tyre nuk janë përkthyer fare (6%). Mendojmë se prirja mbizotëruese e përkthyesit është pikërisht e orientuar ndaj huajëzimit, nisur edhe nga dëshira për ta sjellë me sa më shumë vërtetësi personazhin dhe aventurat e tij ashtu si ai shfaqet në një mjedis të huaj, tipik anglez, si dhe, njëkohësisht, duke mos iu drejtuar ekskluzivisht një publiku të përbërë nga fëmijë, por, një publiku të përbërë nga të rritur e të vegjël njëkohësisht. Për më tepër, mendojmë se nëse fëmijët do të shfletonin këtë variant në ditët e sotme, sasia e njësive kulturore të huajëzuara nuk do të përbënte pengesa në procesin e të kuptuarit, meqenëse, siç e kemi theksuar edhe në fillim të këtij punimi, njohuritë e fëmijëve në brezin e sotëm nuk janë të kufizuara, dhe, nga ana tjetër, dëshira e tyre për të përthithur sa më shumë informacione të reja, është gjithmone e më tepër në rritje.

Në përfundim të këtij diskutimi mund të themi në mënyrë të përmbledhur se tekstet origjinale kanë qenë të pasur me njësi specifike kulturore, megjithatë ne morëm në analizë vetëm ato njësi që kishin të bënin me njësi matëse, njësi monetare dhe ushqime dhe pije. Pasi krahasuam tekstin origjinal dhe përkthimin, i klasifikuam gjithë njësitë e gjetura sipas dy prirjeve kryesore: amëtarizimi dhe huajëzimi. Prirja mbizotëruese në përkthimin e UG dhe RK është dukshëm huajëzimi, ndërsa në LBÇ mbizotëron huajëzimi në variantin e parë, të tretë dhe të pestë dhe amëtarizimi në variantin e dytë dhe të katërt. Duhet të përmendim se të dyja prirjet shpërndahen pothuajse në mënyrë të njëtrajtshme në secilin prej varianteve, në variantin e katërt shfaqet shkalla më e lartë e njësive të amëtarizuara, pra, me më pak elementë të huaj të sjellë në gjuhën shqipe me kalimin e viteve.

Duke iu referuar gjithë korpusit të analizuar, mund të hamendësojmë se fakti që **LBÇ** lexohet kryesisht nga fëmijë është një nga arsyet se pse amëtarizohen njësitë e huaja, veçanërisht në variantin e katërt. Nga ana tjetër, **UG** dhe **RK**, nisur edhe nga fakti se janë shkruar fillimisht për të rritur, shfaqin dukshëm një numër më të lartë njësish specifike kulturore të huajëzuara, me shumë gjasa nisur nga hamendësimi se lexuesit mund t'i kuptojnë ato. Edhe pse librat sot lexohen gjerësisht nga fëmijët, ata mund të kenë një përvojë leximi më të lehtë, të ndihmuar gjatë procesit të të lexuarit edhe nga një sërë shënimesh në fund të faqes apo në fund të veprës si dhe nga një nivel më i lartë njohurish rreth botës që i rrethon, karakteristike për fëmijët në ditët e sotme.

Nuk mund të lemë pa përmendur se në një sërë rastesh kemi vërejtur vendimmarrje rastësore nga ana e përkthyesit gjatë përkthimit të njësive specifike kulturore jo vetëm brenda të njëjtit variant, por gjithashtu edhe gjatë përkthimit të së njëjtës njësie specifike kulturore brenda variantit. Këto paqëndrueshmëri pa dyshim shkaktojnë ngatërresa dhe keqkuptime te lexuesit si dhe perceptimit të veprës origjinale nga ana e tyre. Disa prej tyre do t'i përmendim në kreun e pestë, ku do të kemi mundësi të diskutojmë më në hollësi rreth disa anëve problematike të vërejtura gjatë krahasimit të vazhdueshëm të veprave origjinale me variantet në gjuhën shqipe.

Kreu IV Vështirësitë në identifikimin dhe mbartjen e nënkuptimeve të pranishme në origjinal

Kur diskutojmë mbi përkthimin, rrallë i shpëtojmë analizave që përqëndrohen në tekstin origjinal, duke anashkaluar funksionin e tekstit të përkthyer në një gjuhë dhe kulturë të re. Kjo vjen edhe si pasojë e përdorimit të termave të tilla në fushën e studimeve përkthimore si "besnikëria", "njëvlershmëria", etj. të cilat gjithnjë e më tepër shfaqin paragjykime ndaj statusit të veprës së përkthyer kundrejt origjinalit, duke e ngritur tekstin origjinal në një lartësi të tillë sa që përkthyesi nuk mund ta arrijë kurrë. Për këtë arsye, shumë studime krahasuese vazhdojnë të theksojnë atë që humbet gjatë përkthimit, si për shembull, referencat kulturore, lojërat e fjalëve, etj.[224] Kjo lloj pikpamjeje mbi përkthimin po zëvendësohet nga qëndrime të tjera, ndër të cilat i jepet shumë rëndësi rolit të lexuesit (marrësit) të tekstit të përkthyer. Lexuesi vendoset në rolin e një përpunuesi aktiv të tekstit, që prodhon dhe jo thjesht rindërton kuptimet e brendshme të tekstit, dhe, për rrrjedhojë, edhe teksti origjinal nuk konsiderohet më si vepra me status më të lartë, dhe përkthimi nuk konsiderohet të ketë një status inferior. Theksimi i rolit të lexuesit në krijimin e kuptimit të tekstit na bën të ndërgjegjësohemi për ekzistencën e shumë mundësive të interpretimit të tekstit origjinal. Përkthyesi vendoset në rolin e lexuesit të tekstit origjinal dhe është interpretimi i tij që do të mbizotërojë për lexuesit e tekstit të përkthyer.

Në ditët e sotme gjithnjë e më shumë disiplina po përfshihen në fushën e studimeve përkthimore. Ndër këto disiplina mund të përmendim semiotikën dhe një ndër konceptet bazë të saj "ndërtekstualitetin" si një perspektivë që ze vend të dukshëm në studimet e kohëve të fundit. Le të lexojmë më poshtë për të kuptuar fillimisht nocionin e ndërtekstualitetit, e, më tej, të shohim shembuj konkretë të shfaqjes së kësaj dukurie. Në vazhdimësi të këtij kreu do të analizojmë shembujt për të parë nëse përkthyesit kanë arritur të përcjellin nënkuptimet e pranishme në veprat origjinale, nëpërmjet çfarë lloji strategjish, dhe deri në çfarë mase është arritur një gjë e tillë.

IV.1 Përshkrim teorik i dukurisë së ndërtekstualitetit

Çdo tekst ndërtohet si një mozaik citimesh, çdo tekst është përthithje dhe transformim i një teksti tjetër.[225]

Sa herë që lexojmë një vepër letrare, ne përpiqemi të nxjerrim kuptimin që ajo ka, duke u përfshirë kështu në një proces leximi dhe interpretimi njëkohësisht. Kjo mënyrë të menduari ka ndryshuar në dritën e zhvillimeve të teorisë bashkëkohore letrare dhe kulturore. Veprat letrare, në fakt, ndërtohen në bazë të sistemeve, kodeve dhe traditave, themelet e të cilave janë vendosur nga vepra letare të mëparshme. Teoricienët modernë janë të mendimit se tekstet, qofshin këto letrare apo jo-letrare, nuk kanë në vetvete asnjë lloj kuptimi të pavarur. Këto tekste emërtohen si *ndërtekstuale* nga teoricienët modernë. Është procesi i të lexuarit ai që na përfshin në një rrjetë marrëdhëniesh tekstuale. Interpretimi i një teksti, zbulimi i kuptimit apo kuptimeve të tij, nënkupton zbulimin e

[224] E. O'Sullivan (1998) *Losses and gains in translation: Some remarks on the translation of humor in the books of Aidan Chambers (Anathea Bell, trans.).* Në E. L. Keyser (ed.) *Children's Literature 26.* New Haven: Yale University Press, fq. 186.

[225] J. Kristeva (1969) *Séméiôtiké: Recherches pour une Sémanalyse.* Paris: Edition du Seuil. Përkthyer në anglisht (1980) *Desire in Language: A Semiotic Approach to Literature and Art*. Columbia University Press, fq. 66.

marrëdhënieve të tilla.[226] Në këtë mënyrë, procesi i të lexuarit shndërrohet në një proces gjatë së cilit lexuesit lëvizin ndërmjet teksteve. Kuptimi shndërrohet në një element që ekziston ndërmjet tekstit dhe të gjithë teksteve të tjera të cilave ai i referohet dhe me të cilët ai ka lidhje, duke u zhvendosur nga teksti i pavarur në një rrjet marrëdhëniesh tekstuale. Teksti shndërrohet në *ndërtekst*.[227]

Për qëllimet e studimit tonë po përmendim një panoramë të shkurtër të kontributeve teorike në kuadër të dukurisë së ndërtekstualitetit. Të dhënat e mëposhtme do të na njohim me studiuesit kryesorë në këtë fushë dhe do të na ndihmojnë të kuptojmë këtë dukuri, shfaqjet e së cilës do t'i shohim më konkretisht në vazhdim të këtij kapitulli. Gjithashtu, pjesa teorike, pasuruar edhe me shembujt që vijojnë, mendojmë se do te jetë e dobishme për përkthyesit e letërsisë për fëmijë, puna e të cilëve nuk është gjithmonë aq e drejtpërdrejtë sa ç'mund të duket në pamje të parë.

Themelet e punës mbi ndërtekstualitetin i gjurojmë në studimet e Mikail Mikailoviç Bakhtin (Mikhail Mikailovich Bakhtin) (1895-1975), filozof dhe teoricien letrar rus. Pikpamjet e tij njihen gjerësisht si baza e nocionit të *ndërtekstualitetit*, nocion ky që u prezantua nga Julia Kristeva (Julia Kristeva) në esenë e saj mbi Bakhtinin të titulluar *Word, Dialogue, and Novel* (botuar fillimisht në 1969, përkthyer në anglisht në vitin 1980). Nocioni i të menduarit i Bakhtinit bazohet në nocionin e dialogut ndërmjet asaj çka është "vetjake" dhe asaj çka është "e huaj". Ndërgjegja njerëzore dhe gjithë veprimet njerëzore marrin pjesë në një dialog të vazhdueshëm ndërmjet vetes dhe të tjerëve; në fakt, vetja mund të përkufizohet vetëm në marrëdhënie me të tjerët.[228] Sipas një pikpamjeje ndërtekstore, lexuesit nuk mendojnë se një shkrimtar "huazon" nga një tjetër, por ata (lexuesit) priren që të zbulojnë jehona dhe lidhje të fshehta.[229] Procesi i të lexuarit është i ndryshëm për lexuesit në moshë madhore kundrejt fëmijëve, duke bërë që ata të perceptojnë tekstin në mënyra të ndryshme: normalisht, një lexues i rritur ka një bagazh njohurish dhe veprash të lexuara paraprakisht që nuk njihen nga fëmijët, por edhe fëmijët nga ana e tyre, mund të njohin një sërë veprash të cilat janë të panjohura për të rriturit. Këto ndryshime në nivelin dhe llojin e njohurive nënkuptojnë që disa referime ndërtekstuale (dhe, siç do të përmendim më poshtë, edhe një sërë aludimesh) do të mbeten të fshehta dhe do të krijohen lidhje të llojeve të ndryshme.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se ndërtekstualiteti mund të kuptohet si një proces i krijimit të tekstit gjatë së cilit teksti përthith jehona nga një sërë burimesh të ndryshme. Referencat gjenden të thurura në brendësi të tekstit, duke hapur njëkohësisht dialogje me tekste të tjerë. Kjo pikpamje gjen zbatueshmëri edhe në përkthimin e një teksti: teksti i përkthyer është një jehonë e tekstit origjinal në një gjuhë dhe kulturë të ndryshme. Përkthimi risjell në jetë tekstin origjinal, duke transformuar edhe potencialet kuptimore.

IV.2 Ndërtekstualiteti dhe aludimet

[226] G. Allen (2000) *Intertextuality.* London and New York, Routledge, fq. 1
[227] Po aty, fq. 1.
[228] M. Bakhtin (1984a) *Problems of Dostoevsky's Poetics,* C. Emerson (trans. and ed.), University of Minnesota Press, Minneapolis MN, fq. 40.
[229] M. Nikolajeva (1996) *Children's Literature Comes of Age: Toward a New Aesthetic*. New York and London: Garland, fq. 154.

Aludimet janë referime ndërtekstuale që përcjellin nënkuptime të fshehta, interpretimi i të cilave bazohet në referentë që supozohen të jenë të njohur për lexuesin.[230] Nisur nga kjo që sapo parashtruam, mund ta kuptojmë lehtë se pse aludimet paraqesin një sfidë të dyfishtë për përkthyesin: së pari, edhe vetë përkthyesi është në rolin e një lexuesi, pra, edhe ai vetë duhet të identifikojë referentët e një aludimi, dhe, së dyti, duhet të përcjellë edhe në gjuhën e përkthimit, sa më shumë të jetë e mundur, një kombinim të tillë të kuptimit të fshehtë dhe njohurive të supozuara si të mirëqena për lexuesit marrës, duke pasur gjithmonë parasysh se lexuesit në gjuhën e përkthimit nuk i njohin gjithmonë referentët socio-kulturorë dhe mund të mos jenë të aftë që të nxjerrin në sipërfaqe kuptimin e thellë të një aludimi.

Studimet dhe kërkimet letrare i përkufizojnë aludimet si referenca të fshehta ndërtekstuale; interpretimi i tyre nuk do të ishte i mundur në mungesë të njohurive më të thella jo vetëm nga ana e përkthyesit por edhe nga ana e lexuesve, në mënyrë që të gjithë së bashku t'i afrohen asaj çka ka dashur të përcjellë shkrimtari në origjinal. Aludimet e identifikuara në këtë mënyrë (nga përkthyesi, lexuesi sa më afër shkrimtarit) krijojnë një ndjesi afrimiteti dhe bashkëveprimi mes lexuesve, shkrimtarit dhe personazheve.

Mund të përmendim një sërë studimesh në lidhje me aludimet dhe procesin e identifikmit të tyre, për shembull studiuesit Ziva Ben-Porat (Ziva Ben-Porat), Karmela Peri (Carmela Perri) dhe Uiliam Irvin (William Irwin), të cilët përkufizojnë aludimet dhe diskutojnë *procesin e suksesshëm të interpretimit të aludimit në formë ideale*, pa marrë në konsideratë faktin se lexuesit nuk e njohin gjithmonë referentin.[231] Të tjerë studiues, si Xhan Biaxho Konte (Gian Biagio Conte), Elën Pasko (Allan H. Pasco) dhe Xhozef Puçi (Joseph Pucci), analizojnë aludimet në vepra letrare, duke u përqëndruar në *interpretimin e formuar nga ndërveprimi i një aludimi dhe referentit të tij*.[232] Nga ana tjetër, studimet e kryera mbi *përkthimin e aludimeve* i kanë kushtuar më shumë vëmendje faktit që aludimet nuk arrijnë të identifikohen gjithmonë nga lexuesit e tekstit të përkthyer, të cilët i përkasin një kulture të ndryshme nga ajo e shkrimtarit dhe publikut të veprës origjinale. Përmendim në këtë drejtim studimin e Ritva Lepihalmes (*Ritva Leppihalme*) që ofron një sërë strategjish për përkthimin e aludimeve si dhe, nëpërmjet testeve që matin reagimin e lexuesve, përcakton efektin e strategjive në publikun marrës.[233] Me interes janë edhe studimet e bëra nga Kristianë Nord, Ives Gambieri (Yves Gambier) dhe Mina Ruokonena (Minna Ruokonen) të cilët diskutojnë rreth strategjive të mundshme për përkthimin e

[230] Aludimi si proces ka të bëjë me një lloj të veçantë reference, një mënyrë shenjëzimi [C. Perri (1978), *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307; fq. 295]. Aludimi në vetvete është një shembull individual, një referencë e fshehtë ndaj një teksti apo thënieje në vecanti. Referenti mund të jetë një pasazh i veçantë, një personazh i vërtetë apo i trilluar. Ndërveprimi mes aludimit dhe referentit të tij i jep jetë **interpretimit aludiv**. Megjithatë, aludimi në vetvete ka një kuptim në kotekst edhe pa referentin [p.sh. Z. Ben-Porat (1976) *The Poetics of Literary Allusion*. Në *A Journal for Descriptive Poetics and Theory of Literature* 1, 105–128; fq. 114-115; C. Perri (1978), *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307; fq. 295, 300-301). Ky kuptim kotekstual nxirret nga aftësitë gjuhësore dhe bagazhi i njohurive mbi botën.

[231] Z. Ben-Porat (1976) *The Poetics of Literary Allusion*. Në *A Journal for Descriptive Poetics and Theory of Literature* 1, 105–128; C. Perri (1978), *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307; W. Irwin (2001) *What is an Allusion.* Në *The Journal of Aesthetics and Art Criticism* 59.3, fq. 287-297; W. Irvin (2002) *The Aesthetics of Allusion.* Në *The Journal of Value Inquiry 36*, fq. 521–532.

[232] G. B. Conte (1986) *The Rhetoric of Imitation: Genre and Poetic Memory in Virgil and Other Latin Poets.* Ithaca: Cornell University Press.; A. H. Pasco (1994) *Allusion: A Literary Graft.* Toronto, Buffalo: University of Toronto Press.; J. Pucci (1998) *The Full-Knowing Reader: Allusion and the Power of the Reader in the Western Literary Tradition*. New Haven, Conn.: Yale University Press.

[233] R. Leppihalme (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters.

referencave ndërtekstuale si dhe faktorët ndikues në përdorimin e secilës strategjie.[234] Shumica e studimeve të përmendura nxjerr në pah problemin e mospërcjelljes së efektit të nënkuptimeve të pranishme në origjinal: edhe pse një pjesë e mirë e aludimeve mund të jenë përkthyer, lexuesit i lexojnë ato në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa hyrë në thellësi të aludimit, duke mbetur të çuditur, të ngatërruar, dhe, nganjëherë, edhe të pakënaqur ndaj tekstit origjinal.

Procesi i interpretimit mbart një rëndësi të madhe në identifikimin dhe përkthimin e një aludimi. Një këndvështrim tjetër që mund të na ndihmojë në këtë drejtim është ai sipas së cilit gjuha dhe tekstet mendohet të jenë dialogjikë, por, parimi i dialogut gjen zbatim në një mënyrë më të kufizuar edhe në interpretimin e teksteve të veçanta apo pasazheve në një kontekst të veçantë. Rrjedhimisht, elementi i huaj është njëkohësisht një karakteristikë e gjuhës dhe teksteve në përgjithësi, dhe, një karakteristikë e veçantë e pasazheve të marra në veçanti. Sipas Bakhtinit, të gjitha fjalët orientohen edhe ndaj fjalëve apo thënieve të mëparëshme rreth një teme të veçantë, edhe ndaj reagimeve të ardhshme, d.m.th. ndaj fjalëve të huaja.[235] Asnjë fjalë apo thënie nuk mund të interpretohet duke u bazuar vetëm në kuptimin referencial meqenëse "sendi" ose referenti është i "veshur" nga drita e fjalëve të huaja që janë thënë rreth tij.[236] Kështu, të shkruarit ose të lexuarit të çfarëdo lloj teksti është gjithmonë një proces dialogimi që përfshin tekste të tjera, të cilat, sipas teorisë së ndërtekstualitetit përpunuar nga Kristeva, e shndërrojnë çdo lloj teksti në një mozaik citimesh – përthithje dhe transformim të një teksti tjetër.[237] Çdo tekst mbushet nga jehona anonime ndërtekstuale.[238]

Pavarësisht faktit se Bakhtini i referohet një lloji më specifik të pranisë së elementit të huaj – pranisë së fjalëve të dikujt tjetër – njohur si *ligjërimi i huaj*,[239] ai i referohet gjithmonë një "zëri" që mund të shprehë kuptime, nënkuptime, madje dhe ideologji e pikpamje të ndryshme mbi botën.[240] Ligjërimi i huaj është një koncept edhe më i gjerë se aludimet, duke përfshirë edhe parodinë.[241] Përfshirja e aludimeve në ligjërimin e huaj ka pasoja me rëndësi jo vetëm për përkufizimin dhe qartësimin e konceptit "aludim", por, njëkohësisht, edhe për interpretimin dhe përkthimin e aludimeve. Në përgjithësi, interpretimi dhe përkthimi i aludimeve mund të konsiderohet

---

[234] C. Nord (1990) *Zitate und Anspielungen als pragmatisches Übersetzungsproblem*. *TEXTconTEXT* 5, fq. 1–30.; Y. Gambier (2001) *Traduire le sous-texte*. Në *Kronning, H. et al.* (eds.), 223–235; M. Ruokonen (2010) *Cultural and textual properties in the translation and interpretation of allusions*. (punim dizertacioni) Painosalama Oy – Turku, Finland.

[235] M. Bakhtin (1934) *Discourse in the Novel*. Në: M. Holquist (ed.) (1981) *The Dialogic Imagination: Four Essays*. (transl.) C. Emerson and M. Holquist. Austin, Texas: University of Texas Press, 259–422; fq. 279-280.

[236] M. Bakhtin (1934) *Discourse in the Novel*. Në: M. Holquist (ed.) (1981) *The Dialogic Imagination: Four Essays*. (transl.) C. Emerson and M. Holquist. Austin, Texas: University of Texas Press, 259–422; fq. 276.

[237] J. Kristeva (1969) *Séméiôtiké: Recherches pour une Sémanalyse.* Paris: Edition du Seuil. Përkthyer në anglisht (1980) *Desire in Language: A Semiotic Approach to Literature and Art*. Columbia University Press, fq. 66.

[238] R. Barthes (1977) *Image, Music, Text.* S. Heath (trans.), Fontana, London, fq. 160.

[239] Po përdorim togfjalëshi "ligjërim i huaj" si gjegjës për "*foreign discourse*", që i referohet "*slovo"* përdorur nga Bakhtini për dukurinë nën shqyrtim. Përkthimi në anglisht *foreign discourse* është bërë dhe argumentuar hollësisht nga M. Ruokonen (2010) *Cultural and textual properties in the translation and interpretation of allusions.* (punim dizertacioni) Painosalama Oy – Turku, Finland, fq. 28-30.

[240] M. Bakhtin (1934) *Discourse in the Novel*. Në: M. Holquist (ed.) (1981) *The Dialogic Imagination: Four Essays*. (transl.) C. Emerson and M. Holquist. Austin, Texas: University of Texas Press, 259–422; fq.291-292, 342-347; M. Bakhtin (1984) *Problems of Dostoevsky's Poetics,* C. Emerson (trans. and ed.), University of Minnesota Press, Minneapolis MN, fq. 193-199.

[241] M. Bakhtin (1984a) *Problems of Dostoevsky's Poetics,* C. Emerson (trans. and ed.), University of Minnesota Press, Minneapolis MN, fq. 189.

si një proces dialogjik.[242] Sipas Bakhtinit, çdo rast interpretimi i një thënieje apo një teksti është një dialog që përfshin folësin dhe dëgjuesin (ose shkrimtarin dhe lexuesin) në kontekste të veçanta.[243] Në përfundim, krijohet një përzierje dialogjike e zërave të shkrimtarit dhe lexuesit të tekstit të përkthyer si dhe përkthyesit. Dialogu, në kushte ideale, është një proces mësimi, një shkëmbim idesh që i ndryshon të dy pjesëmarrësit.[244] Dialogu, në përgjithësi, është pa fund, çdo thënie nxit një reagim të ri;[245] ndërsa interpretimi i një aludimi është një proces më i përmbyllur dhe i përfundueshëm. Edhe aludimet, ashtu si ligjërimi i huaj, mund të marrin forma të ndryshme: disa përngjasojnë me referentët e tyre dhe dallohen si "të huaj" në kotekstin aludiv duke iu referuar kuptimit të tyre kotekstual, formës ose stilit, ndërsa, aludime të tjera, përkundrazi, ndërthuren me kotekstin dhe bëhen pjesë e tij. Format e ndryshme të aludimeve ndikojnë mundësitë e lexuesve për të identifikuar dhe interpretuar aludimet: sa më mirë që një aludim të përshtatet në kotekstin e ri, aq më e lehtë është për lexuesin ta interpretojë atë edhe nëse nuk e njeh referentin.[246]

Studiues të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme për aludimin, duke theksuar kryesisht nënkuptimin dhe natyrën e fshehtë brenda çdo aludimi. Dhënia e një përkufizimi të vetëm për aludimin, ashtu si dhe dhënia e një përkufizimi të vetëm mbi dukurinë e ndërtekstualitetit, siç shprehet edhe Graham Elën (Graham Allen) në studimin e tij mbi ndërtekstualitetin, do të ishte një projekt i dështuar që në nisje.[247] Për këtë arsye, brenda qëllimeve të këtij punimi, po përmendim më poshtë vetëm ato cilësi të aludimeve që kanë lidhje me studimin tonë.

- Nënkuptimshmëria mund të shprehet nëpërmjet formës së fshehtë ose të dukshme në tekst, duke i shtuar diçka tekstit që e ndryshon interpretimin e tij;[248]
- Aludimet shprehin kuptim të fshehtë nëpërmjet disa cilësive të referentit që nuk shfaqen qartë në tekstin aludiv;[249]
- Fshehtësia e kuptimit të një aludimi nuk duhet të ngatërrohet me mungesën e koherencës;[250]
- Aludimet mund të ndikojnë në interpretimin që i bëhet një pjese të tekstit ose pjesëve të veçanta të tij;

---

[242] M. Ruokonen (2010) *Cultural and textual properties in the translation and interpretation of allusions*. (punim dizertacioni) Painosalama Oy – Turku, Finland, fq. 29.

[243] M. Bakhtin (1934) *Discourse in the Novel*. Në: M. Holquist (ed.) (1981) *The Dialogic Imagination: Four Essays*. (transl.) C. Emerson and M. Holquist. Austin, Texas: University of Texas Press, fq. 282.

[244] Po aty, 281-282.

[245] M. Bakhtin (1984) *Problems of Dostoevsky's Poetics,* C. Emerson (trans. and ed.), University of Minnesota Press, Minneapolis MN, fq. 252.

[246] Me "kotekst" nënkuptojmë "mjedisin tekstual të një njësie gjuhësore", përkufizim ky dhënë nga B. Hatim dhe I. Mason (1990) *Discourse and the translator*. London: Longman, fq. 240. Gjatë këtij punimi do të përdorim "kotekst" duke iu referuar mjedisit tekstual të ngushtë që e rrethon një pasazh në vecanti: fjalët dhe fjalitë që ndodhen më afër, ose paragrafi i mëparëshëm dhe i mëvonshëm. Nganjëherë, për një mjedis të tillë gjuhësor, përdoret edhe termi "kontekst" [sipas përkufizimit dhënë nga J. Deslie et. al. (1999) (ed.) *Translation Terminology*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins, fq. 129], por, në këtë studim, termi "kontekst" do t'i referohet sfondit socio-kulturor në një kohë dhe hapësirë të vecantë.

[247] G. Allen (2000) *Intertextuality*. London and New York, Routledge, fq. 2.

[248] C. Perri (1978), *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307: fq. 290-291, 295; Z. Ben-Porat (1976) *The Poetics of Literary Allusion*. Në *A Journal for Descriptive Poetics and Theory of Literature* 1, 105–128: fq. 109, 114-115.

[249] R. Leppihalme (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters, fq. 3; C. Perri (1978), *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307: fq. 297.

[250] M. Ruokonen (2010) *Cultural and textual properties in the translation and interpretation of allusions*. (punim dizertacioni) Painosalama Oy – Turku, Finland, fq. 32.

- Aludimet mund t'iu referohen teksteve letrare, sloganeve, veprave të artit, personazheve reale, zakoneve të cilat konsiderohen si referentë të mundshëm;[251]
- Interpretimi i një aludimi varet nga familjariteti i lexuesit me referentin, shkrimtari që aludon supozon se ekziston një traditë bazë letrare, një trup njohurish të përbashkëta me publikun që ka tradita të njëjta me të.[252]

Në mënyrë të përmbledhur themi se *aludimi është një referencë e fshehtë që përngjason me një referent të jashtëm që i përket njohurisë që supozohet të jetë e përbashkët.* Pra, nëpërmjet këtij përkufizimi kuptojmë se: 1) aludimi është një referencë e veçantë që përcjell *kuptim të fshehtë* duke aktivizuar tekstin referent ose një pjesë të tij (konotacionet), 2) aludimi mund të ketë formë të fshehtë ose të dukshme, por duhet të ketë *ngjashmëri të mjaftueshme me referentin* në mënyrë që të jetë i dallueshëm, dhe, 3) referenti i përket *njohurisë së supozuar të përbashkët*, që mendohet të jetë e njëjtë për shkrimtarin dhe, të paktën, për disa nga lexuesit e tij. Në këtë mënyrë, aludimi është një formë e veçantë e ligjërimit të huaj të përshkruar nga Bakhtini ose e ndërtekstualitetit: një referencë ndërtekstuale që përçon kuptim të fshehtë nëpërmjet një referenti specifik, që supozohet të jetë i njohur. Pavarësisht vështirësisë së dhënies së një përkufizimi përfundimtar mbi aludimin, ajo çka na intereson më shumë është të shtrojmë një sërë pyetjesh, si për shembull:

- Nëse aludime të ndryshme shprehin kuptime të fshehta, si do të ndikojë kjo në interpretimin dhe përkthimin e tyre?
- Sa rëndësi ka gjetja e referentit për të kuptuar aludimin?
- Si ndikon forma e shfaqjes së aludimit në procesin e interpretimit dhe përkthimit?
- A ka ndonjë mënyrë për të vlerësuar faktin nëse lexuesi e njeh referentin? Sa ndikon kultura e përbashkët në interpretimin dhe përkthimin e aludimeve?
- Sa e rëndësishme është përvoja e lexuesve në formimin e interpretimit dhe leximin dhe të kuptuarit e përkthimit?
- Çfarë roli luan koteksti dhe konteksti në mundësitë e interpretimit të aludimeve nga ana e lexuesve?
- Çfarë ndikimi ka mosha e lexuesve në perceptimin e aludimeve?

Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve do të ndikojnë edhe në strategjinë e përdorur në përkthimin e aludimeve. Një panoramë që përmbledh strategjitë e mundshme në përkthimin e aludimeve ofrohet gjerësisisht në studimin e Ritva Lepihalmes, procedurat e përkthimit të citimeve përshkruar nga Kristianë Nord, si dhe strategjitë për përkthimin e aludimeve propozuar nga Ives Gambier.[253] Në të tria studimet në fjalë, përmendet se përkthyesi gjendet përballë dy zgjedhjeve: ose do të ruajë aludimin e pranishëm në origjinal pak a shumë në të njëjtën formë, ose aludimi do të modifikohet nëpërmjet qartësimit, zëvendësimit, ose mospërfshirjes. Disa nga këto strategji përfshijnë: *citimin e*

[251] R. Leppihalme (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters, fq. 9.

[252] J. A. Cuddon (1979) *A Dictionary of Literary Terms.* London: Deutsch.; R. Kaskenviita (1991) *Alluusiot Asterix-sarjan kulttuurisidonnaisena käännösongelmana. 'Allusions as a culture-bound translation problem in the Asterix series*. Sananjalka 33, 77–92: fq. 77.

[253] R. Leppihalme (1994) *Translating Allusions: When Minimal Change is not Enough*. Në *Target: International Journal of Translation Studies* 6 (2), fq. 177–193; R. Leppihalme (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters; C. Nord (1990) *Zitate und Anspielungen als pragmatisches Übersetzungsproblem*. *TEXTconTEXT* 5, fq. 1–30; Y. Gambier (2001) *Traduire le sous-texte*. Në *Kronning, H. et al.* (eds.), 223–235.

drejtpërdrejtë, transkriptimin, zëvendësimin, përkthimin fjalë për fjalë, perifrazimin, përshtatjen, shpjegimin, mospërfshirjen, kompensimin, shënimin në fund të faqes, etj. Në parim, çdo proces përkthimi përbën një proces vendimmarrjeje nën ndikimin e faktorëve socio-kulturorë, materialë, tekstualë dhe psikologjikë, dhe faktorë të ndryshëm mund të kundërveprojnë osë të përforcojnë ndikimin e njëri-tjetrit.[254] Edhe përkthimi merr formën e një ndërveprimi dialogjik që përfshin tekstin origjinal, konceptin e përkthyesit mbi shkrimtarin e tekstit origjinal dhe lexuesit e përkthimit, si dhe kontekstet e origjinalit dhe përkthimit.[255] Ndër faktorët që ndikojnë në vendim-marrje përmendim *çështjet konjitive, faktorët socio-kulturorë, fakti nëse aludimi i tekstit origjinal është i njohur për lexuesit e përkthimit, funksioni i aludimit të tekstit origjinal dhe roli i aludimit në tekstin e përkthyer*. Në çështjen më poshtë do të kemi mundësi të shpalosim konkretisht faktorët e përmendur si dhe strategjitë e përdorura nga përkthyesit në korpusin tonë.

IV.3 Shfaqje konkrete të aludimeve në korpusin në shqyrtim, shembuj

Pothuajse të gjitha tekstet letrare kanë të pranishëm elementë ndërtekstualë që shkaktojnë boshllëqe ndërkulturore gjatë procesit të leximit dhe interpretimit ë tekstit. Duke iu referuar në mënyrë specifike korpusit tonë, do të përmendim aludimet si një lloj i veçantë i elementëve ndërtekstualë të vërejtur në tekstin origjinal, për të shqyrtuar më pas edhe shkallën e përcjelljes së tyre në tekstin e përkthyer. Në këtë punim, nisur edhe nga përkufizimet e mësipërme si dhe nga një shqyrtim i hollësishëm i korpusit nën studim, do të sjellim shembuj për të pasqyruar shfaqjen konkrete dukurisë së ndërtekstualitetit në përkthimin e aludimeve të tilla si lojërat e fjalëve dhe emrat e përveçëm. Secili prej grupeve te shembujve të lartpërmendur paraprihet nga një shpjegim i dukurisë në fjalë, për t'u ndjekur më tej nga një analizë konkrete e strategjive të përdorura gjatë përkthimit (shpeshtësia e përdorimit dhe efikasiteti i secilës prej tyre, kjo e fundit edhe si një faktor që përcakton "suksesin" në përkthim) duke bërë gjithmonë krahasimin me shembujt e identifikuar në tekstet origjinale. Për të qenë sa më konkretë dhe lehtësisht të orientueshëm në punim, të dhënat e nxjerra nga analizat përkatëse do t'i paraqesim në formë tabelash dhe grafikësh. Në këtë mënyrë, edhe nxjerrja e përfundimeve do të jetë më e lehtë.

IV.3.1 Përkthimi i lojërave të fjalëve

Fjala ka një jetë të vetën, ka një dinamikë të sajën, ka një histori të vetën. Dhe nëse e ka në gjuhën e origjinalit, duhet ta ketë edhe në atë të shqipërimit.[256]

Aludimet nëpërmjet lojërave të fjalëve përbëjnë një nga rastet e shfaqjes së dukurisë së ndërtekstualitetit. Nëpërmjet nënçështjeve të mëposhtme do të njihemi fillimisht teorikisht me lojërat e fjalëve dhe tipologjitë e tyre, duke vazhduar më tej me pasqyrimin e shembujve konkretë. Libri që kemi përzgjedhur për të ilustruar këtë dukuri është *Alice's Adventures in Wonderland* për vetë faktin se këtu gjejmë një sërë shembujsh, madje edhe

[254] A. Pym (1998) *Method in Translation History.* Manchester: St. Jerome, fq. 114; A. Chesterman (1998) *Causes, Translations, Effects*. Në *Target* 10:2, fq. 201–230; S. Brownlie (2003) *Investigating Explanations of Translational Phenomena. A Case for Multiple Causality*. Në *Target* 15:1, fq. 111–152.
[255] R. Oittinen (2000) *Translating for Children.* New York: Garland. Publishing, Inc.fq. 19-20, 30-31; A. J. Klungervik Greenall (2006) *Translation as dialogue.* Në *Translation Studies at the Interface of Disciplines.* (ed.) J. F. Duarte, A. A. Rosa, T. Seruya. Benjamins Translation Library, 67-81, fq. 72-73.
[256] A. Kasoruho në Botimet Shqiptare, 16.09. 2010.

vetë suksesi i përkthyesit të kësaj vepre varet në një masë të konsiderueshme edhe nga fakti se sa dhe si janë përkthyer pikërisht lojërat e fjalëve. Kemi përzgjedhur pesë variante të kësaj vepre në gjuhën shqipe për të bërë një krahasim sa më të plotë me origjinalin dhe, njëkohësisht, ndërmjet varianteve të përkthyera në gjuhën shqipe, në mënyrë që të krahasojmë strategjitë e përdorura gjatë përkthimit, si dhe nivelin e përcjelljes së efektit komik të pranishëm në origjinal.

Rast Studimor: Alice's Adventures in Wonderland

IV.3.1.1 Përkufizimi i "lojë fjalësh"

Humori, siç shprehet An Mari Solje (Anne-Marie Soulier), është mbi të gjitha një fitore mbi gjuhën.[257] Vërtet, të arrish të bësh humor nënkupton të njohësh mirë gjuhën dhe të dish ta mannipulosh atë, t'i vendosësh sfida vetes e t'i kalosh ato, të fitosh, por, kjo lloj fitoreje, që tregon më së miri aftësitë e shkrimtarit, mund të kthehet në një betejë vërtet shqetësuese për përkthyesin, dhe, mund të mos përfundojë gjithmonë me fitore. Një nga çështjet më të diskutuara në lidhje me përkthimin nga anglishtja në gjuhë të ndryshme të *Alice's Adventures in Wonderland* shtrohet në aspektin e përkthyeshmërisë së lojërave të fjalëve që i japin statusin e papërsëritshëm kësaj vepre, dhe, njëkohësisht, mundësinë e përcjelljes së efektit komik të përcjellë nëpërmjet tekstit origjinal. Nënçështjet e mëposhtme paraqesin interes të veçantë qoftë nga ana teorike, pasi do të shpalosin përkufizimet e lojërave të fjalëve dhe tipologjinë e tyre, por, njëkohësisht, edhe nga ana praktike, sepse, nëpërmjet identifikimit të lojërave të fjalëve në tekstin origjinal, do të njohim gjenialitetin e shkrimtarit, fitoret e tij mbi gjuhën, e, më pas, do të ndalemi në pesë variantet nën shqyrtim duke parë "betejat" që zhvillohen me gjuhën shqipe në secilin rast.

Pothuajse çdo përkufizim i lojërave të fjalëve thekson atë çka do të quhej si përputhshmëria (ose ngjashmëria) e formës kundrejt dallimit të kuptimit. Sipas Xhoel Sherzerit (Joel Sherzer) "*një lojë fjalësh është një lloj loje ... ku një fjalë ose shprehje në mënyrë spontane dhe të papritur kombinon dy kuptime që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin*".[258] Edhe përkufizimi që jep Heller (L. G. Heller) është i ngjashëm: "*loja e fjalëve nuk përfaqëson vetëm një model, por një klasë të tërë të modeleve të ndryshme, të cilat të gjitha kanë të përbashkëta këto karakteristika strukturore: një shenjë e vetme e dukshme shënon më shumë se një funksion konceptual"*.[259] Sipas Xhefri Liçit (Geoffrey N. Leech) "*një lojë fjalësh është një shumëkuptimësi me bazë leksikore, që mund ta ketë origjinën ose në homonimi, ose në polisemi"*.[260] Megjithatë, këto përkufizime janë disi të kufizuara. Dy të parat përfshijnë ato lojëra fjalësh në të cilat një njësi ose grup leksikor mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, por nuk përfshijnë raste të tjera që bazohen në afërsinë e dy ose më shumë fjalëve ose shprehjeve që janë të ngjashme nga forma, por të ndryshme nga kuptimi. Shpjegimi që na jep Liçi, nga ana tjetër, nuk përfshin ato lojëra fjalësh që mund të bazohen në shumëkuptimësinë sintaksore ose në dukuri të tjera si homofonia ose homografia.

---

[257] A. Soulier (1998) *Traduire entres les Lignes, ou, les aventures du non-dit dans la traduction du texte humoristique*. Në *Ateliers, 15: Traduire L'Humour, Cahiers de la Maison de la Recherche*. Université Charles-de-Gaulle, Lille III. 11-18, fq. 11. Citimi është shkëputur nga P. Seixas *A Bush is not a Shrub*. Në P. E. Carvalho, R. C. Homem (ed.s) (2008) *Plural Beckett Pluriel*. *Centenary Essays/Essais D'Un Centenaire*. Faculdade de Letras da Universidade Do Porto, Porto, Portugal, fq. 199.

[258] J. Sherzer (1978) *Oh, That's a Pun and I Didn't Mean It'* në *Semiotica* 22, 3-4. 335-350, fq. 336.

[259] L. G. Heller (1974) *Toward a General Typology of the Pun* në *Language and Style* 7, 271-282, fq. 271.

[260] G. N. Leech (1969) *A Linguistic Guide to English Poetry.* London, Longman, fq. 209.

Gjatë këtij kreu ne do t'i referohemi përkufizimit dhënë nga Dirk Delabastita (Dirk Delabastita) meqenëse, brenda thuktësisë së tij, arrin të mbulojë lloje të ndryshme të lojërave të fjalëve që nuk përfshihen në përshkrimet e sipërpërmendura.

> *... loja e fjalëve është një emërtim i përgjithshëm që tregon dukuritë e ndryshme tekstuale (d.m.th. në nivelin e performancës ose "parole") në të cilat shfrytëzohen disa karakteristika të brendshme në strukturën e gjuhës së përdorur (niveli i kompetencës ose "langue") në mënyrë të tillë që të vendoset një përballje (thuajse) e njëkohësishme, domethënëse nga ana komunikative për të paktën dy struktura gjuhësore me kuptime pak a shumë të ndryshme (të shenjuarit) dhe forma pak a shumë të ngjashme (shenjuesit).*[261]

Një përkufizim i tillë na lejon që t'i referohemi niveleve të ndryshme të ngjashmërisë ndërmjet shënuesve (p.sh. paronimia), në vend që të tregojë një përputhshmëri të plotë. Në nivelin semantik, pranohet fakti se shkalla e mospërputhjeve mund të ndryshojë, gjë që nënkupton se ndryshimi ndërmjet kuptimit të parë dhe atij figurativ të një fjale do të bëjë të mundur që të lindë një lojë fjalësh. Gjithashtu, ky përkufizim thekson "domethënien komunikative" të lojës, d.m.th. efektin humoristik ose ndonjë efekt tjetër. Në nënçështjen që vijon do të ecim sipas tipologjisë prezantuar nga Delabastita, duke vjelë shembuj nga *Alice's Adventures in Wonderland.*

IV.3.1.2 Tipologjia e lojërave të fjalëve

A. Kriteri formal

Kriteri i parë për klasifikimin e lojërave të fjalëve është *formal*, dhe bën të mundur dallimin "*hapësinor*" mes lojërave të ashtuquajtura *vertikale* dhe *horizontale*. Në një lojë vertikale marrëdhënia ndërmjet përbërësve semantikë vendoset në mënyrë paradigmatike: kuptimet e ndryshme prezantohen njëkohësisht nga e njëjta pjesë e tekstit. Në një lojë horizontale përbërësit shfaqen në mënyrë sintagmatike: kuptimet shfaqen njëri pas tjetrit në sintagmën ku trupëzohet loja e fjalëve. Le të shohim dy shembuj konkretë:

a. Lojë fjalësh *vertikale*

> Presently she began again. 'I wonder if I shall fall right through the earth! How funny it'll seem to come out among the people that walk with their heads downward! The ***Antipathies***, I think—' (she was rather glad there was no one listening, this time, as it didn't sound at all the right word) '--but I shall have to ask them what the name of the country is, you know (fq. 12).

Liza përdor gabimisht fjalën "antipatët" në vend të antipodët duke transferuar kështu udhëtimin e saj fizik në anën e kundërt të botës në një udhëtim semantik nga një fjalë që do të thotë "*ana e kundërt e botës*" në një fjalë tjetër që do të thotë "*të kundërt në karakter*". Kerrëli në këtë mënyrë na tregon se si përzihen kufijtë mes lëvizjes fizike dhe asaj verbale në brendësi të një rrëfenje fantastike. Liza nuk arrin ta ndjekë udhëtimin e saj në Botën e Çudirave në kushtet gjeografike dhe semantike njëkohësisht.

b. Lojë fjalësh *horizontale*

[261] D. Delabastita (1993) *There's a Double Tongue: An Investigation Into the Translation of Shakespeare's Wordplay, with Special Reference to Hamlet*. Rodopi, fq. 57.

> ‘You promised to tell me your history, you know,’ said Alice, ‘and why it is you hate--C and D,' she added in a whisper, half afraid that it would be offended again.
> ‘Mine is a long and a sad ***tale***!’ said the Mouse, turning to Alice, and sighing.
> ‘It IS a long ***tail***, certainly,’ said Alice, looking down with wonder at the Mouse's ***tail***; ‘but why do you call it sad?’(fq. 18)

Loja e fjalëve bazohet në homofonët *tale-tail.* Miu përdor *tale* duke iu referuar historisë që ai do të rrëfejë, ndërsa Liza, e habitur vështron bishtin e miut duke menduar se ai që në fillim është duke folur për bishtin e tij – *tail* – si një “bisht” i gjatë dhe i trishtueshëm (kur në fakt e tillë është historia që ai do të rrëfejë pas pak).

B. Kriteri gjuhësor

Duke e nisur analizën nga *materiali gjuhësor*, dallojmë këto kategori:

a. Kategoria fonologjike

Një lojë fjalësh që bazohet në fonologji formohet nga fjalë që kanë disa fonema të përbashkëta, por që nuk kanë lidhje etimologjike apo semantike (si në rastin e polisemisë). Fjalët ***porpoise*** dhe ***purpose*** janë të ngjashme nga ana fonologjike dhe ndërtojnë një lojë fjalësh me kuptime të ndryshme, kështu edhe pse Breshka përdor fjalën ***porpoise*** – që i përket fushës semantike të detit – kuptimi i fjalës tjetër ***purpose*** që shqiptohet afërsisht njësoj krijon një situatë komike.[262]

> ‘They were obliged to have him with them,’ the Mock Turtle said: ‘no wise fish would go anywhere without a ***porpoise***.’
> ‘Wouldn’t it really?’ said Alice in a tone of great surprise.
> ‘Of course not,’ said the Mock Turtle: ‘why, if a fish came to me, and told me he was going on a journey, I should say “With what ***porpoise***?”’
> ‘Don’t you mean “***purpose***”?’ said Alice. (fq. 44)

Lojërat fonologjike mund t’i nënshtrohen një nëndarjeje edhe më të hollësishme nisur nga natyra e shtresës gjuhësore si më poshtë:

a.1 Homofonia

Kemi të bëjmë me dy ose më shumë fjalë që shkruhen në mënyra të ndryshme, por që kanë shqiptime të njëjta:

> …You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its ***axis***--'
> ‘Talking of ***axes***,’ said the Duchess, ‘chop off her head!’ (fq. 29)

Liza përpiqet të shpjegojë faktin se tokës i duhen njëzet e katër orë për të bërë një rrotullim rreth vetes (***boshtit***), ndërsa Dukesha i referohet një sendi tjetër – ***sëpatës***, dhe kërkon që Lizës t’i pritet koka.[263]

a.2 Homonimia

Homonimi kemi në ato raste kur dy ose më shumë fjalë shkruhen dhe shqiptohen njësoj:

> ‘You ought to be ashamed of yourself,’ said Alice, ‘a **great girl** like you,’ (she might well say this), ‘to go on crying in this way! Stop this moment, I tell you!’ (fq. 14)

[262] Përkthimet në gjuhën shqipe janë (sipas fjalorit anglisht-shqip 2000 të Pavli Qeskut) *porpoise* – em. zool. derr deti; delfin (fq. 815); *purpose* – qëllim; synim; dobi (fq. 851).
[263] Sipas të fjalorit të sipërcituar: *axis* – aks,bosht; *axes* – sëpatë, latë (fq. 64).

Në këtë rast përcaktori ***great*** për emrin *girl* i referohet si fizikut, ashtu edhe personalitetit.[264]

a.3 Homografia

Homografet janë dy ose më shumë fjalë që shkruhen në të njëjtën mënyrë:

> 'Of course it is,' said the Duchess, who seemed ready to agree to everything that Alice said; 'there's a large mustard-***mine*** near here. And the moral of that is— "The more there is of ***mine***, the less there is of yours.".[265] (fq. 39)

a.4 Paronimia

Një lojë fjalësh fonologjike është paronimike atëherë kur fjalët shkruhen dhe shqiptohen në mënyrë të ngjashme (por nuk përputhen krejtësisht):

> 'You are not attending!' said the Mouse to Alice severely. 'What are you thinking of?'
> 'I beg your pardon,' said Alice very humbly: 'you had got to the fifth bend, I think?'
> 'I had ***NOT***!' cried the Mouse, sharply and very angrily.
> 'A ***knot***!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!' (fq. 19)

Liza e akuzon Miun se ai ka arritur në "*fifth band"*, duke nënkuptuar kështu paqëndrueshmëri mendore, gjë për të cilën Miu përgjigjet "*I have* ***not*****"**, Liza mendon se bëhet fjalë për ***knot*** dhe ofron ndihmën e saj që ta zgidhë.[266]

b. Kategoria polisemantike

Kur një lojë fjalësh lind nga polisemia, ekzistojnë dy ose më shumë kuptime të së njëjtës fjalë. Në pjesën për ilustrim mund të shohim dy kuptimet (të shenjuar) të ndryshëm të së njëjtës fjalë ***dry*** (i njëjti i shenjuar): ***dry*** **"**i thatë, pa ujë ose lëngje", dhe "pa interes ose emocione". Kuptimi i parë i referohet publikut që po dëgjon Miun (të cilët janë të gjithë të lagur dhe duhet të thahen), ndërsa kuptimi i dytë historisë (pa interes) që Miu do të rrëfejë:

> At last the Mouse, who seemed to be a person of authority among them, called out, 'Sit down, all of you, and listen to me! I'll soon make you ***dry*** enough!' They all sat down at once, in a large ring, with the Mouse in the middle. Alice kept her eyes anxiously fixed on it, for she felt sure she would catch a bad cold if she did not get dry very soon.
> 'Ahem!' said the Mouse with an important air, 'are you all ready? This is the ***driest*** thing I know.
> Silence all round, if you please!... (fq. 17)

c. Kategoria idiomatike

Shtresa idiomatike në gjuhë mundëson lehtësisht krijimin e lojërave të fjalëve meqenëse kuptimi i shprehjes frazeologjike nuk përcaktohet nga shuma e përbërësve të saj. Kështu,

---

[264] Në *Fjalor i Shqipes së Sotme.* (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet Toena, Tiranë, fq. 440, lexojmë *madh (i), e (e)* 1. që ka trup, vëllim ose përmasa mbi mesataren dhe që ia kalon dikujt a diçkaje tjetër; që zë shumë vend a që nxë shumë; ... 5. që është më i rritur në moshë se një tjetër; që ka arritur moshën e pjekurisë dhe ka përvojë; i rritur; i moshuar…6. që dallohet nga të tjerër për aftësitë e veçanta fizike, mendore e morale…madhështor (fq.721). Gjithashtu, sipas fjalorit anglisht-shqip: *great* – i madh, i rëndësishëm, kryesor.

[265] Sipas fjalorit anglisht-shqip (2000) *mine*$_1$- minierë; … *mine*$_3$ _im, imi (fq. 659, 660).

[266] Sipas fjalorit anglisht-shqip, *not* – nuk, s', mos (fq. 708); dhe *knot* – nyjë, kokël, lidhje, bashkim (fq. 563).

në një lojë fjalësh, mund të përballen lehtësisht kuptimi i drejtpërdrejtë dhe kuptimi idiomatik, duke krijuar situata shpesh qesharake.

> ‘Perhaps not,’ Alice cautiously replied: ‘but I know I have to ***beat time*** when I learn music.’
>
> ‘Ah! that accounts for it,’ said the Hatter. ‘**He** won’t stand ***beating***. Now, if you only kept on good terms with him, he’d do almost anything you like with the clock. [267] (fq. 33)

ç. Kategoria morfologjike

Lojërat e fjalëve që bazohen në morfologji përfshijnë fjalë që lidhen me fjalë të tjera nëpërmjet mekanizmave morfologjike si për shembull prejardhja ose kompozimi. Një fjalë e prejardhur, e përngjitur ose e përbërë, kuptimi i së cilës nuk mund të rrjedhë nga kuptimi i morfemave që e përbëjnë atë formon një lojë fjalësh.

> ‘Reeling and Writhing, of course, to begin with,’ the Mock Turtle replied; ‘and then the different branches of Arithmetic-- Ambition, Distraction, ***Uglification***, and Derision.’
>
> ‘I never heard of “***Uglification***,” ‘Alice ventured to say. ‘What is it?’
>
> The Gryphon lifted up both its paws in surprise. ‘What! Never heard of ***uglifying***!’ it exclaimed. ‘You know what to beautify is, I suppose?’
>
> ‘Yes,' said Alice doubtfully: ‘it means--to--make--anything-- prettier.’
>
> ‘Well, then,’ the Gryphon went on, ‘if you don't know what ***to uglify*** is, you are a simpleton.’ (fq. 41)

Në këtë pjesë të shkëputur nga origjinali, Liza është duke biseduar me Breshkën dhe duke u përpjekur të kuptojë lëndët që ajo ka zhvilluar në shkollë. Të gjitha emërtimet e lëndëve përbëjnë lojëra fjalësh (siç do të diskutojmë më vonë në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm). Prapa fjalës ***Uglification*** qëndron fjala ***Multiplication*** (përkatësisht ***Shëmtim*** për ***Pjestim***), ku për të formuar fjalën *uglification* mund të mbështetemi në analogjinë *beauty-beautiful-to beautify >>> ugly-to uglify* (edhe pse fjala e fundit, d.m.th. folja *to uglify* nuk ekziston në anglisht).

d. Kategoria sintaksore

Ndërtimet sintaksore mund të shfrytëzohen për qëllimet e ndërtimit të lojërave të fjalëve: pohimet mund të analizohen nga ana sintaksore në të paktën dy mënyra të ndryshme, ndryshimet në rendin e fjalëve sjellin ndryshime në kuptim, etj.

> "Then you should ***say what you mean***," the March Hare went on.
>
> "I do," Alice hastily replied; "at least – at least ***I mean what I say*** – that's the same thing, you know."
>
> "Not the same thing a bit!" said the Hatter. "Why, you might just as well say that ***'I see what I eat***' is the same thing as ***'I eat what I see'***!"
>
> "You might just as well say," added the March Hare, "that ***'I like what I get***' is the same thing as ***'I get what I like'***!"
>
> "You might just as well say," added the Dormouse, which seemed to be talking in its sleep, "that ***'I breathe when I sleep***' is the same thing as ***'I sleep when I breathe'***!" (fq. 33)

---

[267] Në C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O’Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq.115, gjejmë këtë shpjegim për *beat time: ‘to make regular movements or sounds to show the speed at which music should be played’* (Në shqip ky shpjegim do të ishte ‘të bësh lëvizje ose tinguj të rregullt për të treguar shpejtësinë në të cilën duhet të luhet muzika’, pra, me pak fjalë, të mbash ritmin.) Nëse do ta zbërthenim këtë shprehje në fjalët përbërëse do të shpreheshim: “*rrah kohën”*.

Sigurisht që këtu na jepet një mësim i vlefshëm: rendi i fjalëve ka shumë rëndësi për kuptimin në gjuhën angleze. Përtej kësaj personazhet na kujtojnë se ndryshime në dukje të vogla e të parëndësishme mund të shkaktojnë keqkuptime të mëdha.

Duke qenë se jemi diskutuar për lojërat e fjalëve, nuk mund të lemë pa përmendur edhe një mënyrë krejt origjinale të autorit për t'iu dhënë emërtime karakterizuese kafshëve që e rrethojnë duke i shndërruar ato në personazhe domethënëse, apo nëpërmjet përdorimi të *malapropizmit* për disa nga emrat e përveçëm. Edhe pse kemi të bëjmë me lojëra fjalësh, këto shembuj do t'i trajtojmë në një çështje më vete për shkak të problematikës të shumëfishtë që shfaqet në variantet e përkthyera.

IV.3.1.3 Identifikimi i lojërave të fjalëve në origjinal

Leximi dhe rileximi i herëpashershëm i *Alice's Adventures in Wonderland* na befason me mënyrat e shumëfishta të përdorur nga autori për të shprehur kuptime, nënkuptime dhe kundërkuptime. Mendojmë se asnjëherë nuk është e mundur të zbulojmë terësisht pëlhurën që ka endur autori për t'i dhënë veprës një status të papërcaktuar, megjithatë, në këtë çështje ne do të paraqesim lojërat e fjalëve të cilat identifikohen lehtësisht dhe që, çka është edhe më e rëndësishme për këtë punim, shfaqin vështirësi për punën e përkthyesit dhe procesin e të lexuarit dhe të kuptuarit nga publiku marrës. Për këtë qëllim, veçanërisht i dobishëm ka qenë edhe leximi i shënimeve të nxjerra nga studiuesi Martin Gardner (Martin Gardner) në *The Annotated Alice – The Definitive Edition.* (W. W. Norton & Company: New York, USA, 2000). Në këtë mënyrë, mund të shohim edhe qëllimet që fshihen pas lojërave të fjalëve (në dukje të rastësishme) dhe nëse ato përcillen në përkthim. Herë pas here, do të ngremë pyetjet: Çfarë lloj loje fjale është kjo? Cili ka qënë synimi i autorit? Cili është nënkuptimi i fshehur? A ruhet loja e fjalëve në përkthim? Po nënkuptimi arrin të përcillet? Cilat janë strategjitë e përkthyesit? Sa të efektshme janë ato? Çfarë dallimesh vërejmë nga një variant në tjetri? A mund të shërbejë fakti nëse loja e fjalëve ruhet apo kompensohet si një kriter për vlerësimin e cilësisë së përkthimit?

Pyetjet do të marrin përgjigje pasi një analize sasiore dhe cilësore që do të bëjmë pasi të kemi analizuar shembujt e lojërave të fjalëve të identifikuara në veprën origjinale. Le të shohim fillimisht një pasqyrë të lojërave të fjalëve nëpërmjet tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 12 ***Lojërat e fjalëve në origjinal: llojet dhe shpjegimi i tyre***

Loja e fjalëve	***Horizontale - H Vertikale - V***	***Lloji***	***Shpjegimi***
How funny it'll seem to come out among the people that walk with their heads downward! The ***Antipathies****, I think*-- (fq. 12)[268]	V.	Malapropizëm	Liza dëshiron të thotë *Antipodes* por nuk i kujtohet fjala e duhur. *Antipathy* do të thotë antipati, urrejtje, ndërsa *antipode* – antipodë, diametralisht të kundërt.[269]
Do cats eat bats? *Do bats eat cats?* (fq. 12)	H.	Paronimi	Fjalët *cats* dhe *bats* ngjasojnë në shqiptim dhe rimojnë me njëra-tjetrën

[268] Numrat e faqeve dhënë në kllapa tregojnë pjësën nga janë shkëputur shembujt nga vepra: L. Carrol (2001) *The Complete Stories and Poems of Lewis Carroll*. Midpoint Press: New Lanark, Scotland.

[269] P. Qesku (2000) *Fjalor anglisht-shqip*. Botimet EDFA, Tiranë ,fq. 40; S. Wehmeir, C. McIntosh, J. Turnbull, M. Ashby (ed.s) (2010) *Oxford Advanced Learner's Dictionary*. Oxford University Press, fq. 54. [*the Antipodes - a way of referring to Australia and New Zeland, often used in a humorous way*; *antipathy – a strong feeling of dislike, hostility*] [përkth. shq. *the Antipodes – një mënyrë për t'iu referuar Australisë dhe Zelandës së Re; antipathy – një ndjenjë e fuqishme moskënaqësie, urrejtje*]

			edhe kur ndryshon rendi i tyre brenda fjalisë.
...and the fall was over. (fq. 12)	V.	Homonimi	*The fall* në anglisht i referohet edhe stinës së vjeshtës edhe veprimit të rënies – Liza bie mbi një grumbull gjethesh të vyshkura.
'Curiouser and curiouser!' cried Alice (she was so much surprised, that for the moment she quite forgot how to speak good English) (fq. 14)	V.	Malapropizëm	E befasuar nga ngjarjet *e çuditshme* që po i ndodhin, Liza harron rregullat gramatikore të anglishtes (mbiemri *curious* nuk e formon shkallën krahasore me *–er* në fund, por duke marrë përpara *more*, d.m.th. *more curious*, pra ngjarjet vazhdojnë të bëhen *edhe më shumë të cuditshme*).
'You ought to be ashamed of yourself,' said Alice, 'a great girl like you,' (she might well say this), 'to go on crying in this way! (fq. 14)	V.	Homonimi	*Great girl* – një vajzë e rritur edhe në moshë edhe në përmasat trupore (në këtë pjesë të veprës trupi i Lizës ka filluar të shndërrohet duke u rritur shumë).
I shall be punished for it now, I suppose, by being drowned in my own tears! (fq. 16)	V.	Polisemi	*being drowned in my own tears* – duke u mbytur në lotët e mi – shprehja mund të interpretohet edhe figurativisht, edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë meqënëse Liza (tani e shndërruar sërish por në përmasa shumë herë më të vogla) rrezikon të mbytet në pelllgun e lotëve që ka formuar vetë pak më parë.
This is the driest thing I know. (fq. 17)	V.	Homonimi	Mbiemri *dry* në anglisht ka edhe kuptimin *i, e thatë* edhe kuptimin *i, e mërzitshme, pa interes.* Miu rrëfen një histori shumë të mërzitshme për të tharë krijesat e bëra qull nga pellgu i lotëve.[270]
'Mine is a long and a sad ***tale****!' said the Mouse, turning to Alice, and sighing.* *'It IS a long* ***tail****, certainly,' said Alice, looking down with wonder at the Mouse's* ***tail****; 'but why do you* *call it sad?'* (fq. 18)	H.	Homofoni	*Tale* dhe *tail* në anglisht shqiptohen njësoj, pra përbëjnë një çift homofonik. Miu i referohet *tale* – histori, rrëfim, (si një rrëfim i gjatë dhe i trishtueshëm), ndërsa Liza kujton se ai i referohet *tail* – bishtit të tij, që mund të jetë një bisht i gjatë (pasi Liza e shikon me habi), por jo i trishtueshëm.
'I beg your pardon,' said Alice very humbly: 'you ***had got to the fifth bend****, I think?'* (fq. 19)	V.	Idiomë	Liza përdor një shprehje idiomatike që mund të interpretohet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, meqënëse rrëfimi i historisë së Miut ishte me *kthesa,* por njëkohësisht edhe në

[270] Miu në fakt fillon të flasë për personazhe reale historikë si *William Pushtuesi* etj. duke bërë një përmbledhje të historisë që ndiqet pa ndonjë interes nga personazhet e tjerë. *Martin Gardner* në *The Annotated Alice – The Definitive Edition* (fq.30) shpjegon se Roxher Lencilin Grin (Roger Lancelyn Green), redaktor i ditarit të Kerël, e identifikon këtë paragraf si një citim nga vepra e Havilend Çepmël (Havilland Chepmell) (1862) *Short Course of History*. Lond, United Kingdom, fq. 143-144. Libri i Çepmëlit ishte një nga librat që studiohej nga fëmijët Lidël. Grin madje shprehet se ndoshta Miu personifikon *Miss Prickett,* mësuesen e fëmijëve. Në *Longman Dictionary of Centemporay English*' gjejmë këto shpjegime për *dry – not wet; boring; showing no emotion*, ndërsa në fjalorin shqip-anglisht të P. Qeskut: *i thatë; monoton; pa zbukurime*. Ngjashmëria në formë e kuptim bën të mundur që, brenda aftësive të përkthyesve, loja e fjalëve të rindërtohet edhe në shqip.

			mënyrë të figurshme duke nënkuptuar paqëndrueshmëri mendore për Miun, meqënëse rrëfimi i tij në të vërtetë është pa kuptim.
*'I had **NOT**!' cried the Mouse, sharply and very angrily.* *'A **knot**!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!'* *'I shall do nothing of the sort,' said the Mouse*. (fq. 19)	H.	Paronimi	Liza keqkupton përgjigjen negative të Miut – që përmban pjesëzën mohuese *not* – duke nënkuptuar *knot* – nyje, dhe ofron gadishmërinë e saj për të ndihmuar Miun ta zgidhë.
*'What do you mean by that?' said the Caterpillar sternly. '**Explain yourself!'*** *'I can't **explain MYSELF**, I'm afraid, sir' said Alice, 'because I'm not myself, **you see**.'* *'**I don't see**,' said the Caterpillar.* (fq. 24)	H.	Idiomë	Përdorime të ndryshme të *myself* – në fillim e ngurtësur në shprehjen e parë me përdorim vetvetor (*explain myself* – shpjegohem) dhe marrë veçmas, e ndarë nga folja (shpjegoj veten), flas për veten – gjë që Liza nuk mund ta bëjë sepse ka pësuar shumë shndërrime dhe nuk është më e sigurt për vehten. Gjithashtu, *you see* – e kupton – që vemja e merr në kuptim të drejtpërdrejtë – e shikon – dhe përgjigjet në mënyrë negative.
*You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its **axis**—'* *'Talking of **axes**,' said the Duchess, 'chop off her head!'* (fq. 29)	H.	Homofoni	Këto dy fjalë në anglisht shqiptohen njësoj. Liza përpiqet të shpjegojë faktin se tokës i duhen njëzet e katër orë për të bërë një rrotullim rreth vetes (*axis – boshtit*), ndërsa Dukesha i referohet një sendi tjetër (*axes – sëpatës*), dhe kërkon që Lizës *t'i pritet koka*.
*Wouldn't it be a **murder** to leave it behind?* (fq. 30)	V.	Idiomë	*be a murder* – mund të interpretohet edhe figurativisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë meqënëse, nëse Liza nuk e merr me vete foshnjën, dukesha nuk do të kujdesej për të dhe do të ishte njësoj sikur ta vriste nga pakujdesia.
'Did you say pig, or fig?' said the Cat. (fq. 32)	H.	Paronimi	Fjalët *pig* (derr) dhe *fig* (fik) ngjasojnë në shqiptim dhe në shkrim.
*'Then you should **say what you mean,**' the March Hare went on.* *'I do,' Alice hastily replied; 'at least--at least I mean what I **say**--that's the same thing, you know.'* ***'I see what I eat' 'I eat what I see'*** ***'I like what I get''I get what I like'*** ***'I breathe when I sleep' 'I sleep when I breathe'*** (fq. 33)	H.	Rendi i fjalëve	Siç mund të shihet, rendi i fjalëve ka shumë rëndësi për përcjelljen e kuptimit të duhur në gjuhën angleze. Përmbysja e rendit sjell ndryshime domethënëse.

*'If you knew Time as well as I do,' said the Hatter, 'you wouldn't talk about wasting **IT**. It's **HIM**.'...* *I know I have to **beat time** when I learn music.'* *'Ah! that accounts for it,' said the Hatter. '**He won't stand beating**.'* (fq. 33)	H.	Idiomë	*Koha* konsiderohet të jetë një ndër personazhet e tjerë krahas Lepurit të Marrë, Kapelebërësit, etj., ndërsa Liza flet për kohën në mënyrë abstrakte.[271]
*...they were learning to **draw**, you know—* *'What did they **draw**?' said Alice, quite forgetting her promise.* *'Treacle,' said the Dormouse, without considering at all this time.* (fq. 34)	H.	Homonimi	*Draw* në anglisht ka kuptimet *vizatoj* dhe *tërheq*, *nxjerr*.[272] Në këtë shembull, Miu Gjumash i referohet veprimit të nxjerrjes së pekmezit nga pusi, ndërsa Liza mendon se ai po flet për veprimin e të vizatuarit.
*'But they were IN the **well**,' Alice said to the Dormouse, not choosing to notice this last remark.* *'Of course they were', said the Dormouse; '--**well in**.'* (fq. 35)	H.	Homonimi	Në fjalinë e parë *well* si emër (pus), në fjalinë e dytë *well* si ndajfolje (shumë thellë).
*...there's a large mustard-**mine** near here. And the moral of that is—'The more there is of **mine**, the less there is of yours.'*(fq. 39)	V.	Homografi	*Mine* si një emër (minierë) dhe si një përemër pronor (i, e imja).
*...either you or your head **must be off**...* (fq. 40)	H.	Polisemi	*be off* – të largohet ose të pritet (kjo është kërkesa i bën Mbretëresha Dukeshës, ose të largohet ose do t'i pritet koka)

[271] Në C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq.115, gjejmë këtë shpjegim për *beat time: 'to make regular movements or sounds to show the speed at which music should be played'* (Në shqip ky shpjegim do të ishte "të bësh lëvizje ose tinguj të rregullt për të treguar shpejtësinë në të cilën duhet të luhet muzika", pra, me pak fjalë, të mbash ritmin.) Nëse do ta përkthenim këtë shprehje fjalë për fjalë do të shpreheshim: "*rrah kohën*".

[271] Nisur nga analiza komponenciale mund të themi se përdorimi i *school* në anglisht duke iu referuar një grupi peshqish ose kafshësh deti që notojnë së bashku nuk ekziston në kuptimet e fjalës *shkollë* në gjuhën shqipe. *school – 1 (where children learn) a place where children go to get educated; ... 9 (of fish) a large number of fish or other sea animals, swimming together: a school of dolphins.* (Marë nga S. Wehmeir, C. McIntosh, J. Turnbull, M. Ashby (ed.s) (2010) *Oxford Advanced Learner's Dictionary*. Oxford University Press, fq. 1306); shkollë – 1. institucion arsimor ku mëson dhe edukohet brezi i ri; ndërtesa e këtij institucioni; sistemi arsimor i një vendi; 2. *fig.* burim mësimesh e njohurish, veprimtari gjatë së cilës njeriu fiton përvojë të pasur dhe edukohet. 3. drejtim i caktuar në fushën e shkencës, të artit, të lëtërsisë etj., që ka disa parime e metoda të veçanta; rrymë; tërësia e parimeve krijuese dhe e metodave të një drejtimi të tillë; *përmb.* tërësia e atyre që ndjekin një drejtim të tillë [marrë nga *Fjalori i Shqipes së Sotme* (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet Toena, Tiranë. fq. 1255-6].

*... we went to **school** in the sea* *... we went to school every **day*** *`I'VE been to a **day-school**, too,' said Alice; `you needn't be so proud as all that.'* (fq. 41)	V.	Polisemi	Në anglisht *school* përveç kuptimit *shkollë*, mund të përdoret edhe duke iu referuar një grupi peshqish ose kafshësh deti që notojnë së bashku.[273] Më pas, është Liza ajo që keqkupton komentin e Breshkës në lidhje me faktin se shkonte në shkollë përditë, duke prezantuar konceptin e s*hkollës ditore* (që nuk është e njëjta gjë). Dëshira e saj fëminore për të garuar me *Mock Turtle* na çon drejt një përmbysjeje të fjalëve në rendin e tyre, dhe të kuptimit që ato shprehin.[274]
*'That's the reason they're called **lessons**,' the Gryphon remarked: 'because they **lessen** from day to day.'* (fq. 42)	H.	Paronimi	Të dyja fjalët ngjasojnë shumë në shqiptim: *lesson* – emër që nënkupton mësimet në shkollë dhe *to lessen* – folje që do të thotë 'me u pakësue'.
'And what are they made of?' Alice asked in a tone of great curiosity. *'**Soles and eels**, of course,' the Gryphon replied rather impatiently: 'any shrimp could have told you that.'* (fq. 43)	V.	Paronimi	Liza pyet se nga çfarë përbëhen këpucët dhe çizmet. Grifoni (duke i vendosur fjalët brenda fushës semantike të detit) përgjigjet *soles and eels (shojza dhe ngjala)* duke nënkuptuar dy fjalë të tjera shumë të ngjashme në shqiptim – *soles and heels – taban, shollë dhe frone, taka* (jashtë fushës semantike të detit).
*'What are they doing?' Alice whispered to the Gryphon. 'They can't have anything to **put down** yet, before the trial's begun.'* *'They're **putting down** their names,' the Gryphon whispered in reply, 'for fear they should forget them before the end of the trial.'* (fq. 45)	H.	Idiomë	Idioma *put down* mbart disa kuptime, ndër të cilat në këtë shembull janë shfrytëzuar: *vendos* dhe *shkruaj*.
*...and I hadn't begun my **tea**--not above a week or so--and what with the bread-and-butter getting so thin--and the **twinkling** of the **tea**—'* *'The **twinkling** of the what?' said the King.* *'It began with the **tea**,' the Hatter replied.* *'Of course **twinkling** begins with a **T**!' said the King sharply. 'Do you take me for a dunce? Go on!'* (fq. 47)	H.	Paronimi	Ngatërresa që lind një lojë fjalësh ka të bëjë me shqiptimin e *tea* (çaj), gërmës *T* (të shqiptuar ashtu si dhe *tea* në anglisht [ti:], si dhe gërmës së parë të *twinkling* që është *T* dhe shqiptohet njësoj si në dy rastet e mëparëshme.
*'I'm a **poor man**, your Majesty,' he began.* *'You're a very **poor speaker**,' said*	H.	Polisemi	*Poor man* – njeri i varfër, dhe *poor speaker* – njeri me mangësi në aftësitë e të folurit, të komunikimit.[275]

[274] *school-day*-ditë mësimi; *day-school*-shkollë ditore pa konvikt.

[275] *poor* – mb. i varfër. *poor man* - i varfër; skamës; fukara;i varfër; i pamjaftueshëm. i dobët. [shkëputur nga P. Qesku (2000) *Fjalori anglisht-shqip*. Botimet EDFA, Tiranë, fq. 814] Në fjalorin anglisht-anglisht lexojmë *poor – having little money; unfortunate; not good or skilled at something* (i varfër – të kesh pak para; pa fat; të mos kesh aftësi të mira për diçka). Të dhënat janë shkëputur nga S. Wehmeir, C. McIntosh,

the King. (fq. 47)			
Here one of the guinea-pigs cheered, and was immediately ***suppressed*** *by the officers of the court. (As that is rather a hard word, I will just explain to you how it was done. They had a large canvas bag,* *which tied up at the mouth with strings: into this they slipped the guinea-pig, head first, and then sat upon it.)* *'I'm glad I've seen that done' thought Alice. 'I've so often read in the newspapers, at the end of trials,* *"There was some attempts at applause, which was immediately* ***suppressed*** *by the officers of the court," and I never understood what it meant till now.'* (fq. 47)	H.	Polisemi	Sërish kemi një situatë dykuptimëshe të krijuar në sallën e gjyqit. *Supress* ka disa kuptime, mes tyre përmendim: *mbyt, shtyp (liritë e njeriut); fsheh, kaloj në heshtje (provat e një cështjeje); ndrydh (ndjenjat)* etj. Loja e fjalëve zgjerohet edhe më shumë, pasi Liza, duke mos e njohur më parë kuptimin e kësaj fjale (ndonëse e kishte dëgjuar shpesh në gazeta që i referoheshin proces eve gjyqësore) jep edhe një shpjegim qesharak se si bëhej "*shtypja*", duke satirizuar kështu në përgjithësi proces in gjyqësor (zyrtarët mbanin një çantë në të cilën futën një nga derrkucët, në fillim kokën e tij, e lidhën grykën e çantës me spango, dhe pastaj iu ulën përsipër).
'If that's all you know about it, you may ***stand down****,' continued the King.* *'I can't go no lower,' said the Hatter: 'I'm on the floor, as it is.'* *'Then you may* ***SIT down****,' the King replied.* (fq. 47)	H.	Idiomë	*Stand down* në zhargonin ligjor (të përdorur brenda sallës së gjyqit ku ndodhen personazhet) ka kuptimin *të largohesh nga banka e dëshmitarit.* Kapelebërësi mendon se Mbreti kërkon që ai të *zbresë* (tjetër kuptim i shprehjes së përdorur) dhe thotë se nuk mund të zbresë më poshtë. Mbreti, për t'u sqaruar, përdor shprehjen *sit down,* duke i kërkuar Kapelëbërësit që të *ulet.*

IV.3.1.4 Strategjitë për përkthimin e lojërave të fjalëve: krahasim mes varianteve në gjuhën shqipe

Përpara se të japim një analizë sasiore të përkthimit të lojërave të fjalëve në korpusin e zgjedhur, do të pasqyrojmë fillimisht cilat janë disa strategji që mund të përdoren në përkthimin e lojërave të fjalëve, duke u nisur nga supozimi se lojërat e fjalëve mund të konsiderohen si një formë e veçantë letrare dhe, rrjedhimisht, për përkthimin e tyre mund të zbatohen strategji të ndryshme. Modeli të cilit do t'i referohemi bazohet në ndarjen e dhënë nga Drik Delabastita duke marrë si shembull veprat e Shekspirit, në veçanti veprën e Hamletit.[276] Ne do t'i përmbahemi klasifikimit të strategjive që ofron ai, duke sjellë shembuj konkretë nga tabela nr.13.

Në parantezë, duhet të themi se vështirësitë gjatë përkthimit janë të shumta. Pavarësisht se në parim zgjidhja optimale në sytë e një kritiku do të ishte rikrijimi i çdo loje fjalësh të pranishme në origjinal, vetë *rikrijimi* do të nënkuptonte ndryshime në strukturën formale, gjuhësore, kuptimore si dhe të kontekstit në të cilin është ndërtuar loja në origjinal. Siç shprehet edhe Delabastita, në dukje kemi të bëjmë me një paradoks, por në fakt mënyra e vetme për t'i qëndruar besnik tekstit origjinal arrihet duke mos i

J. Turnbull, M. Ashby (ed.s) (2010) *Oxford Advanced Learner's Dictionary*. Oxford University Press, fq. 1125.

[276] D. Delabastita (1993) *There's a Double Tongue. An Investigation into the Translation of Shakespeare's Wordplay with Special Reference to Hamlet.* Amsterdam and Atlanta: Rodopi, fq. 192-227.

qëndruar besnik atij.[277] Sipas tij ka tre raste që paraqesin mundësi që lojërat e fjalëve të rikrijohen në gjuhë të tjera:

1. ndërmjet gjuhëve që janë të lidhura historikisht, veçanërisht ato lojëra fjalësh që bazohen në ngjashmëritë tingullore, për shembull, gjermanishtja dhe anglishtja;
2. lojërat e fjalëve të bazuara në polisemi (meqënëse i kanë rrënjët në realitetin jashtëgjuhësor) mund të rikrijohen me pak humbje edhe mes gjuhëve që nuk janë të lidhura historikisht;
3. huazimet ndërgjuhësore të përbashkëta edhe për gjuhën e origjinalit dhe atë të përkthimit.[278]

Pavarësisht këtyre rasteve të paraqitura, duhet të kemi parasysh se pengesa më e madhe me të cilën përballet përkthyesi ka të bëjë me faktin që simbolet gjuhësore janë arbitrare, kështu që shpesh përkthyesit do t'i duhet të zgjedhë fjalë që nuk kanë ngjashmëri me origjinalin. Përkthyesi është i përfshirë gjatë gjithë kohës në një proces vendimmarrës ku faktorët që ndikojnë janë nga më të ndryshmit, ndër të cilët mund të përmendin: faktin nëse libri i drejtohet fëmijëve apo të rriturve (edhe një herë kujtojmë statusin e tekstit), nëse do të priret ndaj përshtatshmërisë (orientuar nga teksti i përkthyer) apo pranueshmërisë (orientuar nga teksti origjinal), ndërgjegjësimi për nivelin e njohurive dhe përvojës së ndryshme kulturore të publikut origjinal kundrejt atij të përkthimit, por njëkohësisht edhe vetë njohuritë enciklopedike dhe kulturore të vetë përkthyesit të cilit i duhet të përafrojë e të vendosë ura lidhëse mes dy botëve të ndryshme. Kjo nuk do të thotë se përkthimi i lojërave të fjalëve është i pamundur. Reiçëll Vajsbrod (Rachel Weissbrod) sugjeron disa taktika si:

- të përdoren gjithë nivelet stilistike dhe shtresat historike të gjendshme në gjuhën e përkthimit, edhe nëse këto nuk kanë paralele ekzistuese në tekstin origjinal;
- të ndryshohen një apo më shumë kuptime të lojës së fjalëve në origjinal në mënyrë që ato të mund të përmblidhen në një ose në më shumë fjalë të ngjashme në formë ose në shqiptim;
- të ndryshohet lloji i lojës së fjalëve ose vendndodhja e saj në tekst[279].

Këto mundësi të ndryshme do ta ndihmonin një përkthyes që të përdorte imagjinatën e tij (ndërthurur me njohuri të shëndosha gjuhësore) për të marrë vendimet shpesh herë jo të lehta gjatë përkthimit. Megjthatë, nuk duhet të harrojmë se, pavarësisht nga pengesat gjuhësore ose kulturore dhe teknikat që përdoren për t'i kaluar ato, ka gjithmonë edhe faktorë subjektivë që ndikojnë në këtë proces si talenti, aftësitë dhe gadishmëria e përkthyesit që t'i kushtojë vëmendje, kohë dhe energji fillimisht procesit të të kuptuarit, e, më pas të të përkthyerit të tekstit në përgjithësi, dhe lojërave të fjalëve në veçanti.

Duke iu referuar tani konkretisht korpusit tonë, theksojmë se në këtë çështje do të rishikojmë edhe një herë lojërat e fjalëve që pasqyruam në tabelën nr. 12. Pasi kemi kuptuar secilën prej tyre, pasi kemi shijuar manipulimin e gjuhës nga shkrimtari dhe kemi arritur të zhbirojmë nënkuptimet, është vërtet me interes të shqyrtojmë variantet në gjuhën shqipe dhe t'i krahasojmë ato me origjinalin dhe me njëri-tjetrin. Do të paraqesim kështu një tabelë tjetër, ku kolona e parë do të jetë e njëjtë me tabelën nr. 12, (në këtë kolonë do të japim sërish lojërat e fjalëve ashtu siç shfaqen në origjinal) ndërsa në kolonat e tjera do të riprodhojmë pjesët përkatëse nga secili variant i përkthyer. Pasi të

[277] D. Delabastita (1996) *Wordplay and Translation.* Special Issue of *The Translator: Studies in Intercultural Communication,* 2(2). Manchester: St. Jerome, fq. 135.
[278] Po aty, fq. 135-136.
[279] R. Weissbrod (1996) *"Curiouser and Curiouser': Hebrew Translations of Wordplay in 'Alice's Adventures in Wonderland* në *Worplay and Translation"*. St. Jerome Publishing, Manchester, fq. 221.

kemi vënë në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë mes varianteve (njëkohësisht duke bërë krahasim edhe me origjinalin) do të komentojmë rreth strategjive të përdorura nga përkthyesit, vështirësitë që ata kanë hasur si dhe do të prezantojmë përmbledhtasi mënyrat që janë përdorur prej tyre, duke u përpjekur të nxjerrim disa përfundime në lidhje me strategjitë e përkthimit të lojërave të fjalëve në përgjithësi.

Shembujt e shkruar në fillim janë shkëputur nga origjinali *Alice's Adventures in Wonderland*, ndërsa shembujt që ndjekin citimin (siç do të vëreni në më poshtë) janë marrë nga pesë variantet e përkthyera në gjuhën shqipe si vijon:

1) përkthimi në shqip nga *Hysejn Çela dhe Beqir Çela* (viti 1944),
2) përkthimi nga *Maqo Afezolli* (1961)
3) sërish përkthim nga *Maqo Afezolli* (1998),
4) përkthimi nga *Taulant dhe Eri Tafa* (2008), dhe
5) përkthimi nga *Frederik Shuraja* (2008).

Për lehtësi shprehjeje dhe orientimi, secili përkthim shoqërohet në kllapa me shënimet përkatëse të faqes nga ku është shkëputur. Më poshtë po japim vetëm një pjesë ilustruese të tabelës, të cilën mund ta gjeni të plotë në fund të këtij punimi, në pjesën *Shtojca 1*.

Tabela nr. 13 ***Lojërat e fjalëve në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe (1944-2008)***

Loja e fjalëve në origjinal	***Varianti i parë*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***Varianti i dytë*** *Maqo Afezolli* (1961)	***Varianti i tretë*** *Maqo Afezolli* (1998)	***Varianti i katërt*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***Varianti i pestë*** *Fredetik Shuraja* (2008)
How funny it'll seem to come out among the people that walk with their heads downward! The ***Antipathies****, I think--* (fq. 12)	Sa qejf ka për të qenë kùr të dal ke njerëzit që ecin me kokë teposhtë! Kokë-tatpjetët më thotë mendja do t'i quejnë.....” (fq. 12)	Ç'gjë e habitshme do të jetë kur të shoh njerëzit të ecin me kokë poshtë! Antipathët besoj, (përnjëherësh u ndal, mbasi kjo fjalë nuk i tingëlloi mirë) jo, më duket se quhen Antipode*. (*shën. përkth. Ata që bnojnë n'anën tjetër të dheut) (fq. 6)	Ç'gjë e habitshme do të jetë kur të shoh njerëzit të ecin e kokë poshtë! Antipathët më duket... (fq. 12)	“Do të kënaqesha duke shëtitur krah banorëve që ecin kokë poshtë! Më duket se quhen Antipatë...” (fq. 8)	Sa argëtuese do të jetë të gjendesh mes njerëzve që ecin kokëposhtë! Antipati ... më duket, kështu quhen ata ... (fq. 12)
'Do cats eat bats? Do bats eat cats? (fq. 12)	A i hanë macat lakuriqat? A i hanë lakuriqat macat? (fq. 12)	A i hanë macet laskuriqet e natës? A i hanë laskuriqet macet? (fq. 7)	A i hanë macet lakuriqët e natës? A i hanë lakuriqët macet? (fq. 13)	A hanë macet lakuriqë nate? Po lakuriqët e natës a hanë mace? (fq. 9)	“Vallë i hanë macet lakuriqët e natës?” “Vallë i hanë minjtë macet lakuriqë?” (fq. 12-13)
...and the fall was over. (fq. 12)	Do me thanë se të ranët kishte marrë fund! (fq. 13)	Domethënë se zbritja kishte marrë fund. (fq. 7)	Domethënë se zbritja kishte marrë fund. (fq. 14)	Rënja kishte mbaruar. (fq. 10)	...dhe me këtë rënia e saj mbaroi. (fq. 13)
'Curiouser	“Çudí edhe	“Çudi, çudi” –	Çudi, çudi e	“ E	“Sa çudi, ç'është

and curiouser!' cried Alice (she was so much surprised, that for the moment she quite forgot how to speak good English) (fq. 14)	mâ!" (Liza deshi me thânë "Çudí e madhe!" Por, nga habija, at çast të-thuesh si kishte harrue me folë si duhet). (fq. 19)	u ankua Liza. (Atë çast Liza desh të thosh "çudi e madhe", por nga habia kishte harruar të fliste si duhet). (fq. 11)	madhe, - thirri Liza, - tani jam duke u rritur kaq shumë ... (fq. 19)	çuditshme, shumë e çuditshme" thirri Liza (ishte aq e mrekulluar sa atë çast harroi edhe rregullat gramatikore). (fq. 17)	kështu! – thirri Liza (nga habia ajo madje një çast harroi, si duhej të fliste saktë). (fq. 19)
'You ought to be ashamed of yourself,' said Alice, 'a great girl like you,' (she might well say this), 'to go on crying in this way! (fq. 14)	"Duhet të keshë turp nga vehtja!" tha Liza: "Nji vajz' e madhe si ti..." (këtê tashti mund t'a thoshte me të drejtë) " me qà kështu! (fq. 20)	"Të kesh turp nga vetja jote" – tha Liza. "Një vajzë e madhe si ti, (këtë, tashti, mund ta thoshte me të drejtë), të qajë kështu! (fq. 12)	- Të kesh turp nga vetja jote, – tha Liza. - Një vajzë e madhe si ti, (këtë, tani mund ta thoshte me të drejtë) të qajë kështu! (fq. 20)	"Të të vij turp nga vetja!" tha Liza. "Një vajzë e rritur si ti" (tani kishte plotësisht të drejtë të thoshte kështu) "nuk duhet të qaj në këtë mënyrë! (fq. 18)	"Si nuk të vjen turp! – tha Liza, - një vajzë kaq e madhe (këtu ajo, sigurisht, kishte të drejtë) dhe qan! (fq. 21)
I shall be punished for it now, I suppose, by being drowned in my own tears! (fq. 16)	...dhe si dënim tashti duket se po mbytem në lotët e mij! (fq. 24)	... dhe si dënim po mbutem në lotët e mij! (fq. 15)	...dhe si dënim po mbytem në lotët e mi! (fq. 24)	"Do të ishte e tmerrshme që të mbytesha në lotët e mia! (fq. 23)	Tani ndoshta jam e dënuar të mbytem në lotët e mi! (fq. 25)
This is the driest thing I know. (fq. 17)	Kam me ju terë shpejt. (fq. 28)	Do t'ju thaj shpejt! (fq. 19)	Do t'ju thaj shpejt! (fq. 29)	... do ta gjej unë mënyrën si të thaheni!" (fq. 30)	Kjo është gjëja më e thatë që njoh. (fq. 31)

Për secilën prej strategjive të përdorura kemi përzgjedhur një nga ngjyrat ilustruese si më poshtë. Të njëjtat ngjyra të përdorura në tabelë janë përdorur edhe në ndërtimin e grafikëve, në mënyrë që edhe interpretimi i të dhënave të jetë më i lehtë.

E gjelbër	Rikrijimi i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer
Blu	Përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer
E verdhë	Mospërfshirje e lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer
Portokalli	

Transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer

Le të shohim më konkretisht nëpërmjet shembujve strategjitë e përdorura në korpusin tonë.

1. Rikrijimi i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer

E kemi përmendur tashmë se lojërat e fjalëve mund të jenë të natyrave dhe kategorive të ndryshme në varësi të organizmit hapësinor dhe përbërësve gjuhësorë. Kjo është edhe arsyeja pse një lojë fjalësh e tekstit origjinal mund të rikrijohet në tekstin e përkthyer, edhe pse mund t'i përkasë një natyre të ndryshme (loja e fjalëve në tekstin e përkthyer mund të mos ketë të njëjtën strukturë formale si në tekstin origjinal, mund t'i përkasë një fushe tjetër semantike, mund të kalohet nga homonimia në paronimi, idiomë, polisemi, etj). Për të ilustruar këtë rast po shkëputim një shembull nga tabela nr.13. (Rikujtojmë se të gjitha rastet kur loja e fjalëve është rikrijuar jepen në tabelë më ngjyrë të gjelbër.)

Shembulli 1

*'You ought to be ashamed of yourself,' said Alice, '**a great girl** like you,' (she might well say this), 'to go on crying in this way!* (fq. 14)	"Duhet të keshë turp nga vehtja!" tha Liza: "Nji ***vajz' e madhe*** si ti..." (këtê tashti mund t'a thoshte me të drejtë) " me qà kështu! (v. I, fq. 20)

Loja e fjalëve ruhet edhe në variantin e përkthyer në shqip, ku ***vajzë e madhe*** mund t'i referohet edhe përmasave trupore edhe moshës.

Shembulli 2

*You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its **axis**—'*	E dini se toka don 24 orë me u rrotullue rreth **boshtit** të vet...."
*'Talking of **axes**,' said the Duchess, 'chop off her head!'* (fq. 29)	"Mbassi po na flet për ***boshte***", bërtiti Dukesha, "**shpojani** kryet!" (v. I, fq. 65)

Në tekstin origjinal loja e fjalëve ka karakter homofonik, ndërsa në variantin në tekstin e përkthyer ka karakter homonimik, megjithatë e rëndësishme është që loja e fjalëve ruhet brenda të njëjtit kontekst. Duhet përmendur gjithashtu se përkthyesi arrin të ruajë koherencën, duke zgjedhur fjalën *bosht* ai i referohet prerjes së kokës – veprimi më i kërkuar nga Dukesha ndaj personazheve që e kundërshtojnë – me foljen *shpojani* dhe jo *prejani* si në pjesët e tjera të po këtij varianti, për të ruajtur koherencën brendatekstuale.

Shembulli 3

*'That's the reason they're called **lessons**,' the Gryphon remarked: 'because they **lessen** from day to day.'* (fq. 42)	Prandaj quhej ***shkollë***!" theksoi Grifoni. "Në fakt nëse ti zëvendëson një ***"a" me "o", në vend të shkollës bëhet shkallë. Dhe prandaj çdo ditë shkallëzohet dhe hiqet një orë"***. (v. IV, fq. 123)

Pavarësisht se loja e fjalëve në tekstin e përkthyer nuk bazohet në e njëjta fjalë si në origjinal, në të dyja rastet kemi lojë fjalësh bazuar në paronimi, dhe rrjedhimisht transmetohet efekti humoristik.

Shembulli 4

'Did you say pig, or fig?' said the Cat. (fq. 32)	"A thé derr apo çerr?" e pyeti ajo Lizën. (v.I, fq. 71)

Loja e fjalëve ka të njëjtën natyrë, këmi të bëjmë me homofonet ***pig-fig*** në TB dhe ***derr-çerr*** në TM.[280]

2.Përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer

Në këtë grupim do të përfshijmë të gjitha rastet kur edhe pse në teksin origjinal ekziston një lojë fjalësh, kjo lojë fjalësh përkthehet fjalë për fjalë duke e humbur krejtësisht efektin humoristik në tekstin e përkthyer, ose duke humbur dykuptimësinë (pra përcillet kuptimi i drejtpërdrejtë, por humbet nënkuptimi). Shikojmë shembujt më poshtë (shënuar me ngjyrë blu) shkëputur nga tabela nr.13. Njëkohësisht për të kuptuar lojën e fjalëve në teksin origjinal mund t'i referoheni lojës përkatëse në tabelën nr. 12.

Shembulli 1

...*and the **fall** was over.* (fq. 12)	...dhe me këtë **rënia** e saj mbaroi. (v. V, fq. 13)

Në këtë variant, fjala *fall* (*fall*-vjeshtë; akti i të rënit) është përkthyer *zbritja* duke mos përcjellë kështu dykuptimësinë e tekstit origjinal.

Shembulli 2

*This is the **driest** thing I know.* (fq. 17)	... do ta gjej unë mënyrën si të ***thaheni***!" (v.IV, fq. 30)

Përcillet vetëm një kuptim i përcaktorit *dry* (jo i qullët) dhe nuk përcillet kuptimi tjetër (pa interes, monoton, i mërzitshëm). Të mos harrojmë që historia që rrëfehet sjell ndërmend përmbledhtasi faktet e historise së Britanisë, gjë që nuk ngjall ndonjë interes në krijesat që po e dëgjojnë.

Shembulli 3

...*we went to **school** in the sea...* (fq. 41)	...ne shkonim ***në shkollë*** në det... (v.II, fq. 108)

Loja e fjalës për *school* humbet, meqenëse nuk përcillet shumësia e kuptimeve. (nisur nga analiza komponenciale mund të themi se përdorimi i *school* në anglisht duke iu referuar një grupi peshqish ose kafshësh deti që notojnë së bashku nuk ekziston në kuptimet e fjalës *shkollë* në gjuhën shqipe).

3. Mospërfshirje e lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer

Për ta dalluar këtë grupim me grupimin e mësipërm, duhet të qartësojmë se në këtë grup përfshijmë rastet kur loja e fjalëve në tekstin origjinal nuk përkthehet fare në tekstin e përkthyer, pra ajo pjesë e origjinalit që përmban lojë fjalësh lihet e papërkthyer dhe nuk përfshihet në përkthim (në tabelën nr. 13 janë pjesët e identifikuara me ngjyrë të verdhë).

Shembulli 1

*'I had **NOT**!' cried the Mouse, sharply and very angrily.*	
*'A **knot**!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!'*	[Ç'***kthesë*** moj? – pyeti Miu shumë i zemëruar...] – Ti më fyen vazhdimisht me ato marrëzi që flet! (v. III, fq. 37)
"I shall do nothing of the sort," said the Mouse.	

[280] çerr, i – 1. cinxami, ferrak. *i vogël sa një çerr.* 2. zog i vogël pule, zakonisht i ngrohur nga një tjetër shtëpiak (marrë nga *Fjalori i Shqipes së Sotme* Tiranë 2002, fq. 190).

"You insult me by talking such nonsense!" (fq. 19)	

Përkthyesi ka lënë pa përkthyer fjalitë e mësipërme ku vërejmë lojën mes fjalëve homofonike ***not-knot***.

Shembulli 2

*...there's a large mustard-**mine** near here. And the moral of that is—'The more there is of **mine**, the less there is of yours.'* (fq. 39)	---------- (v. I, fq. 98).

E gjithë loja e fjalëve është lënë pa përkthyer në gjuhën shqipe.

Shembulli 3

*You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its **axis**—'* *'Talking of **axes**,' said the Duchess, 'chop off her head!' (fq. 29)*	E shikoni, toka rrotullohet rreth ***boshtit*** të vet gjatë njëzet e katër orëve, kështu që njëzet e katër orë më parë ishte mëngjes, kështu që ... ---------- (v. V, fq. 70).

Vetëm pjesa e parë e lojës së fjalëve është përkthyer, si rrjedhojë, dykuptimësia nuk transmetohet në gjuhën shqipe.

4. Transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer

Në shumë raste, fjalë ose shprehje të caktuara përkthehen duke marrë "të transferuar" një pjesë të kuptimit të tyre nga gjuha origjinale, edhe pse ky nuk është kuptimi i tyre i zakonshëm me të cilin përdoren në gjuhën e përkthimit. Në raste të tjera, vetë përkthyesi vendos të transferojë lojën e fjalëve ashtu siç është në origjinal, edhe pse kjo mund të mos ketë kuptim për lexuesit e përkthimit, kështu që nëpërmjet disa teknikave editoriale (siç janë shënimet në fund të faqes apo shpjegimet mes kllapave) përpiqet të kompesojë humbjen e dykuptimësisë ose mungesën e nënkuptimit të fshehur në origjinal. Të tilla janë shembujt që kemi përfshirë në këtë grup (nëse do t'i referoheni sërish tabelës nr. 13, shembujt që do të shkëputim më poshtë janë ilustruar me ngjyrë portokalli).

Shembulli 1

*'That's the reason they're called **lessons**,' the Gryphon remarked: 'because they **lessen** from day to day.'* (fq. 42)	"Prandaj quhen '*mêhsime*'ato" – tha Grifoni – "se shkojnë gjithënjë duke u mehur*!" (*shën. përkth. duke u pakësuar) (v. II, fq. 109)

Loja e fjalëve rindërtohet bukur edhe në përkthim, përkthyesi gjithashtu u shikon të arsyeshme të japë shpjegimin në fund të faqes për foljen *mehet – pakësohet.*

Shembulli 2

*...they were learning to **draw**, you know—* *'What did they **draw**?' said Alice, quite forgetting her promise.* *'Treacle,' said the Dormouse, without considering at all this time.* (fq. 34)	"...këto tri motra vogëlushe... kishin filluar ***të nxjerrin, (të vizatojnë, e di?)".*** "Çfarë ***nxirrnin***?" pyeti Liza duke e harruar premtimin. "Pekmez!" – tha Miu gjumash, pa vënë re ndërhyrjen kësj radhe. (v. II, fq. 89)

Përkthyesi është përpjekur që nëpërmjet shpjegimit në kllapa të transferojë dykuptimësinë e ***draw*** (nxjerr, tërheq dhe vizatoj) edhe për lexuesit në gjuhën shqipe, por,

megjithatë, mbetet e paqartë për ta se pse jepet fillimisht folja *nxjerr*, pastaj në kllapa jepet një folje tjetër *vizatoj*, dhe në pyetjen e Lizës përdoret sërish *nxjerr*.

Shembulli 3

*'Did you say **pig**, or **fig**?' said the Cat.* (fq. 32)	- A the ***derr***, apo ***fik***-*? – e pyeti ajo vajzën. (*shën. përkth. Anglisht pig (derr) dhe fig (fik) janë fjalë që ngatërrohen lehtë me njëra-tjetrën) (v. III, fq. 75)

Shënimet, shprehet profesor Edmond Tupja, janë të pashmangshme, sidomos kur ka lojëra fjalësh apo aludime historike të cilat duhen sqaruar në mënyrë që lexuesi i veprës së përkthyer t'i kuptojë e t'i shijojë tërësisht ato.[281] Nëpërmjet shënimit në fund të faqes, përkthyesi u vë në dukje lexuesve të përkthimit se këtu ka patur një lojë fjalësh në origjinal, të cilën ai nuk e ka rikrijuar, por e ka transferuar në shqip dhe lexuesit do të kenë dijeni rreth ekzistencës së saj vetëm nëse do të lexojnë shënimin në fund të faqes.

Shembulli 4

*I had **NOT**!' cried the Mouse, sharply and very angrily.*	["Ç'lidhje, moj?', pyeti Miu, shumë i zemëruem.]
*'A **knot**!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!'*	"Oh, po ***ny***!...'vijoi Liza, përherë gati me qenë e vjefshme; dhe, tue vështrue për-qark si e hutueme: "Oh më lejoni të ju ndihmoj për me e zgjidhë!"
"I shall do nothing of the sort," said the Mouse. (fq. 19)	"***Ç'po merremi vesht se!...***" tha Miu. (v. I, fq. 34-35)

Pavarësisht se për lexuesit e variantit të përkthyer nuk është shumë e qartë se përse Liza fillon të flasë për *lidhje* e *nyje*, përkthyesi, nëpërmjet shprehjes *Ç'po merremi vesht se!...*" (që nuk i korrespondon ndonjë pjese të origjinalit) përcjell atë çka është më e rëndësishme në këtë shkëmbim mes personazheve: vështirësia për të komunikuar e për *t'u marrë vesh.*

5. Nuk ka lojë fjalësh në tekstin origjinal – ka lojë fjalësh në tekstin e përkthyer

Gjatë vrojtimit të hollësishëm të teksteve kemi vënë re se shfaqen edhe raste kur kemi një lojë fjalësh në tekstin e përkthyer për të cilën nuk ka një lojë fjalësh në tekstin origjinal. Kjo mund të ndodhë krejt rastësisht, ose mund të jetë një zgjedhje e mprehtë nga ana e përkthyesit (folëm pak më lart për procesin e të përkthyerit si një proces vendimmarrje që kërkon që vazhdimisht të merren vendime e të bëhen zgjedhjet e duhura mes shumë mundësive të ofruara), që, pasi ka arritur të kuptojë mënyrën e të shkruarit të Kerrëlit dhe mënyrën e përzgjedhjes së fjalëve, përpiqet të kompensojë për humbjet e mundshme në pjesë të tjera të tekstit. Le të lexojmë shembujt më poshtë:

Shembulli 1

*Maybe it's always pepper that makes people hot-tempered,… and vinegar that makes them sour--and **chamomile that makes them bitter**--and--and barley-sugar and such things that make children sweet-tempered.* (fq. 39)	Ndoshta është piperi që i bën njerëzit zemërakë e gjaknxehtë! ... dhe uthulla që i bën të thartë ... **hithra të hidhur** ... çokollatat që i bëjnë fëmijët të ëmbël... " (V. II, fq. 39)

[281] E. Tupja (2003) *Pro Translatore – Shënime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin.* Shtëpia e Librit OMBRA GVG: Tiranë, fq. 81.

Duket qartë se në origjinal nuk kemi lojë fjalësh, ndërsa në variantin e dytë përkthyesi ndryshon bimën (komomilin me hithrën) duke krijuar një lojë fjalësh bazuar në paronimia.

Shembulli 2

'Please would you tell me,' said Alice, a little timidly, for she was not quite sure whether it was good manners for her to speak first, 'why your cat grins like that?'	"Ju lutem, a mund të më kallxoni", pyeti Liza, pak e frigsueme (pse nuk qe e sigurtë në ishte sjellje e mirë me u folë ajo e para), "përse po I zgërdhînë dhambët ashtu Macja e Juej?"
*'It's a **Cheshire** cat,' said the Duchess, 'and that's why. Pig!'* (fq. 29)	"Pse âsht e racës ***Qeshire***", tha Dukesha. Pastaj vazhdoi: "Prâjë he derr!" (V. I, fq. 64)

Për domethënien e emërtimit të personazheve do të diskutojmë në çështjen tjetër, megjithatë, brenda diskutimit mbi lojën e fjalëve, po përmendim se macja është nga i njëjti vend ku ka lindur edhe Kerrëli. Përkthyesi shfrytëzon kalimin nga njëra gjuhë në tjetrën jo vetëm për të treguar prejardhjen e maces, por për të vendosur lidhje mes emrit të saj dhe faktit që ajo është gjithmonë duke qeshur (edhe kur nuk është macja e pranishme, e qeshura e saj është gjithmonë e dukshme). Edhe vetë Kerrël do të kishte qënë dakort me këtë mënyrë emërtimi! Krijohet kështu një lojë fjalësh në përkthim, që nuk ekzistonte në origjinal.

Shembulli 3

'Now I growl when I'm pleased, and wag my tail when I'm angry. Therefore I'm mad.'	"Unë ... gërindem kur jam e kënaqun e luej bishtin kur zemrohem. Prandej unë jam e marrë!"
*'I call it **purring**, not **growling**,' said Alice.*	"Unë e quej ***gërhatje*** atê t'anden e jo ***gërindje***", tha Liza.
'Call it what you like,' said the Cat. (fq.31)	"Queje si të duesh!" ia priti Macja, dhe u-zhduk. (V.I, fq. 70)

Në origjinal nuk kemi lojë fjalësh, ndërsa në përkthim shfrytëzohet shqiptimi i ngjashëm i fjalëve *gërhatje* dhe *gërindje*, duke krijuar kështu një paronimi.

Shembulli 4

*'Thank you,' said Alice, 'it's very interesting. I never knew so much about a **whiting** before.'*	- Faleminderit, - tha Liza, - kjo është interesante. – Unë më parë nuk dija kaq shumë për **merlucin**.
'I can tell you more than that, if you like,' said the Gryphon. 'Do you know why it's called a whiting?'	- Unë mund të të tregoj edhe më shumë, nëse dëshiron, - tha Grifoni. – E di pse e quajnë merluc?
'I never thought about it,' said Alice. 'Why?'	- Nuk e kam vrarë mendjen asnjëherë për këtë, - pranoi Liza. – Pse?
*'**It does the boots and shoes**.' The Gryphon replied very solemnly.*	**- Merr llucë me vete kur noton**, - u përgjig serioz Grifoni.
Alice was thoroughly puzzled. 'Does the boots and shoes!' she repeated in a wondering tone.	Kjo gjë e hutoi fare Lizën. - Shumë llucë? Përsëriti ajo e çuditur.
*'Why, **what are your shoes done with**?' said the Gryphon. 'I mean what makes them so shiny?'*	- **Pse ti asnjëherë nuk ke parë këmbë kur merr llucë**? - Po, kam parë, - u përgjigj Liza, që për çdo rast mendohej pak para se të bënte pyetjen tjetër. – **Pse vallë edhe në det ka**
Alice looked down at them, and	

considered a little before she gave her answer. 'They're done with ***blacking****, I believe.'* *'Boots and shoes under the sea,' the Gryphon went on in a deep voice, 'are done with whiting. Now you know.'* *'****And what are they made of****?' Alice asked in a tone of great curiosity.* *'****Soles and eels, of course****,' the Gryphon replied rather impatiently: 'any shrimp could have told you that.'* (fq. 43)	**llucë**? - Kuptohet që ka. Jo më kot thonë "**u bë deti llucë**" – sqaroi me zë të ulët Grifoni tashmë me një farë nervozizmi. – Këtë ty mund të ta thotë çdo kërmill. (V. V, fq. 122-3).

Në këtë rast kemi një varg lojërash fjalësh në origjinal, të cilat nuk korrespondojnë tërësisht në natyrën e tyre dhe mënyrën e shfaqjes në variantin në gjuhën shqipe. Mund të shohim se si në gjuhën shqipe kompesohen lojërat e fjalëve të origjinalit duke rindërtuar bukur një sërë kuptimesh e nënkuptimesh nga emri "merluc", duke krijuar paronimi me "merr llucë" dhe duke e zhvilluar më thellë vetë paroniminë nëpërmjet shprehjes frazeologjike "u bë deti llucë". Efekti komik i origjinalit është rikrijuar në gjuhën shqipe, pavarësisht faktit se kemi një lojë fjalë në gjuhën shqipe e cila nuk i korrespondon tërësisht vendit dhe mënyrës së shfaqjes së saj në origjinal. E rëndëishme është që përkthyesi ka arritur të kuptojë *skoposin* e origjinalit dhe ka transmetuar pikërisht atë në gjuhën shqipe, duke qenë besnik ndaj tij dhe jo ndaj mënyrës së shprehjes së jashtme në origjinal.

IV.3.1.1.5 Analizë sasiore dhe interpretime cilësore

Përpara se të fillojmë të japim shifra dhe t'i analizojmë ato, rimpërmendim faktin se zbulimi i të gjitha lojërave të fjalëve në tekstin origjinal nuk është i mundur për shkak të imagjinatës dhe krijimtarisë shumë të zhvilluar të autorit si dhe të kompleksitetit të gjuhës dhe veçanërisht humorit anglez. Për shembull, edhe vetë emri *Alice* është një lojë me fjalën *Alysum* – lule, dhe emri i kësaj luleje në greqisht do të thotë "pa çmenduri", duke na lënë të kuptojmë se pse Liza nuk mund të jetë e çmendur siç thotë Macja Qeshire, vetë emri i saj e përjashton këtë gjë.[282] Ka një pafundësi lojërash brenda fjalëve e një pafundësi fjalësh brenda lojërave, shumica e të cilave lidhen në mënyrë të fshehtë (dhe jo lehtësisht të zbulueshme) me gjuhë të tjera si dhe me folklorin dhe traditën angleze. Mbi të gjitha, identifikimi dhe vlerësimi i një loje fjalësh varet edhe nga zakonet e të lexuarit të përdoruesit të tekstit, që në vetvete janë të lidhura ngushtë me normat e gjinive dhe konceptimeve mbi gjuhën.[283] Në këtë nënçështje ne do të analizojmë statistikisht të dhënat e tabelës nr. 13, bazuar në lojërat e fjalëve të identifikuara në tabelën nr. 12. Rikujtojmë se një analizë tjetër do të bëhet në lidhje me strategjitë e përdorura në përkthimin e emrave të përveçëm (meqenëse, siç do ta argumentojmë më poshtë, edhe në raste të tilla shfaqet një mënyrë e manipulimit të gjuhës) në nënçështjen *Përkthimi i emrave të përveçëm.*

Bazuar në tabelën nr. 12, në tekstin origjinal kemi identifikuar 29 lojëra fjalësh, nga të cilat: 2 malapropizma, 6 paronimi, 5 homonimi, 5 polisemi, 2 homofoni, 6 idioma,

[282] A. Balci (2005) *A Comparative Analysis on Pun Translation in Alice in Wonderland by Lewis Carroll*. Tezë e pabotuar masteri, Dokuz Eylül Üniversitesi, fq. 43.

[283] D. Delabastita (1996) *Wordplay and Translation.* Special Issue of *The Translator: Studies in Intercultural Communication*, 2(2). Manchester: St. Jerome, fq. 132.

2 rendi i fjalëve dhe 1 homografi. Le të shohim si janë përdorur strategjitë e përshkruara më lart në pesë variantet nën shqyrtim nëpërmjet tabelës së mëposhtme.

Tabela nr.14

Shpërndarja e strategjive të përdorura në përkthimin e lojërave të fjalëve

Strategjia / Varianti	Rikrijimi i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer		Përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer		Mospërfshirje e lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer		Transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer	
	nr.	%	nr.	%	nr.	%	nr.	%
Hysejn Çela Beqir Çela (1944)	14	**48%**	12	**42%**	1	**3%**	2	**7%**
Maqo Afezolli (1961)	10	**35%**	14	**48%**	0	**0%**	5	**17%**
Maqo Afezolli (1998)	9	**31%**	15	**52%**	1	**3%**	4	**14%**
Taulant dhe Eri Tafa (2008)	7	**24%**	16	**55%**	0	**0%**	6	**21%**
Frederik Shuraja (2008)	14	**48%**	10	**35%**	1	**3%**	4	**14%**
Gjithsej	54	**37%**	67	**46%**	3	**2%**	21	**15%**

Nga të dhënat e tabelës nr. 14 vërejmë se varianti i parë dhe i pestë të përkthyer në gjuhën shqipe kanë rikrijuar më shumë lojërat e fjalëve (48% për secilin variant), dhe shumë pak prej tyre janë transferuar apo nuk janë përkthyer, përkatësisht 7% dhe 1% në variantin e parë dhe 14% dhe 1 % në variantin e pestë. Parë nga afër, mund të themi se rendi kronologjik i përkthimeve dëshmon një *rënie në numrin e rasteve ku loja e fjalëve është ruajtur*. Varianti i dytë dhe i tretë janë përkthyer nga i njëjti përkthyes, megjithatë, edhe në këtë rast, në përkthimin e dytë (pas 37 vjetësh që nga përkthimi i parë) shikojmë se një pjesë e konsiderueshme e lojërave nuk janë riprodhuar (52%), dhe disa janë transferuar (14%), ndërsa ka pësuar një rënie strategjia e përkthimit të lojës së fjalës me një lojë fjalësh tjetër, pra, është shtuar numri i rasteve ku *nuk ekzistojnë lojëra fjalësh kundrejt origjinalit*. Në variantin e katërt shohim se lojërat e fjalëve nuk janë riprodhuar në më shumë se gjysmën e rasteve (55%) dhe një pjesë e mirë e tyre thjesht janë transferuar (21%). Në variantin e pëstë është bërë një punë e konsiderueshme nga ana e përkthyesit për të sjellë në gjuhën shqipe lojërat e fjalëve të origjinalit, ndoshta këtë element ka patur edhe vetë përkthyesi parasysh kur është shprehur në hyrje se "ka bërë një përkthim *sa më të saktë*, aq sa e lejojnë ndryshimet e gjuhës angleze me atë shqipe".[284] Duke krahasuar shifrat në përgjithësi, mund të themi se strategjia kryesore që mbizotëron është përkthimi i lojës së fjalës, por pa riprodhuar dykuptimësinë, homoniminë,etj. (strategjia e dytë e përmendur – ngjyra blu). Shumë rrallë ndodh që pjesa që përmban një lojë fjalësh të mos

[284] L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave.* (përkth.) F. Shuraja. Redona, Tiranë, fq. 3.

përkthehet fare (2% të rasteve në gjithë korpusin në studim). Duhet përmendur, megjithatë, se në më shumë se një të tretën e rasteve nën studim, janë rikrijuar lojërat e fjalëve në përkthim, dhe në 15% të rasteve lojërat e fjalëve thjesht transferohen nëpërmjet teknikave të ndryshme.

Këto të dhëna mund t'i paraqesim edhe nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm:

Grafiku nr. 4 ***Strategjitë e përdorura në V.I për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Grafiku nr. 5 ***Strategjitë e përdorura në V.II për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Grafiku nr. 6 ***Strategjitë e përdorura në V. III për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Grafiku nr. 7 ***Strategjitë e përdorura në V. IV për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Grafiku nr. 8 ***Strategjitë e përdorura në V.V për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Grafiku nr. 9 ***Strategjitë e përdorura në gjithë korpusin për përkthimin e lojërave të fjalëve***



Vetë fakti që lojërat përkthehen e zhvlerëson konceptin e papërkthyeshmërisë së tyre, meqenëse tekstet e përkthyera janë fakti më i vrojtueshëm dhe më i rëndësishëm. Duke u bazuar në këndvështrimin e Gideon Tourit (Gideon Toury) në studimet përkthimore përshkruese duhet të nxjerrim në pah se nga se përbëhet sjellja përkthimore, dhe jo se nga se duhet të përbëhet nëpërmjet shqyrtimeve dhe vlerësimeve.[285] Sipas konceptit të normave prezantuar prej tij, përkthyesi përfshihet në një proces vendimmarrjeje: veprimet përkthimore duhet të kosiderohen si vendime që kanë edhe domethënie kulturore. Gjithashtu, fakti që në një pjesë të konsiderueshme të varianteve të përkthyera kemi sërish lojëra fjalësh mund të shërbejë si një tregues i karakterit "*të përshtatshëm*" të përkthimeve në përputhje me përdorimin e këtij termi nga Touri.[286] Njëkohësisht nuk mund të mos përmendim se, mbi të gjitha, statusi i veprës është një nga faktorët më të rëndësishëm të vendimmarrjes. A do t'i drejtohet përkthimi një publiku në moshë të

[285] G. Toury (1995) *Descriptive Translation Studies and Beyond*. Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.

[286] Termi "i përshtatshëm" tregon se "përkthimi është i prirur të përshtatet me normat e veprës origjinale, dhe nëpërmjet tyre – gjithashtu – me normat e gjuhës origjinale dhe / ose polisistemin letrar origjinal në përgjithësi" [G. Toury (1980) *In Search of a Theory of Translation*. Tel Aviv: The Porter Institute for Poetics and Semiotics, Tel Aviv University, fq. 55].

vogël apo të rritur? Përgjigjja e kësaj pyetjeje ndikon shumë në strategjitë e zgjedhura nga përkthyesit dhe në analizën që parashtrojmë në këtë studim. Në çështjen mbi përzgjedhjen e materialit, nisur nga të dhëna të tilla si kopertina, parathënia etj. kemi hamendësuar se përkthimet u drejtohen fëmijëve, dhe kjo ndikon në strategjitë që kanë përdorur përkthyesit (gjë që pasqyrohet edhe në numrin e ulët të shënimeve apo komenteve nga ana e përkthyesve). Tashmë e kemi theksuar faktin se kemi të bëjmë me një vepër të veçantë nisur nga prania e lojërave të fjalëve në origjinal, dhe, meqenëse prania e tyre është mjaft domethënëse dhe e qëllimshme nga ana e autorit, mund të shprehemi se rikrijimi dhe shkalla e pranisë së tyre në tekstin e përkthyer (pavarësisht strategjisë së përdorur) do të shërbejnë edhe si një kriter për të përcaktuar cilësinë e secilit prej varianteve të përkthyera në raport me origjinalin dhe me njëri-tjetrin. Nisur nga një kriter i tillë do të shpreheshim se cilësia është më e lartë në variantin e parë dhe të pestë dhe vjen duke u ulur në variantet e tjera. Megjithatë, ky është vetëm një nga kriteret e mundshme për të vlerësuar një përkthim dhe nuk është qëllimi i këtij punimi dhënia e kritereve për vlerësim, thjesht duam të theksojmë se, për një vepër që karakterizohet në mënyrë të qëllimshme nga lojërat e fjalëve, një nga kriteret që mund të shërbejë për të bërë vlerësimin e përkthimit do të ishte shkalla e ruajtjes apo rikrijimit të lojërave të fjalëve. Duke ecur sipas parimeve të Delabastitas duhet të kemi parasysh se "*ajo që duhet të kërkohet është një përkthim i lojërave të fjalëve që nuk favorizon nocionet ideale të përkthimit dhe përkthyeshmërisë, dhe që iu drejtohet në fakt rregullave dhe normave të cilave iu përmbahet përkthimi i lojërave në realitetin aktual.*"[287] dhe se vështirësitë teknike janë të ndryshme dhe përkthyesve iu duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që të marrin parasysh përparësitë dhe mangësitë e një lloj "sakrifice" apo të një lloji tjetër.[288] Gjithashtu, siç shprehet edhe Viktor Ristani, barasvlershmëria në përkthim kurrë nuk duhet të barazohet me përpjekjet për të realizuar riprodhimin dhe rikrijimin e tekstit të njëjtë, gjë që është e pamundur, madje edhe brenda së njëjtës gjuhë.[289]

Në përfundim të kësaj çështjeje, theksojmë se kemi vërejtur katër strategji të ndryshme për përkthimin e lojërave të fjalëve: rikrijim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer, përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer, mospërfshirje e lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer dhe transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer. Strategjia mbizotëruese e përdorur është përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer (46%), ndjekur nga strategjia e rikrijimit të lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer (37%). Është shumë e rëndësishme të vërejmë se në më shumë se një të tretën e gjithë korpusit nën studim lojërat e fjalëve janë rikrijuar, gjë që tregon se shkrimtarët i kanë kushtuar vëmendje tekstit origjinal dhe veçanësisë së tij – gjuhë e përdorur në mënyrë të qëllimshme për të transmetuar efekte humoristike. Pikërisht, në ndjekje të një logjike të tillë, vetëm një numër shumë i ulët i lojërave të fjalëve (2%) nuk janë përfshirë fare në tekstin e përkthyer, pra, janë lënë pa përkthyer, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë transferuar në tekstin e përkthyer (15%), duke iu transmetuar efektin e origjinalit lexuesve në gjuhën shqipe. Fakti që në një pjesë të konsiderueshme lojërat e fjalëve janë përkthyer bën që ne të pohojmë me plot gojë se lojërat e fjalëve *mund* të përkthehen, dhe prova më e mirë për këtë është pikërisht korpusi nën shqyrtim. Megjithatë, vështirësitë me të cilat përballet përkthyesi janë të natyrave të ndryshme, si, për shembull, njohuritë e tij në lidhje me

[287] D. Delabastita (1993) *There's a Double Tongue. There's a Double Tongue. An Investigation into the Translation of Shakespeare's Wordplay* Amsterdam and Atlanta: Rodopi, fq. 190.
[288] D. Delabastita (1997) *Traductio, Essays on punning and Translation*. St. Jerome Publishing: Manchester, fq. 11.
[289] V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90*. fq. 106.

kulturën e origjinalit, gatishmëria për të qenë gjithmonë në kërkim të vazhdueshëm për fjalën ose fjalët e duhura. Ai duhet të përfshihet gjithmonë në një proces të kujdesshëm leximi dhe kuptimi të tekstit origjinal, si dhe të konsultohet vazhdimisht me fjalorë një dhe dygjuhësh, fjalorë frazeologjikë, enciklopedikë, etj. me qëllim që të gjejë kuptimin e shprehur në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar në origjinal dhe t'ua transmetojë këtë lexuesve në gjuhën shqipe. Ky është, në fund të fundit, edhe misioni i përkthyesit. Gjëja më e mirë që përkthyesi mund të bëjë sa herë që përballet me një lojë fjalësh do të ishte identifikimi dhe transmetimi i synimit të shkrimtarit origjinal, duke u përpjekur të prodhojë afërsisht të njëjtin efekt ashtu si e kanë përjetuar edhe lexuesit e veprës origjinale.

IV.3.2 *Loja e fjalëve "tale-tail" – Marrëdhënia formë-përmbajtje*

Rast Studimor: Alice's Adventures in Wonderland

Në këtë çështje do të shqyrtojmë marrëdhënien mes formës dhe përmbajtjes dhe mënyrën e rikrijimit të kësaj marrëdhënieje në gjuhën e përkthimit. Pikpamja mbizotëruese në fushën e përkthimit letrar është se përmbajtja mund të përkthehet, ndërsa forma, në të shumtën e rasteve, nuk mund të përkthehet. Dhe atëherë kur forma bëhet pjesë e kuptimit fillojmë t'i afrohemi papërkthyeshmërisë.[290] Me fjalë të tjera, ato tekste që e përfaqësojnë formalisht kuptimin konsiderohen si të papërkthyeshme, edhe pse shkalla e papërkthyeshmërisë mund të ndryshojë. Për të shprehur qëndrimin tonë në lidhje me këtë çështje, do të përqëndrohemi në një nga lojërat e fjalëve më të diskutuara në studimet mbi përkthimin e *Alice's Adventures in Wonderland* në gjuhë të tjera. Tregimi i miut është ndoshta shembulli më i njohur në anglisht për vargjet emblematike të përfaqësuara figurativisht: vjersha të shkruara në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë diçka që ka të bëjë me temën që trajtohet.[291] Keqkuptimi mes dy personazheve fillon që kur Miu shprehet "*Mine is a lond and sad **tale"*** dhe Liza, duke parë bishtin e Miut ia kthen "*It IS a long **tail**, certainly, but why do you call it sad?*". Në këtë rast me shumë mprehtësi shfrytëzohet nga shkrimtari një çift homofonësh të gjuhës angleze *tale-tail.*[292] Le të shohim se si përkthehen këto fjalë në secilin prej varianteve në shqyrtim, duke shpresuar që shembujt e nxjerrë do të na ndihmojnë për të përcaktuar përparësitë e përkthyesit gjatë procesit të rëndësishëm të vendimmarrjes.

IV.3.2.1 Pikpamje të ndryshme rreth diskutimit *formë-përmbajtje* në përkthim

Jiri Levi, përfaqësues i shkollës së Pragës, shprehet: "*Një përkthim nuk është një përbërje e njënjëshme, por një ndërfutje dhe një përzierje e dy strukturave. Nga njëra anë janë përbërja semantike dhe ndërtimi formal i origjinalit, nga ana tjetër, është gjithë sistemi i karakteristikave estetike që kanë të bëjnë me gjuhën e përkthimit*".[293] Siç shprehet me të drejtë Levi, përkthyesit duhet t'i kushtojnë vëmendje njëkohësisht jo vetëm përmbajtjes, por edhe formës dhe cilësive estetike. Nuk është e lehtë që të ekuilibrohen vazhdimisht

---

[290] B. Hatim, J. Munday (2004) *Translation: An Advanced Resource Book*. Routledge, London and New York, fq. 10.

[291] Këto vjersha e kanë origjinën në Greqi, ndër praktikuesit e tyre përmendim *Robert Herrick, George Herbert, Stéphane Mallarmé, Dylan Thomas, E. E. Cummings,* dhe *Guilluame Apollinaire.* Sot këtë teknikë e shohim të përdorur në mënyrën e të shkruarit të reklamave, titujve të revistave dhe artikujve, etj.

[292] ***tale****-a story about exciting imaginary events;* ***tail****-the part that sticks out at the back of an animal's body, and that it can move; tale*-tregim, përrallë, rrëfenjë; ***tail***-bisht, fund, shtojcë, zgjatim.

[293] J. Levý (1963), cituar në S. Bassnett-McGuire (1980) *Translation Studies.* London: Methuen, fq. 5-6).

këto cilësi të ndryshme në pothuajse të njëjtën mënyrë siç shfaqen ato në origjinal, madje një punë e tillë jo gjithmonë ndiqet nga rezultate të kënaqshme nga marrësit e tekstit të përkthyer (kryesisht, por jo domosdoshmërisht fëmijë). Edhe Juxhin Naida i bashkohet këtij diskutimi mbi formën dhe përmbajtjen, duke u shprehur: "*Çdo gjë që mund të thuhet në një gjuhë mund të thuhet në një gjuhë tjetër, përveç rastit kur forma është një element thelbësor i mesazhit.*",[294] një pikpamje që thekson shumë hërë më tepër formën si një përbërës që mund të kontribuojë në nivelin e vështirësisë së përkthimit. Megjithatë, besnikëria ndaj formës nuk duhet të na çojë drejt një përkthimi të çuditshëm dhe të paqartë. Juxhin Najda dhe Çarls Teibër (Charles Taber) na paralajmërojnë rreth mungesës së besnikërisë ndaj përmbajtjes dhe ndikimit që një gjë e tillë ka në mesazhin që do të përcillet.[295] Në mënyrë të ngjashme, sipas Uolter Benxhaminit (Walter Benjamin) një besnikëri e lartë në përpjekje për të riprodhuar formën bëhet pengesë për përcjelljen e kuptimit dhe në asnjë rast përkthimi fjalë për fjalë nuk mund të realizohet thjesht bazuar në dëshira për të ruajtur kuptimin.[296] Duke qenë edhe ne të të njëjtit mendim ashtu si edhe Benxhamini shprehemi se marrëdhënia mes përmbajtjes dhe gjuhës është e ndryshme në origjinal dhe në përkthim,[297] dhe mendojmë se është pikërisht ky fakt që duhet të kuptohet nga përkthyesit që në fillim, edhe pse kjo nuk do të thotë që ata duhet të kryejnë një përkthim nisur nga mendimi i përgjithshëm se disa lloj tekstesh janë të papërkthyeshme, dhe, rrjedhimisht, ta shmangin krejtësisht përkthimin dhe misionin e tyre si ndërtues të urave të komunikimit. Ka tekste të lehtë për të përkthyer ashtu siç ka edhe tekste të vështirë për t'u përkthyer. Shkalla e vështirësisë së përkthimit nuk duhet të shërbejë si një pengesë apo një stepje për përkthyesit, por, në të kundërt, si një ftesë e hapur për t'u përfshirë në detyra edhe më sfiduese.

E mbyllim këtë diskutim duke sjellë sërish një citim nga këshillat që na jep Najda *"…gjithmonë përballemi me një sërë dallimesh në kundërvënie mes atyre që na detyrojnë të zgjedhim përmbajtjen në kundërvënie me formën, kuptimin ndaj stilit … dhe natyrshmërinë ndaj përkatësisë formale. Me qëllim që të zgjedhim në mënyrë të kuptimshme mes këtyre grupeve që kanë cilësi përkufizuese në kundërvënie, është e nevojshme që të themelojmë disa kritere thelbësore që të na udhëzojnë gjatë procesit. Pra, duhet të themelojmë një grup prioritetesh, të cilat mund ta përkufizojnë të përkthyerit nga perspektiva të ndryshme: perspektivat e formës dhe të kuptueshmërisë*".[298] Kështu, është me rëndësi të madhe që të identifikohet jo vetëm kuptimi i origjinalit dhe forma e shprehjes së tij, por, njëkohësisht, edhe synimi (i nënkuptuar), qëllimi i përgjithshëm si dhe ndikimi fillestar që teksti origjinal ka patur, duke u përpjekur më tej që të gjithë këta element të sillen me sukses në gjuhën e përkthimit.

IV.3.2.2 Loja e fjalëve *tale-tail* dhe variantet e saj në gjuhën shqipe

Sa më e madhe të jetë shkalla e rëndësisë së formës,
aq më e madhe është mundësia e humbjeve kuptimore. [299]

---

[294] E. Nida, C. R. Taber (1982) *The Theory and Practice of Translation*. Leiden. E. J. Brill, fq. 4.
[295] Po aty, fq. 13.
[296] W. Benjamin, cituar në L. Venuti (ed.) (2000) *The Translation Studies Reader*. London and New York: Routledge, fq. 21.
[297] W. Benjamin (1992) *Illuminations.* (tr. Harry Zohn) London, Fontana Press, fq. 76.
[298] E. Nida, C. Taber (1982) *The Theory and Practice of Translation*. Leiden. E. J. Brill, fq.15.
[299] V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 221.

Në këtë nënçështje do të prezantojmë më konkretisht pikpamjet e parashtruara më lart. Do të flasim rreth një loje fjalësh nga më interesantet që gjejmë në AAiW, njëkohësisht një nga lojërat e fjalëve më të diskutuara në studimet krahasimore përkthimore. Në kapitullin e tretë, Miu, një nga personazhet, rrëfen një tregim të gjatë, të shkruar në formë të tillë që ngjason vërtet me bishtin e një miu – i gjatë dhe i përdredhur. Pikërisht këtu nis edhe keqkuptimi mes personazheve: Miu thotë se tregimi i tij është i gjatë por i trishtuar, ndërsa, Liza, e hutuar, vështron bishtin e tij, vërtet të gjatë, por…ç'ka tek ai të trishtuar? Ky keqkuptim është i qëllimshëm në origjinal, pasi shkrimtari ka përdorur një çift homofonësh: *tale-tail.* Në anglisht mund të shohim se si autori kalon nga përdorimi i *history* në *tale* që kanë pak a shumë të njëjtin kuptim,[300] për të realizuar lojën e dykuptimësisë nëpërmjet përdorimit të këtij çifti homofonik. Miu përdor *tale* duke iu referuar tregimit që ai do të rrëfejë, ndërsa Liza, e habitur, vështron bishtin e miut duke menduar se ai që në fillim i referohet *tail.* Për njohësit e gjuhës angleze dykuptimësia është më se e qartë dhe përcillet lehtësisht. Për lexuesit e varianteve në shqip, nga ana tjetër, në mungesë të mundësisë për të lexuar dhe kuptuar origjinalin, loja e fjalëve e realizuar nëpërmjet këtyre homofoneve, së pari nuk arrin të përcillet si e tillë, dhe së dyti nuk arrihet (të paktën për dy variantet e para) të kuptohet se përse Liza shikon bishtin e Miut ndërkohë që ai bëhet gati t'i rrëfejë tregimin e tij.

Në *Pro Translatore* lexojmë "*Loja e fjalëve, sidomos kur ka karakter fonetikor, përbën një problem që, siç e dini, nxjerr shumë pengesa dhe vështirësi*".[301] Në këtë këndvështrim, është shumë me interes t'i vërejmë më nga afër mënyrat se si janë sjellë në gjuhën shqipe homofonët e lartpërshkruar.

Tabela 15:

Përkthimi i lojës së fjalëve "tale-tail" në pesë variantet në gjuhën shqipe

AAiW	**V. I**	**V. II**	**V. III**	**V. IV**	**V. V**
'You promised to tell me your ***history***, you know,' said Alice, 'and why it is you hate--C and D,' she added in a whisper, half afraid that it would be offended again. '***Mine is a long and a sad tale***!' said the Mouse, turning to Alice, and sighing.	**"**Ti më premtove me më kallxue ***historín*** t'ande", i tha Liza, "dhe shkakun pse i urren m... e q…" shtoi me zâ shumë t'ulët, nga friga se mos e fyente prap. ***"Historija e ime âsht e idhët dhe e gjatë"*** tha Miu, tue fshâ. "***Vërtetë do të jetë e gjatë"*** tha Liza, tue i hudh nji sy	"Ti më premtove të më tregoje ***historinë*** tënde' – tha Liza dhe shkakun pse i urren M... dhe Q..." – shtoi ajo me një zë shumë të ulët nga frika se mos e fyente prap. *"**Historia ime është e gjatë dhe e hidhur***" – u përgjegj Miu me një zë si për të ardhur keq.	"Ti më premtove të më tregosh ***historinë*** tënde, – tha Liza, - dhe shkakun pse i urren M... dhe Q... – shtoi ajo me zë shumë të ulët, nga frika se mos e fyente prapë. "***Sigurisht është i gjatë,*** – tha Liza me vete duke shikuar me habi ***bishtin*** e tij - * por	"Më premtove se do të më tregoje ***historinë*** tënde, të kujtohet? Tha Liza. "Duhet të më shpjegosh pse i urren Q... dhe M..." shtoi gati me pëshpërimë, nga frika se mos e lëndonte sërish. "***Historia ime nuk është nga ato pa fillim dhe pa mbarim; ajo është edhe e gjatë edhe e trishtueshme"*** u drejtua Miu nga	"E mbani mend, ju na premtuat të na tregoni ***historinë*** tuaj, - tha Liza, - dhe pse ju i urreni... M dhe Q, - shtoi ajo me zë të ulët nga frika se mos Miu fyhej përsëri. - ***Tregimi*** im titullohet "***Për bishtin". Ai është i gjatë dhe i trishtuar***.

[300] *history-all the things that happened in the past, especially the political, social, or economic development of a nation;a record of something that has affected someone or been done by them in the past* (gjithë gjërat që kanë ndodhur në të shkuarën, veçanërisht zhvillimi politik, shoqëror ose ekonomik i një kombi; një rregjistrim i diçkaje që ka ndikuar dikë ose që ka ndodhur në kohën e shkuar); *history* – histori; e kaluar; mësim i historisë [P. Qesku (2000) *Fjalori anglisht-shqip*. Botimet EDFA, Tiranë, fq. 479.]

[301] E. Tupja (2003) *Pro Translatore.* Shtëpia e Librit OMBRA GVG: Tiranë, fq. 84, citimi shkëputur nga *Jacques de Decker.*

'***It IS a long tail,*** certainly,' said Alice, looking down with wonder at ***the Mouse's tail;*** **'but why do you call it sad?**' And she kept on puzzling about it while the Mouse was speaking, so that her idea of ***the tale*** was something like this: --- (fq. 18)	***bishtit të tij***, "***por pse e quen t'idhët?***". Dhe gjithnji vriste mendjen për me gjetë arsyen...ndë rsa Miu vazhdonte kallximin, kështu që, në fund, ajo e përmblodhi vetë ***historín e tij*** në këtê mënyrë: (fq. 33)	"***Sigurisht është e gjatë"–*** tha Liza duke shikuar me habi ***bishtin*** e tij, - por pse e quan ***të hidhur***?" Dhe gjithënjë vriste më ndjen për të gjetur arësyen..., ndërsa Miu vazhdonte ***tregimin***, kështuqë në fund ajo e përmblodhi vetë ***historinë e tij*** në këtë mënyrë: (fq. 22)	pse e quan ***të hidhur?" (* shën. përkth. Tale (histori) dhe tail (bisht), të dyja anglisht shqiptohen teil. Liza e ngatërron të parën me të dytën***.) – Dhe zuri të vriste mendjen për të gjetur arsyen... ndërsa Miu ***vazhdonte të tregonte***, kështu që në fund ajo e përmblodhi vetë ***historinë e tij*** në këtë mënyrë: (fq. 34-35)	me një frymëmarrje të rëndë. - "***E di që trimëria jote është e gjatë***" tha Liza, e cila nuk e kishte dëgjuar mirë atë që kishte thënë miu. "***Po si mund të jetë edhe e trishtueshme***?" Ajo e bëri këtë pyetje, ndërsa Miu fliste. Kështuqë nuk kuptoi gati asgjë nga ***tregimi i tij,*** nga ***i cili*** mbetën të fiksuara vetëm disa fjalë të shkëputura. (fq. 35)	Miu u kthye nga Liza dhe u mbush thellë me frymë. "***Për bishtin? Ai vërtet është i gjatë, - mendoi Liza, duke vështruar me çudi bishtin e Miut. – Megjithatë, çfarë ka tek ai të trishtuar?"*** Dhe ndërsa ajo përpiqej të zgjidhte këtë enigmë, ndërkohë që Miu rrëfente ***historinë*** e vet, atëherë dhe vetë ***tregimi*** në përfytyrimin e Lizës ishte i tillë. (fq. 35-36)

Le të analizojmë secilin nga variantet me qëllim që të reflektojmë rreth përzgjedhjeve të përkthyesve dhe mënyrës se si ato ndikojnë në të kuptuarin e përgjithshëm dhe efektin që ka pasazhi që shfaqet në tekstin origjinal.

Më konkretisht, në ***variantin e parë*** edhe *history* edhe *tale* përkthehen me të njëjtën fjalë në të dyja rastet – *histori*. Për fjalën *tail* në përkthim përdoret *bisht* dhe lexuesi, pavarësisht se mund ta kalojë pa e vënë re, nuk realizon dot lidhjen mes historisë dhe bishtit të Miut, që në variantin në gjuhën angleze është e dukshme. Për më tepër, Liza duke parë bishtin e Miut, përdor gjininë femërore (duke iu referuar *historisë*, pra, ruan gjininë përkatëse femërore) dhe nuk e ndryshon atë në mashkullore. Kjo për arsye se gjinia nuk përbënte problem në origjinal (kemi parasysh se gjinia nuk është një kategori gramatikore e emrit në gjuhën angleze) por shfaqet në gjuhën shqipe dhe si e tillë kërkon përshtatje.

Në ***variantin e dytë***, përsëri *history* dhe *tale* përkthehen me të njëjtën fjalë *histori*, dhe *tail* përkthehet *bisht*. Sërish nuk është bërë përshtatja e gjinisë për *histori-**a*** (gjinia femërore) dhe *bisht-**i*** (gjinia mashkullore). Fjalët përkthehen në të njëjtën mënyrë edhe në ***variantin e tretë***, por ky variant ka diçka që mungonte në dy përkthimet e mëparshme. Së pari, është bërë përshtatja në gjini (Liza shprehet "Sigurisht që është **i gjatë"** (dhe jo "e gjatë"), kështu që arrihet të realizohet lidhja kuptimore referenciale gjatë veprimit të saj (duke shikuar me habi bishtin e tij), ndonëse nuk ka përputhje mes gjinisë femërore *histori-**a*** dhe gjinisë mashkullore *bisht-**i.*** Së dyti, në mënyrë që ta ndihmojë lexuesin të rrokë atë pjesë të lojës së fjalëve që "humbet" gjatë përkthimit (siç ka ndodhur me dy variantet e para), përkthyesi shton një shënim në fund të faqes që "kompenson" deri diku

mungesën e mundësisë së realizimit të një loje fjalësh me po të njëjtin efekt në gjuhën shqipe. Efekti ka humbur, transferohet vetëm dykuptimësia siç ishte në origjinal pa rikrijuar një lojë fjalësh.

Në ***variantin e katërt*** përkthyesi shfrytëzon dy fjalë të gjinisë femërore që rimojnë me njëra-tjetrën *historia-trimëria*, duke shmangur rikrijimin e lojës së fjalëve *tale-tail* si dhe duke mos e përmendur fare faktin që Liza po shikonte me habi *bishtin* e Miut, por duke shkruar *Ajo e bëri këtë pyetje, ndërsa Miu fliste. Kështu që nuk kuptoi gati asgjë nga tregimi i tij, nga i cili mbetën të fiksuara vetëm disa fjalë të shkëputura.* Për më tepër edhe përcaktorët e shprehur nëpërmjet mbiemrave *e gjatë, e trishtueshme* nuk janë të përshtatshëm nga ana semantike për t'u përdorur në sintagmën *trimëri e gjatë* apo *trimëri e trishtueshme.*

Në ***variantin e pestë*** përdoret fillimisht emri në gjininë femërore *histori-**a,*** ndjekur nga emri në gjininë mashkullore *tregim-**i***. Ka diçka ndryshe në këtë variant, ku është arritur të krijohet një marrëdhënie mes dy emrave në gjininë mashkullore: *tregim-**i*** dhe *bisht-**i.*** Përkthyesi arrin të kompensojë lojën e fjalëve të origjinalit duke krijuar një tjetër lojë fjalësh, jo duke u bazuar në çifti homofonik i origjinalit, por duke dashur të rikrijojë efektin humoristik të pranishëm në origjinal. Mendojmë se, për të qënë tërësisht koherent në përzgjedhjen e tij, përkthyesi duhet të kishte shmangur përdorimin e emrit të gjinisë femërore *histori-**a*** dhe të ishte kufizuar thjesht në përdorimin e emrit të gjinisë mashkullore *tregim-**i.***

Loja e fjalëve nuk mbaron këtu, në origjinal shkrimtari bashkon formën dhe përmbajtjen për të na dhënë një "bisht" të gjatë ku rrëfehet tregimi i Miut. Le të shohim si shfaqet kjo pjesë në origjinal dhe në pesë variantet nën shqyrtim:


the tale was something like this:—[4]

"Fury said to
a mouse, That
he met in the
house, 'Let
us both go
to law: *I*
will prose-
cute *you*.—
Come, I'll
take no de-
nial: We
must have
the trial;
For really
this morn-
ing I've
nothing
to do.'
Said the
mouse to
the cur,
'Such a
trial, dear
sir, With
no jury
or judge,
would
be wast-
ing our
breath.'
'I'll be
judge,
I'll be
jury,'
said
cun-
ning
old
Fury:
'I'll
try
the
whole
cause,
and
con-
demn
you to
death.' 5

Figura 1 ***Tregimi i Miut në origjinal***

Sigurisht që për të gjithë anglisht-folësit, të cilët pasi kanë interpretuar me sukses lojën e fjalëve *tale-tail,* kjo ide që krijon Liza për "historinë" dhe njëkohësisht "bishtin" e Miut, interpretohet si një gjetje më se e realizuar nga autori. Por ç'ndodh me përkthimin? A do ta ketë këtë të njëjtën kënaqësi edhe lexuesi i gjuhës shqipe (që nuk e njeh mënyrën e realizimit të lojës pasqyruar kaq bukur në origjinal)? A do t'i kushtohet më shumë rëndësi formës apo përmbajtjes? Më poshtë po sjellim të skanuara imazhet e vjershës, saktësisht ashtu si ato shfaqen në variantet në gjuhën shqipe, si dhe po komentojmë shkurtimisht rreth tyre.



4 LIZA NË BOTËN E ÇUDINAVET

Kshtu nji Mîu
i tha Daci (Që
në shpí të tij
e hasi): «Ec të
shkojm në gjyq
të dy; Me t'pa-
ditun dú un
ty!... Ec po
t'them se s'dú
bishtnim! Do
të bâhet ky
gjykim!... Pse,
a din, asndo-
nji punë Sot
mëngjes nuk
po kam unë..»
I tha Mîu:
«Mor Zotni!
Po kjo pun'
s'ka bâ vakí:
Me u-bâ gjy-
qi pa të pa-
rë: Pa gjy-
katës e an-
t a r ë !»
Ja ktheu Daci
me ç a p o j:
"Un do t'py-
es; un do t'
gjykoj; Vetë
do t'shkru-
ej, vetë do
t' këndoj
Dhe me
vdekje
do t'
dëno-
jë!"

Figura 2 ***Tregimi i Miut në V.I***



I shkon Daci në shtëpi
dhe i thot' të gjorit Mi:
«Një padi un' kam me ty:
ec të shkojm' në gjyq të dy!....
Ec. të them, kot kundërshton:
këtë gjyq gjë s'e náalon!
Jam i ngeshëm sot, s'kam punë,
porse prap nuk pres dot shumë!»
I tha Miu: «Mor zotni,
po kjo pun' s'ka bërë naki!
Gjya i till' kërkund s'është parë:
pa gjykatës. pa anëtarë!»
Ja kthen Daci me çapoj:
«Vetë pyes. vetë gjykoj!
vetë shkruaj e vet' lexoj
e me vdekje do t'dënoj!»

Figura 3 ***Tregimi i Miut në V.II***

Fjalët e një vjershe, shprehet Xhevat Lloshi në *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, përbëjnë një bashkësi të ndërlikuar, nga e cila përftohet një rrafsh i ri kuptimor.[302] Pavarësisht diskutimit nëse kemi të bëjmë në këtë rast me një poezi të mirëfilltë, bashkësia e fjalëve, përzgjedhja dhe kombinimi i veçantë i tyre na bën të ndiejmë aftësitë ritmike si dhe na sjell një rrafsh të ri kuptimi. Sa dhe si paraqitet ky 'rrafsh kuptimi' edhe në gjuhën shqipe? Mund të shohim se përkthyesi i variantit të parë ka ruajtur fomën e origjinalit, dhe, pavarësisht se për lexuesit nuk është e qartë loja e fjalëve *tale-tail*, *historia* rrëfehet në mënyrë të tillë që të pasqyrojë bishtin e Miut. Në origjinal *historia* paraqitet në 49 rrjeshta, ndërsa në këtë variant vjersha është më e shkurtër – përbëhet nga 38 rrjeshta. Efektet e rimës, të pranishme në origjinal, arrijnë të përcillen me sukses edhe në përkthim. Nëse i lexojmë vjershat me zë të lartë, mund të vërejmë se muzikaliteti është i pranishëm si në anglisht ashtu edhe në shqip. Pra, mund të themi se forma (me të gjithë elementët përbërës) ashtu edhe përmbajtja (që është sërish në funksion të formës) e ruajnë efektin e tyre gjatë përkthimit.

Menjëherë na bie në sy se forma e "bishtit" të Miut nuk ruhet në këtë variant përkthimi, por *historia* rrëfehet në formën e një vjershe me 16 rreshta që gëzojnë edhe ritëm edhe rimë. Kuptimi arrin të transmetohet për lexuesit, por forma është sakrifikuar (edhe pse forma në këtë rast është në thelbësore për të realizuar vazhdimësinë e lojës së fjalëve). Mund të përmendim këtu edhe faktin se *tale* përkthehet edhe me fjalën *tregim* që mund të ishte përdorur që në fillim në vend të fjalës *histori*, meqënëse *tregim* dhe *bisht* i përkasin të gjinisë mashkullore, ndërsa *histori* gjinisë femërore.


quan të hidhur'" - Dhe zuri të vriste
nendjen për të gjetur arsyen... ndërsa Miu
azhdonte të tregonte. kështu që në fund ajo e
ërmblodhi vetë historinë e tij në këtë mënyrë:
I shkon Daci
në shtëpi dhe
i thotë të
gjorit Mi.
"Një padi
unë kam
me ty
që të
shkojmë
në gjyq
të dy!
Ec, të
them, kot
kundërshton:
këtë gjyq gjë
s'e ndalon!
m i ngeshëm.
sot s'kam
punë.
porse
prapë
nuk prev
dot shumë!"
I thot'miu:
"Mor zotni,
po kjo punë
s'ka bërë vakt!"
Gjyq i ulët
kur
s'eshtë pun
pa gjykatës,
pa anëtarë!"
Ia kthen daci
me çapoj:
"Vetë pyes,
vetë gjykoj!
vetë
dhe
vetë lexoj
e me vdekje
do
të
dënoj."
- Ti s'po më dëgjon. - i tha Miu Lizës
të ashpër. - Për se mendon?
- Më fal, - ia priti Liza. Kishe arritu
kthesa e pestë.

Figura 4 ***Tregimi i Miut në V.III***

Fillimisht rikujtojmë faktin se varianti dytë dhe i tretë janë kryer nga i njëjti përkthyes – *Maqo Afezolli*. Përsa i përket përmbajtjes, ai paraqet të njëjtin përkthim si në variantin e dytë (ndryshimet janë thjesht në transkriptimin e fjalëve), por, përsa i përket formës, mund të shohim se ai është përpjekur ta sjellë atë si në origjinal (mund të shtojmë se forma nuk ngjason krejt me origjinalin dhe se fjalët ndjekin njëra-tjetrën për të formuar një zig-zag më shumë se sa një *bisht* Miu; gjithashtu, në origjinal shkronjat vijnë duke u zvogëluar për të krijuar tërësisht formën e bishtit të Miut, kjo paraqitje grafike përdoret edhe nga përkthyesit e variantit të parë, por në këtë variant shkronjat kanë të njëjtën

[302] Xh. Lloshi (2005) *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar: Albas, fq. 273.

madhësi prandaj ndoshta edhe forma nuk pasqyron tërësisht një *bisht* Miu). Fakti që autori përdor një përkthim pak a shumë të njëjtë, por e riformëson atë, ka lidhje dhe me faktin se në këtë përkthim, (v.1998) siç e përmendëm më lart, autori përdor shënimin sqarues që bën me dije lexuesin se ekziston një lojë fjalësh për *tale-tail* në anglisht. Duke vërejtur variantet e mësipërme, ashtu si dhe *Edmond Tupja* mund të themi se "*Përkthyesi, detyrimisht ndërton një raport të ri midis të thënës dhe të nënkuptuarës, që privilegjon të parën*".[303]



Liza në botën e çudirave

"Duhet të më shpjegosh pse i urren Q... dhe M..." shtoi gati me pëshpërimë, nga frika se mos e lëndonte sërish.

"Historia ime nuk është nga ato pa fillim dhe pa mbarim; ajo është edhe e gjatë edhe e trishtueshme" u drejtua Miu nga Liza me një frymëmarrje të rëndë.

"E di që trimëria jote është e gjatë" tha Liza, e cila nuk e kishte dëgjuar mirë atë që kishte thënë miu. "Po si mund të jetë edhe e trishtueshme?" Ajo e bëri këtë pyetje, ndërsa Miu fliste. Kështuqë nuk kuptoi gati asgjë nga tregimi i tij, nga i cili i mbetën të fiksuara vetëm disa fjalë të shkëputura:

Furia takoi
një mi
që po flinte
në shtëpi
do ta bëj
gjyqin tani
sepse kur je
në gjumë
oh sa shumë
ti bën zhurmë,
gjyqin do ta
bëj në çast

35

Liza në botën e çudirave

nuk gjej dot
një tjetër
rast!
Qeshi miu:
Ha, ha, ha,
ky s'është gjyq
more vëlla,
nuk bëhet gjyqi
në oborr
pa gjykatës
pa prokuror!
U vrejt Furia,
Qeshi me zor,
Unë jam
gjykatës
dhe prokuror!
Jam i uritur
Kam dhe etje
Të dënoj
ty me vdekje!

"Po ti nuk po më ndjek!" i tha një çast Miu Lizës, me një ton qortues e i fyer. "Ku e ke mendjen?"

"Të kërkoj ndjesë" u përgjigj Liza me përulësi. "Isha hutuar pak".

"E shikoj!" tha Miu nervoz.

36

Figura 5 ***Tregimi i Miut në V.IV***

Sa më e madhe të jetë shkalla e rëndësisë së formës, aq më e madhe është mundësia e humbjeve kuptimore.[304] Edhe në këtë rast, që në pamje të parë mund të shohim se forma e bishtit të Miut nuk është ruajtur, gjë që është logjike meqenëse në këtë variant nuk përmendet fare loja e fjalëve *tale-tail*. Janë gjithsej 32 rrjeshta kundrejt 49 rrjeshta të origjinalit, megjithatë, mund të themi se do të ishte më mirë që vjersha të shkruhej në formë të zakonshme, për më tepër që vargjet edhe rimojnë mes tyre. Nuk është e qartë se si do të identifikohet si personazh nga lexuesit e vegjël *Furia* që përmendet dy herë në këtë vjershë (ndërkohë që në origjinal *Fury* është emri i një qeni, në përkthim nuk del shumë e qartë se çfarë krijese është *Furia* dhe fëmijët mund ta identifikojnë me një kalë të zi, nisur nga seriali i ndjekur për fëmijë në Shqipëri), ndërkohë që në fjalorin e gjuhës shqipe lexojmë se furia është një vrull i madh e i papërmbajtur, tërbim, dhe erë shumë e fortë.[305]

[303] E. Tupja (2003) *Pro Translatore – Shënime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin*. Shtëpia e Librit OMBRA GVG: Tiranë, fq. 33-34.

[304] V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 221.

[305] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002) *Fjalor i Shqipes së Sotme*. Botimet Toena, Tiranë, fq. 367.



të zgjidhte këtë enigmë, ndërkohë që Miu rrëfente historinë e vet, atëherë dhe vetë tregimi në përfytyrimin e Lizës ishte i tillë:

Egërsira miut,
pasi e kapi,
në shtëpi
i tha
eja të shkojmë!
Ty, unë
do të të bëj dava.
Do të ta heq
unë padinë
dhe si arrest
do të kesh shtëpinë,
sepse nga mëngjesi unë
nuk kam gjetur
as vetë punë.
*Miu, **të poshtrit**[9]*
i thotë:
- Mendimet e tua
të këqija sot.
Pa gjykatës
e pa anëtarë,
gjyqin
e bëjmë kot.

Egërsira ulëriu:
- Unë forcë kam,
dhe gjykatës,
dhe prokuror
vetë jam.
Punën tënde
do ta shqyrtoj,
do ta gjykoj,
dhe me vdekje
do të të dënoj.

- Ti nuk po dëgjon! - i tha rreptë Miu Lizës. - Për çfarë po mendoje?
- Më falni, ju lutem, - foli me zë lutës Liza. - Ju, më duket, arritët deri te pika e pestë?
- Kjo ishte pikëlidhja? - klithi i tërbuar Miu.
- Bohçja u lidh! - e kuptoi Liza, dhe derisa ajo gjithmonë ishte e gatshme të ndihmonte, në çast propozoi: - Më lejoni, unë do ta ndihmoj atë ta zgjidhë!
- Nuk kam ndër mend të bëj asgjë të tillë! - deklaroi Miu duke u ngritur dhe u largua tej. - Ti më fyen kur thua gjepura të tilla!
- Unë nuk desha, - u justifikua Liza e gjorë. - Ju vetëm se ofendoheni menjëherë, për hiç gjë!
Miu si përgjigje vetëm sa mërmëriti diçka.

Figura 6 ***Tregimi i Miut në V.V***

Edhe në variantin e pestë i kushtohet më shumë rëndësi përmbajtjes se sa formës. Vargjet ndjekin një model ritmik të ngjashëm me origjinalin, ndërkohë që forma në të cilën vendosen ato nuk ngjason me bishtin e një miu, dhe kjo ndodh edhe për arsye se shkronjat duhet të fillonin të zvogëloheshin pak e nga pak nga mesi i tregimit, ashtu siç bëjnë në origjinal.

Në vazhdim shfaqet një tjetër keqinterpretim nga ana e Lizës dhe një tjetër lojë fjalësh mes personazheve, nisur nga keqinterpretimi i idiomës *fifth bend* si dhe nga çifti *knot-not*, për variantet e përkthimit të të çilave mund t'i referoheni tabelave nr. 12 dhe 13. Në lidhje me këto lojëra fjalësh mund të sugjerojmë se për çiftin *tale-tail* në gjuhën shqipe duhet të shmanget përkthimi fjalë për fjalë meqenëse kjo nuk krijon lojë fjalësh, por, nga ana tjetër, nisur nga fakti se kjo lojë fjalësh ndiqet edhe nga vërejtja e Lizës që bishti është i gjatë, edhe vjersha me formën e bishtit, dhe pastaj nga *bend* (që nënkupton një kthesë – përsëri i referohet formës së bishtit), dhe në fund nga *knot-not* (ku *knot*-nyje sëish i referohet bishtit të gjatë që ka formuar nyje), grupi i lojërave të fjalësh është vërtet i gjatë si një bisht miu dhe, si e tillë, është e vështirësi të rikrijohet tërësisht në gjuhën shqipe, por duhet të kompensohet pjesërisht që të ruhet të paktën efekti i transmetimit të saj deri në një farë mase për publikun e përkthimit. Së pari, do të ishte mirë që përkthyesit të shmangnin përdorimin e fjalës *histori* meqënëse kjo fjalë i përket gjinisë femërore dhe të përdorin një fjalë të gjinisë mashkullore si *rrëfim, tregim,* etj. Gjithashtu, që të bëhet lidhja me vjershën (nëse kjo do të riprodhohet në formën e origjinalit) duhet të gjurmojmë në lëmin e shprehjeve frazeologjike shqiptare dhe të gjejmë një shprehje që përmban fjalën *bisht* ose që nënkupton *gjatësi;* për shembull, do të sugjeronim që Miu të shprehej ***Rrëfimi*** *im s'ka* ***fund*** *e krye, nuk i gjender* ***filli*** (dhe pastaj të vazhdohej ***Rrëfimi*** *vazhdoi kaq gjatë sa u bë* ***lëmsh*** ose Liza të mërzitet e të shprehet *Bjeri shkurt tani, prije...* dhe Miu, i frikësuar të thotë *Kë të pres, moj, bishtin?*), *mos i bëj* ***bisht;*** *do t'i japësh fund* ***sot*** *apo* ***mot? – Not,*** *po ku di unë not, moj?,* etj. Nuk është e nevojshme të riprodhohen të gjitha lojërat e fjalëve në zinxhir siç janë në origjinal, mendojmë se do të ishte e mjaftueshme të realizohet qëllimi i autorit, vështirësia dhe keqkuptimet e personazheve gjatë komunikimit. Vendimet e përkthyesit në këtë rast mendojmë se duhet të udhëhiqen nga besnikëria ndaj lexuesve në gjuhën e përkthimit, prandaj edhe shprehjet frazeologjike ose homofonet nuk duhen përkthyer, por duhen kërkuar shprehje në shqip që ngjallin efekt sa më shumë të ngjashëm, dhe, ky, besojmë, duhet të jetë parimi që duhet të udhëheqë edhe procesin e vendimmarrjes së përkthyesit.

Në përfundim të diskutimit tonë, ripërmendim se ekzistojnë, ashtu siç kanë ekzistuar gjithmonë, tekste që përkthehen lehtësisht, dhe, nga ana tjetër, tekste që përfaqësojnë më shumë vështirësi gjatë procesit të të përkthyerit. Këto të fundit janë zakonisht ato tekste ku forma ndikon në përmbajtje, dhe këto dy elementë lidhen në një mënyrë të pazgjidhshme dhe të ndërsjellë, tekste në të cilët gjuha përdoret në mënyrë të qëllimshme për të arritur funksione estetike. Ajo çka duhet të bëjnë përkthyesit në këto raste është të identifikojnë fillimisht synimet e qëllimshme (ndoshta edhe të fshehta) të shkrimtarit në veprën origjinale dhe më pas të përpiqen të transmetojnë efektin dhe jo formën apo fjalët në mënyrën identike të shfaqjes së tyre në origjinal. Më konkretisht, në lidhje me çiftin homofonik ***tail-tale*** mund të vërejmë se përkthyesit kryesisht janë përqëndruar në riprodhimin e përmbajtjes së origjinalit, duke anashkaluar formën, që është një element shumë i rëndësishëm në rikrijimin e efektit të ngjashëm. E mbyllim këtë diskutim duke theksuar se, meqënëse procesi i përkthimit është një proces vendimmarrjeje, përkthyesit duhet të tregojnë kujdes për vendimet që marrin, sepse çdo zgjedhje e bërë prej tyre do të ndiqet nga vendime të mëtejshme në një fazë të mëvonshme të procesit të të përkthyerit. Për këtë arsye, do të ishte mirë që ata të tregohen sa më koherentë në vendimet e tyre në mënyrë që përkthimi të lexohet dhe të përcillet e të perceptohet sa më rrjedhshëm drejt një interpretimi sa më të saktë të mesazhit origjinal.

IV.3.2 Problematika e përkthimit të emrave të përveçëm

Ekziston një qëndrim i përgjithshëm sipas së cilit emrat duhet të transmetohen në mënyrë të pandryshuar në shkrimet tekstuale (...). Me të vërtetë, një përkthyes naiv ose pa përvojë (...) mund t'i presë me kënaqësi emrat e përveçëm të një teksti dhe t'i konsiderojë ata si ishuj pushimi – pjesë jo problematike që do të transmetohen pa ndonjë mundim të madh në materialin e ri gjuhësor që do të krijohet – që do të përkthehen në kuptimin e transmetimit përtej hapësirës gjuhësore pa u ndryshuar, ashtu si dhe reliket e një shenjtori përkthehen nga një vend qetësie në një vend tjetër.[306]

Duket e çuditshme, në fakt, por ky qëndrim kritik shprehur nga Timocko është shumë aktual sepse konsiderimi i emrave të përveçëm si një periudhë qetësie dhe moslodhjeje për përkthyesit është akoma një mendim shumë i përhapur ndër njerëz të ndryshëm, qofshin këta të përfshirë apo jo në fushën e studimeve përkthimore. Më ka qëlluar shpesh që, gjatë bisedave me miq e kolegë, të shprehem se kam qenë duke mbledhur të dhëna rreth "problematikës" së përkthimit të emrave të përveçëm në letërsinë për fëmijë. "A përbën kjo vërtet një problem?" pyesin ata. Ky reagim nga ana e tyre shpreh një pikpamje të përgjithshme se emrat e përveçëm nuk duhet të përkthehen gjatë kalimit nga njëra gjuhë në tjetrën, por thjesht të transferohen ashtu siç janë.

Po i referohemi fillimisht situatës aktuale në Shqipëri, për ta shtrirë më tej diskutimin më në përgjithësi. Gjuha shqipe është zhvilluar mjaft ndër vite për të arritur në nivelin e normës letrare standarde. Përmendim si dy hapa themelorë në këtë drejtim Konsultën e Gjuhës në Prishtinë (1968) si dhe Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë (1972). Megjithatë, sado që këto kanë qenë dy hapa vërtet me rëndësi në kuadër të themelimit të standardit të gjuhës shqipe, gjithnjë e më tepër në ditët e sotme po shfaqet nevoja e institucionalizimit mbi baza shkencore të bashkëpranuara, larg subjektivizimit dhe prirjeve dialektore. Duke pasur si qëllim të diskutojmë thjesht rreth qëndrimit të mbajtur ndaj emrave të përveçëm të huaj, po përmendim vetëm disa rregulla që kanë

[306] M. Tymoczko (1999) *Translation in a Postcolonial Context*, Manchester, UK: St Jerome, fq. 223.

ekzistuar prej kohësh në këtë drejtim. Para Kongresit të Drejtshkrimit nuk kishtë një kriter të vetëm për shkrimin e emrave të huaj, të cilët shkruheshin kryesisht si në gjuhën në të cilën fliste dhe shkruante shkrimtari i huaj nga përkthehej teksti. Pas Kongresit të Drejtshkrimit u përcaktuan kritere të pranuara gjerësisht në shkrimin e emrave të huaj, duke u bazuar në parimin fonetik, pra, në parimin e shqiptimit: *shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhën përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes*.[307] Ky parim, pas viteve '90, me ardhjen e demokracisë, filloi të zvetënohet dhe t'i nënshtrohet subjektivizmit, gjë që, fatkeqësisht ndikoi edhe në gjuhën shqipe negativisht, duke i hapur rrugën shqiptimeve dhe shkrimeve gati qesharake në median e gjerë të emrave të huaj. Problematika është edhe më e dukshme në shkrimin e emrave, sepse parimi fonetik nuk zbatohet gjithmonë dhe emrat shkruhen ashtu si në gjuhën e huaj nga disa njerëz, nga të tjerë shkruhen si në gjuhën e huaj duke ndryshuar thjesht ndonjë zanore e bashkëtingëllore dhe duke lënë të pandryshuar pjesën tjetër përbërëse të emrit. Akoma më shqetësues shfaqet problemi në lidhje me kategorinë e shquarsisë që është karakteristikë e emrave në gjuhën shqipe, që do të thotë se emrat e huaj do të duhet t'i nënshtrohen kësaj kategorie, gjë që rrallë kuptohet drejt nga ana e përkthyesve apo përdoruesve në përgjithësi.

Duke e ngushtuar disi diskutimin tonë dhe duke u përqëndruar tani në aspektin e përkthimit letrar, ne përballemi vërtet me një problem kur emrat janë përzgjedhur nga ana e shkrimtarit në mënyrë të tillë që të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar me personazhin që mbart këtë emër apo me cilësi të veçanta të tij. Një vështrim i shpejtë në shumë libra të përkthyer dhe një krahasim i tyre me origjinalin do të nxirrte në pah se emrat e përveçëm, edhe brenda së njëjtës vepre, mund të mos përkthehen gjatë një pjese, dhe të përkthehen, të përshtaten apo të ndryshohen gjatë pjesës tjetër të po kësaj vepre. Një qëndrim i tillë i përkthyesit përbën, në fakt, një problem që nuk mund të kalojë pa u vënë re as nga lexuesit dhe as nga studiuesit apo përkthyesit. Në këtë drejtim, edhe përkthyesi Amik Kasoruho, duke diskutuar mbi pastërtinë e gjuhës shqipe, duke nxjerrë në pah një sërë problemesh të përkthimeve të sotme shprehet *se akoma nuk e dimë se si duhen shkruar emrat e përveçëm të të huajve,* nuk lakojmë emrat e huaj, nuk e shkruajmë shqipen siç e shqiptojmë, etj.[308] Shqetësimet që ngre përkthyesi janë mjaft aktuale për gjendjen e përkthimeve në ditën e sotme, megjithatë, ne do të përqëndrohemi vetëm në përkthimin e emrave të përveçëm, duke nxjerrë në pah veçanërisht ata emra të përveçëm që shprehin aludime, si një shfaqje të dukurisë së lartpërmendur të ndërtekstualitetit.

Natyrisht, kjo çështje nuk është aq e lehtë sa ç'mund të duket në vështrim të parë dhe vendimi për përkthimin apo jo të emrave të përveçëm do të jetë në varësi të një sërë faktorëve të tillë si çfarë konsiderojmë një emër të përveçëm, si e zbulojmë kuptimin e një emri të përveçëm si dhe çfarë kuptojmë me temrin e përgjithshëm "përkthim". Në këtë pjesë të punimit do t'i kushtojmë vëmendje fillimisht identifikimit të emrave të përveçëm si dhe klasifikimit të tyre në disa lloje e nënlloje me qëllim identifikimin dhe të strategjisë të përdorur nga përkthyesi dhe hamendësimeve mbi qëllimshmërinë e vendimeve të marra prej tij. Kemi gjithmonë parasysh se në letërsinë për fëmijë emrat e përveçëm janë shumë të rëndësishëm sepse shpesh shërbejnë për të nxjerrë në pah cilësitë e personazheve dhe për të na udhëhequr drejt ngjarjeve domethënëse që kanë ndikuar në emërtimin e tyre. Për të përmbushur këtë synim do t'iu referohemi dy veprave përfaqësuese: *Alice's Adventures in Wonderland* dhe *Harry Potter and the Philosopher's Stone.* Fillimisht do të paraqesim një kuadër teorik që ka për synim të na njohë me procedurat kryesore që ndiqen në përkthimin e emrave të përveçëm në përgjithësi, dhe,

[307] Drejtshkrimi i gjuhës shqipe (1973) Tiranë, fq. 35; fq. 104.
[308] *Botimet Shqiptare*, dt. 16.09.2010.

më tej, nëpërmjet shembujve të ndryshëm, do të shohim se si dhe sa mund t'i gjejmë të zbatuara ato nga ana praktike në strategjitë e përdorura nga ana e përkthyesit, duke u përpjekur të argumentojmë dhe hamendësojmë edhe mbi arsyet që e kanë shtyrë përkthyesin të veprojë në një mënyrë dhe jo në një tjetër. Emrat e përveçëm janë klasifikuar në grupe të ndryshme, gjë që thjeshtëson edhe analizën e tyre. Në fund të punimit do të parashtrojmë disa përfundime në kuadër të rasteve studimorë, letërsisë për fëmijë, dhe përkthimit të emrave të përveçëm në përgjithësi.

IV.3.2.1 Pikpamje teorike mbi përkthimin e emrave të përveçëm

Një shkallë besnikërie ndaj tekstit origjinal është domethënëse kur përkthejmë emrat, meqenëse duhet të njihet pozicioni dhe funksioni i tyre origjinal në tekstin si dhe në kulturën origjinale.[309]

Po prezantojmë fillimisht se çfarë kuptojmë me "emër i përveçëm", për të vazhduar më pas me parashtrimin e disa studimeve që përshkruajnë qëndrime të ndryshme të përkthyesve gjatë përballjes me emrat e përveçëm gjatë përkthimit të tekstit origjinal. Sipas Dejvid Kristëll (David Crystal) shkenca që studion emrat njihet si onomastikë (gr. *onomastikos),* që zakonisht ndahet në studimin e emrave të njerëzve (gr. anthroponomastikos) dhe vendeve (gr. toponomastikos).[310] Emrat gjithashtu klasifikohen si të përgjithshëm dhe të përveçëm. Në këtë pjesë të punimit tonë, nuk kemi për qëllim të ndalemi në mënyrë të hollësishme në klasifikime të mëtejshme të emrave, mjafton të themi se një emër i përveçëm është "emri që i jepet një individi ose një grup individësh të veçantë, që dallohen nga emri që kanë".[311] Dy cilësi thelbësore të emrave të përveçëm janë pikërisht veçanësia e tyre dhe cilësia e identifikimit.[312] Problemi i përkthimit të emrave të përveçëm shfaqet si pjesë e një sërë vështirësive të tjera në përkthimin letrar, meqenëse personazhet më domethënës kanë emra të krijuar posaçërisht për t'iu përshtatur qëllimeve narrative të veprës lerare, për këtë arsye, emrat e përveçëm në krijimtarinë letrare janë dyfish të veçantë: së pari, sepse janë unikë, në dallim nga personazhet e tjerë brenda së njëjtës vepre letrare, por, njëkohësisht sepse janë krijuar si risi nga shkrimtari, dhe, si të tillë, janë unikë në krijimtarinë letrare në përgjithësi. Një gjë e tillë e vështirëson përkthimin e tyre dhe rrit përgjegjësitë e përkthyesit që duhet të jetë po aq unik në përzgjedhjet e tij sa edhe shkrimtari i veprës origjinale dhe të mundohet të shmangë emërtime që kanë ekzistuar më përpara, në mënyrë që këto të mos interpretohen si referenca ndërtekstuale (të paqëllimshme) për lexuesit e përkthimit. Vështirësitë krijohen gjithashtu në ato raste kur një emër i përgjithshëm kthehet në një emër të përveçëm, dhe kjo gjë ndodh veçanërisht kur personazhet-kafshë në një vepër emërtohen sipas kategorisë së gjallesës që ato përfaqësojnë, siç do të shohim më konkretisht, për shembull, në *Alice's Adventures in Wonderland.* Meqenëse vetë lloji i emrit të përveçëm luan rol në strategjinë që ndiqet në përkthimin e tij, po prezantojmë shkurtimisht një mënyrë klasifikimi të emrave të përveçëm që do të na ndihmojë edhe në identifikimin e qëndrimit të përkthyesit, duke qenë të vetëdijshëm se çdo kategori mund të pësojë ndarje

---

[309] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 194.

[310] D. Crystal (1997) *The Cambridge Encyclopedia of Language.* (2nd ed.) Cambridge: Cambridge University Press, fq. 112.

[311] P. Matthews, Peter (1997) *The Concise Oxford Dictionary of Linguistics*. Oxford: Oxford University Press, fq. 300.

[312] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 18.

e nëndarje të tjera, gjë që nuk përfshihet në synimet e studimit tonë. Duke u mbështetur në studimin e Ivonë Bertillsës (Yvonne Bertills), po përmendim tri kategori të emrave të përveçëm:

1) *Emra të përveçëm tradicionalë* – emra dhe mbiemra që i përkasin antroponimisë së përgjithshme. Në këtë kategori bëjnë pjesë vetëm emra që mund t'i gjejmë, për shembull, në regjistrin e përgjithshëm të emrave dhe që nuk mund të nënkuptojnë karakteristika të brendshme të atij/asaj që e mban këtë emër.
2) *Emra të shpikur ose të vetëkrijuar* – emra që kanë ngarkesë semantike dhe formohen ose shpiken për qëllime narrative, sipas kontekstit. Shumica e këtyre emrave kanë një ngarkesë semantike të qartë ose lehtësisht të identifikueshme. Emrat që nuk kanë ngarkesë semantike të dukshme ose që nuk formohen nga emra ekzistues quhen *imagjinarë*, ndërsa emrat që krijohen sipas emrave ekzistues dhe përshtaten sipas kontekstit quhen emra *tradicionalë të përshtatur*.
3) *Emra klasikë (ose historikë ose letrarë*) kanë një përmbajtje universale, pra, emri ka lidhje me disa karakteristika pavarësisht kontekstit kulturor ose gjuhësor, për shembull, emra klasikë të personazheve letrare si Hamleti, Çezari, emra që nuk janë tradicionalë dhe që nuk kanë ndonjë kuptim të identifikueshëm.[313]

Siç mund të kuptohet edhe nga ky klasifikim jo shumë i hollësishëm, por i mjaftueshëm për qëllimet e veprimtarisë përkthimore, kategoria më problematike është e dyta. Kjo nuk do të thotë se edhe shfaqja e një emri klasik apo tradicional në origjinal mund të kalohet pa një moment reflektimi nga ana e përkthyesit sepse përzgjedhja e bërë nga ana e shkrimtarit nuk është asnjëherë krejt rastësore dhe mund të mos jetë tërësisht e pavarur nga konteksti. Emrat e përveçëm, në një kontekst të veçantë letrar, bartin kuptim sepse funksionojnë si mjete stilistikore dhe narrative, mund të shërbejnë si alegori të njerëzve të vërtetë, të sjellin gjurmë të jetës, të dhëna rreth jetës së shkrimtarit, etj. – të gjitha këto nëpërmjet emrit që i jep jetë vetë personazhit.

Janë të shumta studimet që thellohen në rolin që ka emri në karakterizimin e personazheve.[314] Meqenëse personazhet letrare nuk mund t'i shfaqin cilësitë e tyre në mënyrë aq të dukshme sa personazhet reale, vijnë në ndihmë të dhëna të tjera që merren nëpërmjet tekstit si përshkrimet, dialogjet, mënyra e të sjellurit, etj., një pjesë e së cilave mund të bëhen të dukshme nëpërmjet formës së emrit ose ngarkesës së tij semantike. Xhonatan Kuller (Jonathan Culler) komenton se emrat e përveçëm ofrojnë një lloj mbulese; një siguri që të gjitha këto cilësi, të mbledhura gjatë gjithë tekstit, mund të lidhen me njëra-tjetrën dhe të formojnë një tërësi që është më e madhe se sa shuma e pjesëve përbërëse: emri i përveçëm i lejon personazhit që të ekzistojë jashtë cilësive semantike, shuma e të cilave gjithsesi e formon tërësinë e tij.[315] Nëse emri është tradicional, të dhënat rreth tij mund të merren nga njohuri të shëndosha të kulturës dhe gjuhës, nëse emri ka ngarkesë semantike me ngjyrime konotative të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara, duhet që lexuesi të ketë njohuri të mira gjuhësore dhe jo-gjuhësore.[316] Siç shprehet Maria Nikolajeva (Maria Nikolajeva), ndërtimi i personazheve letrarë në

[313] Po aty, fq. 45-47.

[314] Për studime më të hollësishme përmendim R. Barthes (1975) *S/Z. Essays*. Lund: Berlinska boktryckeriet.; S. Chatman (1978) *Story and Discourse. Narrative Structure in Fiction and Film.* Ithaca and London: Cornell University Press.; T. Docherty (1983) *Reading (Absent) Character. Towards a Theory of Characterization in Fiction.* Oxford: Clarendon.; S. Rimmon-Kenan (1983) *Narrative Fiction: Contemporary Poetics*. London and New York: Methuen.; M. Nikolajeva (2002) *The Rethoric of Character in Children.s Literature*. USA: Scarecrow. etj.).

[315] J. Culler (1975) [1994]. *Structuralist Poetics. Structuralism, Linguistics and the Study of Literature*. London: Routledge, fq. 237.

[316] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 54.

letërsinë për fëmijë nuk është më pak i ndërlikuar se në letërsinë në përgjithësi, megjithatë, është i ndryshëm sepse në letërsinë për fëmijë përfshihen edhe lexuesit e rritur ashtu si edhe fëmijët.[317] Ne kemi folur për këtë adresim të dyfishtë si një nga cilësitë e letërsisë për fëmijë, dhe kjo cilësi shfaq ndikimin e saj edhe në përgjedhjen e gjuhës nga ana e shkrimtarit, rrjedhimisht në emërtimin e personazheve nga ana e tij (i rritur) dhe në mënyrën e perceptimit të tyre (nga të rriturit dhe fëmijët njëkohësisht).

Meqenëse çdo tekst përmban aludime ndaj teksteve dhe ngjarjeve të tjera, gjithmonë është e nevojshme që përkthyesi, si lexuesi fillestar i tekstit që pasi të përkthehet do të jetë në dorën e lexuesve të tjerë pikërisht me ndërmjetësimin e tij, duhet t'i identifikojë aludimet sa më afër qëllimit të shkrimtarit origjinal. Sipas Peri Nodelmanit (Perry Nodelman) "*ajo që është e vërtetë për romanet me mistere është e vërtetë edhe për tragjeditë, romanet me kafshë që flasin dhe gjithë rangun e teksteve letrare. Çdo tekst i dhënë ka gjithmonë shumë tekste të tjera në sfond të tij, dhe shumë cilësi të përbashkëta me to: jo vetëm aludime të dukshme, por edhe ide, imazhe dhe modele bazë të subjektit".*[318] Ndërtekstualiteti, pra, nuk shfaqet vetëm në tërësi të tekstit, por edhe në njësi më të vogla. Përdorimi i një shprehjeje të re ndodh në marrëdhënie ndërtekstuale me përdorimin e saj në kontekste të mëparëshme. Çdo njësi gjuhësore mbart lidhje me shprehje të tjera brenda kulturës dhe gjuhës. Në një mikro-nivel, konotacionet e emrave të përveçëm, funksionojnë si elementë ndërtekstualë, dhe, në një shkallë më të gjerë, modelet e formimit të emrave dhe përdorimit të tyre duhen parë në mënyrë të ngjashme.[319]

Emer O'Sulivani, që ka studiuar përkthime të ndryshme në gjuhën gjermane të *Alice's Adventures in Wonderland* në periudha të ndryshme kohore, shprehet se përkthimi është gjithmonë një veprim individual i marrjes dhe interpretimit të një teksti origjinal nga ana e përkthyesit. Pra, përkthimi është gjithmonë një çështje e mënyrës së të kuptuarit të tekstit origjinal nga ana e përkthyesit, por edhe të qëndrimit që mban përkthyesi ndaj lexuesve dhe kulturës së përkthimit. Gjithashtu, Nikolajeva mendon se, ndryshe nga përkthimi për të rritur, në përkthimin e letërsisë për fëmijë kërkohet, jo thjesht transmetimi i kuptimit, por, në një nivel më të lartë, të zgjohen te lexuesi të njëjtat ndjenja, mendime dhe lidhje si ato që janë përjetuar nga lexuesit e tekstit origjinal.[320] Problemi qëndron në faktin se përkthyesi tashmë do t'iu drejtohet fëmijëve të një kulture tjetër. Qëndrimi që mban Bertillsa, në lidhje me përkthimin e letërsisë për fëmijë, dhe, në veçanti në lidhje me emrat e përveçëm, kërkon nga përkthyesi që, nëse ai synon të krijojë për lexuesit e tekstit të përkthyer ndjesi të ngjashme me ato të tekstit origjinal, ai duhet të mendojë fillimisht për ekuivalencën semantike, dhe, nëse emri ka edhe përbërës të veçantë fonetikë, duhet të bëhen përpjekje për të kapur edhe këto elementë. Në ato raste kur nuk mund të arrihen njëkohësisht edhe ekuivalenca semantike edhe ajo formale, atëherë do t'i kthemi funksionit të emrit në kontekstin e gjerë. Është e rëndësishme që lexuesit e tekstit të përkthyer të krijojnë një ide të njëjtë për personazhin ashtu si edhe

[317] M. Nikolajeva (1998) *The Magic Code. The use of magical patterns in fantasy for children*. Stockholm: Almqvist & Wiksell, fq. 55; (2001) *The Changing Aesthetics of Character in Children's Fiction.* Në *Style*, Volume 35, Number 3, 430-453. Northern Illinois University, fq. 442; (2002) *The Rethoric of Character in Children's Literature*. USA: Scarecrow, fq. x.

[318] P. Nodelman (1992) [1996] *The Pleasures of Children.s Literature*. New York: Longman, fq. 143.

[319] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 64.

[320] M. Nikolajeva (1996) *Children's Literature Comes of Age. Towards a New Aesthetic*. New York: Garland, fq. 28.

lexuesit e tekstit origjinal, si dhe që emri të ketë të njëjtin funksion. Nëse ka më shumë rëndësi përmbajtja apo forma, kjo varet nga funksioni i emrit në kontekst.[321]

Studiuesja Kristianë Nord me të drejtë shprehet se shumë njerëz janë të bindur se emrat e përveçëm asnjëherë nuk përkthehen, e, megjithatë, nëse shikojmë veprat e përkthyera do të vemë re se përkthyesit mbajnë qëndrime nga më të ndryshmet ndaj emrave të përveçëm: nuk i përkthejnë, nuk i përkthejnë por bëjnë ndryshime në mënyrën e shkrimit të tyre nisur nga shqiptimi në gjuhën e përkthimit, i transkriptojnë sipas alfabetit latin, i përshtatin morfologjikisht për gjuhën e përkthimit, bëjnë përshtatje kulturore, i zëvendësojnë, etj., dhe, çka është edhe më interesante, nuk mbajnë qëndrim të njëjtë për të gjithë emrat e përveçëm që shfaqen në tekstin që ata po përkthejnë.[322]

Nëse do t'i referoheshim hapësirës shqiptare, e gjejmë me vend të përmendim qëndrimin e Edmond Tupes. Ai shprehet se emrat e njerëzve nuk përkthehen, nuk mund të përkthejmë një emër francez *Pierre* ose italian *Pietro* me emrin shqiptar *Guri.* Një gjë e tillë do ta ngatërronte lexuesin. Por, ka disa përjashtime kur emrave u bëhet një farë përshtatje, emri i papës ndryshon sipas gjuhëve dhe e njëjta gjë ndodh edhe me mbiemrin e Kristofor Kolombit. Studiuesi Tupja na bën me dije gjithashtu se për emrat e vendeve dhe rrugëve çështja nuk është kaq e thjeshtë, sepse rrezikojmë të japim ngjyra lokale aty ku nuk është gjithmonë e dëshirueshme një gjë e tillë. Nga pikpamja onomastike – shprehet ai, - kemi padyshim një saktësim më të madh, kurse nga këndvështrimi i ngjyrës lokale ngjan se kemi një farë bjerrje. Duke iu referuar më tej problemit të drejtshkrimit të emrave të përveçëm të huaj gjatë përkthimit të një vepre letrare në shqipe, Tupja na njeh me faktin se para luftës së dytë botërore në mjaft vepra të përkthyera emri i autorit shkruhej si në origjinal, kurse emrat e përsonazheve shkruheshin herë si në origjinal dhe herë fonetikisht, duke u lakuar. Pas vendosjes së regjimit komunist, u vunë re prirjet unifikuese të gjuhës letrare edhe në veprat e përkthyera, dhe meqë letërsia i drejtohej mbarë popullit, të gjithë emrat e përveçëm do të shkruheshin fonetikisht. Më pas, me vendosjen e demokracisë dhe me lindjen e shtëpive botuese private, u rishfaq prirja e vjetër e të shkruarit të emrave të huaj të përveçëm, ajo që ishte praktikuar deri në fund të luftës së dytë botërore. Në ditët e sotme bashkëekzistojnë të dyja këto prirje. Mendimi personal i përkthyesit Tupja është që emrat e autorëve bashkëkohorë duhen shkruar në gjuhën shqipe si në gjuhën origjinale, duke përjashtuar vetëm emrat e autorëve japonezë, grekë, arabë, sllave, etj. që nuk shkruhen në gjuhën origjinale me shkronja latine. Ai na tërheq vëmendjen gjithashtu për rastet kur emrat e huaj i shkruajmë si në gjuhën origjinale, gjë që kërkon detyrimisht që ata t'iu binden ligjeve morfo-sintaksore të gjuhës shqipe. Duke e përqëndruar vëmendjen në emrat e personazheve të një vepre letrare të përkthyer, Tupja mendon se ata mund të shkruhen sipas njërës prej dy prirjeve të përmendura prej tij, duke na lënë të kuptojmë se më e natyrshme do të ishte përshtatja fonetike. Megjithatë, më e rëndësishme nga të gjitha është që, pasi të jetë zgjedhur një nga dy prirjet, t'i përmbahemi vetëm asaj nga kreu deri në fund të përkthimit.[323]

Duke e shtrirë diskutimin tonë në një hapësirë ndërkombëtare, do të shpreheshim se përkthimi i emrave të përveçëm në përgjithësi ka qenë në qendër të studimeve teorike të studimeve përkthimre. Në parantezë, duhet të themi se të gjitha përpjekjet teorike të bëra në këtë drejtim janë me shumë vlerë nisur edhe nga numri i lartë i shembujve që sjellin, nga përshkrimi i hollësishëm si dhe këshillat që japin për përkthyesit. Më poshtë po përmendim shkurtimisht disa nga këto studime për t'u njohur me qëndrimet e

[321] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 194.
[322] C. Nord (2003) *Proper Names in Translations for Children: Alice in Wonderland as a Case in Point*. Meta: Journal des Traducteurs / Meta: Translators' Journal, vol. 48, n° 1-2, 182-196, fq. 182.
[323] E. Tupja *Këshilla një Pëkthyesi të Ri.* Onufri, Tiranë, fq. 50-54.

studiuesve të ndryshëm të cilët kanë përshkruar se çfarë ndodh me emrat e përveçëm gjatë përkthimit. Pas këtij prezantimi, do të bëjmë një përmbledhje të gjithë procedurave që do të na shërbejë për qëllime më konkrete të studimit tonë, mbështetur në dy raste studimorë: *Alice's Adventures in Wonderland* dhe *Harry Potter and the Philosopher's Stone.*

1) Brixhit Shtolt (1978)

Brixhit Shtolt (Brigit Stolt), duke folur rreth synimeve edukative të letërsisë për fëmijë si dhe opinionet e paramenduara të të rriturve rreth lexuesve fëmijë, shprehet se shpesh njerëzit i nënvlerësojnë pritshmëritë e tyre në lidhje me fëmijët, imagjinatën e tyre, nivelin e kuptimit te informacioneve të reja, të vështira dhe të çuditshme, përveç rasteve kur përshkrimet bëhen në mënyrë emocionuese. Në këtë kategori përfshihen edhe emrat edhe titujt e librave. Sipas saj, nuk është e nevojshme t'i ndërrojmë emrat e personazheve sipas vendeve dhe gjuhëve ku do të lexohet teksti i përkthyer, por, mund t'iu parashtrojmë fëmijëve faktin se ka edhe fëmijë të ndryshëm me të njëjtin emër. Gjithashtu, sipas saj, duhet të kufizojmë sa më shumë zakonin kaq të përhapur të zëvendësimit të emrave. Nëse përmbajtja e librit është shumë interesante, fëmijët do t'i tejkalojnë vështirësitë e një emri të çuditshëm. Në të kundërt, elementë të huaj dhe ekzotikë do të zbehen dhe nuk do të ketë më as interes dhe as vlera edukative. Pra, do të ishte më mirë të përdoreshin teknika të tilla si shpjegime shtesë, ndihmë për shqiptimin e emrave të huaj të vështirë, etj., të dhëna këto që duhet të jenë në brendësi të vetë librit. Edhe një herë ajo bën thirrje të tregojmë kujdes për shkallën e përshtatjes: besnikëria ndaj origjinalit përbën një nga problemet më themelore të përkthimit. Nëse përshtatjet janë patjetër të domosdoshme, ato duhen bërë me kudes, sa më pak të jetë e mundur dhe në bashkëpunim me shkrimtari. Përkthyesi i letërsisë për fëmijë nuk ka një punë më të lehtë se përkthyesi i letërsisë për të rritur.[324]

2) Suzan Basnet (1980)

Duke disktuar fillimisht mbi vështirësinë e përkthimit të emrave rusë (përbërja e tyre e trefishtë: emri, emri i babait dhe mbiemri), Basneti thekson se është thelbësore për përkthyesin që të marrë në konsideratë *funksionin* e sistemit të emërtimit se sa vetë sistemin. Fillimisht përkthyesi duhet të përcaktojë funksionin e sistemit të gjuhës origjinale dhe më pas të gjejë një system në gjuhën e përkthimit që do të kryejë atë funksion në mënyrën e duhur.[325]

3) Gëte Klingberg (1986)

Sipas Gëte Klingbergut, rregulli i përgjithshëm është që emrat nuk duhet të ndryshohen. Megjithatë, ka edhe përjashtime nga ky rregull. Si fillim, në përgjithësi, emrat e përveçëm që nuk kanë ndonjë kuptim të veçantë dhe që i përkasin jetës së përditshme nuk duhet të ndryshohen gjatë përkthimit. Në librat për fëmijë, duhet përmendur fakti se, për shkak të përshtatjes kulturore kontekstuale, emri mund të përshtatet në një formë më të përdorshme në gjuhën e përkthimit. Në librat për fëmijë ka shumë emra të shpikur, të cilët mund të ndryshohen për arsye të ndryshme. Ndryshimi është i nevojshëm kur emri duhet të përshtatet nga ana e shqiptimit dhe të bëhet më i natyrshëm për lexuesit dhe më i kuptueshëm. Gjithashtu, emrat mund të ndryshohen kur ata kanë cilësi përshkruese dhe ndryshimi është i nevojshëm për të ruajtur këto cilësi. Cilësi të tilla mund të jenë

[324] B. Stolt *How Emil Becomes Michel. On the Translation of Children's Books.* Në G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader.* Clevedon: Multilingual Matters, fq. 71-75, fq. 83.
[325] S. Bassnett [1980] 1994 *Translation Studies.* London and New York: Routledge, fq. 118-119.

melodiciteti, efektet humoristike, dykuptimësia, elementë ekzotikë e kulturorë të cilët mund të ruhen vetëm duke e ndryshuar emrin sipas kontekstit të ri kulturor në gjuhën e përkthimit. Vetëm në raste të tilla ndryshimet janë të justifikueshme. Emrat gjeografikë që i përkasin gjuhës origjinale duhet ose të mbajnë formën e gjuhës origjinale, ose formën specifike ekzistuese në gjuhën e përkthimit. Emrat që mund të krijojnë aludime për lexuesit e tekstit origjinal por jo për lexuesit e përkthimit duhet të shpjegohen ose të ndryshohen me emra me vlerë të njëjtë për gjuhën e përkthimit. Për çdo rast ndryshimi, duhet të tregohet kujdes që të shmangen aludime që mund të krijohen në mënyrë të paqëllimshme nga emri i ndryshuar.[326]

4) Pitër Njumark (1988)

Pitër Njumarku sjell shembuj nga tri klasa të emrave të përveçëm: emrat e njerëzve, të sendeve dhe emra gjeografikë. Emrat dhe mbiemrat e njerëzve, sipas tij, zakonisht *transferohen* (nëse nuk kanë konotacione brenda tekstit), duke ruajtur kështu shprehjen e kombësisë së tyre. Megjithatë, në disa raste, edhe emrat e njerëzve mund të *përkthehen*, si në rastin e mbretërve, papëve apo shenjtorëve ose në rastin e emrave që kanë konotacione në letërsinë imagjinare. Emra të tjerë *natyralizohen*, d.m.th. shndërrohen sipas shkrimit ose shqiptimit në gjuhën e përkthimit (dukuri që studiues të tjerë e quajnë *transliterim*). Nëse edhe kombësia edhe konotacionet janë domethënës, mund të përdoren njëkohësisht edhe *përkthimi* edhe *natyralizimi*. Emrat e sendeve, përfshi këtu edhe emrat markash dhe pronarësh, zakonisht transferohen, ndërsa për emrat gjeografikë duhet që përkthyesi të kontrollojë nëse ka emra korrespondues ekzistues në atlasë apo burime të ngjashme në gjuhën e përkthimit.[327]

5) Teo Hermans (1988)

Klasifikimi që ofrohet nga Teo Hermans (Theo Hermans) sjell të paktën katër mënyra për të transferuar emrat e përveçëm nga njëra gjuhë në tjetrën. Ata mund të *kopjohen*, d.m.th. të riprodhohen në tekstin e përkthyer ashtu siç ishin në tekstin origjinal; mund të *transkriptohen*, d.m.th. të transliterohen ose të përshtaten në nivelin e gërmëzimit dhe atë fonologjike; emrat që nuk kanë lidhje formale mund të *zëvendësohen* në gjuhën e përkthimit; dhe atëherë kur emri i përveçëm në gjuhën origjinale është i ndërthurur brenda leksikut të asaj gjuhe dhe ka fituar kuptim, emri mund të *përkthehet*. Mund të ketë edhe kombinime të këtyre katër mënyrave, sepse një emër i përveçëm mund të kopjohet ose të transkriptohet dhe gjithashtu edhe të përkthehet nëpërmjet një shënimi në fund të faqes nga ana e përkthyesit. Nga pikpamja teorike, duhen përmendur edhe shumë mundësi të tjera, dy nga të cilat janë më të shpeshtat: *mospërkthimi*, d.m.th. mospërfshirja e emrit të tekstit origjinal në tekstin e përkthyer, dhe *zëvendësimi i emrit të përveçëm me një emër të përgjithshëm* (që zakonisht i referohet një cilësie funksionale përbërëse të personazhit në fjalë). Gjithashtu ekziston edhe mundësia *shtimit* të një emri të përveçëm në tekstin e përkthyer, edhe në rastet kur një emër i tillë nuk ekziston në tekstin origjinal, ose *zëvendësimi i një emri të përgjithshëm me një emër të përveçëm* në tekstin e përkthyer, por kjo ndodh më rrallë dhe vetëm në disa gjini dhe kontekste të veçanta.[328]

---

[326] G. Klingberg (1986) *Children's Literature in the Hands of the Translators*. Lund: CWK, Gleerup. fq. 43-52.

[327] P. Newmark (1988) *A Textbook of Translation.* Prentice Hall, London, fq. 35; 214-215.

[328] T. Hermans (1988) *On Translating Proper Names with reference to De Witte and Max Havelaar"* Në *Modern Dutch Studies: Essays in Honour of Peter King* edited by Michael Wintle and Paul Vincent, fq. 11-24. London and Atlantic Highlands, NJ: Atlone.

6) Brixhit Shulze (1991)

Studiuesja Brixhit Shulze (Brigit Schultze) i referohet përkthimit të emrave të përveçëm dhe titujve për gjininë e dramës. Ajo na ofron pesë mënyra të ndryshme për sjelljen e emrave të përveçëm në përkthim: 1) *transferim i drejtpërdrejtë* ku ruhet forma e emrit në gjuhën origjinale, 2) *adaptimi* ku emri përshtatet sipas rregullave të shkrimit dhe shqiptimit të gjuhës së përkthimit, 3) *zëvendësimi* ku përkthyesi përdor ekuivalentin e emrit në gjuhën e përkthimit, 4) *përkthimi semantik* ku kuptimi denotativ dhe, ndoshta, edhe pak nga kuptimet konotative të origjinalit sillen në një formë të gjuhës së përkthimit, duke përfshirë edhe raste të përkthimit të pjesshëm, ku përkthehet vetëm një aspekt i veçantë i kuptimit të emrit, dhe 5) *transferimi i mjetit artistik,* ku përkthyesi imiton mjetin nëpërmjet të cilit është formuar emri origjial. Sipas kësaj studiueseje, përzgjedhja e njërës metodë apo tjetrës lidhet ngushtë me nivelin e të kuptuarit nga ana e përkthyesit të transferimit kulturor dhe identitetit kulturor (pra, konteksti kulturor dhe ndërkulturor).[329]

7) Ritva Lepihalme (1994)

Ritva Lepihalme (Ritva Leppihalme) në librin e saj *Culture Bumps,* duke shqyrtuar nga afër përdorimin e aludimeve, bën dallimin mes aludimeve të shprehur nga emrat e përveçëm dhe atyre të shprehur nga shprehjet "kyçe", duke propozuar këto strategji për përkthimin e emrave të përveçëm: 1) ruajtja e emrit ashtu si shfaqet në formën e tij origjinale, 2) ruajtja e emrit duke u shoqëruar nga disa përshkrime ose udhëzime shtesë, 3) ruajtja e emrit shoqëruar nga shpjegime të hollësishme (shënime në fund të faqes, etj.), 4) zëvendësimi i emrit me një emër tjetër nga gjuha origjinale, 5) zëvendësimi i emrit me një emër tjetër nga gjuha e përkthimit, 6) mospërfshirja e emrit, duke e përcjellë kuptimin nëpërmjet një emri të përgjithshëm, 7) mospërfshirja e emrit dhe aludimit të nënkuptuar prej tij.[330]

8) Ivonë Bertils (2003)

Duke iu referuar Njumarkut, Ivonë Bertilsa (Yvonne Bertills) shprehet se emrat e përveçëm tradicionalë i përkasin atyre elementëve specifikë kulturorë që janë të vështirë për t'u përkthyer. Megjithëse disa emra dhe forma emrash ekzistojnë në kultura të ndryshme gjuhësore, jo të gjithë emrat kanë ekuivalentë të natyrshëm në atë kuptim që kanë fjalë të tjera. Gjithashtu, Bertilsa mendon se është e rëndësishme të dallohet që emrat tradiconalë fitojnë edhe përmbajtje konotative në kontekstin narrativ ku ato shfaqen. Emrat tradicionalë që i përkasin ose që kanë ekuivalentë të ngjashëm edhe në gjuhën origjinale edhe në gjuhën e përkthimit, nuk është e nevojshme që të përkthehen, përveç rastit kur forma ortografike ka një funksion dallues në kontekst.[331] Emrat që përfshihen në leksik dhe në onomastikë janë paraqesin një sfidë më të vështirë për përkthyesit. Nëse përmbajtja semantike ka lidhje tematike me historinë, duhet të ruhet me qëllim që të mbahet i njëjti funksion letrar i emrit.[332]

---

[329] B. Schultze (1991) *Problems of Cultural Transfer and Cultural Identity: Personal Names and Titles in Drama Translation.* Në A. Kittley dhe A. P. Frank (ed.s) Gőttingen: Eric Schmidt Verlag, 91-100; cituar në A. P. Vermes (2001) *Proper Names in Translation: a relevance-theoretic analysis.* University of Debrecen, Hungari, fq. 7-8.

[330] R. Leppihalme (1994) *Culture Bumps. On the Translation of Allusions*. Helsinki: University of Helsinki, fq. 71-73.

[331] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 198.

[332] Po aty, fq. 204.

Përkthimi i emrave të shpikur është në qendër të vëmendjes në letërsinë për fëmijë, veçanërisht sepse emrat lidhen me karakterizimin gjuhësor të personazheve. Sipas Bertilsës, emrat me ngarkesë semantike ndahen në dy kategori, në varësi të faktit nëse lidhja e tyre me leksikun është transparente apo jo. Duke cituar Hermansin, studiuesja na kujton se emrat në të cilët ngarkesa semantike është më e dukshme dhe lidhja me leksikun është më konkrete quhen emra më ekspresivë, ndërsa emrat sugjestivë na bëjnë të kuptojmë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë karakteristika që janë të rëndësishme për referentin.[333] Edhe studiuesja Bertilsa, pasi prezanton mënyrat e ndryshme për përkthimin e emrave të përveçëm, shprehet se edhe ajo mendon se do të ishte më mirë një kombinim i të gjitha metodave. Madje ajo shkon edhe më tej duke thënë se kombinimet nuk janë thjesht të mundshme, por të domosdoshme në përkthimin e emrave me ngarkesë semantike.[334]

Emrat me ngarkesë semantike, edhe nga forma edhe nga përmbajtja e tyre, meritojnë vëmendje edhe për përfshirjen e tyre si dhe lojën me rrëfimin. Disa emra na habisin më pak se të tjerët, kështu që nëse personazhet e përfaqësuar prej tyre janë tërheqës dhe emocionues, kjo ndodh falë asaj çka ata thonë, bëjnë apo mendojnë në kontekst. Emra të tjerë janë më provokues, sepse lidhja e tyre me bartësit e emrit nuk është e dukshme dhe lexuesit janë duke pyetur veten përse personazhi është emërtuar në mënyrë të tillë. Nuk është e lehtë të vendoset nëse emri me të vërtetë përcjell ndonjë kuptim. Në përgjithësi supozohet se mënyra se si emri përkthehet lidhet me shkallën e transparencës apo konkretësisë së përmbajtjes semantike, por nuk është kaq e thjeshtë të vendoset kjo gjë sepse përmbajta semantike mund të jetë ekspresive dhe sugjestionuese në nivele të ndryshme. Ndonjëherë tingëllimi i emrit, ndonjëherë përmbajtja semantike janë sugjestionuese vetëm në një nivel konotativ dhe për një sistem lexuesish. Për rrjedhojë, mënyra se si do të konsiderohet dhe më tej se si do të përkthehet përmbajtja semantike nuk varet vetëm nga kuptimi i saj në gjuhën standarde por edhe nga funksioni brenda kontekstit, ose nga ajo çka duket se është funksioni brenda kontekstit. Edhe pse përmbajtja semantike e emrit është transparente, ajo mund të shkaktojë vështirësi për përkthyesin nëse konteksti nuk merret mirë parasysh.[335]

Në letërsinë për fëmijë shpesh përballemi me lojërat gjuhësore – një nga çështjet më të vështira gjatë përkthimit. Nëse loja nuk përcillet në përkthim, efektet humoristike do të humbasin.[336] Emrat nonsens, në të cilët lidhja me leksikun ose onomastikën nuk është e dukshme në mënyrë transparente, konotacionet dhe cilësitë simbolike të tingujve dalin në sipërfaqe. Kuptimet konotative lindin nga forma gjuhësore e emrit dhe përcaktohen më tej nga konteksti, ata marrin kuptime specifike kur vendosen në një kontekst. Kur përkthehen, ata zakonisht transkriptohen, gjë që çon në humbjen e konotacioneve.[337] Sa më shumë të ketë një emër ngarkesë nga aspekti kulturor, aq më i vështirë do të jetë përkthimi i tij. Duhet pasur gjithashtu parasysh se forma gjuhësore dhe përmbajtja e emrave të përveçëm funksionojnë si mjete të rëndësishme stilistikore në veprat letrare. Në përkthimin e letërsisë për fëmijë nuk mund të lemë mënjanë karakteristikat stilistikore të emrave. Sa herë që cilësitë gjuhësore përdoren për qëllimin e krijimit të një atmosfere apo për ngjyrim lokal, është e rëndësishme që ato të

[333] T. Hermans (1988) *On Translating Proper Names with reference to De Witte and Max Havelaar"* Në *Modern Dutch Studies: Essays in Honour of Peter King* edited by Michael Wintle and Paul Vincent.. London and Atlantic Highlands, NJ: Atlone, fq. 13.
[334] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 207.
[335] Po aty, fq. 208.
[336] Po aty, fq. 209-210.
[337] Po aty, fq. 218.

transmetohen edhe nëpërmjet përkthimit.[338] Bertilsa bën gjithashtu thirrje që t'i kushtojmë vëmendje edhe aspekteve që dallojnë gjininë e mundshme të emrave të përveçëm. Nëse injorohen karakteristika sugjestionuese për gjininë, mund të gjenden ekuivalentë për emrin që na çojnë drejt keqkuptimeve dhe që sugjerojnë cilësi të tjera për personazhin që mban atë emër.

Në përfundim të studimit të saj, Bertilsa shprehet se nuk ka kritere të thjeshta për përkthmin e emrave të personazheve letrarë. Kur përkthejmë emrat e përveçëm nuk mjafton vetëm që ata t'i vështrojmë në dritë të kontekstit që ekzistojnë, por edhe nga pikpamja e pozicionit të tyre në kulturë si dhe marrëdhëniet e tyre me emra të tjerë të leksikut dhe/ose me vetë leksikun. Transferimi i një emri të shpikur nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit kërkon një analizë të kujdesshme të formës ortografike, kuptimeve të mundshme të elementëve të emrit, kritereve të formimit ose përzgjedhjes të emrit si dhe funksioneve të tij në rrëfim. Emrat tradicionalë dhe ata me ngarkesë semantike lidhen me funksione të ndryshme në kontekstin narrativ, dhe kjo është arsyeja se përse nuk mund dhe nuk duhet të përkthehen sipas normave tërësisht të njëjta. Një sfidë më e madhe për përkthyesin paraqitet në rastet kur ai përballet me emra me ngarkesë semantike, sepse këto lloj emrash përmbajnë lojëra gjuhësore që duhen përcjellë edhe në gjuhën e përkthimit. Është e vështirë të përcillet edhe forma edhe përmbajtja, por funksioni i emrit duhet t'i ofrojë një zgjidhje përkthyesit. Meqenëse emri komunikon në nivele të ndryshme me të rriturit dhe me fëmijët, shtresat e kuptimit duhet të ruhen. Kështu, përkthyesit e letërsisë për fëmijë duhet të vendosin nëse do ta bëjnë përkthimin më të kuptueshëm për lexuesit fëmijë të tekstit të përkthyer, apo do të përpiqen të sjellin vërtetësisht elementët e tekstit origjinal. Nuk duhet të harrojmë se mënyra se si funksionon një emër i përveçëm në një vepër letare dhe përkthimet e saj është edhe në varësi të marrëdhënies mes teksteve dhe lexuesve të ndryshëm të tyre. Lexuesit e interpretojnë një emër në varësi të nivelit të tyre të njohurive gjuhësore, paramendimet, besimet, vlerat, etj. Dy faktorët kryesorë që shfaqin dallim janë mosha dhe formimi kulturor. Përkthyesit duhet ta kuptojnë se roli i tyre kërkon ndjeshmëri më të lartë, gjykim të shendoshë dhe origjinalitet, gjë që shkakton mendime të ndryshme sepse ajo çka konsiderohet të jetë e përshtatshme nuk është njësoj e dukshme për çdo lloj lexuesi, dhe, për këtë arsye, përfaqëson një sfidë më të madhe për përkthyesit.[339]

Studiuesja e mbyll diskutimin e saj duke shprehur mendim të njëjtë me studiuesen Emer O'Sullivanin, e cila vë në dukje se kërkohen standarde më të larta në përkthimet letrare për fëmijë. Gjithashtu, Bertilsa, me të drejtë nxjerr në pah faktin se edhe pse qëndrimet kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të ndryshojnë, akoma duket me vend të themi se, të paktën në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm, ka akoma vend për përmirësim.

Nisur nga ç'kemi përmendur më lart (1-8) arrijmë në përfundimin se përkthimi i emrave të përveçëm nuk është aspak një çështje e parëndësishme dhe e udhëhequr nga vendime rastësore. Gjithashtu, me mjaft rëndësi është të kuptojmë se një ndër parimet më të rëndësishme në përkthimin e emrave të përveçëm do të ishte edhe fakti nëse *këto emra janë bartëse të kuptimeve e nënkuptimeve dhe deri në çfarë shkalle duhet përcjellë një gjë e tillë nëpërmjet përkthimit*. Studiuesit e sipërpërmendur na ofrojnë një sërë procedurash a strategjish që mund të ndodhin gjatë përkthimit, disa prej të cilave janë të ngjashme, dhe disa të tjera mbivendosen mes tyre. Për këto arsye, më poshtë po japim një listë përmbledhëse të teknikave të ndryshme të përkthimit të emrave të përveçëm, gjë që do të

[338] Po aty, 220-224.
[339] Po aty, fq. 227-231.

na shërbejë si kuadër teorik për shembujt që do të analizojmë në vazhdim të këtij punimi. Ndër teknikat që mund të përdoren gjatë përkthimit të emrave të përveçëm përmendim:

- *Transferimi* ose lënia e emrit të pandryshuar – përdoret në ato raste kur përkthyesi vendos ta përcjellë emrin të pandryshuar nga gjuha origjinale në tekstin e përkthyer, ose sepse i tillë kontribuon në përcjelljen e (nën)kuptimit, ose sepse ndonjë ndryshim do të bënte që (nën)kuptimi të ndryshonte krejtësisht.
- *Zëvendësimi* i një emri në gjuhën origjinale me një emër të zakonshëm në gjuhën e përkthimit. Kjo teknikë përdoret kryesisht në përkthimin e emrave gjeografikë.
- *Transliterimi* ose *natyralizimi* është teknikë e ngjashme me zëvendësimin dhe përdoret si në përkthimin e emrave gjeografikë, ashtu dhe në përkthimin e emrave të përveçëm për të cilët është e nevojshme të bëhet përshtatja edhe nga ana fonetike ose grafologjike.
- *Përkthimi* – rindërtimi në gjuhën e përkthimit të kuptimit të shprehur në tekstin origjinal në mënyrë të ngjashme me atë të synuar nga autori gjatë krijimit të tekstit origjinal. Pra, kjo teknikë synon të rikrijojë nënkuptime të njëjta në tekstin e përkthyer ashtu si nënkuptimet e fshehura nën emrin e përveçëm në tekstin origjinal.
- *Përshtatja,* ose transformimi total – procesi nëpërmjet të cilit zgjidhet për emrin në gjuhën origjinale një zëvendësues në gjuhën e përkthimit, i cili nuk ka lidhje logjike ose normative me origjinalin (ose lidhet me të vetëm pjesërisht). Pra, emri origjinal zëvendësohet me një emër në gjuhën e përkthimit, gjë që bën që përkthimi të shkaktojë ndryshime edhe në formë dhe nënkuptime që mund të ketë emri. Kështu, në përshtatje mund të përfshihen edhe përgjithësimi, shtimi dhe mospërfshirja.
- *Mospërfshirja* e emrit ose pjesë të emrit, përdoret në rastin e emrave që përmbajnë lojëra fjalësh që nuk mund të rindërtohen në gjuhën e përkthimit ose emra që nuk janë të rëndësishëm për vazhdimësinë e rrëfimit.
- *Shtimi* i elementëve të emrit ose një emri tjetër.
- *Përgjithësimi* i kuptimit të emrit.
- *Rikrijimi* – një emër i shpikur nga gjuha origjinale rikrijohet në tekstin e përkthyer, duke riprodhuar efekte të ngjashme në një sfond tjetër kulturor.
- *Mospërkthimi* – i njohur gjithashtu edhe si riprodhimi, kopjimi ose ruajtja, d.m.th. lënia e emrit të pandryshuar (duke rrezikuar mospërcjelljen e konotacioneve, lojërave të fjalëve të shprehura në origjinal).
- *Mospërkthim plus shpjegim shtesë* – për të mbushur boshllëkun mes njohurive të lexuesve të tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer. Shpjegimet mund të shtohen në tekst ose jashtë tij, duke përforcuar funksionin informativ.

Në mënyrë edhe më të përmbledhur këto teknika do të ishin katër: *transferimi, zëvendësimi, përkthimi dhe përshtatja.* Vendimi i përkthyesit për të përdorur një nga këto katër procedura do të jetë kryesisht në varësi të kuptimit që bart emri në gjuhën origjinale dhe kuptimit të mundshëm në gjuhën e përkthimit dhe se cili nga (nën)kuptimet e mundshme duhet ruajtur në tekstin e përkthyer duke qenë në koherencë me qëndrimin e mbajtur në përgjithësi gjatë përkthimit. Është e rëndësishme që të prezantojmë këto teknika për përkthimin e emrave të përveçëm pasi ato mund t'ju hyjnë në punë përkthyesve sa herë që përballen me emrat e përveçëm në një tekst letrar. Në këtë drejtim, *Kasoruho* shprehet se ... *nuk mjafton përvoja dhe as njohja e mirë e leksikut të gjuhës nga e cila përkthehet, por është e domosdoshme njohja gjuhës në të cilën përkthehet dhe intuita artistike*.[340]

[340] *Botimet Shqiptare,* dt. 16.09.2010.

IV.3.2.2 Konkretizimi i përkthimit të emrave të përveçëm në brendësi të korpusit

Le të shohim tani se si gjejnë zbatim nga ana praktikë teknikat e sipërpërmendura.

Rast Studimor 1 - Harry Potter and the Philospher's Stone

Le të fillojmë me *Harry Poter and the Philosopher's Stone* shqipëruar nga Amik Kasoruho nën titullin *Harri Poter dhe Guri Filozofal*. Vetë përkthyesi, i cili ka sjellë në gjuhën shqipe serinë Poter, shprehet se "*E veçanta e këtyre librave ka qenë se shumica e lexuesve kanë qenë fëmijë ose adoleshentë, dhe është shumë e zorshme, por edhe kënaqësi që t'u japësh atyre më të mirën, më të thjeshtën, por me imagjinatë të bukur që ato romane kanë*".[341]

1. Analiza e emrave të studentëve në Hoguorts

a. Personazhi kryesor Harri Poter
Emri i protagonistit është qëndror në të gjitha veprat letrare, sepse ai ndikon jo vetëm në ndërtimin e përshtypjes mbi personazhin, por edhe në të gjithë veprën. Sipas Kristianë Nordit *nuk ekziston asnjë emër në një vepër letrare që të mos shprehë synimet e fshehura të autorit*.[342] Po kështu, edhe Ivonë Bertillsa shprehet: "*Emri është si një term çadër që përmbledh gjithë karakteristikat, për shembull, pamjen e personazhit, moshën, sjelljen (...) të dhëna në kontekst*."[343]

Emri *Harry Potter* është krejtësisht tipik britanik, plotësuar edhe nga fakti se *Harry* si emër shfaqet rregullisht në krye të pesë emrave më të përdorshëm në Britani.[344] Kështu mund të kuptojmë njëkohësisht dy gjëra: së pari, emri është i zakonshëm (jo i veçantë) dhe, së dyti, është më se i njohur (i përhapur). Dhënia e një emri të tillë një personazhi të trilluar nga ana e shkrimtarit mund të shërbejë për të theksuar normalitetin e personazhit në krahasim me atë çka e rrethon atë vetë, duke nxjerrë në pah kundërvënien mes dy botëve (botën e zakonshme britanike dhe botën e çuditshme të magjistarëve). Megjithatë, nëse do ta shikonim më nga afër emrin *Harry*, do të zbulonim se ky emër është një formë e emrit *Henry* (nga anglishtja e mesjetës) – një emër i famshëm për udhëheqës e mbretër, që, në fakt, rrjedh nga emri *Heimrich/Heinrich* që do të zbërthehej "mbret/udhëheqës i shtëpisë".[345] Nuk mund të japim një mendim të saktë në lidhje me shkallën e ndikimit të shkrimtares Rouling nga prejardhja etimologjike në përdorimin e një emri të tillë, megjithatë mund të themi me bindje se ajo nuk ka se si të ketë qenë në padijeni të origjinës së këtij emri.

Siç përmend edhe Rita Otineni, ky emër i referohet qartë Britanisë së Madhe, duke e lidhur njëkohësisht historinë me një kulturë të veçantë, pra, edhe me prejardhjen britanike të vetë protagonistit të shfaqur në emrin e përzgjedhur për të.[346] Rrjedhimisht,

---

[341] *Yll Press – Amik Kasoruho, shkrimtari që "përktheu" jetën e tij*, dt 15.06.2010.
[342] C. Nord (2003) *Proper Names in Translations for Children: Alice in Wonderland as a Case in Point*. *Meta XLVIII* (1-2): 182-196, fq. 183.
[343] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification. Proper Names in Children's Literature.* Åbo Akademi University Press, fq. 54.
[344] Office for National Statistics, http://www.ons.gov.uk/ons/rel/vsob1/baby-names--england-and-wales/2011/sb-baby-names-2011.html.
[345] Të dhënat rreth emrit *Harry* janë marrë nga *behindthename.com 2010.*
[346] M.G. Davies, R. Oittinen (ed.s) (2008*) Whose Story? Translating the Verbal and the Visual in Literature for Young Readers*. Cambridge Scholars Publishing, Newcastle, Uk, fq. 125-126.

përkthyesi përdor në të gjithë serinë emrin *Harri Potter*, duke na lënë të kuptojmë se një vendim i tillë dëshmon edhe një herë faktin se emri shërben (si në original ashtu edhe në përkthim) si një element identifikues kulturor për personazhin dhe për lexuesit. Nga njëra anë, ruajtja e emrit origjinal nga ana e përkthyesit i lejon lexuesit të identifikojë personazhin lehtësisht si një personazh britanik, dhe, nga ana tjetër, shqiptimi nuk përbën vështirësi edhe për një publik në moshë të re (sot një pjesë e mirë e fëmijëve shqiptarë janë të familjarizuar me gjuhën angleze nëpërmjet mediave të ndryshme). Duhet theksuar fakti se Kasoruho është shumë koherent jo vetëm gjatë përdorimit të këtij emri po në përdorimin e gjithë emrave të përveçëm gjatë këtij libri dhe në të gjithë serinë e librave *Potter*, jo vetëm duke ruajtur të njëjtën formë të emrit, por, njëkohësisht, edhe duke zbatuar saktësisht rregullat e shqiptimit, drejtshkrimit, lakimit të emrave në gjuhën shqipe, gjë që rrallë e hasim në përkthimet e ditëve të sotme.

b. Hermionë Granxher dhe Ron Uezli

Hermionë Granxher dhe Ron Uezli, si miqtë më të ngushtë të Harrit dhe personazhë qëndrorë në seritë *Poter*, duhen shqyrtuar sërish për kuptimet që fshehin pas emrit të tyre. Rouling ka zgjedhur për personazhin femëror një emër me origjinë greke – *Hermione*. Shkrimtarja ka bërë një zgjedhje të tillë për një personazh të zgjuar, të përfshirë në fushën e librave, duke "mos dashur të vinte në lojë vajza të tjera që janë të ngjashme në karakter, me dëshirë për të punuar e mësuar".[347] Mund të duket si një emër i çuditshëm dhe i vjetër, veçanërisht për lexuesit e vegjël, ndërsa më të rriturit mund të sjellin ndërmend një tjetër personazh nga Shekspiri (Hermionia në *The Winter's Tale).* Mund të themi se Hermiona shekspiriane e ka ndikuar shkrimtaren në zgjedhjen e emrit, megjithëse personazhet, siç shprehet edhe vetë shkrimtarja, nuk janë aspak të ngjashëm. Në përkthimin në gjuhën shqipe, ruhet emri i plotë i personazhit duke iu përshtatur rregullave të shqiptimit në gjuhën shqipe *Hermione Granger* - Hermionë Granxher. Nuk mund të themi nëse edhe në gjuhën shqipe lexuesit do të arrijnë të perceptojnë të njëjtat nënkuptime të shprehura nëpërmjet emrit dhe mbiemrit në origjinal, megjithatë lexuesit mund të kuptojnë se kemi të bëjmë me një personazh që vjen nga një sfond sërish britanik dhe emri deri diku na le të hamendësojmë se është një vajzë e dhënë pas librave dhe mësimeve.

Shoku i ngushtë i Harrit – Ron Uezli – është fëmija më i vogël nga shtatë fëmijët flokëkuq në familjen Uezli. Nëse do t'i referoheshim origjinës etimologjike të emrit të plotë *Ronald,* do të zbulonim edhe disa lidhje interesantë me rolin e këtij personazhi në vepër: emri rrjedh nga *Ragnvaldr* (Skandinavishte e vjetër), një emër kompozitë i përbërë nga "*regin* – këshilltar, këshillues" dhe *valdr* "mbretërues".[348] Pra, nga pikpamja etimologjike, emri *Ronald* mund të interpretohet si një emër që përshkruan një personazh që këshillon dikë që është në fuqi. Edhe në vepër, mund të vërejmë se shpesh Roni e shoqëron dhe këshillon Harrin, madje, duke pasur parasysh edhe shpjegimin e emrit Harri si një udhëheqës apo mbretërues, mund të themi se niveli i motivimit brenda emrit Ron është edhe më i lartë dhe jo i rastësishëm. Mbiemri *Weasely* në anglisht na kujton fjalën *weasel,*[349] ndërsa në shqip ky mbiemër, ashtu si dhe emri, "nuk përkthehet", por thjesht "vjen në shqip" i përshtatur nga ana fonetike e fonologjike.

---

[347] C. Lydon,. J.K. Rowling intervistë dhënë The Connection (WBUR Radio), 12 tetor 1999.

[348] Marrë nga *behindthename.com 2010*.

[349] Është me interes të përmendim lidhjen që realizohet e nënkuptuar mes mbiemrit *Weasley* dhe emrit *Hermione.* Fjala *hermine* (fr.) dhe *ermine* (ang.) nënkuptojnë një kafshë në fisin *weasel* (shq. nuselalë). Mendohet që emërtimet të mos jenë krejtësisht të rastësishme për shkrimtaren, nisur edhe nga njohuritë dhe studimet e saj në gjuhën frënge. Meqenëse personazhet kanë emra të ngjashëm, kjo mund të nënkuptojë që ata kanë një marrëdhënie të veçantë me njëri-tjetrin. Megjithatë, lidhjet etimologjike të fshehura nën

c. Studentë të tjerë nga Grifarti, Baldoskuqi dhe Korbziu

Një pjesë e mirë e emrave të studentëve të këtyre shtëpive nuk përkthehen, thjesht modifikohen nga ana fonetike, ashtu si dhe është vepruar me emrin e personazhit kryesor – *Harri Poter.* Kjo procedurë e përdorur nga përkthyesi i lejon lexuesit të identifikojnë dhe shijojnë një mjedis britanik, meqenëse në origjinal emrat e personazheve i përkasin antroponimisë së gjuhës angleze dhe e vendosin historinë në një kontekst kulturor britanik. Ruajtja e emrave origjinalë, pra, ndihmon lexuesit që të plotësojnë idenë e një vendi anglez, me emra dhe mbiemra anglezë, si dhe zakone tipike angleze. Kështu, emrat funksionojnë si shenjues kulturorë, duke nënkuptuar edhe origjinën kulturore të personazheve. Duhet të përmendim se të gjithë emrat iu përshtaten rregullave morfologjike të gjuhës shqipe.

Edhe emra të tillë si *Seamus Finnigan* që shërbejnë për të treguar edhe sfondin kulturor të referentit nuk janë përkthyer dhe një gjë e tillë është e kuptueshme sepse ruajtja e emrit iu tregon lexuesve edhe kombësinë apo të dhëna kulturore të personazhit, në krahasim me personazhe të tjerë, që kanë emra anglezë më tipikë, duke ruajtur kështu edhe një njësi më autentike në lidhje me historinë. Përmendim si shembuj *Seamus Finnigan* (irlandez) dhe *Parvati Patil* (indian) – të përshtatur përkatësisht *Simus Finigan* dhe *Kal Patili* – kundrejt emrave të tjerë si, për shembull, *Hannah Abbott* dhe *Katie Bell* – përkatësisht *Hanah Abot* dhe *Keti Bell.*

Ky vendim i përkthyesit për të ruajtur emrat ashtu siç ato shfaqen në origjinal, duket se qëndron në të njëjtën linjë edhe me mendimin e shprehur nga Klingbergu se "*emrat që i përkasin gjuhës së përditshme dhe pa ndonjë kuptim të veçantë që duhet kuptuar nga lexuesit nuk duhen ndryshuar pa pasur ndonjë arsye të f*ortë".[350] Ky vendim do të ishte i arsyeshëm për mospërkthimin e emrave të tillë që nuk shprehin nënkuptime, si për shembull: *Hannah Abbott* (Hanah Abot), *Mandy Brocklehurst* (Mandi Brokëllhërst), *Katie Bell* (Keti Bell), *Lavender Brown* (Lavanda Braun), *Justin Finch-Fletchley* (Xhastin Finç-Fletçij), *Seamus Finnigan* (Simus Finigan), *Morag MacDougal* (Moragut MekDugal), *Lisa Turpin* (Liza Torpin), *Blaise Zabini* (Blejzi Zabini), *Lee Jordan* (Li Xhordan), *Sally-Anne Perks* (Sali Anë Perks), *Alicia Spinnet* (Alis Spineti), *Dean Thomas* (Din Tomasi), *Fred Weasely* (Fred Uezli), *George Weasely* (Xhorxh Uezli), *Ginny Weasely* (Xhin Uezli), *Percy Weasely* (Persi Uezli), *Angelina Johnson* (Anxhelinë Xhonson).

Gjatë shqyrtimit të emrave të përveçëm të përkthyer vërejmë edhe dukuri të tilla si, nga njëra anë humbja e ngjyrimit të shprehur në origjinal, dhe, nga ana tjetër, shtimi i ngjyrimeve të pathëna apo nënkuptuara në origjinal. Përmendim dy shembuj për të pasqyruar çka thamë. Për (mbi)emra të tillë si (*Neville*) *Longbottom* që nuk janë pa nënkuptim ndoshta do të justifikohej edhe një zëvendësim apo përkthim i mbiemrit nga thjesht (Nevil) Longbotomi me një mbiemër më domethënës, meqenëse në anglisht nënkuptohet një djalë që ka shumë shëndet, pra, mund të ishte zëvendësuar mbiemri me *Buti, Buçko,* etj. Nga ana tjetër, duke ndjekur të njëjtin arsyetim, mund të themi se mospërkthimi i emrit dhe mbiemrit *Terry Boot* dhe thjesht përshtatja me rregullat e shqiptimit në gjuhën shqipe në formën *Terri But* sjell në gjuhën shqipe disa konotacione të panënkuptuara në origjinal, nëpërmjet mbiemrit *But*, që, duke ndjekur logjikën e emërtimit të personazheve ku mbiemri shpreh cilësi karakterizuese të personazhit, na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me një djalë trupmadh, me shumë tule.

---

emërtimet e personazheve, do të mbeten në errësirë për shumë lexues, edhe të gjuhës angleze, por, veçanërisht edhe për ata që e lexojnë historinë në gjuhën shqipe.

[350] G. Klingberg (1986), cituar në Y. Bertills (2003) *Beyond Identification. Proper Names in Children's Literature.* Åbo Akademi University Press, fq. 196.

d. Drako Mallfoi dhe studentë të tjerë nga Gjarpërblerti

Një personazh i rëndësishëm në seritë Poter është *Drako Mallfoi*, një student në shtëpinë e Gjarpërblertit. Kjo shtëpi është e mbushur me personazhe të tillë që shprehin anët më keqdashëse, lakmitare dhe tallëse të njerëzve, nga të cilët një pasqyrim mjaft i mirë është Drako Mallfoi: një djalë i neveritshëm, të cilit nuk i vjen keq që t'i lëndojë dhe t'i verë në lojë të tjerët. Ai shfaq mospërfillje ndaj të tjerëve që i konsideron inferiorë – studentët që vijnë nga familje që nuk kanë prejardhje magjistarësh, pra, janë thjesht njerëzorë. Drako Mallfoi është në krye të studentëve në shtëpinë e Gjarpërblertëve si dhe udhëheq shokët e tij: *Vincent Crabbe* (Vinsent Tersi) dhe *Gregory Goyle* (Gregor Gojli).

Le të ndalemi fillimisht në domethënien e emrit Drako Mallfoi. Emri në origjinal shfaqet *Draco Malfoy.* Nga Latinishtja *Draco* nënkupton një dragon, gjithashtu emri mund të ketë rrjedhur nga mbiemri *draconic* – i ashpër, i rreptë, mizor.[351] Sic shprehet edhe Otinen, emri mund të na sjellë ndër mend Drakulan apo dragonj[352] – konotacione që janë të kapshme edhe për ata që nuk e njohin gjuhën angleze. *Malfoy* është emër i përbërë: parashtesa *mal-*, që e ka origjinën në frëngjishten e vjetër (*mal*) ose latinishten klasike (*male / malus* – i keq, i sëmurë), si dhe fjala *foy* – që është me përdorim të vjetër për anglishen moderne, edhe pse njihet një nga kuptimet e vjetra të kësaj fjale - "besim, lidhje, nderim". Kështu, *Malfoy* do të zbërthehej "besnikëri apo shoqëri e keqe". Edhe nëse lexuesit e veprës në anglisht nuk do të mund ta kuptonin emrin e përbërë *Malfoy,* sërish ata do të kuptonin se çfarë prirjeje ka një emër i tillë, duke u nisur nga fjalë të tjera në anglisht që përmbajnë parashtesën negative "*mal-*", si për shembull fjala *malice.* Pra, emri dhe përmbajtja semantike e tij janë përbërës shtesë që na ndihmojnë në përcaktimin e identitetit të personazhit: natyra e ashpër dhe mizore e Drakos ndaj studentëve të tjerë, dhe, njëkohësisht, lidhja e tij familjare me Fluronvdekjen (*Voldemort*) e shfaqur në fillim të librit, pasqyrohen dhe përforcohen edhe nëpërmjet emrit të tij. Nëpërmjet një emri me përmbajtje të tillë gjuhësore që dallohet nga emrat e studentëve të tjerë, shkrimtarja gjithashtu tregon se ky personazh i kundërvihet Harrit dhe miqve të tij. Lind pyetja nëse cilësi të tilla arrijnë të transmetohen edhe nëpërmjet emrit të personazhit në gjuhën shqipe.

Në shqip përkthyesi ka zgjedhur të përdorë të njëjtin emër pa e përkthyer, por duke e përshtatur fonetikisht dhe morfologjikisht atë. Megjithatë, lexuesit e librit në gjuhën shqipe mund të dallojnë konotacione të fshehura edhe nën emrin *Drako* – duke menduar per dragonjtë ose thjesht dikë të fortë e mbi të tjerët – edhe nën mbiemrim *Mallfoi* – parashtesa "mal" besojmë se do të zgjojë konotacione negative edhe për lexuesit shqiptarë. Megjithatë, jemi të mendimit se një zbërthim të tillë ka më shumë mundësi që ta bëjnë lexuesit në një moshë më te rritur, ndërsa, për lexuesit më të vegjël, që janë më shumë të prirur të lexojnë dhe analizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë se sa të zbulojnë nënkuptimet e fshehura, do të ishte më mirë që të paktën mbiemri të ishte më domethënës, ndoshta të ishte përkthyer apo zëvendësuar, për shembull, *Drako Keqdashësi.* Sërish, duhet thënë se emri dhe mbiemri i përdorur nga përkthyesi krijon një sfond më anglez rreth personazhit, gjë që nuk do të përcillej me ndryshimin e mbiemrit. Aq më tepër që përkthyesi qëndron koherent në emërtimin e personazheve duke ekuilibrurar jo vetëm prejardhjen e tyre, por dhe mënyrën e shqiptimit të tyre në gjuhën shqipe. Të gjithë këto faktorë na bëjnë ta konsiderojmë edhe një herë punën e përkthyesit

[351] *draconian – very strict and cruel* [C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 472] (shq. shumë strikt dhe mizor).

[352] M.G. Davies, R. Oittinen (ed.s) (2008*) Whose Story? Translating the Verbal and the Visual in Literature for Young Readers*. Cambridge Scholars Publishing, Newcastle, UK, fq. 125.

si një proces vendimmarrjeje, ku domethënia e faktorëve të tillë si publiku marrës, qëllimi i përkthimit, lloji i tesktit ndikon në marrjen e vendimit në lidhje me strategjinë e përdorur gjatë përkthimit.

Emra edhe më tërheqës janë zgjedhur për dy miqtë e Drakos – *Vincent Crabbe* dhe *Gregory Goyle* të cilët ngjasojnë me Drakon në karakter – u pëlqen të tallin të tjerët dhe kanë një pamje që pasqyron ligësi. Emrat e tyre janë pjesë e antroponimisë angleze, ndërsa mbiemrat janë më frymëzues, duke na sjellë të dhëna shtesë për referentët e tyre. Për lexuesit në origjinal, fjala *crab* mund të gjendet lehtë në mbiemrin *Crabbe*, që mund të nënkuptojë ngadalësinë apo mefshtësinë e këtij personazhi. Në fakt, asnjë nga të dy djemtë nuk shquhet për mendjemprehtësi. Nga ana tjetër, emri *Goyle* mund të jetë shkurtimi i *gargoyle,*[353] gjë që theksohet edhe më tepër nga shqiptimi i plotë i emrit *Gregory Goyle* – emri *Gregory* në shqiptim jehon tingullimin e parashtesës së munguar "*gar-*". Në anglisht emri krijon konotacione të diçkaje të shëmtuar, groteske dhe personazhi në fjalë i përshtatet këtij përshkrimi. Të tre personazhet Drako, Tersi dhe Gojli duket të jenë në antitezë me tre personazhet e tjerë - Harri, Hermiona dhe Roni. Përkthyesi ka ndjekur dy strategji të ndryshme në përkthimin e emrave të shokëve të Darkos. *Crabbe* është zëvendësuar me mbiemrin *Tersi*, duke iu dhënë lexuesve më shumë mundësi për të kuptuar cilësi të këtij personazhi që me prezantimin e tij filllestar. Nga ana tjetër, *Goyle* është përshtatur në shqiptim si *Gojli* duke lënë të papërcjella konotacionet e origjinalit.

Përmendim edhe studentë të tjerë të Gjarpërblertit si, *Millicent Bulstrode* (Milisenti Bullstrod), *Pansy Parkinson* (Pansi Parkinson), *Marcus Flint* (Markus Flint), *Terence Higgs* (Terens Higs), *Adrian Pucey* (Adrian Pjusi). Një pjesë e emrave të këtyre studentëve pasqyrojnë cilësi të pakëndshme (gjë që merret si e mirëqenë për të gjithë studentët në këtë shtëpi) ashtu si edhe vetë emri i shtëpisë. Për shembull, Milisent Bullstrodi dhe Markus Flinti përshkruajnë personazhe që janë po kaq të neveritshëm sa dhe vetë emrat e tyre. Mund të duket qartë se këto emra nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe, është përshtatur thjesht shqiptimi, dhe, nga ana tjetër, nuk mund të themi nëse edhe në gjuhën shqipe ato përcjellin nivel të njëjtë konotacioni negativ ashtu si edhe në origjinal. Gjithashtu, nuk mund të lemë pa përmendur edhe faktin se emrat e studentëve në shtëpinë e Gjarpërblertit janë të ndryshëm nga emrat e studentëve të shtëpive të tjera edhe për faktin se përfaqësojnë shmangie nga antroponimia angleze. Kështu, për lexuesit e veprës origjinale, personazhet mund të klasifikohen si të veçantë apo të ndryshëm nga të tjerët edhe duke u nisur thjesht nga fakti që emrat kanë ngjashmëri mes tyre (në shtëpinë e Gjarpërblertit), por dallohen nga emrat e personazheve të caktuar në shtëpitë e tjera (që i përkasin antroponimisë angleze). Megjithatë, nuk mund ta pohojmë me siguri një gjë të tilë për lexuesit e veprës së përkthyer në shqip, sidomos për lexuesit në moshë të vogël, të cilët mund të formojnë një perceptim negativ për personazhet që banojnë në shtëpinë e Gjarpërblertit (nisur edhe nga vetë emri i kësaj shtëpie), por jo domosdoshmërisht nga emërtimi i tyre.

Nisur nga sa shembuj përmendëm më lart, duke reflektuar mbi strategjinë e ndjekur nga përkthyesi në përkthimin e emrave të përveçëm të studentëve, mund të themi se mbizotëron vendimi për të ruajtur emrat e origjinalit, duke ua përshtatur ata rregullave të shkrimit e shqiptimit në gjuhën shqipe. Ky vendim mund të priret si nga dëshira e

[353] Në arkitekturë, *gargoyle* është një skulpturë e gdhendur në mur, me një ulluk për të përcejllë ujin nga një çati dhe për ta nxjerrë dhe për ta nxjerrë jashtë ndërtesës. Zakonisht këra ullukë gdhenden në forma të ndryshme që ngjasojnë me kafshë fantastike. Ky term vjen nga frëngjishtja *gargouille*, që përkthyer në anglisht ka kuptimin "grykë". Skulptura të tilla në formën e kafshëve të frikshme kanë për qëllim të mbrojnë ndërtesa të tilla si kishat nga shpirtra të këqinj apo djallëzorë. [http://en.wikipedia.org/wiki/Gargoyle]

përkthyesit për të përcjellë për lexuesit emra që shërbejnë si shenjues kulturorë (ndërtimi i një sfondi karakteristik britanik dhe ruajtja me koherencë e një sfondi të tillë gjatë gjithë veprës), dhe, njëkohësisht, fakti se pjesa më e madhe e lexuesve do të jenë fëmijë dhe, si të tillë, do të përqëndrohen në atë çka është thënë dhe jo nënkuptuar.

Ne e mbështetim këtë strategji të përdorur nga përkthyesi, duke menduar se sot, si rrjedhojë e vendosjes së kontakteve të ndryshme me shoqëritë perëndimore, jo vetëm të rriturit, por edhe një pjesë e mirë e adoleshentëve dhe fëmijëve, kanë njohuri të mira për gjuhët dhe kulturat e tjera, kështu që nuk jemi të mendimit se përdorimi i emrave të huaj, jotipikë për gjuhën shqipe, do të "krijonte pengesa gjuhësore" për lexuesit e rinj.[354] Kështu, duke e mbështetur strategjinë e përkthyesit për sjelljen në shqip të emrave të huaj, mendojmë se një gjë e tillë, veç të tjerave, ka edhe rol edukativ për lexuesit, duke qenë se përkthyesi iu ofron lexuesve një mundësi për të rritur njohuritë e tyre mbi botën që i rrethon dhe, nëpërmjet leximit të veprës së përkthyer, përmbush edhe një mision tjetër, atë të përhapjes së kulturës britanike për lexuesit shqiptarë.

Megjithatë, në disa raste të veçanta, kur domethënia e (mbi)emrit ka qenë vendimtare për përcaktimin e identitetit të personazhit, përkthyesi ka sjellë mbiemrin karakterizues në gjuhën shqipe, gjë që ndihmon lexuesit për një identifikim dhe kategorizim të menjëhershëm të personazhit. Sipas Kristianë Nordit, nëse rëndësia e emrit si një shenjues kulturor është më e madhe se vlera informative se emrit të ngarkuar semantikisht, ose, në rast se përmbajtja përshkruese e emrit është e fshehtë dhe e nënkuptuar, të dhënat konotative mund të humbasin në tekstin e përkthyer nëse përkthyesi nuk i shpreh këto të dhëna duke i kompensuar në një pjesë tjetër të kontekstit.[355] Në lidhje me emrat e përveçëm që kemi diskutuar, vërejmë se përkthyesi kanë ruajtur emrat në përgjithësi, si dhe një pjesë të emrave me përmbajtje konotative. Një vendim i tillë është krejtësisht i arsyeshëm, për më tepër, nisur edhe nga fakti se përkthimi i një mbiemri kuptimplotë në gjuhën shqipe do të ndërpriste koherencën e përdorimit të emrave të tjerë që ruhen në formën e tyre origjinale. Vendimi për t'i përkthyer emra të tillë domethënës është i justifikueshëm në përkthimin e emrave të studentëve nga shtëpia e *Gjarpërblertit,* meqenëse emrat e këtyre studentëve dallohen edhe në origjinal nga emrat e studentëve të tjerë, kështu që dallimi i tyre mund të sillet si tillë edhe në gjuhën shqipe. Por çfarë do të ndodhë me emra të cilët kanë përmbajtje domethënëse semantike? Le të lexojmë më poshtë.

2. Analizë e emrave të profesorëve dhe stafit në Hoguorts

Në këtë çështje do të përqëndrohemi në analizën e emrave të profesorëve dhe pjesës përbërëse të stafit mësimor në Hoguorts; listën e plotë të emrave mund ta lexoni në pjesën *Shtojca 2* në fund të këtij punimi. Ne do të përqendrohemi në emrat e atyre personazheve që kanë një rol kyç në këtë vepër (si dhe në vazhdimësinë e serisë).

a. Albus Urtimori dhe Minerva MekGur

Dy personazhe kryesorë në serinë e librave Poter janë Drejtori i Hoguortsit – Albus Urtimori (*Albus Dumbledore*) dhe Nëndrejtoresha – Profesoresha Minerva MekGur (*Minerva McGonagall*). Në fakt, të dy këta personazhë janë edhe të parët magjistarë që shfaqen në histori, gjë që thekson edhe më tepër rëndësinë e tyre edhe për personazhin

[354] T. Puurtinen (1995) *Linguistic Acceptability in Translated Children's Literature*. Joensuu: University of Joensuu, cituar në L. Fernandes (2006) *Translation of Names in Children's Fantasy Literature: Bringing the Young Reader into Play*. Në *New Voices in Translation Studies 2 (2006), 44-57,* fq. 48.

[355] C. Nord (2003) *Proper Names in Translations for Children: Alice in Wonderland as a Case in Point*. Meta: Journal des Traducteurs / Meta: Translators' Journal, vol. 48, n° 1-2, 182-196, fq. 182.

kryesor si dhe rishfaqjen e tyre në serinë Poter, duke ofruar siguri dhe qëndrueshmëri mes fëmijëve, veçanërisht Urtimori, i cili shndërrohet në një prind zëvendësues për Harrin, edhe pse në largësi.

Albus Urtimori, në vazhdimësinë e magjistarëve të tjerë në traditën letrare, ashtu si dhe Merlini, ka rolin e dyfishtë të një magjistari të fuqishëm si dhe të një burri të zgjuar që i qëndron pranë heroit dhe e mbeshtet atë gjatë rritjes. Pamja e tij plotësohet me detaje të tilla si: "*i gjatë, shumë i vjetër, me flokë dhe mjekër të argjendtë*". Gjithashtu ai mban edhe syze në formë gjysëm hëne si dhe vesh rroba të gjata magjistari. Ashtu si edhe magjistarë të tjerë të traditës letrare, ai ka një emër domethënës: *Albus Percival Wulfric Brian Dumbledore* në formën e tij të plotë. Emri *Percival* krijon lidhje me legjendat arturiane, nisur nga fakti që *Percival* ishte një kalorës në trupën e mbretit Artur. Pra, Urtimori përfaqëson në shumë mënyra magjistarin tipik në qendër të imagjinatës së lexuesve.

Personaliteti i Urtimorit shfaqet më së miri në emrin e tij në origjinal, gjë që do të ketë ndikuar edhe në vendimin e autorit për ta zëvendësuar këtë emër pjesërisht për lexuesit në gjuhën shqipe. Le ta analizojmë filimisht emrin ashtu siç shfaqet në origjinal. *Albus* (nga lat. "i bardhë") mund t'i referohet flokëve të argjendta të personazhit, por njëkohësisht edhe rolit të tij për të mbrojtur të mirën, duke iu kundërvënë magjistarit të forcave të errëta Fluronvdekjes, për të cilin do të diskutojmë më vonë. Nga ana tjetër, mbiemri *Dumbledore* është një fjalë që i përket anglishtes së vjetër dhe që përdorej për fjalën e sotme *bumblebee*,[356] - ky emër është zgjedhur nga shkrimtarja sepse ajo "gjithmonë e imagjinonte këtë personazh duke folur me vete".[357] Megjithatë, studiuesja Otinen mendon se ky mbiemër i referohet një blete të artë (duke e zbërthyer kompozitën në *bumble* dhe *d'or* – nga frëngjishtja).[358] Këto interpretime të ndryshme na bëjnë të kuptojmë se gjetja e (nën)kuptimeve të mundshme nuk është gjithmonë një proces i lehtë dhe i qartë, në fakt, "*nuk mund të themi asnjëherë me siguri se pse një emër i veçantë me një përmbajtje të caktuar i është dhënë një personazhi të caktuar*"[359] – ne thjesht mund të hamendësojmë.

Kuptimet etimologjike dhe semantike nën emrin *Albus Dumbledore* mund të mos hapen lehtësisht, veçanërisht për lexuesit e vegjël. Kështu, aspekti semantik i emrit nuk është parësor, dhe rëndësi fillestare marrin konotacionet e shkaktuara nga një emër i pazakontë ose tingëllimi i tij. Në përkthim shohim se është ruajtur emri si në origjinal, dhe është zëvendësuar mbiemri me *Urtimorin.* Të dhënat e nënkuptuara të emrit nuk përcillen për lexuesit e vegjel të veprës në gjuhën shqipe, thjesht ruhet tingëllimi i veçantë i një emri të përshtatshëm për një magjistar. Mbiemri, nga ana tjetër, sjell pjesërisht konotacionet e origjinalit, duke indentifikuar që prej emrit një personazh të urtë e të ditur. Ky emërtim i tillë shërben edhe për të distancuar Urtimorin nga personazhet e tjerë që i përkasin botës së babanacëve. Ashtu siç shprehet edhe Nensi Jenç (Nancy K. Jentsch): "*kundërvënia e botës magjike dhe reale është me shumë rëndësi për tekstin origjinal dhe duhet të merret seriozisht në konsideratë nga përkthyesit. Kështu, përkthyesi duhet të vendosë jo vetëm se si të përkthejë, por edhe se kur të përkthejë dhe*

---

[356] *bumblebee – a large, hairy bee* [C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 194] (shq. një bletë e madhe leshtore që bën shumë zhurmë kur fluturon).

[357] C. Lydon,. J.K. Rowling intervistë dhënë The Connection (WBUR Radio), 12 tetor 1999.

[358] M.G. Davies, R. Oittinen (ed.s) (2008*) Whose Story? Translating the Verbal and the Visual in Literature for Young Readers*. Cambridge Scholars Publishing, Newcastle, Uk, fq. 123.

[359] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification. Proper Names in Children's Literature.* Åbo Akademi University Press, fq. 208.

kur t'i lerë fjalët ashtu siç janë në origjinal".[360] Mendojmë se zgjedhja e përkthyesit për të përdorur *Albus Urtimor* në gjuhën shqipe është e justifikueshme dhe e arsyeshme, sepse përcjell njëkohësisht veçanësinë e emrit në origjinal, dhe, nga ana tjetër, identifikon cilësitë e personazhit, duke e distancuar atë, edhe nëpërmjet emërtimit, nga personazhet e tjera të botës së babanacëve.

Përmbajtja potenciale semantike nën emrin *Minerva McGonagall* mund të mbetet e pazbuluar për shumë lexues. Rouling është shprehuar se ajo e ka emërtuar profesoreshën e *Ndërrimit të Pamjes* (*Transfiguration*) sipas poetit skocez *William McGonagall*, emrin e të cilit ajo e pëlqente shumë.[361] Kështu që në këtë rast ka më shumë rëndësi tingullimi i emrit se sa vlera semantike e tij; për më tepër, emri gjithashtu tregon se profesoresha në fjalë ka origjinë skoceze, gjë që theksohet edhe më tepër nga detaje të tilla si veshja e saj. Në përkthimin në gjuhën shqipe ruhet emri siç është në origjinal, ndërsa mbiemri transformohet nëpërmjet procedurës së zëvendësimit – *McGonagall – MekGur*. Pra, emri është pjesërisht i përshtatur dhe pjesërisht i zëvendësuar, duke ruajtur parashtesën skoceze *Mek*, dhe duke sjellë nëpërmjet pjesës së dytë të mbiemrit një cilësi të përsonazhit, ndoshta duke aluduar për aftësitë ndërruese të pamjes – lënda që kjo profesoreshë zhvillon me studentët në Grifart.

b. Severus Pitoni

Një nga personazhet më tërheqës në vepër (dhe në gjithë serinë) është profesor Severus Pitoni (ang. *Professor Severus Snape*) që zhvillon lëndën Shurupet (*ang. Potions*) dhe që është drejtor në shtëpinë Gjarpërblertit. Ai përshkruhet që herët si një njeri aspak i këndshëm, si në pamje, ashtu edhe në sjellje. Përshkrimi fillestar e kategorizon si një njeri me flokë e sy të zinj dhe hundë të kërrusur; si mësues, ai është strikt dhe nuk kursehet për t'i poshtëruar studentët apo për t'i fyer ata nëse nuk do të arrijnë dot standardet e vendosura prej tij. Këto karakteristika janë edhe më të theksuara në sjelljen e tij ndaj Harrit, të cilin Pitoni nuk e duron dot që në fillim të ngjarjeve, kjo duket qartë në mënyrën se si qëndron dhe sillet me të, për shembull, duke e dënuar Harrin për mungesën e njohurive apo thjesht për veprime që nuk i ka bërë. Për këto arsye mund ta konsiderojmë Pitonin si antagonist të Urtimorit.

Nëse do ta studionim më nga afër emrin në origjinal të këtij personazhi – *Severus Snape*, do të gjejmë disa aspekte të sipërpërmendura që pasqyrohen të fshehura edhe në emër. Emri vjen drejtpërsëdrejti nga latinishtja *severus – severe* (ang.) – i, e rreptë; mbiemër për të cilin jepen këto kuptime nga fjalori ang-ang: shumë serioz, i vështirë, i mërzitshëm, jo miqësor.[362] Kuptimet e mësipërme përputhen me idenë që krijohet edhe gjatë leximit më të thellë të ngjarjeve që përfshijnë këtë personazh. Mbiemri *Snape* e thekson edhe më tepër imazhin e krijuar; folja *snape* do të thotë të jesh i ashpër, të dëmtosh, të lëndosh, etj. Ky kuptim është i vjetër në anglishten moderne, gjithashtu, mbiemri është i ngjashëm në shkrim dhe shqiptim me *snake* (ang. – gjarpër), që jo vetëm na krijon konotacione negative mbi personazhin, por edhe e lidh emrin e përzgjedhur me postin e tij si drejtor në shtëpinë e Gjarpërblertit (ang. *Slytherin*). Vetë emri i shtëpisë në anglisht do të zbërthehej në *sly* (dinak) dhe *slither* (rrëshqas), që përfaqësojnë cilësi të studentëve të kësaj shtëpie si dhe të drejtorit të tyre, për më tepër, edhe emblema e

[360] N. K. Jentsch (2002) *Harry Potter and the Tower of Babel. Translating the Magic*. Në L. A. Whited (ed.) (2002) *Ivory Tower and Harry Potter: Perspectives on a Literary Phenomenon*. Columbia: University of Missouri Press, fq. 285–301, fq. 286.

[361] C. Lydon,. J.K. Rowling intervistë dhënë The Connection (WBUR Radio), 12 tetor 1999.

[362] *severe – very serious, difficult, plain, unfriendly* [C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 1503.]

shtëpisë përfaqëson një gjarpër. Kur kujtojmë që forma e emrit dhe përmbajtja semantike mund t'i shtojë më shumë aspekte kuptimore emrit,[363] për këtë personazh mund të pohojmë me plot gojë se është një trupëzim që në emër i cilësive që mbart: ashtu siç sugjerohet nga emri, është i ashpër dhe i rreptë në mënyrën se si sillet me të tjerët, dhe, ashtu siç sugjerohet nga mbiemri, ai i poshtëron të tjerët, duke bërë që të krijohet një përshtypje e ftohtë dhe negative për të – ashtu si edhe për një gjarpër. Mund të themi, pra, se ka shumë shtresa kuptimi, si në nivel semantik, ashtu edhe në atë konotativ, të fshehura nën emrin e përzgjedhur për këtë personazh, të cilat zbulohen gjatë kontaktit të parë me emrin, e, më thellë, gjatë leximit të veprës.

Në veprën e përkthyer në gjuhën shqipe, emri i këtij perzonazhi vjen pjesërisht i zëvendësuar – *Severus Pitoni.* Mendojmë se përkthyesi ka bërë një zgjedhje të zgjuar, që ecën paralel logjikës së origjinalit. Ruajtja e emrit ashtu siç shfaqet në origjinal, me emrin në latinisht – *Severus* – është një vendim i përshtatshëm, duke vazhduar në të njëjtën linjë me emërtimin e *Albus Urtimorit, Rubeus Hagridi* ku emri lihet i pandryshuar. Pavarësisht se emri mund të mos kuptohet nga lexuesit e vegjël, sërish arrihet të përçohen cilësitë e një personi të rreptë, me aftësi magjie të errët, veçanërisht në kombinim edhe me mbiemrin *Piton* – që lexuesit do ta identifikojnë me një lloj gjarpri, rrjedhimisht, një personazh negativ, i neveritshëm, i prirur për t'iu bërë keq të tjerëve. Mbiemri vjen i përshtatur edhe me emrin si dhe me emblemën e shtëpisë që ky profesor përfaqëson – *Gjarpërblerti.*

c. Stafi përbërës në Hoguorts

Edhe shumë profesorë të tjerë brenda stafit në Hoguorts kanë emra që përfaqësojnë përmbajtjen semantike ose përshkruajnë cilësi të personalitetit të tyre ose lëndën që japin në shkollë. Për shembull, nëse do të analizonim emrat duke shpjeguar logjikën e emërtimit të tyre në anglisht, do të përmendnim shembuj të tillë si: *Professor Sprout (Herbology),* për të cilin në shqip gjejmë emërtimin *profesor Bifka (Shkenca e Barërave).* Nga fjalorët anglisht-anglisht dhe anglisht-shqip gjejmë këto të dhëna që na bëjnë ta lidhim emrin me fushën e botanikës: *sprout* në fjalorin anglisht-anglisht dëshmon për lidhjen një perim të vogël të gjelbër të ngjashëm me lakrën apo një rritje të bimëve.[364]

Nisur nga krahasimet mes emërtimeve mund të vërejmë se janë përshtatur në shqiptim dhe transkriptim emra të tillë si: *Rubeus Hagrid* (Rubeus Hagrid), *Doris Crockford* (Doris Krokford), *Professor Binns* (profesor Binsi), *Professor Flitwick* (profesor Flituiku); ndërkohë që është ndjekur një strategji e ndryshme për emra të tillë si *Professor Quirrell* (Profesor Grepsi), *Argus Filch* (Zoti Argus Laraska – rojtari) për të cilët zëvendësohet mbiemri, duke na sjellë cilësi karakterizuese të vetë personazhit. Duket se përkthyesi është kujdesur të përcjellë cilësi të personazheve që janë më domethënës dhe rishfaqen në vepër, në krahasim me personazhe kalimtarë, duke mos dashur të rëndojë logjikën dhe kujtesën e lexuesve (kryesisht fëmijëve). Le të shohim më nga afër disa prej emrave.

Rojtari *Argus Filch* (Argus Laraska) është një personazh të cilin shumë prej studentëve e kanë frikë sepse ai është i fiksuar pas disiplinës dhe rregullit, vërtitet rreth shkollës duke u përpjekur t'i kapë keqbërësit "me presh në dorë", dhe është gjithmonë i gatshëm të marrë masa disiplinore dhe t'i dënojë studentët rëndë edhe për shkelje të vogla. Emri i tij i përshtatet personalitetit të tij dyshues: *Argus* është "një njeri mitologjik

[363] Y. Bertills (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press, fq. 55.

[364] *sprout – a small green vegetable like a very small cabbage; a new growth on a plant* [[C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 1604].

që thuhet se ka njëqind sy, pra, personalizon një njeri vigjilent, një rojtar, ose një mbikqyrës". Mbiemri *Filch* [*flich* – ang. (slang) vjedh) përfaqëson zakonin e tij për të konfiskuar çdo gjë që mund të përdoret në mënyrë të dyshimtë nga studentët. Ky personazh, pra, është një shembull tjetër i përfaqësimit të cilësive nëpërmjet emrit dhe anasjelltas. Në përkthimin në gjuhën shqipe, ruhet emri *Argus*, duke sjellë sërish logjikën e emërtimit ashtu si edhe për personazhe të tjerë si *Albus*, *Minerva*, *Rubeus*, *Severus*, ndërsa për mbiemrin, nëpërmjet zëvendësimit, përdoret një emër karakterizues i cilësive të lartpërmendura, të fshehura nën mbiemrin *Laraska.* Mendojmë se për lexuesit në gjuhën shqipe arrijnë të përcillen konotacione disi negative dhe njëkohësisht karakterizuese për personazhin në fjalë – i kudogjendur, si rojtar që është, dhe si një hije që ndjek sutudentët dhe i dënonë ata. Njëkohësisht, edhe titulli *Zoti* i përdorur në fillim të emrit i shton personazhit një hije respekti, gjë që, në fakt, nuk ndihet shumë nga studentët.

Një tjetër emër ilustrues për nga përmbajtja semantike është *madamë Pomfri* emërtuar në anglisht *nurse Madam Poppy Pomfrey*. Emri *Poppy* është një emër i thjeshtë me përmbajtje leksikore, ndërsa mbiemri shfaq lidhje me *comfrey* – një bimë që ka përdorim mjekësor, si për shembull, për kurimin e plagëve.[365] Përdorimi i një emri të tillë në anglisht aludon për një personazh me aftësi kuruese, ndërsa emri në gjuhën shqipe vjen thjesht i përshtatur sipas parimit fonetik, duke iu shtuar radhës së personazheve me sfond britanik nga mënyra e tingëllimit të tyre.

Zbulimi i potencialit të kuptimit në emrin e rojes së Hoguortsit *Rubeus Hagrid* nuk është një proces shumë i thjeshtë, meqenëse emri fsheh disa nënkuptime që nuk shfaqen qartë. Mbiemri mund të interpretohet si një fjalë dialektore *hag-rid* ose *hag-ridden*, që do të thotë "të kesh shqetësime apo të ndikohesh keq nga ëndrrat e këqija.[366] Kështu, ky mbiemër përfaqëson një cilësi qëndrore të personazhit; edhe vetë shkrimtarja është shprehur: *Hagrid është një pijanec i pandreqshëm – ai kalon shumë net të vështira.*[367] Kemi të bëjmë, pra, me një emër që jo vetëm identifikon cilësi të personazhit, por, që, njëkohësisht, e përshkruan mjeshtërisht referentin në fjalë. Emri, siç mund ta vemë re, është ruajtur gjatë përkthimit të veprës, duke bërë që të dhënat e sipërpërmendura të mos përcillen për lexuesit në gjuhën shqip, megjithatë, duhet thënë se as një pjesë e mirë e lexuesve në origjinal nuk mund t'i marrin këto të dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në këtë drejtim, e shohim të arsyeshëm vendimin e përkthyesit për të identifikuar rojen e çelësave dhe vendeve në Hoguorts me të njëjtin emër si në origjinal *Rubeus Hagrid.*

Në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm Van Koilli (Van Coillie) shprehet: "*Ndryshimi në funksionimin e emrave është më i madh kur përkthyesi le* ***pa përkthyer emra të shpikur që kanë konotacione të veçanta****. Nëse emri i referohet një cilësie të personazhit apo profesionit të tij (siç ndodh shpesh në librat për fëmijë) imazhi që krijohet në mendjen e lexuesit është i ndryshëm dhe emri mund të mos ketë të njëjtin efekt emocional apo zbavitës. Nëse konotacioni është më i fshehtë (për shembull, nëse përbëhet nga një lojë fjalësh) efekti nuk do të përcillet për lexuesin që nuk e njeh gjuhën origjinale, dhe, njëkohësisht, lexuesi nuk do të ndiejë kënaqësinë intelektuale të identifikimit të*

[365] *comfrey*, Encyclopaedia Britannica 2010. *Encyclopaedia Britannica Online* [online]. http://search.eb.com/eb/article-9024932.

[366] Oxford English Dictionary (2014) Oxford University Press, fq. 1684. [http://www.oed.com/view/Entry/83256?redirectedFrom=hag-rid#eid]

[367] C. Lydon,. J.K. Rowling intervistë dhënë The Connection (WBUR Radio), 12 tetor 1999.

tij".[368] Le të shohim se sa të zbatueshme janë këto fjalë në strategjitë e përkthimit ndjekur nga përkthyesi në rastet e analizuara.

Në krahasim me emrat e studentëve, emrat e stafit nuk përcjellin të dhëna kulturore, por kanë më tepër konotacione "magjike", duke i përshkruar referentët më shumë se ç'do të bënte një emër i përzgjedhur në mënyrë rastësore. Emrat pasqyrojnë personazhet në një kontekst të veçantë dhe, në shumicën e rasteve, edhe lëndën që ata zhvillojnë me studentët. Një mënyrë emërtimi e veçantë, njëkohësisht, shërben edhe për t'i bashkuar personazhet në veçanësinë e tyre – të qenurit magjistarë. Për këtë arsye emrat e tyre janë të ndryshëm nga antroponimia britanike, dhe, rrjedhimisht, edhe nga bota e babanacëve. Emrat e personazheve janë të krijuar nga shkrimtarja dhe nuk ekzistojnë në onomastikën reale, janë emra që kanë përmbajtje shprehëse dhe semantike të nënkuptuar. Nga emrat dhe mbiemrat e analizuar në këtë kategori, është përdorur kryesisht procedura e përshtatjes sipas parimit fonetik për emrat, dhe procedura e zëvendësimit të mbiemrave sipas cilësive karakterizuese të personazhit (p.sh. *Urtimor, MekGur, Grepsi, Pitoni, Bifka, Laraska*), ndërkohë që janë lënë të pandryshuar dhe janë përshtatur thjesht fonetikisht mbiemrat e tjerë (p.sh. *Pomfri, Hagrid, Krokfordi, Binsi, Flituiku, Huku*), duke mos përcjellë nënkuptimet e fshehura në origjinal, të cilat, vështirë se do të gjendeshin edhe për lexuesit në origjinal.

3. Analizë e emrave të magjistarëve të tjerë

Pasi kemi analizuar emrat e stafit të Hoguortsit dhe të studentëve, në këtë pjesë të punimit do të ndalemi në llojet e emrave të përzgjedhur për magjistarët e tjerë dhe mënyrës së përkthimit të tyre. Do të ndalemi fillimisht në analizimin e magjistarit të cilit i tremben të gjithë – *Lord Voldemort.* Më pas, do t'i kushtojmë vëmendje personazheve më pak qëndrorë si dhe emrave të shkrimtarëve të librave të studimit të Hoguorts. Edhe pse këta të fundit nuk shfaqen asnjëherë si personazhe veprues, emrat e tyre janë të ngarkuar semantikisht dhe jemi të interesuar të shohim se çfarë ndodh me ta gjatë përkthimit.

a. Fluronvdekja dhe mbështetës të tij

Një nga personazhet më domethënës në të gjithë serinë Poter është *Lord Voldemort* – magjistari më keqbërës i gjithë kohërave, i cili ka bërë përpjekje për të marrë fuqi magjike nëpërmjet Forcave të Errëta, duke torturuar dhe vrarë babanacë dhe magjistarë të tjerë. Në fillim të librit shpjegohet se si është mundur që ky magjistar (edhe pse mallkimi i tij drejtuar Harrit nuk u përmbush por iu kthye drejt vetes), nuk vdiq, vetëm sa humbi formën e tij njerëzore. Më shumë në trajtën e një shpirti se sa një njeriu, ai trupëzohet brenda një magjistari tjetër. Edhe pasi ka pësuar disfatë, të gjithë vazhdojnë ta kenë frikë këtë personazh, aq sa shmangin edhe thënien e emrit të tij, duke përdorur një sërë eufemizmash si: *You-Know-Who, He-Who-Must-Not-Be-Named* (Ti-E-Di-Kushi, Ai-Që-S'Duhet-Përmendur). Vetëm Harri dhe Urtimori përdorin me guxim emrin e tij të vërtetë *Voldemort – Fluronvdekje.* Shumësia e emrave të këtij personazhi tregojnë edhe metamorfozën e zhvillimit të tij. Duke shqyrtuar më nga afër emrin *Voldemort* do ta ndanim atë në tri pjesë: *vol, de, mort.* Nisur nga fjalët *mort* (fr. vdekje) dhe *vol* (fr. vjedhje ose fluturim), arrijmë në përfundimin se *Voldemort* nënkupton "vjedhje e vdekjes" ose "fluturim nga vdekja". Nëse sjellim ndërmend se ky personazh, në fillim të librit, pas një mallkimi për vdekje, nuk u vra por thjesht pësoi një disfatë, emri mund të nënkuptojë që ai ka gjetur një mënyrë për të shmangur vdekjen, pra, në një farë mënyrë, e ka sfiduar vdekjen, i ka vjedhur asaj fuqitë. Edhe pse këto nënkuptime fshihen pas

[368] J. Van Coillie, W. P. Verschueren (eds.) (2006) *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 125.

origjinës në frëngjisht të emrit, përkthyesi ka vendosur ta zëvendësojë në gjuhën shqipe, duke përcjellë të njëjtat konotacione, madje duke i qartësuar edhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë ato, nën emrin *Fluronvdekje* – duke nënkuptuar dikë që fluturon nga vdekja, që i shmanget vdekjes, që e sfidon atë. Emri i përshatur i nënshtrohet rregullave të gjuhës shqipe, sa herë që përdoret në vepër shfaqet në përputhje me kategorinë e shquarsisë. Njëkohësisht, edhe eufemizmat e përdorura në anglisht – *You-Know-Who, He-Who-Must-Not-Be-Named* – përkthehen duke ruajtur të njëjtën logjikë emërtimi në gjuhën shqipe – Ti-E-Di-Kushi, Ai-Që-S'Duhet-Përmendur – duke ruajtur edhe përdorimin e shkronjës së madhe. Kështu, si emri, ashtu edhe eufemizmat përcjellin edhe në gjuhën shqipe konotacione të ngjashme me origjinalin: kanë ngarkesë semantike, shprehin cilësi që karakterizojnë personazhin, ofrojnë lojëra fjalësh që mbështesin edhe magjinë brenda magjistarit.

Një emër tjetër përfaqësues është *Cornelius Fudge – Minister of Magic* (shq. Kornelius Gjelsheqeri – Ministria e Magjisë). Emri *fudge* mund t'i referohet sheqerit velës të embëlsirave, ndërsa folja me të njëjtën formë mund t'i referohet shmangies së çështjeve problematike ose falsifikimit apo manipulimit të gjërave[369]. Këto kuptime e karakterizojnë këtë personazh të cilit i pëlqen të qenurit në post të lartë, që sillet në një mënyrë "të sheqerosur" por që edhe ka aftësi për të shmangur temat e pakëndshme, duke refuzuar të njohë faktet dhe duke shpërndarë të dhëna të pasakta. Një emër i tillë "polisemantik" nuk është lehtësisht i transferueshëm në gjuhë tjetër. Përkthyesi përshtat emrin dhe zëvendëson mbiemrin *Fudge – Gjelsheqeri*, duke ruajtur konotacionet që krijojnë asosacione me diçka të ëmbël (madje edhe duke e përshtatur me një ëmbëlsirë karakteristike shqiptare), si dhe duke lënë pas nënkuptimet e manipulimit dhe shmangies së problemeve.

Një nga personazhet jo kryesorë ka një tjetër emër domethënës *Sirius Black* (shq. Sirius Blek) – ai është një vrasës i rrezikshëm në mbështetje të Fluronvdekjes. *Sirius* (Ylli i Qenit) i referohet yllit më të shndritshëm në konstelacionin *Canis Major* – në fakt, ky personazh, falë aftësive të tij të veçanta, mund të shndërrohet në një qen të madh e të zi; *Black* – edhe një herë shërben për të theksuar konotacionet negative si dhe imazhin e shndërrimit në një qen të zi. Në gjuhën shqipe përdoret procedura e përshtatjes. Emri *Sirius* nuk sjell konotacione në gjuhën shqipe, ndërsa mbiemri *Blek* thjesht mund t'iu sjellë ndërmend lexuesve imazhe të errëta e negtive. Informacioni plotësues në gjuhën shqipe është më i pakët, megjithatë, duhet thënë se, edhe në gjuhën angleze, të rrallë janë lexuesit që arrijnë të zbulojnë çdo synim të paramenduar të shkrimtares.

b. Personazhet jo kryesorë

Në vepër përmenden edhe një sërë personazhesh që nuk janë qëndrorë në zhvillimin e ngjarjeve dhe mund të shfaqen vetëm një herë. Edhe pse personazhe të tillë nuk janë me interes në linjën e historisë, shumica e tyre kanë emra që kanë ngarkesë semantike dhe kanë funksion zbavitës ose identifikues. Një pjesë e tyre janë përkthyer dhe një pjesë janë ruajtur si në origjinal. Përmendim përkatësisht disa shembuj të emrave që janë përkthyer ose zëvendësuar: *Dedalus Diggle* – Dedalus Luksi, *Nearly Headless Nick* – Niku-Zëre-Pa-Kokë, *Bloody Baron* – Baroni Gjakatar, *Peeves, a poltergeist* – Ngaci, një Poltergeist, *Emetic the Evil and Uric the Oddball* – Emeriku i Lig dhe Urik Kokëmarri, *Wizard*

[369] *fudge (n.) – a soft creamy brown sweet food* [C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 652)] (shq. një ushqim kremoz, i butë, me ngjyrë kafe); *fudge (v.) – to avoid giving exact details or a clear answer about something* [C. Fox, E. Manning, M. Murphy, R. Urbom, K. C. Marwick, S. O'Shea, (ed.s) *Longman Dictionary of Contemporary English* (2003), Pearson Education Limited, fq. 652] (shq. të shmangësh dhënien e hollësive konkrete apo përgjigjes së qartë për diçka).

Baruffio – Magjistari Kacafyti, *Common Welsh Green and Hebridean Blacks* – Dragoi i Blertë i Uellsit dhe i Ziu i Ishujve Hibride, *Norbert, the Norwegian Ridgeback* – Norberti, dragoi kurrizrrudhur i Norvegjisë*;* si dhe disa emra të përshtatur: *Nicolas Flamel* – Nikolas Flamel, *Mr. Ollivander* – Zoti Ulliander, *Hengist of Woodcroft* – Hengisti, xhuxhi i pyjeve, *Alberic Grunnion* – Alberik Grunioni, etj. Duket se përkthyesi ka ndjekur procedura të ndryshme në varësi të shkallës së përcjelljes së domethënies së emrit në origjinal (nisur nga rëndësia që vetë shkrimtari i ka kushtuar kësaj të fundit).

c. Emrat e autorëve të librave të studimit

Këta emra na ofrojnë një material interesant analize, në origjinal ata kanë emra domethënës që kanë lidhje edhe me librat e shkruar prej tyre. Le të shohim se çfarë ndodh gjatë përkthimit.

Ndoshta është pikërisht ngaqë emrat janë krijuar për të qenë zbavitës edhe arsyeja pse përkthyesi ka përkthyer një pjesë të mirë të tyre. Ashtu siç shprehet edhe Jan Van Kolli, "*Veçanërisht në përrallat me fantazi dhe historitë humoristike, përkthyesit i kushtojnë vëmendje parësore kënaqësisë gjatë leximit. Ata shpesh përkthejnë më lirisht, gjë që iu jep më shumë mundësi që të shprehin lirisht krijueshmërinë dhe humorin e gjallë*".[370] Në këtë këndvështrim, është e logjikshme që, nga nëntë emra të përmendur, janë zëvendësuar gjashtë prej tyre dhe janë përshtatur sipas parimit fonetik tre të tjerë. *Adalbert Waffling***,** për shembull, shkrimtari i Teorisë së Magjisë, në gjuhën shqipe prezantohet si Adalbert Yshti – duke nënkuptuar dikë që i përket kësaj fushe të çuditshme. Gjithashtu, *Emeric Switch* **–** shkrimtari i Udhëzuesit praktik të shndërrimit për fillestarë – vjen nën emrin Emerik Zoti**,** që na le të kuptojmë se, ashtu si dhe përmbajtja e librit (shndërrimi nga diçka në diçka tjetër) ashtu edhe mbiemri, tregojnë për aftësitë e shkrimtarit për t'u vendosur në rolin e Zotit duke pasur fuqi çudibërëse. Mbiemri i shkrimtarit, si në origjinal, ashtu edhe në përkthim, është i lidhur në mënyrë të ndërsjellë me librin e shkruar prej tij dhe fuqitë e nënkuptuara që ai zotëron. Një tjetër shembull përfaqësues është *Phyllida Spore* – shkrimtarja e librit mbi barnat dhe kërpudhat magjike – në shqip me emrin Filida Spori**,** duke prodhuar përsëri një emër që ka lidhje me fushën e botanikës. Në po këtë mënyrë, besojmë, vazhdon arsyetimi edhe për *Arsenius Jigger* **–** Arsenius Lëngus (për librin Çaje dhe shurupe të ndryshme), si dhe *Quentin Trimble* – Dante Dredhësi (Udhëzues për forcat e errëta). Në të gjitha këto raste është riprodhuar në gjuhën shqipe funksioni zbavitës dhe nënkuptues i mbiemrave të shkrimtarëve, gjë që na bën edhe një herë të reflektojmë mbi rëndësinë parësore të funksionit si një kriteret bazë të procesit të vendimmarrjes gjatë përkthimit.

Pjesa më e madhe e emrave të shqyrtuar në këtë çështje janë me përmbajtje semantike dhe nënkuptime brenda botës së magjisë. Përmbajtja semantike e tyre në disa raste është pak a shumë transparente dhe kontribuon edhe në zhvillimin e ngjarjeve, ndërsa në raste të tjera emri është krijuar thjesht për arsye zbavitëse. Gjatë përkthimit, do të luajë një rol vendimtar në ruajtjen apo rikrijimin e një emri pikërisht shkalla e nxjerrjes së kuptimit të shprehur ose të nënkuptuar në origjinal si dhe fakti nëse funksioni dhe efekti i transmetuar në origjinal do të përcillet në gjuhën shqipe. Në pjesën më të madhe të shembujve në shqyrtim, vërejmë se përkthyesi është treguar i kujdesshëm për të rindërtuar efekte të ngjashme me origjinalin, pa rënduar logjikën dhe kujtesën e lexuesve fëmijë, por, kryesisht duke i zbavituar dhe informuar ata. Mund të themi, pra, se lexuesit përfitojnë shumë të thëna e të nënthëna të origjinalit, që janë qartësuar për ta.

4. Analizë e emrave të tjerë

a. Emrat e familjarëve

Nisur nga tërësia e shembujve të dhënë, mund të mendohet se shkrimtarja Rouling ka krijuar emra të veçantë dhe semantikisht shprehës për të gjithë personazhet magjikë. Megjithatë, janë edhe disa magjistarë me emra normalë në libër, si, për shembull, prindërit e Harrit – Lili dhe Xhejms Poteri (ang. *Lily* dhe *James Potter*) si dhe anëtarët e familjes Uezli (ang. *Weasley*). Edhe pse këta personazhë janë po kaq magjikë sa edhe

[370] J. Van Coillie, W. P. Verschueren (eds.) (2006) *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 135-136.

pjesa tjetër magjistarëve që kemi diskutuar, ata kanë një lidhje më të fortë me botën "normale" dhe jetën e Harrit jashtë Hoguortsit, dhe përzgjedhja e emrave "normalë" shërben për ta parathënë dhe theksuar këtë lidhje. Një emër si *Albus Urtimori* thekson qartë aspektet magjike të personazhit, ndërsa një emër si *Artur Uezli* apo *Xhejms Poter* ka një tingëllim më të zakonshëm, më realist, si dhe krijon më shumë lidhje me kontekstin britanik të historisë. Emra të tillë janë përshtatur sipas parimit fonetik. Një listë të plotë të tyre mund ta gjeni në pjesën *Shtojca 2*. Le të japim disa shembuj ilustrues: *Petunia* – Petunia, *Dudley* – Dadli, *Jim McGuffin* – Xhim MekGafini, *Uncle Vernon* – Xhaxha Vernoni, *Auntie Marge* – hallë Marxhi, *Great Uncle Algie* – Stërungji Alxhi, etj.

b. Adresa ekzistuese dhe të shpikura

Emra që iu referohen adresave reale ose janë përkthyer me përkatëset e tyre në gjuhën shqipe, referentë të njohur për lexuesit në gjuhën shqipe (p.sh. *London* – Londër, *Romania* – Rumani), ose thjesht janë përshatur (p.sh. *Privet Drive* – Privet Draijv, *Paddington Station* – Padington Steshjon, *King's Cross* – King's Kross). Nga ana tjetër, për emrat që iu referohen adresave joekzistuese në mjedisin britanik, të krijuara qëllimisht nga autorja për të shprehur nënkuptime kontekstuale, përkthyesi herë bën zëvendësim me një emër që sërish shpreh nënkuptime edhe në gjuhën shqipe (p.sh. *Smeltings* **–** Snobkin – shkolla private; *a shop called Flourish and Blotts* – një dyqan që quhej Shkarravina), herë përshtat vetëm shqiptimin (p.sh. *Diagon Alley* – Diagon Alli*; Grunnings* – Grunings*; Stonewall High* – Stonuoll Haj).

Përsa i përket shkollave ku studiojnë magjistarët e vegjël shohim përkatësisht këto çifte korrespondues anglisht-shqip: *Gryffindor* – Grifarti*; Hufflepuff* – Baldoskuqi*; Ravenclaw* – Korbziu*; Slytherin* – Gjarpërblerti. Në gjuhën angleze emrat e shtëpive janë zgjedhur sipas emrave të themeluesve të tyre *Godric Gryffindor, Rovena Ravenclaw, Helga Hufflepuff,* dhe *Salazar Slytherin.*

E mbyllim këtë diskutim duke shprehur mendimin e përkthyesit Kasoruho që e gjejmë shumë me vend në këtë drejtim: *Të përkthesh është art, është të rikrijosh, të japësh në një trajtë të re diçka që ndryshe do të mbetej e panjohur për një pjesë lexuesish... Të përkthesh është t'i japësh një jetë të re dhe një mjedis të ri, një vlere të krijuar në rrethana dhe kohë të tjera, duke ruajtur* ***dëshirat e dukshme apo të fshehura që ka vënë në të krijuesi i saj.*** *Kërkon mjeshtëri, pa qenë e tillë.*[371]

5. Përfundime në lidhje me strategjitë e përdorura në rastin studimor 1

Një sërë shembujsh që kemi analizuar tregojnë se emrat e përveçëm në tekste (me një statur të papërcaktuar përfundimisht) të cilat mund të lexohen si nga fëmijë ashtu edhe të rritur mund të fshehin nënkuptime të dyfishta: të vegjlit mund të arrijnë të interpretojnë dhe kuptojnë të dhënat më sipërfaqësore dhe më të dukshme, ndërsa lexuesit më të rritur e më me përvojë, me aftësi më të mira gjuhësore e me më shumë njohuri rreth fjalorit dhe botës që i rrethon do të jenë më të aftë për të zbuluar konotacionet më të fshehta. E kemi përmendur tashmë se përzgjedhja e emrave nuk është e rastësishme për shkrimtaren. Në të kundërt, shumica e personazheve mbartin emra që fshehin një sërë mesazhesh të qëllimshme, gjë që e vendos përkthyesin përpara një sërë sfidash. Së pari, përkthyesi duhet të identifikojë ato emra që përmbajnë elementë të kuptimshëm semantikë ose konotativë – kjo fazë identifikimi do të jetë në varësi të nivelit të njohurive gjuhësore të gjuhës origjinale dhe njohurive kulturore.[372] Kjo është edhe arsyeja pse disa emra që kanë

[371] *Bota Sot. Ta duam dhe ta kultivojmë gjuhën shqipe.* Intervistë nga Miranda Haxhia. 09.01.2011.

[372] J. Van Coillie, W. P. Verschueren (eds.) (2006) *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome fq. 132.

kuptim semantik më pak transparent në disa raste janë lënë pa përkthyer; ndoshta përmbajtja e tyre kuptimore është vlerësuar nga përkthyesi si shumë e vështirë për t'u kuptuar nga lexuesit në gjuhën e përkthimit.

Kemi përmendur se mungesa e rregullsisë në përkthimin e emrave të përvëçëm ndodh kryesisht për shkak të përplasjes mes dy parimeve: parimi i identifikimit dhe parimi i kuptueshmërisë. Me fjalë të tjera, gjatë përkthimit duhet të marrë përparësi njëri parim ndaj tjetrit, në varësi edhe të normave dhe traditave brenda gjuhës. Në fakt, duke rishikuar gjithë shembujt e trajtuar gjatë këtij punimi, mund të themi me bindje se, në një nivel më të përgjithshëm, nuk ka një përplasje mes këtyre dy parimeve, në të kundërt, ato janë pjesë e një parimi edhe më të përgjithshëm – parimi i komunikimit, që në vetvete pranon edhe parregullsi dhe përjashtime. Përkthimi, në fund të fundit, është një formë komunikimi që synon të vendosë rregull dhe të ndërtojë ura mes botëve të ndryshme.

Përkthimi i emrave të përveçëm nuk është një çështje rastërore, por një proces i kujdesshëm vendimmarrjeje që përfshin një sërë faktorësh duke filluar nga elementët e situatës fillestare komunikative (gjuha dhe kultura origjinale) deri në situatën dytësore komunikative (gjuha dhe kultura e përkthimit), dhe kërkon konsiderim të kujdesshëm të gjithë këtyre faktorëve nga ana e përkthyesit, mes të tjerave edhe funksionimit të emrit në tekstin origjinal. Gjatë këtij procesi nuk ka zgjedhje automatike, pra, në një situatë të caktuar do të bëhet një zgjedhje e caktuar, që gjithmonë do të jetë rrjedhoja e një vendimi në varësi të rrethanave, nevojave dhe pritshmërive të tre bashkëaktorëve brenda mendjes së përkthyesit: shkrimtari origjinal, lexuesi i tekstit të përkthyer, dhe ndërmjetësi mes tyre – vetë përkthyesi. Në të njëjtën mënyrë, *Kasoruho* shprehet: *Përkthimi nuk do të thotë vetëm të gjesh fjalën e saktë, por të thithësh shpirtin e shkrimtarit që e ka shkruar librin, të njësohesh me stilin e tij, të bashkëpunosh duke eksploruar gjuhën-nënë, të gjesh fjalë korresponduese edhe kur gjuha jonë nuk i ka mundësitë të kodifikojë disa terma që gjenden në gjuhën origjinale me të cilën është shkruar një libër. Domethënë përkthyesi është me plot kuptimin e fjalës një autor i librit që përkthen.*[373]

Rast Studimor 2 - Alice's Adventures in Wonderland

Përzgjedhja e emrave të përveçëm nuk do të mund të ishte e rastësishme për një shkrimtar me ndjeshmëri dhe mprehtësi të tillë si Kerrël, aftësitë e të cilit për të shprehur shumë të pathëna nëpërmjet fjalëve dhe mënyrës së përdorimit të tyre i kemi përmendur në diskutimin mbi lojërat e fjalëve. Vepra origjinale ka një numër të lartë emrash të përveçëm, mes të tjerave emra që iu referohen personazheve historike, vendeve të botës reale, gjuhëve, personazheve të trilluar, lëndëve shkollore, etj. Shpesh, madje, ne mund të identifikojmë një personazh vetëm prej faktit se ai shkruhet me shkronjë të madhe. Për ne është me interes të shqyrtojmë se çfarë ndodh me emrat e përveçëm gjatë kalimit nga anglishtja në shqip në korpusin e përzgjedhur, gjithmonë duke patur parasysh se, ashtu siç shprehet edhe *Eshref Ymeri* duke e trajtuar përkthimin si një problem filologjik, përkthimi në shqip i emrave të përveçëm dhe emërtimeve përbën një vështirësi specifike për filologun-përkthyes.[374]

1. Emërtimet e personazheve

Gjovalin Shkurtaj shprehet se dallohen dy grupe shkrimtarësh: disa që emrat e personazheve i kanë si gjë të parëndësishme dhe i venë pa ndonjë kriter dhe, një pjesë tjetër, që përbëjnë grupin më të madh, që gjakojnë të thonë shumëçka edhe me vetë emrat

[373] *Bota Sot. Ta duam dhe ta kultivojmë gjuhën shqipe.* Intervistë nga Miranda Haxhia. 09.01.2011.
[374] E. Ymeri (1989) *Nga mendimi kritik shqiptar për përkthimin*. në Ylli, 8 gusht 1989.

që u vënë personazheve.[375] Ne njohim faktin se shkrimtarët, për të gjetur emrat e personazheve të tyre, mund të nisen nga repertori i emrave që ekzistojnë në kulturën e tyre ose mund të shpikin emra të rinj (absurdë ose përshkrues) për personazhet që krijojnë, megjithatë jemi të mendimit se të gjithë emrat që iu lidhen personazheve kanë një farë synimi apo qëllimshmërie sado të vogël nga ana e autorit, edhe pse kjo mund të mos jetë gjithmonë e dukshme për lexuesit. Edhe përkthyesi, para se ta vendosë veten në rolin e përkthyesit, duhet të vendoset në rolin e një lexuesi (një lexuesi të kujdesshëm madje), në mënyrë që fillimisht të identifikojë arsyet e emërtimeve të personazheve në një mënyrë të caktuar, dhe t'i mbajë parasysh gjatë përkthimit dhe procesit të vendimarrjes e përzgjedhjes që të rikrijojë të njëjtën teknikë emërtimi. Meqenëse, siç do ta shohim më poshtë, emrat e përveçëm janë shumë domethënës dhe jo të rastësishëm për Kerrël, përkthyesi duhet të përcjellë këtë domethënie. A ka ndodhur kështu në variantet që po studiojmë? A orientohet përkthyesi ndaj tekstit origjinal apo ndaj publikut marrës? A përkthehen emrat e përveçëm? Në ç'mënyrë? Sa koherentë janë përkthyesit brenda të njëjtit variant të përkthyer? Këto janë pyetjet që do të gjejnë përgjigje në këtë pjesë të punimit. Për lehtësi orientimi, jemi përpjekur t'i grupojmë emrat e përveçëm në disa grupe, të cilat pasqyrohen më poshtë. Në fillim do të prezantojmë formën se si shfaqen emrat e përveçëm në origjinal si dhe funksionin e synuar të tyre, më pas do të krahasojmë variantet e përkthyera dhe do të diskutojmë strategjitë e ndjekura në korpus si dhe ndikimin e tyre në publikun marrës. Pra, do të ndjekim një qëndrim funksional dhe përshkrues. Të dhënat nga origjinali dhe krahasimet mes varianteve do t'i pasqyrojmë nëpërmjet tabelave dhe grafikëve.

a. Emra marrë nga bota reale

E kemi përmendur faktin se Kerrëli e trilloi *Alice's Adventures in Wonderland* për mikeshën e tij dhjetëvjeçare Elis Lidëll (Alice Liddel) gjatë një shëtitjeje me varkë me të si dhe me dy motrat e saj Lorina Sharlotë (Lorina Charlotte) (13 vjeçe) dhe Edit Lidëll (Edith Liddell) (8 vjeçe). Disa të dhëna në histori iu referohen (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të dhënave të jetës së vetë vajzave, ndërsa të tjera janë thjesht trillime. Për një lexues të thjeshtë (por edhe për një përkthyes) është e vështirë të përcaktojë kufirin që ndan qëllimshmërinë dhe rastësinë në rrjetin e nënkuptimeve brenda botës së çudirave të endur aq mjeshtërisht nga Kerrël. Ne do të përpiqemi të identifikojmë fillimisht emra të përveçëm që janë marrë nga bota reale (duke përfshirë edhe emra të shkëputur nga bota reale, por edhe emra që në mënyrë të fshehtë dhe aludive i referohen botës reale). Nuk mund të mos përmendim se në këtë drejtim një ndihmesë e paçmueshme kanë qënë shënimet e *The Annotated Alice* nga studiuesi Martin Gardener.

a.1 Emra të përveçëm që i referohen drejtpërsëdrejti botës reale të autorit

Bota *reale* ku vendosen ngjarjet është Anglia në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, duke përfshirë fakte historike që mendohet se njihen nga publiku marrës së cilit i drejtohet vepra origjinale (publiku fillestar është Elis Lidëlli dhe dy motrat e saj, ndërsa, pas publikimit, një publik më i gjerë – si fëmijë ashtu edhe të rritur – që ka shumë gjasa të kenë njohuri të njëjta për botën reale), kështu që, emrat e përveçëm duhet të përmbushin funksionin identifikues fillimisht për këtë publik.

[375] Gj. Shkurtaj (2008) *Si të Shkruajmë Shqip.* Botimet Toena: Tiranë, fq. 165.

Nëpërmjet tabelës së mëposhtme njihemi me ato emra të përmendur në vepër që emërtojnë njerëz të ndryshëm si *Alice, Mary Ann, Ada, Mabel* apo vende të ndryshme si *New Zeland, Australia, London, Rome, Paris, the Nile* dhe personalitete historike *Shakespeare, Edwin, the Earl of Mercia, Morcar, the Earl of Northumbria, Stigand, the Archbishop of Canterbury, Edgar Atheling, William the Conqueror* të cilat identifikohen lehtësisht nga Elis Lidëlli dhe motrat e saj (publiku P_1). Për një publik më të gjerë – të rriturit dhe fëmijët që e lexojnë në gjuhën origjinale pas botimit – referencat gjeografike dhe historike do të jenë të qarta, ndërsa *Alice, Ada, Mabel* dhe *Mary Ann* do të jenë personazhe të trilluara për ta (publiku P_2 – bashkëkohor me shkrimtarin).

Tabela nr. 16 ***Përkthimi i emrave të përveçëm – personazhe reale***

Për lexuesit e sotëm të veprës, në origjinal dhe në përkthim (Publiku P_3), personazhet *Alice, Ada, Mabel* dhe *Mary Ann* do të jenë të trilluar, ndërsa referencat gjeografike dhe historike janë të identifikueshme përgjithësisht. Për publikun P_3, ashtu si edhe për P_2, personazhet janë gjithsesi të trillura, kështu që përshtatja e emrave lejon një shqiptim më të lehtë dhe nuk ndërhyn në funksionin identifikues. Megjithatë, emrat e përveçëm që gjenden në kulturën e përkthimit, shënojnë edhe atmosferën e përgjithshme në lidhje me botën reale të vetë lexuesve të P_3, kështu që përkthyesi duhet të tregohet i kujdesshëm që të ruajë të njëjtën strategji në të gjithë veprën, duke shmangur prodhimin e skenave jo

Varianti / *AAiW*	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
Alice	Liza	Liza	Liza	Liza	Liza
Dinah	Dina, Dinah	Dina, Dinah	Dina	Dina	Dina
Ada	Adda	Adda	Ada	Ada	Ada
Mabel	Mabel-a	Mabela, Maba	Mabela, Maba	Mabeli	Mejbeli
Mary Ann	Marije-Anë	Ana Maria	Ana Maria	Mariananna Marianna	Meri En

koherente nga ana kulturore. Në të gjitha variantet shohim të përshtatur fonetikisht emrin e personazhit kryesor – Liza. Në variantin e dytë dhe të tretë përdoret herë *Mabela* herë *Maba* (ndërkohë që në origjinal emri nuk përmendet i shkurtuar). Edhe në variantin e pestë është bërë përshtatja fonetike e emrit *Mabel* të origjinalit. Të dhënat që shkëputim nga *The Annotated Alice* për emrin *Mary Ann* janë shumë interesante: sipas Roxher Grinit, në kohën që u shkrua vepra, ky emër ishtë një eufemizëm britanik që nënkuptonte një shërbëtore – gjë që pasqyrohet edhe në mënyrën se si Lepuri i Bardhë i drejtohet asaj duke e urdhëruar dhe në fjalët e Lizës "Më mori për shërbëtoren e tij".[376] Në shqip emri përshtatet në shqiptim në variantin e parë *Marije-Anë*, ndryshohet me një ndikim më shumë latin në variantin e dytë dhe të tretë *Ana Maria*, në variantin e katërt përdoren të dy emrat *Mariananna* dhe *Marianna*, pra, është bërë zëvendësimi me një emër të gjuhës shqipe, ndërsa në variantin e pestë emri është përshtatur sipas parimit fonetik. Asnjë prej këtyre emrave të përgjedhur nga përkthyesit nuk arrin të përcjellë të dhënat ndërtekstuale (emri *Mary Ann* – shërbëtore) në gjuhën shqipe.

Tabela nr.17 ***Përkthimi i emrave të përveçëm – referenca historike***

[376] M. Gardener (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA, fq. 38.

Në variantin e parë është përdorur procedura e transferimit të emrave të huaj në gjuhën shqipe, emrat e respektojnë kategorinë e shquarsisë, duke u lakuar sipas rasës përkatëse. Nëpërmjet tabelës mund të vërejmë sërish të hijëzuar rastet që shfaqin mungesë koherence në procedurën e përgjedhur për përkthimin e emrave të përveçëm (p.sh. v.II: *William-Viliam*) si dhe në strategjinë e përdorur brenda të njëjtit variant [v.II: *William* (transferuar në të njëjtën formë nga anglishtja) kundrejt . *Edvin, Merçia* (përshtatur sipas parimit fonetik në gjuhën shqipe)], ndërkohë që për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj gjatë përkthimit të një vepre letrare në gjuhën shqipe duhet të zgjedhim një nga dy

Varianti / *AAiW*	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
William the Conquerer	William-in Pushtues; William Pushtuesi	pushtuesi William; pushtuesi Viliam	Uiliam Pushtuesi	Uilliam Pushtuesi	Vilhelm Pushtuesi
Edwin, the Earl of Mercia	Edwin-i, Zotni i Mercia-s	Edvini, zoti i Merçias; Edvini, zoti i Marcias	Edvini, zoti i Merçias	Edvini, konti i Mercias	Edvini, konti i Mersisë
Morcar, the Earl of Northumbria	Marcar-i, Zotni i Northumbria-s; Morcar-i	Marcori, zoti i Northumbrias	Morkari, zoti i Northumbrias	Moreari, konti i Nortumbrias	Morkari, konti i Nortumberit
Stigand, the Archbishop of Canterbury	Kryepeshkopi i Cantebury-t, Stigan-i	kryepeshkopi i Kanteburyt, Stigani	Stigani, kryepeshkopi i Kantërbërit	Stigandi, arqipeshkvi i Kanterburisë	Stigandi, kryepiskopi i Kenterberit
Edgar Atheling	Edgar Atheling-un	Edgar Athelingu	Edgar Ejdhlingun	Edgardo Athelingun	Edgar Atelingu
Shakespeare	----------[377]	----------[378]	----------[379]	Shekspiri[380]	Shekspiri[381]

prirjet, dhe, çka është më e rëndësishme, t'i përmbahemi vetëm një prirjeje nga fillimi deri në fund të përkthimit, duke iu bindur ligjeve morfo-sintaksore të gjuhës shqipe[382]. Varianti i parë është më koherent në strategjinë e ndjekur, duke transferuar emrat siç janë në anglisht dhe duke ua nënshtruar rregullave të lakimit të gjuhës shqipe. Në variantin e katërt përmendet *Edgardo Athelingu* si përkthim i *Edgar Atheling* gjë që na bën të mendojmë se përkthyesit e variantit të katërt janë nisur nga përkthimi nga italishtja dhe jo nga teksti origjinal në anglisht, gjë që patëm mundësi ta vërtetojmë edhe nga intervista

[377] Në variantin e parë gjejmë këtë përkthim … *ndêjti për nji kohë të gjatë me gisht në tâmth, ndërsa të tjetër e pritshin në heshtje* [L. Carroll (1944) *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë, fq. 31].

[378] Në variantin e dyte gjejmë këtë përkthim … *ndjejti për një copë herë me gjisht në kokë ndërsa të tjerët prisnin në heshtje*. [L. Karoll (1961) *Liza ne Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Mihal Duri: Tiranë. fq. 20).

[379] Në variantin e tretë gjejmë këtë përkthim … *pasi ndenji një copë herë me gishtin kokës, ndërsa të tjerët pritnin në heshtje* . [L. Kerël (1998) *Liza në Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Shtëpia Botuese 'Mësonjëtorja': Tiranë, fq. 32-33].

[380] Në variantin e katërt gjejmë këtë përkthim … *qëndroi ulur për shumë kohë duke e mbajtur gishtin mbi ballë, në atë pozicion që zakonisht shohim të pikturuar Shekspirin* [L. Kerël (2008) *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë, fq. 33].

[381] Në variantin e pestë gjejmë këtë përkthim … *ndenji me gishtin mbështetur në ballë (në këtë pozë shpesh paraqesin Shekspirin* [L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 34].

[382] E. Tupja (2000) *Këshilla një Pëkthyesi të Ri.* Onufri, Tiranë, fq. 54.

zhvilluar me këta përkthyes që ju mund ta lexoni në pjesën *Shtojca 3.* Edhe në variantin e pestë emrat i nënshtrohen përshtatjes fonetike.

Lexuesit e P_3 do ta kenë të vështirë që ta identifikojnë *William the Conquerer* dhe gjithë personazhet e përmendur në të njëjtën linjë me të nëse nuk e njohin historinë angleze. Ai përmendet në atë pjesë të historisë ku Miu rrëfen *the driest thing I know* (historinë më të thatë që di). Nëse do të identifikonim skoposin e përkthimit në këtë rast, duhet të theksojmë se në këtë pjesë nuk ka rëndësi të përcillet personazhi i përmendur, por "thatësia, mungesa e interesit" së historisë që ai rrëfen. Do të sugjeronim, pra, që në këtë rast nuk është e rëndësishme të transferohet i njëjti emër (dhe po kështu edhe emrat e tjerë të origjinalit si, për shembull, *Edëin, the Earl of Mercia, Morcar, the Earl of Northumbria, Stigand, the Archbishop of Canterbury, Edgar Atheling*) dhe të përkthehen gjithë faktet e historisë, por thjesht të bëhen zëvendësime nga ana e përkthyesit, që mund të rrëfejë një histori tejet të mërzitshme edhe nëpërmjet personazheve të tjerë, pra, mund të ishte përdorur edhe zëvendësimi (kjo gjithmonë në koherencë me strategjinë që ka ndjekur në përkthimin e veprës në tërësi). Të njëjtën gjë mund të themi edhe për *Shakespeare,* ndonëse në këtë rast pritet që të gjithë ta identifikojnë lehtësisht, në vepër bëhet fjalë për qëndrimin e tij në një pozicion të menduar, dhe është ky funksion (apelativ) që duhet transmetuar, ndoshta edhe pa e përmendur fare personazhin në fjalë. Ndoshta kjo është dhe arsyeja që në tre variantet e para emri i Shekspirit nuk përkthehet fare, dhe përkthehet thjesht mënyra e qëndrimit të Dodosë.

Tabela nr.18 ***Përkthimi i emrave të përveçëm – referenca gjeografike***

Vetëm në variantin e parë është transferuar emri *London* në gjuhën shqipe, në të gjitha rastet e tjera janë përkthyer gjithë emrat e tjerë gjeografikë në gjuhën shqipe, kjo edhe sepse referencat gjeografike janë vende të njohura për publikun P_3. Në variantin e dytë *Australia* dhe *New Zeland* nuk përkthehen (procedura e mos-përfshirjes) por kjo gjë kompensohet në tekstin e përkthyer nëpërmjet fjalëve të Lizës '*si t'ja bëj që të pyes për vendin e tyre*'[383].

a.2 Emra të përveçëm që i referohen tërthorazi botës reale të autorit dhe emra që formohen nga lojëra fjalësh

Përveç disa emrave të përveçëm që janë aludime të tërthorta të njerëzve realë, shumica e

Varianti / *AAiW*	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
London	Londoni	Londra	Londra	Londra	Londra
Paris	Parisi	Parisi	Parisi	Parisi	Parisit
Rome	Rroma	Roma	Roma	Roma	Roma
the Nile	Nil	Nil	Nil	Nil	Nil
Australia	Australija	----------	Australia	Australia	Australia
New Zeland	Zelanda e Ré	----------	Zelanda e Re	Zelanda e Re	Zelanda e Re

emrave të përveçëm në veprën origjinale janë ndërtuar në bazë të lojërave të fjalëve ose idiomave. Në të dyja këto raste, mendojmë se aludimi do të ketë pasur funksion apelativ

[383] L. Karoll (1961) *Liza ne Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Mihal Duri: Tiranë. fq. 6.

për P_1 pasi të ketë zbuluar referentin e fshehur, por referenti i fshehtë do të humbasë për P_2 dhe për P_3. Kështu, aludimi do të funksionojë të paktën për P_2, ndërsa për P_3 kjo do të jetë në varësi të procedurës së përzgjedhur për përkthimin (aludimi mund të ketë funksion analog vetëm në rast se përkthimi është i orientuar ndaj gjuhës së përkthimit).

Dodo mbetet një personazh i trilluar për P_2 dhe P_3, të cilët mund ta shohin atë në figurë (në variantin e parë dhe të dytë) si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga ana e përkthyesit. Lexuesit e thjeshtë nuk do të arrijnë të kuptojnë se *Do-do* është një aludim i mënyrës se si vetë autori belbëzonte kur shqiptonte emrin e tij *Do-do-doxhson*, gjithashtu *Duck* i referohet mikut të tij *Duckworth*, ndërsa *Lory* dhe *Eaglet* i referohen motrave të Lizës - Lorina Sharlotës dhe Editës. Edhe në rrëfimin e Miut Gjumash, tre motrat *Elsi*, *Lejsi* dhe *Tilli* përfaqësojnë sërish motrat Lidëll: Elsi është Lorina Sharlotë (gërmëzimi i inicialeve *L. C.*), Tilli është Edita dhe Lejsi është anagram i emrit të personazhit kryesor. Fakti që këto aludime nuk transmetohen nuk përbën ndonjë humbje të madhe në përkthim dhe publiku P_3 i identifikon këto si personazhe fantastikë ose të trilluar, pjesë e Botës së Çudirave dhe jo botës reale që njihej vetëm nga Kerrël dhe Elis Lidëll. Nuk është e qartë se si do të identifikohet si personazh nga lexuesit e vegjël *Furia*, ndërkohë që kemi përmendur se furia është një erë shumë e fortë. Në tre variantet e para emri është zëvendësuar, në variantin e katërt është përshtatur dhe në variantin e pestë është përkthyer.

Grifoni mbetet një krijesë fantazie për lexuesit e varianteve në gjuhën shqipe, për më tepër që ai mund të identifikohet në figurë vetëm në variantin e parë, ndërsa në variantet e tjera thjesht nëpërmjet shpjegimit "qënie e gjallë, gjysëm zog, gjysëm kafshë"; ndërkohë që shkrimtari e sjell këtë krijesë në vepër për të aluduar dhe satirizuar emblemën e *Trinity College* në Oksford.[384] Në variantin e pestë aludimet sqarohen nëpëmjet shënimeve në fund të librit, madje edhe pse figura për ilustrimin e Grifonit mungon, përkthyesi na bën me dije se Grifoni, në tekste të tjera shoqëruar me ilustrime, paraqitet me trup luani dhe kokë e krahë shqiponje. Pavarësisht shpjegimit dhënë nga ana e përkthyesit, mendojmë se fjalia që shfaqet në brendësi të tekstit dhe i referohet ilustrimit shpjegues të Grifonit nuk duhet të përfshihet për faktin e thjeshtë se ilustrimi mungon.[385]

Hatter dhe *March Hare* janë aludime të shprehjeve idiomatike *as mad as a hatter* dhe *as mad as a March Hare*[386] që nuk kanë idioma ekuivalente në gjuhën shqipe. Ideja se të dy personazhet janë të marrë mund të kapet lehtësisht për P_1 dhe P_2, ndërsa për P_3 në

---

[384] M. Gardener (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition*. W. W. Norton & Company: New York, USA, fq. 94.

[385] Shumë shpejt ata erdhën te Grifoni, i cili flinte shtrirë në diell (në qoftë se ju nuk e dini si e ka pamjen Grifoni, shikoni figurën*). (*shën. përkth. Kjo fjalë është në origjinal, megjithëse në variantin e tekstit që ju po lexoni, ilustrim nuk ka. Për çdo rast, Grifoni paraqitet me trup luani dhe me kokë e krahë shqiponje. [L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 111, 162].

[386] Në S. Wehmeir, C. McIntosh, J. Turnbull, M. Ashby (ed.s) (2010) *Oxford Advanced Learner's Dictionary*. Oxford University Press, fq. 887; nën fjalën *mad* lexojmë, mes të tjerash, shpjegimet për idiomat *as mad as a hatter / a March hare – of a person mentally ill; very silly. [origin: From the Mad Hatter, a character in Lewis Carroll's Alice's Adventures in Wonderland. Because of the chemicals used in hat-making, workers often suffered from mercury poisoning, which can cause loss of memory and damage to the nervous system. A march hare was called mad because of the strange behavior of hares during mating season.* [*as mad as a hatter / a March hare* – për një njeri të sëmurë mendërisht; shumë budalla – origjina - nga personazhi *Mad Hatter* i krijuar nga *Lewis Carroll* në *Alice's Adventures in Wonderland.* Për shkak të lëndëve kimike të përdorura gjatë prodhimit të kapeleve, shpesh punëtorët vuanin nga helmimi nga zhiva, gjë që mund të shkaktojë humbje të kujtesës dhe dëmtim të sistemit nervor. Një *march hare* quhej i çmendur për shkak të sjelljes së çuditshme të lepujve gjatë periudhës së çiftëzimit.] Në nga P. Qesku (2000) *Fjalori anglisht-shqip*. Botimet EDFA, Tiranë, fq. 463: *as mad as a hatter* – i marrë për t'u lidhur, i marrë për hekura; dhe fq. 631: *as mad as a March hare* – i çmendur për hekura.

shqip *Kapelebërës* nuk ka ndonjë konotacion të veçantë, *Lepuri i Marrë* e përcjell idenë e marrëzisë, vetëm se nuk ka koherencë brendatekstuale (Liza shprehet "*meqë jemi në maj, nuk do të jetë aq i çmendur sa në mars"*). Në varintin e katërt gjejmë emërtimin *Lepuri Marsian* që ruan koherencën brendatekstuale por jo atë ndërtekstuale dhe ka konotacione të ndryshme nga origjinali. Në varianin e pestë kemi emrin Lepuri i Marsit duke ruajtur kështu pjesërisht koherencën brendatekstuale (lidhja me muajin maj), por jo tërësisht (nuk kuptohet pse lepuri identifikohet si i marrë.)

Emërtimi *Mace Qeshire,* i sjellë në gjuhën shqipe nëpërmjet procedurës së zëvendësimit, është i goditur në gjuhën shqipe, ndërsa mendojmë se nuk është e përshtatshme që të përmendet *Maçok Çesteri* sepse nuk përcjell as idenë e të qeshurës ose të zgërdhirës së kudogjendur të maces dhe as nuk ruan koherence me pjesë të tjera të tekstit ku përmendet *mace.* Edhe në variantin e pestë përdoret i njëjti emërtim në gjininë mashkullore, Maçok Çesteri, pra emri është përkthyer. Në këtë rast, e gjejmë me vend të theksojmë edhe rëndësinë e kategorisë së gjinisë gjatë përkthimit, ashtu si edhe për personazhin tjetër *Dormouse* – një emër me origjinë pjesërisht latine nga folja *dormire* dhe që përfaqëson një krijesë që më shumë ngjason me një ketër se sa me një mi, dhe gjatë ditës është në në gjendje gjumi. Këto karakteristika përcillen nëpërmjet emërtimeve në variantin e parë dhe të dytë, pjesërisht edhe në variantin e tretë (nëpërmjet shënimit sqarues), por jo në variantin e katërt (aq më tepër që këtu përmendet herë *Gjer* e herë *Gjër*). Në variantin e pestë ky personazh emërtohet *Gjumashe*, pra, kemi një ndryshim të gjinisë në krahasim me variantet e tjera.

Personazhi *Mock Turtle* është një sfidë e vërtetë për gjithë përkthyesit e *Alice's Adventures in Wonderland.* Në këtë emërtim ka rëndësi elementi parodik i shfrytëzuar nga Kerrëli – *Mock Turtle* nënkupton një krijesë që është imitimi (ndoshta tallës e qesharak) i një breshke të vërtetë, ndërsa *Mock Turtle Soup* pregatitej me kokën e viçit, dhe me salca dhe përbërës të tjerë që të ngjasonin me shijen e breshkës, prandaj edhe në ilustrim personazhi në fjalë eshtë një breshkë me kokën e një viçi. Këto të dhëna jepen pjesërisht për lexuesit e variantit të tretë (edhe pse përkthyesi që në fillim e bën me dije lexuesin se po lexon një *lojë fjalësh të papërkthyeshme*), ndërsa në variantin e katërt përkthyesi nuk është koherent dhe shprehet herë *Breshkë e Gënjeshtërt* dhe herë *Breshkë Gënjeshtare,* por këto dy shprehje kanë kuptime të ndryshme: mund të pranohet për një farë analogjie me shpjegimin e mësipërm përkthimi *Breshkë e Gënjeshtërt,* por *Breshkë Gënjeshtare* nënkupton se Breshka po tregon histori që nuk janë të vërteta, gjë që nuk përfshihet në nënkuptimet e origjinalit dhe as nga ngjarjet në brendësi të veprës. Mendojmë se është më mirë të përdoret emërtimi *Breshkë e Rreme,* ashtu si në variantin e tretë dhe të pestë. Me po këtë emërtim që ngërthen lojë fjalësh lidhet edhe emri tjetër *Tortoise* që rimon me *tought us*, për të cilën do të diskutojmë më vonë. Për momentin përmendim se sërish është problematik ndryshimi i gjinisë në emërtimin *plaku Breshkë* në variantin e pestë, sepse nuk ka përputhje të gjinisë *plak-**u*** dhe *Breshk-**a.*** Emri *Bill* ruhet i pandryshuar në të gjitha variantet (për nënkuptimin e *Bill* kemi diskutuar edhe në përkthimin e titujve) dhe emri *Pat* ndryshon vetëm në mënyrën e transkriptimit në variantin e parë, të dytë dhe të pestë, duke u përshtatur fonetikisht. Emri *Pat* në origjinal ka disa konotacione të dukshme për P_1 dhe P_2 që nuk kapen nga P_3, meqenëse ky është një emër tipik për irlandezë dhe është vendosur qëllimisht nga shkrimtari për të përfaqësuar disa karakteristika të dialektit irlandez edhe nëpërmjet të folurit dhe sjelljes së tij. Vetë emri nuk i transmeton këto të dhëna në gjuhën shqipe, ndërsa për të dhënat që transmetohen nëpërmjet mënyrës së të folurit në variantet shqip do të diskutojmë më vonë.

Tabela nr.19 ***Përkthimi i emrave të përveçëm – aludime***

Varianti / AAiW	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
Dodo	Dodo* (* shën. përkth. *Nji shpezë para-historike, fara e së cilës tashti âsht zhdukë.*)	Dodo* (*shën. përkth. *një shpezë parahistorike, që tashti nuk ekziston më*)	Dodo* (*shën. përkth. *një shpezë parahistorike, që nuk ekziston më*)	Dodo	zogu Dodo
Gryphon	Grifon	Grifon* (*shën. përkth. *qenje e gjallë, gjysmë zog, gjysmë kafshë*)	grifon* (*shën. përkth. *qenie e gjallë, gjysëm zog, gjysëm kafshë)*	Grifon	Grifon
Duck	Rosa	Rosa	Rosë	Patë, Patoku	Pata
Lory	Papagal	Papagalli	Papagalli	Papagal, Papagall	papagalli Lori
Fury	Daci	Daci	Daci	Furia	Egërsira
Eaglet	shqipe, Shqiponjëza	Shqiponjë	Shqiponjë	Shqiponjëz	Zogu i Shqiponjës*[387]
Elsie	Elsije	Elsije	Elsi	Elsi	Elsi
Lucie	Lucije	Lucije	Lusi	Luci	Lusi
Little Tilly	Tilje	Tilje	Till	Till	Till*[388]
Hatter	Kestu-bamës	Kapelebërës	Kapelebërës	Kapelebërës, Kapelexhiu	Kapelaberesi
March Hare	Lepur	Lepur	Lepur i Marrë	Lepuri Marsian	Lepuri i Marsit
Cheshire Cat	Maqo	Mace Qeshire, mace Qeshire	Mace Qeshire	maçok Çesteri, Maçok Çesteri	Maçoku Çeshir*[389]

[387] (shën. përkth. *[illegible] ëto krijesa kanë tipat (njerëzit) realë. Pata (Duck) është prifti Dukoart (Duckworth), miku i Luis Kerolit, dje shoqëroi atë dhe vajzat Lidëll në shëtitjen nëpër lumë. Dodo është emri i një zogu i zhdukur dhe [illegible] emri i Lusi thërrisnin vëzhgimet e Luis Kerolit, të cilat mbahej goja kur shfaqeshin emrin Lusi të vërtetë: Dodo-Doxhson. Lori është një lloj papagalli Australian, porn ë rastin në fjalë është dhe Lorina, më e m[illegible] Lidëll. (Kështu q[illegible] ditshme, që Liza me vonë "sigurisht" u zu me Lorin; "ar[illegible] prej Lorit në këtë [illegible] u është marrë nga jeta e përditshme). Zogu i shqiponjës (Eaglet) është Edit Lidëll, motra e [illegible] (2008) Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 154].

[388] (shën. përkth.) *Përsëri është fjala për motrat Lidëll: Elsi-LS; L[illegible] esi-Lorie – anagrama e emrit Alice, Till-Matilda – emri [illegible] dhit.* [L. Kerol (20[illegible] huraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 16[illegible]

[389] (shën. përkth.) *Qeshiri [illegible] përme[illegible] glez "Buzëqesh si [illegible] ka dy hipoteza: Disa gjuhëtarë menc[illegible] verb ka lindur pr[illegible]ir, ku paraqitej një leopard me dhëmbë kërcëllitës. Të tjerë janë të mendimit se prejardhja e proverbit është nga punishtet e Çeshirit, të cilat një kohë prodhonin monedha me kokën në formën e maçokut që buzëqesh.* [L. Kerol (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. F. Shuraja (përkth.) Redona: Tiranë, fq. 158].

Dormouse	Mî-gjumash, Mîu-fjetës	Mi gjumash	gjer* (*shën. përkth. *gjeri – brejtës i vogël pylli me bisht të madh si ketër e me turi si të miut, që e kalon dimrin në gjumë*)	Gjeri, Gjëri	Gjumashja
Mock Turtle	Breshkën e Ndrrueme	Breshkën e ndryshuar, Breshka e Ndryshuar	Breshka e Rreme[390]	Breshka e Gënjeshtërt, Breshka Gënjështare	Breshka e Rreme
Tortoise	Zojushe	Zonjushe	Zonjushe	Breshkujëse	plaku Breshkë
Bill	Bill	Bill	Bill	Bill	Bill
Pat	Pet	Pet, pet	Pati	Pat	Pet

b. Emra personazhesh të trilluar

Një karakteristikë e *Alice's Adventures in Wonderland* është se personazhet e trilluar nuk kanë emra në kuptimin e përgjithshëm të fjalës. Personazhet, më së shumti kafshë ose krijesa fantazie, zakonisht prezantohen nëpërmjet një përshkrimi, që më pas përdoret si emër i përveçëm thjesht duke e shkruar me shkronjë të madhe, për shembull *the White Rabbit, the Caterpillar, the Mouse, the Duchess, the Gryphon, the Lobster, the Judge, Seven, the Fish-Footman, the Frog-Footman.* Përkthimi në gjuhët neolatine nuk paraqet vështirësi, sepse duhet thjesht të ndjekim modelin e autorit për përdorimin e shkronjës së madhe. Megjithatë, mund ta shikojmë lehtësisht edhe nëpërmjet tabelave se përkthyesit nuk janë treguar gjithmonë koherentë dhe, herë nuk përdorin shkronjën e madhe për të identifikuar emërtimin e personazhit (përndryshe, i shkruar me shkronjë të vogël, ai mbetet një emër i përgjithshëm), herë shkruajnë me shkronjë të madhe në vend të shkronjës së vogël të përdorur në origjinal, duke identifikuar kështu personazhe të tjerë që nuk ishin veçuar si të tillë në origjinal.

Pjesët e hijëzuara në tabelë paraqesin ose mungesë koherence në lidhje me shkronjën e madhe sipas përdorimit të saj në origjinal (*Canary-kanarinë*), ose brenda variantit të përkthyer (*Caterpillar-Krimbi, krimbi*), ose ndryshohet lloji i kafshës së përmendur në origjinal (*Old Crab-kukuvajkë*) ose shtohen konotacione të tjera dhe nuk ruhet koherenca as brenda të njëjtit variant përkthimi (*Knave of Hearts-Fanti i Zemrave, Kopuku i Zemrave*), ose nuk përkthehen fare (*old Crab, young Crab*), ose ndryshohet emërtimi për qëllime ndërtekstuale si në shembullin *Time-plaku Kohë,* ku nuk ka përputhje mes emërtimit në vetvete *plak-**u** Kohë-**a**,* ku shfaqet kategoria e gjinisë, gjë që nuk përbënte problem në origjinal. Duke iu referuar sërish gjinisë mendojmë se është më mirë emërtimi *Shërbëtori Bretk* se sa *Portieri Bretkosë* apo *Oborrtari Bretkosë.* Procedura e përkthimit që mbizotëron, siç mund ta shikoni më poshtë, është ajo e përkthimit të emrave.

[390] Ky variant shoqërohet me këtë shënim në fund të faqes për lexuesit e gjuhës shqipe: "*Kjo është një lojë fjalësh e papërkthyeshme. Turtle soup është një lloj supe që bëhet me breshkë, në mungesë të së cilës mund të bëhet edhe pa të, dhe atëhere quhet mock turtle soup, dmth "supë breshke e rremë", pra supa është e rreme (është gjoja supë breshke) dhe jo breshke. Mirëpo meqë mbiemri "e rreme" është puq me fjalën "breshkë", autori bën lojë fjalësh dhe thotë "breshkë e rreme" (mock turtle), që në të vërtetë nuk ekziston*". [L. Kerël (1998) *Liza në Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Shtëpia Botuese 'Mësonjëtorja': Tiranë, fq. 109.]

Tabela nr.20 ***Përkthimi i emrave të përveçëm – trillime***

Varianti / *AAiW*	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
White Rabbit	Lepuri i Bardhë	Lepur i bardhë, Lepuri i Bardhë	Lepur i bardhë, Lepuri i Bardhë	Lepuri i Bardhë, Lepurushi i Bardhë	lepur i bardhë, Lepuri i Bardhë
the Duchess	Dukesha	Dukesha	Dukesha	Dukesha	Dukesha
the Mouse	Miu	mi, Miu	Miu	Mi, mi, miush	Miu, Miush
old Crab	Kukuvajkë	kukuvajkë	gaforre	Gaforre plakë	---------
young Crab	e bija	e bija	e bija	gaforrja e vogël	----------
old Magpie	Mullêjë plakë	mëllënjë plakë	laraskë plakë	laraskë plakë	laraskë plakë
Canary	Kanarinë	kanarinë	kanarinë	Kanarinë	Kanarina
the Caterpillar	Krymbi	Krimbi, krimbi	Vemja	Vemja	Vemja
the Pigeon	Pëllumbi	Pëllumbi	Pëllumbi	Pëllumbesha	Pëllumbesha
Serpent	Gjarpën	gjarpër	gjarpër	Gjarpër, gjarpër	gjarpër
the Fish-Footman	Lajmtari-Peshk	Lajmëtari Peshk	Portieri-Peshk	oborrtari-Peshk	Shërbëtori-Peshk
the Frog-Footman	Portjeri - Bretkocë	Portjeri Bretkosë	Portieri-Bretkosë	oborrtari-Bretkosë	Shërbëtori-Bretk
the Footman	Lajmtari, Portjeri	Lajmëtari, Portjeri	Portieri	Oborrtari	shërbëtori
the Queen	Mbretnesha	Mbretëresha	Mbretëresha	Mbretëresha	Mbretëresha
the Time	Koha	Koha, koha	Koha, koha	Koha	Koha, Plaku Kohë
Five	Pesësh[391]	Pesëshi	Pesëshi	Pesë	Pesa
Seven	Shtatshi	Shtatëshi	Shtatëshi	Shtatë	Shtata
Two	Dysh	Dysh	Dysh	Dysh	Dysh
Knave of Hearts	Fandi-Spathi	Fanti Spathi	Fanti Kupë, Fanti kupë	Fanti i Zemrave, Kopuku i zemrave	Fanti i Kuq
the King	Mbreti	Mbreti	Mbreti	Mbreti	Mbreti
the Lobster	Gaforre	Gafore	gaforre	Aragostë	Gaforre

[391] Përkthyesi i variantit të parë dhe të dytë pasi prezantojnë kopshtarët, shtojnë shënimin sqarues e identifikues * *Kopshtarët ishin në formë letrash bixhozi.* Mendojmë se ky shënim është i panevojshëm meqënëse pak më tej jepet shpjegimi i "të gjatë e të preftë, me duer e kambë në të katër qoshet" që, së bashku me përshkrime të tjera brendatekstuale, i identifikon si letra bixhozi. Përkthyesi i variantit të dytë, madje, shton një paragraf në mes të dialogut *Emërat e tre kopështarëve, në qoftë se mund të gjykonte nga ajo tabela e madhe që kishin varur në qafë ishin vetëm numura* (*shën.përkth. katër ngjyra letrash: kupa, spathi, karé, maçi).* Edhe ky shënim nuk është i nevojshëm, pasi logjika e emërtimit të kopshtarëve është e njëjtë me atë të emërtimit të personazheve të tjerë dhe nuk ka arsye pse të bëhen sqarime të tepërta.

2. Emërtimet e lëndëve që zhvillohen në shkollë

Kur diskutuam mbi lojërat e fjalëve, përmendëm se një lloj i veçantë lojërash janë edhe malapropizmat – zëvendësimi i një fjale me një fjalë tjetër, e cila ka shqiptim të ngjashëm, por kuptim të kundërt, të shtrembëruar, dhe shpesh shoqërohet me një efekt komik.[392] Në këtë çështje do të marrim si pasqyrim të malapropizmave emërtimet që iu vendosen lëndëve që kanë zhvilluar në shkollë Breshka dhe Grifoni. Në tabelën nr. 21 mund të dëshmoni se sa mahnitëse është aftësia me të cilën Kerrëli arrin të ndërtojë fjalë që ngjasojnë shumë në shqiptim me lëndët tradicionale duke iu dhënë atyre një veçanësi shumë të përshtatshme për Botën e Çudirave, e, njëkohësisht, duke i kthyer në lëndë normale për personazhet e kësaj bote. A kanë arritur përkthyesit të sjellin edhe në shqip një lojë kaq të bukur fjalësh, ku fjalët që përdoren për të përshkruar lëndët e "Botës së Çudirave" ngjasojnë kaq shumë me lëndët tradicionale? Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta zhbirojmë nëpërmjet tablës nr. 22.[393]

Tabela nr. 21 ***Emrat e lëndëve dhe çfarë përfaqësojnë ato***

Emërtimi i lëndës në Botën e Çudirave	***Përkthimi në gjuhën shqipe***	***Emërtimi i lëndës për të cilën aludohet***	***Përkthimi në gjuhën shqipe***
Reeling	*Mbështjellje; Rrotullim; Vërtitje*	*Reading*	*Lexim*
Writhing	*Përdredhje*	*Writing*	*Shkrim*
Ambition	*Synim; Qëllim*	*Addition*	*Mbledhje*
Distraction	*Zbavitje; Shpërqendrim*	*Subtraction*	*Zbritje*
Uglification	*Shëmtim*	*Multiplication*	*Shumëzim*
Derision	*Përqeshje; Shpotí*	*Division*	*Pjestim*
Mystery	*Mister; E fshehtë*	*History*	*Histori*
Seography	*Detografi*	*Geography*	*Gjeografi*
Drawling	*Zvarritje; Zgjatje*	*Drawing*	*Vizatim*
Stretching	*Shtritje; Tendosje; Zgjatje*	*Sketching*	*Skicim*
Fainting in Coils	*Zalisje spirale*	*Painting in oils*	*Pikturim në vaj*
Laughing	*Qeshje; Tallje*	*Latin*	*Latinisht*
Grief	*Pikëllim; Brengosje*	*Greek*	*Greqisht*

[392] Termi *malapropizëm* (nga frëngjishtja *mal à propos* – me qëllim të keq) vjen nga emri i *Mrs. Malaprop*, një personazh në komedinë *The Rivals* të *Richard Brinsley Sheridan*, emri i së cilës ishte formuar nga fjala *malapropos* – në mënyrë jo të përshtatshme.

[393] Gjithashtu si pjesë e lëndëve shfaqen edhe emrat *French, music and washing-extra* të cilat nuk i kemi përfshirë në tabelë sepse nuk janë malapropizma. Nga libri *The Annotated Alice* [M. Gardener (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition*. W. W. Norton & Company: New York, USA, fq. 97] mësojmë se shprehja *French, music and Washing-extra* shfaqej shpesh në faturat e shkollave me konvikt dhe nënkuptonte se kishte një pagesë shtesë për frëngjishten, muzikën si dhe për të larën e rrobave nga shkolla. Ky nënkuptim mund të themi se përcillet në variantin e parë (*Të Lame*) dhe të tretë (*larje*) por jo në variantin e dytë (*Përsëritje*) dhe në variantin e katërt "*larje rrobash si kurs special"*. Ndërsa në variantin e pestë lexojmë ""*Frëngjishtja, muzika dhe të larët* janë lëndë plotësuese" shoqëruar nga shënimi i përkthyesit: "*Një fjali e tillë ka qenë tepër e zakonshme në shkollat britanike me konvikt, por kuptohet kishte kuptim tjetër: pagesa shtesë në to merrej për lëndët plotësuese (frëngjisht dhe muzikë) dhe larjen e rrobave".* Mendojmë se në këtë variant arrijnë të përcillen qartë nënkuptimet e origjinalit.

Përpara se të shohim të dhënat e tabelës nr. 22 po shtrojmë parantezën se parimi nga i cili duhet të udhëhiqet përkthyesi është të riprodhojë aludimin dhe jo të niset nga përkthimi i drejtpërdrejtë i lëndës ashtu siç jepet në kolonën e parë, sepse në këtë mënyrë do të humbasë nënkuptimi. Pra, duhet të gjendet një fjalë në shqip e cila është një malapropizëm i termit përkatës që ekziston në shqip (kolona e katërt) për lëndën në anglisht (shkruar në kolonën e tretë të tabelës nr. 21). Atëherë, le të shohim fillimisht të dhënat që kemi mbledhur nga korpusi nën shqyrtim:

Tabela nr. 22 ***Emërtimi i lëndëve në variantet e përkthyera***

Emërtimi i lëndës në Botën e Çudirave	***V. I*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***V. II*** *Maqo Afezolli* (1961)	***V. III*** *Maqo Afezolli* (1998)	***V. IV*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***V. V*** *Frederik Shuraja* (2008)
Reeling	*Shgrrim*	*shgrim*	*zhgërrim*	*Anoret*	*të teshtinim*
Writhing	*Kërcim*	*kërcim*	*kërcim*	*Bashkëlloret*	*të këlthisnim*
Ambition	*Mbjellje*	*mbjellje*	*mbledhje*	*Rrjedhje*	*shërbimi*
Distraction	*Hecje*	*hecje*	*hecje*	*Rritje / Ritje*	*respekti*
Uglification	*Shëmtim*	*shëmtim*	*shëmtim*	*Shushurim*	*shëmtimi*
Derision	*Përtim*	*përtim*	*përtim*	*Përcaktim*	*shtypja*
Mystery	*Hiçorí*	*Hiçori*	*hiçori*	*Hiskori*	*histeri*
Seography	*Dheshtroje*	-------	*detografi*	*Detografi*	*qiellgrafinë*
Drawling	*Vizorim*	*Vizorim*	*vizorim*	*Dizadim / Dizatim*	*luftim*
Stretching	*Rroshkullim*	*Rroshkullim*	*rroshkullim*	*skuqje në telë*	*të shpifnim*
Fainting in Coils	-------	-------	-------	*peshk afresko*	*të vallëzonim me merlucët e dhjamosur*
Laughing	*Lakranishte*	*Latrinishte*	*qeshje*	*Gekisht*	*tunxhin*
Grief	*Grepishte*	*Grepishte*	*pikëllim*[394]	*Katinisht*	*besimin*

Në ***variantin e parë*** mund të themi se përkthyesi riprodhon me sukses një efekt shumë të ngjashëm me efektin e arritur në origjinal: të gjithë emërtimet janë zgjedhur në mënyrë të tillë që të krijojnë bashkëshoqërime me mënyrën si emërtohen lëndët në shqip: *shkrim-shgrrim; këndim-kërcim; mbledhje-mbjellje; heqje-hecje; shtim-shëmtim; pjestim-përtim; histori-hiçori; latinishte-lakranishte; greqishte-grepishte.* Vemë re se përkthyesi është nisur nga parimi rikrijimit të funksionit apelativ (aludimi) dhe efektit të ngjashëm, duke krijuar fjalë që ngjasojnë në shqiptim me termat përkatës në gjuhën shqipe, pra, ka ndjekur të njëjtën teknikë përdorur nga Kerrëli, duke u shfaqur edhe ai vetë (përkthyesi) një krijues origjinal i termave në gjuhën shqipe dhe jo duke përkthyer drejtpërsëdrejti fjalët në anglisht korresponduese për Botën e Çudirave sepse kështu do të humbisnim lojën e fjalëve. Përkthyesi, pra, ka arritur të kuptojë teknikën e përdorur nga shkrimtari dhe pikërisht këtë teknikë e risjell në përkthim me shumë aftësi, sepse me të lexuar

[394] Përkthyesi lidh këtë shënim me këto dy fjalë: *"lojë e autorit me fjalët latinisht dhe greqisht që në anglisht, me pak ndryshim, i kthen fare lehtë në qeshje dhe pikëllim".* Loja e fjalëve nuk është rikrijuar dhe pavarësisht se jepet ky shpjegim, mendojmë se përthyesi në këtë rast i largohet edhe më shumë lojës së fjalëve të origjinalit, meqënëse lexuesit në gjuhën shqipe (që nuk kanë lexuar origjinalin dhe që s'kanë njohuri të gjuhës angleze) nuk kanë mundësi të bëjnë krahasimin e termave me përkthimet e tyre në shqip, aq më tepër që ky variant u drejtohet fëmijëve.

termin në shqip, ne na vjen ndërmend lënda tradicionale përkatëse që zhvillohet në shkollë e që fshihet pas fjalëve të përdorura, dhe nënqeshim me humorin e hollë (që menjëherë e identifikojmë si cilësi të shkrimtarit, por që në fakt përcillet mjeshtërisht dhe origjinalisht prej përkthyesit). Pra, procedura që është përdorur në variantin e parë për sjelljen në gjuhën shqipe të emrave të përveçëm që përfaqësojnë lëndët e shkollës është zëvendësimi. Përmendim këtu edhe një fakt shumë interesant që na tërheq vëmendjen në lidhje me variantin e parë të përkthimit. Në fillim të librit, pasi paraqitet përmbajtja, shohim një shënim të vogël në fund "*Në faqen mbrapa kësajë do të gjeni spjegimet e fjalëve me dy kuptime".* Në faqen tjetër na jepet kjo tabelë:

SPJEGIM I FJALËVE ME DY KUPTIME:

Fjala	**Kuptimi i dukshëm**	**Për ç'fjalë qëndron**
Shgrrim	Nga folja me zgrry (me ndy)	*Shkrim*
Kërcim	>>>> me vallzue (me hovë)	*Këndim*
Mbjelljë	>>>> me mbjellë	*Mbledhje*
Hecje	>>>> me ecë	*Hekje (zbritje)*
Shëmtim	>>>> me shëmtue (e kundërta e foljes me zbukurue)	*Shumzim* *Pjestim (damje)*
Përtim	>>>> me përtue (me mos pasë qejfë për punë)	
Hiçori	Kotësi, kurrëgjasí (nga fjala hiç)	*Histori*
Dheshtroje	Shtroje e dheut	*Dheshtroje (Gjeografi)*
Vizorim	Nji kombinim i fjalëve *vi* dhe *zor* (vështirë)	*Vizatim*
Rroshkullim	Me vizatue vija të rrumbullakëta (përdorej në shkollën e Plotsimit)	
Lakranishte	Kopësht laknash	*Latinishte*
Grepishte	Si me thanë "në mënyrë të grepit"	*Greqishte*
Shojza	Nji farë peshku	*Shoje (këpucësh)*
Qefllim	Nga fjala Qefull (nji peshk)	*Qellim*

Në këtë mënyrë, përkthyesi që në fillim të librit na njofton se teksti do të ketë *fjalë me dy kuptime* që, në fakt, janë të gjitha lojëra fjalësh të realizuara në origjinal e që përkthyesi i ka rikrijuar në gjuhën shqipe. Përkthyesi e shikon të arsyeshme t'i zbërthejë aludimet për të përcjellë efektin e dëshiruar për të gjithë lexuesit e vëmendshëm; kjo e dhënë na bën të mendojmë se libri u drejtohet pjesërisht edhe të rriturve, gjë që mbështetet nga kujdesi i veçantë që ka treguar përkthyesi gjatë gjithë veprës për të rikrijuar lojëra fjalësh e aludimesh (kjo është me rëndësi të kuptohet ndonëse në parathënie libri cilësohet si libër për fëmijë). Theksojmë edhe një herë se përkthyesi niset nga fjala ekzistuese për lëndën tradicionale në gjuhën shqipe, e, që këtej, mundohet të gjejë një fjalë që ka shqiptim të ngjashëm me të dhe nuk përkthen fjalën e krijuar në mënyrë aludive në gjuhën angleze. Fjala që fsheh aludimin ka funksion të dyfishtë: ka funksion emërtues dhe nënkuptues, d.m.th. fjala që përzgjidhet nuk është një fjalë pa kuptim, ajo duhet të ekzistojë në fondin e gjuhës shqipe, por njëkohësisht të jetë një malapropizëm i lëndës tradicionale. Gjetja e kësaj fjale tregon mprehtësinë e përkthyesit dhe një shkallë të lartë ndjeshmërie ndaj

origjinalit, dhe, njëkohësisht, dëshirën e aftësinë për t'i përcjellë lexuesit këtë ndjeshmëri sa më natyrshëm.

Në ***variantin e dytë*** të përkthimit gjejmë të njëjtat terma të përdorur si edhe në variantin e parë, të shkruara me shkronja të vogla (një faktor që tregon largësinë nga origjinali), me përjashtim të shembullit *latrinishte* që nuk është në vazhdimësi të logjikës së përkthimit të përdorur. Gjithashtu, as në këtë variant dhe as në variantin e tretë, nuk gjejmë një listë shpjeguese për këtë "lojë fjalësh".

Në ***variantin e tretë*** përkthyesi nuk është shumë i vendosur në lidhje me procedurat e përkthimit që përdor: herë e ruan lojën e fjalës (duke bërë të njëjtin përkthim si në variantin e parë) për shembull *zhgërrim, rroshkullim, hecje, shëmtim, përtim, Hiçori, Vizorim, Kërcim;* dhe herë e braktis lojën e fjalës duke përkthyer termin që përdoret në botën e çudirave (dhe jo fjalën që nënkuptohet nëpërmjet tij) për shembull, *qeshje, pikëllim* ose përkthen drejtpërsëdrejti termin e përdorur në botën tradicionale pa përcjellë lojë fjalësh, për shembull *mbledhje* për *Addition.* Mbizotëron në këtë variant procedura e përkthimit, gjë që nuk e lejon lexuesin të gëzojë gjithë kënaqësitë në mënyrë të ngjashme me shprehjen e tyre në origjinal, përkundrazi, deri diku e ngatërron atë, ose të paktën, e largon nga synimet fillestare të tekstit origjinal.

Në ***variantin e katërt*** përkthyesi sërish nuk është koherent as në përdorimin e shkronjës së madhe për emërtimet dhe as në transmetimin e aludimeve, madje, mund të themi se për një lexues nuk është fare e qartë arsyeja e përmendjes së lëndëve të tilla si *skuqje në telë, peshk afresko* apo *gekisht e katinisht.* Theksojmë se, pavarësisht se kemi të bëjmë më malapropizma, fjalët duhet të kenë kuptim edhe kur janë transformuar, dhe se mënyra e shqiptimit të tyre duhet të na sjellë ndërmend fjalën origjinale. Të njëjtën dukuri vërejmë edhe në ***variantin e pestë*** ku sërish përkthyesi nuk mban një qëndrim shumë të qartë gjatë krijimit të emrave të lëndëve, të cilat nuk krijojnë aludime, thjesht janë fjalë ekzistuese brenda gjuhës shqipe, pra, nuk janë të transformuara e pa kuptim, ndonëse nuk rindërtojnë lojëra fjalësh si në origjinal. Deri diku, bëjnë përjashtim *histeri* që përngjason me *histori*, si dhe *të vallëzonim me merlucët e dhjamosur,* që është në vazhdimësi të lojës së fjalës me merlucët të përmendur në këtë variant, për të cilën kemi diskutuar. Gjithashtu të gjitha lëndët shkruhen me shkronjë të vogël kundrejt lëndëve me shkronjë të madhe në origjinal, ndërkohë që e kemi theksuar rëndësinë që ka përdorimi i shkronjës së madhe për shkrimtarin në identifikimin e emrave të përveçëm.

Grafiku nr. 10 tregon qartë se ruajtja e shkronjës së madhe në emërtimin e lëndëve ndodh më shumë në variantin e parë, ndjekur nga varianti i katërt, më pas varianti i dytë dhe, në fund, varianti i tretë dhe i pestë ku nuk përdoret asnjëherë shkronja e madhe. Grafiku nr. 11 shfaq të dhëna në lidhje me rikrijimin e aludimeve në përkthim. Edhe në këtë grafik është e dukshme se aludimet rikrijohen në një shkallë më të lartë në variantin e parë, të ndjekur kronologjikisht nga varianti II, III, IV, V.

Grafiku nr. 10 ***Ruajtja e shkronjës së madhe në emërtimin e lëndëve në variantet në gjuhën shqipe***



Grafiku nr. 11 ***Rikrijimi i aludimeve në emërtimin e lëndëve në variantet në gjuhën shqipe***



Më poshtë po sjellim një shembull shkëputur nga varianti IV për të dëshmuar se sa e rëndësishme është rikrijimi i aludimeve në gjuhën shqipe dhe jo përkthimi i tyre i drejpërdrejtë, gjë që mund të dëshmojë (deri diku) besnikëri të rreptë ndaj origjinalit, por në kurriz të koherencës brendatekstuale:

'When we were little,' the Mock Turtle went on at last, more calmly, though still sobbing a little now and then, 'we went to school in the sea. The master was an ***old Turtle*** – we used to call him ***Tortoise*** –' 'Why did you call him ***Tortoise***, if he wasn't one?' Alice asked. 'We called him ***Tortoise*** because he ***taught us***,' said the Mock Turtle angrily: 'really you are very dull!' (fq. 40)	"Kur ishim të vogla", vijoi mâ në fund Breshka, disi mâ e e qetë, sadoqë fshante gjithënji herë-mbas-here: "na shkojshim në shkollë në dét. Mësuesja ishte nji ***Breshkë plakë*** – Na këtë e thirrshim ***Zojushe***". "E pse?" pyeti Liza. "***Pse na mësonte***", iu përgjegj Breshka, me zemrim: "Ti qenke me të vërtetë e trashë!" (v. I, fq. 103)	"Kur ishim të vegjël", vazhdoi më në fund Breshka Gënjeshtare, më me qetësi, por duke u përtypur herë pas here, "na çuan në një kolegj në fund të detit. Mësuesja jonë ishte një ***Breshkë plakë*** që e thërrisnim ***Breshkujëse***..." "Përse e thërrisnit kështu?" pyeti Liza. "E thërritnim ***Breshkujëse*** sepse e kishim mësuese" tha e nervozuar Breshka Gënjeshtare. (v. IV, fq. 119-120)

Loja e fjalëve në këtë rast bazohet në paroniminë *Turtle - Tortoise – tought us.* Përkthimi i fjalëve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mungesa e rikrijimit të nënkuptimeve bën që përgjigja e Breshkës të mos ketë fare kuptim, ndërkohë që duhet të krijohet një lidhje

midis mënyrës si e thërrisnin Breshkën dhe faktit që ajo i mësonte. Ndërsa në variantin e parë, pavarësisht se nuk rikrijohet paronimia (*Tortoise-tought us ---- Breshkë plakë-Zojushe*), ruhet nënkuptimi, Breshkën e thërrisnin me një emër tjetër sepse e kishin mësuese.[395]

3. Përfundime në lidhje me strategjitë e përdorura në rastin studimor 2

Pasi i kemi pasqyruar nëpërmjet tabelave nr. 16-22 të gjitha rastet e shfaqjes së emrave të përveçëm në origjinal dhe në variantet e përkthyera, mund t'i klasifikojmë dukuritë që vihen re gjatë përkthimit si më poshtë:

1) Në përkthimin e emrave të përveçëm që emërtojnë personazhe historikë dhe referenca gjeografike dhe historike, kryesisht përdoret procedura e përshtatjes, duke bërë të mundur që emrat t'iu nënshtrohen rregullave të të shkruarit dhe të shqiptuarit në gjuhën shqipe;
2) Përkthehet ose zëvendësohet emri i personazhit dhe ruhet edhe paraqitja grafike e tij (shkronja e madhe);
3) Përkthehet ose zëvendësohet emri i personazhit por nuk ruhet paraqitja grafike;
4) Transferohet emri i personazhit dhe shoqërohet me shpjegim ose shënim në fund të faqes;
5) Transferohet emri i personazhit dhe nuk shoqërohet me shpjegim ose shënim në fund të faqes;
6) Shtohen karakteristika grafike në përkthim;
7) Emri i personazhit mungon në përkthim, pra, përdoret procedura e mospëfshirjes;
8) Ndryshohet lloji i kafshës së referuar;
9) Shtohen ngjyrime të tjera konotative në përkthim;
10) Emrat e personazheve përshtaten sipas shqiptimit dhe shkrimit në gjuhën shqipe, pa ruajtur të dhënat ndërtekstuale apo aludimet;
11) Ka mungesë qëndrueshmërie në procedurën e përdorur si dhe në përdorimin e shkronjës së madhe.

Nga të pesë variantet, vërejmë se përkthyesi i variantit të parë ka qëndruar më shumë besnik ndaj origjinalit në përdorimin e shkronjës së madhe kur kjo përdoret edhe në origjinal, edhe pse në raste të tjera e përdor shkronjën e madhe edhe kur kjo nuk përdoret në origjinal. Në të katër variantet e tjera përkthyesit nuk i kushtojnë shumë rëndësi identifikimit të personazheve sipas paraqitjes grafike në origjinal.

Në përfundim të kësaj çështjeje mund të themi se, në një vepër të tillë si *Alice's Adventures in Wonderland* ku asgjë nuk është e rastësishme për shkak të kujdesit që ka treguar autori në rrëfimin e ngjarjeve, emërtimin e personazheve, titujt e kapitujve, ajo çka duhet të bëjë përkthyesi pikësëpari është të kuptojë sa më mirë stilin e autorit dhe qëllimet e tij. Nëse kjo fazë e të kuptuarit të thellë nuk përjetohet prej përkthyesit (për shkaqe të ndryshme si mungesë kohe, vullneti, përkushtimi, burimesh të tjera), atëherë nuk mund të pretendojmë që të shfaqen edhe në përkthim nënkuptimet e origjinalit. Me

[395] Përzgjedhja e emrit "zonjushe" është me vend në këtë rast, meqënëse në *Fjalor i Shqipes së Sotme.* (2002) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimet Toena, Tiranë, fq. 1518, gjejmë këtë shpjegim: *zonjush/ë, a 1. Përdoret për t'i drejtuar në mënyrë a me nderim vajzave; përdoret për të thirrur me nderim një vajzë të rritur e të pamartuar; përdoret nga nxënësit për t'iu drejtuar mësueses.* Nisur nga ky përdorim i fundit, themi se përgjigja "*sepse na mësonte"* përligj përzgjedhjen e fjalës "*zonjushe"*.

mjaft rëndësi në këtë aspekt është edhe faza e redaktimit, pikpamja sasiore e së cilës është e ndryshme në varësi të vështirësisë së tekstit si dhe lexuesit të cilit i drejtohet përkthimi.[396] Nëse fazave të tilla nuk u kushtohet vëmendje dhe kohë e posaçme nga përkthyesit, për publikun P_3 do të bëhet vetëm një përkthim i sipërfaqshëm që do t'i largojë lexuesit nga vepra origjinale dhe nga mesazhet e synuara nga shkrimtari i origjinalit për publikun P_1 dhe P_2.

E mbyllim diskutimin tonë rreth ndërtekstualitetit dhe formave të ndryshme të shfaqjes së tij duke mbështetur mendimin e Gjovalin Shkurtaj se kompetenca ndërtekstore e vecantë, është aftësia për ta njohur raportin që lidh tekstin me tekste të tjera: nga gjinia, nga stili, nga forma dhe nga përmbajtja. Në optikën e autorit këto kompetenca merren si parakushte të atij profili lexuesish që ai ka parasysh kur harton tekstin e paracaktuar për ta.[397] Mund të shtojmë, nën dritën e arsyetimit të ndjekur gjatë këtij kreu, se këto kompetenca duhet të merren si parakushte edhe në optikën e përkthyesit kur harton tekstin për publikun marrës, në fund të fundit, edhe përkthyesi është një lloj shkrimtari, sepse e ofron tekstin e përkthyer për herë të parë për lexuesit e publikut në gjuhën e përkthimit.

[396] P. Newmark (1981) *Approaches to Translation.* Oxford, Pergamon Press. Cituar në V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 218.

[397] Gj. Shkurtaj (2008) *Si të Shkruajmë Shqip.* Botimet Toena: Tiranë, fq. 84.

Kreu V Pasqyrim konkret i standardeve në përkthimin e letërsisë për fëmijë

Kur përkthejmë për fëmijë, siç shprehet Otinen, ka një problem që është i njëjtë edhe me përkthimin për të rritur: ashtu si çdo lloj tjetër përkthimi, ai është anonim, madje i padukshëm.[398] Ka shumë njerëz të cilët akoma nuk kanë arritur ta kuptojnë se të përkthyerit për fëmijë ka metodologjinë e vet si dhe një sërë kërkesash që duhen përmbushur. Kur shkruhen libra për fëmijë, në mendjen e shkrimtarit ka gjithmonë një imazh të fëmijës, që e frymëzon atë gjatë procesit të krijimit të veprës. E njëjta gjë ndodh edhe gjatë procesit të përkthimit: përkthyesit kanë në mendje një imazh për fëmijët që do ta lexojnë përkthimin. Ky imazh mendor është pjesë e ideologjive që ndikojnë në mënyrën e të përkthyerit si dhe në përzgjedhjen e metodave të përkthimit. Aftësia e të lexuarit është e ndryshme për njerëz të ndryshëm. Për të qenë të aftë të lexojmë, ne duhet të kalojmë në faza të ndryshme të zhvillimit: fizik, intelektual, emocional, shoqëror, moral, shpirtëror si dhe fazat që kanë të bëjnë me zhvillimin e personalitetit dhe gjuhës. Mënyra e reagimit ndaj një teksti nga ana e lexuesit varet nga faktorë të tillë si: aftësitë e tyre për të lexuar dhe formimi i tyre, përvoja, reagimi i tyre ndaj personazheve të imagjinuar të krijuar nga shkrimtari, titulli, kopertina, ilustrimet, përvoja e mëparshme me libra të tjerë të këtij shkrimtari, etj.[399] Faktorë të tillë ndryshojnë nga një lexues te tjetri, gjë që nënkupton se njerëzit nuk mund të lexojnë, dhe, rrjedhimisht, t'i kuptojnë ato që lexojnë, në të njëjtën mënyrë. Aftësitë e tyre për të kuptuar varen nga një kombinim i gjithë faktorëve të sipërpërmendur. Fëmijët, në këtë kuptim, janë lexues të veçantë për shkak të përvojës së tyre të kufizuar, sepse ata nuk kanë kaluar nëpërmjet të gjitha fazave të zhvillimit. Kjo është edhe një nga arsyet se pse tekstet që do të lexohen prej tyre, si në origjinal, ashtu edhe të përkthyera, duhet të përshtaten.

Një nga normat kryesore së cilës i nënshtrohet përkthimi i letërsisë për fëmijë është pikërisht kërkesa për ta përshtatur nivelin e ndërlikueshmërisë së tekstit sipas aftësive të të kuptuarit të fëmijëve. Ndërkohë që në sistemin e të rriturve ndërlikueshmëria është një kërkesë për t'u përmbushur, letërsia për fëmijë karakterizohet ende nga norma të modeleve të thjeshta apo të thjeshtëzuara.[400] Koncepti i normës bazohet në supozimin se fëmijët nuk janë në gjendje të lexojnë tekste të gjata, kanë vështirësi të kuptojnë fjali të gjata dhe të ndërlikuara, dhe se njohuria e tyre e gjuhës mëmë ashtu si edhe niveli i fjalorit të tyre është i kufizuar. Në këtë mënyrë, standardi i ndërlikueshmërisë së kufizuar bëhet përcaktues jo vetëm për temat dhe personazhet e tekstit, por, njëkohësisht edhe për strukturat e lejueshme për përdorim. Me qëllim që teksti i përkthyer të përputhet me këto norma, përkthyesit janë të lirë të heqin elementë apo të ndryshojnë marrëdhëniet mes tyre si dhe funksionet e tyre.[401] Ata mund të fshijnë elementë që mendojnë se janë shumë të ndërlikuar, dhe, nga ana tjetër, ata mund të shtojnë elementë duke bërë që nënkuptimet të dalin në sipërfaqe. Një nga metodat kryesore që përdoret për të zvogëluar ndërlikueshmërinë e tekstit është ***thjeshtëzimi***, që mund të vrojtohet në nivel leksikor, sintaksor dhe stilistikor. Thjeshtëzimi në nivelin leksikor shfaqet nëpërmjet përdorimit të një fjalori dhe regjistri të thjeshtë – fjalë më të shkurta, jo të prejardhura, shkëputur nga jeta e përditshme, shprehje frzaeologjike standarde si dhe fjalë konkrete në vend të atyre abstrakte. Thjeshtëzimi në nivel sintaksor shfaqet kryesisht nëpërmjet strukturave të thjeshta dhe të lehta, fjalitë e gjata të origjinalit copëzohen në fjali më të shkurtra, fjalitë e përbëra shndërrohen në fjali të thjeshta ose në

[398] R. Oittinen (2000) *Translating for Children*. New York: Garland, fq. 4.
[399] J. Spink në R. Ottinen (2000) *Translating for Children*. New York: Garland, fq. 16.
[400] Z. Shavit (2006) *Translation of children's literature* në G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature: A Reader*. Clevendon: Multilingual Matters, fq. 36.
[401] Po aty, fq. 37.

fjali të përbëra të lidhura me bashkërenditje. Thjeshtëzimi stilistikor shfaqet nëpërmjet përdorimit në tekstin e përkthyer të një gjuhe të thjeshtë dhe jo formale, përdorimit të një zhargoni me shprehjeve të përditshme të ligjërimit bisedor, përdorimit të ligjëratës së drejtë dhe dialogjeve. Karakteristika të tilla mendohet se i ndihmojnë fëmijët në një proces më të natyrshëm leximi, duke lehtësuar edhe mënyrën e perceptimit të personazheve, duke e bërë tekstin më dinamik dhe më të gjallë. Teksti mund të thjeshtëzohet edhe më tepër gjatë përkthimit në nivelin e përmbajtjes, duke u karakterizuar nga një mungesë e hollësive historike apo atyre teknike, nga një strukturim më i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i personazheve, një qëndrim kryesisht optimist, etj.[402]

Për shkak të njohurive të kufizuara dhe mundësive të kufizuara për të njohur gjuhë dhe kultura të tjera, gjatë përkthimit përdoret edhe standardi i ***përshtatjes kulturore kontekstuale***. Një standard i tillë bazohet në supozimin se fëmijët do ta kenë të vështirë të kuptojnë emrat e huaj, ushqimet dhe vendodhjet e panjohura dhe se ata mund ta refuzojnë një libër që pasqyron një kulturë të panjohur.[403] Për këtë arsye, përkthyesi transformon shenjat kulturore të origjinalit sipas kontekstit të kulturës së përkthimit dhe krijon një iluzion se teksti është shkruar në gjuhën dhe kulturën e vetë lexuesit. Prirjet e përshtatjes së tekstit sipas kontekstit të gjuhës së përkthimit mund të përshkruhen nëpërmjet termave të ndryshme. Ne kemi diskutuar në këtë punim rreth amëtarizimit dhe huajëzimit si dhe nivelit të dukshmërisë së përkthyesit në tekstin e përkthyer. Në këtë kre, do të diskutojmë fillimisht rreth shkallës së përshtatjes së origjinalit, duke prezantuar strategji të ndryshme brenda standardit të ***përshtatjes kulturore kontekstuale,*** një term i përdorur fillimisht nga Gëte Klingberg dhe i zgjeruar më tej si një term "çadër" që mbulon strategji të ndryshme për të transmetuar tekstin origjinal drejt lexuesve fëmijë në kulturën e përkthimit.[404] Të gjitha strategjitë e ndryshme që përfshihen brenda përshtatjes kulturore kontekstuale do të pasqyrohen me shembuj nga korpusi ynë konkret. Do të sjellim shembuj për të pasuruar edhe më shumë studimin krahasimor për të ilustruar konkretisht disa standarde të tjera në përkthimin e letërsisë për fëmijë si modernizimi, purifikimi, disa aspekte të gjuhës, shkurtime, referime ndaj vendodhjes gjeografike si dhe keqpërkthime – të gjitha këto duke ndjekur terminologjinë e përdorur nga studiuesi Klingberg, për të cilën do të flasim më hollësisht në brendësi të këtij kreu. Në çështjen e dytë do të sjellim sërish një sërë shembujsh, kësaj here për të treguar se si thjeshtëzimi mund të shfaqet në nivelin sintaksor dhe çfarë ndryshimesh vërehen në përkthimin e fjalive të përbëra. Do ta mbyllim këtë kre duke përzgjedhur sërish disa shembuj nga korpusi ynë, kësaj radhe për të shfaqur disa anë problematike të vërejtura gjatë krahasimit të vazhdueshëm të teksteve origjinale me përkthimet e tyre në gjuhën shqipe.

V.1 Shkallë të ndryshme të përshtatjes si një nga standardet e përkthimit të letërsisë për fëmijë

Në fillim të këtij punimi kemi përmendur se përkthimi mund të konceptohet edhe si një proces transferimi jo vetëm nga një gjuhë në tjetrën por edhe nga sistemi i të rriturve në

[402] M. Rudvin, F. Orlati (2006). *Dual Readership and Hidden Subtexts in Children"s Literature: The Case of Salman Rushdie"s Haroun and the Sea of Stories*. Në J. van Coillie, V. P. Walter (eds.), *Children's Literature in Translation. Challenges and Strategies*, Manchester: St. Jerome Publishing, fq. 157-184; fq. 163.

[403] G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature: A Reader*. Clevendon: Multilingual Matters, fq. 7.

[404] Po aty, fq. 7.

sistemin e fëmijëve.[405] Ky proces transferimi nga letërsia e synuar për të rritur në sistemin e letërsisë për fëmijë mund të ndodhë vetëm në ato raste kur librat janë të përshtatshëm për fëmijë, dhe, atëherë kur ata nuk janë të tillë, përkthyesit mund të bëjnë disa ndryshime në tekstin origjinal. Shkalla deri në të cilën këto ndryshime mund të realizohen është e ndryshme dhe, nëpërmjet shembujve të përfshirë në këtë çështje, ne do përpiqemi të tregojmë disa nga mënyrat e transformimit të origjinalit dhe niveli deri në cilin një transformim i tillë është i lejueshëm apo i tolerueshëm.

Studimet përkthimore në fushën e letërsisë për fëmijë kanë përfituar shumë nga kontributi i dhënë nga studiuezi suedez Gëte Klingberg, të cilit shpesh i referohen si babai i kërkimeve suedeze në letërsinë për fëmijë, megjithatë, studimet e tij janë shtrirë përtej kufijve suedezë. Për qëllimet e studimit tonë, do t'i referohemi në mënyrë të veçantë strategjive të përkthimit të letërsisë për fëmijë të cilat ai i prezanton në veprën e tij *Children's Fiction in the Hands of Translators*. Kjo vepër (Letërsia për Fëmijë në Duart e Përkthyesve) botuar në vitin 1986 është një kontribut i përmasave madhore në studimin e letërsisë për fëmijë, ku studiuesi diskuton se si përkthehen librat për fëmijë dhe se si duhet të përkthehen ata.[406] Ai shqyrton libra me meritë letrare, që në përkthim nënkuptojnë një shtim me vlerë në fondin e letërsisë për fëmijë në gjuhën e përkthimit. Sipas Klingbergut, duhet që të njihen problemet praktike në këtë proces kalimi. Për këtë arsye, një trajtim sistematik i problemeve të ndryshme që ndodhin gjatë përkthimit dhe mënyra se si mund të zgjidhen ato paraqet interes për botuesit dhe për mësuesit dhe përkthyesit. Bazuar në studimet e tij, Klingberg komenton dy qëllime të rëndësishme pedagogjike të cilat kërkojnë që origjinali të ndryshohet gjatë përkthimit. Ai argumenton se një nga qëllimet e letërsisë për fëmijë është që fëmijët të kenë një tekst që mund ta kuptojnë. Megjithatë, meqenëse të vegjlit kanë më pak njohuri në lidhje me kulturën e huaj se sa të rriturit, përkthyesi është nën tundimin apo nën detyrimin për të ndryshuar apo për të fshirë pjesë të tekstit më shumë në një vepër për fëmijë nga ç'do të bënte në një libër për të rritur, duke pasur parasysh arritjen e kuptueshmërisë. Një tjetër qëllim pedagogjik është kontribuimi në nivelin e zhvillimit të vlerave të lexuesve. Kjo do të thotë se, nëse përkthyesi përballet me vlera të tilla në origjinal të cilat mendon se janë të papërshtatshme për t'iu përcjellë lexuesve të tekstit të përkthyer, ai mund të marrë vendimin për t'i fshirë ose për t'i ndryshuar ato.[407]

Sipas Klingbergut, shpesh ndodh që elementët kulturorë brenda tekstit origjinal të mos jenë të njohur për lexuesit e përkthimit. Nëse përkthyesi do t'i përcjellë si të tillë këta elementë, shkalla e përshtatjes së tekstit do të jetë minimale, gjë që do të rezultojë në një tekst të vështirë për t'u kuptuar, ose ndoshta më pak interesant për lexuesit e përkthimit se sa për lexuesit e origjinalit. Për këtë arsye, përkthyesi mund të bëjë një përshtatje më të ndjeshme për publikun e ri. Kjo përshtatje është emërtuar si *përshtatje kulturore kontekstuale.*[408] Klingbergu i përmbahet idesë se ne nuk duhet ta kuptojmë përkthimin vetëm siç praktikohet në perëndim, por edhe në kultura të tjera. Edhe pse globalizimi është tashmë një realitet, shumë njerëz akoma kapen pas pikpamjes së tyre mbi botën dhe do të parapëlqenin të kishin lidhje me ato lloj realitetesh që ata i njohin më mirë. Kështu që, për të përkthyer një tekst nga një kulturë në një tjetër, duhet që të përzgjedhim mes një sërë strategjish të mundshme. Shkurtimisht, normat e kulturës për të

[405] Z. Shavit (1986) *Poetics of Children's Literature*. Athens, University of Georgia Press, fq. 111.
[406] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of Translators.* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq. 7.
[407] Po aty, fq. 10.
[408] Po aty, fq. 11-12.

cilët synohet të përcillet përkthimi duhet të merren gjithmonë parasysh nëse shpresohet që përkthimi të jetë i suksesshëm për atë kulturë.[409]

Përkthyesi, duke u vendosur në rolin e një ndërmjetësi, duhet që të gjejë një ekuilibër ndërmjet kulturës së origjinalit dhe të përkthimit. Sipas Hermansit, gjithë përkthimet nënkuptojnë një shkallë manipulimi të tekstit origjinal për ndonjë qëllim të caktuar.[410] Përkthimi nuk mund të lexohet asnjëherë si një shkrim transparent, apo si një pasqyrim i saktë i tekstit origjinal, por shoqërohet nga një ndikim i qëllimshëm i përkthyesit në këtë shkrim. Ka një sërë mënyrash se si përkthyesi mund të shfaqë ndikimin e tij në tekstin e përkthyer. Siç e përmendëm më lart, ai mund të ndikojë në aspektin kulturor, por, gjithashtu, ai mund të ndikojë edhe në aspektin pedagogjik, duke e vënë veten e tij në rolin e një edukatori. Studiuesja Shtolt na paralajmëron se fëmijët nuk janë kaq naivë sa të mos kuptojnë dot argumenta dhe emocione të ndërlikuara.[411] Sipas saj, përkthim i një libri me synime të qarta për ta korrigjuar atë në mënyrë të tillë që publiku i përkthimit të edukohet nuk është qëndrimi i duhur.[412] Ajo na paralajmëron se kur një përkthyes e përshtat librin në mënyrë të tillë sipas nevojave të kontekstit të ri, ai duhet të jetë i kujdesshëm: "Nëse përshtatja është vërtet e domosdoshme, duhet të bëhet me kujdes, sa më pak të jetë e mundur dhe në bashkëpunim me shkrimtarin.[413] Edhe Kristianë Nord na tërheq vëmendjen për faktin se përshtatja e një vepre për të pasqyruar realitetin vendas nuk do të thotë që përkthyesit duhet të zëvendësojnë njësitë e huaja me ato vendase në të gjitha rastet e shfaqjes së tyre. Librat për fëmijë kanë rëndësi sepse i sjellin më afër njerëzit e botës. Fëmijët duhet të zbulojnë heroj të rinj dhe ide të ndryshme nga ato të cilat ata i njohin më së miri.[414] Të gjitha këto komente duhet të na bëjnë të kuptojmë se sa të kujdesshëm duhet të tregohen përkthyesit gjatë përdorimit të përshtatjes si një nga mënyrat për ta bërë tekstin sa më të kuptueshëm për fëmijët dhe nëse është vërtet e dëshirueshme apo e domosdoshme një gjë e tillë.

V.1.1 Përshtatja kulturore kontekstuale

Sipas Klingbergut, shkalla në të cilën karakteristikat e lexuesve të rinj merren në konsideratë mund të cilësohet si *shkalla e përshtatjes*. Ndryshimet e bëra nga ana e përkthyesit përfshihen nën termin përshtatje kulturore kontekstuale dhe ato do ta ndihmojnë lexuesin në moshë të re për ta kuptuar më mirë origjinalin. Çështjet problematike mund të përfshijnë referenca letrare, gjuhë të huaja, referenca mitologjike dhe historike si dhe besime fetare dhe politike, ndërtesa, ushqime dhe pije, norma dhe zakone, aktivitete festive, emra të përveçëm dhe tituj, hierarki shoqërore, emra gjeografikë, njësi matëse të llojeve të ndryshme, tabu të tilla si referimi ndaj marrëdhënieve seksuale, procesit të defektimit, dhunë, çështje raciale, vdekje, vulgarizëm, etj. Gjithsesi, nuk mund të lemë jashtë vëmendjes sonë faktin se, duke ia nënshtruar transformimit shenjat kulturore të origjinalit, krijohet gjithmonë një besim i rremë te lexuesit e tekstit të përkthyer që ata po e lexojnë tekstin si të ishte shkruar në

---

[409] P. Zlateva (1990) *Translation: Text and Pre-text 'Adequacy' and 'Acceptability' in Crosscultural Communication.* Në *Translation, History and Culture*. (ed.) S. Bassnett, A. Lefevre. London and New York: Pinter Publishers., në Lefevere, et al. fq.10-12.

[410] T. Hermans (ed.) (1985) *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*. London and Sydney: Croom Helm, fq. 11.

[411] B. Stolt (1978) *How Emil becomes Michel: On the translation of children's books* në *Children's Books in Translation*. (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell, fq. 133, 145.

[412] Po aty, fq. 133.

[413] Po aty, fq. 145.

[414] W. Bussewitz (1978) *The Role of Soviet Children's literature in the GDR*. Në *Children's Books in Translation*. (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell: 51-59, fq. 55.

gjuhën dhe kulturën e tyre dhe kjo gjë mund të jetë iluzion me ndikime negative. Edhe vetë Klingbergu na paralajmëron kundër përshtatjes kulturore kontekstuale të zbatuar deri në ekstrem, duke rekomanduar që përshtatja të kufizohet në hollësira dhe teksti origjinal të manipulohet sa më pak të jetë e mundur. Edhe studiuesja Lejdhi i bashkohet këtij mendimi, duke nxjerrë në pah se lexuesit e rinj nuk do të tërhiqeshin dhe emocionoheshin nga një tekst nëse ai nuk paraqet diçka të ndryshme, të panjohur. Në po të njëjtën mënyrë, Otinen mirëpret idetë e reja dhe vlerat kulturore të importuara në kulturën e përkthimit.[415]

Nëpërmjet studimit të tij të thellë të librave për fëmijë të përkthyer, Klingbergu identifikon gjithsej nëntë strategji të ndryshme që përfshihen në përshtatjen kulturore kontekstuale. Gjatë studimit tonë kemi lexuar paralelisht tekstet origjinale dhe përkthimet e tyre në gjuhën shqipe, duke mbajtur shënime të hollësishme në lidhje me çështjet e sipërpërmendura për të cilat është përdorur standardi i përshtatjes kulturore kontekstuale. Numri i shembujve të gjetur është tejet i lartë, megjithatë, ne po përmendim më poshtë shembuj ilustrues për secilën prej strategjive. Po fillojmë duke përshkruar secilën prej strategjive dhe duke sjellë shembuj përqasës për çdo rast. Ato janë si më poshtë vijon:

a. Shpjegimet shtesë

Elementi kulturor i origjinalit ruhet në tekstin e përkthyer por shtohet edhe një shpjegim shtesë brenda tekstit. Në këtë mënyrë, ruhet njësia kulturore, megjithëse duhet të tregohet kujdes nga ana e përkthyesit në mënyrë që teksti të mos tingëllojë artificial dhe duhet shmangur veçanërisht në rastet e dialogjeve.

Shembulli 1 I have seen him do *the summerset* several times together, upon a trencher fixed on the rope, which is no thicker than a common packthread in England. (GT, fq. 35)	E kam parë shumë herë duke bërë atë *kërcimin e rrezikshëm* (*që ne, anglezët, e quajmë kërcimi i vdekjes)* mbi një dërrasë të vogël druri, të lidhur te një tërkuzë, jo më e trashë nga gajtani ynë. (UG, fq. 44)
Shembulli 2 … and having a Pot for that purpose, I boil'd, or stew'd some of the Flesh, and made some very good *Broth*; (RC, fq. 179)	... zjeva një copë të mirë në një kusi që mbaja për këtë punë dhe bëra *një supë ose jahni të shijshme.* (RK, fq. 190)
Shembulli 3 Let's try again. Potter, where would you look if I told you to find me a *bezoar*? (HPaPS, fq. 101)	Të shohim diçka tjetër, Poter, në rast se të them të më gjesh *një gur bezoari,* ku do ta kërkosh? (HP, fq. 113)

Siç mund ta shikojmë edhe më sipër, shpjegimet për elementët kulturorë jepen brenda tekstit (në kllapa ose menjëherë përpara apo pas njësisë kulturore).

[415] G. Lathey (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature: A Reader*. Clevendon: Multilingual Matters, fq. 7, 8, 43.

b. Rifjalësimi

Rishprehet ajo që thuhet në origjinal por pa përmendur elementin kulturor. Në këtë mënyrë, fjalitë mund të mos kenë të njëjti nivel saktësie si në origjinal, megjithatë, në përgjithësi, niveli i shpjegimit është zakonisht i mjaftueshëm për të përcjellë idenë e përgjithshme.

Shembulli 1

…administer to each of them *lenitives, aperitives, abstersives, corrosives, restringents, palliatives, laxatives, cephalalgicks, ictericks, apophlegmaticks, acousticks, as their several cases required* …(GT, fq. 201)	…t'u jepnin gjithë senatorëve me radhë *nga një bar për të tkurrur organet e sëmura, për të lehtësuar dhembjen, për të dalë jashtë në rregull, për të ulur dhembjen e kokës, për të qetësuar krizat histerike, për të mjekuar veshët, dhe shumë barëra të tjera sipas sëmundjes*. (UG, fq. 219)

Shembulli 2

… so that I was able to turn my head *about two inches*. (GT, fq. 16)	…kështu që tani mund ta luaja *një çikë* qafën. (UG, fq. 22)

Shembulli 3

My Beard I had once suffer'd to grow till it was *about a quarter of a Yard long*... (RC, fq. 127)	...një herë lashë mjëkrën e m'u rrit *ndonjë pëllëmbë*... (RK, fq. 137)

Shembulli 4

... thickned my Wall to *above ten Foot* thick (RC, fq. 136)	... ledhi arriti *një metër e gjysmë* trashësi (RK, fq. 146)

Shembulli 5

put in *five or six Pound* of Gun-powder (RC, fq. 142)	të shtija në dhé *ndonjë kile a një e gjysmë* barut... (RK, fq. 153)

Shembulli 6

... she was now only *ten inches high*... (AAiW, fq. 13)	Tani ajo kishte mbetë *vetëm nji pëllâmbë e naltë*. (V.I, fq. 16)	Ajo qe katandisur *vetëm një pëllëmbë njeri*. (V. II, fq. 8)	Ajo qe katandisur *vetëm një pëllëmbë njeri*. (V. III, fq. 16)	Liza qe zvogëluar dhe *nuk ishte më e gjatë se njëzet centimetra*. (V. IV, fq. 13)

Shembulli 7

Dudley was now having a tantrum and throwing his *cereal* at the walls. (HPaPS, fq. 8)	... fëmija po flakte *biskotat prej tërshëre* pas murit. (HP, fq. 8)

Shembulli 8

Marge's ill,' he informed Aunt Petunia. 'Ate a funny *whelk* ...' (HPaPS, fq. 30)	-Marxhi nuk është mirë, - i tha teze Petunias. – Seç ka ngrënë *një frut deti* të çuditshëm ...(HP, fq. 33)

Shembulli 9

Their feather rose off the desk and hovered *about four feet* above their	Pupla u ngrit nga banka dhe mbeti pezull në ajër *rreth një metër e gjysmë* përmbi

heads. (HPaPS, fq. 127)	kokat e tyre. HP, fq. 33)

Shembujt e mësipërm na tregojnë se si nëpërmjet kësaj strategjie të përshtatjes kulturore kontekstuale janë rifjalësuar elementë kulturorë të natyrave të ndryshme, duke u zëvendësuar me shprehje që janë karakteristike për kulturën shqiptare, duke e bërë tekstin më të kuptueshëm për lexuesit në gjuhën shqipe. Pavarësisht se nuk përcillet i njëjti nivel saktësie si në origjinal, sërish arrihet të krijohet ideja e përgjithshme edhe në tekstin e përkthyer.

c. Përkthimi shpjegues

Përcillet funksioni ose përdorimi i elementit kulturor por nuk përdoret emri i tij i huaj. Kjo është një strategji e dobishme meqenëse përcjell kuptimin konotativ ose funksionin e elementit kulturor, duke shmangur ndërhyrjet e kulturës së huaj. Megjithatë, edhe kjo strategji është mirë të shmanget në raste dialogjesh.

Shembulli 1

There was no *'One, two, three, and away,'* but they began running when they liked, and left off when they liked, so that it was not easy to know when the race was over. (AAiW, fq. 18)	Nuk pati asnjë komandë "*gati, vëmendje a para marsh"*. Përkundrazi secili niste të vraponte e të ndalonte sipas dëshirës, kështu që nuk ishte e thjeshtë të kuptohej kur përfundoi maratona. (V. V, fq. 33)

Shembulli 2

… and it sat for a long time *with one finger pressed upon its forehead (the position in which you usually see Shakespeare, in the pictures of him)* (AAiW, fq. 38)	...ndêjti për nji kohë të gjatë *me gisht në tâmth*, ... (V.I, fq. 31).	... ndjejti për një copë herë *me gjisht në kokë*... (V. II, fq. 32)	... pasi ndenji një copë herë *me gishtin kokës*, ... (V. III, fq. 32-33).

Në të dy rastet, përkthyesit kënë përcjellë për lexuesit në gjuhën shqipe vetëm funksionin e elementit të huaj kulturor, por jo vetë elementin.

ç. Shpjegimi jashtë tekstit

Shpjegimet jashtë tekstit mund të jenë në formën e shënimeve në fund të faqes, në fund të librit, në parathënie, etj. Ka lexues që mendojnë se shënimet janë të bezdisshme, kështu që ato duhet të përdoren me kujdes nga përkthyesit që të mos ndërpresin në mënyrë artificiale procesin e leximit, veçanërisht në rastin e lexuesve të rinj. Megjithatë, duhet thënë se shpjegimet jashtë tekstit ofrojnë një mënyrë më të mirë për të informuar lexuesit sesa shpjegimet brenda tekstit.

Shembulli1

I wonder how many *miles* I've fallen by this time? (AAiW, fq. 12)	Kush e di sa *milje** do të kem zbritur. (*shën. përkth. *Masë për matjen e largësisë. Një milje=1524 metra*.) (V. III, fq.12)

Shembulli 2

This liquor tasted like a small *cyder*, and was not unpleasant. (GT, fq. 93)	Pija i ngjante në shije *sidrës** dhe nuk më vinte e keqe. [*shën. përkth. *Cidre (frëngjisht), cyder (anglisht) = një farë vere, që nxirret nga molla. Mjeda ka përdorur fjalën sider.*] (UG, fq. 103)
Shembulli 3	
…I perceived it to be a human creature *not six inches high*… (GT, fq. 16)	…një njeri të gjallë, *që nuk e kishte shtatin as gjashtë gishtërinj të gjatë** (*shën. përkth. *Masa e gishtit është baras me një të dymbëdhjetën e këmbës, ose afro 7 milimetra. Prandaj të gjashtë gishtërinjtë janë pak më shumë se gjashtëmbëdhjetë centimetra.*) (UG, fq. 21)
Shembulli 4	
…my country was governed by a female man, whom we called '*queen'*. (GT, fq. 159)	…kisha dalë nga atdheu im – që e qeveris një grua, të cilën e quajmë *mbretëreshë** … (* shën. përkth. *Mbretëresha Anë: 8 mars 1702 – 12 gusht 1714*) (UG, fq. 280)
Shembulli 5	
He often buildeth his largest men of war, whereof some are *nine foot long*, in the woods where the timber grows, and has them carried on these engines three or four hundred yards to the sea. (GT, fq. 21)	Perandori ka ca makina të mrekullueshme pëe mbartje, që mund të ngrenë anije lufte (nganjëherë *nëntë këmbë* të gjata*)dhe t'i shpien nga pyjet ku janë ndërtuar, gjer në bregdet. (* shën. përkth. *këmba angleze është afro 32 centimetra*) (UG, fq. 28)
Shembulli 6	
…we labour under two mighty evils; a violent faction at home, and the danger of an invasion by a most potent enemy from abroad. As to the first, you are to understand, that for above seventy moons past, there have been two struggling parties in this empire, under the names of Tramecksan, and Slamecksan, from the high and the low heels on their shoes, by which they distinguish themselves. (GT. fq. 44)	…vendi ynë…ka dy re të zeza mbi kokë: nga brenda po e bren një luftë e tërbuar partish*, nga jashtë i kërcënohet ta shkelë një armik shumë i fuqishëm. Sa për pikën e parë, lypset ta dini se prej më se shtatëdhjetë hënash po hahen dy parti kundershtare për të marrë fuqinë në dorë, që quhen Tamecksan e Slamecksan, shqip, thembërlartë e thembërshkurtër, se të dy partitë dallohen nga njëra-tjetra prej thembrave të larta ose të shkurtra të këpucëve. (* shën. përkth. *Duket qartë se e ka fjalën për dy partitë angleze, Vig e Tori.*) (UG, fq. 57)
Shembulli 7	
He desired I would stand *like a Colossus*, with my legs as far asunder as I conveniently could. (GT, fq. 39)	…m'u lut të qëndroja *shtruar, me këmbët sa më të hapura, siç qëndron ai vigani i Rodit…*((* shën. përkth. *Vigani i Rodit është statujë prej bakri 72 m. e lartë, që ndodhet para hyrjes së limanit të qytetit të*

	Rodit. Sipas gojëdhanës, këmbët e hapura së tepërmi të kësaj statuje shërbenin si porta ku kalonin anijet.) (UG, fq. 48)

Shembulli 8

I brought Home *L. 5.9 Ounces** of Gold Dust for my Adventure, which yielded me in *London* at my Return, almost 300 *l.* …. (RC, fq. 17)	…fitova nga malli im *pesë libra** (*shën. përkth. *masë peshe prej 409,5 gramësh*) dhe nëntë une* (*shën. përkth. *masë peshe prej 28.35 gramësh*) flori pluhur, nga i cili nxora, kur u ktheva në Londër, afro 300 stërlina … (RK, fq. 32)

Të gjithë shembujt shërbejnë për të ilustruar strategjinë e shpjegimit jashtë tekstit. Shpjegimet jepen në fund të faqes ose në fund të librit të përkthyer, dhe, në rastet konkrete të përmendura, përdoren për të qartësuar elementë të huaj kulturorë që kanë të bëjnë me pije, njësi matëse të llojeve të ndryshme ose për të qartësuar elementë kulturorë specifikë të një mjedisi të huaj dhe ndoshta të panjohur, si mbretëresha, ndasitë partiake, apo vigani i Rodit.

d. Zëvendësimi me një ekuivalent në kulturën e gjuhës së përkthimit

Kjo strategji ka të bëjë me ndryshimin e elementëve specifikë kulturorë duke i zëvendësuar ata me një element që ka status të njëjtë në kulturën e gjuhës së përkthimit. Përdorimi i kësaj strategjie justifikohet me faktin se procesi i të lexuarit dhe interpretuarit do të ishte më i rrjedhshëm nëse fjalia do t'i referohej diçkaje të njohur brenda kulturës së përkthimit. Kujdes i veçantë duhet të tregohet nga ana e përkthyesit kur përdor këtë strategji sepse mund të shkaktohen një sërë problemesh në lidhje me nivelin e elementëve të huaj që duhet të përcillen gjatë përkthimit.

Shembulli 1

…about *half a pint* of brandy that I drank as I left the ship… (GT, fq. 15)	…*një gjysmë brojcë* me raki që kisha rrëkëllyer para se të dilja nga anija…(UG, fq. 21)

Shembulli 2

…sat down at my table to eat *a piece of sweet-cake* for my breakfast…(GT, fq. 114)	…u ula te tryeza, ku nisa te haja *një tortë të shijshme*…(UG, fq. 130)

Shembulli 3

Within seconds it was the greyish white of *old porridge*. (HPaPS, fq. 31)	Brenda pak sekondash i mori njw ngjyrw tw bardhw si nw hi, si *ermik i mykur*. (HP, fq. 33)

Shembujt tregojnë se si përkthyesi përdor strategjinë e zëvendësimit me elementë me status të njëjtë në gjuhën e përkthimit duke përzgjedhur njësi matëse, ushqime që njihen më mirë në kulturën e përkthimit.

Shembulli 4

It's always six o'clock ... always teatime. (AAiW, fq. 34)	*ora qëndron vazhdimisht gjashtë ... vazhdimisht kohë ngrënje* (V.II, fq.87)

Shembulli 5

Run in to your tea; it's getting	Tashti shko shpejt e pi *çajin*, se po	Shko të pish *çajin* se t'u bë vonë.	Shko të pish *çajin* se t'u bë	Por tani vrapo të *hamë*	... tani vrapo në shtëpi, ndryshe do të

late. (AAiW, fq. 52)	bâhet vonë. (V. I, fq. 134)	(V.II, fq. 141)	vonë. (V. III, fq.150)	*zemrën.* Është vonë (V. IV, fq. 158).	vonohesh për *çajin*. (V.V, fq. 149)

Është interesante t'i shohim nga afër shembujt 3 dhe 4. Në shembullim 3, përkthyesi i variantit të dytë përdor strategjinë e zëvendësimit duke iu referuar orarit të *ngrënies* dhe jo pirjes së çajit që nuk është karakteristike për kulturën shqiptare. Kështu, ai largohet disi nga origjinali kur shprehet se ora gjashtë është vazhdimisht kohë *ngrënieje* – në origjinal kjo është ora e çajit dhe ndoshta do të ishte mirë të transferohej si e tillë edhe në përkthim meqënëse është pjesë e zakoneve viktoriane të parodizuara nga Kerrëli dhe, për më tepër, personazhet paraqiten (edhe në figurë) duke pirë çaj, kështu shkaktohet një ngatërresë ndërsemiotike mes figurave dhe ngjarjeve të përshkruara. Në shembullin 4, mund të shikojmë se si varianti i katërt sërish largohet edhe më shumë nga origjinali kur, në fund të librit, motra e Lizës përmend se dielli po perëndon dhe duhet të hanë zemër – në fakt, ky nuk është orari që të konsumohet vakti që në shqip e quajmë zemër, por është përsëri ora për të pirë çajin. Përkthyesi, pra, ka zgjedhur sërish strategjinë e zëvendësimit me një element me status të njëjtë duke iu referuar kulturës shqiptare.

dh. Zëvendësimi me një ekuivalent të përafërt në kulturën e gjuhës së përkthimit

Nëpërmjet kësaj strategjie, elementi kulturor specifik i tekstit origjinal zëvendësohet me një element që ka pothuajse të njëjtin status në kulturën e përkthimit. Sërish, përdorimi i kësaj strategjie justifikohet nisur nga kërkesat për një proces leximi dhe të kuptuari më të lehtësuar në mungesë të "pengesave" të huaja. Megjithatë, nuk mund të mohojmë se, duke përdorur këtë strategji, përkthyesi nënkupton një nënvleftësim të lexuesve të tekstit të përkthyer, dhe, deri në një farë mase, edhe mund t'i keqinformojë ata.

Shembulli 1	
Would you care for *a sherbet lemon*?' (HPaPS, fq. 13)	A ju pëlqen një *akullore me limon?* (HP, fq. 14)
Shembulli 2	
Harry had torn open the parcel to find a thick, hand-knitted sweater in emerald green and a large box of *homemade fudge*. (HPaPS, fq. 147)	Harri e hapi pakon dhe nxorri një triko të trashë, të punuar me shtiza, ngjyrë smeraldi dhe një kuti *sheqerkash të buta e të bëra në shtëpi.* (HP, fq. 163)
Shembulli 3	
They sat by the hour eating anything they could spear on a toasting fork — *bread, English muffins, marshmallows* — and plotting ways of getting Malfoy expelled, which were fun to talk about even if they wouldn't work. (HPaPS, fq. 146)	Rrinin ulur aty me orë të tëra duke ngrënë gjithçka që mundtë tejshpohej me pirun dhe të piqej mbi flakë – *petulla, salçiçe, gështenja* – dhe duke sajuar plane që Mallfoi të përjashtohej nga shkolla: të gjitha këto gjëra ishin të këndshme për t'u biseduar, edhe pse zor se mund të realizoheshin. (HP, fq. 162)
Shembulli 4	
Ron had a piece of *steak-and-kidney pie* halfway to his mouth, but he'd forgotten all about it. (HPaPS, fq. 113)	Ronit i kishte mbetur në hava copa e *pastiços me mish*, sepse kishte harruar ta fuste në gojë. (HP, fq. 103)
Shembulli 5	
'This is Ron,' Harry told Hagrid, who was pouring boiling water into a large	-Ky është Roni – i tha Harri Hagridit, ndërsa ky i fundit po hidhte ujë të vluar

teapot and putting *rock cakes* on to a plate. (HPaPS, fq. 104)	në një ibrik të madh çaji dhe po vinte disa *biskota* në një pjatë. (HP, fq. 115)

Pesë shembujt e parë të shkëputur nga *Harry Potter and the Philosopher's Stone* shfaqin përdorimin e strategjisë së zëvendësimit të elementëve kulturorë që i referohen ushqimit me elementë kulturorë të përafërt të kulturës shqiptare.

Shembulli 6

... it's so useful, i*t's worth a hundred pounds.* (AAiW, fq. 17)	âsht shumë i dobishëm: *vlen qinda napolojna!* (V. I, fq. 27)

Shembulli 7

…when I saw his dishes of *the size of a silver three-pence*, a leg of pork hardly a mouthful, a cup not so big as a nutshel… (GT, fq. 157)	….kur shihja pjatat, që më ngjanin *sa një qindarkë*, kofshën e derrit, që s'ma zinte synë as për kafshatë, ose kupat, që më shëmbëllenin si lëvozhga arre. (UG, fq. 176)

Në këto dy raste, elementët kulturorë i referohen njësive monetare të huaja, të cilat janë zëvendësuar me njësi monetare të njohura në kulturën tonë shqiptare. Edhe pse njësitë nuk janë tërësisht ekuivalente me njëra-tjetrën, është krejtësisht e qartë që, në rastin e parë, bëhet fjalë për një shumë të konsiderueshme parash, dhe, në rastin e dytë, për një madhësi të vogël.

Shembulli 8

There were some Casks of Liquor, whether Wine or *Brandy* ... (RC, fq. 162)	Kishte ca fuçi me pije, nuk e di me verë a me *raki* ... (RK, fq. 172)

Kemi shkëputur këtë shembull për të treguar zëvendësimin e një pije të njohur për anglezët me një pije pak a shumë të ngjashme për shqiptarët.

Shembulli 9

…if the captain had not allowed me some of his best *bisket*, which rubbed to powder, and mingled with water, was their constant food. (GT, fq. 80)	…sikur të mos më jepte kapedani ca *biskota* të mira, që i bluaja dhe i përzieja me ujë. (UG, fq. 90)

Në këtë shembull është zëvendësuar një njësi kulturore në fushën e ushqimeve me një njësi me status pak a shumë të ngjashëm në gjuhën shqipe, mënyra e pregatitjes mund të mos jetë krejtësisht e njëjtë në të dyja kulturat, por, sërish, ushqimet janë shumë të përafërta.

Shembulli 10

it had, in fact, a sort of mixed flavour of *cherry tart, custard, pineapple, roast turkey, toffee, hot buttered toast.* (AAiW, fq.	... shishja kishte nji gjellë të përbâme me *qershija, gajgana*[416], *mollë-sheqeri, gjel të pjekun, ratafije, bukëza të*	... shishja kishte një lëng të këndshëm të përbërë nga *qershi, mollë sheqeri, gjel të pjekur, copëza buke të kuqura*	... shishja kishte një lëng aq të këndëshëm, që e kish shijen si *tortë me qershi, krem karamel, gjeldeti të pjekur, bukë*	Shija e saj kishte diçka që të kujtonte *tortën me qershi, me krem, me ananas, gjelin e pjekur, kërcitëset dhe kekun i*	Në shije ishte si përzierja e *tortës me qershi, omëletës së ëmbël, ananasit, gjelit të detit të pjekur ,*

[416] Nga *Fjalori i Shqipes së Sotme* (2002) *gajgana* – 1. vezë të fërguara së bashku me speca, me domate e me erëza, 2. Ëmbëlsirë që bëhet me vezë, me miell, me qumësht e me gjalpë dhe mbytet me sherbet. (fq. 275).

13)	*kuquna me tëlyen.* (V.I, fq. 16)	*me gjalpë.* (V. II, fq. 8)	*të thekur me gjalpë.* (V. III, fq. 16)	*ngrohtë me gjalp.* (V. IV, fq. 13)	*biskotave dhe bukës së thekur me gjalpë.* (V. V, fq. 16)

Edhe në këtë rast kemi përzgjedhur një shembull nga gastronomia. Ushqimet, në fakt, përbëjnë një nga elementët më të rëndësishëm në letërsinë për fëmijë, sepse fëmijët tërhiqen shumë nga elementë të tillë. Mund të shikojmë se sa interesante është të vërehen nga afër përzgjedhjet e përkthyesve të ndryshëm në krahasim me origjinalin, por edhe me njëri tjetrin. Në dy variantet më të hershme, për shembull, *pineapple* zëvendësohet me *mollë sheqeri*, në variantin e tretë me *krem karamel*, dhe vetëm në variantet e ditëve të sotme përkthehet si *ananas.* Ndërkohë që për *hot buttered toast* mbizotëron përkthimi me një element të ngjashëm *bukë të thekur me gjalpë*, përveç variantit të katërt që e zëvendëson me *kek i ngrohtë me gjalpë.* Po kështu zëvenësohet edhe *toffee* me *biskota* në variantin e pestë.

e. Thjeshtësimi

Thjeshtësimi si një nga strategjitë e përshtatjes kulturore kontekstuale ka të bëjë me përdorimin e një koncepti më të përgjithshëm në vend të një koncepti specifik. Elementët e huaj të kulturës së origjinalit nuk sillen në gjuhën e përkthimit, ato vetëm sa zëvendësohen me terma më të përgjithshëm. Në këtë mënyrë, "shija" e së huajës humbet dhe teksti i prodhuar orientohet ndaj gjuhës së huaj.

Shembulli 1

He had never had any money for candy with the Dursleys, and now that he had pockets rattling with gold and silver he was ready to buy as many *Mars Bars* as he could carry — but the woman didn't have *Mars Bars*. (HPaPS, fq. 76)	Sa kishte jetuar te Dërslit, s'kishte pasur kurrë para për ëmbëlsira, po tashti që xhepat sa s'po i shqyheshin nga ari dhe nga argjendi, mund të blinte të gjitha *çokollatat* që donte. Por në karrocë nuk kishte *çokollata*. (HP, fq. 85)

Shembulli 2

At last, *the puddings* too disappeared and Professor Dumbledore got to his feet again. (HPaPS, fq. 94)	Më në fund u zhdukën edhe *ëmbëlsirat* dhe profesor Urtimori u ngrit përësëri më këmbë. (HP, fq. 104)

Shembulli 3

Have some *bacon* or something, why aren't you eating anything?' (HPaPS, fq. 154)	Eja, ha ndonjë *kafshatë...* Pse nuk po ha mëngjes? (HP, fq. 171)

Mund të shikojmë se si janë "thjeshtësuar" koceptet specifikë të origjinalit në koncepte më të përgjithshme në gjuhën shqipe.

Shembulli 4

…he no sooner had it, but he runs to his Enemy, and at one blow cut off his Head as cleaverly,* *no Executioner in Germany,** could have done it sooner or better; …(RC, fq.172)	Pa e vënë mirë në dorë, i kërceu armikut posi shigjeta dhe ia hodhi kokën tej me një vringëllimë aq të shpejtë e të shkathët, *sa s'do t'ia kalonte asnjë xhelat në botë...(*RK, fq. 183)

Thjeshtësimi në këtë rast përdoret për të shmangur përdorimin e prejardhjes specifike të ekzekutuesit apo, siç shprehet përkthyesi, të xhelatit, i cili në gjuhën shqipe është thjesht një xhelat i botës dhe jo ai gjerman i përmendur (jo pa qëllim) në origjinal.

Shembulli 5

... and had in it Room for him to lye, with a Slave or two... (RC, fq.19)	... atje mund të flinin tre veta...(RK, fq. 35)

Sërish përkthyesi ka përdorur thjeshtësimin, këtë radhë duke mos dashur të përmendë në mënyrë specifike se vendi i lirë (por jo me shumë hapësirë) mund të mbushej me një ose dy skllevër, dhe, në këtë mënyrë, aty mund të qëndronin tre njerëz. Në shqip ne lexojmë thjesht se mund të flinin tre veta, në përgjithësi, pa e nënkuptuar (si në origjinal) se një ose dy të tjerë në mënyrë specifike duhet të qenë skllevër që të mund të rrinin disi më ngushtë.

Shembulli 6

Në këtë shembull janë thjeshtuar njësitë kulturore të origjinalit, duke i sjellë ato të

I found in one, a fine Case of Bottles, of an extraordinary kind, and fill'd with Cordial Waters, fine, and very good; the Bottles held about three Pints each, and were tipp'd with Silver: I found two Pots of *very good Succades, or Sweetmeats*, so fastned also on top, that the Salt Water had not hurt them; and two more of the same, which the Water had spoil'd: (RC, fq, 162)	... në njërën na kishte një arkëz me shishe, me një farë kordiali të rrallë e të shijshëm; secili prej tyre kishte ndonjë litër e gjysmë, dhe grykën e kishte të vulosur me krisaf. Pa gjeta edhe dy qyptha me *një ëmbëlsirë që të shkrinte në gojë;* qypthat ishin të lidhur aq mirë në grykë, sa nuk u kishte hyrë asnjë pikë ujë, kurse dy të tjera, po me këtë ëmbëlsirë, i kishte prishur kripa e detit. (RK, fq. 173)

përgjithësuari nëpërmjet një shprehjeje të vetme në gjuhën shqipe *ëmbëlsirë që të shkrinte në gojë.*

Shembulli 7

... also I found *three very good Bibles* which came to me in my Cargo from *England*, and which I had pack'd up among my things; some *Portugueze* Books also, and among them two or *three Popish Prayer-Books, and several other Books*, all which I carefully secur'd. (RC, fq. 56)	...pastaj kisha gjetur edhe *tri libra shumë të mira*, që më patën ardhur nga Anglia bashkë me plaçkat, ndonjë libër portugalisht *dhe ca vëllime të tj*era, që i ruaja me kujdesin më të madh. (RK, fq. 73)

E kemi përzgjedhur këtë shembull pasi është një nga referimet e para fetare në vepër ku personazhi kryesor bie në kontakt me Biblën, fillon ta shfletojë atë dhe, më vonë, shfaq në shumë raste mendimet e tij dhe besimin fetar që fillon të zhvillohet brenda tij. Pjesë të tilla, siç do të kemi rast të shikojmë më vonë nëpërmjet shembujve kur të diskutojmë mbi shkurtimin si një nga standardet e tjera gjatë përkthimit, janë lënë pa u përkthyer ose janë përkthyer me shkurtime të ndjeshme. I referohemi edhe një herë shembullit për të parë se si librat përmenden si libra të mirë apo si vëllime – pra, në përgjithësi, pa iu referuar në mënyrë specifike aspektit fetar të tyre.

Shembulli 8

I found different Fruits, and particularly I found Mellons upon the Ground in great Abundance, and Grapes upon the Trees; the Vines had spread indeed over the Trees, and the Clusters of Grapes were just now in their Prime, very ripe and rich. (RC, fq. 85)	gjeta pemë të ndryshme, po sidomos pjepra dhe degë hardhie, që plekseshin me degët e pemëve. (RK, fq. 98)

Në këtë shembull mund të shikojmë se si janë thjeshtësuar elementët kulturorë në gjuhën shqipe.

f. Fshirja

Nëpërmjet kësaj strategjie përkthyesi fshin fjalë ose pjesë fjalie, paragrafë deri edhe kapituj të plotë. Mund që një strategji e tillë të jetë edhe nën ndikimin e tregut (p.sh. kërkesë e vendosur nga shtëpia botuese ose redaktorët), ndërsa, në raste të tjera, mund të shërbejë si një mënyrë për të minimizuar elementët e huaj nga kultura e origjinalit. Kjo strategji mund të përdoret vetëm në raste ekstreme kur përdorimi i asnjërës nga strategjitë e mësipërme nuk u vjen në ndihmë përkthyesve, dhe, çka është edhe më e rëndësishme, atëherë kur fshirja e një fjale, fjalie, paragrafi ose edhe kapitulli nuk sjell ngatërresa, humbje kuptimi, apo mungesë koherence në ngjarjet e subjektit.

Shembulli 1

… and the Sea being very calm I kept a large offing* to make this Point; at length, doubling the Point *at about two Leagues from the Land*, I saw plainly Land on the other Side to Seaward; then I concluded, as it was most certain indeed, that this was the Cape de Verd, and those the Islands, call'd from thence Cape de Verd Islands.* (RC, fq. 29)	... në ato ujëra do të qenë ujëdhesat që i japin atij vendi emrin Kepi i Ishujve të Gjelbër. (RK, fq. 45)

Shembulli 2

... and as soon as they came to a little rising Ground, *at about half a Mile Distance*, I bad them hollow, as loud as they could, and wait till they found the Seamen heard them; (RC, fq. 222)	... me të ngjitur një të përpjetë të vogël, të thërritnin me të gjithë mushkëritë, gjersa të bindeshin se i kishin degjuar detarët. (RK, fq. 235)

Shembulli 3

... eighty poles, each of *one foot high*, were erected for this purpose. (GT, fq. 22)	... për këtë punë ngulën në tokë tetëdhjetë shtylla; (UG, fq. 28)

Shembulli 4

She was very good-natured, and not *above forty foot high*, being little for her age. (GT, fq. 99)	---------- (UG, fq. 109)

Shembulli 5

But she went on all the same, shedding *gallons of tears*, until there was a large pool around her...(AAiW, fq. 14)	Mirëpo përsëri vazhdoi të qajë derisa u formua një pellg i vërtetë rreth e përqark saj... (V. II, fq. 12)

Shembulli 6

In my youth, said the sage, as he shook his grey locks, I kept all my limbs very supple by use of this ointment – *one shilling the box* – allow me to sell you a couple? (AAiW, fq. 25)	Në të rí, përgjegji Tata, rueja mirë unë trup e krye t'ue ngran kso hapjesh t'thata: don t'i shes nj'a dy dhe tye? (V. I, fq.)

Shembulli 7

Soon her eye fell on a little glass box that was lying under the table: she opened it, and found in it a very small cake, on which the words 'EAT ME' were beautifully marked in *currants.* (AAiW, fq. 13)	Por shpejt vuri re një kuti qelqi të vogël nën tavolinë. Si e hapi, atje gjeti një kek të butë, në të cilin ishte vendosur bukur mbishkrimi "MË HA". (V. V, fq. 17)

Shembulli 8

They had a good time eating the Every-Flavour Beans. Harry got toast, *coconut*, baked bean, strawberry, *curry*, grass, coffee, sardine and was even brave enough to nibble the end off a funny grey one Ron wouldn't touch, which turned out to be pepper. (HPaPS, fq. 78)	U shkrinë duke ngrënë xhelatinat. Harri gjeti prej atyre që kishin shijen e bukës së thekur, të fasuleve të konservuara, të luleshtrydheve, të barit të njomë, të kafesë, të sardeleve, dhe pati zemër të ngjëronte edhe një me ngjyrë të përhimët që Roni as që kishte dashur ta çikte dhe që më vonë e moren vesh se kishte shijen e piperit. (HP, fq. 87)

Nëpërmjet gjithë shembujve të pasqyruar më lart, mund të shohim se si elementë përfaqësues kulturorë të origjinalit të llojeve të ndryshme, si, për shembull, njësi matëse, njësi monetare, ushqime, etj. janë minimizuar në përkthim.

g. Lokalizimi

Lokalizimi ka të bëjë me lëvizjen e gjithë atmosferës kulturore të tekstit origjinal afër lexuesve të tekstit të përkthyer. Nga të gjitha strategjitë, kjo është më radikalja sepse gjithçka duhet të ndryshohet për të përshtatur pritshmëritë dhe nivelin e të kuptuarit të lexuesve të tekstit të përkthyer. Përdorimi i kësaj strategjie kërkon një nivel të lartë përgjegjshmërie nga përkthyesit meqenëse keqpërdorimi i saj do të kishte rrjedhoja serioze në sjelljen e lexuesve të tekstit të përkthyer ndaj tekstit origjinal dhe synimeve të shkrimtarit origjinal. Klingbergu shprehet se kjo prirje mund të vrojtohet kryesisht në realizimin e filmave bazuar në librat për fëmijë, prandaj edhe shembujt që mund të gjejmë brenda korpusit tonë janë vërtet të kufizuar. Nuk mund të flasim për një lokalizim të shtrirë në të gjithë nivelin e teksteve të përkthyer, një gjë e tillë do të nënkuptonte që përkthimi të ishte vendosur tërësisht brenda kulturës shqiptare, me gjithë elementët përbërës të saj. Por, brenda korpusit tonë, ne kemi vërejtur disa "prirje" lokalizuese të cilat po i përmendim mes shembujve të mëposhtëm.

Shembulli 1

It may be rendered into English thus: 'May your coelestial Majesty out-live the sun, eleven moons and a half.'(GT, fq. 219)	*…dhe mund të shqipërohet kështu*: *Rroftë e qoftë Madhëria juaj qiellore e mbretëroftë edhe njëmbëdhjetë hëna e gjysmë pas diellit.* (UG, fq. 239)

Shembulli 2

My only concern is, that I shall hardly be able to do justice to my master's arguments and expressions, which must needs suffer by my want of capacity, as well as by a *translation into our barbarous English.* (GT, fq. 261)	E kam një çikë zemrën të thyer, se do të jetë shumë e vështirë t'i vë mirë e bukur në pah shprehjet e arsyetimet e timzoti, që do të çalojnë pa fjalë, meqë jam pak a shumë i cekët *dhe u dashka t'i përkthej në këtë anglishten tonë barbare.* (GT, fq. 282)

Shembulli 3

…she made two excuses, first to her husband, who, as she said happened that very morning to *lhduwhn.* The word is strongly expressed in their language, *but not easily rendered into English; it signifies, to retire to his first* mother. (GT, fq. 293)	…ajo kërkoi ndjesë për dy gjëra. Në ballë i lypi të falur për të shoqin, i cili atë mëngjes ishte *shuunh.* Në gjuhën e tyre kjo fjalë ka një kuptim të thellë dhe *s'është punë e lehtë të përkthehet në anglisht; do të thotë*: *ishte futur në gjirin e mëmës së parë.* (UG, fq. 317)
Shembulli 4	
My master and his friends continued on the shoar, until I was almost out of sight; and I often heard the sorrel nag (who always loved me) crying out, 'Hnuy illa nyha maiah Yahoo' (*Take care of thy self, gentle Yahoo*). (GT, fq. 303)	…Imzot dhe miqtë e tij qëndruan te rëra gjersa më humbën nga sytë; dhe dëgjova kush e di sa herë atë kalin murrak (i cili më kishte dashur me gjithë shpirt) që thirri me tërë fuqinë: *Hnuy illa nyha majah, jahu! Shqip: Ki mendjen, o jahu i dashur!* (UG, fq. 329)

Shembujt i kemi shkëputur ashtu siç shfaqen në rend kronologjik në origjinal dhe, rrjedhimisht, në përkthimin përkatës. Mund të shikojmë se si në shembullin e parë përkthyesi përdor lokalizimin duke iu referuar gjuhës shqipe, ndërkohë që origjinali flet për një përkthim në anglisht. Megjjithatë, edhe kjo gjë ka logjikën e vet, meqenëse e gjithë historia po rrëfehet në shqip. Sërish, vetëm pak faqe më pas, përkthyesi i referohet tashmë përkthimit jo në gjuhën shqipe, por përkthimit në këtë anglishten *tonë* barbare, siç mund ta shikojmë në shembullin 2. Edhe për shembullin e tretë përkthimi supozohet se bëhet në anglisht (paçka se fjalët janë në gjuhën shqipe). Shembulli i katërt shfaq përsëri përdorimin e lokalizimit, duke u shpehur se fjalia është përkthyer në shqipe. Mendojmë se përkthyesit duhet të tregohen veçanërisht të kujdesshëm me përdorimin e kësaj strategjie, dhe, nëse vendosin ta përdorin atë, të tregohen sa më koherentë në zgjedhjen e tyre dhe të dinë ta pozicionojnë mirë lexuesin, ose në një mjedis të huaj ku flitet gjuha vendase, ose në një mjedis të huaj ku flitet gjuha shqipe, ose në një mjedis shqiptar ku flitet gjuhë shqipe, etj., por jo një përzierje e gjithë këtyre së bashku. Përdorimi i kësaj strategjie gjithashtu kërkon koherencë edhe në qëndrimin e mbajtur ndaj gjithë njësive specifike kulturore të origjinalit, prandaj e theksojmë se është një vendim që duhet peshuar mirë nga ana e përkthyesit. Pra, a duhen ruajtuar apo duhen ndryshuar gjithë emrat e huaj, njësitë matëse, ushqimet, emrat e vendeve dhe referimet ndaj gjuhës, etj.? Në fund të fundit, nëse vërtet do të bëhet një gjë e tillë, sa e dëshirueshme është kjo? Çfarë interesi do të zgjojë një vepër e tillë te lexuesit që nuk paraqet asnjë njohuri të re dhe nuk nxit për eksplorime të mëtejshme rreth së panjohurës? Këto pyetje duhet t'i mendojë mirë përkthyesi që të arrijë të vendosë qëllimin e përkthimit dhe prirjet mbizotëruese në veprën që do të sjellë në gjuhën shqipe.

V.1.2 Aspekte gjuhësore

Në lidhje me përshtatjen gjuhësore, Klingbergu sjell argumentin se shkrimtari i letërsisë për fëmijë mund të kufizojë fjalorin, të përdorë fjali të shkurtra dhe të priret drejt përdorimit të foljeve ndaj emrave si dhe të shmangë metaforat me qëllim që të përshtatë tekstin e përkthyer sipas kapaciteteve të lexuesve.[417] Kjo prirje shfaqet sidomos në rastet e përkthimit të librave të cilat lexohen nga fëmijët, por që nuk janë shkruar ekskluzivisht për fëmijë në origjinal. Gjithashtu këtu mund të përfshihen aspekte të tilla të gjuhës si dialektet, gjuha jo-standarde dhe lojërat e fjalëve të cilat mund të thjeshtëzohen në tekstin

[417] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of Translators.* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq. 63.

e përkthyer, gjithmonë duke rrezikuar që ky i fundit të mos përcjellë synimet origjinale të shkrimtarit.

Shembulli 1

'I had *NOT*!' cried the Mouse, sharply and very angrily. 'A *knot*!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!' "I shall do nothing of the sort," said the Mouse. (AAiW, fq. 19)	- Ç'kthesë moj? – pyeti Miu shumë i zemëruar. - Ti më fyen vazhdimisht me ato marrëzi që flet! (V. III, fq. 37)

Shembulli 2

'It's a mineral, I think,' said Alice. 'Of course it is,' said the Duchess, who seemed ready to agree to everything that Alice said; *'there's a large mustard mine near here. And the moral of that is – "The more there is of mine, the less there is of yours." '* 'Oh, I know!' exclaimed Alice, who had not attended to this last remark. 'It's a vegetable. It doesn't look like one, but it is.' (AAiW, fq. 39)	"Unë mendoj se kulpra âsht mineral", tha Liza. "Me doemos!" ia ktheu Dukesha, e cila dukej përherë e gatishme me pranue çdo gjâ, që I thonte Liza. "Oh, po, e gjeta!" thirri Liza, që s'ua kishte vû veshin fjalëve të fundit të Dukeshës: "Kulpra âsht nji bimë. Nuk duket e tillë, po âsht se âsht!" (v.I fq. 98)

Të dy shembujt shërbejnë për të na treguar se si lojërat e fjalëve, një ndër format e përfshira në standardin e aspekteve gjuhësore, nuk janë përfshirë, duke e thjeshtësuar tekstin në duart e lexuesve.

Shembulli 3

I took nine of these sticks, and fixing them firmly in the ground in a quadrangular figure, two foot and a half square; I took four other sticks, and tyed them parallel at each corner, about two foot from the ground. (RC, fq. 37)	Nëntë prej tyre i ngula pingulthi përtokë dhe sajova një katror më brinjën dy këmbë e gjysmë të gjatë. (RK, fq. 46)

Nëpërmjet këtij shembulli mund të vërejmë një tjetër aspekt gjuhësor që shfaqet gjatë përkthimit, thjeshtësimi i fjalive, pra, përdorim i fjalive më të shkurtra kundrejt fjalive më të përpunuara të origjinalit.

Shembulli 4

Do let me help undo it! (AAiW, fq. 19)	Të ndihmoj ta zgjidhësh! (v. IV, fq. 37)

Shembulli 5

Pray don't trouble yourself to say it any longer than that.	Të lutem, mos u lodh shmë për të thënë gjëra kaq të vështira! (V. IV, fq. 114)

Shembulli 4 dhe 5 na tregojnë një tjetër aspekt gjuhësor, përdorimin e gjuhës në situata më formale dhe në formë politese. Një gjë e tillë është e dukshme në gjuhën angleze, por, në variantet e përkthyera një gjë e tillë nuk vërehet, duke qenë se është kaluar në përdorimin e vetës së dytë njëjës, ndërkohë që duhet të ishte përdorur forma e politesës *ju*. Kjo ndoshta dhe sepse nuk është identifikuar drejt përdorimi i *you*, forma e së cilit korrespondon edhe me njëjësin edhe me shumësin në anglisht, por nuk ndodh kështu në

gjuhën shqipe, sepse ndryshimi i vetës do të duhet të shoqërohet edhe me ndryshimet në folje, kundrejt origjinalit ku nuk ndodh një dukuri e tillë për shkak të mungesës së mbaresave.

Shembulli 6

Varianti / *AAiW*	***V. I***	***V. II***	***V. III***	***V. IV***	***V. V***
(Pat) *Sure then I'm here! Digging for apples, yer honour!*	(Pet) Sigurisht këtu, Zotni! Jam tue gërmue për molla!	(Pet) Këtu jam, zotëri. Po nxjerr molla dheu!	(Pati) Këtu jam, zotëri. Po nxjerr mollë dheu!	(Pat) Jam këtu! Po mbledh mollët, Shkëlqesi.	Eh, këtu jam. Po nxjerr mollë, Madhëria juaj!
Sure, it's an arm, yer honour! (He pronounced it 'arrum'.)	Nji krah, Zotni.	----------	Ai duket që është një krah, zotëri.	Një krah, vetëm një krah Shkëlqesi (shqiptoi vetëm Ëlqesi).	E di, dorë është, Madhëria juaj! (Ai shqiptoi "dorrë")
Sure, it does, yer honour: but it's an arm for all that.	Po, Zotni, âsht e vërtetë. Por, prap, krah se krah âsht.	Vërtet, zotëri, ashtu është. E megjithatë, ai është krah.	Vërtet, zotëri, ashtu është. E megjithatë, ai është krah.	E shoh, shkëlqesi, por është thjeshtë, një krah.	E di, ashtu është Madhëria juaj, megjithatë kjo është dorë.
Sure, I don't like it, yer honour, at all, at all! (fq. 21-22)	Besa, Zotni, s'më pëlqen aspak kjo punë. (fq. 41)	Zotëri, s'më pëlqen aspak kjo punë! (fq. 28)	Zotëri, s'më pëlqen aspak kjo punë! (fq. 44)	Nuk kam dëshirë, Shkëlqesi. Nuk kam dëshirë. (46-47)	E di, kjo nuk më pëlqen, Madhëria juaj! Nuk më pëlqen fare! (fq. 45)
Shembulli 7					
(Bill) *Well, I hardly know – No more, thank ye; I'm better now – but I'm a deal too flustered to tell you – all I know is, something comes at me like a Jack-in-the-box, and up I goes like a skyrocket.*	(Billi) As vetë s'e dij – *S'due mâ rakí, falem-nderës*; jam mâ mirë tashti – por jam mjaft i hutuem endé e s'mundem as të flas mirë – *Qe se çka vura ré unë:* Diçka më rà me fuqi nga	(Billi) As vetë s'e di. Mjaft. S'dua më raki, faleminderit, jam më mirë tashti, por jam shumë i hutuar dhe as mund të flas. – Ja ç'pashë: Diçka më goditi si ndonjë kuti bosh dhe	(Billi) As vetë s'e di. Mjaft. S'dua më raki, falemnderit, por jam shumë i hutuar dhe mezi mund të flas. Ja ç'ndodhi. Diçka më goditi papritur e pakujtuar dhe hop!	(Billi) Nuk e di ... Mjaft, faleminderit, tani jam më mirë ... Jam shumë i tronditur dhe nuk jam në gjendje ta shpjegoj ... Diçka si një kukull e madhe m'u sul përballë dhe më nxorri jashtë oxhakut si një raketë.	(Billi) Unë saktë nuk e di. Nuk di ç'të them, faleminderit, tashmë jam më mirë, por jam shumë i emocionuar që t'ua tregoj juve... të gjitha ato që di. Diçka më shtyu nga poshtë si kuti dhe

(fq. 22)	poshtë dhe... hajt! fluturova n'ajr! (fq. 43)	hop flururova n'ajër, si ndonjë raketë. (fq. 29-30)	fluturova në ajër si ndonjë raketë. (fq. 46)	(fq. 49)	unë fluturova ja si ... si raketë. (fq. 47)
Shembulli 8					
(Gryphon) It's all her fancy, that: they never executes nobody, you know. *He hasn't got no sorrow, you know.* *This here young lady, she wants for to know your history, she do.* *Drive on, old fellow! Don't be all day about it!* *You are a simpleton.* (fq. 40)	(Grifoni) Urdhënat e sajë për dënime s'janë veçse andrra, pse asnji prej të dënuemve s'âsht mbytë deri më tashti, a din? Dëshprimi i sajë s'âsht veçse nji ândërr. Kjo Zonja e ré, që shef këtu don me dijtë historinë t'ande. Vijo, mikja ime e vjetër! Mos na humb gjithë ditën duke të pritë. Je me të vërtetë e marrë. (fq. 102-104)	(Grifoni) Urdhërat e saj për dënime s'janë veçse ëndëra, sepse asnjë nga të dënuarit nuk është ekzekutuar deri tashti, a e di? Dëshpërimi i saj s'është gjë tjetër veç një ëndër! Kjo zonjë e re, që shikoni këtu, do të mësojë historinë tënde. Vazhdo, mikja ime e vjetër! Mos na humb gjithë ditën duke pritur! Je me të vërtetë e marrë! (fq. 106-108)	(Grifoni) Urdhrat e saj për dënime s'janë veç ëndrra, sepse asnjë nga të dënuarit nuk është ekzekutuar deri tani. Dëshpërimi i saj s'është gjë tjetër veç një ëndërr! Kjo zonjushe e re, që shikoni këtu, do të mësojë historinë tënde. Vazhdo, mikja ime e vjetër! Mos na lër gjithë ditën duke pritur! Je me të vërtetë e trashë nga trutë! (fq. 110-114)	(Grifoni) Dënimet me prerje koke janë vetëm në mendjen e saj. Nuk kam parë kurrë të vritet asnjë. Nuk ka asnjë thyerje zemre. Kjo zonjushë dëshiron të dëgjojë historinë tënde. Nxito, edhe ca plakushe! Mos na mba këtu gjithë ditën. Je një budallaçkë. (fq. 119-122)	(Grifoni) Këto të gjitha janë shpikjet e saj, nuk është aspak e dëshpëruar, e kupton? Tani këtu është një zonjushë, dhe ajo dëshiron të dijë historinë tënde. Ja, kështu. Vazhdo më tej, *plako*! Mos e zgjat gjithë ditën! Ti je syleshe. (fq. 113-116)

Këta tre shembuj i kemi shkëputur nga ligjërimi i atyre personazheve në AAiW, të cilët dallohen shoqërisht nga përdorimi i gjuhës nga ana e tyre. Le të shohim qëndrimin e mbajtur nga përkthyesit në secilin prej varianteve të ilustruar më lart. Gjatë analizës së shembujve, do t'i përmbahemi parimit sipas së cilit, në rast se ligjërimi idiosinkretik i personazheve është posaçërisht i përngjashmuar nga autori në mënyrë që të japë informacion plotësues mbi prejardhjen gjeografike, shoqërore, familjare, mbi gjendjen arsimore e kulturore të tyre si dhe marrëdhëniet e vendosura me personazhet e tjerë,

atëherë në gjuhën e përkthimit duhet të përcillen elementë të veçantë, deri në atë shkallë sa të realizohet zhvendosja në planin lokal gjeografik; kështu, rekomandohet që elementët dialektorë të origjinalit të mund të përcillen në gjuhën e përkthimit me forma të ligjërimit bisedor ... në mënyrë që të mund të përcillen vlerat shprehëse dhe informacioni plotësues i veprës së përkthyer.[418]

Nisur nga të dhënat në tekst nuk e kemi shumë të qartë se çfarë lloj krijesash janë *Pat* dhe *Bill*, por mënyra e të folurit në anglisht të këtyre personazheve ka domethënie të veçantë dhe i identifikon ata si personazhe që i përkasin klasave të ulëta shoqërore, ndoshta janë bujq, dhe, ka shumë mundësi, irlandezë (mënyra e shqiptimit *arrum* lidhet me një theks tipik për Anglinë veriore ose Skocinë). Gjithashtu, mund të shikojmë në tabelën e mësipërme se edhe Grifoni ka një mënyrë të foluri të shenjuar nga pikpamja e standartit të gjuhës angleze. Ajo çka na intereson të nxjerrim në pah është qëndrimi që mbajnë përkthyesit, pra, a do të kemi një gjuhë të shenjuar edhe në shqip (që do të kërkonte përdorimin e një dialekti a të shprehjeve dialektore, apo thjesht mungesë të kohezionit gjatë ligjërimit të personazheve)? Për të ruajtur edhe në përkthim vlerat artistike të origjinalit është e domosdoshme t'i shmangemi të folurit të rrafshtë të karaktereve. Kjo kërkon që në përkthim t'i pasqyrojmë karakteristikat e të folmeve të secilit prej tyre pasi përkthimi me anën e metodës së emëruesit të përbashkët gjuhësor cënon gjithashtu individualitetin e karaktereve dhe ul vlerat shprehëse të origjinalit.[419] Në fakt, në të pesë variantet ligjërimi i personazheve është standartizuar, nuk kemi të bëjmë me përdorime të gjuhës të shënjuara shoqërisht. Ndoshta ky vendim i përkthyesve është nisur nga fakti se përkthimi u drejtohet fëmijëve. Më lart kemi veçuar dy raste ku përkthyesi na bën të ditur se ka diçka që nuk shkon në mënyrën e shqiptimit të fjalëve nga ana e Patit, por nuk arrihen të qartësohen arsyet e një qëndrimi të tillë. Në shembujt e mësipërm do të ishte me vend të ndiqej nga ana e përkthyesve këshilla e dhënë nga *Gëzim Hadaj* mbi gjendjen shoqërore të folësit: *kur ligjërata e drejtë e personazheve karakterizohet në plan horizontal (krahinor) dhe jo në planin shoqëror (stilistik), atëherë dialektin e origjinalit e kthejmë në ligjërim bisedor të gjuhës së përkthimit ... shtresimi bisedor jep një informacion të ndërmjetëm midis gjuhës letrare dhe dialektit ... ka rëndësi t'i japim gjuhës së personazhit një ngjyrim të lehtë krahinor, të krijojmë të njëjtën përshtypje a mbresë si në origjinal me anën e zgjedhjes së barazvlerësve të ngjashëm komikë në gjuhën e përkthimit. shkrimtari i përdor krahinorizmat në funksion stilistik për të tipizuar gjendjen shoqërore të folësit ... karakterizimi i personazheve në përkthim bëhet duke i përqasur veçoritë e të folmeve të tyre me veçoritë gjegjëse të atyre dialekteve, të cilat në gjuhën e përkthimit kanë funksione të përafërta stilistike.*[420] Një gjë e tillë nuk është realizuar dhe ne mund të arrijmë në përfundimin se ligjërimi i personazheve është standardizuar.

Shembulli 9

Alice could see, as well as if she were looking	Liza e përfëtyronte fare mirë, taman sikur t'ishte tue	Liza tashti shikonte sesi të gjithë anëtarët	Liza tani shikonte se si të gjithë anëtarët ishin duke	Që të gjithë anëtarët e jurisë po shkruanin "*budallë*"	Liza mund të shikonte se si gjykatësit shkruan "Sa

[418] V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 157.

[419] G. Hadaj (1984) *Nëntori VIII, Shkolla dhe arti "Vërtetësia artistike e origjinalit në përkthim nëpërmjet karakterizimit gjuhësor"*, fq. 167.

[420] G. Hadaj (1984) *Nëntori VIII, Shkolla dhe arti "Vërtetësia artistike e origjinalit në përkthim nëpërmjet karakterizimit gjuhësor"*, fq. 167-168.

over their shoulders, that all the jurors were writing down '*Stupid things*!' on their slates, and she could even make out that one of them *didn't know how to spell 'stupid,'* and that he had to ask his neighbour to tell him. (AAiW, fq. 45)	vërejtë përmbi shpatullat e tyne, se të gjithë Antarët ishin tue shkrue nepër pllaka fjalën "*Marrina*!". Bile mundi edhe të shofi se *njani prej tyre, tue mos dijtë se qysh shkruhej fjala,* pyeti nji shok. (fq. 118)	ishin duke shkruar në blloqet e tyre fjalën "*Marrëzi*!" Bile *njëri nga ata që s'dinte si ta shkruajë* pyeti shokun e vet. (fq. 130)	shkruar nëpër pllakat e tyre fjalën "*Marrëzi*". Bile njëri nga ata, *që s'dinte në shkruhej me një r apo me dy*, pyeti shokun e vet. (fq. 131-132)	mbi dërrasat e tyre të zeza. Bile, vuri re që *njëri prej anëtarëve, duke mos ditur se si shkruhej 'budallë',* i ishte dashur t'i kërkonte shpjegime fqinjit. (fq. 140)	*budallenj*" në dërrasat e veta, madje vuri re që *njëri prej tyre nuk dinte si shkruhej fjala "budallenj"* dhe për këtë pyeste fqinjin. (fq. 131)

Shembulli i fundit është shkëputur nga një diskutim në sallën e gjyqit ku Liza, pasi shikon absurditetet brenda sallës, bërtet *Stupid things*, por, ç'është edhe më keq, anëtarët e jurisë nuk dinë ta shkruajnë këtë shprehje. Në të pesë variantet është bërë përshtatja në gjuhën shqipe, veçojmë variantin e tretë që e "shqipëron" edhe më shumë këtë skenë, duke thënë se anëtarët e jurisë nuk dinin nëse *marrëzira* shkruhej *me një r apo me dy r* (gjë që, sigurisht, nuk është pjesë e origjinalit).

V.1.3 Modernizimi

Përdorimi i kësaj strategjie, sipas Klingbergut, ka të bëjë me rifreskimin e klasikëve, përdorimin e shprehjeve të reja në vend të atyre të vjetëruara si dhe me prezantimin e sendeve dhe ideve të reja.[421] Gjithashtu mund të ndryshohen edhe hollësi të kohës dhe vendit, duke e zhvendosur tekstin origjinal më afër datës së botimit të tekstit të përkthyer. Kjo gjë nuk ndodh vetëm në përkthim, por mund të vërehet edhe kur hidhen në treg ribotime në gjuhën origjinale. Modernizimet mund të jenë thelbësore në përkthimin e letërsisë për fëmijë, veçanërisht kur përkthimi ka si synim amëtarizimin. Megjithatë, Klingbergu nuk i sugjeron përkthyesve që të ndryshojnë një datë specifike të shkruar në tekstin origjinal sepse një gjë e tillë do të ndërhyjë me synimet e origjinalit si dhe sfondin historik të origjinalit. Raste të tilla nuk kemi vërejtur në korpusin tonë.

V.1.4 Purifikimi

Qëllimi kryesor i purifikimit, sipas Klingbergut, është që teksti i përkthyer të korrespondojë me vlerat që kanë lexuesit e tij – ose me vlerat e supozuara të atyre që e

[421] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of Translators.* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq. 56.

konsiderojnë veten të përgjegjshëm për rritjen e lexuesve fëmijë.[422] Kjo lidhet me idenë se letërsia për fëmijë duhet të kontribuojë në zhvillimin e fëmijëve. Ajo që, në sytë e përkthyesit, nuk duket si e përshtatshme, do të "pastrohet" dhe do të përshtatet sipas kritereve që mendohen si ato të duhurat për lexuesit e synuar. Disa hollësi që mund të kenë nevojë për t'u purifikuar kanë të bëjnë me sjellje të gabuara të fëmijëve ose të të rriturve, procesin e defektimit, erotizmin, etj. Përkthyesi do të heqë gjithçka që mendon se është ofensive ose e pakuptueshme për kulturën e përkthimit, në mënyrë që të sigurohet se përkthimi i realizuar prej tij do të ketë një reagim pozitiv jo vetëm nga ana e fëmijëve, por, njëkohësisht, edhe nga të rriturit, si kritikët, prindërit, etj. Megjithatë, purifikimi duket se është kundër qëllimit të shtrirjes së mundësisë për të kuptuar dhe për të fituar njohuri ndërkombëtare nga ana e lexuesve. Duke e "pastruar" përmbajtjen që do t'i përcillet fëmijëve, vetë përkthyesi i pengon ata që të mësojnë rreth mënyrës së jetesës së shoqërive të tjera. Gjithashtu fëmijët mund të krijojnë përshtypjen e gabuar se të gjitha shoqëritë kanë të njëjtat vlera ose se vlerat ndaj të cilave ata janë të ekspozuar janë të vetmet që ekzistojnë.

Shembulli 1

They call'd immediately to some of their Friends, and there came two Women and brought a great Vessel made of Earth, and burnt as I suppose in the Sun; this they set down for me, as before, and I sent *Xury* on Shore with my Jarrs, and filled them all three: *The Women were as stark Naked as the Men*. (RC, fq. 28)	Zezakët pastaj deshën të më falnin edhe ushqime të tjera, po unë u tregova se i kisha qypat bosh dhe ata u bënë copë që të m'i mbushnin me ujë. Pas të gjitha këtyre, u lashë shëndetin atyre banorëve të urtë. ---------- (RK, fq. 45)

Në këtë rast, është lënë pa përkthyer fjalia me shkronja të pjerrëta e origjinalit, që i referohet lakuriqësisë së grave dhe burrave.

Shembulli 2

... for that Gratitude was no inherent Virtue in the Nature of Man; nor did Men always square their Dealings by the Obligations they had receiv'd, so much as they did by the Advantages they expected.* I told him it would be very hard, that I should be the Instrument of their Deliverance ... (RC, fq. 205-206)	---------- I thashë pa u druajtur që më hante frika se mos më tradhtonin e ma punonin keq, pasi të bija në duart e tyre. (RK, fq. 217)

Nëpërmjet këtij shembulli, mund të shikojmë se reflektime të shkrimtarit rreth natyrës së njeriut nuk përfshihen fare në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe, ndoshta për arsye se këto reflektime nxjerrin në pah anë negative të natyrës njerëzore.

Shembulli 3

There are some laws and customs in this empire very peculiar; and if they were not so directly contrary to those of my own dear country, I should be tempted to say a little in their justification. *It is only to be wished, that they were as well executed.* The first I shall mention, relateth to informers. (GT, fq. 56)	Në atë perandori kanë ca ligje e zakone shumë të çuditshme; dhe, po të mos ishin aq tq kundërta nga ato të atdheut tim të dashur, mbase do të përpiqesha t'i shfajësoja një thërrime.---------- Në radhë të parë do të flas se si përdoren paditësit. (UG, fq. 67)

[422] Po aty, fq. 58.

Siç mund ta shikojmë, është lënë pa përkthyer një fjali që i referohet procesit të vdekjes, në mënyrë më specifike ekzekutimit.

Shembulli 4

Flimnap the Lord High Treasurer attended there likewise, *with his white staff;* and I observed he often looked on me with a sour countenance ... (GT, fq. 63)	Flimnapi, lordi i madh i Thesarit, ---------- që kuptova se po më hante me sy ... (UG, fq. 74)

Pjesa që iu referohet dallimeve racore nuk është përkthyer.

Shembulli 5

... for want of sufficient food, you would grow weak and faint, and lose your appetite, *and consequently decay and consume in a few months; neither would the stench of your carcass be then so dangerous, when it should become more than half diminished* ... (GT, fq. 71)	... po të mos ushqeheshit si duhet, do të ligeshit e do të bëheshit koskë e lëkurë, s'do të kishit shije të hanit e pas pak kohe do të vdisnit… (UG, fq. 81)

Mund të shikojmë se si hollësitë që jepen në origjinal në lidhje me vdekjen, aromën e keqe të kufomës etj. nuk janë përcjellë në tekstin e përkthyer. Duhet të përmendim këtu se qëndrimet që mbahen ndaj shkurtimeve ose tjetërsimeve të tekstit origjinal me qëllim purifikimin e tij janë të ndryshme. Klingbergu mendon se në këtë mënyrë nuk tregohet respekt për integritetin e veprës origjinale, Shaviti mendon se në këtë mënyrë i mëshojmë edhe më shumë statusit inferior të letërsisë për fëmijë, ndërsa Otineni ndjen keqardhje që përkthyesi nuk përfshihet në *karnivalizëm*, gjq që përfshin edhe magjepsjen e fëmijëve me procesin e defektimit.[423]

Duke iu referuar edhe një herë të gjithë shembujve, mund të themi se përkthyesi ka përdorur standardin e purifikimit për të shmangur përcjelljen në gjuhën e përkthimit të hollësive të tilla që kanë të bëjnë me procesin e vdekjes, ekzekutimit, dallimet racore, lakuriqësisë, aspekte negative të natyrës njerëzore, etj.

V.1.5 Shkurtimi

Shkurtime të cilat mund të kalojnë pa u vënë re në tekstin e përkthyer nuk përbëjnë një shqetësim për lexuesit; mjaft tekste të përkthyera mund të jenë më të shkurtra se origjinali dhe një gjë e tillë mund të mos jetë e qëllimshme nga ana e përkthyesit. Kur flasim për shkurtimin si një nga prirjet e përkthimit të letërsisë për fëmijë, kemi parasysh një qëndrim të qëllimshëm nga ana e përkthyesit për të shkurtuar pjesë të caktuara të origjinalit. Ashtu siç shprehet edhe vetë Klingberg, në historinë e letërsisë për fëmijë ka një traditë të gjatë të botimeve të shkurtuara.[424] Kryesisht këto botime janë shkurtime të veprave që fillimisht janë botuar për të rritur, por ka edhe shkurime të veprave që janë shkruar fillimisht për fëmijë. Edhe përkthyesit mund të prodhojnë versione të shkurtuara kur janë duke përkthyer për fëmijë. Qëllimi kryesor i shkurtimit duhet të jetë që t'i ofrojë fëmijëve një material leximi në një gjatësi të arsyeshme, por, njëkohësisht, shkurtimet mund të bëhen edhe për të ndryshuar përmbajtjen, formën dhe gjuhën e përdorur.

Shembulli 1

But I was to have another Trial for it still;	Por qe shkruar nga fati që të kaloja

[423] R. Oittinen (1993) *I Am Me--I Am Other: On the Dialogics of Translating for Children*. Tampere, Finland: University of Tampere, fq. 105.

[424] Po aty, fq. 73.

and Providence,* *as in such Cases generally it does, resolv'd to leave me entirely without Excuse. For if I would not take this for a Deliverance, the next was to be such a oneas the worst and most harden'd Wretch among us would confess both the Danger and the Mercy.* (RC, fq. 10)	edhe një sprovë. (RK, fq. 24)
Shembulli 2	
After I got to Shore and had escap'd drowning, *instead of being thankful to God for my Deliverance*, having first vomited with the great Quantity of salt Water which was gotten into my Stomach, and recovering my self a little, I ran about the Shore, wringing my Hands and beating my Head and Face, exclaiming at my Misery, (RC, fq. 60)	... shpëtova nga vdekja dhe sosa në breg, për një kohë të gjatë s'e mbajta dot vetennxora kushedi se sa ujë të kripur nga goja, pastaj renda andej këtej duke rrahur duart, duke u gërvishtur, duke mallkuar fatin dhe duke uluritur....(RK, fq. 78)
Shembulli 3	
Thus I liv'd mighty comfortably, my Mind being entirely composed by resigning to the Will of God, and throwing my self wholly upon the Disposal of his Providence. This made my Life better than sociable, for when I began to regret the want of Conversation, I would ask my self whether thus conversing mutually with my own Thoughts, and, as I hope I may say, with even God himself by Ejaculations, was not better than the utmost Enjoyment of humane Society in the World. (RC, fq. 115)	---------- (RK, fq. 125)
Shembulli 4	

In the Interval of this Operation, I took up the Bible and began to read, but my Head was too much disturb'd with the Tobacco to bear reading, at least that Time; only having open'd the Book casually, the first Words that occurr'd to me were these, *Call on me in the Day of Trouble, and I will deliver, and thou shalt glorify me.** The Words were very apt to my Case, and made some Impression upon my Thoughts at the Time of reading them, tho' not so much as they did afterwards; for as for being deliver'd, the Word had no Sound, *as I may say*, to me; the Thing was so remote, so impossible in my Apprehension of Things, that I began to say as the Children of *Israel* did, when they were promis'd Flesh to eat, *Can God spread a Table in the Wilderness?* * so I began to say, Can God himself deliver me from this Place? and as it was not for many Years that any Hope appear'd, this prevail'd very often upon my Thoughts: But however, the Words made a great Impression upon me, and I mused upon them very often. (RC, fq. 80-81)

94-95)

Shembulli 8

Alice looked at the jury-box, and saw that, in her haste, she had put the Lizard in head downwards, and the poor little thing was waving its tail about in a melancholy way, being quite unable to move. *She soon got it out again, and put it right; 'not that it signifies much,' she said to herself; 'I should think it would be quite as much use in the trial one way up as the other.'*	Liza hodhi vështrimin nga tavolina e Trupit gjykues dhe vuri re se, nga të shpejtuarit, e kishte vënë Zhapinin me kokë poshtë, dhe ai i shkreti po e luante bishtin në një mënyrë të mallëngjyeshme, por krejt i paaftë për të lëvizur.
As soon as the jury had a little recovered from the shock of being upset, and their slates and pencils had been found and handed back to them, they set to work very diligently to write out a history of the accident, *all except the Lizard, who seemed too much overcome to do anything but sit with its mouth open, gazing up into the roof of the court.* 'What do you know about this business?' the King said to Alice. (AAiW, fq. 48)	Menjëherë sapo Trupi gjykues e kishte marrë pak veten mbas tronditjes dhe gjetën pllakat e plumçat, ja hynë punës për të shkruar historinë e këtij aksidenti. "Çfarë di mbi këtë punë?" – e pyeti më në fund Mbreti Lizën. (v.II, fq. 135)

Këta katër shembuj tregojnë shkurtime të një natyre të ndryshme, ku përkthyesi e ka përdorur standardin e shkurtimit në nivelin e përmbajtjes apo të gjuhës së përdorur, duke shkurtuar hollësitë e origjinalit.

V.1.6 Përshkrimi i vendodhjes gjeografike

Letërsia për fëmijë mund të ketë si pjesë të qëllimeve të saj edhe edukimin e lexuesve në lidhje me vendodhje të caktuara gjeografike të prezantuara në veprën origjinale, si, për shembull, emra vendesh gjeografike. Është e rëndësishme që hollësi të tilla të mos mbeten në hije dhe të saktësohen edhe në variantin e përkthyer.

Shembulli 1

At last, *Friday* pitch'd upon a Tree, for I found he knew much better than I what kind of Wood was fittest for it, *nor can I tell to this Day what Wood to call the Tree we cut down, except that it was very like the Tree we call Fustic,* or between that and the Nicaragua Wood,* for it was much of the same Colour and Smell.* (RC, fq. 191)	Më në fund Premti mundi të gjënte një dru të mirë. Dhe me të vërtetë, ai merrte vesh më shumë nga unë për të zgjedhur lëndën më të vyer për barkë. (RK, fq. 201)

Shembulli 2

…his features are strong and masculine, with an *Austrian lip*, and arched nose, his complexion olive, his countenance erect, his body and limbs	…nga tiparet tregon një burrë që e ha hekurin me dhëmbë; *buzën e ka të dalë*, hundën si të shqiponjës, cipën zeshkane, këmbët e duart pa ndonjë cen; dhe, sa herë

well proportioned, all his motions graceful, and his deportment majestick. (RC, fq. 25)	që kuvendon e luan pakëz, lëshon plot nur e dritë. (RK, fq. 133)
Shembulli 3	
I shall have to ask them what the name of the country is, you know. Please, Ma'am, is this *New Zealand or Australia*?' (and she tried to curtsey as she spoke--fancy curtseying as you're falling through the air! (AAiW, fq. 12)	Po si t'ia bëj që të pyes *për vëndin e tyre*. (V.II, fq. 6)
Shembulli 4	
…which were *High and Low-Dutch, Latin, French, Spanish, Italian, and lingua franca*…(GT, fq. 26)	…ca fjalë nga hollandishtja e veriut dhe e jugut, një çikë latinisht, frëngjisht, spanjollçe, italisht e një çikë në gjuhë levantine* (*gjuhët që fliten në ishujt dhe brigjet lindore të Mesdheut)… (UG, fq. 34)

Mund të shikojmë se në shembullin e parë të dhëna karakteristike gjeografike për llojin e drurit dhe prejardhjen e tij nuk përmenden fare në përkthim. Edhe në shembullin e dytë referimi ndaj tipareve austriake nuk përcillet në gjuhën shqipe, thjesht perifrazohet pa përmendur se bëhet fjalë për buzë tipike australiane. Edhe në shembullin e tretë përkthyesi i referohet vendeve në përgjithësi, pa përmendur vendodhjen e saktë gjeografike, ndoshta duke menduar se një gjë e tillë nuk është e nevojshme për lexuesit fëmijë. Mbetet për t'u diskutuar, megjithatë, nëse është ky qëndrimi i drejtë, apo do të ishte më mirë që të dhënat e munguara t'iu përcillen lexuesve për të zgjeruar më shumë horizontin e tyre. Ndërsa shembullin e katërt e kemi sjellë për të ilustruar faktin se përkthyesi është përpjekur që t'i sjellë të dhënat gjeografike ashtu si edhe në origjinal, madje shton edhe një shënim në fund të faqes për t'i qartësuar lexuesit.

V.1.7 Keqpërkthime serioze

Dallimet kulturore mes gjuhës origjinale dhe asaj të përkthimit shpesh shkaktojnë keqkuptime dhe çojnë në keqpërkthime. Është e rëndësishme që përkthyesi të arrijë të kuptojë drejt origjinalin dhe ta përcjellë atë sa më saktë në gjuhën e përkthimit. Kjo gjë kërkon që përkthyesi të ketë njohuri të shëndosha të kulturës origjinale dhe të jetë gjithmonë duke kërkuar informacione për të plotësuar boshllëqe të mundshme në këtë drejtim. Keqpërkthimet gjithashtu mund të ndodhin edhe për shkak të paragjykimit të gabuar të gjinisë së letërsisë për fëmijë si "inferiore" në krahasim me gjinitë e tjera. Nuk duhet të ketë asnjë justifikim për këto keqpërkthime: ato nuk duhet t'i shpëtojnë kurrë syrit të një përkthyesi, dhe, aq më tepër, redaktorit dhe botuesit.

Shembulli 1

Në këtë shembull kemi të bëjmë me një shprehje që përdor Liza pasi Miu nuk po i kthen përgjigje, dhe, meqë Liza në origjinal flet gjuhën angleze, mendon se Miu nuk kupton anglisht, është ndoshta Mi francez që ka ardhur këtu (pra, në Angli) me pushtuesin Uilliam. Nuk është shumë e lehtë të përkthehet kjo pjesë e librit, duhet patur kujdes që përkthyesit mos bien në grackën e përkthimit fjalë për fjalë, duke i qëndruar më shumë besnik se ç'duhet origjinalit dhe të veprojnë si përkthyesit e tre varianteve të para dhe të variantit të pestë, të cilër të gjithë shprehen se ndoshta Miu nuk di anglisht (por Liza deri

tani po i drejtohej Miut në gjuhën shqipe, pse u dashka papritmas që Miu të flasë anglisht?) dhe është ndoshta një Mi francez që ka erdhur *këtu* (fjala *këtu* nuk është shumë e qartë se kujt vendi i referohet – Shqipërisë apo Anglisë) me Uilliam Pushtuesin (atëherë, *këtu* do të jetë patjetër në Angli, përndryshe edhe vetë lexuesit nuk do të mund të identifikojnë ngjarjet historike që përmenden në vepër). Përkthyesit e variantit të katërt bëjnë një zgjedhje më të sigurt kur shprehen se Miu thjesht nuk kupton gjuhën (pa thënë në mënyrë specifike se që gjuhë) dhe është ndoshta një Mi francez (që nuk e kupton Lizën që po i flet shqip).

Shembulli 2

'Perhaps it doesn't understand *English*,' thought Alice; 'I daresay it's a *French mouse*, come over with William the Conqueror.' (AAiW, fq. 16)	"Ndofta s'merr vesht *inglisht*!" tha Liza. "Sigurisht do të jetë ndonji *mî frëng*, i ardhun këndej me William-in Pushtues. (V.I, fq. 25)	"Ndoshta s'kupton *inglisht*" – mendoi Liza. "Sigurisht do të jetë ndonjë *mi francez*, i ardhur me pushtuesin William". (V. II, fq. 16)	Ndoshta s'kupton *anlglisht*, - mendoi Liza. Sigurisht do të jetë ndonjë *mi francez*, ardhur me Uiliam Pushtuesin. (V. III, fq. 25)	"Ndoshta nuk kupton *gjuhën*" mendoi Liza. "Mos është ndoshta ndonjë *mi francez* që ka ardhur këtu pas Uilliam Pushtuesit? (V. IV, fq. 24)	"Ndoshta, ai nuk kupton *anglisht*, - mendoi Liza. – Me siguri është *mi francez*, i cili ka notuar këtu bashkë me Vilhelm Pushtuesin." (V. V, fq. 26)

Pjesa që kemi shkëptur më poshtë tregon se si një gabim gjatë përkthimit mund të ndiqet nga një zgjedhje e gabuar duke shkaktuar humbje të koherencës dhe largim nga origjinali.

There is such a nice little dog near our house I should like to show you! A little bright-eyed terrier, you know, with oh, such long curly brown hair! And it'll fetch things when you throw them, and it'll sit up and beg for its dinner, and all sorts of things--***I can't remember half of them***--and ***it*** belongs ***to a farmer***, you know, and he says it's so useful, it's worth a hundred pounds! He says it kills all the rats and--oh dear!' cried Alice in a sorrowful tone, 'I'm afraid I've offended it again!' (AAiW, fq. 16-17)	"Ka një qen, afër shtëpisë sonë dhe është aq i vogël dhe aq i këndshëm, sa do të më pëlqente me të vërtetë që të njihja me të! Ai është një qen race Terier që i ka gjithnjë sytë si me lot dhe leshrat të gjatë ngjyrë kafe, kaçurela! Gjithnjë do ta shohësh duke vrapuar dhe kapur gjërat që dikush ia hedh për të lozur! Pastaj ulet dhe pret ushqimin e darkës. *E vërteta është se* ***unë di të bëj shumë gjëra, por për fat të keq nuk më kujtohen as gjysmat.*** Dhe a e di, *njoh edhe* ***qenin e një fshatari***. Ai thotë se qeni i tij është shumë i mirë dhe nuk do ta shiste as edhe për njëqind stërlina! Thotë se vret të gjithë minjtë dhe ... oh e shkreta unë!" ia bëri Liza e hidhëruar. "Gabova sërish. Të fyeva?" (v. IV, fq. 26)

Në përkthim thuhet se vetë Liza di të bëjë shumë gjëra, por në fakt ajo nuk arrin të kujtojë as gjysmën e gjërave që *qeni* i përshkruar më lart di të bëjë. Më pas në përkthim përmendet një tjetër qen, që i përket një fshatari, kur, në fakt, është i njëjti qen i përshkruar, që ka për pronar një fshatar dhe që ka shumë rëndësi për pronarin e vet. Po këtë pjesë e shohim të përkthyer shumë më qartë për lexuesit e variantit të parë:

> "Afër shtëpísa s'onë âsht nji qen i vogël, shumë i bukur! Oh, veç të kishem se si me t'a tregue! Asht nji kone e vogël, a e din?, dhe oh! Me ç'leshna të gjata kaçurrela në ngjyrë të kafes! Kur i hudh gurin, e kap e t'a sjellë. Rrin suz mbi dy kambët e mbrapna, tue u-lutë t'i japish diçka me ngrânë. ***Ban gjithfarë lojnash***

dhe âsht i një bujku, a kupton?, i cili thotë se âsht shumë i dobishëm: vlen qinda napolojna! Ai thotë se mbyt çdo mî dhe ... Oh, e mjera unë!..” bërtiti Liza, me nji zâ të përdhimshëm. “Kam frigë se e kam fye prap!” (v. I, fq. 26-27)

Shembulli 3

then we give them the shoot Gun says *Xury* laughing, *make them run wey*; such *English Xury* spoke by conversing among us Slaves; (RC, fq. 23)	-Atëherë në godit “njerëz” pushkë, - tha duke qeshur Xuri, - dhe ata ika nga sytë këmbët! – Kështu e fliste Xuri anglishten, që kishte mësuar duke ndenjur me ne skllevërit. (RK, fq. 39)

Përkthyesi ka bërë fillimisht një përzgjedhje të saktë të fjalëve, duke dashur të tregojë se Xuri nuk flet sipas rregullave gramatikore në bashkebisedim me Kruzonë, e, megjithatë, edhe në këtë rast, përkthyesi nuk mban një qëndrim koherent sepse Xuri është duke folur shqip, ndërsa reflektimet e rrëfimtarit janë se ai fliste një *anglishte* jo të saktë që e kishte mësuar duke ndenjur me skllëvërit. Do të ishte më mirë që në vend të gjuhës specifike – anglisht – t’i referohej thjesht mungesës së të folurit të saktë të gjuhës – në përgjithësi.

Shembulli 4

I put about *a Quarter of a Pint* of Rum into it (RC, fq. 79)	i hodha *afro një çerek litri* rum...(RK, fq. 94)

Shembulli 5

Heap of Grapes, of Limes and *Lemons*... (RC, fq. 86)	grumbull veshulësh, grumbull...qitrosh e *portokallesh* (RK, fq. 99)

Shembulli 6

about *fifty Yards* nearer to them than the Place where I was, (RC, fq. 196)	ndo *njëzet metra* më pranë tyre ... (RK, fq. 207)

Shembulli 7

three leagues (GT, fq. 15)	*tri milje* (UG, fq. 20)

Shembulli 8

The mistress sent her maid for a small dram-cup, which held about *two gallons*; and filled it with drink…(GT, fq. 92)	Zonja dërgoi shërbëtoren të sillte një kupë të vogël, që merrtë gati *pesëmbëdhjetë litra* liker dhe e mbushi me pije. (UG, fq. 102)

Shembulli 9

…a park of about three thousand acres, surrounded by a wall of hewn stone *twenty foot high*. (GT, fq. 206)	…një park pothuaj tri mijë ditarë të gjerë, rrethuar me një mur prej blloqesh të mëdha, ndo *njëqind këmbë të lartë*. (UG, fq. 224)

Shembulli 10

He paid *seven gold Galleons* for his wand and Mr. Ollivander bowed them from his shop. (HPaPS, fq. 65)	Pagoi *nëntë galeone ari* për shkopin e tij dhe, ndërsa po dilnin, Ullianderi i përshëndeti pa dalë nga dyqani, duke përkthyer trupin. (HP, fq.73)

Shembujt 4-8 tregojnë keqpërkthime të cilat vijnë si pasojë e mosnjohjes mirë të elementëve specifikë kulturorë nga ana e përkthyesit, gjë që çon në krijimin e pasaktësive në procesin e lexim-interpretimit nga ana e publikut në gjuhën shqipe. Në shembullin e

tretë, përdoret në origjinal një masë lëngjesh – pintë – e cila është e barabartë pothuajse me një gjysëm litri, dhe, për rrjedhojë, çereku i saj, do të ishte rreth 120 mililitra, pra, as gjysma e një çereku. Në shembullin e katërt përkthehen limonat si portokaj. Në shembullin e pestë, duhet pasur parasysh se një jard konvertohet në rreth 90 centimetra, rrjedhimisht, 50 jardë do të ishin rreth 45 metra. Për shembullin gjashtë, duhet të dimë se një legë si njësi matëse konvertohet në rreth tri milje e gjysëm, gjë që do të thotë se tri liga përbëjnë rreth 9 ose 10 milje. Edhe konvertimi në shembullin 8 nuk është i saktë, një gallon konvertohet në rreth 3.7 litra, pra, dy gallonë janë rreth shtatë litra e gjysëm, pra, gjysma e sasisë së lëngut të përmendur nga përkthyesi. Ndërsa, në shembujt e fundit (9, 10) ka një gabim në përkthimin e lartësisë prej njëqind këmbësh në gjuhën shqipe kundrejt njëzet këmbëve të origjinalit, dhe nëntë galeone ari kundrejt shtatë të tillave në origjinal. Mendojmë se këto nuk janë gabime të bëra nga konvertimi, aq më tepër që është e njëjta njësi matëse edhe në gjuhën shqipe, por thjesht nga nxitimi i përkthyesit. Gjithashtu, edhe shembulli i mëposhtëm shërben për të na treguar se si gjatë përkthimit krijohen kundërkuptime.

Shembulli 11

First, however, she waited for a few minutes to see if she was going to shrink any further: she felt a little nervous about this; ‘for it might end, you know,’ said Alice to herself, ‘*in my going out altogether, like a candle.* I wonder what I should be like then?’ And she tried to fancy what the flame of a candle is like *after the candle is blown out,* for she could not remember ever having seen such a thing. (AAiW, fq. 13)

Priti edhe pak sepse e ndjente se ende po vazhdonte të shkurtohej e po bëhej nervoze. “Shpresoj që të mos zvogëlohem më” thoshte me vete. “Nëse vazhdoj ende kështu, *do të bëhem si një qiri i ndezur.* Dhe atëherë çfarë pamje do të kisha?” U përpoq të merrte me mend se çfarë pamje ka flaka e një qiriu *para se të fiket* dhe nuk e kujtonte nëse kishte parë ndonjëherë diçka të tillë. (v. IV, fq. 14)

Në tekstin origjinal Liza, e frikësuar nga zvogëlimi i përmasave trupore, druhet se mos do të *shuhet fare, si një qiri,* ndërsa në përkthim ajo ka frikë se mos *do të bëhet si një qiri i ndezur* (?) dhe në fund të paragrafit përpiqet të përfytyrojë *flakën e një qiriu* ***para*** *se të fiket*, ndërkohë që në origjinal Liza përpiqet të përfytyrojë se si mund të duket *flaka që mbetet nga një qiri* ***pasi*** *qiriu është shuar.* Krahasimi me variantin e parë shpreh qartë se si kuptimi është përmbysur në variantin e katërt.

> Me-gjith’atê, priti disa grima për të pá në se do të rregjohej edhe mâ. Nga ky shkak u-nxê pak. “Pse, a di?, kam frigë ***se mos shkrîhem fare, si qiriu***”, tha Liza me vehte. “Çuditem se kuej kishem me i ngjà atëhere?” pyeste me habí, dhe mundohej me përfytërue se qysh do të dukej flaka e qiriut ***kur ky vetë të jetë shue.*** Nuk i kujtohej t’a kishte pá ndonji herë njin gjâ të tillë. (v. I, fq. 16)

Në përfundim të kësaj çështjeje, mund të themi se standardet e përkthimit të letërsisë për fëmijë të nxjerra në pah nga Klingberg i kemi hasur në një pjesë të ndjeshme të studimit tonë krahasues, paçka se këtu kemi sjellë vetëm shembuj ilustrues. Mendojmë se është me rëndësi që edhe përkthyesit të jenë në dijeni të strategjive të përshkruara, në mënyrë që të dinë se si të përballen me vështirësi të ndryshme që mund të hasin gjatë procesit të përkthimit, gjithmonë duke patur parasysh që teksti origjinal duhet të manipulohet sa më pak të jetë e mundur. Ajo çka është edhe më e rëndësishme, duhet që të kuptohet në hollësi dhe në thellësi origjinali. Ashtu siç shprehet Kristianë Nord, përkthyesi duhet ta analizojë tekstin përpara se ta fillojë përkthimit. Analiza e tekstit mundëson kuptimin e plotë, interpretimin e saktë të tekstit dhe shpjegimin e strukturave gjuhësore dhe tekstore

si dhe marrëdhëniet e tyre me sistemin dhe normat e gjuhës origjinale.[425] Analiza e tekstit gjithashtu duhet të shëmbejë si themel i çfarëdo vendimi që përkthyesi duhet të marrë gjatë procesit të përkthimit. Një model analize i tillë do të duhej t'iu përgjigjej pyetjeve të tilla si: kush përcjell, për kë, me çfarë qëllimi, nëpërmjet çfarë mjetesh, ku, kur, pse, me çfarë funksioni, në çfarë teme, në çfarë rendi, me çfarë lloj fjalësh e fjalish, me çfarë stili dhe me çfarë efekti.[426] Mendojmë se të gjithë këta tregues janë të rëndësishëm në mënyrë që përkthyesi të dijë t'i shfrytëzojë mirë standardet e përmendura dhe të mos bjerë pre e keqpërkthimeve që i çorientojnë lexuesit që nuk e njohin origjinalin. Duhet të përmendim këtu se, edhe pas studimit dhe krahasimit të hollësishëm të veprave origjinale me përkthimet e tyre në gjuhën shqipe, jemi të ndërgjegjshëm për aspektet kontradiktore që përfshihen brenda përshtatjes kulturore kontekstuale: nga njëra anë nevoja e përshtatjes në nivele të ndryshme për një publik të përbërë nga fëmijë, dhe, nga ana tjetër, qëllimi i nxitjes së pasurimit kulturor nëpërmjet eksplorimit ndërkombëtar, aq i dëshirueshëm për fëmijët dhe nga fëmijët. Asnjëherë nuk duhet të lemë jashtë vëmendjes sonë moshën e publikut marrës të synuar të veprës së përkthyer, duke i dhënë gjithmonë prioritet tekstit origjinal që ofron për lexuesit të dhëna të reja rreth kulturave të panjohura.

Megjithatë, ashtu siç është shprehur edhe vetë Klingbergu, beteja mes konsideratave ndaj tekstit origjinal dhe kujdesi për lexuesit e përkthimit është po aq e vjetër sa edhe vetë përkthimi.[427] Otineni i përmbahet mendimit se nuk ka vetëm një zgjidhje në këtë betejë.[428] Një pjesë e mirë e vendimeve varet nga fakti nëse përkthyesi vlerëson më tepër lexueshmërinë se sa atmosferën e huaj apo anasjelltas. Një tjetër faktor që ndikon është vetë imazhi që ka përkthyesi për fëmijët dhe fëmijërinë dhe atë që ai vetë e konsideron si të (pa)përshtatshme për ta. Nuk mund të lemë pa përmendur se kemi vërejtur një sërë rastesh që tregojnë se përkthyesit janë treguar të paqëndrueshëm në përdorimin e një strategjie apo të një tjetre brenda të njëjtit variant, gjë që bën që lexuesit të mos dinë ta pozicionojnë veten saktë. Kjo tregon edhe një herë se letërsia për fëmijë konsiderohet si një gjini inferiore, dhe, si e tillë, shpesh bie pre e profesionalizmit të ulët si dhe nuk i nënshtrohet një procesi të kujdesshëm redaktimi dhe recensimi.

Në mbyllje të këtij diskutimi, theksojmë se standardet e përmendura prej Klingbergut, pavarësisht fushës së tij të studimit (letërsia për fëmijë), janë të përshtatshme edhe për të analizuar letërsinë e përkthyer në përgjithësi. Edhe vetë Klingbergu ka përmendur se është e pamundur të përcaktohet një kufi ndarës i qartë mes problemeve të përkthimit të një libri për fëmijë dhe një libri për të rritur. Në shumë këndvështrime, përkthimi i një libri për fëmijë do të paraqesë probleme të njëjta si çfarëdo lloj përkthimi tjetër.[429] Edhe ne, ashtu si Klingberg mendojmë se fillimisht duhen përdorur strategji të tilla që shpjegojnë elementët e vështirë kulturorë, duke shmangur sa më shumë ato mënyra të cilat përfshijnë fshirjen e elementëve kulturorë dhe zevendësimin e tyre me elementë të tjerë nga gjuha e përkthimit, përndryshe lexuesve në gjuhën e përkthimit nuk iu prezantohet vepra letare si e tillë, me gjithë karakteristikat e saj dalluese.[430]

---

[425] C. Nord (1991) *Text Analysis in Translation.* Amsterdam, Rodopi, fq. 1.
[426] Po aty, fq. 36.
[427] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq.10.
[428] R. Oittinen (2000) *Translating for Children* New York: Garland, fq. 91.
[429] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq.10).
[430] G. Klingberg (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators* Lund: Liber/ CWK Gleerup, fq.10-19, 63).

V.2 Ndryshime në nivelin sintaksor

Përkthimi na lejon të qartësojmë disa dukuri gjuhësore
të cilat në të kundërt do të mbeteshin të pazbuluara.[431]

Në këtë çështje të punimit tonë do të përqëndrohemi në shqyrtimin e dukurive që ndodhin gjatë përkthimit të fjalive të përbëra nga gjuha angleze në atë shqipe. Qëllimi ynë është të shikojmë nëse përkthyesi priret ndaj thjeshtësimit të strukturave të ndërlikuara të origjinalit, nisur edhe nga fakti që po realizohet një përkthim për fëmijë. Niveli në të cilin do të përqëndrohemi është niveli sintaksor, pra, do të shikojmë organizimin e strukturës së fjalive të origjinalit dhe do të studiojmë mënyrën e përcjelljes së tyre në gjuhën shqipe. Për të përmbushur këtë qëllim, kemi zgjedhur *Alice's Adventures in Wonderland* dhe variantin e tretë të përkthyer në gjuhën shqipe, meqenëse jemi të sigurt se ky variant iu drejtohet fëmijëve. Kemi gjurmuar fjalitë e përbëra në origjinal dhe, nëpërmjet leximit dhe krahasimit paralel me origjinalin, kemi identifikuar dukuri të ndryshme që karakterizojnë përkthimin e fjalive të përbëra nga anglishtja në shqip. Tabelat dhe grafikët do të na ndihmojnë që nxjerrim në pah shpeshtësinë e çdo dukurie.

Një krahasim i tillë merr shtysë nga studimet e gjuhësisë krahasuese në fushën e përkthimit letrar, kështu që për ta pozicionuar këtë studim brenda sfondit të studimeve të ngjashme në fushën e analizave përqasëse gjuhësore, do të prezantojmë shkurtimisht disa të dhëna informuese. Studimet gjuhësore përqasëse kanë pasur origjinën e tyre me studiuesin Çarls Karpenter Fris (Charles Carpenter Fries) në vitet 1940, të bazuara në supozimin se "materialet më efikase (në mësimin e gjuhës së huaj) janë ato që themelohen mbi përshkrime shkencore të gjuhës që do të përvetësohet, të krahasuara me kujdes me një përshkrim paralel të gjuhës amtare të nxënësit.[432] Ky projekt u zbatua në praktikë në vitin 1957 nga Robert Lado (Robert Lado), i cili u përfshi në studime krahasimore ndërmjet anglishtes dhe spanjishtes.[433] Në vitet 1970 dhe 1980 pati një sërë botimesh, të cilat nuk u përqëndruan parësorisht në qëllime didaktike,[434] por, në një mënyrë më thelbësore, në mënyrën e konsiderimit të gjuhësisë përqasëse si një "krahasim tipologjik".[435] Ky lloj përafrimi ndaj analizës gjuhësore përqasëse është veçanërisht i dukshëm në studimin e Xhon Hokinsit (John Hawkins) – *A Comparative Typology of English and German – Unifying the Contrasts (Një tipologji krahasimore e anglishtes dhe gjermanishtes – Njëjtësimi i Ndryshimeve).* Mes qëllimeve kryesore të këtij studimi ishte identifikimi i bashkëlidhjeve në sintaksë dhe morfologji. Pavarësisht disa anëve të dobëta në lidhje me përgjithësimet, përgjithësisht njihet fakti se studimi i Hokinisit ishte vërtet me vlerë sepse hodhi dritë mbi krahasimin e gjuhëve, pa iu referuar domosdoshmërisht përvetësimit të gjuhës së huaj.[436] Duke ndjekur kronologjinë, gjatë

---

[431] J.-P. Vinay dhe J. Darbelnet (1995:9).

[432] C. Fries (1945) *Teaching and learning English as a foreign language*. Ann Arbor: University of Michigan Press, fq. 9)

[433] R. Lado (1957) *Linguistics across cultures: Applied linguistics for language teachers*. Ann Arbor: University of Michigan Press.

[434] E. König (1971) Adjectival constructions in English and German. Heidelberg: Groos; G. Rohdenburg (1974) *Sekundäre Subjektivierungen im Englischen und Deutschen. Vergleichende Untersuchungen zur Verb- und Adjektivsyntax*. Bielefeld: Cornelsen-Velhaben & Klasing; F. Plank (1984) *Verbs and objects in semantic agreement: Minor differences between English and German that might suggest a major one.* Journal of Semantics 3: 305-60.

[435] E. Köning (1996) *Kontrastive Grammatik und Typologie.* Në E. Lang, G. Zifonun (eds.), *Deutsch – typologisch, 31-54*. Berlin/New York: Mouton de Gruyter, fq. 51.

[436] Për të mësuar më tepër rreth kritikave kundër përgjithësimeve në studimin e *Hawkins*, mund t'i referoheni B. Kortmann & P. Meyer (1992) *Is English grammar more explicit than German grammar, after all?* Në C. Mair, M. Manfred (eds.), *New departures in contrastive linguistics. Proceedings of the*

viteve 1980 dhe 1990, mund të vërehen tema të reja të përfshira në gjuhësinë përqasëse, si për shembull studimet në fushën e pragmatikës dhe ligjërimit, si dhe studimet e bazuara në korpus. Në këtë mënyrë analiza gjuhësore përqasëse fitoi më shumë vlerë në fushën e studimeve përkthimore krahasimore. Edhe kjo pjesë e punimit është një përpjekje për të kontribuar në mënyrë modeste në fushën e studimeve gjuhësore përqasëse në përkthimin letrar.

Tani po paraqesim shembujt e vjelë nga AAiW dhe, paralelisht, në plan krahasues, shembujt korrespondues në gjuhën shqipe. Shembujt e shkruar me shkronja të pjerrëta janë shkëputur nga origjinali, ndërsa shembujt përkatës janë marrë nga varianti në gjuhën shqipe. Kemi identifikuar gjithsej 655 fjali në veprën origjinale në gjuhën angleze dhe i kemi krahasuar ato me fjalitë përkatëse në gjuhën shqipe. Fjalitë që kanë shfaqur të njëjtën dukuri përkthimi janë grupuar sipas dukurisë përkatëse, për shembull, nëse ruhet e njëjta strukturë e origjinalit, apo lloji i pjesës së nënrenditur, nëse është thjeshtësuar struktura, nëse ruhet apo jo përdorimi i lidhëzës, etj. Në tabelën e mëposhtme mund të shohim të ilustruara konkretisht dukuritë që kemi vërejtur si dhe shpeshtësinë e tyre. Më pas, do të sjellim shembuj konretë për të ilustruar secilën prej dukurive të vërejtura. Gjithashtu, tabelat dhe grafikët do të na ndihmojnë të nxjerrim përfundime rreth ndryshimeve në nivelin sintaksor.

Tabela 23 ***Dukuritë gjuhësore të vërejtura në përkthimin e fjalive të përbëra***

Dukuritë gjuhësore të vërejtura		Shpeshtësia e përdorimit	
Përputhje / ngjashmëri në strukturën e fjalisë së përbërë dhe llojin e pjesës së nënrenditur		38%	
Copëzimi i fjalisë së përbërë		17%	
Mungesë përputhshmërish	*Fjali e thjeshtë në original – Fjali e përbërë në tekstin e përkthyer*	7%	35%
	Strukturë e thjeshtësuar e fjalisë në tekstin e përkthyer	7%	
	Fjali e përbërë në origjinal – Fjali e thjeshtë në tekstin e përkthyer	4%	
	Ndryshimi i llojës së fjalisë së nënrenditur	7%	
	Strukturë më e ndërlikuar në tekstin e përkthyer	10%	

conference held at the Leopold-Franzens-University of Innsbruck, Austria, 10–12 May 1991, 155-166. Innsbruck.; G. Rohdenburg (1992) *Bemerkungen zu infiniten Konstruktionen im Englischen und Deutschen.* Në C. Mair, M. Manfred (eds.), *New departures in contrastive linguistics. Proceedings of the conference held at the Leopold-Franzens-University of Innsbruck, Austria*, 10–12 May 1991, 187-207. Innsbruck.

Përdorimi i lidhëzave	*Asindete në origjinal – Sindete në gjuhën e përkthimit*	8%
	Sindete në origjinal – Asindete në gjuhën e përkthimit	2%

Grafiku nr. 12 Dukuritë gjuhësore të vërejtura në përkthimin e fjalive të përbëra



Mund të shikojmë se dy dukuritë kryesore që përfshijnë pothuajse të njëjtën shpeshtësi të dukurive të vërejtura janë përputhshmëritë ose ngjashmëritë në strukturën e fjalisë (38%) si dhe mungesë e përputhshmërisë në strukturën e fjalisë (35%). Një numër i ndjeshëm fjalish të përbëra janë copëzuar në tekstin e përkthyer (17%). Në raste të tjera, janë përdorur lidhëzat në tekstin e përkthyer kur ato nuk kanë qenë të pranishme në origjinal (8%) dhe në pak raste (2%) janë hequr lidhëzat dhe fjalia është sërish e përbërë, por pa lidhëza në tekstin e përkthyer. Meqenëse rastet që përfshijnë mungesë përputhshmërie në përkthimin e fjalive të përbëra janë përfaqësuese të disa dukurive, këto po i prezantojmë më poshtë nëpërmjet një grafiku më të hollësishëm.

Grafiku nr. 13 ***Mungesë përputhshmërish***



Nën dukurinë e mungesës së përputhshmërive përfshihen një sërë nëndukurish: dukuria më e shpeshtë është shfaqja e një strukture më të ndërlikuar në tekstin e përkthyer (10%), duke u ndjekur për nga shpeshtësia nga dukuritë e tjera – thjeshtësimi i strukturës së fjalisë (7%), fjali e përbërë kundrejt fjalisë së thjeshtë të origjinalit (7%) ose anasjelltas (4%) si dhe raste kur është ndryshuar lloji i pjesës së nënrenditur (7%). Duke synuar të jemi sa më konkretë në prezantimin e të dhënave të përqasjes së fjalive dhe llojeve e nënllojeve të tyre, po sjellim tani shembuj ilustrues për secilën prej dukurive të përshkruara nëpërmjet tabelave e grafikëve të mësipërm.

V.2.1 Përputhshmëri ose ngjashmëri në llojin dhe strukturën e fjalisë së përbërë (38%)

Shembulli 1

***However**, she soon made out **that** she was in the pool of tears **which** she had wept **when** she was nine feet high.* (fq. 16)	**Por** shpejt u kujtua **se** ishte në pellgun e lotëve **që** kish derdhur vetë **kur** ishte tre metra e gjatë. (fq. 24)

Mund të shikojmë se ka ngjashmëri në strukturën e fjalive si dhe në funksionin e pjesëve të nënrenditura. Në origjinal pjesa kryesore [she soon made out] ndiqet nga një pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë [that she was in the pool of tears], dhe më pas nga një pjesë e nënrenditur lidhore [which she had wept] dhe në fund nga një pjesë e nënrenditur rrethanore (kohore) [when she was nine feet high]. Në tekstin në gjuhën shqipe fjalia ndjek të njëjtën strukturë: pjesë kryesore [shpejt u kujtua], pjesë e nënrenditur emërore [se ishte në pellgun e lotëve], pjesë e nënrenditur lidhore [**që** kish derdhur vetë], pjesë e nënrenditur kohore [kur ishte tre metra e gjatë]. I vetmi ndryshim që mund të vërehet është se pjesa emërore në tekstin e përkthyer në gjuhën shqipe është në funksionin e kryefjalës.

Shembulli 2

*Would YOU like cats **if** you were me?* (fq. 16)	A do t'i doje ti macet **po** të ishe në vendin tim? (fq. 26)

Në të dyja fjalitë mund të shohim të njëjtën strukturë: pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur kushtore. Edhe rendi i shfaqjes së pjesëve është i njëjtë në të dyja gjuhët: pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur.

Shembulli 3

*We won't talk about her any more **if** you'd rather not.* (fq. 25)	S'po flasim më për të, **po qe se** s'të pëlqen. (fq. 26)

Edhe nëpërmjet këtij shembulli shfaqim ruatjen e së njëjtës strukturë të fjalisë së përbërë, madje edhe rendi i pjesëve përbërëse si dhe lloji i tyre është i njëjtë.

Shembulli 4

*I do wonder **what** can have happened to me!* (fq. 21)	Me të vërtetë çuditem **se ç**'do të më ketë ndodhur. (fq. 42)

Fjalitë kanë të njëjtën strukturë dhe lloj të pjesëve përbërëse si dhe rendin e shfaqjes së tyre: pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë.

Shembulli 5

***If** they had any sense, they'd take the roof off.* (fq. 23)	**Sikur** t'ua priste pak, do të zbulonin çatinë. (fq. 46)

Në tekstin origjinal, fjalia e përbërë ka një pjesë kryesore [the'd take the roof off] dhe një pjesë të nënrenditur [if they had any sense]. E para shfaqet pjesa e nënrenditur, që është i njëjti rend që ndiqet edhe në fjalinë e përkthyer në gjuhën shqipe: pjesë e nënrenditur kushtore [sikur t'ua priste pak] ndjekur nga pjesa kryesore [do të zbulonin çatinë].

Shembulli 6

*Alice thought the whole thing very absurd, **but** they all looked so grave **that** she did not dare to laugh.* (fq. 18)	Të gjitha këto Lizës i dukeshin fare të kota, **por** ata ishin seriozë, **sa** ajo s'guxonte të qeshte. (fq. 34)

Fjalitë kanë të njëjtën strukturë dhe lloj të pjesëve përbërëse si dhe rendin e shfaqjes së tyre: pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë.

V.2.2 Copëzim i fjalive të përbëra të origjinalit në tekstin e përkthyer (17%)

Shembulli 1

*So she was considering in her own mind (**as well as** she could, **for** the hot day made her feel very sleepy and stupid), **whether** the pleasure of making a daisy-chain would be worth the trouble of getting up and picking the daisies, **when** suddenly a White Rabbit with pink eyes ran close by her.* (fq. 11)	Dhe për një çast mendoi (**megjithëse** e kishte mendjen turbull, **ngaqë** bënte vapë **dhe** po i vinte gjumë) **ϕ** të shkonte të mblidhte ca luleshqerra **e** të thurte një kurorë me to. Kjo punë do ta kënaqte **dhe** do t'i hiqte mërzinë. **Por**, papritur, këtë çast, i kaloi pranë një lepur i bardhë me ca sy të kuq. (fq. 10)

Fjalia e origjinalit ka pjesën kryesore [she was considering in her own mind] dhe një sërë pjesësh të nënrenditura, ndërsa fjalia në tekstin e përkthyer është copëzuar në tri fjali korresponduese: e para e përbërë nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur në

funksionin e kundrinorit të drejtë, e dyta nga dy pjesë të bashkërenditura dhe fjalia e tretë që është një fjali e thjeshtë.

Shembulli 2

*And she tried to fancy **what** the flame of a candle is like **after** the candle is blown out, **for** she could not remember ever having seen such a thing.* (fq. 13)	Vrau mendjen dhe u përpoq të përfytyronte flakën e qiririt **pasi** ky është shuar fare. **Mirëpo** nuk i kujtohej **ϕ** ta kish parë ndonjëherë. (fq. 17)

Fjalia në tekstin origjinal ndjek këtë strukturë: pjesë kryesore [she tried to fancy] + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e një kundrinori të drejtë [what the flame of the candle is like] + pjesë e nënrenditur rrethanore-kohore [after the candle is blown] + pjesë e nënrenditur rrethanore-shkakore [for she could not remember ever having seen such a thing]. Mund të vërejmë se si në tekstin e përkthyer ka dy fjali korresponduese; të dyja janë fjali të përbëra.

Shembulli 3

*She had never been so much contradicted in her life before, **and** she felt **that** she was losing her temper.* (fq. 27)	Asnjëherë në jetën e saj s'e kishin kundërshtuar kaq shumë. E kuptoi **se** po humbiste durimin. (fq. 56)

Fjalia në tekstin origjinal përmban një pjesë kryesore, një pjesë tjetër të bashkërenditur dhe një pjesë të nënrenditur emërore. Struktura e kësaj fjalie është thjeshtësuar në tekstin në gjuhën shqipe duke u copëzuar në dy fjali: fjalia e parë është e thjeshtë dhe fjalia e dytë është e përbërë nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur emërore.

V.2.3 Mungesë përputhshmërie në llojin e fjalisë dhe strukturës (35%)

V.2.3.1 Fjali e thjeshtë në gjuhën origjinale – Fjali e përbërë në gjuhën e përkthimit (7%)

Shembulli 1

O Mouse, do you know the way out of this pool? (fq.16)	O Mi, a di si mund të dilet nga ky pellg? (fq. 25)

Fjalia është e thjeshtë në origjinal, ndërsa fjalia në tekstin e përkthyer është e përbërë nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e një kundrinori të drejtë.

Shembulli 2

You insult me by talking such nonsense. (fq.19)	Ti më fyen vazhdimisht me ato marrëzi **që** flet. (fq. 37)

Fjalisë së thjeshtë të origjinalit i korrespondon një fjali e përbërë në tekstin e përkthyer (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur përcaktore).

Shembulli 3

Now, I'll manage better this time. (fq.90)	Por këtë radhë di unë si të veproj. (fq. 89)

Edhe në këtë rast, fjalisë së thjeshtë të origjinalit i korrespondon një fjali e përbërë në tekstin e përkthyer (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë).

V.2.3.2 Strukturë e thjeshtësuar e fjalisë në gjuhën e përkthimit (7%)
Shembulli 1

*All she could see, **when** she looked down, was an immense length of neck, **which** seemed to rise like a stalk out of a sea of green leaves **that** lay far below her.* (fq. 27)	S'shikonte gjë tjetër veç një alamet qafe **që** ngrihej si një minare përmbi një det gjethesh të blerta. (fq. 58)

Fjalia e përbërë në gjuhën angleze ka një pjesë kryesore, pjesë të nënrenditur rrethanore-kohore dhe dy pjesë të nënrenditura lidhore. Fjalia në tekstin e përkthyer ka një strukturë më të thjeshtuar: pjesë kryesore dhe pjesë e nënrenditur përcaktore.
Shembulli 2

***As** she said this, she looked up, **and** there was the Cat again, sitting on a branch of a tree.* (fq. 77)	Në këto e sipër ngriti kokën, **kur** ç'të shihte, përsëri Macja po qëndronte në degë të pemës. (fq.75)

Struktura e fjalisë së përbërë në gjuhën angleze përfshin një pjesë kryesore, një pjesë të nënrenditur rrethanore-kohore dhe një pjesë të bashkërenditur. Pjesës së nënrenditur kohore të origjinalit i korrespondon një shprehje parafjalore me funksion rrethanor në tekstin e përkthyer, për rrjedhojë struktura në gjuhën shqipe vjen më e thjeshtësuar, me më pak pjesë fjalie.
Shembulli 3

*The cook threw a frying-pan after her **as** she went, **but** it just missed her.* (fq. 30)	Gjellëbërësja i hodhi nga pas një tigan, **por** nuk e goditi. (fq.70)

Fjalia në gjuhën angleze ka një strukturë më të ndërlikuar se fjalia korresponduese në gjuhën shqipe (nga pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur rrethanore-kohore+pjesë e bashkërenditur të origjinalit kalohet në një strukturë më të thjeshtësuar me një pjesë kryesore dhe një pjesë bashkërenditëse) .

V.2.3.3 Fjali e përbërë në origjinal – Fjali e thjeshtë në gjuhën e përkthimit (4%)
Shembulli 1

*The door led right into a large kitchen, **which** was full of smoke from one end to the other.* (fq. 29)	Dera të shpinte në një kuzhinë të madhe, gjithë tym. (fq. 66)

Mund të dallojmë menjëherë se fjalisë së thjeshtë në gjuhën shqipe i korrespondon një fjali e përbërë në gjuhën angleze (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur përcaktore).
Shembulli 2

*She had not gone much farther **before** she came in sight of the house of the March Hare.* (fq. 32)	Pa shkuar shumë larg i doli përpara një shtëpi e çuditshme. (fq. 75)

Fjalia e përbërë në gjuhën angleze ka si pjesë të saj një pjesë kryesore dhe një pjesë të nënrenditur rrethanore-kohore, ndërsa në gjuhën shqipe fjalia është e thjeshtë.

V.2.3.4 Ndryshim i llojit të pjesës së nënrenditur nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit (7%)

Shembulli 1

*And she began fancying the sort of thing **that** would happen.* (fq. 20)	E menjëherë filloi të mendonte **se ç**'mund t'i ndodhte në shtëpi. (fq. 40)

Të dyja fjalitë janë të përbëra, por në gjuhën angleze pjesa kryesore ndiqet nga një pjesë e nënrenditur përcaktore, ndërsa në gjuhën shqipe pjesa kryesore ndiqet nga një pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e një kundrinori të drejtë.

Shembulli 2

*Then they both bowed low, **and** their curls got entangled together.* (fq. 28)	Pas kësaj, të dy bënë një përkulje **aq** të madhe **sa** ngatërruan leshrat me njëri-tjetrin. (fq. 64)

Fjalia në origjinal është e përbërë nga dy pjesë të bashkërenditura, ndërsa fjalia në gjuhën shqipe është sërish e përbërë, por nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur rrethanore-rrjedhimore.

Shembulli 3

*The Cat seemed to think **that** there was enough of it now in sight, **and** no more of it appeared.* (fq. 37)	Macja mendonte **se** kishte treguar një pjesë të mirë të vetvetes, **prandaj** nuk u rrit më. (fq. 98)

Fjalia në gjuhën angleze ka një pjesë kryesore të ndjekur nga një pjesë e nënrenditur emërore në funksion të kundrinorit të drejtë si dhe nga një pjesë e bashkërenditur. Fjalia në gjuhën shqipe fillon sërish me një pjesë kryesore, por ndiqet nga dy pjesë të nënrenditura: pjesa e parë është pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë dhe pjesa e dytë është një pjesë e nënrenditur rrethanore-rrjedhimore.

V.2.3.5 Strukturë më e ndërlikuar në tekstin e përkthyer (10%)

Shembulli 1

*So she stood still **where** she was, **and** waited.* (fq. 36)	Kështu vendosi ***ϕ*** të qëndronte **ashtu siç** qe **dhe** të priste. (fq. 91)

Siç mund ta shikojmë, struktura e fjalisë së origjinalit (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur rrethanore-vendore + pjesë e bashkërenditur) është pasuruar edhe me një pjesë tjetër në tekstin në gjuhën shqipe, ku struktura e fjalisë është më e ndërlikuar (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë + pjesë e nënrenditur rrethanore-krahasimore + pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë – kjo pjesë e fundit i bashkërendohet pjesës tjetër emërore me po të njëjtin funksion). Numri i pjesëve të fjalisë është më i madh në variantin e përkthyer.

Shembulli 2

Here the Queen put on her spectacles, ***and*** *began staring at the Hatter,* ***who*** *turned pale* ***and*** *fidgeted.* (fq. 46)	Ne këto e sipër Mbretëresha vuri syzet **dhe** ia nguli sytë dëshmitarit, **i cili** filloi të dridhej **dhe** u zverdh nga frika. (fq. 134)

Fjalia në gjuhën angleze përbëhet nga një pjesë kryesore, një pjesë e bashkërenditur si dhe një pjesë e nënrenditur përcaktore. Struktura në gjuhën shqipe pasurohet edhe me një pjesë tjetër të bashkërenditur, përveç pjesëve të tjera që korrespondojnë me origjinalin.

V.2.4 Përdorimi i lidhëzave

Një pjesë e këtij studimi krahasimor në lidhje me ndryshimet e vërejtura në nivelin sintaksor i kushtohet edhe përdorimit të lidhëzave. Fjalitë e përbëra që kanë lidhëza quhen sindete dhe ato që nuk përmbajnë lidhëza quhen asindete, dhe, zakonisht, janë të shenjuara nga pikpamja stilistikore pasi përdoren për të shënuar intensifikim dramatik ose për të sugjeruar një listim të hapur të dhënash. Le të shikojmë nëpërmjet shembujve konkretë dukuritë që kemi vërejtur.

V.2.4.1 Fjali asindetike në origjinal – fjali sindetike në gjuhën shqipe (8%)

Shembulli 1

I'm afraid ***ϕ***[437] *I can't put it more clearly.* (fq. 24)	Kam frikë **se** s'mund të shpjegohem. (fq. 52)

Fjalia në gjuhën angleze përbëhet nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur emërore, struktura është e njëjtë në gjuhën shqipe, por, siç mund të vemë re, kjo fjali karakterizohet edhe nga përdorimi i lidhëzës, ndryshe nga fjalia origjinale.

Shembulli 2

"I can see ***ϕ*** *you're trying to invent something"* (fq. 27)	"E shoh **se** po mundohesh të shpifësh diçka." (fq. 60)

Fjalia në gjuhën angleze përbëhet nga një pjesë kryesore dhe një pjesë e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë. Fjalia nuk karakterizohet nga përdorimi i lidhëzës. Në gjuhën shqipe, fjalia përbëhet nga pjesa kryesore dhe pjesa e nënrenditur emërore në funksionin e kundrinorit të drejtë. Dy pjesët e fjalisë së përbërë lidhen me një lidhëzë ftilluese, të shtuar nga ana e përkthyesit.

Shembulli 3

'That's the most important piece of evidence ***ϕ*** *we've heard yet.* (fq. 50)	"Kjo është dëshmia më e rëndësishme **që** kemi dëgjuar deri tani. (fq. 147)

[437] E përdorim simbolin ***ϕ*** për të treguar mungesën e lidhëzës.

Edhe në këtë rast mund të vërejmë se struktura e fjalive në të duja gjuhët është e ngjashme (pjesë kryesore + pjesë e nënrenditur përcaktore), vetëm se në origjinal fjalia nuk përmban lidhëze, ndërsa në variantin e përkthyer po.

V.2.4.2 Fjali sindetike në origjinal – Fjali asindetike në tekstin e përkthyer (2%)

Shembulli 1

'One side will make you grow taller, ***and*** *the other side will make you grow shorter.'* (fq. 27)	"Njera anë të rrit, ***ϕ*** tjetra të shkurton!" (fq. 57)

Shembulli 2

And as she could not think of anything to say, she simply bowed, ***and*** *took the thimble, looking* ***as*** *solemn* ***as*** *she could.* (fq. 18)	Prandaj, meqë s'dinte ç'të thoshte, u përkul në shenjë nderimi, **ϕ** mori gishtëzën dhe u përpoq të dukej më serioze. (fq. 34)

Shembulli 3

In a minute or two the Caterpillar took the hookah out of its mouth, ***and*** *yawned once or twice,* ***and*** *shook itself.* (fq. 24)	Pas pak, Vemja e hoqi llullën, **ϕ** gogësiti nja dy a tri herë **dhe** u shkund. (fq. 57)

Të tre shembujt i kemi sjellë për të ilustruar dukurinë e përmendur, pra, faktin se për fjalitë e shkëputura nga origjinali që karakterizohen nga përdorimi i lidhëzës, fjalitë korresponduese në tekstin e përkthyer në gjuhën shqipe janë fjali që nuk përmbajnë lidhëza.

V.3 Përfundime në lidhje me ndryshimet në nivel sintaksor

Nëpërmjet shembujve të sjellë, dhe, studimit krahasimor të shtrirë në një numër të konsiderueshëm fjalish, kemi patur për qëllim të identifikojmë dhe ilustrojmë një sërë dukurish gjuhësore që ndodhin gjatë përkthimit të fjalive të përbëra. Duke u nisur nga analiza e shembujve si dhe grafikët dhe tabelat e mësipërme, arrijmë në këto përfundime:

- Nisur nga korpusi nën shqyrtim, mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë: struktura e fjalisë mund të ruhet ose të braktiset nëpërmjet copëzimit të fjalisë origjinale, mund të ndryshohet lloji i pjesëve të nënrenditura, fjalia mund të shfaqet edhe më e ndërlikuar apo më e thjeshtuar se sa në origjinal, lidhëzat mund të mos përdoren pavarësisht faktit se janë përdorur në origjinal, ose edhe mund të përdoren në gjuhën shqipe edhe pse mungojnë në origjinal.
- Për të qenë më konkretë po iu referohemi shifrave. 38% e fjalive të përkthyera në gjuhën shqipe ruajnë strukturën e fjalisë ashtu si edhe në origjinal, ndërsa në 35% të rasteve nuk ka përputhshmëri në strukturën e fjalisë. Dukuria e segmentimit të fjalisë është vërejtur në 17% të fjalive të përbëra të origjinalit. Arsyet që mund ta kenë shtyrë përkthyesin drejt copëzimit të një fjalie të përbërë në fjali të ndryshme (sërish të përbëra ose të thjeshta) mund të jenë të ndryshme, megjithatë,

hamendësojmë se kjo mund të jetë përdorur si një strategji në ato raste kur struktura e origjinalit ka qenë shumë e ndërlikuar për t'u ndjekur, aq më tepër që e kemi theksuar që në fillim të këtij kreu se letërsia për fëmijë karakterizohet nga një stil i thjeshtë e fjali me struktura të thjeshtëzuara.

- Brenda dukurisë së mungesës së përputhshmërisë së strukturës dhe llojit të fjalive, shohim se 7% e fjalive karakterizohen nga struktura e thjeshtëzuar e fjalisë së përbërë në teksti e përkthyer dhe 4% nga ndryshimi nga një fjali e përbërë e origjinalit në një fjali të thjeshtë në tekstin e përkthyer, duke kapur kështu shifrën prej 11 %. Nëse këtë shifër (11%) do ta mbledhim me 17% të rasteve që shfaqin copëzim të fjalisë, do të kemi një shifër prej **28%**, që përmbledh rastet në të cilat mund të flasim me të drejtë për një thjeshtëzim të strukturës së fjalisë së përbërë, ose nëpërmjet copëzimit të saj ose nëpërmjet numrit të reduktuar në pjesëve të nënrenditura ose të bashkërenditura në fjalinë e përbërë. Nga ana tjetër, vërejmë një fjali me një strukturë më të ndërlikuar në përkthim kundrejt strukturës më të thjeshtë të origjinalit në 10% të fjalive të përbëra të pëkthyera në gjuhën shqipe si dhe transformimin e një fjalie të thjeshtë në një fjali të përbërë në 7% të rasteve. Duke i mbledhur këto dy shifra arrijmë në **17%**. Nëse krahasojmë këto shifra, arrijmë në përfundimin se numri i rasteve që shfaqin thjeshtëzim të strukturës së fjalisë së përbërë (një numër më i ulët pjesësh përbërëse) është më i lartë se numri i rasteve në të cilat është vërejtur një strukturë më e zhvilluar (numër më i lartë pjesësh përbërëse) të fjalisë në tekstin e përkthyer. Për këtë arsye themi se prirja e përgjithshme e përkthyesit ka qenë thjeshtëzimi, ndoshta ndikuar nga fakti që teksti iu drejtohet fëmijëve.
- Në lidhje me përdorimin e lidhëzave, në të shumtën e rasteve, përkthyesi ka përdorur lidhëza edhe kur ato mungonin në origjinal, duke i bërë më të qarta marrëdhëniet kuptimore mes pjesëve të fjalisë. Edhe kjo prirje tegon se në përgjithësi përkthyesi përpiqet të *thjeshtëzojë* dhe të *qartësojë* origjinalin.

V. 4 Anë problematike të vërejtura gjatë studimit krahasimor

Vendimet e përkthyesit ndikojnë në mënyrën se si fëmijët e përjetojnë letërsinë, dhe gjuha e teksteve të përkthyera mund të ndikojë në zhvillimin e gjuhës së tyre si dhe në pranimin e ideve.[438]

Duke u afruar drejt fundit të punimit tonë, nuk mund të lemë pa përmendur disa shfaqje të dukurive të tjera që kanë ndodhur gjatë përkthimeve të veprave në gjuhën shqipe. Në këtë çështje nuk do t'iu referohemi strategjive apo metodave të përkthimit nga gjuha origjinale në gjuhën shqipe, por do t'i shohim me sy kritik librat në gjuhën shipe, gjithmonë në krahasim me origjinalin. Në fakt, nxjerrja në pah e prirjeve të ndryshme të përkthyesve, përpilimi i tabelave dhe grafikëve kanë bërë që t'i shfletojmë dhe rishfletojmë vazhdimisht variantet e përkthyera në gjuhën shqipe, duke lexuar paralelisht origjinalin dhe duke i vendosur në librat në plan krahasues. Një gjë tillë ka nxjerrë në pah një sërë problemesh që kanë ndodhur gjatë përcjelljes së veprës nga gjuha angleze në atë shqipe. Problemet kanë qenë të natyrave të ndryshme, prandaj menduam t'i përmbledhim në këtë çështje të fundit të punimit tonë. Gjithashtu, shpresojmë se, duke hedhur dritë mbi këto aspekte problematike të vërejtura, mund t'iu vijmë në ndihmë përkthyesve të letërsisë për fëmijë në veçanti si dhe përkthyesve të letërsisë artistike në përgjithësi për të shmangur probleme të tilla si ato që do të prezantohen më poshtë.

[438] M. Knowles, K. Malmkjær (1996) *Language and Control in Children's Literature*. London: Routledge.

V.4.1 Mungesa e koherencës

Përkthimi nuk është thjesht një çështje e tranferimit të gjuhës…Përkthimi ka të bëjë me të kuptuarit e tekstit dhe sfondit kulturor, si dhe me marrjen e vendimeve rreth formulimeve të gjuhës që do të përdoren, gjë që nënkupton vendime në lidhje me koherencën, stilin dhe ideologjinë.[439]

Gjatë krahasimit të veprave origjinale me variantet e përkthyera të përfshira në korpusin tonë kemi vërejtur se në disa raste pjesë të caktuara të tekstit nuk gëzojnë koherencë. Kjo mund të shfaqet në disa mënyra: ose pjesa e përkthyer i qëndron besnike origjinalit, por, si rrjedhojë e përkthimit fjalë për fjalë, nuk ka koherencë në vetvete, ose pjesa e përkthyer nuk është koherente me origjinalin (shpreh ide të ndryshme ose të kundërta), ose pjesë të ndryshme të tekstit nuk janë në koherencë me njëra-tjetrën (pjesë të kapitujve të ndryshëm). Le të shohim disa shembuj konkretë:

Shembulli 1

'O Mouse, do you know the way out of this pool? I am very tired of swimming about here, O Mouse!'…The Mouse looked at her … but it said nothing. 'Perhaps it doesn't understand ***English***,' thought Alice; 'I daresay it's a ***French mouse***, come over with William the Conqueror.' (AAiW, fq. 16)	"O Mî, a e din se qysh dilet nga ky pellg? Jam lodhë shumë tue bâ not, o Mî" … Miu e shikoi, … por s'i tha kurrgjâ. "Ndofta s'merr vesh ***inglisht***!" tha Liza. "Sigurisht do të jetë ndonji ***mî freng***, i ardhun këndej me William-in Pushtues". (V. I, fq. 25)

Mund të shikojmë se përkthimi i qëndron besnik mënyrës së të shprehurit në origjinal, por humbet koherencën e brendshme, meqenëse vetë Liza i flet Miut në shqip dhe, pasi Miu nuk i kthen përgjigje, mendon se ai nuk kupton gjuhën angleze dhe do të jetë një mi francez.

Shembulli 2

Pjesa që kemi shkëputur më poshtë shërben për të treguar se sa kujdes duhet të tregojë përkthyesi që të mos bjerë në grackën e të përkthyerit fjalë për fjalë.

'Keep your temper,' said the Caterpillar.
'*Is that all*?' said Alice, swallowing down her anger as well as she could.
'***No***,' said the Caterpillar. (AAiW, fq. 24)

["Tregohu e duruar", tha Vemja.
"***Kjo ishte e gjitha ç'kishe për të thënë***?" tha Liza, duke u përprekur të mos e shfaqte zemërimin.
"***Jo***," tha Vemja.]

[439] R. Stolze (2003) *Translating for Children – World View or Pedagogics?* Në *Meta*, 48 (1-2), fq. 208-221; fq. 220.

"Mos e humb durimin!" e porositi Krymbi. "***S'ke tjetër?***" pyeti Liza, tue u-mundue me e mëshefë zemrimin. "***Jo***", përgjegji Krymbi. (V. I, fq. 50)	"Mos e humb durimin!" e porositi Krimbi. "***S'ke tjetër*?"** – e pyeti Liza duke u menduar të fshihte zëmërimin. "***Jo***" – iu përgjegj Krimbi. (V. II, fq. 47-48)	– Mos e humb durimin! – e porositi Vemja. - ***S'ke tjetër*?** – e pyeti Liza, duke u munduar të fshihte zemërimin. - ***Jo***, - iu përgjigj Vemja. (V. III, fq. 53)	"Ruaj qetësinë!" tha. "***Kjo është e gjitha çfarë do të më thoshe*"** pyeti Liza, duke u munduar ta fshihte mungesën e respektit të saj ndaj vemjes. "***Jo***" tha Vemja. (V. IV, fq. 57)	-Merre veten në dorë, - tha Vemja. - ***Kjo është e gjitha?*** – pyeti Liza duke u përpjekur të fshihte zemërimin e vet, aq sa ishte e mundur. -***Jo***, - u përgjigj Vemja.

Përgjigja negative e Vemjes nënkupton se ajo ka akoma gjëra të tjera për të thënë, gjë që shfaqet edhe në pjesën në vazhdim ku Liza dhe Vemja vazhdojnë dialogun mes tyre. Mund të shikojmë se në tre variantet e para përkthyesit përdorin strategjinë e përkthimit antonimik për pyetjen e Lizës, por lënë të pandryshuar përgjigjen e Vemjes, gjë që bën të përcillet kuptimi i kundërt. Varianti i katërt dhe i pestë ruajnë koherencën brendatekstuale, duke nënkuptuar se biseda do të vazhdojë akoma. Mund të shikojmë se përgjigja e Vemjes është negative, por është ndryshuar përkthimi i pyetjes, gjë që arrin të përcjellë të njëjtin kuptim si në origjinal.

Shembulli 3

…then we give them the shoot Gun says *Xury* laughing, *make them run wey*; such *English Xury* spoke by conversing among us Slaves; (RC, fq. 23)	- Atëherë në godit "njerëz" pushkë, - tha duke qeshur Xuri, - dhe ata ika nga sytë këmbët! – Kështu e fliste Xuri anglishten, që kishte mësuar duke ndenjur me ne skllevërit. (RK, fq. 39)

Nëpërmjet këtij shembulli shohim se si në përkthim përmendet se Xuri fliste një anglishte të pasaktë, ndërkohë që ai është duke folur vërtet pasaktësisht, por në gjuhën shqipe.

Shembulli 4

Ky shembull është shkëputur nga varianti i katërt i AAiW dhe shërben për të nxjerrë në pah faktin që, pasi një përkthyes bën zgjedhjen për të përdorur një fjalë apo shprehje të caktuar në përkthim, duhet të jetë i qëndrueshëm për zgjedhjet e bëra me qëllim që të mos shkaktojë pështjellim në lexuesit e tij.

The first witness was the Hatter. He came in with a *teacup* in one hand and a piece of bread-and-butter in the other… This did not seem to encourage the witness at all: he kept shifting from one foot to the other, looking uneasily at the Queen, and in his confusion he bit a large piece out of his *teacup* instead of the bread-and-butter… The miserable Hatter dropped his *teacup* and bread-and-butter, and	Dëshmitari i parë ishte Kapelebërësi. Ai u paraqit duke mbajtur një *gotë çaji* nga njëra dorë dhe një copëz kore me gjalpë në tjetrën... Mesa duket ky kërcënim e trembi dëshmitarin. Ai filloi të tërhiqej prapa duke qëndruar herë mbi njërën këmbë e herë mbi tjetrën dhe shihte i frikësuar Mbretëreshën. Nga hutimi kafshoi *filxhanin* në vën të kores së bukës me gjalpë... Atëherë i pikëlluar,

went down on one knee. (AAiW, fq. 46-47)	Kapelebërësi e lëshoi *filxhanin* dhe bukën nga dora, u ul në gjunjë dhe iu lut mbretit... (v. IV, fq. 143-145)

Mund të shikojmë se në gjuhën shqipe përdoret herë *gotë çaji* dhe herë *filxhan*. Në variantin e parë dhe dytë përdoret fillimisht *tas çaji* dhe më pas *gotë,* edhe në variantin e tretë vërejmë mungesë koherence në termat e zgjedhur: përdoret herë *filxhan çaji* herë *gotë,* ndërkohë që në figurë (për dy variantet e para) duket qartë se kemi të bëjmë me një *filxhan* çaji. Duke iu referuar sërish AAiW, po përmendim edhe një rast nga varianti i katërt ku shfaqen disa mospërputhje mes titullit dhe përmbajtjes: Kapitulli i dytë titullohet *Liqeni i lotëve,* ndërsa ngjarjet flasin për një Lizë të dëshpëruar sepse ka rënë në *ujin e kripur* (fq. 22), i duket sikur është *në det* (fq. 23) dhe pjesa çuditërisht titullohet *liqeni* i lotëve. Në po këtë variant vemë re një mospërputhje mes titullit *Kush i vodhi* ***tortat*** dhe episodit që e përshkruan këtë veprim kur lexojmë *Mbretëresha e zemrave përgatiti* ***feta buke të thekura me gjalpë*** *në një ditë vere; por Kopuku i zemrave, i vodhi* ***bukët e thekura me gjalpë*** *dhe tashmë i ka ngrënë* (fq. 141), gjë që nuk ka lidhje as me titullin dhe as me pjesët e tjera të rrefyera brenda sallës së gjyqit ku ndodhen personazhet.

Shembulli 5

'Oh, *please mind what you're doing*!' (AAiW, fq. 29)	- Oj, *të lutem, mendoni* pak çfarë po *bëni*! (v. V, fq. 69)

Në origjinal Liza i drejtohet Dukeshës duke përdorur një gjuhë formale, që në anglisht shprehet nëpërmjet përdorimit të formës së politesës *you,* e cila, në mungesë të mbaresave, përputhet edhe me formën në numrin njëjës, veta e dytë. Kjo gjë nuk është kuptuar mirë nga përkthyesi, i cili i ngatërron të dyja format dhe i përdor të dyja brenda së njëjtës fjalie – *të lutem* (veta e dytë njëjës) dhe *mendoni* e *bëni* (veta e dytë shumës – forma e politesës).

V.4.2 Gabime drejtshkrimore

Në këtë nënçështje do të grupojmë disa gabime të aspektit drejtshkrimor që kemi vërejtur në korpusin tonë. Gabime të tilla i kemi identifikuar në variantin e tretë, të katërt dhe të pestë të *Alice's Adventures in Wonderland.* Arsyeja pse po i nxjerrim në pah këto gabime është që të gjithë të arrijmë ta kuptojmë se roli i përkthyesit nuk është thjesht të përcjellë përmbajtjen dhe mesazhet e veprës origjinale, por, njëkohësisht t'i shprehë ato nëpërmjet një shqipeje të qartë e të pastër, duke treguar po aq respekt e njohje të thellë si për gjuhën origjinale ashtu dhe për gjuhën dhe publikun në përkthim. Gjithashtu, meqenëse këto variante janë më afër ditëve të sotme (nisur nga viti i botimit të tyre) kjo duhet të na bëjë të reflektojmë edhe më thellë mbi gjendjen e përkthimeve të letërsisë për fëmijë aktualisht dhe, për fat të keq, mbi faktin se shpesh kjo gjini konsiderohet si inferiore edhe nga vetë përkthyesit. Nga ***varianti i tretë*** shkëputim shembujt: foljet *ta humbnit; do të flitje, flitnin, pritnin, duhet ta pyetni* në vend të foljeve *ta humbisnit, do të flisje, flisnin, prisnin, duhet ta pyesni;* përdorimin e tepërt të ë-së në mbiemri *të këndëshme* në vend të *të këndshme; ka shpurë* në vend të *ka shpënë; çpështjellë* në vend të *shmbështjellë;* urdhërorja e vetës së dytë njëjës *tregoi* në vend të *tregoji;* si dhe *ju falem nderit shumë* në vend të *ju faleminderit shumë.* Nga ***varianti i katërt*** shkëputim këto shembuj: fjalët *për një herësh* dhe *një herësh* që duhet të ishin shkruar *përnjëherësh dhe njëherësh;* fjalët *rënje, rënja, thënja, thënjen, thënjes* që duhet të ishin shkruar pwrkatwsisht me *ie* dhe *ia* në vend të *je* dhe *ja*; lidhëzën *me që* dhe fjalët *e pa sjellshme, të pa zakonta, e pa saktë, e pa rëndësishme, pa tjetër* që duket të shkruheshin si një fjalë e vetme; fjalët *përshembull, sëbashku, kështuqë,* që duhet të shkruhen me hapësirë në mes; mungesën e zanores *ë* në

fjalët *mos u zemro, i zemruar, minut, brryli, brrylet, fatkeqsisht, gjalp, vlersoni, çelsin*; përdorimi i gabuar i zanores *ë* në vend të zanores *e* të theksuar në fjalët *gjëndje, shëmbull, qëndër*; përdorimi i gabuar i zanores *e* në vend të ë-së në fjalën *çeshtje*; të shkruarit gabim të fjalës *shtërngoj, dorështërnguar* në vend të *shtrëngoj* dhe *dorështrënguar*; fjala *mbrapsh* në vend të *mbrapsht* ; përdorimi i gabuar i *ë*-së në fjalën *gjithësesi* që duhet shkruar *gjithsesi,* fjala *qenje* që duhet të shkruhet *qenie*, mungesa e *ë*-së në fund të foljeve në fjalitë *ç'do të ndodh? me mua, të të vij? turp nga vetja, (një vajzë e rritur) nuk duhet të qaj? në këtë mënyrë.*

Pavarësisht se variantet e dyta të veprave *Gulliver's Travels* dhe *Robinson Crusoe* nuk janë përfshirë në studimin tonë krahasimor për shkak se janë shkurtime të ndjeshme të origjinalit, ne kemi shkëputur disa shembuj që janë domethënës në lidhje me aspektet problematike që po përshkruajmë në këtë pjesë të punimit, sërish duke dashur të reflektojmë rreth gjendjes së përkthimeve të letërsisë në ditët e sotme. Për këtë arsye po përmendim edhe disa shembuj të tjerë nga varianti i dytë i *Gulliver's Travels* në gjuhën shqipe: mungesa e gërmës *h* në *duke i ndimuar*, shkrimi i gabuar pa hapësirë në mes në fjalët *kështuqë, sesi*, si dhe nga varianti i dytë i *Robinson Crusoe* përdorimin e gabuar të foljes *do të mirrja* në vend të *do të merrja.*

V.4.3 Shtrembërimi i strukturave morfosintaksore të shqipes

Një aspekt me shumë rëndësi i gjuhës së përkthimeve është edhe çështja e ***ruajtjes së sintaksës shqipe***. Në lidhje me këtë problem akademiku *Aleksandër Xhuvani* është shprehur se *vështirësia e të përkthyemit nuk asht aq ke termat e skajnet, sa asht ke konstrukti, ke fryma, ke idiotizmat, që duhet me qenë krejt të shqipes e jo të gjuhës së huaj*.[440] Disa shembuj të tillë, ku sintaksa nuk i nënshtrohet rregullave të gjuhës shqipe, por "huazohet" dhunshëm nga gjuha origjinale mund t'i lexojmë më poshtë.

Shembujt janë shkëputur nga varianti i katërt dhe i pestë i *Alice's Adventures in Wonderland* meqënëse janë edhe variantet më të afërta në kohë me ditët e sotme, kjo për të theksuar edhe një herë aktualitetin e fjalëve që cituam më lart.

Shembuj nga varianti i katërt i AAiW

Të urdhëroj ta ndalosh menjëherë të qarën! (fq. 18)
Sa do të jetë nevrikosur që e bëra të priste! (fq. 19)
Në këtë orë duhet të ishit prej kohësh në shtrat. (fq. 38)
Flokët e tu kanë nevojë për një të prerë. (fq. 84)
Si po e kalon? (fq. 105)
Duhet të mos mërzitem! (fq. 108)
Gjyqi nuk mund të vazhdojë më tutje gjersa anëtarët e jurisë nuk janë rikthyer në vendet e tyre. (fq. 150)

Shembuj nga varianti i pestë i AAiW

Unë aq dëshiroj që ata të vijnë e të varin kokat! (fq. 24)
Unë do të dëshiroja t'jua tregoja juve. (fq. 28)
Por më në fund, e gjithë kjo mbaroi dhe përsëri u ulën në formë rrethi dhe filluan t'i kërkonin Miut t'u tregonte diçka tjetër. (fq. 35)
Kam frikë se nuk mundem ta shpjegoj veten. (fq. 52)
Kjo është gjëja më e çuditshme që shoh gjatë gjithë jetës sime! (fq. 77)

[440]D. Omari (1985) *Rreth gjuhës së përkthimeve të letërsisë së huaj artistike.* Në *Studime Filologjike nr. 1,* fq. 178.

Po kaq shqetësues është edhe p***ërdorimi i gabuar i presjes*** në shembujt e mëposhtëm, ku gabimet në pikësim janë më se të dukshme dhe nuk duhet të kishin kaluar pa u vënë re.

Shembuj shkëputur nga varianti i tretë i AAiW
Liza u gëzua shumë, sepse mendoi që do t'i bënte ndonjë dere. (fq. 14)
Kjo ishte një pyetje tjetër hutuese dhe, meqë Liza s'dinte të gjente arsyen dhe Vemja dukej se ishte në gjendje shpirtërore të keqe, Liza u nis të ikte. (fq. 52)

Shembuj shkëputur nga varianti i katërt i AAiW
Vështroi lart, por mbi kokën e saj, kishte një errësirë të plotë (fq. 10)
Për fat mbi tavolinë, gjeti një shishe. (fq. 12)
Ndoshta, ajo kishte të drejtë kur e quante të pafat veten e saj. Por çfarë mund të bënte, për të dalë nga ajo dhomë? (fq. 44)
Papritmas erdhi me vrap nga pylli, një oborrtar i mbretit. (fq. 68)
Derrkuci duke trokthitur, u largua, me siguri drejt pyllit. (fq. 77)
Gjeri, bërtiti nga dhimbja dhe vazhdoi... (fq. 94)

Shembuj shkëputur nga varianti i pestë i AAiW
Ky fëmijë i çuditshëm, pëlqente ta përfytyronte veten si dy njerëz njëherësh. (fq. 17)
Gjithçka që mundi të bënte, ishte vetëm sa i hodhi një sy kopshtit dhe për këtë iu desh të shtrihej në dysheme. (fq. 20)
Për mua më keq, s'ka ku shkon. (fq. 25)
Shumë shpejt Lepuri vuri re Lizën, që kërkonte diçka, dhe i thirri me zemërim. (fq. 40)
Ndërkohë, që për t'u rritur s'kam ku të vete më, ahtëherë duhet të zvogëlohem. (fq. 48)
Ti ke parasysh që mendon, se do të mundesh të gjesh përgjigjen? (fq. 80)
Supa madje edhe pa të, bëhet shumë e shijshme. (fq. 105)
Faleminderit, për tregimin tuaj interesant. (fq. 113)

Shembuj shkëputur nga varianti i dytë i GT

Kisha një uri aq të madhe, sa nuk e mbajta dot veten. (fq. 11)
Madhëria e tij më urdhëroi me ca fjalë të ëmbla, që t'ia dorëzoja shpatën. (fq. 16)
Kisha paraqitur e dërguar aq kërkesa e lutje, që të më linin të lirë, saqë më në fund Madhëria e Tij e pleqëroi punën në Këshillin e Shtetit (fq. 19).
Në një ceremony të organizuar pikërisht pët këtë qëllim, u detyrova të deklaroja me zë të lartë. (fq. 19)
Fjala që mbajti Ai për mua, u botua në të katër anët e vendit. (fq. 31)
Siç duket, më kishte dënuar Perëndia, që të mos gjeja prehje. (fq. 37)
I zoti i shtëpisë ma bëri me shenjë, që të afrohem te pjata e tij. (fq. 41)

Shembuj shkëputur nga varianti i dytë i RC

Shpresa se kështu po gjeja ç'më duhej, më shtynte dhe më bënte të punoj më tepër sesa mundja. (fq. 12)
Kështu prita sa të ulej uji e t'ma linte trapin mbi dhé të thatë. (fq. 14)
Duke ngjitur lumin, gjeta luadhe të bukura, që shtriheshin mbi njëri-tjetrin duke u lartësuar. (fq. 33)
M'u kujtua që degët e atij druri që më kishte dhënë hunjtë e gardhit, ishin mjaft të epshme për këtë punë (fq. 37)

Pandeha se mund të ndërtoja barkën e anijes, që e kishin hedhur valët e detit mbi zall. (fq. 44)
Kur u nisa për udhë, isha veshur në atë mënyrë, që në një qytet të Evropës do ta bënte botën të qeshtë a të trembej (fq. 52)

Pasi kemi përmendur shembujt e mësipërm ilustrues, theksojmë edhe një herë se është e domosdoshme që përkthyesit, gjatë përkthimit të teksteve të çfarëdolloj përkatësie funksionale, të ruajnë natyrshmërinë, t'i kushtojnë vëmendje aspektit stilistikor në procesin e përkthimit, "*nënvlerësimi, shkujdesja apo mohimi i të cilit nënkupton varfëri të përkthimit*".[441]

V.4.4 Përdorimi i fjalëve e shprehjeve të huazuara kundrejt atyre karakteristike shqiptare

Duke shfletuar shkrime të ndryshme të studiuesve shqiptarë mbi përkthimin vërejmë se të gjithë theksojnë faktin se misioni i përkthyesit është edhe ai i pasurimit të gjuhës amtare. Aleksandër Xhuvani thekson se kushdo që i hyn një pune përkthimore, i pajisur me vyrtyte të larta morale, i bën një shërbim të madh gjuhës e kombit.[442] Gjithashtu, Donika Omari duke diskutuar rreth gjuhës së përkthimeve të letërsisë së huaj artistike shprehet se një nga burimet prej nga pasurohet gjuha kombëtare letrare është edhe veprimtaria përkthimore, vetë përkthyesi është një furnizues i vazhdueshëm i fondit leksikor të gjuhës.[443] Megjithatë, në ditët e sotme mbetet shqetësues fakti se gjuha shqipe duhet të pastrohet nga trysnia e gjuhëve të huaja,[444] dhe se gjuha shqipe bëhet mbartëse e ndikimeve të huaja që pasqyrohen si në leksik, ashtu edhe në sintaksë dhe frazeologji.[445] Në këtë nënçështje do të përmendim disa shembuj për të parë se në ç'raport qëndrojnë fjalët dhe shprehjet e huazuara kundrejt atyre karakteristike shqiptare në korpusin nën studim.

Duke iu referuar varianteve të përkthyera në gjuhën shqipe të *AAiW*, përmendim këto fjalë të huazuara: *sahat, llagam, mashallah, pekmez, proçesion, peripetina, vaki* (v.I); *bujar, zotrote, konfuzion, mashallah, muhabet, gjynah, pekmez, aman, nervoz, sherbet, mile, shiling* (v.II); *hile, zotrote, shiling, gjynah, karamel, pallavra, surrati, ekzekutim, dokrra, lustroj, pensë* (v.III); *ilustrime, nervoze, tersi, simpati, debati, e moderuar, arroganca, absurde, pretekste, solemn, gajasem, sarkazëm, salcë vegjetale, shans, gizili, relacion, e preokupuar, persona* (v.IV); *demonstrim, kroket, normale, shanse, vulgare, ekip, debat, arroganca, solemnitet, solemnisht, truke, fatale, badihava, efekt, adresoj, falsifikoj,* etj. (V.V)

Krahas fjalëve të huazuara përmendim edhe përdorimin e shprehjeve karakteristike shqiptare si: *sa pare bân, ulu nga fiku, gjat e gjânë, çante kryet, në nji déll shumë të keq, i dha zemër, me dalë mendsh, ngul kambë, në damàr të mirë, i shkonte lang për goje, ve punën në vij* (v.I); *m'u hiq qafe, loz mënç, shes mënd, ngrin gjakun, paç veten më qafë* (v.II); *më vjen mendja vërdallë, e kam mbledhur mendjen top, shpëtova për qime, të lagur deri në palcë, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, si një e një që bëjnë dy, e*

---

[443] Xh. Lloshi (1982) *Analiza stilistike e gjuhës shqipe.* Në Viktor Ristani (2010) në *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 212.
[442] E. Ymeri në Ylli (8 gusht 1989), *Nga mendimi kritik shqiptar për përkthimin,* fq. 16.
[443] D. Omari (1985) *Rreth gjuhës së përkthimeve të letërsisë së huaj artistike.* Në *Studime Filologjike nr. 1,* fq. 175.
[444] E. Ymeri në Ylli (8 gusht 1989), *Nga mendimi kritik shqiptar për përkthimin,* fq. 16.
[445] D. Omari (1985) *Rreth gjuhës së përkthimeve të letërsisë së huaj artistike.* Në *Studime Filologjike nr. 1,* fq. 177.

merrte me të mirë, mbush mendjen, luaj mendsh, vesh më vesh, me sa i hante fyti, më është bërë koka dhallë, të këpuste shpirtin (v.III); *çdo gjë shkonte vaj, ja hodha për një fije, të hapte udhë, sa hap e mbyll sytë, i lëshoi goja lëng* (v.IV); *gjethnajë, vras mendjen, si mbi gjemba, buzëqesh vesh më vesh, flakë e kuqe, gjest,* etj. (V. V). Duke e njohur faktin se huazimet nga turqishtja kanë qenë thuajse të pashmangshme për variantin e parë dhe të dytë, do të ishte mirë që huazime të tilla si *nervoze, ters, absurde, person, shans, preokupim* etj. të shmangeshin në përkthimet e sotme, veçanërisht për faktin që përkthimet u drejtohen fëmijëve dhe, meqënëse aftësia thithëse dhe riprodhuese në periudhën e fëmijërisë është shumë e lartë, do të ishte mirë që ata të pasuronin fjalorin e tyre me fjalët e bukura dhe të pastra shqipe.

Përmendim edhe disa shembuj nga variantet në gjuhën shqip të *Gulliver's Travels*. Nga varianti i parë shkëputim këto shprehje të huazuara: *aluzion***,** *dallavere, sahat, derman***,** *poltrona, sehir, merak, manevër, medet, takëm, lord, balancë, kapardisur* kundrejt këtyre shprehjeve karakteristike të fondit të gjuhës shqipe *ngul këmbë, fshati duket dhe nuk do kallauz, ndaj shaping nga sheqeri, hap udhë, pjell mendja, hante me sy, s'ia bënte fjalën dy, vë kokën në trastë, halë në sy, me dorë në zemër, mjaltë e qumësht, koskë e lëkurë, i fluturoi zogu nga dora, krip xhepin, shaka pa kripë, të hurit e të litarit, janë me dy faqe, ha bukën e përmbys kupën, lajle e lule, shesh me lule, fjalët i mori era, kullot sytë, nuk ka sy e faqe, i ruan si sytë e ballit, lindur me këmishë, me një këmbë në varr, vëth në vesh, m'u bë mendja dhallë, lesh e li.* Nga varianti i dytë shkëpusim fjalët e huazuara si vijon *sehir, hallat, xhade, temena, regjiment, xhevahir, ibret, mysafir, dajak* dhe shprehjet karakteristike të gjuhës shqipe *më tym, kacamic, t'i bëjë sytë katër, ujdhesë, i ra erë, ma kishte ënda, fët e fët, u prishej gjaku, vë ujin në zjarr, si veshka midis dhjamit, lë në baltë, nuk ia vlente barra qeranë, për shtatë palë qejfe*. Japim, në përfundim, edhe disa shembuj pasqyrues nga *Robinson Crusoe* në gjuhën shqipe: fjalët e huazuara *llagap, medet, zanat, panoramë, taksirat, hesap, senior, tërkuzë, kusur, merak, lord, tahmaqar, stoik, kapardisej, leverdi* (v. I) dhe *mynxyra, bollëk, senjor* (v. II) si dhe shprehjet karakteristike të frazeologjisë shqiptare *marr më qafë, më hyri data, rri duarkryq, bëj ballë, m'u bë zemra mal, ika nga sytë këmbët, copë e thërrime, vaj halli, m'u bë zemra mal, nuk e humba zemrën, heq dorë, shtie në dorë, vras mendjen, ia qepa sytë, do t'i ngrihej qimja drizë, më bëhej shtati miza miza, rrija si në gjemba, e hiqnin jetën hollë, isha regjur me vaj e me uthull, u turr si një fatos, u shkrimë së qeshuri, e bëri natën ditë, më digjte një mall e një flakë e pashuar, mendje të fjetur* (v. I). Nga *Harry Potter and the Philosopher's Stone* shkëputim këta shembuj të fjalëve dhe shprehjeve të tabanit shqiptar *bëj vaki, me një vidë mangët, humbas fiqirin, s'ma ka ënda, s'pi ujë, ka gisht, shpëtoi paq, heq qafe, mbaj vesh, shtrydh trutë, mbi gjemba* kundrejt atyre të huazuara: *shyqyr, dërdëng, lokalitete, spiker, mesele, karar, bandë, hesap, mysafir, kornflejks, parkimetër, fast-fude, nervoz, angazhoj, tërsëllëm, sahat, kiamet, fodullëk, ishalla, vulgare, favorizuar, haber, kallaballëk, alibi, klozet,* etj. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të shprehjeve të përdorura në secilin variant, kemi parasysh edhe fjalët e Eshref Ymerit se çdo vepër është produkt i një mjedisi shoqëror të caktuar dhe i një epoke të caktuar, dhe, për rrjedhojë, përdorimi i disa shprehjeve karakteristike shqiptare do të jetë i pashmangshëm në çfarëdolloj përkthimi.

Nuk mund të lemë pa përmendur se veprat në gjuhën shqipe – Udhëtimet e Guliverit dhe Robinson Kruzo (variantet e hershme) si dhe Harri Poter dhe Guri Filozofal nuk paraqiten problematike nëse mendojmë për aspektet e lartpërmendura. Në këto vepra kemi vërejtur një gjuhë të përzgjedhur me kujdes, shkallë të lartë besnikërie ndaj origjinalit si dhe marrje në konsideratë të publikut lexues. Të mos harrojmë që UG dhe RK i përkasin një periudhe tjetër në veprat e përkthyera në gjuhën shqipe (para viteve '90) si dhe, çka është edhe më e rëndësishme, nuk i drejtohen ekskluzivisht një publiku të

përbërë nga fëmijë, ndonëse lexohen gjerësisht nga fëmijët në ditët e sotme. Nga ana tjetër, vepra e Harri Poterit vjen mjeshtërisht në gjuhën shqipe nga Amik Kasoruho, me po të njëjtin nivel të lartë përkthimi që e karakterizon këtë përkthyes edhe në përkthimin e veprave për të rritur, pa e nënvleftësuar gjininë e letërsisë për fëmijë.

Në përfundim të kësaj çështjeje theksojmë se aspektet problematike janë vërejtur kryesisht në përkthimet e pas viteve '90. Kjo duhet të na bëjë të kuptojmë se aktualisht përkthimet e letërsisë për fëmijë nuk i nënshtrohen një procesi të kujdesshëm dhe të hollësishëm si nga ana e përkthyesve, ashtu edhe nga ana e shtëpive botuese. Me mjaft rëndësi në këtë aspekt është edhe faza e redaktimit, pikpamja sasiore e së cilës është e ndryshme në varësi të vështirësisë së tekstit si dhe *lexuesit* të cilit i drejtohet përkthimi.[446] Ndoshta është me rëndësi të kuptojmë se është ky i fundit – lexuesi – një ndër elementët më kryesorë në ushtrimin e pushtetit gjatë përkthimit. Gjithashtu, nëpërmjet shembujve të vërejtur në këtë punim, dëshirojmë të nxjerrim në pah faktin shumë domethënës se të përkthyerit e një teksti kalon nëpër shumë faza, ndër të cilat më e rëndësishmja është *të lexuarit e kujdesshëm, nxjerrja e kuptimit dhe interpretimi i origjinalit, dhe, vetëm pas kësaj faze, përcjellja në mënyrë sa më të ngjashme për publikun marrës nëpërmjet përkthimit*. Nëse përkthyesit i kushtojnë pak ose aspak rëndësi kësaj faze përkthimi do të jetë domosdoshmërisht i mangët, dhe, njëkohësisht, lexuesit e variantit të përkthyer nuk do të kenë mundësi të shijojnë efekte të ngjashme me ato të përcjella në origjinal. Përkthyesit duhet të ndërgjegjësohen në lidhje me procesin e vendimarrjes gjatë përkthimit si dhe problemeve që ata mund të hasin në lidhje me përcjelljen sa më të saktë të mesazhit shprehur në origjinal. Njëkohësisht të gjithë duhet ta kuptojnë se letërsia për fëmijë nuk paraqet një gjini inferiore përkrah gjinive të tjera letrare, dhe, aq më pak, përkthimi i kësaj letërsie, një punë më pak të rëndësishme se përkthimi i një gjinie tjetër.

[446] P. Newmark (1984) *Approaches to Translation.* Cituar nga V. Ristani (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë, fq. 218.

PËRFUNDIME

Në ditët e sotme, ekzistojnë shumë mënyra përkufizimi dhe perceptimi të përkthimit. Në kreun e parë të këtij punimi, kemi përmendur këndvështrime të ndryshme rreth çështjeve të tilla që ndodhen në qendër të studimeve përkthimore, si, për shembull, çështja e ekuivalencës, pozicionimi i përkthyesit, pikpamjet funksionaliste mbi përkthimin si dhe prirjet e huajëzimit dhe amëtarizimit. Në mënyrë të përmbledhur, theksojmë një nga këndvështrimet më bashkëkohore mbi përkthimin dhe procesin e të përkthyerit, i cili konsiderohet të jetë një proces komunikimi dhe negociimi ndërmjet teksteve dhe kulturave, një proces gjatë së cilit ndodhin një sërë shkëmbimesh të ndërmjetësuara nga përkthyesi, brenda një konteksti shoqëror Një gjë e tillë na bën të kuptojmë se përkthimi dhe studimi i tij nuk paraqet vetëm interes gjuhësor, por përfshin gjithashtu një ndërthurje mes kulturave të ndryshme. Theksojmë, gjithashtu, se gjatë përcjelljes së tekstit nga origjinali drejt gjuhës së përkthimit asnjëherë nuk duhet të jemi në kërkim të ekuivalencës së plotë, diçka e paarritshme edhe brenda së njëjtës gjuhë. Kështu, përkthyesi vendoset fillimisht në rolin e një lexuesi dhe interpretuesi të kujdesshëm të tekstit origjinal dhe synimeve të drejtpërdrejta apo të fshehta të shkrimtarit, duke synuar të përcjellë të njëjtat ide e mesazhe ashtu si edhe të njëjtin funksion të origjinalit, nëpërmjet një teksti që krijon një efekt sa më të përafërt për lexuesit e tekstit të përkthyer ashtu si edhe teksti origjinal. Pikpamje të tilla të përmendura janë parë në dritën e përkthimit të letërsisë për fëmijë. Studime të ndryshme të përmendura në kreun e parë nxjerrin në pah se shenjat e para të shfaqjes së një interesi rreth letërsisë për fëmijë janë vënë re brenda disiplinës së Letërsisë Krahasuese, ndërkohë që studimet mbi përkthimin e kësaj letërsie kanë fituar më shumë terren pasi studiuesit dhe filluan ta vlerësojnë letërsinë për fëmijë si një mjet të fuqishëm si nga ana ideologjike, ashtu edhe nga ana estetike.

Kemi sjellë një sërë argumentash për të theksuar se përse nuk është e lehtë të japim një përkufizim vendimtar në lidhje me gjininë e letërsisë për fëmijë, por kemi parapëlqyer të rendisim një sërë cilësish të kësaj gjinie të cilat marrin edhe më shumë rëndësi në përkthimin e kësaj letërsie, dhe, rrjedhimisht, edhe në punimin konkret. Ndër këto cilësi përmendim faktin se gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë duhen marrë gjithmonë në konsideratë aftësitë e lexuesve për të kuptuar elementët e kulturës së huaj. Niveli i përshtatjes së këtyre elementëve shpesh çon në manipulim të tekstit origjinal, pavarësisht shqetësimit të shumë studiuesve rreth nivelit të transformimit të tekstit. Një tjetër faktor që sërish çon drejt manipulimit të origjinalit, dhe, shpeshherë, edhe nënvlerësimit të përkthimit të letërsisë për fëmijë, është pozicioni periferik që ze letërsia e përkthyer për fëmijë brenda polisistemit letrar. Faktorë të tillë na bëjnë të kuptojmë se përkthimi i letërsisë për fëmijë është gjithmonë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm si faktorë kulturorë, ideologjikë, shoqërorë, ekonomikë, politikë, etj.

Ka qenë një sfidë e vërtetë përzgjedhja e korpusit tonë studimor. Ashtu siç e kemi theksuar gjatë punimit kemi përzgjedhur vepra të tilla të cilat nxjerrin më në pah qëllimet e studimit tonë, pra, qartësimin dhe shtjellimin e analizimin e atyre dukurive domethënëse të parashtruara teorikisht dhe të aktualizuara nëpërmjet shembujve konkretë nga korpusi ynë. Këto vepra përfshijnë *Alice's Adventures in Wonderland, Harry Potter and the Philosopher's Stone, Robinson Crusoe* dhe *Gulliver's Travels* dhe variantet e tyre në gjuhën shqipe. Secila prej veprave në fjalë ka paraqitur interes të veçantë për studimin tonë, duke u kthyer kështu, për pjesët përkatëse të këtij punimi, në raste studimorë për vërejtjen e dukurive të veçanta si përkthimi i emrave të përveçëm, përcjellja e nënkuptimeve, përkthimi i lojërave të fjalëve, prirja e varianteve në gjuhën shqipe ndaj amëtarizimit apo huajëzimit, niveli i përcjelljes së elementëve specifikë kulturorë,

konkretizimi i shkallëve të ndryshme të përshtatjes si një nga standardet e përdorura në variantet në gjuhën shqipe, etj. Për shembull, *Alice's Adventures in Wonderland* dhe krahasimi i saj me variantet në gjuhën shqipe ka qenë me të vërtetë frytdhënës për studimin e strategjive për përkthimin e lojërave të fjalëve si dhe përcjelljen e nënkuptimeve të shprehura nëpërmjet emrave të përveçëm. Po kështu, krahas veprës së sipërpërmendur, edhe *Robinson Crusoe* dhe *Gulliver's Travels* dhe krahasimi i tyre me variantet në gjuhën shqipe na kanë ndihmuar për të vërejtur nivelin e transmetimit të elementëve specifikë kulturorë në gjuhën shqipe dhe për të analizuar të dhënat krahasuese drejt nxjerrjes së përfundimeve mjaft domethënëse në këtë drejtim. Të dhëna më specifike në lidhje me përligjen e korpusit të përzgjedhur si dhe karakteristika të tij si për veprat origjinale, ashtu edhe për variantet në gjuhën shqipe i kemi përshkruar në kreun e dytë.

Krahas të dhënave të tjera si ilustrimet, kopertina, ndarja në kapituj, emërtimi i titujve, etj., jemi ndalur edhe në analizimin e qëllimeve të parathënies. Shkurtimisht përmendim se funksionet e parathënies në korpusin tonë janë: informimi i lexuesve të tekstit të përkthyer rreth shkrimtarit dhe veprës së shkruar në origjinal, shtjellimi i arsyeve se pse është përkthyer vepra në gjuhën shqipe (skoposi i përkthimit), informimi rreth përkthimeve ekzistuese të mëparshme (nëse ka), identifikimi i publikut marrës, parashtrimi i vështirësive me të cilat është përballuar përkthyesi, përcaktimi i pozicionit të veprës brenda letërsisë shqipe si dhe kërkesë për mirënjohje për punën e bërë nga ana e përkthyesir shoqëruar me shfajësimin për gabime të mundshme. Në një këndvështrim diakronik kemi vënë re se parathënia fillon të mungojë në variantet në gjuhën shqipe ose është e pranishme, por nuk është shkruar nga vetë përkthyesi. Për këtë arsye dëshirojmë të theksojmë se është shumë e rëndësishme që vepra të shoqërohet me parathënie, si për qëllime studimore, ashtu edhe për qëllime informuese të publikut marrës. Prania e parathënies do të mundësojë një nivel më të thellë të të kuptuarit të veprës, dhe, njëkohësisht, ndërgjegjësim të rolit të përkthyesit si dhe rritje të përgjegjësisë së tij.

Në kreun e tretë kemi sjellë një sërë argumentash për të treguar ekzistencën e një marrëdhënieje të pabarabartë mes të rriturve dhe fëmijëve në përkthimin e letërsisë për fëmijë si dhe mënyrën e përdorimit të pushtetit nga të rriturit në këtë drejtim. Kemi përmendur faktorë të ndryshëm që luajnë rol në këtë proces, si, për shembull, shtëpitë botuese, mësuesit, prindërit, librashitësit, shkrimtarët dhe përkthyesit, të cilët i "filtrojnë" librat e botuar për fëmijë shtresë pas shtrese, duke lënë kështu në fund të procesit të përzgjedhjes ata të cilëve iu drejtohen librat në të vërtetë – vetë fëmijët. Kjo është edhe arsyeja se pse shpesh, gjatë përkthimit të letërsisë për fëmijë, ndodh që një sërë elementësh kulturorë t'iu nënshtrohen tjetërsimeve nga ana e përkthyesit, i cili mundohet të sjellë në duart e fëmijëve një libër sa më "të përshtatshëm" për moshën dhe nivelin e njohurive dhe të kuptuarit të tyre. Kjo prirje ndaj "përshtatshmërisë" në përkthimin e librave për fëmijë mund të shfaqet në aspekte nga më të ndryshmet. Në këtë kapitull, kemi analizuar shkallën e përcjelljes së elementëve kulturorë nga gjuha angleze në gjuhën shqipe për veprat *Alice's Adventures in Wonderland, Robinson Crusoe* dhe *Guliver's Travels*. Për veprat në fjalë kemi identifikuar në veprat origjinale elementë të tillë kulturorë si njësitë matëse, njësitë monetare si dhe ushqimet dhe pijet, dhe, një fazë të dytë, kemi gjetur njësitë përkatëse në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe. Të gjithë elementët përkatës janë krahasuar me njëri-tjetrin dhe janë klasifikuar sipas prirjeve të amëtarizimit dhe huajëzimit, pra, më pak fjalë, nëse përkthyesi ka vendosur që t'i asimilojë elemëntët e huaj brenda kulturës shqiptare, apo, në të kundërt, t'i mbartë elementët e huaj në gjuhën dhe kulturën e përkthimit. Jemi mbështetur jo vetëm në këtë dikotomi të prezantuar nga Venuti, por, brenda kësaj dikotomie kemi klasifikuar raste të veçanta të shprehjes së amëtarizimit dhe huajëzimit duke prezantuar modelin dhënë nga

Vladimir Ivir rreth procedurave dhe strategjive për përthimin e kulturës. Brenda këtij modeli përmendim strategji të tilla si: huazimi, përkufizimi, përkthimi fjalë për fjalë, zëvendësimi, krijimi leksikor, mospërfshirja she shtimi. Në punimin tonë kemi përmendur thjesht shembuj ilustrues, megjithatë, theksojmë edhe një herë, se të dhënat e tabelave dhe grafikëve janë shprehje e rezultateve të nxjerra në të gjithë korpusin, pasojë e krahasimit të të gjithë njësive kulturore të identifikuara në origjinal.

Në *Gulliver's Travels* kemi gjetur 342 njësi specifike kulturore, nga të cilat janë amëtarizuar 29%, dhe i janë nënshtruar huajëzimit 71% të njësive kulturore në tërësi, ku pjesa më e madhe (brenda huajëzimit) janë përkthyer fjalë për fjalë (42%), ndjekur nga procedura e huazimit (26%). Përkufiimi dhe shtimi janë përdorur në shumë pak raste (përkatësisht 1% dhe 2%). Brenda prirjes së amëtarizimit, më shumë se gjysma e njësive të sjella në gjuhën shqipe janë zëvendësuar (17%), ndjekur nga procedurat e krijimit leksikor (7%) dhe mospërfshirja në një numër të vogël rastesh (4%). Edhe një herë theksojmë se në përkthimin e kësaj vepre mbizotëron dukshëm huajëzimi, pra, një pjesë e konsiderueshme e elemenëve të huaj kulturorë janë sjellë si të tillë në gjuhën shqipe.

Në *Alice's Adventures in Wonderland* kemi identifikuar gjithsej 43 njësi specifike kulturore. Krahasimi i secilit prej varianteve me origjinalin tregon se prirjet shpërndahen pothuajse në të njëjtën përqindje në të gjitha variantet, vetëm me disa dallime të lehta. Kështu, në variantin e parë, të tretë dhe të pestë mbizotëron huajëzimi, ndërsa në variantin e dytë dhe të katërt amëtarizimi. Shkalla e amëtarizimit është më e lartë në variantin e sjellë në gjuhën shqipe nga vëllezërit *Tafa* (varianti i katërt), gjë që tregon se, me kalimin e viteve, më pak elementë të huaj janë përcjellë në gjuhën dhe kulturën shqipe. Megjithatë, nuk mund të lemë pa përmendur se brenda secilit variant shfaqen rastë të një mungese të qëndrueshmërisë në prirjet e vërejtura, për shembull, e njëjta njësi mund të përkthehet nëpërmjet procedurave të ndryshme brenda të njëjtit variant, duke shfaqur kështu herë prirjen e amëtarizimit dhe herë të tjera prirjen e huajëzimit. Për arsye të tilla, nuk është shumë i qartë pozicionimi i lexuesit në veprën e përkthyer: një mjedis shqiptar që përdor para të huaja, një kontekst britanik që përdor pare dhe njësi matëse shqiptare, etj. Gjithashtu mendojmë se kalimi nga një prirje në tjetra brenda së njëjtit variant shkakton pështjellim në të kuptuarin e përgjithshëm të tekstit nga ana e lexuesve, perceptimin e kulturës së huaj, si dhe, më përgjithësisht, një cilësi më të ulët përkthimi.

Në *Robinson Crusoe* kemi identifikuar gjithsej 505 njësi specifike kulturore të shpërndara në të gjithë veprën origjinale. Edhe në përkthimin e kësaj vepre mbizotëron prirja e huajëzimit (67%) me procedurat kryesore përkthim fjalë për fjalë (38%) dhe huazim (26%), ndjekur nga shfaqje të rralla të shtimit (2%) dhe përkufizimit (1%). Thuajse një e treta e elementëve kulturorë sillen në gjuhën shqipe nëpërmjet amëtarizimit (33%), kryesisht nëpërmjet procedurës së zëvendësimit (21%) dhe pjesërisht nëpërmjet mospërfshirjes apo krijimeve leksikore (secila 6%). Mendojmë se prirja mbizotëruese e përkthyesit është pikërisht e orientuar ndaj huajëzimit, nisur nga një portretizim me shumë vërtetësi i një personazhin dhe aventurave të tij ashtu si ai shfaqet në veprën origjinale, tipik anglez, si dhe, njëkohësisht, duke mos iu drejtuar ekskluzivisht një publiku të përbërë nga fëmijë, por, një publik i përbërë nga të rritur e të vegjël njëkohësisht.

Duke iu referuar të tre rasteve studimorë nëpërmjet të cilëve kemi shqyrtuar prirjet e amëtarizimit dhe huajëzimit, themi se huajëzimi mbizotëron dukshëm në variantet e përkthyera të GT dhe RC. Ndërsa në lidhje me AAiW, vërejmë se huajëzimi mbizotëron në variantin e parë, të tretë dhe të pestë, ndërsa në variantin e dytë dhe të katërt shfaqet më shumë amëtarizimi. Megjithatë, nëse iu referohemi të pesë varianteve në tërësi mund të themi se të dyja prirjet shpërndahen në mënyrë thuajse të njëtrajtshme në secilin prej varianteve, përveç variantit të katërt ku shfaqet qartë mbizotërimi i

amëtarizimit. Kjo edhe për arsye se ky variant iu drejtohet haptazi fëmijëve, ndërsa GT dhe RC janë përkthyer fillimisht për një publik të rritur, pavarësisht se sot lexohen gjerësisht nga fëmijët. Procesi i leximit dhe interpretimit nga ana e tyre mund të lehtësohet dukshëm nga shënimet në fund të faqes dhe në fund të veprës, pavarësisht shkallës së lartë të elementëve kulturorë të huajëzuar. Ia vlen të theksojmë edhe një herë se ka paqëdrueshmëri në lidhje me procedurën e përdorur për përkthimin e së njëjtës njësie brenda variantit në gjuhën shqipe, gjë që shoqërohet me vështirësi për kuptimin e origjinalit apo qëllimeve të shkrimtarit nga ana e lexuesve. Do t'ju rekomandonim përkthyesve që, nëse përballen me elementë specifikë kulturorë gjatë procesit të përkthimit, të ndalen fillimisht në përcaktimin e funksionit të synuar të përdorimit të elementëve të tillë, dhe, më tej, të përpiqen të përcjellin jo elementët në vetvete, por funksionin e tyre në gjuhën shqipe në mënyrë që edhe efekti i përcjellë nëpërmjet elementëve kulturorë në origjinal të jetë sa më i ngjashëm edhe në variantin e përkthyer në gjuhën shqipe.

Studimet përkthimore, duke përfaqësuar një ndërdisiplinë, ruajnë lidhje me shumë disiplina njëkohësisht dhe bëjnë subjekt studimi koncepte të ndryshme të përfshira në këto disiplina. Në kreun e katërt të këtij studimi jemi përqëndruar në përshkrimin teorik të dukurisë së ndërtekstualitetit, veçanërisht studimin e aludimeve: identifikimin dhe analizimin e nënkuptimeve të shprehur nëpërmjet lojërave të fjalëve dhe emrave të përveçëm nëpërmjet shembujve konretë. Për përkthimin e lojërave të fjalëve kemi marrë si rast studimor veprën origjinale *Alice's Adventures in Wonderland* si një nga veprat ku ndërthuren bukur nënkuptimet e fshehura me kuptimet sipërfaqësore si pasojë e krijimit të një sërë lojërash fjalësh të qëllimshme nga shkrimtari. Pasi janë identifikuar lojërat e fjalëve në origjinal, janë krahasuar ato me praninë ose mungesën e tyre në secilin prej varianteve në gjuhën shqipe. Për secilin prej varianteve, kemi grupuar ato lojëra fjalësh që shfaqin prirje të njëjta të qëndrimit të përkthyesit dhe, pas këtij grupimi, kemi emërtuar strategjitë përkatëse që janë përdorur nga përkthyesi për t'i përcjellë lojërat e fjalëve në gjuhën shqipe. Këto strategji janë: rikrijimi i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer, përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve të origjinalit pa riprodhuar lojë fjalësh në tekstin e përkthyer, mospërfshirje e lojës së fjalëve në tekstin e përkthyer si dhe transferim i lojës së fjalëve të origjinalit në tekstin e përkthyer. Me mjaft interes kanë qenë edhe disa raste të vërejtura që shfaqin një tjetër prirje të përkthyesit – krijimi i një loje fjalësh në tekstin e përkthyer edhe pse një lojë fjalësh e tillë përkatëse nuk shfaqet në tekstin origjinal. Nga interpretimi i të dhënave të studimit tonë krahasimor, vërejmë se në mënyrë kronologjike, duke kaluar nga varianti i parë (1944) deri në variantin e pestë (2008) të përkthyer në gjuhën shqipe ka një rënie të rasteve ku loja e fjalëve është ruajtur. Duke iu referuar gjithë korpusit nën shqyrtim, mund të themi se strategjia kryesore që mbizotëron është përkthimi i përbërësve të lojës së fjalëve, por pa rikrijuar nënkuptimin e origjinalit (strategjia e dytë – 46%). Në raste të rralla kemi vërejtur që nuk është përkthyer fare ajo pjesë teksti që përmban lojë fjalësh (2% në të gjithë korpusin), gjë që tregon se përkthyesit janë përpjekur t'i qëndrojnë besnikë cilësisë dalluese të tekstit origjinal, duke mos e anashkaluar rëndësinë që kishin për Kerrëlin lojërat e fjalëve dhe nënkuptimet. Në këtë drejtim, me mjaft rëndësi janë raste të tilla që flasin për një rikrijim të lojërave të fjalëve (në më shumë se një të tretën e gjithë korpusit – 37%) si dhe për një përpjekje për të transferuar lojërat e fjalëve nëpërmjet teknikave të ndryshme editoriale që i hyjnë në ndihmë lexuesve për të vendosur lidhje me synimet e shkrimtarit në tekstin origjinal (15% të gjithë korpusit). Fakte të tilla na bëjnë të mendojmë se lojërat e fjalëve mund dhe duhet të përkthehen, pavarësisht vështirësive me të cilat përballet përkthyesi sa herë që identifikon një lojë fjale në tekstin origjinal. Do t'iu rekomandonim sërish përkthyesve që të mos synojë drejt një përkthimi të menjëhershëm të lojës së fjalëve, por

të përfshihet fillimisht në një proces leximi dhe interpretimi të kujdesshëm, gjatë së cilit duhet të nxjerrë në pah edhe nënkuptimet e synimet e fshehura të shkrimtarit, dhe, pas një procesi tjetër kërkimi, të përcjellë pikërisht synimet e origjinalit, pa rënë në grackën e "besnikërisë" ndaj fjalëve të sipërfaqshme, por në kërkim të vazhdueshëm të transmetimit të efektit të përcjellë në origjinal.

Në kreun e katërt kemi diskutuar gjithashtu rreth një çështjeje që shfaq shumë rëndësi dhe ngre shumë debate brenda studimeve përkthimore: marrëdhënien mes formës dhe përmbajtjes. Jemi mbështetur në një shembull mjaft domethënës në këtë drejtim që shfaqet në AAiW – loja e fjalëve *tail – tale,* e cila gjen shprehje edhe në mënyrë grafike në origjinal. Ne kemi analizuar pikërisht format e ndryshme në të cilat është sjellë "bishti i miut" në gjuhën shqipe dhe, njëkohësisht, nëse përmbajtja apo kuptimi i shprehur në origjinal është ruajtur apo është sakrifikuar në dëshirën për të ruajtur formën. Pas analizës së shembujve, kemi arritur në përfundimin se përkthyesit duhet të kuptojnë që në fillim se marrëdhënia mes gjuhës dhe përmbajtjes është e ndryshme në origjinal dhe do të duhet të rikrijohet në gjuhën e përkthimit. Shkalla e vështirësisë që paraqet një gjë e tillë nuk duhet të shërbejë si pengesë për përkthyesit por si një sfidë për t'u përfshirë në horizonte të reja kërkimi. Edhe në këtë rast është me shumë rëndësi përcjellja e nënkuptimeve dhe synimeve të origjinalit, në përpjekje për të përcjellë efekt sa më të ngjashëm për lexuesit e tekstit të përkthyer.

Pjesë e diskutimit tonë në kreun e katërt ka qenë edhe studimi i emrave të përveçëm në dy prej veprave të korpusit tonë: *Harry Potter and the Philosopher's Stone* dhe *Alice's Adventures in Wonderland.* Mendojmë se kjo pjesë e punimit është gjithashtu me mjaft interes meqenëse qëndrimet e mbajtura ndaj emrave të përveçëm të huaj janë të ndryshme. Jo vetëm kaq, por kemi vërejtur se përkthyesit nuk zbatojnë as parimet fonetike e fonologjike dhe nuk ua nënshtrojnë emrat e huaj kategorisë së shquarësisë, gjë që është e domosdoshme për gjuhën shqipe. Akoma më me rëndësi shfaqet ky problem në pëkthimin e atyre emrave të cilat fshehin nënkuptime të qëllimshme nga ana e shkrimtarit. Për këto arsye, e kemi parë të nevojshme të prezantojmë një sfond teorik rreth përkthimit të emrave të përveçëm që më pas na ka ndihmuar në analizmimin e shembujve. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se janë katër teknika kryesore për përcjelljen e emrave të përveçëm: transferimi (ruajtja e formës origjinale), zëvendësimi (përdorimi i një emri korrespondues në gjuhën e përkthimit), përkthimi (gjetja e një forme ekuivalente në gjuhën e përkthimit) dhe përshtatja (modifikimi i formës së origjinalit sipas funksionit). Vendimi i përkthyesit për përdorimin e njërës apo tjetrës teknikë është në varësi të (nën)kuptimit që bart emri në gjuhën origjinale. Përzgjedhja e emrave zakonisht është një proces i qëllimshëm nga shkrimtari dhe përkthyesi duhet t'i identifikojë më së miri rastet e emërtimeve të qëllimshme dhe funksionin e synuar të shkrimtarit, duke i dalluar ato nga emrat që nuk kanë ngarkesë semantike dhe konotative. Dukuritë e vërejtura në korpusin tonë në lidhje me përkthimin e emrave të përveçëm kanë qene: përshtatja e emrave që emërtojnë personazhe historikë dhe referenca gjeografike, përkthim i emrit (duke e ruajtur ose jo paraqitjen grafike të tij), transferimi i emrit të personazhit (duke e shoqëruar ose jo me shpjegime ose shënime në fund të faqes), mospërkthimi i emrit të personazhit në raste të rralla, shtimi i ngjyrimeve konotative si rrjedhojë e transferimit apo zëvendësimit të emrit, etj. Edhe një herë e gjejmë me vend të theksojmë se sa e rëndësishme është faza e lexim-interpretimit të origjinalit për të nxjerrë në pah synimet e fshehta të shkrimtarit në mënyrë që ato të përcillen me sa më shumë vërtetësi në gjuhën shqipe. Në fund të fundit, lexuesit e tekstit të përkthyer kanë në duart e tyre veprën e përkthyer dhe, për ta, e vetmja mënyrë për t'u afruar me shkrimtarin dhe synimet e tij (të qarta apo të fshehta) është pikërisht nëpërmjet kësaj vepre, gjë që vendos

edhe më shumë përgjegjësi mbi përkthyesin dhe misionin e tij si ndërmjetës mes shkrimtarit, veprës origjinale, publikut marrës dhe veprës së përkthyer.

Kreu i fundit i këtij studimi ka kryesisht një natyrë praktike dhe është i ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë jemi ndalur në shqyrtimin e disa standardeve konkrete që zbatohen në përkthimin e letërsisë për fëmijë, duke u bazuar kryesisht në kërkesën për ta përshtatur nivelin e ndërlikueshmërisë së tekstit sipas aftësive të lexuesve. Kemi përmendur si të tilla përshtatjen kulturore kontekstuale, aspektet gjuhësore, modernizimin, purifikimin, shkurtimin, përshkrimin e venddodhjes gjeografike si dhe keqpërkthimet serioze. Secili nga këto standarde është konkretizuar me shembuj shkëputur nga të katër veprat nën studim dhe variantet e tyre në gjuhën shqipe. Brenda standardit të përshtatjes kulturore kontekstuale jemi ndalur në mënyrë më të hollësishme në shkallë të ndryshme të përshtatjes si shpjegimet shtesë, rifjalësimi, përkthimi shpjegues, shpjegimet jashtë tekstit, zëvendësimi me ekuivalent ose me ekuivalent të përafërt në gjuhën e përkthimit, thjeshtësimi, fshirja dhe lokalizimi që është edhe shkalla më e lartë e përshtatjes kulturore. Të gjitha këto shkallë janë shpjeguar fillimisht teorikisht bazuar në klasifikimin e dhënë nga studiuesi Gëte Klingberg, i përfshirë gjerësisht në studimet përkthimore të letërsisë për fëmijë, dhe janë ilustruar me shembuj nga korpusi ynë. Pas analizimit të shembujve konkretë sipas shfaqjes së tyre brenda standardeve dhe shkallëve të ndryshme të përshtatjes, mendojmë se është me rëndësi që përkthyesit të njihen me dukuritë e përshkruara në fazën pregatitore të përkthimit të tekstit me qëllim që të njohin mënyra të ndryshme se si mund të përballen me elementë kulturorë të tekstit, dhe jo vetëm. Është e rëndësishme gjithashtu që përkthyesi të analizojë thellësisht origjinalin përpara se të përfshihet në procesin konkret të përkthimit. Standardet e ndryshme të përshkruara në këtë kapitull mund t'i hyjnë në ndihmë përkthyesit të letërsisë për fëmijë në veçanti, por edhe përkthyesit letrar në përgjithësi, duke e ndihmuar atë të tregohet sa më i kujdesshëm në përcjelljen e domethënies së origjinalit, por, njëkohësisht edhe në shmangien e dukurive të tjera, si, për shembull, keqpërkthimet serioze. Kjo na bën të reflektojmë edhe për shkallën e lartë të rëndësisë që ka publiku marrës në përzgjedhjen e strategjive të përkthimit nga ana e përkthyesit, veçanërisht mosha e lexuesve si dhe njohuritë e tyre paraprake.

Një nga dukuritë më shpesh të vërejtura në përkthimin e letërsisë për fëmijë është thjeshtëzimi i origjinalit në nivele të ndryshme të përbërjes së tij. Qëllimi ynë ka qenë ta vështrojmë dukurinë e thjeshtëzimit në nivelin sintaksor. Për këtë arsye kemi marrë në shqyrtim variantin e tretë të përkthyer në gjuhën shqipe të *Alice's Adventures in Wonderland* dhe kemi shqyrtuar ndryshimet sintaksore që ndodhin gjatë përkthimit të fjalisë së përbërë. Kemi përzgjedhur pikërisht këtë variant sepse jemi të sigurt që ky variant iu drejtohet fëmijëve dhe, për më tepër, është përkthimi i dytë që i bëhet origjinalit nga i njëjti përkthyes. Kemi marrë në analizë 655 fjali të përbëra të veprës origjinale dhe i kemi krahasuar ato me fjalitë përkatëse të gjetura në variantin në gjuhën shqipe. Ato fjali që kanë shfaqur dukuri të njëjta janë grupuar së bashku. Në përfundim të krahasimit, kemi vërejtur se gjatë përkthimit të fjalive të përbëra shfaqen këto dukuri: ruajtja e strukturës së fjalisë së përbërë, copëzimi i fjalisë së përbërë, thjeshtëzimi i strukturës së origjinalit, ndryshimi i llojit të pjesës së nënrenditur si dhe përdorimi ose jo i lidhëzës kundrejt origjinalit. Në 28% të gjithë rasteve të studiuara struktura e fjalisë është thjeshtëzuar ose nëpërmjet copëzimit të saj ose nëpërmjet reduktimit të numrit të pjesëve të nënrenditura ose të bashkërenditura, ndërsa në 17% të rasteve struktura e fjalisë paraqitet më e ndërlikuar se në origjinal si pasojë e shtimit të një pjese të nënrenditur ose të bashkërenditur ose shndërrimit të një fjalie të thjeshtë në një fjali të përbërë. Raste të tjera shfaqin mospërputhje të strukturës me origjininalin si dhe ndryshimin e llojit të pjesës së nënrenditur si dhe përdorim të lidhëzave edhe në rastet kur ato mungojnë në

origjinal. Krahasimi i rezulatateve të studimit tonë na bën të mendojmë se prirja e përgjithshme e përkthyesit ka qenë vërtet thjeshtëzimi i strukturës së origjinalit, supozojmë nën ndikimin e faktit se përkthimi iu drejtohet haptazi fëmijëve. Edhe përdorimi i lidhëzave mendojmë se është një tjetër mënyrë për të qartësuar origjinalin.

Pjesa e fundit e këtij kapitulli, dhe, njëkohësisht e gjithë punimit, ka për qëllim të nxjerrë në pah disa anë problematike që i kemi vërejtur gjatë krahasimit të vazhdueshëm të veprave origjinale me përkthimet e tyre në gjuhën shqipe. Shpresojmë se renditja e shembujve dhe grupimi i tyre sipas dukurisë problematike të shfaqur mund t'iu hyjë në ndihmë si përkthyesve të letërsisë për fëmijë, ashtu edhe përkthyesve letrarë. Ndër këto probleme përmendim mungesën e koherencës (si ndaj tekstit origjinal, ashtu edhe në brendësi të vetë tekstit të përkthyer), gabime drejtshkrimore dhe përdorim të gabuar të presjes, shtrembërimin e strukturave morfo-sintaksore të gjuhës shqipe nën ndikimin e gjuhës së huaj, si dhe përdorimin e një sërë fjalësh e shprehjesh të huaja kundrejt atyre karakteristike shqiptare. Duhet të theksojmë se aspektet problematike të përshkruara shfaqen në përkthimet e pas viteve '90, gjë që na bën të reflektojmë edhe më shumë rreth gjendjes së përkthimeve së letërsisë për fëmijë në ditët e sotme, të cilat nuk i nënshtrohen një procesi të kujdesshëm analize dhe krahasimi qoftë nga ana e përkthyesve, qoftë nga ana e redaktorëve apo shtëpive botuese në përgjithësi. Tërheqim vëmendjen për ndërgjegjësimin e të gjithë faktorëve pjesëmarrës në përkthimin e letërsisë për fëmijë se letërsia për fëmijë nuk paraqet një gjini inferiore dhe se përkthimit të letërsisë për fëmijë nuk i duhet kushtuar më pak rëndësi se përkthimit të një gjinie tjetër, duke mos e lënë atë në mëshirë të një profesionalizmi të ulët dhe një procesi të pakujdesshëm redaktimi. Në fund të fundit, përkthimi i një libri për fëmijë paraqet probleme të ngjashme me përkthimin e çfarëdo lloj libri tjetër, madje përfaqëson në vetvetë një sfidë edhe më gjithëpërfshirëse se gjinitë e tjera, nisur edhe nga mosha dhe formimi i lexuesve.

Në përfundim të këtij punimi theksojmë edhe një herë se jemi të ndërgjegjshëm që një punim i përmasave të tilla që merr përsipër të hulumtojë rreth aspekteve teorike dhe praktike të përkthimit të letërisë për fëmijë nuk mund të jetë kurrsesi shterues në vetvete. Shumë pyetje janë ngritur gjatë fazës analizuese të këtij punimi dhe shumë syresh vazhdojnë të kërkojnë përgjigje më të hollësishme. Shumë vepra të tjera, të papërfshira në studimin tonë, presin për t'u analizuar praktikisht sipas aspekteve teorike të përmendura në këtë punim. Mundësitë që shfaqen për ta shtrirë këtë studim në të ardhmen, pasi kemi hedhur vetëm hapat e para nëpërmjet këtij studimi, janë edhe më interesante se në fillim dhe presin shtigje të reja që në fillim nuk kishim menduar të ishin pjesë e studimit tonë. Sa më shumë pyetje na dalin përpara, aq më shumë mendojmë se punimi aktual paraqet interes, sepse, mbi të gjitha, një studim ka për detyrë të ecë fillimisht në rrugë të reja, ndoshta edhe të pashkelura më parë, por, njëkohësisht, në faza të mëvonshme, të ftojë studiues të tjerë të bëhen pjesë e një rrugëtimi të përbashkët, në përballje të sfidave të reja.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

Carroll, L. (1944) *Liza në Botën e Çudinavet.* (përkth.) Hysejn dhe Beqir Çela, Botonjës Ismail Mal'Osmani, Tiranë.

Carrol, L. (2001) *The Complete Stories and Poems of Lewis Carroll*. Midpoint Press: New Lanark, Scotland.

Defo, D. (1982). *Robinson Kruzo.* (përkth.) H. Selfo; B. Doko,"Naim Frashëri", Tiranë.

Defo, D. (2007) *Robinson Kruzo* (përkth.) A. Bishqemi; L. Skëndo. Dy Lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë.

Defoe, D. (2007). *Robinson Crusoe* .OUP, New York.
Gardener, M. (2000) *The Annotated Alice – the Definitive Edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA.
Karoll, L. (1961) *Liza në Botën e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Mihal Duri, Tiranë.
Kerël, L. (1998) *Liza në Boten e Çudirave.* (përkth.) M. Afezolli, Shtëpia Botuese 'Mësonjëtorja': Tiranë.
Kerël, L. (2008) *Liza në Botën e Çudirave* (përkth.) Taulant dhe Eri Tafa, Shtëpia botuese: Botimet Vëllezërit Tafa: Tiranë.
Kerol, L. (2008) *Liza në Botën e Çudirave*. (përkth.) F. Shuraja, Redona: Tiranë.
Rowling, J. K. (2002) *Harry Potter dhe Guri Filozofal.* (përkth.) A. Kasoruho. Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë.
Rowling, J.K. (1997). *Harry Potter and the Philosopher's Stone*. London: Bloomsbury.
Suift, Xh. (1974) *Udhëtimet e Guliverit ndër vise të largëta të dheut.* (përkth.) H. Selfo. Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë.
Suift, Xh. (2007) *Udhëtimet e Guliverit.* (përkth.) A. Bishqemi. Dy Lindje dhe Dy Perëndime, Tiranë.
Swift, J. (1961) *Gulliver's Travels,* London J. M. Dent & Sons Ltd. Aldine House, Bedfort Street, London.

Burime dytësore

Aixelá, J. F. (1996) *Culture-specific Items in Translation.* Në *Translation, Power, Subversion.* (ed.) Roman, A.; Vidal, M. Carmen-Africa, Multilinugal Matters Ltd.
Allen, G. (2000) *Intertextuality.* London and New York, Routledge.
Bakhtin, M. (1934) *Discourse in the Novel*. Në: M. Holquist (ed.) (1981) *The Dialogic Imagination: Four Essays*. (transl.) Emerson, C.; Holquist, M. Austin, Texas: University of Texas Press, 259–422; fq. 279-280.
Bakhtin, M. (1984) *Problems of Dostoevsky's Poetics,* Emerson, C. (trans. and ed.), University of Minnesota Press, Minneapolis MN.
Balci, A. (2005) *A Comparative Analysis on Pun Translation in Alice in Wonderland by Lewis Carroll.* Tezë e pabotuar masteri, Dokuz Eylül Üniversitesi.
Bamberger, R. (1978) *The influence of translation on the development of national children's literature* në *Children's Books in Translation.* (ed.s Klingberg, G.; Ørvig, M.) Stockholm: Almqvist and Wiksell.
Barthes, R. (1975) *S/Z. Essays*. Lund: Berlinska boktryckeriet.
Barthes, R. (1977) *Image, Music, Text.* Heath, S. (trans.) Fontana, London.
Bassnett, S. (1980) *Translation Studies.* London: Methuen.
Bassnett, S. (1993) *Comparative Literature: A Critical Introduction*. Oxford: Blackwell.
Bassnett, S. [1980] 1994 *Translation Studies.* London and New York: Routledge.
Bassnett, S. (2002) *Translation Studies*. London: Routledge.
Bastin, G. (1997) *Encyclopaedia of Translation Studies.* London: Routledge.
Beahm, G. (2007) *Jästit ja taikuus: Harry Potterin ja J. K. Rowlingin tarina*. Helsinki: readme.fi.
Becker, J. (1978) *The Internationalism of Children's Books: Translations and their Ideological Deformations in the Federal Republic of Germany.* në Klingberg, G.; Ørvig, M.; Amor, S. *(ed.s) Children's Books in Translation. The Situation and The Problems.* Stockholm, Almqvist&Wiksell International.
Bell, A. (1985) *Translator's Notebook: The Naming of Names.* Në *Signal 46/1985*.
Bell, R. T. (1991) *Translation and Translating: Theory and Practice*. London: Longman.
Benjamin, W. (1992) *Illuminations.* (tr. Harry Zohn) London, Fontana Press.

Ben-Porat, Z. (1976) *The Poetics of Literary Allusion*. Në *A Journal for Descriptive Poetics and Theory of Literature* 1, 105–128.
Bertills, Y. (2003) *Beyond Identification: Proper Names in Children's Literature*. Åbo Akademi University Press.
Bishqemi, A. (2006) *Histori e Letërsisë Botërore për Fëmijë.* Sejko, Tiranë.
Bota Sot. Ta duam dhe ta kultivojmë gjuhën shqipe. Intervistë nga Miranda Haxhia. 09.01.2011.
Botimet Shqiptare, 16.09. 2010.
Bravo-Villasante, C. (1978) *Translation Problems in my Experience as a Translator* në *Children's Books in Translation.* (ed.s G. Klingberg; M. Ørvig) Stockholm: Almqvist and Wiksell International.
Briggs, J. (1989) *Reading Children's Books. Essays in Criticism. XXVIX (1).*
Brown, H. (1996) *The Institution of the English Novel: Defoe's Contribution. NOVEL: A Forum on Fiction*.
Brownlie, S. (2003) *Investigating Explanations of Translational Phenomena. A Case for Multiple Causality*. Në *Target* 15:1, fq. 111–152.
Bush, P. (1997) (përkth.) Juan Goytisolo *Quarantine*. London: Quartet Books.
Bussewitz, W. (1978) *The Role of Soviet Children's literature in the GDR*. Në *Children's Books in Translation*. (ed.s Klingberg, G.; Ørvig, M.) Stockholm: Almqvist and Wiksell: 51-59.
Carus, M. (1980) *Translation and Internationalism in Children's Literature.* Në *Children's Literature in Education. Vol.11/No.4*.
Catford, J. C. (1965) *A Linguistic Theory of Translation: An Essay in Applied Linguistics.* Oxford: Oxford University Press.
Çeliku, M. et. al. (2002) *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*, Shtypshkronja Maluka, Tiranë.
Chatman, S. (1978) *Story and Discourse. Narrative Structure in Fiction and Film.* Ithaca and London: Cornell University Press.
Chepmell, H. (1862) *Short Course of History*. Lond, United Kingdom.
Chesterman, A. (1989) *Readings in Translation Theory.* Helsinki, Finn Lectura.
Chesterman, A. (1998) *Causes, Translations, Effects*. Në *Target* 10:2, fq. 201–230.
Conte, G. B. (1986) *The Rhetoric of Imitation: Genre and Poetic Memory in Virgil and Other Latin Poets.* Ithaca: Cornell University Press.
Crystal, D. (1997) *The Cambridge Encyclopedia of Language.* (2nd ed.) Cambridge: Cambridge University Press.
Cuddon, J. A. (1979) *A Dictionary of Literary Terms.* London: Deutsch.
Culler, J. (1975) [1994]. *Structuralist Poetics. Structuralism, Linguistics and the Study of Literature*. London: Routledge.
Davies, M. G.; Oittinen, R. (ed.s) (2008*) Whose Story? Translating the Verbal and the Visual in Literature for Young Readers.* Cambridge Scholars Publishing, Newcastle, UK.
Defoe, D. (1994) *Robinson Crusoe – An Authoritative Text - Contexts – Criticism*. (Ed.) Shinagel, Michael. New York: W.W. Norton & Company.
Delabastita, D. (1993) *There's a Double Tongue. An Investigation into the Translation of Shakespeare's Wordplay with Special Reference to Hamlet.* Amsterdam and Atlanta: Rodopi.
Delabastita, D. (1996) *Wordplay and Translation.* Special Issue of *The Translator: Studies in Intercultural Communication,* 2(2). Manchester: St. Jerome.
Delabastita, D. (1997) *Traductio, Essays on punning and Translation*. St. Jerome Publishing: Manchester.
Deslie, J. et. al. (1999) (ed.s) *Translation Terminology*. Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.

Docherty, T. (1983) *Reading (Absent) Character. Towards a Theory of Characterization in Fiction.* Oxford: Clarendon.
Ellis, R. & Oakley-Brown, L. (ed.) (2001) *Translation and Nation: Towards a Cultural Politics of Englishness.* Multilingual Matters, Clevedon.
Even-Zohar, I. (1978) *Papers in Historical Poetics.* Tel Aviv: Porter Institute for Poetics and Semiotics.
Ewers, H. H. et. al. (ed.s) (1994) *Kinderliteratur im interkulturellen Prozess: Studien zur Allgemeinen und Vergleichenden Kinderliteratur-Wissenschaft.* J. B. Metzler.
Florin, S. (1993) *Realia in Translation.* Në Zlateva, P. (ed) *Translation as Social Action. Russian and Bulgarian Perspectives*. London-New York.
Flugge, K. (1994) *Crossing the Divide* në *The Bookseller*.
Fox, C. et. al. (ed.s) (2003) *Longman Dictionary of Contemporary English*. Pearson Education Limited.
Fries, C. C. (1945) *Teaching and learning English as a foreign language*. Ann Arbor:
Gambier, Y. (2001) *Traduire le sous-texte*. Në Kronning, H. et al. (eds.), 223–235;
Gardner, M. (2000) *The Annotated Alice – the definitive edition.* W. W. Norton & Company: New York, USA.
Genette, G. (1997) *Paratexts – Thresholds of interpretation*. (tr.) Lewin, J. E. Cambridge: Cambridge University Press.
Gentzler, E. (2001) *Contemporary Translation Theories*. 2nd ed. Clevedon: Multilingual Matters.
Green, L. R. (1960) *Lewis Carroll*. London: Bodley Head.
Green, L. R. (1969) *The Golden Age of Children's Books*. Egoff et al.
Hadaj, G. (1984) *Nëntori VIII, Shkolla dhe arti "Vërtetësia artistike e origjinalit në përkthim nëpërmjet karakterizimit gjuhësor"*.
Haranth, W. (1984) *Übersetzungen und Bearbeitungen.* në Binder, L. (ed.) *Illustrieren, Bearbeiten, Übersetzen. Arbeit an und mit Texten.* Wien: Internationales Institut für Jugendliteratur und Leseforschung.
Harranth, W. (1996) *... und nun das Ganze.* Në *TAUSEND und EIN BUCH 1996/No.5*; (1997) *Good Morning, how are you?* Në *Forum Schule Heute 1997/Heft 4*.
Hartama-Heinonen, R. (1995) "*Translators' Prefaces—A Key to the Translation*?" Në *Folia Translatologica* 4.
Hatim, B., Mason I. (1990). *Discourse and the translator*. London: Longman.
Hatim, B.; Munday J. (2004) *Translation: An Advanced Resource Book*. Routledge, London and New York.
Heller, L. G. (1974) *Toward a General Typology of the Pun* në *Language and Style* 7, 271-282.
Hermans, T. (ed.) (1985) *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation.* London and Sydney: Croom Helm.
Hermans, T. (1988) *On Translating Proper Names with reference to De Witte and Max Havelaar"* Në *Modern Dutch Studies: Essays in Honour of Peter King* edited by Michael Wintle and Paul Vincent, fq. 11-24. London and Atlantic Highlands, NJ: Atlone.
Hervey, S.; Higgins, I. (1992*) Thinking Translation: A Course in Translation Method: French to English.* London and New York: Routledge.
Hönig, H. G. (1998) *Positions, Power and Practice: Functionalist Approaches and Translation Quality Assessment.* Në Schäffner, C. (ed.) (1998). *Translation and Quality*. Clevedon etc: Multilingual Matters.
Huck, C. S. (1987) *Children's Literature in the Elementary School*. Orlando: Saunders College Publishing.
Hunt, P. (1991) *Criticism, Theory and Children's Literature.* Oxford: Blackwell.

Hunt, P. (1992) *Literature for Children: Contemporary Criticism.* London, Routlege.
Hunt, P. (2001) *Children's Literature*. Malden, Mass.: Blackwell Publishers.
Irwin, W. (2001) *What is an Allusion.* Në *The Journal of Aesthetics and Art Criticism* 59.3, fq. 287-297; (2002) *The Aesthetics of Allusion.* Në *The Journal of Value Inquiry 36*, fq. 521–532.
Ivir, V. (1987) *Procedures and strategies for the translation of culture*. Në Toury, G. (1987) *Translation across Cultures.* Bahri Publications, New Delhi.
Jentsch, N. K. (2002) *Harry Potter and the Tower of Babel. Translating the Magic*. Në Whited, L. A. (ed.) (2002) *Ivory Tower and Harry Potter: Perspectives on a Literary Phenomenon*. Columbia: University of Missouri Press, fq. 285–301.
Jung, C. (1996) *Tea-time oder Kaffee und Kuchen?*në *Bulletin Jugend und Literatur 2*.
Karl, J. (1970) *From Childhood to Childhood: Children's Books and Their Creators*. New York: The John Day Company.
Kaskenviita, R. (1991) *Alluusiot Asterix-sarjan kulttuurisidonnaisena käännösongelmana. 'Allusions as a culture-bound translation problem in the Asterix series*. Sananjalka 33, 77–92.
Klingberg, G. (1978) *Children's Books in Translation.* Stockholm: Almqvist and Wiksell.
Klingberg, G. (1986) *Children's Fiction in the Hands of the Translators.* Lund: Liber/ CWK Gleerup.
Klingberg, G. (2008) *Facets of Children's Literature Research: Collected and reused writings*. The Swedish Institute for Children‟s Books, no 99.
Klungervik Greenall A. J. (2006) *Translation as dialogue.* Në Duarte, J. F.; Rosa, A.A.; Seruya, T. (ed.s) *Translation Studies at the Interface of Disciplines.* Benjamins Translation Library, 67-81.
Knowles, M.; Malmkjær, K. (1996) *Language and Control in Children's Literature.* London: Routledge.
Kőnig, E. (1971) Adjectival constructions in English and German. Heidelberg: Groos.
Rohdenburg, G. (1974) *Sekundäre Subjektivierungen im Englischen und Deutschen. Vergleichende Untersuchungen zur Verb- und Adjektivsyntax*. Bielefeld: Cornelsen-Velhaben & Klasing.
König, E. (1996) *Kontrastive Grammatik und Typologie.* Në *Lang, E. and G. Zifonun (eds.), Deutsch – typologisch, 31-54*. Berlin/New York: Mouton de Gruyter.
Kortmann, B. & Meyer, P. (1992) *Is English grammar more explicit than German grammar, after all?* Në Mair, C.; Manfred, M. (eds.), *New departures in contrastive linguistics. Proceedings of the conference held at the Leopold-Franzens-University of Innsbruck, Austria*, 10–12 May 1991, 155-166. Innsbruck.
Kristeva, J. (1969) *Séméiôtiké: Recherches pour une Sémanalyse.* Paris: Edition du Seuil. Përkthyer në anglisht (1980) *Desire in Language: A Semiotic Approach to Literature and Art.* Columbia University Press.
Kurultay, T. (1994) *Probleme und Strategien bei der Kinderliterarischen Übersetzung im Rahmen der Interkulturellen Kommunikation.* në Ewers, H.; O'Sullivan, E. (ed.s) *Kinderlitertatur im Interkulturellen Proseβ* Stuttgart, Weimar: Metzler.
Kwieciński, P. (2001) *Disturbing Strangeness. Foreignisation and Domestication in Translation Procedures in the Context of Cultural Assymetry*. Toruń: Wydawnictwo EDYTOR.
Lado, R. (1957) *Linguistics across cultures: Applied linguistics for language teachers*. Ann Arbor: University of Michigan Press.
Landers, C. E. (2001) *Literary Translation: A Practical Guide. Great Britain.* Cromwell Press Ltd.

Lassén-Seger, M. (2006) *Adventures into Otherness: Child Metamorphs in Late Twentieth-Century Children's Literature.* Åbo : Åbo Akademi University Press.
Lathey, G. (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader.* Clevedon: Multilingual Matters Ltd.
Laviosa, S. (2002) *Corpus-based Translation Studies: Theory, Findings, Applications*. Rodopi B. V., Amsterdam, New York.
Leech, G. N. (1969) *A Linguistic Guide to English Poetry.* London, Longman.
Leppihalme, R. (1994) *Culture Bumps. On the Translation of Allusions*. Helsinki: University of Helsinki.
Leppihalme, R. (1994) *Translating Allusions: When Minimal Change is not Enough*. Në *Target: International Journal of Translation Studies* 6 (2), fq. 177–193.
Leppihalme, R. (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters.
Leppihalme, R. (1997) *Culture Bumps: An Empirical Approach to the Translation of Allusions.* Clevedon: Multilingual Matters.
Lerer, S. (2008) *Children's Literature: A Reader's History, from Aesop to Harry Potter.* The University Chicago Press Ltd. London.
Levý, J. **(**2000) *The Translation Studies Reader. (*ed.*)* L. Venuti. London, RoutledgE.
Lindgren, A. (1969) *Traduire les Livres d'Enfants – est-ce possible?* në *Babel*.
Lloshi, Xh. (1982) *Analiza stilistike e gjuhës shqipe.* Në Viktor Ristani (2010) në *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë.
Lloshi, Xh. (2005) *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika.* Shtëpia Botuese e Librit Universitar: Albas.
Maier, C. (1995) *Toward a Theoretical Practice for Cross-Cultural Translation*. Në Dingwaney, A.; Maier, C. (eds) *Between Languages and Cultures: Translation and Cross-Cultural Texts.* Pittsburgh and London: University of Pittsburgh Press.
Mailhac, J. P. (1996) *The Formulation of Translation Strategies for Cultural References.* Në C. Hoffman (ed) *Language, Culture and Communication in Contemporary Europe*. Clevedon: Multilingual Matters.
Malmkjaer, K. (1996) *Language and Control in Children's Literature* , London: Routledge.
Manlove, C. (2003) *From Alice to Harry Potter: Children's Fantasy in England*. Christchurch, N.Z.: Cybereditions.
Newmark, P. (1981) *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon.
Newmark, P. (1983) *The Translation of Metaphor*. L.A.U.T.
Newmark, P. (1988) *A Textbook of Translation.* Prentice Hall Longman ELT.
Newmark, P. (1991) *About Translation*. Clevedon: Multilingual Matters.
Nida, E.; Taber, C. R. (1982) *The Theory and Practice of Translation*. Leiden. E. J. Brill.
Nikolajeva, M. *(*1996) *Children's Literature Comes of Age: Toward a New Aesthetic*. New York and London: Garland.
Nikolajeva, M. (1998) *The Magic Code. The use of magical patterns in fantasy for children*. Stockholm: Almqvist & Wiksell.
Nikolajeva, M. (2001) *The Changing Aesthetics of Character in Children's Fiction.* Në *Style*, Volume 35, Number 3, 430-453. Northern Illinois University.
Nikolajeva, M. (2002) *The Rethoric of Character in Children.s Literature*. USA: Scarecrow.
Nodelman, P. (1985) *Interpretation and Apparent Sameness of Children's Novels. Studies in the Literary Imagination 18.* .

Nodelman, P. (1992) [1996] *The Pleasures of Children.s Literature*. New York: Longman.
Nord, C. (1990) *Zitate und Anspielungen als pragmatisches Übersetzungsproblem*. *TEXTconTEXT* 5, fq. 1–30.
Nord, C. (1991) *Text Analysis in Translation.* Amsterdam, Rodopi.
Nord, C. (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explained*. Manchester: St. Jerome.
Nord, C. (2003) *Proper Names in Translations for Children: Alice in Wonderland as a Case in Point*. Meta: Journal des Traducteurs / Meta: Translators' Journal, vol. 48, n° 1-2, 182-196.
Nord, C. (2006) *Functional and Skopos Oriented Approaches to Translation*. Në Brown, Keith (ed.), *Encyclopedia of Language & Linguistics*. Elsevier: Oxford.
Norton, D. E. (1987) *Through the Eyes of a Child: An Introduction to Children's Literature.* Colombus: Merrill Publishing Company.
O'Connell, E. (1999) *Translating for children* në *Word, Text, Translation.* (ed.s Anderman, G.; Rogers, M.) Clevedon: Multilingual Matters.
O'Sullivan, E. (1993) *The fate of dual addressee in the translation of children's literature.* në *New Comparison 16*.
O'Sullivan, E. (1998) *Losses and gains in translation: Some remarks on the translation of humor in the books of Aidan Chambers (Anathea Bell, tr.).* Në Keyser, E. L. (ed.) *Children's Literature 26.* New Haven: Yale University Press.
O'Sullivan, E. (2006) *Narratology meets translation studies, or The voice of the translator in Children's Literature.* Në G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader.* Clevedon: Multilingual Matters.
O'Connell, E. (2006) *Translating for children*. Në G. Lathey (2006) *The Translation of Children's Literature. A Reader.* Clevedon: Multilingual Matters.
Oittinen, R. (1992) *Teaching translation of fiction - a dialogic point of view*. Në Dollerup, C.; Loddegaard, A. (eds.) *Teaching Translation and Interpreting: Training Talent and Experience. Papers from the First Language International Conference, Elsinore, Denmark.*
Oittinen, R. (1993) *On the Dialogics of Translating for Children*, në Picken, C. (ed.) *Translation: The Vital Link. XIII FIT World Congress.* London, Institute of Linguistics.
Oittinen, R. (1993) *I Am Me--I Am Other: On the Dialogics of Translating for Children*. Tampere, Finland: University of Tampere.
Oittinen, R. (1995) *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press.
Oittinen, R. (1995). *Kääntäjän karnevaali*. Tampere: Tampere University Press.
Oittinen, R. (2000) *Translating for Children.* New York: Garland. Publishing, Inc.
Oittinen, R. (2004) *Translating for children – theory.* Në Hunt, P. (ed.), *International Companion Encyclopedia of Children's Literature*. London: Routledge.
Oittinen, R. (2006) *No Innocent Act: On the Ethics of Translating for Children*. Në Van Coillie, J., Verschueren W. P. (eds.), *Children's Literature in Translation*. *Challenges and Strategies*. Manchester: St. Jerome.
Omari, D. (1985) *Rreth gjuhës së përkthimeve të letërsisë së huaj artistike.* Në *Studime Filologjike nr. 1,* fq. 178.
Pasco, A. H. (1994) *Allusion: A Literary Graft.* Toronto, Buffalo: University of Toronto Press.
Pedersen, J. (2007) *Scandinavian Subtitles: A Comparative Study of Subtitling Norms in Sweden and Denmark with a focus on Extralinguistic Cultural References.* Stockholm: Stockholm University.
Perri, C. (1978) *On Alluding*. Në *Poetics* 7, 289–307.

Plank, F. (1984) *Verbs and objects in semantic agreement: Minor differences between English and German that might suggest a major one.* Journal of Semantics 3: 305-60.
Pucci, J. (1998) *The Full-Knowing Reader: Allusion and the Power of the Reader in the Western Literary Tradition*. New Haven, Conn.: Yale University Press.
Puurtinen, T. (1994) *Dynamic Style as a Parameter of Acceptability in Translated Children's Books.* në Snell-Hornby, M. (1994) *Translation Studies: An Interdiscipline.* Amsterdam*:* John Benjamins.
Puurtinen, T. (1995) *Linguistic Acceptability in Translated Children's Literature.* Joensuu: University of Joensuu, në Fernandes, L. (2006) *Translation of Names in Children's Fantasy Literature: Bringing the Young Reader into Play*. *New Voices in Translation Studies 2*, 44-57.
Pym, A. (1998) *Method in Translation History.* Manchester: St. Jerome.
Reiss, K. (1971) *Mőglichkeiten und Grenzen der Übersetzungskritik.* München: Max Heuber. Reiss, K. (1982) *Zur Übersetzung von Kinder- und Jugendbüchern.* Lebende Sprachen 1.
Reiss, K. (1982) *Zur Übersetzung von Kinder-und Jugendbüchern.* Lebende Sprachen.
Reiss, K., Vermeer, H. J. (1984) *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Tübingen: Niemeyer. Në C. Nord (1997) *Translating as a Purposeful Activity. Functionalist Approaches Explain*ed. Manchester: St. Jerome
Rimmon-Kenan, S. (1983) *Narrative Fiction: Contemporary Poetics*. London and New York: Methuen.
Ristani, V. (2010) *Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë Viteve '90.* Shtëpi Botuese-Shtypshkronjë Miryeeralb: Tiranë.
Robinson, D. (1991) *The Translator's Turn.* The John Hopkins University Press.
Rudd, D. (1999) *Defining the Indefinable: Children's Literature's Problematic Status*. Punim i pabotuar nga konferenca e nëntë BALCL, Bolton Institute, cituar në Lassén-Seger, M. (2006): *Adventures into Othernes: Child Metamorphs in late twentieth-century children's literature.* Åbo: Åbo Akademi University Press.
Rudd, D. (2000) *Enid Blyton and the Mystery of Children's Literature*. Wiltshire: Macmillan.
Rudvin, M.; Orlati F. (2006). *Dual Readership and Hidden Subtexts in Children"s Literature: The Case of Salman Rushdie"s Haroun and the Sea of Stories.* Në Van Coillie, J.; Walter W. P. (eds.), *Children's Literature in Translation. Challenges and Strategies*, Manchester: St. Jerome Publishing, fq. 157-184.
Ruokonen, M. (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: Tommola, J. (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto.
Ruokonen, M. (2010) *Cultural and textual properties in the translation and interpretation of allusions.* (punim dizertacioni) Painosalama Oy – Turku, Finland.
Rutschmann, V. (1996) *Kinderliterarisches Übersetzen und Interkultureller Austausch* në *Zum Übersetzung von Kinder- und Jugendliteratur* CTL Lausanne No 27/1996
Schleirmacher, F. (1838) *Hermeneutik und Kritik.* Në Ruokonen, M. (2004) *Schleiermacher, Berman ja Venuti: kolme käännösteoreettista näkökulmaa vieraannuttamiseen.* Në: Tommola, J. (ed.), *Kieli, teksti ja kääntäminen = Language, text and translation*. Turku: Turun yliopisto.
Schultze, B. (1991) *Problems of Cultural Transfer and Cultural Identity: Personal Names and Titles in Drama Translation.* Në Kittley, A. dhe Frank, A. P. (ed.s) Gőttingen: Eric Schmidt Verlag, 91-100; cituar në Vermes, A. P. (2001) *Proper Names in Translation: a relevance-theoretic analysis.* University of Debrecen, Hungari.

Seixas, P. *A Bush is not a Shrub.* Në Carvalho, P. E.; Homem, R. C. (ed.s) (2008) *Plural Beckett Pluriel. Centenary Essays/Essais D'Un Centenaire*. Faculdade de Letras da Universidade Do Porto, Porto, Portugal.
Shavit, Z. (1981) *Translation of Children's Literature and its Position in the Literary Polysystem.* Në *Poetics Today* 1981/Vol.2/Part 4.
Shavit, Z. (1986) *Poetics of Children's Literature.* Athens, University of Georgia Press.
Sherzer, J. (1978) *Oh, That's a Pun and I Didn't Mean It'* në *Semiotica* 22, 3-4. 335-350.
Shkurtaj, Gj. (2008) *Si të Shkruajmë Shqip.* Botimet Toena: Tiranë.
Snell-Hornby, M. (1988) *Translation Studies: An Integrated Approach*. Amsterdam: John Benjamins.
Snell-Hornby, M. (2006) *The Turns of Translation Studies: New Paradigms or Shifting Viewpoints.* John Benjamins B. V., Philadelphia, USA.
Soulier, A. (1998) *Traduire entres les Lignes, ou, les aventures du non-dit dans la traduction du texte humoristique*. Në *Ateliers 15: Traduire L'Humour, Cahiers de la Maison de la Recherche*. Université Charles-de-Gaulle, Lille III. 11-18.
Stolt, B. (2006) *How Emil Becomes Michel: On the Translation of Children Books.* në Lathey, G. (ed.) (2006) *The Translation of Children's Literature: A Reader.* Clevedon, Buffalo, Toronto: Multilingual Matters.
Stolze, R. (2003) *Translating for Children – World View or Pedagogics?* Në *Meta*, 48 (1-2), fq. 208-221.
Thomson-Wohlgemuth, G. (1998) *Children's literature and its translation: An overview*. Temë dizertacioni. University of Surrey.
Toury, G. (1980) *In Search of a Theory of Translation.* Tel Aviv: The Porter Institute for Poetics and Semiotics, Tel Aviv University.
Toury, G. (1995) *Descriptive Translation Studies and Beyond.* Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.
Tupja, E. (2003) *Pro Translatore – Shënime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin.* Shtëpia e Librit OMBRA GVG: Tiranë.
Tupja, E. *Këshilla një Pëkthyesi të Ri.* Onufri, Tiranë.
Tymoczko, M. (1999) *Translation in a Postcolonial Context: Early Irish Literature in English Translation.* Manchester, UK: St. Jerome Publishing.
Tynjanov, J.; Jakobson, R. [1929] 1971. *Problems in the Study of Literature and Language.* Matejka and Pomorska.
University of Michigan Press.
Venuti, L. (1991) *Genealogies of Translation Theory: Schleiermacher*. TTR 4:2.
Venuti, L. (1995) *The Translator's Invisibility: A History of Translation*. London and New York: Routledge.
Venuti, L. (ed.) (2000) *The Translation Studies Reader*. London and New York: Routledge.
Vermeer, H. (1994) *Translation Today: Old and New Problems* në Snell-Hornby, M. (1994) *Translation Studies. An Interdiscipline.* Amsterdam, John Benjamins.
Vinay, J. P. and J. Darbelnet (1958/1995) *Stylistique comparée du français et de l'anglais. Méthode de traduction*, Paris: Didier, trans. and ed. Sager, J. C.; Hamel, M. J. (1995) *Comparative Stylistics of French and English: A Methodology for Translation*, Amsterdam and Philadelphia: John Benjamins.
Von Stockar, D. (1996) *Kinderliterarische Übersetzungsprobleme* në *Zum Übersetzung von Kinder- und Jugendliteratur* CTL Lausanne No. 27/1996.
Wehmeir, S, et. al. (ed.s) (2010) *Oxford Advanced Learner's Dictionary.* Oxford University Press.

Weinreich, T. (1978) *International Book Production for Children Related to the Children's Local Experiences and Local Consciousness.* në G. Klingberg, M. Ørvig, S. Amor (ed.s) *Children's Books in Translation. The Situation and The Problems.* Stockholm, Almqvist&Wiksell International.
Weinreich, T. (2000) *Children's literature: Art or Pedagogy?* Roskilde University Press.
Weissbrod, R. (1996) *"Curiouser and Curiouser': Hebrew Translations of Wordplay in 'Alice's Adventures in Wonderland* në *Worplay and Translation".* St. Jerome Publishing, Manchester.
Yll Press – Amik Kasoruho, shkrimtari që "përktheu" jetën e tij, dt 15.06.2010.
Ymeri, E. (1989) *Nga mendimi kritik shqiptar për përkthimin.* në Ylli, 8 gusht 1989.
Zlateva, P. (1990) *Translation: Text and Pre-text 'Adequacy' and 'Acceptability' in Crosscultural Communication.* Në Bassnett, S.; Lefevre, A. *Translation, History and Culture*. (ed.) London and New York: Pinter Publishers.

Burime elektronike

behindthename.com 2010.
http://oxforddictionaries.com/definition/english/.
Lydon, C. *J.K. Rowling interview transcript*, The Connection (WBUR Radio), 12 tetor, 1999.
Office for National Statistics, http://www.ons.gov.uk/ons/rel/vsob1/baby-names--england-and-wales/2011/sb-baby-names-2011.html.

Fjalorë të përdorur

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1973) *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe.* Tiranë.
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (2002) *Fjalor i Shqipes së Sotme.* Botimet Toena, Tiranë.
Matthews, P. (1997) *The Concise Oxford Dictionary of Linguistics*. Oxford: Oxford University Press.
Quirk R., et. al. (2004) *A comprehensive grammar of the English language.* Longman.
Qesku, P. (2000) *Fjalori anglisht-shqip.* Botimet EDFA, Tiranë.

SHTOJCAT

Shtojca 1

Tabela nr. 13
Lojërat e fjalëve në variantet e përkthyera në gjuhën shqipe (1944-2008)

Loja e fjalëve në origjinal	***Varianti i parë*** *Hysejn Çela Beqir Çela* (1944)	***Varianti i dytë*** *Maqo Afezolli* (1961)	***Varianti i tretë*** *Maqo Afezolli* (1998)	***Varianti i katërt*** *Taulant dhe Eri Tafa* (2008)	***Varianti i pestë*** *Fredetik Shuraja* (2008)
How funny it'll seem to come out among the people that walk with their heads downward! The ***Antipathies****, I think--* (fq. 12)	Sa qejf ka për të qenë kùr të dal ke njerëzit që ecin me kokë teposhtë! Kokë-tatpjetët më thotë mendja do t'i quejnë....." (fq. 12)	Ç'gjë e habitshme do të jetë kur të shoh njerëzit të ecin me kokë poshtë! Antipathët besoj, (përnjëherësh u ndal, mbasi kjo fjalë nuk i tingëlloi mirë) jo, më duket se quhen Antipode*. (*shën. përkth. Ata që bnojnë n'anën tjetër të dheut) (fq. 6)	Ç'gjë e habitshme do të jetë kur të shoh njerëzit të ecin e kokë poshtë! Antipathët më duket... (fq. 12)	"Do të kënaqesha duke shëtitur krah banorëve që ecin kokë poshtë! Më duket se quhen Antipatë..." (fq. 8)	Sa argëtuese do të jetë të gjendesh mes njerëzve që ecin kokëposhtë! Antipati ... më duket, kështu quhen ata ... (fq. 12)
'Do cats eat bats? Do bats eat cats? (fq. 12)	A i hanë macat lakuriqat? A i hanë lakuriqat macat? (fq. 12)	A i hanë macet laskuriqet e natës? A i hanë laskuriqet macet? (fq. 7)	A i hanë macet lakuriqët e natës? A i hanë lakuriqët macet? (fq. 13)	A hanë macet lakuriqë nate? Po lakuriqët e natës a hanë mace? (fq. 9)	"Vallë i hanë macet lakuriqët e natës?" "Vallë i hanë minjtë macet lakuriqë?" (fq. 12-13)
...and the fall was over. (fq. 12)	Do me thanë se të ranët kishte marrë fund! (fq. 13)	Domethënë se zbritja kishte marrë fund. (fq. 7)	Domethënë se zbritja kishte marrë fund. (fq. 14)	Rënja kishte mbaruar. (fq. 10)	...dhe me këtë rënia e saj mbaroi. (fq. 13)
'Curiouser and curiouser!' cried Alice (she was so much	"Çudí edhe mâ!" (Liza deshi me thânë "Çudí e madhe!" Por, nga habija, at çast të-thuesh si kishte harrue me folë	"Çudi, çudi" – u ankua Liza. (Atë çast Liza desh të thosh "çudi e madhe", por	Çudi, çudi e madhe, - thirri Liza, - tani jam duke u rritur kaq shumë ... (fq.	" E çuditshme, shumë e çuditshme" thirri Liza (ishte aq e mrekulluar sa	"Sa çudi, ç'është kështu! – thirri Liza (nga habia ajo madje një

surprised, that for the moment she quite forgot how to speak good English) (fq. 14)	si duhet). (fq. 19)	nga habia kishte harruar të fliste si duhet). (fq. 11)	19)	atë çast harroi edhe rregullat gramatikore). (fq. 17)	çast harroi, si duhej të fliste saktë). (fq. 19)
'You ought to be ashamed of yourself,' said Alice, 'a great girl like you,' (she might well say this), 'to go on crying in this way! (fq. 14)	"Duhet të keshë turp nga vehtja!" tha Liza: "Nji vajz' e madhe si ti..." (këtê tashti mund t'a thoshte me të drejtë) " me qà kështu! (fq. 20)	"Të kesh turp nga vetja jote" – tha Liza. "Një vajzë e madhe si ti, (këtë, tashti, mund ta thoshte me të drejtë), të qajë kështu! (fq. 12)	- Të kesh turp nga vetja jote, – tha Liza. - Një vajzë e madhe si ti, (këtë, tani mund ta thoshte me të drejtë) të qajë kështu! (fq. 20)	"Të të vij turp nga vetja!" tha Liza. "Një vajzë e rritur si ti" (tani kishte plotësisht të drejtë të thoshte kështu) "nuk duhet të qaj në këtë mënyrë! (fq. 18)	"Si nuk të vjen turp! – tha Liza, - një vajzë kaq e madhe (këtu ajo, sigurisht, kishte të drejtë) dhe qan! (fq. 21)
I shall be punished for it now, I suppose, by being drowned in my own tears! (fq. 16)	...dhe si dënim tashti duket se po mbytem në lotët e mij! (fq. 24)	... dhe si dënim po mbutem në lotët e mij! (fq. 15)	...dhe si dënim po mbytem në lotët e mi! (fq. 24)	"Do të ishte e tmerrshme që të mbytesha në lotët e mia! (fq. 23)	Tani ndoshta jam e dënuar të mbytem në lotët e mi! (fq. 25)
This is the driest thing I know. (fq. 17)	Kam me ju terë shpejt. (fq. 28)	Do t'ju thaj shpejt! (fq. 19)	Do t'ju thaj shpejt! (fq. 29)	... do ta gjej unë mënyrën si të thaheni!" (fq. 30)	Kjo është gjëja më e thatë që njoh. (fq. 31)
*'Mine is a long and a sad **tale**!' said the Mouse, turning to Alice, and sighing. 'It IS a long **tail**, certainly,' said Alice, looking down with wonder at the Mouse's **tail**; 'but why do you call it sad?'* (fq. 18)	"Historija e ime âsht e idhët dhe e gjatë" tha Miu, tue fshâ. "Vërtetë do të jetë e gjatë" tha Liza, tue i hudh nji sy bishtit të tij, "por pse e quen t'idhët?". (fq. 33)	"Historia ime është e gjatë dhe e hidhur" – u përgjegj Miu me një zë si për të ardhur keq. "Sigurisht është e gjatë" – tha Liza duke shikuar me habi bishtin e tij, - "por pse e quan të hidhur?" (fq. 22)	- Historia ime është e gjatë edhe e hidhur, – u përgjigj Miu, u kthye nga Liza dhe psherëtiu thellë. "Sigurisht është i gjatë, – tha Liza me vete duke shikuar me habi bishtin e tij - * por pse e quan të hidhur?" (* shën. përkth. Tale (histori) dhe tail (bisht), të dyja anglisht shqiptohen *teil*. Liza e ngatërron të	"Historia ime nuk është nga ato pa fillim dhe pa mbarim; ajo është edhe e gjatë edhe e trishtueshme" u drejtua Miu nga me një frymëmarrje të rëndë. - "E di që trimëria jote është e gjatë" tha Liza, e cila nuk e kishte dëgjuar mirë atë që kishte thënë miu. "Po si mund të jetë edhe e trishtueshme?" (fq. 35)	- Tregimi im titullohet "për bishtin". Ai është i gjatë dhe i trishtuar. Miu u kthye nga Liza dhe u mbush thellë me frymë. "Për bishtin? Ai vërtet është i gjatë, - mendoi Liza, duke vështruar bishtin e Miut. – Megjithatë, çfarë ka tek ai të trishtuar?" (fq. 35)

			parën me të dytën.) (fq. 34-35)		
'I beg your pardon,' said Alice very humbly: 'you ***had got to the fifth bend****, I think?'*(fq. 19)	"Të kërkoj ndjesë! ia priti Liza, përvujtnisht. "Kujtoj se kishe mërrijtë ke lidhja e pestë". (fq. 34)	"Më fal – ja priti Liza. "Kujtova se kishe arritur te lidhja e pestë". (fq. 23)	- Më fal, – ia priti Liza. Kishe arritur te kthesa e pestë. (fq. 36)	"Të kërkoj ndjesë" u përgjigj Liza me përulësi. "Isha hutuar pak". (fq. 36)	- Më falni, ju lutem, - foli me zë lutës Liza. – Ju, më duket, arritët deri te pika e pestë? (fq. 37)
'I had ***NOT****!' cried the Mouse, sharply and very angrily. 'A* ***knot****!' said Alice, always ready to make herself useful, and looking anxiously about her. 'Oh, do let me help to undo it!' "I shall do nothing of the sort," said the Mouse.* (fq. 19)	"Ç'lidhje, moj?', pyeti Miu, shumë i zemëruem. "Oh, po ny!...'vijoi Liza, përherë gati me qenë e vjefshme; dhe, tue vështrue për-qark si e hutueme: "Oh më lejoni të ju ndihmoj për me e zgjidhë!" "Ç'po merremi vesht se!..." tha Miu. (fq. 34-35)	"Ç'lidhje moj?" – pyeti Miu shumë i zemëruar. "Oh, po, nyje ... –vazhdoi Liza duke u munduar të jetë gjithënjë e vlefshme; dhe duke vështruar rreth e përqark si e hutuar: "Oh, më lejoni t'u ndihmoj për ta zgjidhur!" "S'do ta bëj kurrë atë" – tha Miu. (fq. 23)	- Ç'kthesë moj? – pyeti Miu shumë i zemëruar. - Ti më fyen vazhdimisht me ato marrëzi që flet! (fq. 37)	"Paske një nyje?" tha Liza. Asaj i dukej se bishti i Miut ishte lidhur nyje dhe dëshironte ta ndihmonte. "Të ndihmoj ta zgjidhësh!" "Nuk do ta pranoja kurrë një ndihmë të tillë!" – tha Miu. (fq. 37)	- Kjo ishte pikëlidhja? – klithi i tërbuar Miu. - Bohçja u lidh! – e kuptoi Liza, dhe derisa ajo gjithmonë ishte e gatshme të ndihmonte, në çast propozoi: - Më lejoni, unë do ta ndihmoj atë ta zgjidhë! - Nuk kam ndër mend të bëj asgjë të tillë! (fq. 37)
'What do you mean by that?' said the Caterpillar sternly. ***'Explain yourself!'*** *'I can't* ***explain MYSELF****, I'm afraid, sir' said Alice,*	"Ç'do të thuesh me atê?" pyeti Krymbi, egërsisht. "Spjegoje vehten!" "S'mundem ta spjegoj *vehten*", përgjegji Liza, "pse kam frigë, Zotni, që nuk jam mâ *unë vetë*. E shef?" "S'shof gjâ", tha ", tha Krymbi. (fq. 49)	"Ç'do të thuash me këtë?" – pyeti Krimbi si me të egër "trego se kush je!" "S'mund të tregoj se kush jam, zotëri" – u përgjegj Liza, - "sepse kam frikë se nuk jan *unë Liza*. E	- Ç'do të thuash me këtë? – pyeti Vemja si me të egër. – Trego se kush je! - S'mund të tregoj se kush jam, zonjë, - u përgjigj Liza, - sepse kam frikë se nuk jam unë. E	"Çfarë kërkon të thuash?" e pyeti Vemja me një pamje të ashpër. "Fol më qartë!" "Më vjen keq, por me të vërtetë nuk mund të shpjegohem", tha Liza "sepse unë nuk jam më unë; më	- Çfarë ke parasysh? – pyeti rreptë Vemja. – Shpjegohu! - Kam frikë se nuk mundem *ta shpjegoj veten*, - tha Liza, e cila e kuptoi fjalën "shpjegohu" pikërisht

'because I'm not myself, ***you see****.'* *'**I don't see**,' said the Caterpillar.* (fq. 24)		shikoni?" "Nuk shoh gjë" tha Krimbi. (fq. 47)	kuptoni? - Nuk kuptoj gjë, - tha Vemja. (fq. 51)	kuptoni?" "Jo" ia bëri Vemja. (fq. 55)	kështu, - sepse e shikoni ju, unë nuk jam unë. - Nuk e shikoj, - ia preu Vemja. (fq. 52)
You see the earth takes twenty-four hours to turn round on its ***axis****—' 'Talking of* ***axes****,' said the Duchess, 'chop off her head!'* (fq. 29)	E dini se toka don 24 orë me u rrotullue rreth boshtit të vet...." "Mbassi po na flet për *boshte*", bërtiti Dukesha, "shpojani kryet!" (fq. 65)	... E di që toka do njëzetekatër orë për t'u vërtitur rreth boshtit të saj." "Mbasi po na flet për boshte" – thirri Dukesha – "shpojani kokën!" (fq. 60)	... E di që toka do njëzet e katër orë për t'u vërtitur rreth boshtit të saj... - Pasi po na flet për boshte, - thirri Dukesha, - këputjani kokën! (fq. 68)	Në të vërtetë tokës i duhen plotësisht njëze e katër orë për t'u rrotulluar rreth boshtit të saj. Kjo është e përcaktuar si me sopatë". "Meqë ra fjala për sopata" e ndërpreu Dukesha që nuk e kishte dëgjuar mirë se çfarë ishte thënë, "Pritjani kokën!" (fq. 73-74)	E shikoni, toka rrotullohet rreth boshtit të vet gjatë njëzet e katër orëve, kështu që njëzet e katër orë më parë ishte mëngjes, kështu që ... (fq. 70)
Wouldn't it be a ***murder*** *to leave it behind?* (fq. 30)	A nuk âsht, pra, mëkat me e lanë këtu? (fq. 67)	A nuk është pra, gjynah ta lësh këtu? (fq. 62)	A nuk është, pra gjynah ta lësh këtu? (fq. 70)	"Mos do të ishte ndonjë mëkat po ta lija në atë shtëpi?" (fq. 76)	Vallë nuk është vrasje ta lësh atë këtu? (fq. 72)
'Did you say pig, or fig?' said the Cat. (fq. 32)	"A thé derr apo çerr?" e pyeti ajo Lizën. (fq. 71)	"A the *derr* apo *çerr*?" – e pyeti ajo vajzën. (fq. 65)	- A the derr, apo fik-*? – e pyeti ajo vajzën. (*shën. përkth. Anglisht pig (derr) dhe fig (fik) janë fjalë që ngatërrohen lehtë me njëra-tjetrën) (fq. 75)	"Nuk të dëgjova mirë, në u bë derrkuc apo hardhucë?" e pyeti Maçoku. (fq. 81)	- Ti më the u kthye në derrkuc apo në merluc? – pyeti maçoku. (fq. 76)

'Then you should ***say what you mean,*** *' the March Hare went on.* *'I do,' Alice hastily replied; 'at least--at least I* ***mean*** *what I* ***say****--that's the same thing, you know.'*	"Atëherë duhet të thuesh atê, që mendon me thânë", vërejti Lepuri i Marrë. "Po, po" përgjegji Liza me nxitim. "Të paktën – të paktën unë them atê që mendoj – që asht gjithë – njisoj, e din?"	"Atëhere duhet ta thuash atë që mendon" – vrejti Lepuri i marrë. "Po, po" – u përgjegj prap Liza me nxitim. "Të paktën – të paktën, unë them atë që mendoj – që është po ajo gjë, e dini?"	- Atëhere duhet ta thuash atë që mendon, – vërejti Lepuri i Marrë. - Po, po – u përgjigj prapë Liza me nxitim. - Të paktën – të paktën, unë mendoj atë që them– që është po ajo gjë.	"Atëherë thuaje menjëherë atë që ti mendon" vazhdoi Lepuri. "E them," u përgjigj me shpejtësi Liza. "Por në fund të fundit, ajo që unë mendoj ... është e njëjtë me atë që mendoni ju".	- Në një rast të tillë ti duhet të thoshe atë çfarë kishe parasysh, - vazhdoi Lepuri i Marsit. - Unë ashtu po bëj, - u përgjigj nxitimthi Liza, - në fund të fundit, unë kam parasysh atë çfarë them dhe kjo është e njëjta gjë. (fq. 80)
'I see what I eat' 'I eat what I see' 'I like what I get' 'I get what I like' 'I breathe when I sleep' 'I sleep when	*...unë shof çdogjâ që hà - unë ha çdogja që shof"!* *...unë pëlqej çdo send që marr -unë marr çdo send që pëlqej."*	*...unë shoh ç'do gjë që ha*	...unë shoh çdo jë që ha ... ha çdo gjë që shoh! ...unë pëlqej		

I breathe' (fq. 33)	*...unë marr frymë kur fleje - unë flejë kur marr frymë!"* (fq. 75)	*... ha çdo gjë që shoh!" ...unë pëlqej çdo gjë që marr...unë marr çdo gjë që pëlqej!" ...unë marr frymë kur flë... flë kur marr frymë.* (fq. 84)	çdo gjë që marr...unë marr çdo gjë që pëlqej!" ...unë marr frymë kur fle... fle kur marr frymë. (fq. 79)	Unë shoh atë që ha...Unë ha atë që shoh Unë pëlqej atë që marr ... unë marr atë që më pëlqen... Unë marr frymë kur fle ... unë fle kur marr frymë... (fq. 85)	"Unë shikoj atë që ha" "Unë ha atë që shikoj". "Unë pëlqej atë që marr" "Unë marr atë që pëlqej" "Unë marr frymë kur fle" "Unë fle kur marr frymë" (fq. 80)
'If you knew Time as well as I do,' said the Hatter, 'you wouldn't talk about wasting ***IT****. It's* ***HIM****.'... I know I have to* ***beat time*** *when I learn music.' 'Ah! that accounts for it,' said the Hatter. '****He won't stand beating****.'* (fq. 33)	"Po t'a njifshe Kohën aq mirë sa unë", tha Ksul-bamësi, "nuk kishe me folë ashtu për të humbunit e sajë". "Nuk dij se çka don të thuesh", foli Liza. ... Vetëm dije se, kur nxâjë muzikë, më duhet me e rrafë kohën!" "Ahaaa! Tashti spjegohet puna!" tha Ksul-bamësi: "*Koha nuk duron të rrafun*! (fq. 77)	"Nëqoftë se do ta njihje Kohën kështu si unë, s'do të flisje në këtë mënyrë për humbjen e saj" – shpjegoi Kapelebërësi. "Nuk të kuptoj ç'do të thuash" – tha Liza. ...Vetëm mund të them se kur të mësoj muzikë, do ta rrah kohën." "Ahaaa! tashti shpjegohet puna" – tha Kapelebërësi. "Por Koha nuk duron të rrahur. (fq. 85-86)	- Nëqoftë se do ta njihje Kohën ashtu si e njoh unë, s'do të flitje në këtë mënyrë për humbjen e saj, – shpjegoi Kapelebërësi. - Nuk të kuptoj ç'do të thuash – tha Liza. ...Vetëm mund të them se, kur mësoj muzikë, më duhet të rrah kohën. - Ahaaa! Tashti shpjegohet puna, – tha Kapelebërësi. Por Koha nuk duron ta rrahësh. (fq. 81-82)	"Nëse ti do ta njihje Kohën si e njoh unë," ndërhyri Kapelebërësi "nuk do të flisje për humbjen e SAJ. ËSHTË AJO që është kështu". "Nuk të kuptoj" tha Liza. ... Por e di se kur studioj muzikë luaj kohën". "Tani të kuptoj!" tha Kapelebërësi. "Por a e di, të paktën, se ajo nuk do që të luhet? (fq. 88)	- Në qoftë se ti do ta njihje kaq mirë Kohën, sa unë, - tha Kapelebërësi, - ti nuk do t'i drejtoheshe me "ajo". Koha thuhet "ai"* (*Është fjala për shprehjen angleze "Plaku Kohë") - Nuk e kuptoj se çfarë keni parasysh, - tha Liza. ... ... Kam kaluar jo pak kohë me mësime. - Atëherë, çdo gjë është e qartë, - tha Kapelebërësi. – Plaku Kohë nuk duron dot kur atë

					përpiqen ta *kalojnë*. (fq. 83)
*…they were learning to **draw**, you know— 'What did they **draw**?' said Alice, quite forgetting her promise. 'Treacle,' said the Dormouse, without considering at all this time.* (fq. 34)	...këto tri motra voglushe...patën fillue *me nxjerrë* (me vizatue, a e din?)" "E çka nxierrshin?" pyeti Liza, tue e harrue premtimin. "Pekmez!" tha Miu-gjumash, pa ia vû re ndërhyemjen kësaj here. (fq. 81)	"këto tri motra vogëlushe... kishin filluar *të nxjerrin*, (të vizatojnë, e di?)". "Çfarë nxirrnin?" pyeti Liza duke e harruar premtimin. "Pekmez!" – tha Miu gjumash, pa vënë re ndërhyrjen kësj radhe. (fq. 89)	... këto tri motra vogëlushe ... kishin filluar të nxirrnin ... - Çfarë të nxirrnin? – pyeti Liza duke e harruar premtimin. - Karamel, - tha gjeri pa e vënë re ndërhyrjen kësaj radhe. (fq. 87)	"Këto tri motra ... mësuan të nxirrnin jashtë ..." "Çfarë?" tha Liza, që e kishte harruar premtimin për të mos e ndërprerë. "Mushtin" tha Gjeri pa ngurim. (fq. 93)	- Dhe tri motrat, ato, e kuptoni, mësonin të vizatonin dhe për këtë merrnin... - Merrnin frymëzimin? – pyeti Liza duke e harruar premtimin e vet për të mos e ndërpretë. - Shurupin, - përgjigj Gjumashja, këtë herë pa u menduar fare. (fq. 88)
*'But they were IN the **well**,' Alice said to the Dormouse, not choosing to notice this last remark. 'Of course they were', said the Dormouse; '--**well in**.'* (fq. 35)	'Por ato ishin mbrenda në pus!" i tha Liza Mîut-gjumash, pa dashtë me iu vû vesh fjalëve të fundit të Ksul-bamësit. "Sigurisht mbrenda ishin me të vërtetë", përgjegji Mîu-gjumash; dhe bilé mjaft fellë!" (fq. 82)	"Po ato ishin brënda në pus?" – pyeti edhe një herë Liza, pa ua vënë veshin fjalëve të fundit të Kapelebërësit. "Sigurisht brënda ishin" – u përgjegj Miu gjumash, - "dhe bile shumë thellë!" (fq. 89)	- Po ato ishin brenda në pus? – pyeti edhe një herë Liza, pa ua vënë veshin fjalëve të fundit të Kapelebërësit. - Sigurisht brenda ishin, – u përgjigj gjeri gjumash, - dhe bile shumë thellë! (fq. 88)	"Por ato ishin BRENDA në pus!" i tha Liza Gjërit duke u shtirur sikur nuk kishte dëgjuar të sharën e Kapelebërësit. "Sigurisht që ato ishin brenda në pus, dhe ndjeheshin shumë mirë" tha Gjeri. (fq. 94)	- Por ato jetonin në pus, *në fund*, - i tha Liza Gjumashes duke vendosur të mos i kushtonte vëmendje fjalëve të fundit. - Sigurisht, ato atje jetonin, - u përgjigj Gjumashja, - në pus dhe *jo sipër*. (fq. 89)
*…there's a large mustard-**mine** near here. And the moral of that is— 'The more there is of **mine**, the less there is of yours.'* (fq. 39)	---------- (fq. 98)	..."Këtu pranë është një kultra ime e madhe. Dhe morali i saj është: sa më shumë është e imja, aq më pak është jotja!". (fq. 103)	- Këtu pranë është miniera ime e madhe e sinapit. Dhe morali i kësaj është: sa më shumë është imja, aq më pak është jotja! (fq. 106)	"Këtu afër ka një minierë të madhe mostarde. Dhe morali është ky: "Sa më shumë ke për të patur ti, aq më pak kam për të patur unë"! (fq.113-114)	... këtu pranë është një minierë e madhe sinapi, atë e hapën me mina. Dhe këtej del morali: "Mua më shtohen, ty të pakësohen". (fq. 108)

*...either you or your head **must be off**...* (fq. 40)	Ja ti, ja kryet t'and, duhen zhdukun! (fq. 99)	Ja ti, ja koka jote duhen çdukur. (fq. 104)	Ja ti, ja koka jote duhen zhdukur. (fq. 108)	Njëra do të bëhet; ose ti ose koka jote, duhet të zhduket nga këtu në çast. (fq. 115)	... ose ti nuk do të qëndrosh më këtu, ose do të mbetesh pa kokë dhe madje shpejt... (fq. 110)
*...we went to **school** in the sea... ...we went to school every **day** `I'VE been to a **day-school**, too,' said Alice; `you needn't be so proud as all that.'* (fq. 41)	...na shkojshim në shkollë në dét... ...na e shkojshim *ditën* në shkollë. "Edhe unë kam qenë në nji *shkollë-dite*", ia priti Liza: "Prandaj ti s'duhet të mburresh aq tepër për këtë gjâ". (fq. 104)	...ne shkonim në shkollë në det... ...ne shkonim *ditën* në shkollë. "Edhe unë kam qënë në një shkollë dite" – ja priti Liza. – "Prandaj ti s'duhet të mburresh aq shumë për vete". (fq. 108)	...ne shkonim në shkollë në det... ... shkonim në shkollë çdo ditë. - Edhe unë kam qenë në një shkollë ditore, - ia priti Liza. – Prandaj s'ke pse mburresh kaq shumë. (fq. 113)	... na çuan në një kolegj në fund të detit. "Mësonim shumë dhe shkonim në shkollë çdo ditë..." "Edhe unë shkoj në shkollë çdo ditë" tha Liza. "Nuk duhet të mburresh shumë me këtë" (fq. 119-120)	... ne shkonim në shkollë në det ... ... bënim shkollë çdo ditë ... "Edhe unë çdo ditë bëj shkollë, - tha Liza, - nuk keni pse të krenoheni kaq shumë. (fq. 114)
*'That's the reason they're called **lessons**,' the Gryphon remarked: 'because they **lessen** from day to day.'* (fq. 42)	"Po prandej thirren '*mêhsime*' ato" tha Grifoni: "pse shkojnë tue u *mê*". (fq. 106)	"Prandaj quhen '*mêhsime*'ato" – tha Grifoni – "se shkojnë gjithënjë duke u mehur*!" (*shën. përkth. duke u pakësuar) (fq. 109)	- Prandaj quhen mësime ato, - tha Grifoni, - nga mehsime, se shkojnë gjithnjë duke u mehur! * (* shën. përkth. mehet-pakësohet) (fq. 116)	- Prandaj quhej shkollë!" theksoi Grifoni. "Në fakt nëse ti zëvendëson një "a" me "o", në vend të shkollës bëhet shkallë. Dhe prandaj çdo ditë shkallëzohet dhe hiqet një orë". (fq. 123)	- Prandaj dhe atë e quajnë orar, - sqaroi Grifoni, - sepse çdo ditë gjithnjë e më pak orë bënim. (fq. 117)

*'And what are they made of?' Alice asked in a tone of great curiosity. '**Soles and eels**, of course,' the Gryphon replied rather impatiently: 'any shrimp could have told you that.'* (fq. 43)	"Po prej ç'farë gjâje bâhen?" pyeti Liza, me shumë kureshtje. "Me *Shojza*, natyrisht", përgjegji Grifoni, të thuesh me pa-durim: "Kushdo kishte mujtë me t'a tregue këtê!" (fq. 111)	"Po nga se bëhen?" – pyeti Liza me shumë kureshtje. "Me *shojza*, natyrisht", u përgjegj Grifoni si me padurim. "Këtë mund të ta tregonte kushdo". (fq. 114)	- Po nga se bëhen? - pyeti Liza me shumë kureshtje. - Me shojza, natyrisht, - u përgjigj Grifoni si me padurim. Këtë mund të ta tregonte kushdo. (fq. 122-123)	... Dhe ti mendon se ke një hundë?" Liza, kryqëzoi sytë dhe u përpoq të shihte hundën e saj. Ishte e menduar dhe hezitoi një çast para se të pyeste: "Dhe çfarë është, të lutem, nëse nuk është një hundë?" "Shikoje mirë sepse nuk është një hundë; është një Troftë" shpjegoi me zë të padururar Grifoni. "Çdo Karkalec, ose Shtojëz, ose Ngjalë do ta dinte një gjë të tillë. (fq. 131)	- Po me se e pastrojnë atë? – pyeti e kureshtje të madhe Liza. - Siguristh, me gaforret që zvarriten, - përgjigj Grifoni tashmë me një farë nervozizmi. – Këtë ty mund ta thotë çdo kërmill. (fq. 123)
*'What are they doing?' Alice whispered to the Gryphon. 'They can't have anything to **put down** yet, before the trial's begun.' 'They're **putting down** their names,' the Gryphon whispered in reply, 'for fear they should forget them before the end of the trial.'* (fq. 45)	'Ç'bâjnë ata ashtu?" i pëshpëriti Liza Grifonit në vesh: "S'mund të kenë gjâ me shkrue përpara se të ketë fillue gjykimi". "Janë tue shkrue emnat e vet", përgjegji Grifoni, "nga friga se mos i harrojnë përpara mbarimit të gjykimit". (fq. 118)	"Ç'bëjnë ashtu?" – i pëshpëriti Liza, Grifonit në vesh. "Nuk mund të shkruash gjë para se të fillojë gjyqi". "Janë duke shkruar emërat e tyre" – u përgjegj Grifoni, që kishte zënë vend edhe ai përkrah saj. – Dhe këtë e bëjnë nga frika se mos i harrojnë përpara se të mbarojë gjyqi". (fq. 130)	'Ç'bëjnë ashtu? – i pëshpëriti Liza Grifonit në vesh. – E ç'mund të shkruajnë para se të fillojë gjyqi? - Janë duke shkruar emrat e tyre, - u përgjigj Grifoni, që kishte zënë vend edhe ai përkrah saj. Dhe këtë e bëjnë nga frika se mos i harrojnë përpara se të mbarojë gjyqi. (fq. 131)	"Çfarë po bëjnë?" pyeti Liza Grifonin. "Shkruajnë emrin e tyre" u përgjigj Grifoni si me pëshpërimë. "Kanë frikë se mos e harrojnë përpara se gjykimi të ketë mbaruar". (fq. 140)	- Çfarë bëjnë ata? – i pëshpëriti Liza Grifonit. – Ata s'kanë ç'të shkruajnë, derisa gjyqi ende nuk ka filluar! - Shkruajnë emrat e vet, - u përgjigj me zë të ulët Grifoni, - pasi kanë frikëse mos i harrojnë ata deri në fund të gjyqit. (fq. 131)
...and I hadn't begun my	"Endé s'e kishem fillue mirë çajin – jo mâ shumë se nji javë	Akoma s'e kisha filluar mirë çajin,	- Ende s'e kisha filluar mirë çajin, jo	"Sapo kisha filluar të pija çajin ... rreth	... unë vetëm sa nisa të pi çaj ... jo më

***tea**--not above a week or so--and what with the bread-and-butter getting so thin--and the **twinkling** of the **tea**—' 'The **twinkling** of the what?' said the King. 'It began with the **tea**,' the Hatter replied. 'Of course **twinkling** begins with a **T**!' said the King sharply. 'Do you take me for a dunce? Go on!'* (fq. 47)	a diçka kështu – dhe, nga nji anë buka me gjalpë, që po hollohej, e n'anë tjetër çkëlqimi i çajit..." "Çkëlqimi i kujt?" pyeti Mbreti. "Filloi nga ç..." nisi me përgjegjë Ksul-bamësi. "Doemos çkëlqimi fillon me ç!" ia preu Mbreti, pa e lanë që t'a mbarojë fjalën. "Të marrë më quen ti mue? Vazhdó!" (fq. 122-123)	pak më shumë se një javë, dhe na njëra anë buka me gjalpë që po hollohej, dhe nga ana tjetër shkëlqimi i çajit..." "Shkëlqimi i kujt?" pyeti Mbreti. "Fillon me sh..." – u përgjegj Kapelebërësi. "Doemos, Shkëlqimi fillon me Sh!" – ja preu Mbreti pa e lënë që të mbarojë fjalën. "Mos më merr për budalla mua? Vazhdo!" (fq. 132)	më shumë se një javë dhe nga njëra anë buka me gjalpë që po hollohej, nga ana tjetër shkëlqimi i çajit... - Shkëlqimi i kujt? – pyeti Mbreti. - Filloi me sh... – u përgjigj Kapelebërësi. - Doemos, shkëlqimi fillon me sh! – ia preu Mbreti, pa e lënë të mbaronte fjalën. – Mos më merr për budalla mua? Vazhdo! (fq. 136)	një javë më parë ... dhe fetat e bukës me gjalpë bëheshin gjithnjë e më të holla ... dhe dridhja e çajit..." "Dridhjet e KUJT? pyeti Mbreti. "Dridhja filloi me çajin" u përpoq të shpjegonte Kapelebërësi. "Do të thuash se fillon me Ç" tha me egërsi Mbreti. "Nuk jam një gomar. Vazhdo!" (fq. 144)	shumë se një javë më parë, ose aty afër ... dhe diçka ndodhi me sanduiçin. Ai nisi të bëhej aq i hollë ... dhe pastaj avulloi, avulloi ... - Avulloi kush? – u çudit Mbreti. - Avulloi, avulloi ai ... – u përpoq të përgjigjej Kapelabërësi. - Kuptohet, jo ai ... – e ndërpreu i zemëruar Mbreti. – Çfarë, për budalla më merrni ju? Vazhdoni dëshminë! (fq. 135)
*'I'm a **poor man**, your Majesty,' he began. 'You're a very **poor speaker**,' said the King.* (fq. 47)	"Unë jam nji njeri i vorfën, Madhní", filloi. "Ti je nji foltàr shumë i vorfën", tha Mbreti. (fq. 123)	"Madhëri, jam një njëri i varfër!" "Ti je një *folës* i varfër", ndërhyri Mbreti. (fq. 133)	- Madhëri, jam një njëri i varfër! - Ti je folës i varfër, - ndërhyri Mbreti. (fq. 137)	"Jam një varfanjak, Madhëri!" "Je tamam një mëkatar i pandreqshëm" theksoi Mbreti. (fq. 145)	- Unë jam njeri i vogël, Madhëria juaj! – filloi ai. - Ju vërtet jeni *mjeshtër jo i madh për të folur*, - tha Mbreti. (fq. 136)
*Here one of the guinea-pigs cheered, and was immediately **suppressed** by the officers of the court. (As that is rather a hard word, I will just explain to you how it*	Këtu njani prej derrave brohoriti, por "u-shtyp" menjiherë prej Nënpunsavet të Gjyqit. (Mbassi kjo âsht nji fjalë pak a shumë e vështirë, do të ju a spjegoj se si bahet "shtypja": Ata kishin nji thes të madh lîni, të mbështjellun ke kryet me ushkurë. Në këtê ata shtinë derrin, me krye tëposhtë dhe u-ulën mbi tê).	Këtu njëri nga derrat brohoriti, por 'u shtyp' menjëherë nga nëpunsat e gjyqit. (Mbasi kjo është një fjalë e vështirë, po ua shpjegoj se si bëhej shtypja. Ata kishin një thes të madh prej liri, me grykën të	Këtu njëra nga kavjet brohoriti, por "u shtyp" menjëherë nga rojet. (Pasi kjo është një fjalë e vështirë, po jua shpjegoj se si bëhej shtypja. Ata kishin një thes të madh prej liri, me grykën të	Në këtë çast një nga Derrkucët e Indisë duartrokiti me forcë, por heshti përnjëherësh duke vështruar nga rojet. (Meqëenëse "hesht" është një fjalë e vështirë për t'u kuptuar, do t'u shpjegoj se si e	Ato çaste njëri prej derrkucëve të detit nisi të duartrokiste dhe menjëherë *u shtyp* prej nëpunësve të gjykatës. (Derisa kjo është një fjalë shumë e vështirë, unë do t'ua shpregoj juve

was done. They had a large canvas bag, which tied up at the mouth with strings: into this they slipped the guinea-pig, head first, and then sat upon it.) 'I'm glad I've seen that done' thought Alice. 'I've so often read in the newspapers, at the end of trials, "There was some attempts at applause, which was immediately ***suppressed*** *by the officers of the court," and I never understood what it meant till now.'* (fq. 47)	"Më vjen mirë që e pashë këtê punë", mendoi Liza. "Kam lexue kaq shpesh nepër fletore, ndër lajme gjyqësore: 'u-bânë disa përpjekje me brohoritë, pir *u-shtypën* menjiherë prej Nëpunsavet të Gjyqit', veçse kurrë deri tash s'e kishem kuptue se *qysh* bahej *shtypja*". (fq. 123-124)	lidhur me spango. Këtu ata futnin derrin me kokën poshtë dhe pastaj uleshin vetë mbi të). "Më vjen mirë që e pashë këtë gjë" – mendoi Liza. Kisha lexuar shumë herë nëpër gazeta në lajmet gjyqësore: 'U bënë disa përpjekje për të brohoritur, por këto *u shtypën* menjëherë nga nëpunësit e gjyqit', veç kurrë deri tashti s'e kisha kuptuar se si bëhej *shtypja.* (fq. 133)	lidhur me spango. Këtu ata futnin kavjen me kokë poshtë dhe pastaj u ulën vetë mbi të). - Sa mirë që e pashë këtë gjë! – mendoi Liza. - Kisha lexuar shumë herë nëpër gazeta lajmet gjyqësore: "U bënë disa përpjekje për të brohoritur, por këto u shtypën menjëherë nga rojet", veç kurrë tani s'e kisha kuptuar se si bëhej shtypja. (fq. 137-138)	bënë derrkucin e Indisë që të hesht. Ata kishin një thes të madh, që lidhej nga gryka me një lidhëse. Derrkucin e Indisë e futën me kokën poshtë. Pastaj rojet u ulën mbi thes). "Mirë e bënë" mendoi Liza. "Kisha lexuar shpesh nëpër titujt e gazetave: "Pati ndonjë përpjekje për të duartrokitur, menjëherë heshti nga ndërhyrja e rojeve", por deri tani nuk e kisha kuptuar ndonjëherë se kush ishte kuptimi". (fq. 145-146)	si e bënë. Ata morën një thes të madh, futën aty derrkucin e detit me kokë poshtë, lidhën grykën e thesit me litar dhe u ulën sipër tij.) "Sa mirë që e pashë si bëhet kjo! – mendoi Liza. – Unë kam lexuar shpesh në gazeta "protestat u shtypën" dhe asnjëherë s'e kam kuptuar ç'do të thoshte kjo. Tani e mora vesh!". (fq. 136-137)

*'If that's all you know about it, you may **stand down**,' continued the King. 'I can't go no lower,' said the Hatter: 'I'm on the floor, as it is.' 'Then you may **SIT down**,' the King replied.* (fq. 47)	"Në qoftë se vetëm aq din mbi tê", tha Mbreti, "atëhere mund të qëndrojsh poshtë!" "S'mund të shkoj mâ poshtë", tha Liza. "Mbi dyshemé jam! "Atëhere *ulu* poshtë!" përsëriti Mbreti. (fq. 124)	Në qoftë se di vetëm aq për të, - tha Mbreti, "atëhere mund të qëndrosh poshtë!" "S'mund të shkoj më poshtë" – u përgjegj Liza. – "Mbi dysheme jam!" "Atëhere ulu poshtë!" – përsëriti Mbreti. (fq. 134)	- Në qoftë se s'ke më gjë për të na thënë, - tha Mbreti, - ulu poshtë. - S'mund të shkoj poshtë, - u përgjigj Kapelebërësi. – Mbi dysheme jam! - Atëherë qëndro poshtë! – përsëriti Mbreti. (fq. 138)	"Nëse nuk ke gjë tjetër për të thënë", tha Mbreti "zbrit nga tribuna e dëshmitarëve!" "Nuk mund të zbres më poshtë se kaq" tha Kapelebërësi. "Jam në dysheme". "Atëherë mund të ulesh" tha Mbreti. (fq. 146)	- Në qoftë se kjo është e gjitha ajo që dini, atëherë mund të largoheni, - vazhdoi Mbreti. - Unë nuk mund të largohem, - tha Kapelebërësi, - unë po rri në gjunjë. - Atëherë ju mund të zvarriteni, - ia ktheu Mbreti. (fq. 137)

Shtojca 2

Tabela përmbledhëse me shembuj krahasues ilustrues nga përkthimi i HPaPS

Tabela nr. 24 ***Emrat e përveçëm – Studentët në Hogwarts***

Anglisht	**Shqip**
Hannah Abbott (H)	Hanah Abot
Susan Bones	Suzana Hosas
Terry Boot	Terri But
Mandy Brocklehurst	Mandi Brokëllhërst
Katie Bell (G)	Keti Bell
Lavender Brown (G)	Lavanda Braun
Millicent Bulstrode	Milisenti Bullstrod
Justin Finch-Fletchley (H)	Xhastin Finç-Fletçij
Seamus Finnigan (G)	Simus Finigan
Morag MacDougal	Moragut MekDugal
Lisa Turpin	Liza Torpin
Blaise Zabini	Blejzi Zabini
Marcus Flint (S)	Markus Flinti
Hermione Granger (G)	Hermionë Granxher
Crabbe, Goyle	Tersi, Gojli
Terence Higgs (S)	Terens Higsi
Lee Jordan (G)	Li Xhordan
Neville Longbottom (G)	Nevil Longbotomi
Draco Malfoy (S)	Drako Mallfoi
Pansy Parkinson (S)	Pansi Parkinsoni
Parvati Patil (G)	Kal Patili
Sally-Anne Perks	Salli Anë Perks
Harry Potter (G)	Harri Poter
Adrian Pucey (S)	Adrian Pjusi
Alicia Spinnet (G)	Alis Spineti
Dean Thomas (G)	Din Tomasi
Fred Weasley (G)	Fredi Uezli
George Weasley (G)	Xhorxhi Uezli
Ginny Weasley (G)	Xhini Uezli
Percy Weasley (G)	Persi Uezli
Ron (Ronald) Weasley (G)	Ron-i Uezli
Oliver Wood (G)	Oliver Bastuni
Angelina Johnson (G)	Anxhelinë Xhonson

Tabela nr. 25 ***Emrat e përveçëm – Stafi dhe profesorët në Hogwarts***

Anglisht	**Shqip**
Albus Dumbledore (Headmaster)	Albus Urtimor (Drejtor)
Professor Minerva McGonall (Deputy Headmistress) (Transfiguration)	Profesoresha Minerva MekGur (Nëndrejtoreshë) (Ndërrimi i Pamjes)
Madam Pomfrey (nurse)	madamë Pomfri
Rubeus Hagrid, Keeper of Keys and Grounds at Hogwarts	Rubeus Hagrid. Roja i Çelësave dhe i Vendeve në Hoguorts
Doris Crockford	Doris Krokfordi
Professor Quirrell (Defence against the Dark Arts)	Profesor Grepsi (Mbrojtja ndaj Arteve të Errëta)
Professor Severus Snape (Potions)	profesor Severus Pitoni (Shurupet)
Professor Binns (History of magic)	Profesor Binsi (Historia e Magjisë)
Professor Flitwick, the Charms teacher	profesor Flituiku, mësuesi i namatisjeve
Professor Sprout (Herbology)	profesor Bifka (Shkenca e Barërave)
Argus Filch (Caretaker)	Zoti Laraska, Argus Laraska (rojtari)
Madam Hooch (Quidditch)	madamë Huku (Kuidiç)
Madam Pince (the librarian)	
Professor Flitwick, the Charms teacher	profesor Flituiku, mësuesi i namatisjeve

Tabela nr. 26 ***Emrat e përveçëm – Magjistarë të tjerë***

Anglisht	**Shqip**
Doris Crockford	Doris Krokfordi
Dedalus Diggle	Dedalus Luksi
Nicolas Flamel	Nikolas Flamel
Miranda Goshawk	Miranda Gadula
Arsenius Jigger	Arsenius Lëngus
Madam Malkin	Madamë MekKlan
Mr. Ollivander, Ollivanders	Zoti Ulliander, Ullianderi
Newt Scamander	Njut Skamandri
Phyllida Spore	Filida Spori
Emeric Switch	Emerik Zoti
Quentin Trimble	Dante Dredhësi
Vindictus Viridian	Vindiktus Viridiani
Voldemort, You-Know-Who, He-Who-Must-Not-Be-Named	Fluronvdekje, Ti-E-Di-Kushi, Ai-Që-S'Duhet-Përmendur
Tom Marvolo Riddle	
Adalbert Waffling	Adalbert Yshti
Bill and Charlie Weasley	Billi dhe Çarli Uezli
Young Sirius Black	Djaloshi Sirius Blek
old Cornelius Fudge (Minister of Magic)	plaku Kornelius Gjelsheqeri (Ministria e Magjisë)
Morgana	Zanamirë
Hengist of Woodcroft	Hengisti, xhuxhi i Pyjeve
Alberic Grunnion	Alberik Grunioni
Circe, Paracelsus, and Merlin	Circe, Paraçelsi dhe Merlini
Druidess Cliodna	orakullja Kliodna
a powerful Dark wizard	magjistar i fuqishëm i të Keqes
Sir Nicholas de Mimsy-Porpington	Sër Nikolas de Mimsi-Porpington
Nearly Headless Nick	Niku-Zëre-Pa-Kokë
Bloody Baron	Baroni Gjakatar
Peeves, A poltergeist	Ngaci, një Poltergeist
Emetic the Evil and Uric the Oddball	Emerikut të Lig dhe Urik Kokëmarrit
Wizard Baruffio	Magjistari Kacafyti
Common Welsh Green and Hebridean Blacks	Dragoi i Blertë i Uellsit dhe i Ziu i Ishujve Hibride
Norwegian Ridgeback; Norbert the Norwegian Ridgeback	Kurrizrrudhur i Norvegjisë; Norberti, dragoi kurrizrrudhur i Norvegjisë

Tabela nr. 27 ***Tituj librash, lëndë në shkollë, shurupe dhe namatisje***

Anglisht	**Shqip**
Tituj librash	
The Standard Book of Spells (Grade 1) by Miranda Goshawk	Doracak i Yshtjeve, Vëllimi i Parë, *nga Miranda Gadula*
A History of Magic by Bathilda Bagshot	Historia e Magjisë, *nga Bathilda Bath*
Magical Theory by Adalbert Waffling	Teoria e Magjisë, *nga Adalbert Yshti*
A Beginners' Guide to Transfiguration by Emeric Switch	Udhëzues praktik i shndërrimit për fillestarë, *nga Emerik Zoti*
One Thousand Magical Herbs and Fungi by Phyllida Spore	Një mijë barna dhe kërpudha magjike, *nga Filida Spori*
Magical Drafts and Potions by Arsenius Jigger – *Fantastic Beasts and Where to Find Them by Newt Scamander-*	Çaje dhe shurupe të ndryshme, *nga Arsenius Lëngus* Kafshët fantastike: ku mund të gjenden, *nga Njut Skamandri*
The Dark Forces: A Guide to Self-Protection by Quentin Trimble	Forcat e errëta: udhëzues për vetëmbrojtje, *nga Dante Dredhësi*
Curses and Countercurses (Bewitch Your Friends and Befuddle Your Enemies with the Latest Revenges: Hair Loss, Jelly-Legs, Tongue-Tying and Much, Much More) by Professor Vindictus Viridian.	*Mallkime dhe Kundërmallkime (Shtrigojini miqtë dhe hutojini armiqtë me të fundit thirrje hakmarrjesh: rënie flokësh, këmbë të squllura, gjuhë të lidhur dhe shumë gjëra të tjera*) shkruar nga profesor Vindiktus Viridiani.
Great Wizards of the Twentieth Century, or *Notable Magical Names of Our Time*; *Important Modern Magical Discoveries*, and *A Study of Recent Developments in Wizardry*.	*Magjistarët e Mëdhenj të Shekullit XX, Figura të shquara të magjisë të kohës sonë, Zbulimet e rëndësishme të magjisë modern, Përmbledhja e zhvillimeve të reja të magjisë*
Study of Recent Developments in Wizardry	*Përmbledhja e zhvillimeve të reja të magjisë*
Dragon Breeding for Pleasure and Profit	*Si të rritim dragonj për punë dhe për të kaluar kohën*
Dragon Species of Great Britain and Ireland; From Egg to Inferno, A Dragon Keeper's Guide.	*Llojet e dragonjve të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës … Nga veza te perënditë e skëterrës: doracak praktik për rritësit e dragonjve*
Hogwarts, A History	*Historia e Hoguortsit*
Quidditch Through the Ages	*Kuidiçi gjatë shekujve*
Lëndë në shkollë	
D-Defense Against the D-D-Dark Arts	M-mbrojtjen k-k-undër Arteve t-t-ë Errëta
Transfiguration	Ndërrimi i Pamjes
Herbology	Shkenca e Barërave
Potions	Shurupet
Dark Arts	Arte të Errëta
Shurupe dhe namatisje	
Draught of Living Death	Distilat i Vdekjes së Gjallë

Switching Spells	Namatsjet e Shndërrimit
Curse of the Bogies	Mallkimin e Fantazmave
There was an inscription carved around the top: *Erised stra ehru oyt ube cafru oyt on wohsi*.	Në majë kishte të gdhendur mbishkrimin: *Kun joryqsap tarytyf rop tarmez.*
Mirror of Erised	Pasqyra e Dëshirave
Leg-Locker Curse	Magjia e Këmbëve të Lidhura
Elixir of Life	*Barin e Jetëgjatësisë*
Warlocks' Convention of 1709	Marrëveshja e Shtriganëve e vitit 1709
1637 Werewolf Code of Conduct or the uprising of Elfric the Eager	Kodi i Sjelljes së Ujqërve të Egër të vitit 1637 apo kryengritja e Elfrik Halleshumit
Petrificus Totalus!	*"Nguros Gjithus!"*
the full Body-Bind	Namatisja e Lidhjes së Tërë Trupit
Devil's Snare	Kurthi i Djallit

Tabela nr. 28 ***Emrat e përveçëm – familjarët***

Anglisht	**Shqip**
Mr. and Mrs. Dursley; the Dursleys	Zoti dhe zonja Dërsli; Dërslit
Petunia	Petunia
Dudley	Dadli
Lily and James Potter	Lili dhe Xhejms Poteri
the Potters	Poterët
their son, Harry	djali i tyre Harri
Jim McGuffin	Xhim MekGafini
Hagrid	Hagridi
Uncle Vernon	Xhaxha Vernoni
Auntie Marge	hallë Marxhi
Mrs. Figg	Zonja Fig
Tibbles, Snowy, Mr. Paws, and Tufty	Fufët e bufët e Pisot e Topçet
Piers Polkiss	Pirs Polkisi
McKinnons, the Bones, the Prewetts	MekKinonët, Bonët, Priuetët
Great Auntie Enid	hallë Enida
Great Uncle Algie	Stërungji Alxhi, Ungji Alxhi

Tabela nr. 29 ***Emrat e rrugëve, adresa, (ekzistuese dhe të shpikura)***

Anglisht	**Shqip**
Adresa ekzistuese	
Privet Drive	rruga Privet Drajv
Bristol	Bristol
London	Londër
Paddington station	Padington Steshjon
King's Cross	King's Kross
Romania	Rumani
Devon	Devon
Mars	Marsi
Adresa të shpikura	
firm called Grunnings	firme që quhej Grunings
Godric Hollow	Golldriks Hau
Diagon Alley	Diagon Alli
Smeltings	Snobkin (shkolla private)
Stonewall High	Stonuoll Haj (shkolla publike)
HOGWARTS SCHOOL of WITCHCRAFT and WIZARDRY	*SHKOLLA E MAGJISË DHE SHTRIGËRISË E HOGUORTSIT*
Mr. H. Potter *The Cupboard under the Stairs* *4 Privet Drive* *Little Whinging* *Surrey*	*Z. H. Poter* *Bimsa nën shkallë* *4, Privet Drajv* *Litël Huingin* *Sërri*
Mr. H. Potter, The Floor, Hut-on-the-Rock, The Sea	*zotit H. Poter, Kati përdhes, Kasollja përmbi shkëmb. Det.*
Mr. H. Potter, The Smallest Bedroom, 4 Privet Drive —'"	Zotit H. Poter, Dhomëza, 4 Privet Drajv
Mr. H. Potter *Room 17* *Railview Hotel* *Cokeworth*	*Zotit H. Poter* *Dhoma 117* *Reilviu Hotel* *Kokuorth*
Gringotts. Wizards' bank.	Gringoti – banka e magjistarëve
the Leaky Cauldron	Kusia magjike
a shop called Flourish and Blotts	një dyqan që quhej *Shkarravina*
Eeylops Owl Emporium	Qendra Tregtare e Bufit
The Ministry of Magic	Ministria e Magjisë
Hog's Head	pijetorja "Koka e Derrit"
Herbology	salla e Shkencës së Barërave
Restricted Section	Reparti i ndaluar, Reparti i Ndaluar
Madam Malkin's Robes for All	Madamë MekKlan-it: veshje për të

Occasions.	gjitha rastet
Great Hall	Salla e Madhe
Gryffindor	Grifarti
Hufflepuff	Baldoskuqi
Ravenclaw	Korbziu
Slytherin	Gjarpërblerti
Blackpool pier	moli i Blekpullit

Shtojca 3

Intervistë me përkthyesit *Taulant dhe Eri Tafa* (varianti IV i AAiW)

Më poshtë mund të lexoni një intervistë zhvilluar me përkthyesit *Taulant dhe Eri Tafa* që e kanë sjellë *Alice's Adventures in Wonderland* në gjuhën shqipe për publikun shqiptar në vitin 2008. Në punimin tonë këtij përkthimi i jemi referuar si varianti i katërt, pasi shfaqet i katërti në rend kronologjik në lidhje me variantet nën shqyrtim.

1. Çfarë lloj veprash ju tërheqin më shumë për t'u përkthyer? Si e vendosni paraprakisht se cilën vepër do të përktheni? Çfarë vepra të tjera keni përkthyer para kësaj vepre?

Edhe pse nuk ka një vijë ndarëse të hekurt, pamëdyshje do të pohonim se parapëlqejmë për të përkthyer ato vepra ku autorët i kalojnë kufijtë e një realizmi të mirfilltë. Me realizmin e mirfilltë, nëse na lejohet ta përdorim një përcaktim të tillë, edhe pse jo një term i sanksionuar nga kritika dhe analiza letrare, kemi parasysh ato drejtime letrare që janë konservatorë në rikrijimin fotografik, natyralist, klasik, dhe më keq akoma dogmatik të realizmit. Brenda këtyre kufijve flu preferencialë, ndoshta diku brenda nesh më të afërt janë ato lloj drejtimesh letrare si realizmi magjik, apo të përafërt me të, edhe pse ndonjëherë kuptimi lëndësor artistik i tyre, veçanrisht kur është fjala për tu shndërruar nga një gjuhë në tjetrën, është i diskutueshëm. Zakonisht kur është folur apo flitet për drejtime letrare, analiza është përqëndruar në grupime veprash me përbashkësi konceptuale, stilistikore, etj, që u drejtohen një lexuesi në moshë madhore. Në të vërtetë, në atë që zakonisht, me apo ndonjëherë pa të drejtë, e quajmë letërsi për fëmijë, (kur bëhet fjalë për kryeveprat), pavarësisht nëse janë apo nuk janë kodifikuar në rryma letrare, gjenden mrekullira artistike që të shtangin me pafundësinë e lirshmërinë e prurjeve të tyre në të gjithë komponentët e një vepre letrare. Mund të gabohemi, po ndoshta, ndonjëherë shpallja e veprës letrare nga autori si për fëmijë, të duket si një " truk" si një "pasaportë" për t'u pranuar më lehtësisht nga lexuesi. E pandarë nga kjo lloj letërsie, për ne është tejet tunduese për t'u shqipëruar, përralla si vepër letrare, si një vepër që pavarësisht nga numri i faqeve të shtang me pasurinë e formave dhe mjeteve shprehëse, por edhe me strukturën e saj stilistikore. Nëse do ta mpiksim sadopak mendimin tonë, do të thoshim se parapëlqejmë të sjellim në gjuhën shqipe atë lloj letërsie që ne nuk na kufizon të shprehemi artistikisht, nuk na bën të ngurtë, por i jep udhë edhe frymëzimit tonë, na bën në një lloj mënyre të ndjehemi të lirë e për një çast të harrojmë se e ka shkruar dikush tjetër veprën letrare e të "gënjejmë" veten sikur po e shkruajmë ne nga e para.

Më shumë se një vendosje paraprake, ne i besojmë frymëzimit. Veçanërisht, tanimë që u jemi përkushtuar edhe botimit, e nuk jemi të kushtëzuar nga institucione apo hallka të tjera zvarrisëse të proçesit të botimit, e kemi më të lehtë që gjer në çastin e fundit të përcaktojmë atë vepër që do të shkojë tek lexuesi. Natyrisht ka një lloj "nuhatjeje", "parandjenje", të asaj që mund të pëlqehet e mirëpritet. Shtysë mbetet gjithnjë kënaqësia që të afron kthimi në gjuhën tënde i një kryevepre latrare dhe e ritheksojmë se një kryevepër letrare për fëmijë, në gjykimin tonë, shumë herë është edhe më shumë se një kryevepër letrare që u drejtohet të rriturve. Ndoshta jemi të gabuar, por në bindjen tonë një kryevepër letrare për fëmijë, është një kryevepër letrare edhe për të rritur.

Pa e kuptuar ndodh që fondi i veprave që seleksionon për të përkthyer, rritet dhe për më tepër, ndonjë vepër që e ke nisur për ta përkthyer mbetet në mes të udhës përkohësisht, e një tjetër e paparashikuar, të rrëmben e nuk i shqitesh.

Nga veprat më të rëndësishme përpara se të përkthenim "Liza në botën e çudirave" do të veçonim tre romane të Dino Buxatit: "Barnaboja i maleve", "E fshehta" dhe "Shpirti". Edhe pse në dy nga ata, kemi dalë me emra të veçantë, të tre i kemi kaluar bashkërisht në duar dhe mbetën në thelb një punë e përbashkët. Nuk besojmë se të ka rënë rasti, t'i njohësh këto vepra sepse ka kohë që nuk janë në qarkullim e kur janë botuar kanë kaluar gati në heshtje, e mbase ka patur një përpjekje të mundimshme edhe për t'i përçmuar. Këto janë vepra që i përkasin periudhës më të hershme krijuese të Buxatit, por që në gjykimin tonë, edhe pse kritika letrare moderne në Itali apo në Europë, nuk i ka trajtuar aq gjërësisht, janë ndoshta nga mrekullitë letrare jo vetëm të Buxatit, por në një rrafsh të letërsisë moderne europiane. Veçanrisht "E fshehta" dhe "Shpirti" janë një risi dhe dimensionojnë një realizëm magjik europian, krejt i ndryshëm nga realizmi magjik latinoamerikan. Në këtë përqasje, veçanrisht "E fshehta", edhe pse i përket periudhës më te hershme krijuese të Buxatit, (është romani tij i dytë, i shkruar pas "Barnaboja i maleve"), për nga kompleksi i ardhjeve stilistikore, ngrihet shumë më lart edhe se "Shkretëtira e Tartarëve". Ky është një mendim krejt subjektiv që mbase, në një çast të mëvonshëm, në një kohë të mundshme, do të kishim dëshirë ta analizonim.

Nga veprat e para të rëndësishme që kemi përkthyer e që ndjehemi mirë që kemi guxuar në një ndërmarrje të tillë pasionante, ka qenë "Pinoku" i Karlo Kolodit. Kemi bindjen se "Pinoku" ynë, ka ardhur në shqip, ndryshe nga shumë variante të tjerë që janë edhe sot në qarkullim dhe ndoshta është edhe më i pëlqyeri nga lexuesit.

Mbase, paralelisht, apo vetëm pak kohë më parë se të sillnim "Lizën" në gjuhën shqipe, kemi përkthyer "Pipi Çorapegjata" të Astrid Lindgrenit, "Xhipi në televizor dhe udhëtime të tjera në orbitë" dhe disa vepra të tjera të Xhani Rodarit, një mori me përralla-tregime nga Alberto Moravia të përmbledhura në një vëllim të titulluar "Përralla", një seri përrallash kryesisht nga Anderseni dhe Vëllezërit Grimm, etj, etj.

2. Kur dhe pse vendosët të përkthenit këtë vepër nga Lewis Carroll? A keni lexuar vepra të tjera të këtij autori? Çfarë mendimi keni për to? Edhe vetë Lewis Carroll e ka shkruar disa herë këtë vepër. Ju në cilin botim jeni bazuar për përkthimin tuaj?

Nuk e besojmë se ka patur një datë apo një kohë të fiksuar për përkthimin e kësaj vepre. Natyrisht krijohet gradualisht një thirrje e heshtur në thellësitë misterioze të pavetëdijes fillimisht e që e ndjen se kërkon të ngrihet lart, të artikulohet, të bëhet pjesë e vetëdijes së përgjithshme dhe vetëdijes artistike. Duhet të ketë qenë një bashkëjetësë e trashëguar, e prejardhur nga fëmijëria, nga filmat, emisionet televizive, përshtatjet letrare, nga leximi i parë në gjuhën shqipe. Ka disa vepra e personazhë që të ndjekin ndoshta nga fëmijëria e të bëhen bashkëudhëtarë në jetë, si "Liza", "Princi i vogël", "Nilsi", "Pipi", "Pinoku", etj, etj. Por me siguri, që në kohën e studimeve në Itali, variantet e përkthyera në gjuhën italiane duhet të kenë qenë dhe kanë qenë përcaktues, sepse ata pothuajse e kanë rishkruar në gjuhën italiane dhe kanë krijuar një vepër të re të afërt për lexuesin që i janë drejtuar. Këto variante të kthimit nga vepra originale në një gjuhë tjetër, janë në thelb një shkollë e veçantë, e diskutueshme dhe subjektive sigurisht, por edhe pafundësisht tunduese. Ky tundim, kjo joshje na ka shtyrë që të provojmë pa nguruar. Shqipërimi i "Lizës" ishte një dëshirë, një thirrje, një pasion, një plotësim i vetes në një formë poetiko romantike në një botë aventurash që edhe pse jo reale, e besueshme dhe ekzistente për ne. Ne nuk kemi patur ndonjë trysni, detyrim ndaj dikujt, një botuesi, një shtyse financiare apo një motiv tjetër të këtij lloji. Shtysa jonë ka qenë frymëzimi, një frymë që të bën të

ndjehesh mirë, një frymë që të bën të gufosh mushkëritë në një çast e t'i shfrysh në një çast tjetër, e të ndjesh përsëri nevojën për t'u mbushur thellë me frymë e për të shfryrë përsëri, e përsëri. Ne nuk kemi dashur të konkurojmë me ndonjë përkthim a shqipërim tjetër.

E kemi lexuar pothuajse të gjithë veprën letrare të tij. Vepra shkencore është e largët për ne.

Kemi dëshirë që dikur të kthehemi tek vepra e tij letrare, por shkëlqimi i "Lizës" na bën të ngurojmë.

Për shqipërimin në gjuhën shqipe, ne jemi mbështetur kryesisht në një përkthim të Alessandro Ceni-it të botuar nga "Einaudi" dhe në një përkthim të Masolino D'Amikos të botuar nga "Mondadori". Në variantin anglisht jemi mbështetur e ballafaquar në një botim të vitit 1994 të botuar nga Barnes & Noble Books, por edhe me variante të tjera që nga botimi i tij fillestar.

3. Sipas mendimit tuaj, cilit lloj publiku i drejtohet vepra origjinale? Po ju vetë, cilit publik i drejtoheni me variantin tuaj të përkthimit?

Ne mendojmë se vepra originale, në thelbin e saj, i drejtohet edhe një lexuesi të rritur. Edhe ne jemi munduar që duke ruajtur joshjen për lexuesin e moshave të ulta dhe adoleshente në thelb, t'i drejtohemi një lexuesit pa moshë më saktë pa një kufi moshe. Nëse kjo është arritur apo jo është diçka tjetër. Duke pohuar këtë, pra drejtimi tek një lexues pakufi moshe, nuk mund të mohohet thirrja parësore për lexuesin e një moshe fillestare.

4. Përpara ose gjatë përkthimit të veprës a keni shfletuar dhe krahasuar përkthime të mëparshme në gjuhën shqipe? Po përkthime në gjuhë të tjera? Nëse po, cfarë mendimi keni për to? A ju ka ndihmuar krahasimi në punën tuaj?

Me përkthime të tjera në gjuhën shqipe kemi patur fillimisht pozicionin e lexuesit. Mbas botimit të variantit tonë, kemi shfletuar për të njohur mënyrat e ardhjeve të tjera në gjuhën shqipe. Por variantet e përkthimeve nga anglishtja në italisht, dy nga të cilët i kemi cituar edhe më lart, na kanë frymëzuar dhe i kemi patur gati si udhërrëfyes për të krijuar frymën e shqipërimit tonë. Cilësisht duam të ritheksojmë se ato variante janë gati një rikrijim i bukur e i freskët në një gjuhë tjetër.

5. Duke menduar për punën e bërë dhe pasi e keni rilexuar variantin e prodhuar prej jush në shqip, a mendoni se ka qënë i lehtë përkthimi i kësaj vepre?

I lehtë natyrisht jo, por i frymëzuar. Frymëzimi, dëshira për të provuar pa e ditur rezultatin, na ka rrëmbyer, na ka marrë me vete. Ne nuk kemi nguruar të provojmë. Në të vërtetë duam ta rimarrim edhe një herë në duar, por ende nuk mund të themi se kur do të ulemi edhe një herë tjetër.

6. "Alice's Adventures in Wonderland" është konsideruar si një gur prove për përkthyesit në të gjithë botën, kryesisht për shkak të lojërave të fjalëve që përmban origjinali të cilat janë të natyrave të ndryshme dhe, rrjedhimisht, krijohen vështirësive të krijuara gjatë përcjelljes së tyre nga njëra gjuhë në tjetrën. A mendoni edhe ju se vështirësia kryesore në përkthimin ne veprës qëndron në përkthimin e lojërave të

fjalëve? A mund të sillni një shembull për të treguar se çfarë strategji keni përdorur në përkthimin e tyre? Si mendoni, lojërat e fjalëve duhen përkthyer apo duhen rikrijuar? Çfarë vështirësish të tjera keni hasur dhe si keni vepruar për t'i kapërxyer ato?

Tani, pasi e vështrojmë veprën e shqipëruar, mund të themi se jo vetëm fati nuk na ka çuar në atë udhë ku ka çuar pothuajse të gjitha botimet në gjuhën shqipe e mbase në udhën e duhur. Fillesa, drejtimi patjetër ka qenë instiktiv, pastaj më tej duke shkuar më tutje apo duke u rikthyer edhe njëherë apo shumë herë mbi atë që shqipërohej, hap pas hapi e ndjeje se e gjithë kjo lojë fjalësh, ishte një komponent i një tërësie të padukshme që krijon të gjithë veprën e që ne do ta quanim frymë artistike. Kjo frymë krijohet nga fjala e shkruar në libër, por nuk është vetë fjala, është përtej fjalës, prandaj dhe është e padukshme. Si mund të përkthehet e padukshmja, fryma? Si mund të përcillet në një gjuhë tjetër? Përcjellja e kësaj fryme është e domosdoshme, se diçka që nuk frymëmerr, është pajetë, e asfiksuar, e vdekur. Në veprën originale, këtë frymë e krijon autori, është frymë e shpirtit të tij. Ajo është e padukshme, por e ndjeshme, e prekshme. Ai që guxon ta përcjellë veprën në një gjuhë tjetër, duhet të përcjellë edhe këtë pjesë të padukshme që krijohet nga fjala e autorit, por nuk është më fjalë, është gjendje. Përkthyesit në këtë rast do t'i duhej një klonim shpirti, por shpirti nuk klonohet. Ai duhet të mundohet që me fuqinë e shpirtit të tij të krijojë sadopak frymën e paarritshme të dikuj tjetri, të autorit. "Liza në botën e çudirave" të magjeps e të fut në grackë me joshjen që të krijon për të krijuar frymën, për të fantazuar, për t'u futur në një lojë të madhe të të gjithë strukturës artistike, dhe befas përkthyesi gjendet përballë një loje të madhe, loje të fjalës. Nëse, pavarësisht nga niveli i njohjes së gjuhës, do të fillojë të përkthejë lojën e fjalëve, gjykojmë se do të futet në një labirinth nga i cili vështirë se mund të dalë e vështirë se mund t'i prekë fundin. Atij i duhet të krijojë në gjuhën e tij, lojën e fjalës, por që ta krijojë këtë lojë i duhet qoftë edhe minimalisht, përmasa e krijimit, e të shkruarit. Sa më e fuqishme të jetë kjo përmasë aq më e pranueshme do të jetë edhe loja e tij me fjalën.

Ne nuk kemi synuar të përkthejmë lojën e fjalës nga anglishtja në gjuhën shqipe ose nga italishtja në gjuhën shqipe, por të krijojmë në gjuhën shqipe lojën tonë me fjalën në një emërues të përbashkët, në të njëjtin funksion artistik me atë të veprës origjinale. Sa e kemi arritur? Kjo është një çeshtje tjetër…

7. A keni menduar që ndonjë lojë fjalësh apo ndonjë pjesë të vështirë për t'u kuptuar ta sqaronit nëpërmjet shënimeve në fund të faqes?

Jo. Letërsia është arti i të shkruarit dhe ne jemi munduar ta sqarojmë jo nëpërmjet shënimeve në fund të faqes, por trajtimit artistik të fjalës.

8. A mendoni se edhe përkthimi, në fund të fundit, mbetet një krijim dhe, si i tillë, gëzon status të mëvetësishëm në gjuhën që përkthehet?

Absolutisht po.

9. Në veprën origjinale mund të shikojmë se ka një sërë poezish të përfshira jo pa qëllim nga Carroll. Poezitë në variantin tuaj nuk janë përkthyer fjalë për fjalë dhe gëzojnë rimë. Sipas mendimit tuaj, nëse duhet të zgjidhnit mes kuptimit dhe rimës, kë do të sakrifikonit?

Ndoshta mes kuptimit dhe rimës do të duhej të sakrifikohej rima ose më saktë duhet kërkuar për një ardhje të kuptimit në një nivel sa më të lartë artistik.

10. Poezitë e përmendura krijojnë efekt parodik në origjinal. Po ju, a jeni përpjekur të rikrijoni një efekt të tillë?

Ne jemi munduar të shmangim, pavarësisht në e kemi arritur apo jo, atë lloj "parodie" që është disi e pakuptueshme apo që mund të kuptohet me vështirësi nga një lexues shqiptar, veçanrisht ai i moshave të vogla dhe të nënvizojmë domethënien poetike të poezisë. Përgjithësisht jemi munduar të ruajmë një natyrë stilistikore të poezive.

11. Libri origjinal përmban një sërë figurash nga John Tenniel. Shohim se varianti juaj nuk përmban figura. Pse keni bërë një zgjedhje të tillë? Nëse do të ribotonit përkthimin, a do të vendosnit të përfshinit figura? A do të ishin këto figura ashtu si dhe në veprën origjinale apo do të bënit skicime të tjera? Po në lidhje me kopertinën e zgjedhur, si e keni bërë këtë zgjedhje?

E vërteta është se ilustrimet e John Tenniel-it janë të mrekullueshme dhe me kalimin e kohës kanë fituar një goxha vlerë. Mos botimi ynë me ilustrime, më tepër ka qenë një çeshtje jo artistike, por me probleme të tjera që lidheshin me dëshirën e futjes dhe tërheqjes së librit nga tregu. Në një ribotim të ilustruar do të na pëlqente më shumë ta botonim me të njëjtat ilustrime ashtu si në veprën origjinale. Kjo natyrisht nuk është kategorike.

Kopertina është punuar nga piktori Ergys Faja i cili na ka ilustruar edhe disa botime të tjera.

12. Sipas mendimit tuaj, varianti i sjellë nga ju në gjuhën shqipe gëzon cilësinë e përkthimit apo të shqipërimit?

13. A mendoni se referencat kulturore duhen përshtatur dhe zëvendësuar në gjuhën shqipe apo duhen transferuar siç janë në origjinal?

Mendojmë se duhen përshtatur dhe zëvendësuar në gjuhën shqipe.

14. A jeni duke përkthyer ndonjë vepër tjetër për momentin dhe cilën? A ka ndikuar përvoja e përkthimit të Alice's Adventures in Wonderland në përzgjedhjen e librave të tjerë për t'u përkthyer apo në mënyrën se si ju e shikoni tashmë proçesin e të përkthyerit?

Po shqipërojmë veprën letrare të shkrimtares nobeliste suedeze Selma Lagërlëf.

Eksperienca me "Liza në botën e çudirave", në kuptimin e plotë të fjalës, i ngjan një lloj shkolle dhe për mungesë kohe ne nuk po sjellim argumente.

Pas "Liza në botën e çudirave" ne kemi shqipëruar një mori romanesh dhe veprash të tjera letrare si "Aventurat e Çipolinos", "Torta që ra nga qielli" (e një seri veprash të tjera të Xhani Rodarit), "Pipi në anije", "Pipi në detrat e jugut", "Emili", Emili i tmerrshëm", "Emili i pamposhtur nga Astrid Lindgren; "Barka e ëndrrave" të Ervin Moster, "Para Adamit" të Xhek Londonit, "Zemra" i De Amiçis, një seri me përshtatje me 50 kryevepra të letërsisë botërore (janë në proçes botimi), kolanat e botimeve me përralla të ilustruara të shtëpisë botuese dhe filmike Vëllezërit Tafa, etj, etj.